BERZH PIRANJANI

INDO-EUROPA

SHQIPTARËT DHE ARMENËT
SHQIPJA DHE ARMENISHTJA



albPAPER

BERZH PIRANJANI

INDO-EUROPA

SHQIPTARËT DHE ARMENËT
SHQIPJA DHE ARMENISHTJA

(Nxjerrë nga shkrime të studjuesve
Shqiptarë dhe të Huaj)

albPAPER
TIRANË, 2021

Përgatiti për shtyp: Berzh Piranjani
Redaktoi: Berzh Piranjani
Art Grafik: Orest Muça

Mundësuan botimin:
Berzh dhe Varuzhan Piranjani

Çdo përdorim ose ribotim i këtij libri për qëllime komerciale ndalohet.
Tirazhi 100 kopje

ISBN 978-9928-05-278-0

Shtëpia Botuese “albPaper”, Tiranë, 2021
Rruga: “Shemsi Haka”, ish-Poligrafiku, Tiranë
Tel.: +355 42 35 89 37

Prindërve tanë,

VAHRAM dhe ELENI

Që shkuan të prehen në paqe,

Që i dhanë jetë jetës pa kërkuar asgjë,

Që na ushqyen dashurinë dhe respektin për njerëzit,

Që na edukuan dëshirën dhe vullnetin për dijen,

Ne dhe pasardhësit tanë …

“Mbas errësirës lind drita,
dhe mitologjisë e vërteta.”

Joseph Ritter von Xylander

PËRMBAJTJA

Kap. 1 Indo-Europa dhe Shqiptarët 7

Kap. 2 Indo-Europa dhe Armenët 225

Kap. 3 Indo-Europa dhe Histori të Lashta 287

Kap. 4 Pema e gjuhëve Indo-Europiane 321

Kap. 5 Shqipja dhe Armenishtja: Motra apo kushërira?! 339

Kap. 6 Interpretime 473

a. Interpretimi skematik i Pemës Gjenealogjike të Noes sipas librit "Historia e Hajkut dhe Bel Nimrodit" me autor G. Nalbandian 477

b. Interpretime të emrit – Pellazg 487

c. Interpretime të emrit – Alban 527

d. Interpretime të emrit Geg-Tosk 573

e. Interpretime të emrit – "Grek – Helen - Ion - Dor" 611

Kap. 7 Në vend të mbylljes 663

A. Disa emra historianësh, gjuhëtarësh apo studjues të fushave të ndryshme që përmenden në faqet e këtyre shkrimeve 705

B. Literatura e Përdorur 711

KAPITULLI 1

INDO-EUROPA DHE SHQIPTARËT

(Nxjerrë nga shkrime të studjuesve Shqiptarë dhe të Huaj)

PËRMBAJTJA

(Renditja sipas datës së botimit për herë të parë)

1. Bernardino de Bindoni: Scanderbeg – Princi i Epirit 17
2. Johann Thunmann: Historia dhe gjuha e Shqiptarëve dhe Vllehëve 19
3. Joseph Ritter von Xylander: Gjuha e Albanëve ose Shkipëtarëve..... 25
4. Johan Georg von Hahn Dr. Jur.: "STUDIME SHQIPTARE" ... 31
5. J. Ph. Fallmerayer: "Elementi shqiptar në Greqi" 45
6. Robert Ellis: "Origjina Armene e Etruskëve" 51
7. Jani Vreto: "Vepra te Zgjedhura" 57
8. Naim Frashëri: "Homeri, Iliada; Kënga e Parë"..... 67
9. Wilhelm Obermüller: Popujt e Alpeve 71
10. Stanislao Marchiano: Studime filologjike zhvilluar me gjuhën Pellazgo-Albane 79
11. Eduard Shnaider: "Pellazgët e pasardhësit e tyre" 91
12. Sir Patrick Colquhoun & Vaso Pasha: "Pellazgët, Pasardhësit e tyre të sotëm dhe origjina pellazge e poemave të Homerit" 95
13. Karl Grimberg: Historia botërore dhe qytetërimi (Libri 1) ... 101
14. Spiro Konda: "Shqiptarët dhe problemi pellazgjik" 109
15. Zacharie Mayani: "Etruskët fillojnë të flasin" 117

16. Shaban Demiraj: “Epiri, Pellazgët, Etruskët dhe Shqiptarët”.....123
17. Eqrem Çabej: “Hyrje në indoeuropianistikë” 125
18. Robert D’Angely: “ENIGMA, nga pellazgët tek shqiptarët”..... 127
19. Luigi Luca Cavalli-Sforza: Gjenet, Popujt dhe Gjuhët..... 131
20. Edwin Jacques: “SHQIPTARËT. Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme”..... 135
21. Kristo Frashëri: “ETNOGJENEZA E SHQIPTAREVE” 139
22. Aleksandër Meksi: “Albania e Kaukazit dhe shqiptarët”..... 145
23. Nermin Vlora Falaski: “Pellazgët, Ilirët, Etruskët, Shqiptarët”.. 151
24. Aristidh P. Kola: “Arvanitasit dhe prejardhja e grekëve”..... 167
25. Muzafer Korkuti: Parailirët, Ilirët, Arbërit 185
26. Muharrem Abazaj: “Kodi i gjuhës Pellazgo - Shqipe”..... 193
27. Elena Kocaqi: “Albanët” 195
28. Elena Kocaqi: “Roli Pellazgo – Ilir në formimin e kombeve dhe gjuhëve europiane”..... 197
29. Elena Kocaqi: “Shqipja – çelsi i gjuhëve Indoeuropiane” 199
30. Aristotel Mici: “Prejardhja e emrit shqiptar” 201
31. Marika Butskhrikidze: “Studjuesja Gjeorgjiane: Ngjashmëri intriguese ndërmjet Shqipes dhe Armenishtes.” 203
32. Luftulla Peza, Liljana Peza: “Gjuhët e Lashta të Ballkanit dhe Anadollit dhe familja Pellazgjike e gjuhëve” 207

PARATHËNIE

Kjo përmbledhje me copëza shkrimesh të nxjerra nga autorë të ndryshëm, nuk pretendon aspak meritën e një shkrimi original apo përmbledhjen e informacioneve, të cilat lexuesi nuk mund t'i gjejë në botimet e veçanta, nga ku janë shkëputur këto pjesëza informacioni. Detyra ime në këtë rast ka qenë përmbledhja apo grupimi në një vend të vetëm i atyre materialeve, që mendova se do të mund të paraqisnin interes për këdo, që është i interesuar për origjinën dhe prejardhjen e Shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre, për pozicionin e tyre në grupin e popujve që popullojnë sot kontinentin Europian dhe të atyre që konsiderohen sot grupi Indo-Europian i popujve.

Autorët, që i kanë trajtuar këto tema, janë të shumtë, siç janë të ndryshme edhe këndvështrimet e tyre lidhur me këtë çështje. Këtu janë paraqitur disa prej tyre; besoj, me pjesën thelbësore të idesë që janë përpjekur të shtjellojnë; ata të cilët i kushtuan vëmendje të veçantë nxjerrjes në dritë të vërtetë përpara syve të të gjithë opinionit të iluminuar Europian e më gjerë të problemit të ekzistencës së një kombi dhe një gjuhe, që vinin nga thellësitë e kohëve, pa zhurmë e pa bujë, por me dinjtetin me të cilin e kishte kurorëzuar historia. Një kurorë, gurët e së cilës, të mbuluar nga pluhuri i kohës dhe tymnajat e nacionalizmave të verbër, e kishin humbur shkëlqimin, që u takonte.

Pikërisht këtu qëndron merita e atyre, që e kuptuan vlerën e

kësaj kurore, në dukje një gjë e vjetër dhe e hedhur diku mënjanë pa ndonjë vlerë, dhe u vunë në ballë të kësaj pune për pastrimin një nga një të gurëve me të cilat ajo ishte stolisur, për të nxjerrë në pah shkëlqimin e vërtetë të tyre, duke i dhuruar historisë njerëzore atë pjesë që i mungon, dhe kombit shqiptar në veçanti atë pjesë të meritës dhe lavdisë që i takon krahas popujve të tjerë të lavdishëm, që kanë lënë gjurmë dhe vlera të pashlyeshme në historinë Europiane dhe atë botërore.

Vendi i parë dhe respekti më i madh ndër studjuesit e huaj, pa dyshim, i takon Johan Georg von Hahn, të cilit jo pa të drejtë dhe pa meritë, albanologjia shqiptare i ka dhënë kryet e vendit, duke e quajtur "Themeluesi i Studimeve Shqiptare".

Jo më pak i rëndësishëm është kontributi i atyre që rreshtohen pas tij, që me punën e tyre kanë dhënë një kontribut të shquar dhe shumë të vyer në nxjerrjen në pah të ekzistencës së një populli me vitalitet për t'u admiruar dhe të një gjuhe të lënë në errësirën e harresës për shekuj të tërë.

Ja si shprehet Prof. Eqrem Çabej në librin *"Hyrje në Indoeuropianistikë"* (Leksionet e Prishtinës) i Botimet " Çabej ", 2008

"Këtu, ndër ata, që studiuan gjuhët e veçanta indoeuropiane në kohën pas Boppit, njëkohësisht me Gramatikanët e rinj, duhen përmendur edhe disa dijetarë të shquar, që vunë themelet e sistemit gramatikor të disa gjuhëve të veçanta. Kështu Gustav Meyeri mund të quhet themeluesi i albanistikës. Gustav Meyer ka qenë njëkohësisht edhe një grecist i dalluar, autor i një gramatike të greqishtes, më të mirën e asaj kohe. Me veprat e tij, me fjalorin etimologjik, me Gramatikën e shqipes e me Studimet shqiptare me gjashtë volume, ky dijetar është edhe themeluesi i albanistikës. Ndërsa H. Hübschmann është themelues i gjuhësisë armene. Gjuhëtari i shquar danez Holger Pedersen çeli rrugë të reja në studimin e shqipes, armenishtes, keltishtes, hetitishtes, tokarishtes e të tjerave gjuhë indoeuropiane. Punën e Gustav Meyerit dhe të Pedersenit në lëmë të shqipes e çoi

më tej dhe e përkreu, sikundër dihet, albanisti i dëgjuar Norbert Jokl." (fq. 50)

Studjuesit shqiptarë? Pa dyshim, të shumtë e të talentuar, të kohrave të hershme e të ditëve të sotme. Kryejnë detyrën e tyre, misionin historik të ndriçimit të vetvetes dhe të kombit nga gjiri i të cilit dolën.

Shumë kombe, shumë popuj, të mëdhenj apo të vegjël, kanë kaluar nëpër rrugën e historisë; shumë prej tyre kanë lënë gjurmë e më pas janë tretur në errësirën e kohëve, shumë prej tyre kanë kaluar pa u vënë re e pa lënë kurrfarë gjurme, por jo shumë janë ata, që kanë lënë gjurmë duke ecur në rrugët e shtruara nga të tjerët apo paraardhësit e tyre dhe kanë arritur deri në ditët e sotme duke ecur mbi zgjatimin e këtyre rrugëve të vjetra, tashmë të shtruara nga ata vetë, apo nëpërmjet shtigjeve të hapura me vështirësi për t'i shpëtuar nëpërkëmbjes dhe shtypjes nga hordhitë e shumta me të cilat do t'u duhej të përballeshin.

E rasti i popullit shqiptar është pa dyshim rasti i atij, që herë nëpër rrugë të gjera e herë nëpër shtigje të parrahura më parë e të hapura nga vetë ai, ja ka arritur jo vetëm të mbijetojë, por edhe të paraqitet ballëlartë përpara shoqërisë njerëzore së sotme për atë çfarë ai përfaqëson: një rreze drite, që tashmë është rishfaqur, për të ndriçuar mbi rrugën e historisë njerëzore.

Mendoj, se në këtë rast, meriton të thuhet:

"Zhvillimi shumë i vonshëm i Shqipes së shkruar përbën sa fatkeqësi ashtu edhe një mrekulli, si për vetë popullin shqiptar, ashtu edhe për mbarë qytetërimin, të paktën, atij Europian.

Përbën fatkeqësi pasi la në errësirën e harresës një komb dhe një gjuhë për një kohë të gjatë, duke i mohuar qytetërimit një mundësi më tepër zhvillimi dhe nga ana tjetër një mrekulli, pasi në errësirën e harresës, ndën pluhurin e kohërave të dhunshme, ruajtën të pacënuar një komb dhe një gjuhë të lashtë.

Një diamant mbase, që po të pastrohet me kujdes, do të pasqyrojë aq dritë sa të mposhtte errësirën, që rrethon atë pjesë të hapësirës historike Europiane lidhur me formimin e kombeve dhe gjuhëve Europiane"

Berzh Piranjani

SHËNIME SQARUESE

1. Me shkrim *Italics* ose **Bold** kam vendosur elemente, që mendoj se duhen theksuar.

2. Me **yll* janë shënuar momentet, të cilat shoqërohen me shënime nga ana ime, shënime këto që vendosen pas shenjës së yllit ose në fund të faqes përkatëse në formën **Shënim B.P.:,* që do të thotë *Shënim: Berzh Piranjani"*

3. Shënimet që i përkasin autorit të librit janë paraqitur në formën: **Shënim X.Y.:* ku X dhe Y do të shprehin germat e para të emrit dhe mbiemrit të autorit të librit.

4. Po kështu, me **yll* janë shënuar edhe emrat e Historianëve, që shpesh janë pajisur edhe me një jetëshkrim të shkurtër.

5. Shënimet nuk ruajnë një numër rendor nga fillimi në fund; numrat e shënimeve tek botimet e secilit autor janë ruajtur në formën e tyre origjinale, duke ruajtur kështu korrespondencën me librin original, nga i cili është shkëputur pjesa.

6. (... *greqisht* ...) – tregohet që brenda kllapës ka shkrime në gjuhën greke që autori i përdor për si përforcim i asaj që ka shprehur në gjuhën e vet. Nuk e pashë të arsyeshme t'i rikopjoj.

7. Me pika të vazhdueshme në formën ... jam përpjekur të tregoj që kam bërë anashkalimin e pjesëve të frazës apo frazave që nuk i kam parë me interes për t'i paraqitur në këtë material.

Berzh Piranjani

BERNARDINO DE BINDONI

SKANDERBEG
PRINCI I EPIRIT

Venezia 1544

Përktheu nga origjinali: Frida Vokopola dhe Albert Gjoka

Shtëpia Botuese: Turdiu
Tiranë, 2018

Shënim B.P.: Disa ngacmime që lindin nga leximi i këtij libri

Mund të pyesë këtu dikush se nga e kishte origjinën Albania: mëso, pra, që Plinio në librin e tij të Njerëzve të Shquar, në kapitullin e 3të shkruan: "Kur Tullo Hostilio, mbreti i tretë i Romakëve, shkatërroi qytetin Alba, që nuk ndodhej larg nga Roma dhe shpesh kishte qenë kundërshtare e saj, dha urdhër që Albanët të shkonin në Romë"; shumë prej tyre (siç thuhet nga shumë autorë) shkuan në pjesët e Azisë dhe banuan mes popujve të atij vendi, që gjendet midis maleve Hiberi e Kaukaz. Ma kalimin e kohës ata u shtuan e u shumëfishuan dhe vendi i tyre u quajt Albania Iberia, e cila është përshkruar nga Plinio në librin e 6të të Historisë Natyrore, në kapitullin e 3të. Prej andej, një pjesë e Albanëve u largua e u shpërngul në Europë dhe një pjesë e tyre populloi Epirin, një pjesë Maqedoninë dhe të tjerë një pjesë të Liburnias, që tani quhet

Esemptia e Poshtme, pranë Maqedonisë dhe Epirit. Ndërsa të tjerë banuan në një pjesë të Dalmacisë e Ilirisë që quhet Esemptia e Sipërme, në kufi me atë pjesë të Liburnias të lartpërshkruar. Për një periudhë të gjatë kohe, në të lartpërmendurat vende, Albanët u shtuan e u shumëfishuan dhe me të gjitha këto krahina u formua një vend i vetëm, që u quajt Albania, duke e marrë kështu emrin nga banorët e saj, Albanët. (Faqe 27-27)

..., Skanderbeu i mblodhi pranë e u tha:

"... Kryqëzata do të jetë e madhe ... Në të do të marrin pjesë italianë, francezë, spanjollë, anglezë, gjermanë, hungarë, polakë, vllehë, sllavë, grekë e albanë[19], si edhe ne e të tjerë, ... (Faqe 109-110)

Shënim B.P.: Se përse bëhet ky dallim ndërmjet fjalëve "albanë" dhe "ne e të tjerë", përkthyesit përpiqen ta japin nëpërmjet këtij Shpjegimi:[19]

[19] Shën. i përkth.: "Albanët ishin edhe në ato vende të zotëruara nga Venediku".

JOHANN THUNMANN

"HISTORIA DHE GJUHA E SHQIPTARËVE DHE VLLEHËVE"

Pjesë e librit:"Studime mbi historinë e popujve të Europës Lindore"
Leipzig 1774

Përkthyer nga origjinali prej: Frida Vokopola dhe Albert Gjoka

Gent Grafik, 2018

Në fillim të librit, në pjesën "Shënim i Përkthyesve", në paragrafin e fundit, theksohet: "... dëshirojmë t'ua dedikojmë këtë përkthim të gjithë studjuesve të mirëfilltë të të gjitha fushave, të cilët me punën e tyre kanë kontribuar ose vazhdojnë të kontribuojnë për përhapjen e dritës." Tani po shkoj tek historia e vërtetë e Shqiptarëve dhe e vendit ku ata banojnë. Ata janë pasardhësit e Ilirëve të vjetër, ashtu si edhe fqinjët e tyre, Vllehët, historinë e hershme të të cilëve dua ta tregoj më pas, janë bijtë e Thrakëve. (Fq. 84)

Jo gjithmonë, i gjithë populli që flet shqip e që ka banuar midis detit Jon dhe Maqedonisë, midis Malit të Zi dhe Neo-Kastros në Evenus, është njohur me emrin Alban. Fillimisht ai emër i përkiste vetëm një popullate të vogël, e cila e kishte vendbanimin e saj në Ilirinë Maqedonase, midis Drinit dhe Siominit (Semanit). Ptolemeus-i është i vetmi midis autorëve të vjetër, i cili i ka përmendur ata dhe kryeqytetin e tyre, Albanopolis.* (Fq. 84)

Në vitin 1273 Albania shtrihej deri në Durrës, ... (Fq. 85)

Ende në ditët e sotme, kjo pjesë e vendit, që shtrihet në veri të këtij qyteti, quhet Albania e vërtetë. (Fq. 86)

Grekët i quanin ata Alvanoi dhe Arvanoi, Alvanita dhe Arvanita, pasi ata shpesh shkëmbejnë "l" dhe "r". (Fq. 86: Shënimi23 në fund të faqes)

Cilët janë Albanët ose Skipatarët? Si ishin ata? Si ishte gjuha e tyre?

Popullsia e parë që historia njeh në këto vende, është ajo Ilire: një popull i madh, i shumtë në numër dhe i fuqishëm, i cili banonte pranë detit Adriatik, nga lumi Po deri në gjirin e Ambrakisë (Artës) dhe në veri deri në Danub. (Fq. 90-91)

Sipas gojëdhënave, Panonius ishte biri i Autarieus. Autariatët ishin për një periudhë të gjatë kohe fisi më i fortë midis të gjitha fiseve Ilire. Princat panonë dhe ilirë kishin të njëjtët emra, si Pinnes, Bato; popujt, të cilët Straboni (libri VII, Faqe 483) i ka konsideruar si panonë, pyrustë, mazaer dhe dasiatë, janë ilirë tek Cezari, Ptolemeusi, Pliniusi, etj. (Fq. 91: Shënim 38 në fund të faqes)

Pjesa më e vogël e Maqedonisë ishte e banuar nga Grekët. Fisi i banorëve ishte Ilir dhe Thrak. (Fq. 92)

Ilirët dhe Thrakët ishin prej shumë kohësh popujt kryesorë në Europë. Po a vinin ata nga i njëjti fis apo nga fise të ndryshme? Asnjeri nga studjuesit e vjetër nuk e ka thënë ndonjëherë shprehimisht se të dy popujt kanë qenë një popull i vetëm me origjinë të përbashkët ose se ilirët dhe thrakët kanë qenë po aq të afërt me njeri tjetrin sa edhe ilirët me dalmatët dhe thrakët me getët.

Por popullsitë e vogla, të cilat studjuesit e tjerë i kanë konsideruar si fise thrake, shpeshherë historianët i kanë mbajtur për fise ilire. (Fq. 96)

Thrakët dhe ilirët trajtohen si popuj me të njëjtat tradita, por megjithatë, unë ende nuk mund të nxjerr ndonjë përfundim për origjinën e përbashkët të këtyre dy popujve. Ndërkaq ka të ngjarë që të dy popujt të kenë qenë të afërm me njeri tjetrin, që të kenë qenë shumë të përzier me njeri tjetrin dhe që, kur historianët grekë

i ndajnë ata nga njeri tjetri, duke i konsideruar si fise të ndryshme, një ndryshim i tillë të ketë ndodhur për shkak të një ndryshimi thelbësor dhe gjenealogjik më tepër se për shkak të traditës. (Fq. 98)

Kadmi duhet të ketë mbretëruar enkelejtë. (Fq. 99)

Ptolemeusi përmend gjithashtu taulantët, elimiotët, eordët, orestët, dasaretët, linkestët, si edhe albanët, të cilët përmenden për herë të parë. Emri i tyre rrjedh pa asnjë dyshim nga qyteti Albanopoplis, i cili në kohët e mëvonshme u quajt Albanon dhe Arbanon. Ata banonin në zonat malore, të cilat shtriheshin pranë kufirit me Maqedoninë dhe, për fatin e tyre të mirë, ata vazhduan të jetonin në male. (Fq. 111)

Maqedonasit dhe epirotët, të cilët herë pas here e shtrinë sundimin e tyre shumë thellë në brendësi të vendit, ka shumë të ngjarë të kenë folur të njëjtën gjuhë me ilirët. (Fq. 112)

Do doja të theksoja këtu se asokohe (bëhet fjalë për periudhën kohore rreth viteve 1100 të erës sonë) Shqipëria e vërtetë e sotme përcaktohej sidomos nëpërmjet emërtimit perëndimor ose të vendeve të perëndimit, por ai vend është quajtur vazhdimisht edhe Ilirikum. Tanimë, pasardhësit e banorëve të lashtë të kësaj pjese të Ilirisë do të njihen me emrin Albanë ose Arbanë. (Fq. 125)

Asokohe, në vitin 1250, Peshkopi i Albanisë shkëputi nga Kisha Greke jo vetëm këtë provincë, por edhe trojet e Pulatit (Philot/Filat) dhe Chunavi-së (Unania) dhe e njohu Papën si Atin Shpirtëror. (Fq. 135: Shënimi169 në fund të faqes)

Prej shumë kohësh albanët kanë banuar vazhdimisht në këtë gadishull dhe ata i kanë atje vendbanimet e tyre edhe sot e kësaj dite. (Fq. 165)

Unë dëshiroja të sillja në ditët e sotme vetëm origjinën e albanëve me anë të një numri faktesh të rradhitura në mënyrë kronologjike, për të larguar errësirën, konfuzionin dhe supozimet tepër të guximshme, si edhe për të bërë të njohur gjatë gjithë rrjedhës së

kohës një popull, i cili i takon banorëve më të vjetër të Europës, dhe që u ka rezistuar dyndjeve të shumta të grekëve, romakëve, gotëve, sllavëve, francezëve, italianëve dhe turqve. (Fq. 166)

Në kohët e vjetra thrakët ishin një nga popujt më të përhapur të botës. Ata i kishin vendbanimet e tyre të shpërndara si në Azi, ashtu edhe në Europë. Fiset Thrake[242] që ndodheshin atje ishin teukritët, frygët, mysët (mësët), bithynët.

...

Në faqen 211 të këtij libri e në vazhdim kemi një kapitull të titulluar "Shënime të përkthyesve", në të cilin përkthyesit Frida Vokopola dhe Albert Gjoka janë përpjekur të zbërthejnë dhe sqarojnë momente të veçanta me interes të shtuar. Këtu më poshtë po shkëpusim disa fragmente nga këto komente dhe analiza:

...

Sipas disa autorëve, Latinët u shpërngulën në Itali në mijëvjeçarin e dytë para Krishtit, nga Europa Danubiane ose Azia e Vogël. Sipas historianit Momsen, emigrimi i popullit latin është i shtrirë nga Lazio deri në Kalabri. Edhe popullatat e tjera italike si Umbrët, Volshët, Sannitët e Sabinët janë shpërngulur në Itali në fillim nga toka, nga Veriu dhe më pas nga Jugu.

Plinio i vjetri në librin e tretë shkruan: "Në periudhat antike, Pellasgët shtynë më tej Umbrët (Umbri), ndërsa këta të fundit Lidët (Lidy), nga mbreti i të cilëve u quajtën "Tyrreni" dhe më pas ata, për traditën e sakrifikimit, u quajtën Tusci/Tuski. Në Enciklopedinë gjermane të viteve 1880-1890 shkruhet: "Shqiptarët

---

Shënim 242: Herodoti mendon se të tillë ishin edhe armenët, libri VII, faqja 259. Por ndoshta ata ishin vetëm pjesërisht të tillë, pasi armenët janë një përzierje e popujve të ndryshëm. Straboni tregon edhe për saraparët, një popull thrak, i cili ndodhej midis armenëve dhe medëve, libri XI, faqja 803. (Fq. 168)

janë një nga popujt më të vjetër, ku tashmë është e sigurtë, pa asnjë dyshim, që janë pasardhësit e drejtpërdrejtë të Pellazgëve të vjetër". (Fq. 219-220)

Por siç është thënë edhe më sipër nga Plini, ishte Enea, Dardan Trojani që u dha origjinë këtyre popujve në Lation e vjetër. Por tek Albanët, ky emër do të njihet si Albanopolis, siç jepet edhe më poshtë, ai gjendej në brendësi të vendit, midis Durrahium dhe Lissus. Por asnjë nga shkrimtarët e tjerë, (përveç Ptolemeus) nuk e ka njohur këtë popull, as dhe qytetin e tyre….. (Fq. 223-224)

Por lind pyetja se ishte ky vendbanim që e mori emrin prej Albës së Italisë, apo ndoshta këta popuj apo fise albanë e kishin sjellë këtë toponim në Itali, ashtu si më pas e përcollën atë emër si në Azi, në Albaninë aziatike dhe më pas në shumë vende të tjera të Europës? (Fq. 224)

- Adelung, në veprën e tij "Mithridates" (1806-1817) në faqen 360 kur trajton temën e Maqedonisë shkruan: "Të tjerë i konsiderojnë maqedonasit si ilirë, ndërsa Justini, (në Librin VII, 1) i konsideronte ata si Pellasgë. Dhe të gjithë ata popuj (që sipas Plinio-s arrinin në 150) ishin degë të të njëjtit trung, teksa sipas Strabonit, "banorët e atyre pjesëve, në atë kohë flisnin të njëjtën gjuhë"

Më pas, Adelung shkruan se sipas Curtius-it (libri VI, faqja 9): "Nuk ishte çudi që grekët në ushtrinë e Aleksandrit nuk i kuptonin fjalimet që ai mbante përpara ushtrisë" dhe Adelung-u vazhdon: "Ende sot përgjithësisht maqedonasit nuk janë grekë dhe gjuha e tyre nuk është greqishtja, por shqipja". (Fq. 226)

JOSEPH RITTER VON XYLANDER

"GJUHA E ALBANËVE OSE SHKIPËTARËVE"

Frankfurt am Main, 1835

Përkthyer nga origjinali prej: Frida Vokopola dhe Albert Gjoka

Shtypshkronja "Turdiu"
Tiranë, 2018

Gjatë këtij shkrimi, ashtu si edhe në fundin e tij, dëshmohet që pasardhësit e ilirëve, të cilët kanë të njëjtën origjinë me Thrakët, gjenden tek shqiptarët, ku në ato vende ata do të shfaqen si rrezet e para të diellit të mëngjesit të historisë sonë, …. (Fq. III)

Shënim B.P: Në faqen 152 të këtij libri kemi një grumbull shënimesh të titulluar "Shënim i përkthyesve", në të cilin përkthyesit Frida Vokopola dhe Albert Gjoka janë përpjekur të zbërthejnë dhe sqarojnë momente të veçanta me interes për të thjeshtuar atë që vijon më pas; më poshtë po shkëpusim disa fragmente nga këto komente dhe analiza:

I kujtojmë lexuesit që Autori (Xylander - *Shënim B.P:*) e ka studjuar gjuhën shqipe midis shqiptarëve që jetonin në Greqi dhe fjalët e nxjerra mund të kenë edhe ndonjë ndryshim në shqiptim. ...

Për shkak të shkronjave pothuajse të njëjta midis "p" dhe "b", "s"

dhe “sh”, ... disa fjalë janë vënë në shkronjën e gabuar, si p.sh.: fjala “Pashka” do të gjendet e shkruar “Bashka”; “Puzë” në vend të fjalës “Buzë”; gjithashtu do të rikujtojmë shqiptimin e disa shkronjave: ou = u, ou = y, mp = mb, b ose p; nt = nd, d ose t; tz = c, ç ose z; tzd = x, xh.

... Në disa raste disa shkronja janë përdorur në vend të shkronjave të tjerave, si p.sh: ..., p-b; b-v; g-k.

Tek disa fjalë, ku ishte e mundur, kemi vënë afër kuptimin e duhur, si p.sh. tek fjala “puzë” kemi vënë në kllapa “buzë”. (Fq. 152)

Leake shkruan se “Sipas Strabo-s fiset epirote ishin të përziera me ato ilire dhe flisnin dy gjuhë[XVIII], dhe me këtë ai ose mendonte se ata, njëlloj si shumica e shqiptarëve të sotëm të Greqisë, kanë folur të njëjtën gjuhë amtare, ose që gjuha epirote ka qenë e ndryshme nga ilirishtja dhe madje të ketë qenë një dialekt i gjuhës maqedonase. (Fq. 281)

[XVIII] (Shën.përkth.): Që epirotët kanë folur dy gjuhë, kjo tregon qartë se epirotët nuk ishin grekë, të cilët kanë folur vetëm gjuhën e tyre. (Fq. 321)

Hofrath v. Arndt jepte në studimin e tij të hershëm në lidhje me përpunimin e fjalorit krahasues të hartuar nën drejtimin e Pallas për Perandoreshën Katharina, nga i cili kishte marrë edhe pjesën më të rëndësishme të studimit, madje edhe disa mendime interesante nga shkrimi i botuar nga këshilltari i shtetit Kluber: “ Mbi origjinën dhe afërsitë e ndryshme të gjuhëve Europiane”, ku në mënyrë thelbësore për gjuhën shqipe ai shkruan:

“Gjuha shqipe konsiderohet si më e lashta e asaj zone, pasi asnjë gjuhë më e hershme nuk ka mundur të dëshmojë, që ajo të jetë folur në ato vende përpara saj, çfarë nuk la së paku të mohohet, që duhej të ishte vetëm gjuha e Iberikëve, të cilët duhet të kenë qenë në Shqipëri përgjatë historisë së tyre më të lashtë, gjë që bëri të mundur të shpjegohet edhe ngjashmëria e aq shumë fjalëve të gjuhës shqipe me ato baske, apo ndoshta banorët e lashtë të maleve të Epirit dhe Pirenejve kanë qenë vetëm një dhe i njëjti popull i lashtë. (Fq. 284)

Shënim B.P: Në faqen 285 Xylander paraqet përfundimet e nxjerra nga Arndt gjatë studimit të fjalëve të fjalorit sipërpërmendur, të cilat shkurtimisht mund të përmblidhen: "gjuha shqipe tregon më tepër ngjashmëri me gjuhët kelte të Europës Perëndimore, pasi fjalët më të vjetra, madje më mirë mund të thuhet, më të lashta të gjuhës shqipe kanë ngjashmëri të dukshme me ato gjuhë që rrjedhin nga gjuha kelte, të cilat konsiderohen si gjuhët nordike të kontinentit tonë, ... (Fq. 285) Më poshtë Xylander vazhdon:

Për t'i kuptuar më mirë këto shënime, vlen të përmendet si më poshtë dhe përfundimi kryesor, të cilin Arndt e ka nxjerrë nga përpunimi i fjalorit të tij në lidhje me historinë e gjuhëve dhe popujve më të vjetër:

"Popujt më të rëndësishëm mes banorëve më të lashtë të Europës, emrat e të cilëve u janë trashëguar stërnipërve të tyre, ishin Keltët dhe Skitët (Skythët); këta të fundit, pasardhësit e të cilëve gjenden tek Çudët (Tschuden), i detyruan të parët të shpërngulen drejt perëndimit; më vonë depërtuan gjithnjë e më në thellësi drejt perëndimit koloni fisesh me emra të ndryshëm, atdheu i të cilëve duhet kërkuar në lartësitë e Azisë Juglindore; ato vendosën dalëngadalë sundimin e tyre mbi banorët e vjetër dhe formuan në lindje dhe në qendër të Europës fise, të cilat në kohën e Herodotit, njiheshin me emrat e Thrakëve dhe Benetëve dhe u konsideruan si një nga tre popujt kryesorë (Keltët, Skitët dhe Thrakët)".

"Nga fiset e fundit rrodhën gjermanikët dhe sllavët; të parët u shpërndanë më në perëndim dhe të dytët në lindje, por në përgjithësi me kalimin e kohës ndodhën përzierje të ndryshme të gjuhëve dhe idiomave të ndryshme....". (Fq. 285 - 286)

Nga 56 fjalët e dhëna dhe të krahasuara nga von Arndt, sigurisht që disa prej tyre janë vënë gabim ose janë krahasime të "guxuara", ndërsa ne mundëm të krahasonim me njera tjetrën edhe disa fjalë, vetëm bazuar në një analizë të bërë nga Z. Dr. von Humboldt, i cili ka vendosur në tabelën e tij krahasuese të fjalëve në librin "Mithridates". (Fq. 287)

Gjermanisht	*Gjuha Baske*	*Shqip*
Ast, zweig	a-daquia	dega
Auf	ea	jà
Axt	puda	so-pata
Bàr	arzta	arì
Binden	lotu	lidh, lidhi
Essen	jan	ha, han
Gold	urea	arr/ar
Land, acker	erria	arra/fushë
Lunge	birria	sh-pira
Mutter	ama	èma
Nase, gesicht	surra	surá
Neu	berria	erà, erè, e re
Nàrrisch	narra	(i) marrë
Nagel	i-thea	thua
Schweif	bustana	bisht
Plòtzlich, heute	sost	sot
Sagen, sprechen	esan	e thàne
Stein	aria	gurrë
Und	eta	e dhe
Wachtel	pospolina	potpoloshka
Wort	hitza	itha/i tha
Luft	airea	erra (ajri)
Alles	gucia	githe/gjithë
Dieser	au	ai
Nein, nicht	ez	s (në fillim të fjalës)

Sein	izan*	ish, ishnà (me qenë)
Weinberg	mastia	veshtia/vreshtë (Fq. 287)

Tani mund të shtojmë ato fjalë kelte, të cilat do të jepeshin nga Adelung-u tek "Mithridates" (vëll. 2, faqe 40), të nxjerra nga Arndt dhe të krahasuara më tej me fjalët shqip: (Fq. 288)

Gjuha Kelte	*Gjuha Baske*	*Shqip*
wasser	ac	uj
ehmann	baro, varo	burrë
unehliches Kind	bastard	bastard
beinkleider	braccae	brekë
richter	bret	mbret
hugel	briga	breg/brig
zerbrechen	brisa	prish/brish
steihausen	carn	gure
wagen	carra, carruca	karra, karoca
morast	lait	lluce
weib (witwe)	bean	vè, và, veia
weiber	gruages	grùa
bier	bir, bier	birrë (pije) (Fq. 288)

Megjithë përfundimet e ndryshme nga njeri-tjetri, në argumente të veçanta, pjesa më e madhe e studjuesve ndajnë të njëjtin mendim: ata i konsiderojnë shqiptarët si pasardhës të ilirëve të vjetër ose, në përgjithësi, edhe të përzjerë, i konsiderojnë ata si pasardhësit më të afërt të një prej fiseve të shumta të familjes së lashtë të thrakëve. (Fq. 288)

Shënim12: Midis fiseve të ndryshme shqiptare do të gjinden disa fise që dallojnë nga të tjerat nga flokët biondë dhe sytë e kaltër, dialektet e të cilëve meritojnë vëmendje të veçantë. (Fq. 291)

….. fjalëformimi dhe gramatika në tërësi, tregojnë një fizionomi të hershme me tipare të veçanta, të cilat gjenden edhe në gjuhën baske, gjuhë kjo e një populli, e cila konsiderohet si ajo e pasardhësve të Iberikëve, të cilët vetëm në kohët më të vjetra quheshin banorë të zonave të Shqipërisë së sotme. (Fq. 313)

Së fundmi lind pyetja nëse shqiptarët e sotëm të konsiderohen për pasardhësit e ilirëve të vjetër apo si një nga fiset e lashta të thrakëve - ... (Fq. 318)

Adelung-u, i cili i quan grekët stërnipërit e thrakëve, gjë që ai e shpreh ndër të tjera në librin "Mithridates", (Pjesa II, faqja 343): "Atje thrakishtja është më e vjetra e gjuhëve të njohura dhe pa dyshim ajo duhet të ketë ruajtur edhe gjurmët e shumta të një gjuhe mëmë më të vjetër, si gjuhët e fqinjëve të saj të afërt dhe të largët. Në gjuhën e vonshme greke nuk janë për t'u mohuar shumë rrënjë fjalësh të gjuhëve kelte, gjermanike, finlandeze dhe sllave, por mbas formimit të popullit dhe gjuhës së tyre, grekët nuk kanë qenë në lidhje të drejtpërdrejtë me asnjë nga këta popuj, prandaj duhet ta shohim gjuhën e tyre si një mbetje të thrakishtes, teksa Thrakët në Europë jo vetëm ishin fqinjët më të afërt të këtyre popujve, por edhe në vendet e tyre të origjinës në Azi duhet të kenë rrjedhur nga i njëjti burim i përbashkët me ta". (Fq. 318)

DR. JUR. JOHAN GEORG VON HAHN

"STUDIME SHQIPTARE"

Përktheu nga gjermanishtja: Veniamin Dashi dhe Afrim Koçi
Instituti i Dialogut & Komunikimit
Tiranë, IDK 2013

Botuar për herë të parë nën titullin:
"Albanesische Studien"
Jena, 1854

Shënim B.P.: Në parathënien e veprës, duke ju referuar vetvetes, Hahn thotë:

"...Për të, përgjithësisht, pellazgjishtja dhe helenikja janë të shkrira kaq ngushtësisht, sa njera mund të ndahet vetëm në kurriz të tjetrës dhe ai pohon se ndodhet në pozitën e atyre, për të cilët pellazgët janë të pakapshëm, sepse sa më shumë prova gjenden për ta, aq më shumë davariten helenët, aq më e errët bëhet pyetja: *Kush ishin ata? Dhe nga erdhën?* Gati-gati duket sikur vetë Herodoti këto pyetje ka bërë, kur thotë: "e ndarë nga pellazgjishtja dhe në vetvete e dobët është dega Helene; nga fillesa të vogla, falë vërshimeve të fiseve të shumta barbare, ajo më vonë u bë një masë e madhe popujsh. Përkundrazi, për mendimin tim, populli pellazg, si një popull barbar, nuk ka njohur kurrë ndonjë rritje të ndjeshme." (Fq. 8)

Populli shqiptar bëhet kaq shpejt i fuqishëm, saqë vërshon vazhdimisht jashtë kufijve të vet dhe përgjatë shumë shekujve

emigron me shumicë. Nuk asht çudi që këto emigracione do të kishin vazhdue edhe shumë kohë, po mos t'i kishte ndërprerë me forcë pushtimi turk. (Fq. 287)

... Një gjurmë e dytë gjindet në gojëdhanën e kryetarit të Mirditës. Sipas kësaj, stërgjyshi i familjes ka qenë një bullgar ortodoks, i cili erdhi në Mirditë me bagëtitë e tij, ku u kthye në besimin katolik. Por gojëdhana nuk tregon që ai mësoi shqip, sepse kjo gja i duket pa randësi, ose kuptohet vetvetiu. (Fq. 288)

... Kush janë Shqiptarët? Rrjedhin këta prej banorëve të lashtë të vendit dhe koha e sllavëve është vetëm një episod në historinë e Shqipnisë, apo kanë ardhë këtu në Kohën Historike, si edhe sllavët, që formojnë shtresën e tretë të popujve, që janë vendosë në tokën shqiptare, por që nuk janë aspak farefis me ta?

Nëqoftëse këtë pyetje ja bajmë historisë, do të marrim vetëm një përgjigje me hamendje, e cila është mbështetur mbi një konkluzion negativ dhe që është kjo: me që shqiptarët nuk janë sllavë dhe nuk kanë farefisni me asndonji popull të njoftun, mbasi edhe burimet e pakta nuk lajmërojnë tjetër imigracion, përveç atij të sllavëve*, atëhere duhet të pranojmë që shqiptarët e sotëm janë pasardhësit e banorëve të lashtë të vendit, që kanë qenë këtu para se me ardhë sllavët.*

...

Në qoftë se nuk gabohemi, asnjë nga lexuesit tanë nuk mund të thotë që kjo ngjasi *(Shënim B.P.:* bëhet fjalë për ngjasitë zakonore*),* asht krejt rastësore; sepse këtu hollësinat janë të shumta; por po të gjithë do të jenë të një mendimi se ato që kanë të përbashkët shqiptarët, romakët dhe grekët dalin nga një burim i vetëm.

Kjo ngjasi asht kaq e madhe dhe tregon kaq hollësina, saqë nuk mund të mos pranojmë, që burimi i saj asht nga një kohë e lashtë dhe nga një vend, ku këta popuj kanë jetue bashkarisht, përpara se me u shpërngulë prej andej dhe me shkue në Europë. (Fq. 289)

Prandaj shumë ma i arsyeshëm na duket mendimi që stërgjyshnit

e shqiptarëve të sotëm, kanë banuar në ato vende, që zotnojnë shqiptarët sot, qysh në kohën e romakëve dhe të grekëve dhe që zakonet e përbashkëta me popujt fqinj i kanë ruejtë deri tek pasardhësit e sotëm shumë më të pastra dhe besnike, sesa kombet fqinj. (Fq. 290)

Atëhere, pra, shqiptari i vjetër nuk ishte vetëm moshatar dhe fqinj i romakut të vjetër dhe i helenit, por edhe farefis me ta. Me fjalë të tjera, ato gjana që janë të njëjta ndër zakonet e këtyre tre popujve, janë sjellë atje nga i njëjti element.

...

Nga sa thamë ma sipër shohim se ato gjana që kanë të përbashkëta zakonet e shqiptarëve me ato të romakëve dhe të helenëve formojnë faktorin e parë të provës sonë.

Faktorin e dytë do ta nxjerrim nga shkenca gjuhësore. Por, së pari, duhet të caktojmë me siguri kombësinë dhe marrëdhëniet reciproke të popujve, të cilët në kohën e vjetër kanë banue në këtë trevë, sepse vetëm me anë të kësaj pune mund të gjejmë materialin e duhur me ba krahasimet e nevojshme.

...

Tezat tona (*Shënim B.P.:* në zbërthim të faktorit të dytë) janë këto:

1. Epirotët dhe Maqedonasit edhe në kohën e Strabonit kanë qenë jogrekë, ose barbarë.

2. Epirotët, Maqedonasit dhe Ilirët janë farefis.

3. Kemi shumë shenja që Epirotët dhe Maqedonasit përbanin thelbin e popullit tireno-pellazg; fiset ma në skaj të këtij populli kanë luejtë rol në historinë e Italisë dhe të Trakisë.

4. Ilirët = Pellazgët në kuptimin ma të gjanë

(Fq. 291)

... prej Epidamni dhe Apolloni, deri tek malet e Keraunive banojnë bylionët, taulantët, partinët dhe *brygasit.* (Fq. 293)

... Straboni nuk e sqaron mirë nëse popujt, të cilët i përmend pas fisit ilir të *Brygasve,* ... (Fq. 294)

2. **Albania:** Janë të shumtë ata që thonë se janë të huejt që ia kanë ngjitë këtij vendi emnin "Albani", të cilin banorët e sotëm nuk e njohin fare. Mannert Geogr. Der Griech.u.R. VII shkruan se, përveç Ptolemeut asnjë shkrimtar i vjetër nuk i përmend *arbënit* dhe qytetin e tyre *Albanopolis.* Por ma poshtë do të shohim se ky emër asht shumë i vjetër dhe origjinën e ka në këtë vend. *Arbëri,* në kuptimin më të ngushtë të fjalës, quajnë toskët malësinë në shpinë të Vlorës, e cila, siç duket, në kohën e lashtë, formonte thelbin e Kaonisë së vjetër. Kjo malësi asht Kurveleshi ose Labëria. Në kuptimin më të gjerë ky emër përfshin edhe Himarën (Akrokerauniet) dhe krahinën e Delvinës, pra të gjithë Kaoninë.

Trajta gegënisht e këtij emri është "Arbëni" dhe përdoret për të gjithë Shqipninë. Por ky emën asht i rrallë, ma fort ndigjohet emni Shqipni, por gjindet shpesh ndër librat fetare të kishës katolike. Nga kjo trajtë asht formue gr. e re *Arvanitis* dhe *Albania* e gjuhëve europiane.

Që ky emën në Iliri asht i vjetër, na e dëshmon emri i ishullit Arba ose Arva, sikundër asht shënue në tabelën e Peutingerit, e cila edhe sot, quhet Arbe. Edhe vargu i Alit që ndan Liburninë prej Paonisë mban emrin Albion (Straboni) ose Albanon[92] (Ptolemeu). Na nuk duem me mbledhë këtu të gjithë emnat që janë njisoj, të cilët janë shpërnda prej zemrës së Azisë[93], deri në skajet ma të largëta të perëndimit[94]. Por na po tregojmë vetëm se janë shumë të përhapun

---

Shënim B.P.: Fragmente nga Shënimet: (Fq. 333-335)

Shënimi[92]: ... ndërrimi i germës "m" me "p" ose "b" shihet shpeshherë në gjuhën shqipe. ...

Shënimi[94]: Albanach në malësinë e Skocisë. Arbasoa "plaku i maleve", stërgjyshi mitologjik i Baskëve.

emnat që kanë rranjën "arb" ose "alb" dhe po ua lajmë atyne që janë ma kompetentë me ba hetime a janë këto fjalë prej nji rranje, apo jo. Besoj se kjo punë do ta shpërblente mundimin, sepse kjo rranjë asht shumë e përhapme[95]. Me këtë rasë po bajmë këtë vërejtje: emnat Averner, Arvernia, Alvernia, Alvernh, emra të Auvergne-s në Kohë të Mesme[96] mund të jenë derivate të kallzores së fjalës shqipe "Arbër-në"[97]. Por shumë dijetarë thonë se emri Albania vjen nga fjala "Albes"[98], Alpes = Alpet, ose ma mirë nga fjala keltishte "alb", d.m.th. i naltë[99], i drejtë[100], pra ka kuptimin "malësi" dhe në lidhje me këtë koncepti i lashtë *barbar*[101] duhet kuptuar si *malësor i pagdhendur* kundrejt banorit më të përpunuar të ultësirës apo bregdetit. Në këtë kuptim e përdor qytetari shqiptar fjalën malësor dhe greku fjalën Arvanitis me kuptimin "i pagdhendur, fshatarak".

Me këtë rasë po përmendim edhe nji tjetër trajtë të kësaj rranje; ky asht emri "Armen". Kështu e quejnë veten vllehët që banojnë ndër malet e Pindit dhe sidomos ata që janë vendosë te qafa e njoftun (e Meçovës – shënim i p.), e cila lidh Epirin me Tesalinë. Të gjithë vllehët e tjerë, si edhe kolonitë e tyre e quajnë veten "Rum", d.m.th. Romanë. Këtë emën e përdorin edhe grekët e rinj (...) (si edhe të krishtenët ortodoksë të Shqipnisë ("urum") - shënim i p.). Këtë emën nuk mund ta spjegojmë nga gjuha vllahishte, por po bajmë vetëm këtë pyetje: Ndoshta edhe fjala "Armeni"[102] dhe Albania e Kaukazit mund të rrjedhin nga e njëjta rranjë?

Mbasi i numëruam të gjitha format e reja të këtij emri dhe i krefëm sa qe e mundun, besojmë se kemi të drejtë me futë tek ato edhe fjalën Almene ose Almine[103], që përdor Ptolemeu. Simbas atij, kjo krahinë e vjetër shtrihet prej grykës së lumit Tyamis deri tek qyteti Nikopolis, pra është pothuaj identike me Çamërinë e sotme, por e kalon kufinin e saj të jugut. (Fq. 311-312).

Shënim B.P.: Fragmente nga Shënimet: (Fq. 333-335)

Shënimi[102]: Përsa i përket farefisnisë në mes frygve, armenëve dhe ilirëve shif kaptinën VI. (Fq. 333-335)

Një tjetër provë që dardanët dhe trojanët e Azisë së Vogël janë pellazgë, kemi tek të gjithë emrat e përveçëm, që gjinden tek ata edhe tek maqedonasit dhe epirotët, si Aleksandër, Kasandër, Hektor, etj. Ma në fund po përmendim këtu edhe shënimin e Strabonit që trakasit dhe trojanët kanë shumë emna të përbashkët[163].

...

Në Shqipninë e jugut ishin dy qytete që quheshin Ilion, njani qytet gjindej afër Beratit të sotëm, tjetri në krahinën kastrine të Tesprotisë. Leake asht i mendimit që qyteti në fjalë asht identik me qytetin Kestria dhe me Trojën, të cilën e përmend Stefan Bizantini në krahinën e Kestrisë[165]. Sipas gojdhanës, Kestria u themelua prej Kestrinit, djalit të Helenit nga Troja dhe Andromakës, të cilët i prue këtu Pirroja, i biri i Aqilit[166]. Heleni trashëgoi gjysmën e shtetit të Pirros që shtrihej pranë bregut të detit[167]. Stefan Byzantini përmend edhe një tjetër Ilion në Maqedoni "..."[169]. Bile Elimea, emnin e krahinës maqedone e nxjerr nga Heleni; si duket ky Trojan ka figurue edhe në gojdhanat e Maqedonisë.

Gojdhana nuk tregon vetëm që trojanët imigruen në Epir, ajo njef edhe kthimin e Pergamit, djalit të Andromakës dhe Pirros, në Azi të Vogël[170]. Edhe Virgjili tregimin e tij, përsa i përket takimit të Eneas me Helenin dhe Andromakën, e ka marrë nga gojdhana të vjetra, prandaj jemi të mendimit se të gjitha këto pika të përbashkëta që kanë gojdhanat e Epirit dhe të Trojës, do të kenë pasë një fakt historik. (Fq. 321)

Nuk asht nevoja me sjellë prova që shumë emna popujsh të vjetër janë identikë me emnat e perëndive të tyre kombëtare. Jemi të mendimit që edhe venetasit kanë pasë një perëndeshë kombëtare që quhej Hënë, ose hanë, gjurmat e të cilës i gjejmë tek romakët, që janë fis me ta. Zakonisht Ana Perenna[171] asht hyjnesha e vitit hanor të romakëve. Gojdhana thotë se ajo ka qenë e *bija e Belit,* e motra e Didos. Mbas vdekjes së saj, kur Jarba pushtoi Kartagon, u

---

Shënim B.P.: Fragmente nga Shënimet: (Fq. 333-335)

Shënimi[169]: Ndoshta ky Ilion është identik me Ilionin që përmend Livi, sepse Maqedonia romake nganjiherë shtrihej deri tek gjini i Vlonës. (Fq. 362)

arratis në Maltë dhe prej këndej shkoi tek Enea, i cili e priti shumë mirë. ... *Shumë interesante asht lidhja e Anës me Enean*, i cili në krahinën e Latiumit asht për ne përfaqësuesi i një imigrimi pellazgo-tyrenas. Themeluesi i fisit të henetëve nuk mund të ishte Enea, sepse atë e kërkonte Roma për vete. Prandaj morën të kushëririn e tij, Antenorin, i cili këtu ndoshta asht përfaqësuesi i një imigrimi tyreno-pellazg-syrien[173], sepse Straboni shkruen kështu: "Disa të tjerë thonë se së bashku me Antenorin shpëtuan nga lufta trojane edhe disa henetas nga Paflagonia dhe mendimi aq i përhapun asht ky, që enetët kanë qenë ma i madhi fis i paflagonasve. Mbas pushtimit të Trojës ata shkuan në Traki dhe ma në fund, tue shetitë andej-këndej, zunë vend në Enetikën e sotme. Disa thonë se Antenori dhe i biri i tij muerrën pjesë në këtë udhëtim dhe u ngulën në skajin e Adriatikut", ma në fund "Antenori dhe djemtë e tij, bashkë me enetët që kishin teprue, shkuen në Traki dhe prej këndej u nisën për në Enetikën e Adriatikut[174]". Por Antenori dhe Enea kanë qenë dardanas dhe dardanasit e vjetër, që banonin në fushën e Kosovës në Mezinë e Sipërme, të cilët Grekët nuk i njifnin, mund të ndërmjetësonin marrëdhëniet nëpër tokë në mes të venetasve ilirë dhe dardanasve të Azisë së Vogël. Po të pranojmë që dardanët dhe henetët kanë imigrue së bashku dhe që në Azi të Vogël ishin fqinj, atëhere mund të spjegojmë shumë lehtë ekzistencën e zakoneve asyriane[175] tek henetët e Adriatikut, pa dyshue aspak ndaj origjinës ilire të fisit. Sepse kultet e tyne tregojnë se janë pellazgë: ... (Fq. 322)

53. **Pellazgët.** Ke fjala Pellazgos ndajmë *pel-asgos* dhe ke fjala *pel* vemë fjalën greqishte *pelos, pelios, peleios* = i zi dhe latinishten *pellos* = i zi. Tingulli *s* në fjalën *asgos* bahet *r* (pelargos, pelarge) dhe fjala *argos* për ne asht fjala pellazge për *"arë, agros, ager",* në të cilën

---

Shënimi[225]: Nji kangë shqipe thotë: dolla, dolla në ballë të malit; jam në ballë. Ndoshta ka të bajë me fjalën e greqishtes së vjetër *"balen"* – mbret; kjo fjalë, siç duket, asht nga origjina Fryge. A asht fis me fjalën semite *Baal, Bel – Zot ?* Grimmi, Gesch. Der Deutch. Sprache, fq. 193, përmend mbretin e Dakasve, Dekebalin dhe mendon se ky emën asht nji apelativ; atëhere fjala shqipe në lidhje me fjalën fryge do të përkthehej "mbreti i dakëve, kryetari i dakëve. ... (Fq. 368)

shfaqet *r* e lëvizshme. Prandaj ne fjalën *"pellazgos"* e përkthejmë *"ai që i takon dheut të zi"* [250], këtë na e tregojnë edhe vargjet që gjejmë tek Pausania[251]:

(...*Shënim B.P.:* më poshtë jepen dy vargje greqisht...)

në të cilat ne nuk shohim thjesht një legjendë, por edhe etimologjinë e fjalës.

Dheu i zi krijohet në mal; përrenjt dhe lumenjt e sjellin atë tëposhtë dhe aty ku dheu ze vend banojnë pellazgët, d.m.th. ata që punojnë arat me dhe të zi (μελάγγάιοι) dhe (τό πελάσγικόν) asht toka e dheut të zi, që nuk i shpëtoi vështrimit të mprehtë të Strabonit, ... [252] (Fq. 331-332)

Mbasi jemi të mendimit se pellazgët dhe ilirët janë nga një fis, po shkojmë ma gjatë tue tërhjekë vëmendjen e lexuesit mbi tokat moçalike të bregdetit në Ilirinë e Jugut, pjellorinë e të cilave të vjetrit e lavdëronin shumë. (Fq. 332)

Ne nuk kemi interes të hetojmë, nëse pellazgët erdhën nëpër tokë, a nëpër det. Na po e zamë se ata banonin në Evropë, por disa shenja tregojnë që kur zunë vend në Evropë ata kishin njifarë kulture, sepse merreshin me bujqësi dhe kishin nji kult fetar mjaft të zhvilluem. Pra, mund të themi se ata kanë qenë bartësit e parë të kulturës në Europë, prandaj meritojnë me u marrë ma shumë me ta dhe duhet me i nda ma mirë gjasendet pellazgjike prej atyne të helenëve. (Fq. 332)

Tashti po vështrojmë pak gojdhanat mbi Pellazgun.

Pellazgu i Arkadisë ose asht vendas (Hesiodi dhe Asiosi), ose si i vëllai i Argosit dhe djali i Zeusit me Niobenë[254] (bijë e Foroneut, mbesë e Inakut), vendoset në lidhje farefisnore me pellazgët e Argosit. ... (Fq. 332)

Shënimi[252]: Straboni XIII, f.621, (…. shkrime greqisht …), më pas vijon: Dionizi, I, 20, shkruan se aborigenët u lëshuan pellazgëve, kur erdhën këtu, fushat moçalike të Velias, mbas të cilave u quejt qyteti. (Fq. 370)

...

Pellazgu i Argosit asht i biri i Palektonit (Palaechthon), d.m.th. sipas mendimit tonë "dheu i zi i pluguem" asht i biri i tokës së vjetër. Disa të tjerë thonë se asht i biri i Foroneut, ose i Triopit dhe ia veshin atij përhapjen e bujqësisë dhe të kultit të Demetrës. (Fq. 333)

Bie në sy që emni i Pellazgut mungon në gjenealogjinë e pellazgëve të Atenës dhe të dardanasve; apo gjindet atje me trajtë tjetër? Po të mendojmë kështu, pa dashtë, do të vijmë tek Eriktoni, të cilin e përmendin të dy gjenealogjitë: të dy heronjtë kanë nji gja të përbashkët, se të dy kanë lidhje me pasuninë. Eriktoni i Atikës

---

Shënim B.P.: Më poshtë po rendis fjalët që analizon Hahn (Fq. 336-343):
vranë, geg. *Vranohet* qielli, *vranohet* njeriu, *vranohem.* (për URANOS)
re - ja; shumësi – *retë* (për hyjneshën RHEA)
krua, kroi, rranjën e plotë e tregon në shumësin *kronjtë* (për KRONOS)
hënë -a, tosk., *hanë* -a, geg. Femnore (Anna Perenna ose Peranna; këtë emën na e mbajmë identik me emnin e hyjneshës *Anaitis* të perso-fenikasve[294])
dhe' (për DEUS, ZEUS, DEMETRA – e ama e dheut)
det-i (për THETIS)
ujë-t (për OGYGIS – përmbytje uji)
dif-vi (dif, divi) (për DIVUS-hyjnor)
diell-i
qiell-i (kjiell-i), *geg., qill-i, mashk.*
hatëllë-a, tosk., hatllë-a geg. (për ATLAS, mbajtës i kupës qiellore)
fuqi-a
tinë-a (vozë e madhe për venë;)
nxjerr, pjesore nxjerrë, emën nxjerrës (për CERES)
korrë-a, asht pjesorja e kuar, korr (për KORE, bija e Ceresit)
herr geg., harr tosk. (pres barishtet e këqija)
them (per THEMIS) (prej pjesores tosk, thënë – hamendësohet ATHINA ??)
nëm tosk., geg. nem, mallkoj, nëmës-i, nemësi "ai që mallkon" (për NEMESIS)
ruaj (për RUANA – perëndi romake)
pjell (për PALES - perëndi romake)

Shënimi[294]: Anath, Antha, Antu asht nji hyjneshë Egjyptiane, e cila sipas Roethit, shën. 226, asht identike me Artemisin e grekëve. Shfaqet në shkrimin e hieroglifeve si Tanath, Tanatha, Tanu; tingulli fillestar T, sipas Roeth, asht nyje (të jetë geg. Tanë, nji Tanath i cunguem? Me këtë kuptim ai do t'i shkonte emnit grek Artemis.) – Hyjnesha Anath ose Anait adhurohej edhe në të gjithë Azinë e mëparshme tek persët, kapadokët, armenët, dhe medët. ... (Fq. 374)

përhap në Atenë përdorimin e sermit, të cilën e kishte gjetë në Indi mbreti i Skythëve[259]. Eriktoni i dardanasve asht ma pasaniku i të gjithë njerëzve të kësaj bote, sepse *tri mijë pela* kullotnin nëpër livadhet e tij[260]. (Fq. 333)

Përpara se me lanë formën Pellazgos ose Pelargos, duhet të përmendim nji fakt shumë interesant; ndërkohë që lejleku në greqishten e vjetër quhet *pelargos,* grekët, shqiptarët dhe vllehët e Pindit i thonë të gjithë *lelek* dhe *lejlek.* Leake asht i mendimit se turqit e gjetën këtu këtë fjalë dhe e muerrën nga vendasit, kurse unë besoj se asht nji fjalë arabishte. A nuk asht, pra, interesant që të dy popujt ma të mëdhenj të Greqisë, të cilët nuk ishin grekë dhe jetonin në këtë vend përpara grekëve, kanë po nji emën për lejlekun? Sepse fjala e greqishtes së re *"lelekas",* mbas rregullit si formë e rasës së katërt të shumësit, na drejton kah fjala *leleks* [265]. (Fq. 334)

Pra, Herodoti shkruen, se pellazgët ma përpara kishin emna të përgjithshëm për perënditë, të cilët tregonin cilësitë e tyre dhe ma vonë erdhën nga Egjypti emnat që përdorin sot. ...

..., a nuk mund të gjejmë në gjuhën shqipe, d.m.th. në pellazgjishten e re, emna të përgjithshëm, të cilët jo vetëm janë identikë me emnat e vjetër të perëndive, por tregojnë edhe cilësitë e zotit përkatës?

Po i japim fund kësaj kaptine, tue qenë të bindun se lidhjet në mes shqipes dhe emnave ma të vjetër të perëndive të Greqisë që zbuluem, janë dëshmia ma e fortë që shqiptarët e sotëm janë pellazgë. (Fq. 343)

Pelazgët janë banorët ma të vjetër të Heladës, që njeh historia[1]. Këtu nuk duam të bajmë hetime mbi lelegët e kuretët, epejtë dhe kaukonët, për të cilët historia dyshon se janë fise pelazge, por të gjithë burimet nji zanit[2] pohojnë se, ndër të gjithë popujt parahelenikë, pelazgët ishin në Greqi ma të fuqishmit. Vendet e tyre kryesore ishin Argosi, Arkadia, Atika, Beotia dhe Thesalia; bile gojëdhana na thotë se në Argos pelazgët ishin vendas, d.m.th. se nuk e mbanin mend ardhjen e tyne atje. Shumë gjurmë tregojnë se pelazgët, kur erdhën

në Greqi, kanë pasë një kulturë të zhvillueme. Ndoshta këtë qytetnim e muerën nga fenikasit, ose nga egjiptasit, ose tek ata kryqëzoheshin dy rryma kulture, të cilat dilnin nga një burim i përbashkët. Por këto pyetje nuk na përkasin neve. Na kufizohemi me vue në dukje se fenikasit (Hyksos?) kanë pasë lidhje të ngushta me pelazgët dhe të parët kanë ndikue te të dytët për sa i përket qytetnimit; këtu s'ka kundërshtim. Bile na mund të themi me plot të drejtë që pelazgët e muerën shkrimin nga fenikasit dhe ua sollën grekëve, përndryshe këtë shkrim nuk do ta kishin quejtë "pelazgjik". Na nuk jemi në gjendje me caktue kohën kur grekët e njoftën këtë alfabet[3]. Pelazgët e kohës parahistorike ishin bujq të mirë, mjeshtër të zotë dhe tek ata kulti fetar ishte mjaft i zhvilluem.

Por grekët erdhën këtu si pushtues nga veriu dalëngadalë dhe e zhdukën popullin e pelazgëve, mbasi ishin ma superiorë në pikëpamjen e zhvillimit, kështu që në kohën e Herodotit gjuha e Pelazgëve nuk flitej ma në Greqi; bile edhe gjurmat e saj ishin zhdukë fare. (fq 407).

Siç duket, ardhja nuk u ba me njiherë, por dalëngadalë[5] (fq 408)

Tashti po kthehemi te një gojëdhanë thesalike e cila më duket se në shumë pika meriton me u vërejt ma mirë. Straboni, kur e përshkruan Armeninë, thotë: "Për sa i përket popullit kemi këtë gojëdhanë të vjetër. Armeni, që ishte nga qyteti Armenion i Thesalisë, mbi liqenin Boibe[11], u nis së bashku me Jasonin dhe shkoi në Armeni, dhe ata burra që shërbyen në ushtrinë e Aleksandrit, nën komandën e Kyrsilit nga Farlisa dhe të Medit nga Larisa, thonë se prej këtyne vendi e muer emnin Armeni. Një pjesë e shokëve të Armenit u vendos në Akilisenë, e cila më përpara ishte e Sofenëve, pjesa tjetër u ngul në Sispiridë deri në Kalahenë dhe Adjabenë, përjashta kufijve të Armenisë." Edhe veshja e armenëve thonë se ka ardhur nga Thesalia: … Thesalasit janë posi medët, qeflinj të mëdhenj kuajsh…. Veç kësaj, besojmë se lumi Arakses e ka marrë emnin prej lumit Penejos, sepse ky i fundit ma përpara quhej Arakses, për arsye se e ndan Osën prej Olympit dhe fushën e Tempes. Edhe ai lumë që

vjen prej maleve të Armenisë thonë se në kohë të vjetra është hapë në fushë, që ishte ma e ulët, dhe ka formue një liqen, mbasi nuk kishtë se nga të rridhte. ...

Veç kësaj, si duket ka ra në sy që veshja e thesalasve dhe ajo e armenëve ishte njësoj, përndryshe shkrimtarët e vjetër nuk do ta kishin shkrue këtë gja. Por ato që shkruen Straboni mbi kanalizimet e Jasonit, duket se janë vepra të pelazgëve. Jo vetëm armenët, por edhe albanët, që janë fqinjët e tyne, mbahen shumë si pasardhësit e argonautëve, edhe pse flasin 26 dialekte[13].

Për ne ka ma shumë rëndësi një tjetër mendim i kohës së vjetër, të cilin e kanë shfaq shkrimtarët e kohnave të ndryshme[14], *që armenët janë me origjinë fryge.* Ky mendim ka edhe njëfarë baze, sepse në ushtrinë e Kserksit, të dy popujt kanë po atë komandant, dhe janë armatosun po njësoj. Edhe gjuhët e dy popujve u përngjasin njanatjetrës[15] dhe të dy popujt jetonin nëpër banesa nën tokë[16]. Këtë zakon e kanë pasë edhe dardanasit e Evropës[17], dhe ai gjindet akoma sot tek vllehët, të cilët banojnë në veri të Danubit[18]. (fq 409-410)

Po ta marrim punën kështu, për neve vlejnë dy shënime, të cilët po të ishin vetëm nuk do të merreshin parasysh. Shënimi i parë thotë se ilirët kanë ardhë nga Persia[19], i dyti thotë se dalmatët ishin armenë dhe frygas[20]. Gojëdhanat tregojnë se edhe popuj të tjerë të Evropës kanë ardhë nga Media. ...

... Prandaj këtu del pyetja: A ashtë vetëm një lodër fjalësh, dhe pa asnjë bazë reale, kur albanët dhe armenët i mbajnë si pasardhës të argonautëve, persët si stërnipër të Perseut, dhe medët si ata të Kekropit, apo kemi këtu kujtime të errta mbi atdheun e vjetër në Azi?

Shënimet e sipërme për sa i përket origjinës së ilirëve nga Persia dhe Armenia, nuk po i lidhim me dyndjet e frygasve nën kryesinë e Dardanit[23], të cilët erdhën deri te lumi Penejos dhe te deti Jon, por po kufizohemi vetëm me theksue se edhe pa këtë ndërmjetësim, kemi shumë paralele në nomenklaturën gjeografike të Ilirisë dhe të Armenisë e të Medisë. (fq 411)

Kulmi i periudhës pelazgjike bie në shekullin e katërt përpara Krishtit. Asht për t'u habitë se çfarë zhvillimi muer atëhere në një kohë fare të shkurtër elementi pelazg, sepse mbas themelimit të hegjemonisë mbi shtetet Helene, vjen fill pushtimi i Azisë. (fq 415)

Dalja në skenë e shqiptarëve – Kur Epiri i Ri dhe i Vjetri bashkohen me Perandorinë Bizantine, analet e saj i përmendin përsëri vendasit e parë, të cilët kishin një mijë vjet që ishin harrue.

Këta dalin në shesh me emrin "arbëresh", i cili pjesërisht përdoret edhe sot. Në kaptinat e para u përpoqëm me provue *vazhdimin e lidhjeve kombëtare në mes ilirëve të vjetër dhe arbëreshëve* dhe njikohësisht me tregue se ky emën asht shumë i vjetër.

...

Edhe pasardhësi i tij (*Shënim B.P.:* bëhet fjalë për pasardhësin e Nikifor Brienit që kishte qenë emëruar Dukë i Durrësit) mblodhi një ushtri të madhe normanësh[92], bullgarësh, grekësh dhe shqiptarësh (... greqisht ...) dhe me këtë në vitin 1079 marshon deri në Selanik, por edhe ai pësoi fatin e të parit[93]. Në këtë rast emni i arbëreshëve përmendet për herë të parë në analet e historisë. (fq 422)

Johan George von Hahn

(Lindur: 11 Korrik 1811, Frankfurt, Gjermani)

(Vdekur: 23 Shtator 1869, Jena, Gjermani)

J. PH. FALLMERAYER

"ELEMENTI SHQIPTAR NË GREQI"

Përktheu nga gjermanishtja: Nestor Nepravishta

Botimet *"SARAÇI"*
Shtypur në shtypshkronjën *"Morava"*
Tiranë, Nëntor 2003
Botuar për herë të parë Gjermanisht: 1857-1861

Katër vjet më vonë, i mbështetur mbi këtë bazë prej 1200 fjalësh shqipe (*Shënim B.P.:* Bëhet fjalë për Fjalorin *"Leksikoni"* e gjuhës shqipe të Theodor Kavaliotit me 1200 fjalë), profesori i Laipcigut Tunman (Thunmann) në hulumtimet e tij për historinë e shteteve europiano-lindore (Laipcig 1774), ka paraqitur tezat e para historiko-filologjike për të shkuarën dhe prejardhjen e shqiptarëve, të cilët i shpall si një popull të stërlashtë të Gadishullit Ilirik, si fqinjë të helenëve të vjetër dhe, për rrjedhim, pasardhës në vijë të drejtë të ilirëve të Gentit, Teutës dhe Pirros

Ndryshe nga të gjithë gjermanët, Tunmani, përveç autorëve klasikë, merr për herë të parë në konsideratë edhe bizantinët dhe thekson me të drejtë se shqiptarët duhet të jenë banorë të stërlashtë të atdheut të tyre të sotëm "sepse asgjëkundi nuk është zbuluar qoftë edhe gjurma më e vogël e një emigrimi të mëvonshëm". (Fq. 40)

..., Malte-Brën (Malte-Brun) erdhi në përfundimin se "gjuha e ilirëve të vjetër dhe e shqiptarëve të sotëm është një gjuhë më vete, prejardhja e së cilës shkon deri në lashtësinë e thinjur dhe, në të

vërtetë, në një kohë kur greqishtja, latinishtja, keltishtja, sllavishtja, teutonishtja e gotishtja, filluan të formoheshin si gjuhë secila në sferën e vet." (Fq. 41)

Liku (*Shënim B.P.:* W.M.Leake, anglez) anon krejtësisht nga pikëpamja e Malte-Brënit. Ai pranon se *shqiptarët janë pasardhës të ilirëve të vjetër* dhe është themeluesi i parë i kësaj pikëpamjeje në filologjinë shqiptare. (Fq. 41)

Nga ana tjetër, shumë kohë para Likut, këshilltari gjerman i oborrit, fon Arndt, në fjalorin krahasues që kishte ndërtuar Pallasi me porosi të Katerinës II, mbas një analize, ç'është e vërteta të vetëm 56 fjalëve, kishte arritur në bindjen *se gjuha Shqipe ishte gjuha e stërlashtë e vendit dhe se ajo kishte afërsi të saktësuar me gjuhën Baske.* Rrjedhimisht, ajo i përkiste gjuhëve më të vjetra historikisht të njohura, që kishin sunduar në Europë para imigrimit të grekëve, sllavëve, latinëve dhe gjermanëve. Këto mbetje gjuhësh të stërlashta janë ruajtur deri në kohët tona vetëm në skajet malore të kësaj pjese të botës, domethënë tek irlandezët, skocezët e Skocisë së Sipërme, çudët, baskët dhe shqiptarët.

Pothuajse njëkohësisht me pikëpamjen e paraqitur nga Tunmani dhe të mbrojtur nga Liku, ekzistonte dhe përpiqej të zinte vend, të afirmohej një mendim diametralisht i kundërt, i cili shpallte se *shqiptarët ishin një popull i përzier, (fillimisht) i afërm me bullgarët finë.* Sipas përkrahësve të kësaj pikëpamjeje, ky popull i përzier vetëm mbas shek. VII[të] ka imigruar në Shqipërinë ilirike, duke ardhur nga Albania e Kaukazit nëpërmjet Rusisë së Jugut dhe Gadishullit të Krimesë. (Fq. 43)

Me qëllim që për prirjet themelore dhe rëndësinë e ndikimit të "Studime shqiptare" [*Shënim B.P.:* bëhet fjalë për punimin "Studime shqiptare" (Albanesische Studien) nga dr. Johann Georg von Hahn, konsull m.e.p. (mbretëror e perandorak – N.N.) për Greqinë Lindore.] të mos ketë asnjë dyshim dhe për të provuar autoktoninë dhe aristokratizmin e stërlashtë të shqiptarëve epirotë, doktrinën e vet autori e mbështet në katër tezat që vijojnë:

1. Epirotët dhe maqedonasit që në kohën e Strabonit kanë qenë jogrekë dhe barbarë.

2. Epirotët, maqedonasit dhe ilirët janë fise të afërta.

3. Ka shumë shenja, që dëshmojnë se epirotët dhe maqedonasit përbënin bërthamën e fisit tirrenik-pellazg, kulmet më të skajshme të të cilit në Itali dhe në Thrakë ngrihen lart në histori.

4. Fjala *ilirik* është e njëjtë me fjalën *pellazg* në një kuptim më të gjerë. (Fq. 50)

..., *Tunmani i konsideron dhe i shpall shqiptarët dhe vllehët si pasardhës të ilirëve dhe të maqedonasve të vjetër.* (Fq. 64)

Nëpërmjet një argumentimi të zbatuar në mënyrë filologjike, ai [*Shënim B.P.:* bëhet fjalë për bavarezin fon Ksilander (von Xylander) "Gjuha e Albanezëve ose shqiptarëve" (Die Sprache der Albanesen oder Schkipetaren) (Frankfurt mbi Main 1835)] ka treguar se *gjuha e shqiptarëve, si dhe ajo e baskëve, iberëve dhe e albanëve të Kaukazit ka një karakter themelor gjermanik* .... (Fq. 64)

... Ksilanderi në studimet e veta etimologjike e quan të drejtë pikëpamjen e atyre dijetarëve, të cilët i nxjerrin të parët e baskëve iberikë nga Albania (Shqipëria) ilirike dhe që sot shqiptarët, që banojnë atje, i njeh si të afërm në gjak dhe në gjuhë me ata, që kanë mbetur në vendin e stërlashtë? (Fq. 65)

Nga ana tjetër, z. fon Hahn ka provuar në mënyrë të pakundërshtueshme karakterin jogrek të epirotëve, ç'ka dihej dhe pranohej që në lashtësi, ... (Fq. 69)

Në të dhënat pozitive të tekstit të Ptolemeut hyn si një provë e re fakti se, shqiptarët kanë qenë në këtë vend që në fillimin e erës sonë dhe kanë bërë pjesë në popullsinë ilire, si edhe rrethana e shënuar tashmë nga Ksilanderi se fjalët latine në të folmen e sotme të shqiptarëve ruajnë ende shqiptimin romak të kohës së Augustit. Rrjedhimisht, *c*-ja ende shqiptohet kudo si *k*. Nga fjala latine *cicer* (qiqërr) shqiptari bën *kjikjere,* nga fjala *civitas – kjutet* (qytet), nga

cepa - kjepë (qepë), nga *piscis* - *pischk* (peshk), nga *facies* - fakje (faqe), nga *segitta* - *schegete* dhe *schengjelle* (shigjetë), nga *gens* - *ghjind* (gjind), nga *vicinus* - *fkjinje* (fqinj) dhe nga *cerasum* - *kjerschia* dhe *kjorschia,* gegërisht *kjerschi* (qershi). (Fq. 83)

Tani, edhe sikur të pranojmë (gjë që nuk mund të mohohet më) se në Iliri që në lashtësinë klasike ka ekzistuar një popull i *albanëve,* prapëseprapë do të mbetej për t'u bërë pyetja nëse ky emër është vendas apo vetëm ka qenë i zakonshëm në gojën e të huajve.

Përdorimi i emrit Alb, Alp, Alba, Albion dhe Albania shtrihet në një varg pothuaj të pandërprerë nga bregu i detit Kaspik deri tek grykat më të skajshme të Kaledonisë dhe duket se është e pamundur të ketë një kuptim të ndryshëm nga ai i *"vend malor"* dhe *"banor i malësive".* Sipas Arndtit, në keltishten e vjetër fjala *al, alb, alp* në të vërtetë ka qenë një emërtim i përgjithshëm për atë që ne e quajmë *mal.* Dhe meqë në gjuhën shqipe *schkep, schkip, schkipe* edhe sot ka kuptimin *shkëmb,* ka mundësi, që me hyrjen e rrokjes së prejardhur mashkullore *"tar",* të ketë lindur emri vendës i popullit *Schipetar* (shqiptar), gjë që pastaj duhej të përkthehej me *"banor i një vendi shkëmbor".* (Fq. 83-84)

Shndrrimi i *l* -së në *r* është një rregull gjuhësor i stërlashtë i latinishtes dhe i greqishtes. ….. Vetë kronistët e Oborrit Bizantin në kohën kur filluan të përmendeshin për herë të parë shqiptarët aty nga fundi i shek. XI[të], kudo ku flasin për ta bëjnë fjalë vetëm për një krahinë, vend dhe një grykë mali *Arbanon,* si edhe për një fis luftarak të *Arbanitëve.* (Fq. 85)

Një lidhje të mundshme të stërlashtë të shqiptarëve (albanëve), arbanitëve dhe të Arbërisë në Ilirinë Europiane me "Αλβανοι" dhe "Αρβιες" të Eskilit dhe Strabonit në Iran dhe në Kaukaz asnjeri nuk e kundërshton tek z. Nikokles. Vetëm se mënyrën se si e shikon ai tani për tani rrugën se si imigruan këta bartës të emrit në Europë, kështu siç kërkon ta paraqesë dr. Nikokles, do ta hedhim poshtë si arbitrare, shtrembëruese, të pabazuar dhe aventureske. (Fq. 90-91)

Nga sa u tha më lart, përpjekjet për ta bërë si të paprovueshme, të pademonstrueshme autoktoninë e albanëve (shqiptarëve) ilirikë, të gegëve dhe të toskëve, dhe për ta zhvendosur imigrimin e tyre në shek. VIII[të], duhen hedhur poshtë si historikisht të pabazuara, të gabuara, joshkencore dhe jokritike. (Fq. 104)

Në trajtesën e parë, në kundërshtim me tezat e ngritura nga një dijetar i ri grek dhe duke u mbështetur tek "Studimet shqiptare" të fon Hahnit, jemi përpjekur të provojmë se shqiptarët janë autoktonë, domethënë se imigrimi i tyre në krahinën e banuar edhe sot e kësaj dite prej tyre pranë detit Jon ka ndodhur para çdo njoftimi historik dhe se, rrjedhimisht, atyre u përket rradha, vendi më i vjetër, para racës Helene të vendosur në të dy anët e detit Egje. Pastaj janë paraqitur arsye të mjaftueshme për t'i quajtur shqiptarët një degë të fisit të madh të ilirëve dhe, njëkohësisht, të afërm në gjak dhe në gjuhë me epiriotët dhe maqedonasit e vjetër, popuj që nga ana e tyre i përkasin po ashtu barbarëve ilirë dhe jo helenëve. (Fq. 108)

Është e qartë se edhe mendjemprehti Tunman i ka rënë në të kur thotë se bizantinët, të cilët i kanë njohur shqiptarët e mirëfilltë së pari në Albanopolisin e krahinës malore, ku përmenden si një popull baritor i pavarur dhe luftarak, më vonë do të kenë përdorur emrin e tyre për cilësimin e përgjithshëm të të gjithë malësorëve të tjerë të Ilirisë dhe të Epirit, meqë këta dhe banorët e Albanopolisit kishin të njëjtën gjuhë dhe të njëjtat zakone.

Z. fon Hahn duket se nuk ka të njëjtin mendim me z.Tunman në këtë pikë dhe parapëlqen hamendësimin se emri *Albania* në shkrimet bizantine cilëson në mënyrë të mirëfilltë vetëm krahinën përreth Albanonit, në kuptim të ngushtë, dhe gjithë territorin e vendit që ndodhet ndërmjet Malit të Zi dhe gjirit të Artës, që i bindet bazileut ortodoks joetnografikisht, siç beson Tunman, por thjesht administrativisht, një premisë kjo që më shumë i anashkalon sesa i zgjidh vështirësitë.

Sidoqoftë, errësira në të cilën na lënë autorët e vjetër lidhur me

shtrirjen dhe popullsinë e krahinës shumë të diskutuar malore të Albanonit ose të Albanopolisit i jep interpretimit të Hahnit, sado pak që ne të mund ta miratojmë, përligjjen e saj të plotë. Përkundrazi, "Studimet shqiptare" për herë të parë, me sa di unë, lënë të vezullojë mundësia që, ndoshta, për rritjen dhe gufimin e bërthamës së stërlashtë shqiptare ka ekzistuar një element, një popull jovendas, i cili ka kontribuar në njëfarë mase në këtë proces në fillim në Iliri dhe pastaj në Epir. (Fq. 129-130)

J. Ph. Fallmerayer

(Lindur: 7 Dhjetor 1790, Weiler Pairdorf, Tiroli Jugor)

(Vdekur: 26 Prill 1861)

ROBERT ELLIS

"ORIGJINA ARMENE E ETRUSKËVE"

Botuar për herë të parë nën titullin:
"The Armenian Origin of the Etruscans"
London, 1861

PELLASGËT

(R. Ellis, Fq. 175 - 179)
Përktheu nga origjinali Anglisht
Berzh Piranjani

Është përmendur në fillim që Etruskët, sipas tregimeve të të lashtëve, ka shumë të ngjarë të kenë qenë të lidhur me dy kombe: me Lidianët dhe Pellasgët. Gjurmimi i këtyre afërsive të para dhe e pasojave, që rrjedhin si rezultat i deduksioneve mbi to, është ajo që na ka çuar deri në këtë pikë, dhe na ka çuar në përfundimin që të përdorim supozimin e afërsisë së Etruskëve me Lidianët, të njërës prej familjeve më të mëdha të grupit Arian, një familje, degët e së cilës flisnin dialekte të ngjashme (farefisnore, të afërta) me atë Armene, që tashmë është i vetmi dialekt i gjallë (i mbijetuar) i kësaj familjeje, që në kohët e lashta shtrihej nga Armenia në Etruri. Nëqoftëse kjo është e vërtetë, dhe nëqoftëse Etruskët, njëkohësisht janë të afërm me Pellasgët, *atëhere Pellasgët duhet të jenë pjesë e kësaj familjeje, dhe po në të njëjtën mënyrë duhet të jenë të lidhur me Armenët.*

Tani, nëqoftëse mbishkrimi Cervetri është Pellasg, ky përfundim

mund të konsiderohet si provë. Nëqoftëse, megjithatë, karakteri Pellasg i këtij mbishkrimi nuk do të pranohet (pohohet), atëhere do të jetë e nevojshme të kontrollohet, se cilat janë ato pak pika, vërtet shumë pak, të cilat mund të shërbejnë si karakteristika bazë të Pellasgëve. Unë mendoj, që këto pika vërtet mund të jenë deri në tri. Pellasgët i quajnë qytetet me emrin Larissa; ata zotërojnë dhe kanë themeluar orakullin e Dodonës; dhe emri i tyre Pelasgi, duke qenë se nuk gjen asnjë shpjegim nëpërmjet gjuhës Greke, është ndoshta Pellasg nga vetvetja. Ndaj këtyre tri pikave unë do të drejtoj vëmendjen time.

1. Larissa. Ky është emri i vjetër i Nimrodit, siç e përmend Ksenofoni. Ai e gjeti atë në rrënoja, por tha që qyteti dikur ka qenë i pushtuar nga Medët. Në Armeni ne gjejmë qytete të quajtur *Lori* ose *Lauri,* gjithashtu edhe *Lar.* Në gjuhën Armene, *lori (loray)* ose lavri *(lavray)* nënkupton "një vend i ngritur, kodrinë". *Larel,* gjithashtu, nënkupton "me u ngrit"; *lerrn (learn)* nënkupton "një mal"; dhe *lernak* nënkupton "shkëlqesi". Një formë të ngjashme me *Larissa* ne e gjejmë në fjalën Armene *Arsissa,* ortografia amtare e së cilës është *Arges,* një emër jo i pangjashëm me Argissa të Thesalisë. Salmudessus, Pan-issus dhe Scot-ussa, janë emra Thrakë. Në vendet pranë Armenisë ka, gjithashtu, qytete me emra të ngjashëm me *Larissa.* Pranë Trebisondës është *Laros.* Në Persinë Perëndimore është *Lar* dhe *Lour. Larsa* është emri i një qyteti në mbishkrimet Babilonase.

Sidoqoftë, terma të tillë nuk janë vetëm Orientalë. Në Gali (Gaelic), *larach* nënkupton "banesë, vendi i një shtëpie", dhe lar nënkupton"tokë". Lapponisht (Lapp.) Laire dhe Suedisht (Swed.) Ler nënkuptojnë "baltë, argjilë". Në veri të Gjermanisë ne gjejmë Goslar, Wetzlar, Fritzlar. Lahr dhe Lohr janë, gjithashtu, qytete Gjermane.

2. Dodona. Mënyra primitive e parashikimit të së ardhmes në Dodona është shumë e veçantë –

Mënyra me të cilën komunikohej me orakujt ishte origjinalisht shumë e thjeshtë: nga shushurima e një lisi të vjetër ose ahu.

Zoti e zbulon vullnetin e tij nëpërmjet degëve të pemëve, mundësisht gjatë shushurimës së erës, zhurmat e së cilës priftërinjtë kanë për detyrë t'i interpretojnë.

E njëjta mënyrë hyjnizimi (adhurimi) ka pasë qenë praktikuar në Armeni në kohët e lashta, gjë që duket nga pasazhi vijues në Historinë e Moisi Khorenacit (lib. i. c. 19). Unë po e sjell atë këtu nëpërmjet gjuhës Latine të Whistons. Përmendet një farë Anusavanus, ... [1]

Armaviri i përmendur këtu, Armauria e Ptolemeut, ka qenë kryeqyteti më i vjetër i Armenisë, si fetar ashtu dhe politik, dhe raportohet të ketë qenë themeluar nga Armaeis, biri i Armenakut. Fjala të cilën Whistonsët e kanë përkthyer *"cypress, shosh – selvi, qiparis",* është dhënë *"poplar, popghar"* nga shkrimtari Armen, Avdall. Aucher e përktheu atë si *"rrap, çinar",* por i referohet si sinonim i *"kalamakh, kaghamakh",* të cilës ai i jep kuptimet "poplar, aspen, beech, elm – plep, plep i egër, ah, elm". *Soxh*,* përsëri nënkupton "a pine = një pishë, pemë pishe" që është e ngjashme me "sosna – pishë" në gjuhën Polake. Kuptimi i vërtetë i *shosh* duhet të jetë "shaker – tundës, lëkundës" siç del qartë nga fjalët *shoshapil, shoshkal, sasanil* – që në gjuhën Armene kanë kuptimin *me tund.* Gjuha Armene ka gjithashtu *thothapil, devedel,* dhe *tatanil* me kuptimin *"tund",* në të cilat bashkëtingëlloret vërshëllyese të *shoshapil,* etj., janë forcuar. Ndonjë pemë ka mundësi të ketë qenë quajtur "tundëse" ose "lëkundëse", që në gjuhën Armene përkthehet *"tatan";* dhe ne mund ta kemi ndoshta emrin Dodona të prejardhur prej së njëjtës rrënjë, dhe i japim asaj kuptimin e duhur, "εἰνοσίφυλλος" në Greqisht.

3. Pelasgus. Zakonisht kjo fjalë trajtohet kështu: *pel – asgus.*

"Batmani sugjeroi kohë më parë, që dy rrokjet e fundit ishin një përcaktim etnik, të lidhur me emrin *asca – nius,* shumë i përhapur në Frigi, Lidi dhe Bitnia, si edhe me vetë emrin e Azisë (Azia, Asia).

[1] *"Shënim B.P. ...*vazhdon citimi i Anusavanus në gjuhën dhe shkrimin Latin"

Kjo rrënjë, *as (az)* – që supozohet të ekzistojë në As-ia, fare lehtë mund të identifikohet me rrënjën Armene – *as* – e cila shfaqet në *as-g* dhe *az-n,* dy fjalë këto, që përfaqësojnë fjalët "komb" dhe e dyta ndoshta ndoshta = "έθνος" (komb) në Greqisht. Ascanius mund të krahasohet me fjalën Armene "*azgajin* – kombëtar, i afërm". Për elementin e dytë të *Pel-asg* ne morëm, pra kështu, nga Armenishtja pjesën "*azg* – komb, racë, familje, tribu, njerëz, popull", një fjalë që unë pak më parë kisha supozuar se hynte në formacionin e fjalës Etruske *Matulnask, Matulnian* me kuptimin "*gens* or *familia* – farefis ose familje".

Tashmë ngelet të përcaktojmë pjesën *Pel-.* Tani, çfarë race *(azg)* janë Pel-asgi? Ata janë racë e vjetër, autoktonë, apo banorë të lashtë, të Greqisë dhe të vendeve nga veriu. Kjo na çon neve të bëjmë lidhjen e Pel- me fjalën Armene "*vagh, vah* – i hershëm, i vjetër = Greqishten "παλαιός" (i vjetër) = Epirot πέλιός, = Alb (gjuhën Shqipen) *"pliak – plak".* Kuptimi *old race = vagh-azg = racë e vjetër* duket si përcaktimi më i mirë që mund t'i jepet emrit *Pel-asgi.* Strabo (p. 220) thotë për Pellasgët, që ka qenë një e njohur universale, (ότι μέν άρχαίον τι φϋλον κατά τήν Ελλάδα πάσαν έπεπόλασε); dhe përsëri (p. 327), (οί δέ Πελασγοί τών περί τήν Ελλάδα δυναστευσάντων άρχαιοτατοι λέγονται). Dionisi (lib. i. c. 17) flet për Pellasgët si (αύτόχθονες, ώς οί πολλοί περί αύτών λέγονσι - autoktone, siç thoshin shumë prej tyre); Dhe Pausanias përsëri, në fillimet e *Arkadikas* së tij, vë në dukje traditën Arkadiane, që Pellasgu ishte i pari që jetonte në atë vend. (φασί δέ Αρκάδες, ώς Πελασγός γένοιτο έν τή γή τανρή πρώος); Pausanias ka vështirësi të konsiderueshme në përshtatjen e këtij pohimi me historinë e mbretit të tij Pelasgus: (ποίων γάρ άν καί ήρχεν ό Μελασγός άνθρώπων); por nëqoftëse ne interpretojmë (Πελασγός = Pelasgu) *"pel-asg"* ose *"racë e vjetër"* atëhere tradita

Shënim B.P.: Tek kapitulli "Pellasgët", gjatë trajtimit të fjalës "Pelasgus", gjatë përkthimit fjalët në gjuhën Greke janë lënë siç i ka vënë autori (R. Ellis), me qëllim që të mos humbasë apo deformohet origjinaliteti i tekstit.

Arkadiane reduktohet thjesht në një të vërtetë të rëndomtë. Me Virgjilin (AEn. Viii. 600) pellasgët janë "veteres - *të parët, pleqtë".*

Ndonëse emri *Pelasgi,* nëqoftëse pranohet shpjegimi i tij nëpërmjet gjuhës Armene, do të mund, pra, të pranohej Thrakas, megjithatë nga kjo, jo domosdoshmërisht, mund të nxirret përfundimi, gjë që mund të jetë e vërtetë, se çdo komb i quajtur *Pellasg* është me origjinë Thrake; pasi Thrakët mund të kenë quajtur Pellasgë ndonjë racë vendase, që i përkiste qoftë familjes së tyre, qoftë ndonjë familjeje tjetër. Sido që të jetë, për çdo rast, duhet të kenë qenë Thrakët në këtë vend, që i kanë dhënë racës emrin *Pellasg.*

Fjala Armene *asg, azg,* nuk është gjetur, që po në gjuhën Armene, të gjendet e kombinuar në një fjalë të vetme me fjalën *vagh, vah;* por gjithashtu nuk duket, që të mund të formojë fjalë si Pelasgus, në kombinim me disa mbiemra.

1. Me "*ajl* – tjetër, i ndryshëm, por"; *Ajlazg* – i ndryshëm, tjetërsoj

   Ajlazgi – i huaj, i ndryshëm, tjetërsoj

2. Me *avtar* ose *oetar* - i huaj, i largët, tjetër

3. Oetarazgi – i huaj, një i huaj; oetarazgi – heterogjen; hamazgi – homogjen

   Me *lav* – mirë;

   Lavazgi – fisnik, nga familje e mirë

   Disa emra Etruskë fillojnë me *lau-* ose *lav-.* Kështu, p.sh. *Laukin* ose *Lavkin* është një emër gruaje, që shfaqet në format: *Laukin, Lavkinal, Laukine, Lavkinasa.* Në gjuhën Armene, fjala *"lav-kin"* ose *"lav-gin"* përkthehet "grua e mirë". Një tjetër emër Etrusk është *Lautn,* i cili mund të krahasohet me fjalën e gjuhës Armene *"lav-toun"* ose *"lav-dovn"* që përkthehet "shtëpi e mirë" ose "familje e mirë". Një emër i tretë është *Lauchme,* që supozohet të jetë forma Etruske e *Lucumo.*

Shënim B.P.: Shqipërimi i disa fjalëve Armene të përdorura në tekst

Armenisht	**Transkriptimi**	**Përkthimi në gjuhën Shqipe**
սոճի	[soçi, soxhi]	pishë, pemë pishe
սոսի	[sosi]	panjë, pemë panje
սոսափյուն	[sosapjun]	shushurimë, fërfërimë
թոթափել	[totapel]	tund
ծածանել	[cacanel; xaxanel]	tund
սասանել	[sasanel]	tund
շոշափել	[shoshapel]	prek, ndjej

Shënim B.P.: Tek kapitulli “Pellasgët”, gjatë trajtimit të fjalës “Pelasgus”, gjatë përkthimit fjalët në gjuhën Greke janë lënë siç i ka vënë autori (R. Ellis), me qëllim që të mos humbasë apo deformohet origjinaliteti i tekstit.

JANI VRETO

"VEPRA TË ZGJEDHURA"

Mbledhur dhe përgatitur nga Alfred Uçi
Shtypshkronja *"8 Nëntori"*
Tiranë 1973

Shënim B.P.: Dy fjalë që i takojnë hyrjes së shkruar nga Alfred Uçi për këtë vepër:

Shpesh kur flitet për Jani Vreton, kujtojmë menjëherë Shoqërinë e shkronjëzave të Stambollit dhe veprimtarinë e tij në Rumani. ...; më 1844 Veqilharxhi botonte *"Evëtarin"* e parë të gjuhës shqipe; me zërin e tyre bashkoi zërin e tij Jani Vreto, i cili qysh më 1847, kur ishte nxënës i Zosimesë së Janinës, shkruante poemën "Istoria e Skënderbeut". Nga kjo kohë fillon interesimi i Jani Vretos për gjuhën shqipe dhe për çështjen kombëtare, ... Në këtë periudhë ... grumbulloi fjalë të ralla shqipe me qëllim që të hartonte një fjalor të gjuhës shqipe, mblodhi këngë popullore dhe fjalë të urta popullore, *krijoi dhe përdori një alfabet të ri* për të shkruar gjuhën shqipe, u interesua për grumbullimin e studimin e shkrimeve të lashta shqipe, ... etj. (Fq 6-7)

Ai ishte ndër antarët më aktivë të komisionit për përpilimin e alfabetit të gjuhës shqipe, që u zgjodh më 1867.

Së bashku me Naimin dhe Samiun shkruan *abetaren e parë me alfabetin e ri,* drejton botimin e së parës revistë shqipe, "Drita", që më pas u quajt "Dituria", ... (Fq 8)

(*Shënim B.P.:* Deri sa më sipër i takon hyrjes së shkruar nga Alfred Uçi për këtë vepër.)

(*Shënim B.P.:* Këtu e më poshtë i përket shkrimeve të Jani Vretos.)

Edhe *xh*do komp, që nukë ka shkruarë gjuhën' e vet, edhe s'ka shkronja ndë gjuhë të vet është ndë t'errëtë dhe barbar.

Shënim A. Uçi: Nevolë – nevojë (Tek kjo fjalë autori ka lëkundje në përdorimin e *j* -së. Prandaj është përgjithësuar forma me *"j"* si p.sh *nevojë* për *nevolë*. (Fq. 35)

*Xh*do gjuhë që të shkruhetë, duhetë për çdo zë të vetëmë dhe të pandam të saj një shënjëzë e mbë vete, që thuhetë shkronjëzë a shkronjezë. Prapo, *xh*do zë i vetëmë dhe i pandam ka shkronjëzën' e ti mbë vete, edhe *xh*do shkronjëzë ka zëthin e saj mbë vetëhe.

Shkronjëzatë të gjitha bashkë thuhenë Alfabetë, prej emëravet të dy shkronjëzavet të para, që ua vuri ay që i gjeti të parë herë, i cili nuk dihetë as se nga qe, as se si ia thoshin emërinë; *përveç vetëm' ay q'i pru ndë Evropë të parë herë gjëndetë e shkruarë, se quhej Kadhmo, edhe erdhi prej Finiqi ndë Elladhë.*

Alfabeta duhet të ketë kaqë shkronjëza, sa zëre të vetëme dhe të pandamë ka gjuha.

Gjuha shqip ka tridhjet' e gjashtë zëre të vetëmë dhe të pandarë, edhe alphabet' e Shqipesë ka tridhjetë e gjashtë shkronjëza, edhe janë këto: *a, b, c, ç, d, dh, ë, e, f, g, gj, h, i, j, k, l, ll, m, n, nj, o, p, q, r, rr, s, sh, t, th, u, v, x, xh, y, z, zh.* (Fq. 49)

Shënim B.P.: (Marrë nga "Allfabetore e Gluhesë Shqip", botuar në Konstandinopojë 1879) (shih Fq. 57)

Më 1879 u bë në Kostandinupojë prej shqiptarësh të krishterë orthodhoksë e katholikë edhe muhametanë Shoqëri për shkronja shqip, *edhe u tipos abetarja e parë shqip* shkruarë prej Sami bej Frashërit muhametanit, prej Pasko Vasësë Shkodranit katholikut dhe pre atij që flet, orthodhoksit me shkronjëza mendimi ndë shum

mbledhje të orthodhksëvet, katholikëvet dhe muhametanëvet, shum kohë, edhe ato shkronjëza të gjuhësë s'anë shqipesë prej shoqërisë për shkronja shqip atje. (Fq. 161)

... Shoqëria "Dritë" u prish, edhe më 1887 u përtërit mbë emërit "Dituri", edhe hapi skholinë shqip ndë Korçë me vivliat që kish tiposurë mbë emërin Dritë, ... (Fq. 162)

Edhe ne e pranojmë se emri Albanoi dhe Albania, nuk njihej jo vetëm nga grekët e lashtë, por ai nuk njihet edhe sot as nga vetë shqiptarët. Të huajt i thërresin shqiptarët Alvanoi. Ai që s'e beson këtë, le të vijë e të thërresë me këtë emër një fëmijë, grua apo burrë, që nuk është shoqëruar ndonjëherë me të huaj; prej tyre asnjeri s'ka për ta kuptuar se cilin thërrasin. Në përgjithësi vehten tonë ne e quajmë shqyptarë ose shqiptarë dhe vendin, në të cilin banojmë, e quajmë Shqypëni ose Shqipëni, sipas dialektit të gegëve, dhe Shqypëri apo Shqipëri, sipas dialektit të toskëve. Po të thërresësh me këtë emër qoftë edhe një foshnjë, kjo ka për të t'u përgjigjur.

Edhe emri Alvanos nuk është as fjalë greke e as fjalë shqipe; të huajtë i thërresin me këtë emër shqiptarët. Dhe, siç thonë ata që dinë gjuhë të huaja, kjo fjalë do të thotë *malësor* ose *i bardhë.* Nëqoftëse e quajtën për herë të parë albanë ata që flasin një gjuhë në të cilën kjo fjalë do të thotë malësor, kanë patur të drejtë dhe në këtë punë s'ka patur ndonjë djallëzi, sepse vendi ku banojmë është në pjesën më të madhe malor. Edhe nëqoftëse e quajtën kështu ata që flasin një gjuhë, në të cilën kjo fjalë do të thotë i bardhë, përsëri kanë të drejtë, sepse vishemi në përgjithësi e prej kohësh të lashta me rroba të bardha. Ata që kanë dashur ta nxjerrin origjinën tonë nga emri Albanos (Albanoi) janë gabuar dhe gënjyer fort. (Fq. 188-189)

Edhe emri shqiptar nuk është ndonjë emër i ri. ... Është krejt e sigurtë që ky emër ka ekzistuar para pushtimit të Stambollit nga Turqit dhe para ndarjes së kishës kristiane, *sepse po të ishte më i ri, atëhere pas ndarjeve fetare s'do ta kishin pranuar me kënaqësi një lloj të gjithë.* Nga ana tjetër nuk ka as edhe një fakt tjetër që të

vinte në dyshim se ky është një emër shumë i lashtë. Meqenëse emri "shqiptar" vjen nga fjala shqipe "shqype", "shqipe" (e afërt me fjalën greke *gyps,* gjindore *gypsos),* domethënë shqiponjë (kjo ishte symbol i Zeusit), mund të supozojmë se banorët vendas autoktonë në fillim e kanë përdorur këtë emër si symbol fetar dhe më vonë është kthyer gradualisht në emër kombëtar, ose e përdorën për t'u krenuar se ishin trima si shqiponja. (Fq. 210)

Përveç kësaj, në gjuhën shqipe është ruajtur dhe përdoret edhe emri *pelazgos, pëlak, plak* (këtej vjen fjala *pelag,* e cila me futjen e *s* -së midis *a* -së dhe *g* -së, u bë *pelasg,* siç ndodh p.sh. me foljen greke *migo-misgo,* dhe me prapashtesën os fjala *pelasg* bëhet *pelasgos*) që do të thotë *njeri i vjetër, i lashtë.* (Fq. 211)

Gjithë gojëdhanat mitologjike e të dyshimta provojnë ekzistencën e fiseve dhe dialekteve të afërta midis tyre, që përmblidheshin nën emrin e pellazgëve. Nga këto, një pjesë, që u përzie me kolonë të qytetëruar të ardhur nga Egjypti e Finikia, dhe që shkroi e kultivoi dialektin e vet, u ndriçua, u qytetërua e u quajt komb Grek. (Fq. 217)

Shënim B.P.: (Marrë nga artikulli "Apollogjia", me nëntitull "Apologjia kundër artikullit 'Epiri, djep i helenizmit, Shqipëri!!!' ") (shih Fq. 175-228)

Vërtet nuk dihet se cili është ai i ditur që shpiku i pari shkrimin, por që shkrimi ishte në përdorim në kombe të Azisë e ndër Egjyptianët e Afrikës prej mijëra vjetësh para Krishtit, kjo është e sigurtë. Dihet gjithashtu se midis evropianëve, pellazgët kanë qenë të parët, që i muarrën shkronjat prej finikasve dhe prej pellazgëve i muarrë grekët aty nga fillimi i shekullit të gjashtëmbëdhjetë po para Krishtit, kur, siç është llogaritur, Kadmi, i biri i Agenorit, mbretit të Finikisë, i shoqëruar nga të tjerë, shkoi në Greqi për të kërkuar motrën e tij Evropa, që ia kishin rrëmbyer dhe shpuri atje, siç tregon historia, shkronjat.

Ja ç'thotë për shkronjat ati i historisë, Herodoti, në librin e V^{të}: "Këta finikas, që shkuan së bashku me Kadmin në Greqi, midis të

cilëve ishin edhe fyreasit, pasi u vendosën mirë e bukur në këtë vënd, u suallë dhe u mësuan gjëra të ndryshme grekëve dhe bile edhe shkronjat, të cilat nuk i kishin më parë grekët, nga sa di unë. Në fillim grekët përdornin të gjithë po ato shkronja që përdornin finikasit, por me kalimin e kohës, në përshtatje me gjuhën e tyre, ndryshuan edhe formën e shkronjave. Rreth e përqark atij vendi ku ndenji Kadmi me finikasit, në shumë pjesë banonin në atë kohë *Grekët që quheshin Jonë,* të cilët, pasi mësuan shkronjat prej finikasve i ndryshuan, ndonëse i përdorën në mënyrë të kufizuar. Këto shkronja Jonët i quajtën shkronja finikase, ashtu siç e kërkonte edhe e drejta, meqë finikasit i sollën të parët në Greqi. Dhe unë vetë kam parë shkronja kadmiane në tempullin e hirshëm të Apollon Ismeniasit në Tebe të Beotisë, të skalisura mbi tre tripode. Këto shkronja ngjisnin shumë me ato të Jonëve". ...

Por edhe [historiani] Diodor Liqelioti, në librin e II[të], 66, thotë: "Thuhet, pra, se midis elenëve, i pari që shpiku rytmat dhe meloditë ka qenë Linos-i, kurse Kadmi solli në Greqi shkronjat e quajtura finikase, të cilat elenët i ndryshuan e ua përshtatën dialekteve të tyre. Përgjithësisht këto shkronja u quajtën finikase nga që u sollën tek elenët prej Finikisë.

Këto shkronja u quajtën në mënyrë të veçantë pellazgjike, sepse të parët që i përdorën ishin Pellazgët. Thonë, pra, se ky Linos-i me shkronjat pellazgjike, shkrojti veprat e Dionisit, kurse tregimet e tjera mitologjike i la pa i përmendur.

Këto shkronja pellazgjike i përdori gjithashtu edhe Orfeu, si edhe mësuesi i Homerit, Pronapidisi, kompozues i shquar këngësh".

Por Diodori, duke thënë se shkronjat e sjellura i përdorën të parët pellazgët, duket sikur nuk pajtohet me Herodotin (shumë më i lashtë se ai) që thotë se midis fiseve elene, Jonët (që banonin në atë kohë në pjesët më të shumta të vendeve rreth e përqark finikasve të ardhur së bashku me Kadmin, midis të cilëve ishin dhe gjefireasit) i morën shkronjat prej këtyre të fundit me anë të mësimit. Kjo do të thotë

se Jonët kanë qenë të parët që i muarrë shkronjat prej finikasve. *Por edhe Herodoti të gjithë elenët i quan pellazgë nga emri dhe pohon se gjithë Greqia quhej Pellazgji më parë.* Kështu në librin A (I) ai thotë: "Kresi (mbreti i Lidisë), duke gjurmuar historinë me anë pyetjesh e kërkimesh, gjente se (midis gjithë fiseve elene), shquheshin lekedemonasit dhe athinasit, të parët në krye te fisit dorian dhe të dytët në krye të fisit jonian. *Në kohët e vjetra jonët ishin pellazgë, kurse dorianët ishin komb elen. Pellazgët kurrë nuk kishin dalë jashtë vendit të tyre, kurse dorianët, përkundrazi, kanë qenë shumë të lëvizshëm.* Ata në kohën e mbretit Leukalion banonin në vendet Ftias kurse në kohën e elenit Doros, banonin rrëzë maleve të Osës dhe të Olimpit, në vendin e quajtur Estiea. Nga Estiea u dëbuan prej kadurianëve dhe u hodhën në Pind; në këtë kohë quheshin Makedonas. Prapë u ngritën së këtejmi dhe shkuan në Driopide dhe prej Driopidës në Peleponez, *ku u quajtën fis dorian"…*

Kështu, pra, vëllezërit e stërgjyshërve tanë ishin të parët në Evropë, që muarrën shkronjat prej finikasve. Them vëllezërit e stërgjyshërve tanë, sepse këto shkronja nuk i muarrën ata pellazgë që flisnin gjuhë barbare, stërnipërit e të cilëve jemi ne shqiptarët, por ata pellazgë që harruan gjuhën e tyre dhe u shndërruan në grekë, siç thotë prapë po Herodoti (në librin e parë (A) 57 dhe 58): "Çfarë gjuhe flisnin pellazgët, nuk mund të them me të vërtetë por nëse, për të folë me fakte, do të marrim parasysh gjuhën që flasin pellazgët, të cilët akoma edhe sot banojnë në Krestonë (qytet që ndodhet përtej tirsanëve) dhe të cilët kanë qënë dikur fqinj me ata që sot quhen dorianë e që banonin asikohe në atë tokë që sot quhet Thesali dhe po të marrim parasysh gjuhën e pellazgëve që sot banojnë në Helispont, në qytetet Pllakia dhe Skillakë (këta pellazgë kishin banuar njëherë së bashku me athinasit) dhe po të marrim parasysh qytete të tjerë të vegjël, që ishin pellazgjikë, atëherë mund të themi se pellazgët flisnin një gjuhë barbare. Pra, nëse të njëjtën gjuhë kishte i tërë kombi pellazgjik (këtë nuk e di), por sa për kombin e Atikës, i cili ishte komb pellazgjik, ky me t'u elenizuar harroi dhe gjuhën. As

krestionjatët, as pllaqianët nuk kanë të njëjtën gjuhë me asnjë nga ata që banojnë sot rreth e përqark tyre, por midis tyre ata kanë të njëjtën gjuhë, dhe thuhet se pellazgët e ruanin atë gjuhë që sillnin kur shkonin në këto vise"…

Pra, historia thotë se shkronjat (të cilat, sipas të thënave të Diodorit, i muarrë pellazgët prej finikasve dhe pastaj elenët prej pellazgëve) ishin këto gjashtëmbëdhjetë: *α, β, γ, δ, ε, ι, χ, λ, μ, ν, ο, π, ρ, σ, τ, υ*

Kadmi e shokët e tij finikas, që i sollën këto shkronja, llogaritet prej historianëve se erdhën në Greqi aty nga fillimi i shekullit të gjashtëmbëdhjetë para Krishtit. Por disa filologë të rinj evropianë të shekullit të shtatëmbëdhjetë të erës sonë thonë se para shekullit të gjashtë e të shtatë para Krishtit elenët nuk kishin shkronja, sepse deri në atë kohë arrijnë mbishkrimet që kanë shpëtuar dhe sepse Homeri (që ishte shumë kurreshtar e që jetoi rreth vitit njëmijë ose nëndëqint para Krishtit, dhe që bën fjalë për shumë gjëra të kohës së vet, bile edhe për gjëra me vlerë shumë të vogël) për punë shkrimi nuk bën fjalë fare. Përsa u përket vjershave të Homerit, thonë se ato u transmetuan verbalisht gojë më gojë dhe se u ruajtën në kujtesë deri në shekullin e shtatë dhe të gjashtë para Krishtit, kur i solli prej Jonie Likurgu dhe Pisistrati i mblodhi dhe i bashkërenditi në dy libra, në Iliadën dhe në Odhisenë…

[Historianët thonë gjithashtu] se nuk ishin vetëm poemat e Homerit, por edhe ato të gati bashkëkohasit me të, të Hesiodit dhe të tjerëve para Homerit dhe Hesiodit e pak pas tyre, të cilat, në qoftë se nuk kanë shpëtuar, përmenden prej [shkrimtarësh] të lashtë, që i patën lexuar në kohën e tyre. Kaq vepra të mëdha, nuk ishte e mundur, thonë, të ruhen vetëm gojë në gojë. Kështu pra, këta të dytët pranojnë sigurisht, gjithsa shkruajnë për shkronjat dhe shkrimin dhe grekët e vjetër, të cilët, duke qenë më afër këtyre gjërave, besonin pa pikë dyshimi se stërgjyshët e tyre i muarrën shkronjat me anë mësimi prej Kadmit dhe finikasve të tjerë që erdhën bashkë me të. Ata shkruanin në fillim nga e djathta në të majtën, sikurse finikasit

dhe semitët e tjerë, të cilët shkruajnë edhe sot ashtu si hebrejtë dhe arabët. Më vonë filluan të shkruajnë siç punojnë qetë në arë, domethënë duke filluar nga e djathta në të majtën dhe, në kthim, nga e majta në të djathtë. Më në fund fare zunë të shkruajnë vetëm e gjithnjë nga e majta në të djathtë.

Por të gjashtëmbëdhjetë shkronjat (që muarrën prej Kadmit dhe finikasve të tjerë të ardhur bashkë me pellazgët që kishin harruar gjuhën e tyre dhe ishin shndrruar në elenë) nuk ishin të mjaftueshme për të paraqitur të gjithë zërat e thjeshtë e të pandarë të gjuhës greke. Bile shumë prej tyre, duke qenë se paraqitnin ftongë grykorë të gjuhës semite, zbatoheshin me përpikmëri në ftongët e elenishtes. Elenishtja kishte shtatë zanore (nga këto dy shqiptoheshin në mënyrë të shkurtër dhe dy në mënyrë të zgjatur, e që kur ndodheshin në fillim të fjalëve shoqëroheshin me një frymë të hollë ose të trashë) dhe pesëmbëdhjetë bashkëtingëllore. Duheshin, pra, ndryshuar dhe plotësuar shkronjat e Kadmit që të mund të paraqiteshin gjithë tingujt elementarë të gjuhës elene …

Alfabetin e finikasve, të ndryshuar prej grekëve, e muarrë më vonë dhe latinët dhe e ndryshuan edhe ata simbas nevojës së gjuhës së tyre … (Fq. 251-255)

Dhe tashti po bëj fjalë për shqiptarët e brezave të fundit para nesh, të cilët shkrojtën në gjuhën shqip dhe veprat e të cilëve i pashë, si dhe për ato që i njoh me anë dëgjimi. Ata janë:

Pjetër Budi nga Gurri i Bardhë i Matit, prift katolik, i cili, me urdhër të papës Klementi i VIII[të], që ishte papë prej vitit 1591 deri në vitin 1605 të erës sonë përktheu në dialektin e gegërishtes katekizmën kristiane, që ishte redaktuar prej kardinalit Robert Belarmini, dhe përkthimi i së cilës prej Budit u shtyp herën e dytë më 1664 dhe herën e tretë më 1868, në Romë, kurse botimi i saj i parë do të jetë bërë pak pas botimit të origjinalit të Belarminit dhe është i një lashtësie gati treqind vjeçare. Në këtë përkthim Budi është

kujdesur të mos fuste fjalë të huaja, veçse vetëm disa pak fjalë latine, dhe ato më tepër me kuptim fetar, dhe dy (fjalë) turke, fjalën "jo" dhe fjalën "murder" (i ndyrë), duke krijuar dhe një fjalë "lazënohem" prej fjalës turke "lazëm" – nevojë, i nevoshëm. (Fq. 261)

...

Pas Pjetër Budit vjen Pjetër Bogdani, gjithashtu prift katolik prej të cilit kanë mbetur fjalime kishtare, që janë përkthim nga latinishtja në dialektin e gegërishtes dhe që u botuan më 1685 të erës sonë në Padova, në një libër, i cili tani është shumë i rallë dhe që siç më tha i ndjeri elbasanas Kostandin Kristoforidhi, i cili e kishte shtënë në dorë dhe e kishte lexuar me shumë vëmendje, është një libër i rëndësishëm përsa i përket gjuhës, sikur edhe ai i Budit. Edhe Bogdani shkrojti me *alfabetin e Budit.*

Pas Budit dhe Bogdanit, ata që unë kam dëgjuar se kanë shkrojtur dhe ata, dorëshkrimet e të cilëve kam parë, janë: Theodhor Filipi prej Elbasani, Tahir Efendiu prej Jakove, Nazim Berati, Hasan Ziko nga fshati Starje i Kolonjës, vëllezërit Stefan dhe Nikolla (nga këta Nikolla ishte prift me gradë jeroikonom) prej fshatit Postenan, vendlindjes sime, rrethi i Përmetit (nxënës të mësuesit të famshëm të shkollës së Janinës, Ballano), Naum Vithkuqari dhe Muhamet Çami. (Fq. 261)

Shënim B.P.: (Marrë nga artikulli "Mendime mbi shkrimin e gjuhës shqipe", po nga libri sipërcituar) (shih Fq. 249-287)

Jani Vreto

(Lindur: 14 Janar 1822, Postenan, Përmet)

(Vdekur: 1900, Athinë, Greqi)

Shënim B.P.: Të shihen dhe të konsiderohen të një rëndësie të veçantë studimore faqet 192-209, ku renditen një sërë fjalësh nga fjalori grek që gjejnë kuptim në gjuhën shqipe !!

NAIM FRASHËRI

"ILIADHË E OMIRIT"

Nxjerrë nga libri:
Homeri
Iliada
Kënga e parë
Lufta e Bretkosave me minjtë
Botim i Argeta-LGM, Tiranë, 2002
Parathënie shkruar nga: Naim Frashëri

Shënim B.P.: Kopjuar siç është në tekstin original paraqitur në libër:

Omiri ka shkruarë dy vjersha të gjata: nga ato njëra tregon luftën e Troësë e thuhetë "Iliadhë", se qytet i Troësë quhej edhe Ilo, pa m'at emër' i thanë Iliadhë vjershës së saj. (Fq. 3)

Grekërit e vjetërë në kohët t'Omirit s'quheshinë as grekë as elinë, por dhanainj, ahainj, etj. Grekërit' e vjetërë nuk ishinë nga far' e pellasgjinjet, por ishinë, si thotë Thuqididi, të mbledhurë nga Finiku, nga Egjypta, etj.

(*Shënim B.P.* Këtu të shihet historia e Finiqit shqiptar – a ka lidhje me Fenikinë, Fenikasit)

Falmajeri thotë se edhe grekërit' e sotmë s'janë nga far' e grekëret të vjetërë, se far' e atyre është shuarë, po janë nga sllavërë, vlleh, etj. (Fq. 5)

Iliadha tregon, si thamë, Luftën e Troësë, a, si thoën ca, luftërat e bëra në mest të pellasgjinjet, se gjith' ata kombe ishin nga pellasgjinjtë, a, si thonë të tjerët, luftërat e Azisë me Evropënë ngaherë. Tri her'

e kanë shpëtuarë nga Azia Evropënë shqipëtarët: Aqilehti mundi Troasitë, Aleksandr' i Madh persianëtë, Skënderbeu turqitë. (Fq. 6)

Ndërron pakë "Odhiseja" nga "Iliadha", prandaj kanë thënë se vjershëtor' i "Odhisjesë" është tjatër e i "Iliadhës" është tjatër, po të tjerë thonë që "Iliadhën" Omiri e ka bërë në djalëri e "Odhisjenë" në pleqëri, e nga vërsa ka ngjarë ndryshimi. Thonë se Omiri rronte njëmijë vjet përpara Krishtit dhe luft' e Troësë qe bërë dyqint vjet përpara Omirit.

Në kohët t'Omirit nuk kish shkronja gjuha greqishte, pastaj i pru Kadhmua shkronjatë nga Finiku, po Omiri në pleqëri is hi verbërë dhe shëndinte derë më derë, duke kënduara vjershat' e Iliadhës e t'Odhisesë; prandaj njerëzia e dininë së jashtësmi, e Likurgu, mbret i Spartësë, i mblodhi më pastaj. Edhe mëmëdheu i Omirit nuk dihetë mirë, po thonë më tepër se ish nga Smirna. (Fq. 6-7)

Shënim B.P.: Afruar me gjuhën e sotme zyrtare:

Homeri ka shkruar dy vjersha të gjata: nga ato njëra tregon luftën e Trojës dhe titullohet "Iliada", se qytet i Trojës quhej edhe Ilo, prandaj sipas këtij emri e emërtuan këtë vjershë "Iliada". (Fq. 3)

Grekërit e vjetër në kohë të Homerit s'quheshin as grekë as helenë, por danaij, akej, etj. Grekërit e vjetër nuk ishin nga fara e pellasgëve, por ishin, siç thotë Thuqididi, të mbledhur nga Fenikia, nga Egjypti, etj.

(*Shënim B.P.* Këtu të shihet historia e Finiqit shqiptar – a ka lidhje me Fenikinë, Fenikasit)

Falmerajeri thotë se edhe grekërit e sotëm s'janë nga fara e grekërve të vjetër, se fara e atyre është shuar, po janë nga sllavët, vllehët, etj. (Fq. 5)

Iliada tregon, siç thamë, Luftën e Trojës, apo, siç thonë disa, luftërat e bëra në mes të pellasgëve, se gjithë ata kombe ishin nga pellasgët, apo, siç thonë të tjerët, luftërat e përherëshme ndërmjet

Azisë dhe Evropës. Tri herë e kanë shpëtuar nga Azia Evropën shqiptarët: Akileu mundi Trojanët, Aleksandri i Madh persianët, Skënderbeu turqit. (Fq. 6)

Ndërron pakë "Odhiseja" nga "Iliadha", prandaj kanë thënë se vjershëtori i "Odisesë" është tjetër dhe i "Iliadës" është tjetër, por të tjerë thonë që "Iliadën" Homeri e ka bërë në djalëri e "Odisenë" në pleqëri, e nga mosha ka ngjarë ndryshimi. Thonë se Homeri rronte njëmijë vjet përpara Krishtit dhe lufta e Trojës qe bërë dyqint vjet përpara Homerit.

Në kohët të Homerit gjuha greke nuk kish shkronja, pastaj i pru Kadmi shkronjat nga Finiku; por Homeri në pleqëri ish i verbër dhe shetiste derë më derë, duke kënduar vjershat e Iliadës e të Odisesë; prandaj njerëzia e dinin së jashtmi, dhe ishte Likurgu, mbret i Spartës, që i mblodhi më pas. Edhe mëmëdheu i Homerit nuk dihet mirë, po thonë më tepër se ish nga Smirna. (Fq. 6-7)

(*Shënim B.P.* nxjerrë nga Wikipedia)

Likurgu ishte ligjvënësi pothuajse legjendar i Spartës, i cili zbatoi reformën me orientim ushtarak të shoqërisë Spartane në përputhje me Orakullin e Apollonit në Delfi. Të gjitha reformat e tij promovuan tre virtytet spartane: barazinë, aftësinë ushtarake dhe qëndrueshmërinë.

Lindur në Spartë, 800 BC

Vdekur 730 BC

WILHELM OBERMÜLLER

“POPUJT E ALPEVE”

TITANËT, GJIGANTËT, ALBANËT, NAPOLETANËT, KATËT, SKOTËT, SHVABËT, ZVICERANËT DHE TIROLEZËT

Vienë 1874

Përkthyer nga origjinali prej: Albert Gjoka dhe Frida Vokopola

Shtypshkronja “Turdiu”
Tiranë, 2019

Në një rrëpirë të “shkëmbit të kuq”, pranë Mentones, që bie thikë mbi det, në linjën hekurudhore të Ligurias, disa muaj më parë u zbulua nga dr. Riviere një skelet njerëzor i fosilizuar, i cili tërhoqi vëmendjen e paleontologëve dhe studjuesve të historisë së niveleve më të larta. (Fq. III)

Skeleti është i një njeriu jashtëzakonisht trupmadh dhe me ndërtim të bukur, me një zhvillim fizik të plotë. (Fq. V)

Shtati është jashtëzakonisht i madh, pra banori i kësaj shpelle nuk ishte ligur, pasi ajo racë, sipas të gjitha të dhënave të autorëve të lashtë, ishte edhe më trupvogël se ajo e romakëve, e cila nga ana e saj nuk ishte as ajo trupmadhe.

Kësisoj nuk mbetet gjë tjetër veçse të shihen ata që grekët i quanin “gjigantë” dhe “titanë”. Në legjendat poetike, gjigantët

paraqiten si paraardhësit e gegëve të sotëm në Albani dhe titanët si popull arian, të cilët nën udhëheqjen e Kronosit dhe Zeusit, duke u nisur nga Siçilia dhe Kreta, që fillimisht banoheshin nga gjigantët, pushtuan pjesën jugore të Italisë dhe Greqisë, dhe banorët e vjetër, pra, autoktonët e vërtetë, gegët, u detyruan të zmbrapseshin. Ndërkaq ata konsiderohen si albanë deri në ditët e sotme. Banorët e pjesës veriore të vendit, me shtate të tilla të bukura, të gjata e të forta, mbajnë ende sot emrin "gegë" dhe Straboni përmend në librin IV, kapitulli 6 edhe "kuajt gegë" në Liguria. (Fq. VII)

Gegët apo, siç quhen ndryshe, ilirët, (pra banorët e maleve, fjalë e prejardhur nga fjala "lwr", "lur", që do të thotë "mal", "shkëmb"), në kohët më të lashta, pra përpara emigrimit të arëve apo titanëve (nga Media dhe Afrika Lindore) dhe përpara ardhjes së ligurëve të vegjël apo sikulëve (nga jugperëndimi), banonin në të gjitha pjesët malore përqark Adriatikut, sepse ilirë apo gjigantë nuk quheshin në kohët e lashta vetëm epirotët apo shqiptarët e sotëm, por edhe panonët, ... (Fq. VII-VIII)

... Ende sot e kësaj dite albanët flasin një dialekt të pakuptueshëm të titanëve të huaj, i cili, megjithë përzierjen e tij me shumë fjalë greke (pra, titane) dhe latine, nuk mund të konsiderohet si një gjuhë ariane apo indo-gjermanike; ajo është gjuha autoktone e jugut të Europës, pra e pavarur nga gjuha ariane, ashtu si edhe gjuhët e baskëve dhe turqve. (Fq. VIII)

Pasardhësit e gjigantëve të vjetër janë dëshmi e gjallë edhe në zonat malore të Skocisë, në gadishullin e Krimesë, në Kaukaz, në Kanaan dhe në pjesë të veçanta të Azisë së Vogël, sikurse edhe në zonën e Rodit; edhe e tërë Panonia apo Hungaria ishte e sunduar nga një nga popujt e këtij fisi, që këtu u quajtën ilirë. (Fq. 2)

Përpara mbërritjes së Titanëve, gegët banonin ose zotëronin gjithë Greqinë; ata u quajtën atje banorë malesh, "graikoi" ose "grekë", fjalë që rrjedh nga fjala "creagh" ose "kreadh" (që do të thotë "gurë", "shkëmb"), ...; ndryshe nga ata, titanët mbanin një sërë emrash të tjerë, madje marinarët kretezë mbanin emrin "pellazgë"

dhe si ndërtues të kështjellave mbanin emrin "kranaer", sepse atyre iu desh të mbroheshin nga gjigantët nëpërmjet këtyre "kronë-ve" apo "granë-ve", siç kishte bërë edhe stërgjyshi i tyre, Kronos-i, në Siçili dhe Kretë, por pasi i dëbuan gegët plotësisht nga jugu i Greqisë, ku banuan tashmë edhe në fshatra të zgjeruara, pikërisht si në Atikë, ata u quajtën "jonë", fjalë që vjen nga fjala "ion", "iaon" apo "aon" dhe që do të thotë "vendbanim i përbashkët"; ... (Fq. 3)

Pushtimi jonik apo pellazg në Greqi ndodhi vetëm 100 vjet pas shkatërrimit të Trojës, pra, nga vitet 1000 apo 1100 para Krishtit. Ata u thyen atje nga dorët, të cilët nën udhëheqjen e bijve të Herkulit pushtuan pjesën juglindore të Peloponezit dhe u ngushtuan nga Sparta, për shkak të jonëve pellazgë të Atikës, Akaisë në gjirin e Lepantos dhe të Arkadisë, dhe pjesërisht ata u shpërngulën për t'u vendosur në Azinë e Vogël. Më pas nëpërmjet dorëve, "gjigantët" u rikthyen në pjesën më të madhe të territorit të tyre dhe në ato troje albanët kanë epërsi etnike ende sot e kësaj dite, ... (Fq. 4-5)

Pellazgët titanë i përkisnin racës ariane dhe, siç e thamë më lart, përbënë fisin kryesor të jonëve, arkadëve dhe akejve, sikurse edhe në krijimin e Greqisë klasike. Ndërkaq, në periudhën pas rënies së Trojës, lidët vunë në kontroll detin, dhe këta "lidë" apo "tyrrenë" konsiderohen si pellazgë, për më tepër, edhe emri i tyre nuk do të thotë gjë tjetër veçse "lundrimtar", gjë që në kohët e lashta bëri që ata të ngatërroheshin me pellazgët edhe më të hershëm të Kretës. (Fq. 5)

... tusk, pasi tuskët apo lidët erdhën nga Egjipti, ...Ndërsa Herkuli vetë (greku, jo kato-fenikasi) ishte me prejardhje titano-egjiptiane, ... (Fq. 6)

Dinastia e Titanëve ("teidh" është një njeri i egër) jepet nga Atlasi; tek ta mbretëronte Kronosi, ati i Zeusit, i cili ngriti kështjella gjatë sundimit të tij në Libi, Siçili dhe Italinë e poshtme; … (Fq. 7)

Nga këto tregime të moçme libiane del qartë se titanët ishin luftëtarë të fuqishëm, pushtues të gjithë Libisë deri në oqeanin Atlantik, ..., por tani lind pyetja se nga e kanë origjinën këta titanë?

Për këtë kemi gojëdhën e vjetër arabe, e cila tregon se në ato troje nga veriu kish shkuar në fillim një popullsi gjigante dhe e egër dhe bëhet fjalë pikërisht për aditët ("aithead" do të thotë "gjigant"). Në fillim ata u vendosën në Hadramaut, pra, në pjesën jugore të Arabisë, duke dëbuar banorët e hershëm të atyre trojeve apo lëkurëkuqtë, pastaj kaluan përmes Detit të Kuq dhe nën drejtimin e Tearko-s (Tuareg), pushtuan gjithë Afrikën. (Fq. 17)

Kapitulli i mësipërm tregon historinë natyrale, që lidhet me vendosjen e sundimit të titanëve nga Arabia deri në Atlas dhe me dyndjen e tyre më tej në Kretë dhe në pjesën tjetër të Greqisë, pa marrë parasysh të gjitha detajet e "pamundura" që në gojëdhënat libiane mund të jenë dhënë si histori të vërteta, atje ku nuk është e nevoshme për t'u pranuar hollësitë.

Ndërsa ndryshe ndodh me tregimet ku grekët e lidhin lindjen e perëndive dhe heronjve të tyre me këto tradita të vjetra afrikane; në rradhë të parë, në to shihet kudo tendenca për t'i helenizuar titanët dhe për ta vendosur origjinën e tyre në tokë të huaj, edhe pse emigrimi i pellazgëve të ardhur nga deti dhe i helenëve të ardhur nga toka, të cilët ishin të emigruar nga Veriu, nuk ka asnjë dyshim, gjë që çoi atëhere edhe në mbërritjen e perëndive të huaja. Vetëm gegët ose gjigantët mund të shihen si autoktonët e vërtetë të Greqisë; megjithatë, ata u vendosën atje përpara titanëve, mirëpo ne nuk e njohim mitologjinë e gjigantëve, e cila ndoshta duhet të jetë krijuar fillimisht në gojëdhënat e albanëve të Veriut dhe për këtë gjenden shumë shkrime në veprën kryesore të J. G. von Hahn-it.

Një vlerë të veçantë historike kanë pikërisht gojëdhënat kreteze...

Gojëdhëna e Kretës lidhet shumë me atë libiane, ... (Fq. 18-19)

Nëse tregimi i Platonit në librin e tij "Timaios" për kalimin e një ushtrie nga perëndimi drejt Atikës do t'i kushtohej një fakti historik, kështu pra tek ata luftarakë të fuqishëm që erdhën nga Atlasi mund të kuptohen titanët, të cilët larguan nga Atika gegët apo gjigantët, të cilët jetonin atje, sepse ata gegë qëndronin në malet në veri të

Athinës si në kohët e lashta, ashtu edhe sot kur albanët në të gjithë Greqinë përbënin sërish masën e gjerë të popullsisë së vendit, por sidomos atë blegtore. Në tregun e Athinës ende sot e kësaj dite nuk flitet greqisht, por shqip. Në shkrimet e tij Platoni konsideronte ushtrinë e lartpërmendur si atë të pasardhësve të Solonit, por ushtria kishte qenë në Egjipt, gjë që ai e kishte dëgjuar nga goja e një prifti të moshuar. (Fq. 25)

Albanak është banori i Alpeve, fjalë që rrjedh nga fjalët "al", që do të thotë "i lartë", "mal" dhe nga prapashtesa e mbiemrit "ac", e cila në gjermanisht është "ig" apo "isch". Në Peninet (Apeninet) e Italisë, që ndodhen më poshtë Alpeve, fjala "al" është hequr, ndërsa ka mbetur në dialektin shvab "alp" ose "alb", sepse ato janë malet më të larta të vendit. (Fq. 26)

Ndërkaq, me fjalën "epirot" u përcaktuan nga grekët vetëm albanët e jugut apo "toskët", ndërsa albanët e veriut u quajtën "ilir", mirëpo "albanët me ilirët ishin të njëjtë", shkruan Ptolemeu në librin 13. (Fq. 27)

Gjuha e gegëve , ashtu si edhe ajo e toskëve, në themel të saj nuk është gjuhë "ariane", por megjithatë ajo është aq e ndryshuar, saqë vetëm nëpërmjet një ndryshimi fare të vogël do të bënte të mundur krijimin e një identiteti. Kohët e fundit, metoda e zhvendosjes dhe ndryshimit ka shkuar deri në kufirin maksimal të ushtrimit gjuhësor, kështu që në fund të gjitha gjuhët e botës duhet të kenë dalë nga një formë e vetme e lashtë, sigurisht në mënyrë të tillë që nga forma e vjetër nuk na mbetet "as mishi, as kocka" dhe as ndonjë gjurmë, kështu që unë besoj se do të jetë më e kështillueshme që gjuhën shqipe, ashtu si edhe atë baske, ta pranojmë si një gjuhë të lashtë dhe të pavarur, e cila, e përzier me shumë fjalë të gjuhës ariane apo sanskrite, në origjinën e saj ishte autoktone. (Fq. 28)

Në ekstremin jugor të Kaukazit jetonin gjithashtu albanë që nga kohët e "Og-ut", siç tregojnë almanakët irlandezë, të shtypur nga kaldeasit apo babilonasit, përfshirë aty edhe iberët, ... Edhe këta

albanë duhet të kenë qenë nga fisi i gjigantëve, ashtu si albanët e Ilirisë, Napolit dhe Tirolit; ... Sipas Strabonit në librin XI, këta albanë dalloheshin nga bukuria dhe shtatlartësia. ... "Atyre u përket edhe populli i kaspikëve pranë detit Kaspik[3] – i përshkruante ai.

Veç kësaj, në kohën e Strabonit, numri i popujve në Kaukaz dhe trojet përreth ishte aq i shumëllojshëm, saqë numëroheshin 26 gjuhë ose dialekte të ndryshme si në lugina, ashtu edhe në krahina. ... Edhe këtu emri "Albania", pra, "Al-bhein-ia", do të thotë "vend i lartë malor" dhe nga këta albanë rrjedhin gjeorgjianët e sotëm. (Fq. 29)

Albanët vazhdojnë të jetojnë edhe në ditët e sotme nga Atika deri në liqenin e Shkodrës, prandaj gjigantët e zonës së Pallene-s (Shënim B.P.: Pallene - krahinë malore në veri të Athinës) mendohet se janë pikërisht ata që të parët hynë në konflikt me titanët e ardhur nga Kreta dhe nga ky konflikt dhe luftra të tjera me ta u detyruan të largoheshin nga i gjithë bregdeti i Greqisë deri në Athos. (Fq. 31)

..., në këto vende perëndimore, para dyndjes së Umbrëve "gjermanikë" (jo gjermanë apo teutonë), jetonin vetëm popuj ligurë, që ishin të pushtuar nga gjigantë të mëdhenj dhe të fuqishëm, të cilët fillimisht duhet të kenë çuar kuaj në Italinë e sipërme, sepse ende në kohën e Romës ekzistonte një racë gege kuajsh (sipas Strabonit, Libri IV, faqja 16). (Fq. 47)

Me shfaqjen e Tuskëve në Italinë e sipërme, të ardhur nga Lidia dhe Qipro, filloi periudha e pestë për trojet e Alpeve. Ky popull ndërtues dhe trim e detyroi popullsinë italiane umbre të tërhiqej drejt jugut, në malet në pjesën e mesme dhe të sipërme të Teveres, pushtoi vetë luginën e Arnos dhe më pas u zhvendos në Etsch drejt pjesës jugore të luginave të Alpeve ku, si mjeshtra të zotë në

[3] *Shënim i autorit W.O.:* Kohët e fundit është gjetur në një manastir armen një histori e këtyre albanëve nga Moses Katalan-Katowatzi i shekullit të 9të pas Krishtit, e cila është botuar në Moskë.

Shënim B.P.: Sot (Viti 2020) ky libër gjendet i përkthyer dhe botuar në gjuhën shqipe dhe ndodhet pranë Bibliotekës Kombëtare të Republikës së Shqipërisë (Fq. 28-29)

përpunimin e metalit, edhe nëse u romanizuan, u vendosën në luginat e Trompia-s dhe Camonica-s, në pjesën veriore të Brescia-s. Edhe lugina e sotme italiane e Etschit, në veri të Veronës, ishte e banuar nga Tuskët. (Fq. 52)

Në kapitujt e kaluar besoj të kem treguar, që në kohët më të lashta, menjëherë pas së ashtuquajturës"Epoka e Akullit" nga brigjet e detit Egje deri në thellësi të Alpeve ishte përhapur një popullsi ilire, e njëjtë me atë që hyri në Italinë jugore e quajtur me emrin "Enotri". Ky popull njihet në gojëdhënat e heronjve grekë me emrin "gjigantët", ndërsa tek albanët në ditët e sotme me emrin "gegët". (Fq. 52)

Shënim B.P.: Është interesante mënyra e zbërthimit të emrave "Albanë", "Ilirë" "Jonë", "Grekë" dhe "Gegë" nga ana e Wilhelm Obermüller ???

STANISLAO MARCHIANO

“STUDIME FILOLOGJIKE ZHVILLUAR ME GJUHËN PELLAZGO-ALBANE”

Napoli, 1882

Përkthyer nga origjinali prej: Frida Vokopola dhe Albert Gjoka

Gent Grafik
2019

Por ajo që më habiti edhe më shumë ishte fakti që Herodoti kërkonte të kuptonte arsyen (së cilës nuk iu kushtua kurrë ndonjëherë vëmendje) që e kishte shtyrë Homerin tek Iliada t’i quante ata “popuj hyjnorë” (dioi) dhe Platonin në veprën e tij “Cratillo”, ku ai u kërkonte me këmbëngulje shkrimtarëve bashkëkohorë “për të gjetur origjinën e fjalëve greke në gjuhën e “barbarëve”, nga e cila grekët kishin marrë shumë fjalë”.

Këto kontradikta, sigurisht që më linin në shpirt një boshllëk aq të madh saqë unë i bëja pyetjen vetes: nëse pellazgët ishin popuj të parëndësishëm, përse duhet t’i quanin ata “hyjnorë”? Dhe nëse gjuha e tyre është një gjuhë “barbare”, përse duhej kërkuar origjina e fjalëve greke në këtë gjuhë të varfër barbare? (Fq. 3-4)

... kuptova shumë shpejt se fjala “pellazg” kërkonte gjithë vëmendjen time, sepse ajo ishte pika kryesore nga e cila duhej të fillohej për të vendosur:

1. Nëse kishte ekzistuar me të vërtetë në Europë dhe jashtë saj një komb i quajtur "pellazg"

2. Që të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme periudha e ekzistencës së këtyre popujve

3. Që të përcaktohet natyra e gjuhës së tyre

...

Pasi u tregua me fakte dhe kundër fakte se fjala "pellazg" është fjalë e pasurisë së gjuhës shqipe, që do të thotë "paraardhës, i lashtë, i vjetër" (kësisoj albanët për të treguar "kohën e lashtë" thonë "plasku mott" dhe për të treguar "vitin e lashtë" thonë "plasku vitt") dhe i lumtur për këtë rezultat të kënaqshëm, kuptova se nuk bëhej më fjalë për një dialekt, siç donin ta përcaktonin në mënyrë të shkujdesur gjuhën shqipe, por për një gjuhë nënë dhe primitive, që u ofron thesarë të panumërt shkencës së gjuhësisë dhe etimologjisë. (Fq. 4)

Pastaj i përqëndrova studimet e mia në origjinën e albanëve, e cila përkonte me atë të pellazgëve, e mbështjellë në terrin e shekujve, për të cilën si studiuesit e lashtë, ashtu edhe ata modernë kanë mbajtur një heshtje kaq të thellë. (Fq. 5)

..., duke kërkuar në faqet e kësaj apo asaj historie, arrita të mblidhja të dhëna e të kuptoja se populli i madh i quajtur fisi Japhet , ardhur nga trojet e pafundme të Kaukazit[1], i konsideruar me vendim hyjnor si djepi i njerëzimit dhe që u vendos në zonat e Europës, nuk ishte veçse populli pellazgo-alban. (Fq. 6)

Sipas Homerit, Thraka, Beotia, Thesalia, Maqedonia dhe Epiri kanë qenë pellazge. (Fq. 13)

Gjuha pellazgo-albane, edhe pse primitive, u bindet gjithnjë të njëjtave rregulla si të gjitha gjuhët e botës dhe ka të njëjtat marrëdhënie, që kanë edhe gjuhët e tjera. Nëpërmjet studimeve

---

Shënim F.V.&A.GJ.: Në faqen 6 autori shkruan për albanët e Azisë së Vogël të zonës së Kaukazit, ku mali i Kaukazit quhej edhe mali Alban. (shih Shënime të përkthyesve, Fq. 258)

tona për çështjet orientale të studiuesve të vjetër dhe në dritën e traditave më të hershme, kemi zbuluar dhe mësuar se banorët e parë të rajonit të Kaukazit, Jonit aziatik dhe Frigisë, nuk ishin veçse të ashtuquajturit pellazgo-albanë dhe pellazgo-albanë ishin edhe ata popuj, që shumë shekuj para luftës së Trojës u larguan nga Azia dhe emigruan në troje të ndryshme të Europës, siç tregohet nga vetë Homeri tek Iliada.

Pas mijëra vjetësh pa një qartësi historike, kush mund të thotë me siguri nëse këta popuj janë vendosur vetëm në trojet e treguara nga Homeri, Herodoti dhe Straboni apo kanë pushtuar të gjithë Europën. Por mund të thuhet pa mëdyshje se nuk ka as më të voglin dyshim se gjurmët e gjuhës pellazgo-albane gjenden në të gjitha gjuhët europiane, gjë që është një fakt më shumë, që na bën të besojmë, se gjuha pellazgo-albane është gjuha e parë që është folur në Europë dhe se vetëm më pas ajo u nda në shumë degë të tjera. (Fq. 16-17)

Përpara se të dalim në përfundimin se gjuha shqipe ishte me të vërtetë gjuha e pellazgëve dhe përpara se të flasim për shënjat dhe shkronjat e gjuhës së tyre, është e nevojshme të shohim nëpërmjet historisë nëse ky popull zotëronte një shkrim përpara pushtimit fenikas dhe çfarë shkrimi kishte konkretisht, si edhe nëse Kadmi apo të tjerët me të vërtetë i kanë shpikur shkronjat e reja apo thjesht kanë ndryshuar ato ekzistuese.

Në mbështetje të mendimit tonë, abati Banier shkruan në Mitologjinë e tij si vijon: "Bochart dhe Vossio kanë provuar në mënyrë të sigurtë se alfabeti i sjellë nga Kadmi në Greqi ishte alfabet fenikas, ndërsa ai që kanë përdorur grekët më përpara ishte alfabeti pellazg dhe nga këto dy gjuhë u formua një e vetme. (Fq. 20)

Po në ç'mënyrë u zhduk shkrimi pellazg dhe si është e mundur që nuk është arritur të njihet asnjë shkronjë e tij? (Fq. 21)

Por edhe nëse pranojmë hipotezën se janë pikërisht ata (*Shënim B.P.:* Kadmi me fenikasit) që kanë shpikur gjashtëmbëdhjetë shkronjat, siç thuhet pa një bazë të thelluar, duhet theksuar se

nuk janë ata, që kanë shpikur zanoret dhe sidomos një zanore të veçantë të albanëve, që i përgjigjet tingullit të zanoreve italiane "e" dhe "o" = ë, e cila nuk mund të mësohet ndryshe përveçse duke dëgjuar mësuesin. (Fq. 21)

Shënim B.P.: Të kihet parasysh që edhe në gjuhën Armene germa "ë" ka përdorim shumë të gjerë e të veçantë!

Dëshmitë e Homerit, Herodotit, Tukididit, Strabonit dhe shkrimtarëve dhe studiuesve të tjerë të njohur të Antikitetit klasik na bindin plotësisht për ekzistencën e pellasgëve në Azi dhe Europë, por ata nuk kanë thënë asgjë për albanët e Azisë dhe të Europës, gjë që na çon në skepticizëm. Sipas mendimit tonë, arsyeja e heshtjes së tyre është e thjeshtë për t'u kuptuar. Në fakt, që nga koha e Homerit deri në ditët e sotme kanë kaluar gati tre mijë vjet dhe fenikasit, të cilët e zëvendësuan emrin "alban" me atë "pellazg", e pushtuan më vonë gadishullin helenik, pra, si rrjedhojë, ne mund të nxjerrim përfundimin se ndoshta mijëra vjet përpara Homerit, si legjendat ashtu edhe lajmet popullore ishin të njëjta me ato të kohëve të sotme. ... as Homeri dhe asnjë nga shkrimtarët dhe studiuesit e lartpërmendur nuk u përpoq të thoshte diçka mbi origjinën e albanëve, të cilët që atëhere humbën emrin e tyre kombëtar dhe u emërtuan me emër tjetër, të çuditshëm dhe të palogjikshëm, me emrin "pellazg". Për rrjedhojë, as në periudhën historike, as në atë poetike dhe gjeografike, nuk u bë e mundur të përcaktohej edhe me afërsi periudha e origjinës së atyre popujve dhe kjo është arsyeja pse Homeri, Herodoti dhe Straboni kanë heshtur dhe prandaj ne do të përpiqemi të hedhim dritë nëpërmjet studimeve tona.

Fjala "pellazg", të cilën më pas do ta analizojmë më mirë, në gjuhën shqipe do të thotë "paraardhës, të vjetër, të lashtë" dhe jo "komb", siç kanë dashur ta tregojnë; kësisoj, në gjuhën e tyre "qytetit të vjetër" albanët i thonë "plaska ghòor", "udhës së vjetër" i thonë "plaska ùudh", "atit të vjetër" i thonë "plaska ati" (ose tàt), "përrallës së vjetër" i thonë "plaska prràlesz". ... Faktin që tezat tona bazohen në

të vërtetën, e vërteton edhe historia e grekëve antikë dhe modernë, ku tregohet se në kohët e lashta, Heladha është quajtur Pelazgia, vendi antik i cili, pas pushtimit nga Kadmi u pagëzua me emrin e ri të Heladhës. (Fq. 24-25-26)

Sipas dëshmive të Herodotit, historianit të madh të lartpërmendur, dy qytetet e famshme, Athina dhe Sparta, u themeluan dhe banoheshin nga pellazgo-albanët, nga gjuha e të cilëve morën edhe emrat. Pas pushtimit nga Kadmi, Athina u bë fenikase, ndërsa trojet përreth mbetën pellazge dhe u quajtën "Joni". ... Pra, lufta midis spartanëve dhe athinasve gabimisht quhet luftë civile apo luftë vëllavrasëse, lufta e një populli që flet të njëjtën gjuhë, që ka të njëjtën origjinë dhe të njëjtat tradita. Ishin popujt semitë, që duke pushtuar tokat e banuara nga popull japhet, kërkonin ta shkatërronin pjesën tjetër, ... (Fq. 28-29)

Pa asnjë diskutim, ne ua lemë historianëve dhe gjuhëtarëve të mëdhenj të drejtën për të gjykuar nëse grekët e racës fenikase mund të kenë të drejtën për t'u quajtur heraklidë ose milesë, pasi u hoqën emrin, atdheun, shkrimin apo alfabetin, shkencat dhe artet atyre popujve fatkeqë, por të lavdishëm albanë, të konsideruar përgjithësisht si qeniet më të padenja, të egra dhe barbare të botës. (Fq. 41)

Banorët e parë të Elladës, thotë Paskida (Shënim B.P.: shkrim i vitit 1879, në Athinë, nga Th.A.Paskida – profesor dhe deputet helen), janë pasardhësit e Japhetit ose Giapetit, të cilët quheshin ndryshe pellazgë apo fisi Japetonid sipas Pindarit, Hesiodit dhe vetë Homerit të pavdekshëm. Ata zbritën nga troje të Azisë, kryesisht nga Kaukazi, ku ekziston një zonë e gjerë e shtrirë e quajtur Albani dhe një kalim apo grykë e quajtur "porta albane" dhe emri Albania rrjedh nga emri "Alvi/Albi" ose "Alpi", që do të thotë "male të bardha", i cili është emri kombëtar i Albanëve. (Fq. 43)

... Mund të pohojmë me siguri se gjuha pellazge është folur në Europë shumë kohë përpara pushtimit fenikas dhe shumë kohë përpara gjuhës greke, së cilës i huazoi shkronjat dhe tingujt, duke

bërë kështu që ajo të pasurohej e të përhapej më shumë. Gjuha pellazgo-albane u quajt barbare sepse, sipas Kadmejve, çfarë nuk ishte greke, ishte barbare dhe barbarë u konsideruan pellazgo-albanët e varfër. (Fq. 44)

Gjuha shqipe, siç e kemi treguar duke u bazuar tek studiuesit e mëdhenj seriozë dhe siç do të mund ta tregojmë sërish gjatë këtij studimi, është thjesht gjuha e të ashtuquajturve pellazgë. Ajo është shumë e lashtë, është primitive, është autonome dhe nuk rrjedh nga gjuhë të tjera. (Fq. 45)

Miti i Erebusit është njëri ndër mitet më të vjetra pellazge. Sipas mendimit të Hesiodit, Erebusi ishte i biri i Kaosit. Për albanët e lashtë apo pellazgo-albanët, Erebusi ishte një pjesë e errët e ferrit. Sipas Servios, ishte pikërisht ajo pjesë e ferrit ku gjendeshin hijet, të cilat nuk jetonin në kushte të mira, ndryshe nga "Campi Elisi", atje ku qëndronin vetëm shpirtrat, që ishin pastruar nga mëkatet. Disa studiues e përcaktuan atë gabimisht si fjalë fenikase. "Erebo" është një fjalë e prejardhur nga gjuha shqipe dhe do të thotë "errësirë", "terr". "Është errësirë" në gjuhën shqipe thuhet: "Ësct gnë erbrsii pissie" (bërë zi pis), ndërsa "Është natë e errët" thuhet ""Ëë nat e èrbur". (Fq. 50)

Edhe fenikasit, për shembull, një popull më i vonshëm se pellazgo-albanët, siç pohohet edhe nga vetë historianët, emigruan në territorin helen dhe tanimë dihet gjithashtu me siguri se ata gjetën atje një racë tjetër popujsh të ndryshëm nga ata si nga gjuha, ashtu edhe nga karakteri, por të famshëm në vende të ndryshme të Europës. ….

Micheleti i famshëm, i cili e ka trajtuar gjithashtu çështjen e pellazgëve, ka plotësisht të njëjtin mendim me ne, paçka se në pjesë të ndryshme të veprës së tij, edhe ai bën të njëjtin gabim që, siç është theksuar, e ka origjinën tek armiqësia dhe urrejtja e dy popujve të ndryshëm, pra, e fenikasve kundër pellazgo-albanëve dhe pikërisht kjo është arsyeja pse Sparta, e cila ishte tërësisht albane, shpeshherë u shkatërrua deri në themele nga Athinasit, të cilët u kthyen pothuajse në popullsi fenikase. (Fq. 71-72)

Është i pakundërshtueshëm fakti që pellazgo-albanët ishin banorët e parë të Maqedonisë, Epirit, Albanisë, Thesalisë, Beotisë, Atikës, Bosnjës, Hercegovinës, Bullgarisë, etj.. Mjafton të përmendim edhe dëshminë e Herodotit, sipas të cilit një numër i madh pellazgo-albanësh, pas pushtimit nga Kadmi, u shndrruan duke bërë pakt me fenikasit dhe që atëhere filloi dallimi midis dorëve dhe jonëve. (Fq. 79)

Nuk na habit aspak fakti sesi albanët e Kaukazit apo banorët e Alpeve të bardha të Kaukazit në periudhat parahistorike humbën emrin e tyre kombëtar dhe në vend të tij morën emrin "pellazgë", sepse popujt fenikas me origjinë semite, të bashkuar me popuj me gjak të njëjtë të periudhës së hershme historike, ... (Fq. 81)

Pa dyshim që fjala "βεκκος" (beckos, veckos) vjen nga gjuha shqipe dhe do të thotë "bukë" dhe kështu me të drejtë, dijetarët egjiptianë mbështetën përpara mbretit Psametik idenë se gjuha frige ishte më e vjetër se ajo egjiptiane. (Fq. 106)

Ndër neoterikët nuk mungojnë edhe ata, të cilët, duke kërkuar për ta nxjerrë shumicën e gjuhëve europiane nga gjuha kelte, mbështesin idenë se ishin keltët banorët e parë të zonave të ndryshme të Europës, pa i dhënë rëndësi origjinës së tyre dhe faktit se përpara keltëve në Europë kishte pasur popuj të tjerë të ndryshëm apo të afërt me ta për nga natyra, karakteri dhe gjuha. (Fq. 110)

Duke u treguar pasardhësve të tyre të rinj dhe të huajve fenikas gojëdhënat historike të stërgjyshërve të tyre, është e natyrshme që albanët e lashtë të kenë përdorur fjalën e tyre "plasgh" ose "pliasgh", sot "pellazg", që në gjuhën shqipe do të thotë "të lashtët", "paraardhësit", "stërgjyshërit" dhe prandaj ata kanë përsëritur shpeherë në tregimet e tyre: "Pellazgët tanë, pra, të lashtët tanë, ..." (Fq. 113)

... Ka të ngjarë që kadmejtë, çekropidët dhe inikadët, ..., e përdorën emrin "pellazg" për albanët e lashtë dhe duke u përcjellë nga goja në gojë dhe nga një pasardhës tek tjetri, emri u bë i njohur në popullatën dhe gjuhën e re, e cila lindi nga bashkimi i gjuhës shqipe me atë fenikase, gjuhë që më vonë u quajt gjuha greke. ...

Duhet thënë gjithashtu se asnjë autor i vjetër nuk ka përmendur një komb pellazg në Azi dhe ata që kanë shkruar për pellazgët dhe ua vënë këtë emër popujve të Azisë, janë të gjithë autorë që i përkasin periudhës pas pushtimeve të Kadmit në Europë.

Gjithashtu, nuk mund të shpjegohen fjalët e Homerit tek Iliada, pra, që "pellazgët e Europës u përballën në luftën e Trojës me pellazgët e Azisë", ndërkohë që as në Azi dhe as në Europë, në asnjë kohë nuk ka pasur një komb, një mbretëri apo perandori të quajtur pellazgji, popujt e së cilës të jenë quajtur pellazgë, njëlloj si popujt e Rusisë janë quajtur rusë, të Francës janë quajtur francezë, ... (Fq. 114)

Herodoti, midis historianëve të parë të lashtë që, sipas thënies së tij, jetoi me pellazgët, të cilët ai i përcaktoi si bashkëkohësit e tij, nuk tregoi se cilët ishin dhe çfarë gjuhe flisnin, por vetëm mundi të thoshte se pellazgët ishin një popull barbar dhe gjuha e tyre ishte gjithashtu barbare, pa shpjeguar pse e përcaktonte këtë popull si të tillë, ... (Fq. 115)

Në veprën e tij "La Lucania", historiani Giuseppe Antonini thekson se popujt e parë, të cilët erdhën së bashku me grekun Enotri në vendin e quajtur sot Lucania rreth 567 vjet përpara luftës së Trojës dhe më shumë se njëmijë vjet përpara Romës dhe themeluan Posidonian pranë Pestos, Elean, Velian, Vietrin, Reggion dhe shumë qytete të tjera, quheshin "enotrë", "arkadë" ose "popuj pellazgë". (Fq. 116)

Autorët e Enciklopedisë popullore italiane, që natyrisht janë të famshëm, mbështesin idenë se beotët e parë janë me origjinë pellazgo-albane aziatike dhe një pohim të tillë e nxorrën nga Straboni, libri IX, faqe 401, nga Pausanias, Libri IX, faqe 5 dhe nga Licifroni vargjet 644, 68, 1209: pra, sipas mendimit të tyre, pellazgët ishin thrakët apo trausët. Shkrimtarët e sipërpërmendur thonë: "Të ardhur nga Thraka aziatike, pellazgët u vendosën në brigjet e detit Egje dhe themeluan fshatra, qytete dhe kështjella në atë zonë të Greqisë, që ende sot e kësaj dite quhet Thrakë, nga gjuha e të cilëve historia nuk ruan as edhe fjalët më të përdorshme". Pra, cilët do të

kishin pasur kaq shumë pasion dhe kaq shumë interes për t'i dhënë emrin e Thrakës një zone të re të Europës përveç të njëjtëve popuj që kishin braktisur Thrakën tjetër në Azi? (Fq. 117)

Në librin e tij "Napoli 1860", ku trajton historinë antike, shkrimtari i njohur Della Mura, duke trajtuar çështjen e pellazgëve, shkruan si vijon: "Pasardhësit e Javanit ose Jonit, birit të Jafetit, padronit të Europës, jetuan si të egër dhe morën emrin "pellazgë". Sipas opinionit të Della Murrës, duket se fjala "pellazgë" do të thotë "i egër". ... Ai shkruan më tej: "Njeri nga mbretërit, të cilit i bindeshin pellazgët, quhej Greka, dhe vendbanimet e pellazgëve të quajtura "toka e Javanit", nga ai morën emrin Grecia". Sipas këtij mendimi të Della Murras, në venat e grekëve rrjedh gjak pellazgo-alban, paraardhësve direktë të grekëve, të cilët më vonë u quajtën helenë, akej, lakedemonë, athinas, etj. Shihet qartë se Della Mura e trajtoi këtë temë kaq delikate në mënyrë sipërfaqësore. (Fq. 118)

Shkrimtari i kohëve të fundit V. Duruy, në librin e tij "Historia Greke", shkruan se populli pellazg ishte njëri ndër popujt e parë të Greqisë dhe se ai nuk paraqitet si një komb i vetëm dhe i madh, por i ndryshëm në fise të shumta që formojnë grupe kryesore. Dhe ai shkruan tekstualisht këto fjalë: "Thrakët, ilirët dhe pellazgo-helenët," siç shkruan Von Hahn në "Albanische Studien" në vitin 1854 – " të cilët janë të vendosur në këto zona, duket në fakt se kanë pasur lidhje të ngushta në origjinën e tyre. Nëpër legjenda ata shpesh konsiderohen aziatikë. Fiset që populluan ekstremin jugor të gadishullit grek, janë njohur me emrat e famshëm të pellazgëve dhe helenëve. Helenët tregonin me emërtimin "pellazgë" popujt që ishin vendosur përpara tyre në territorin e Greqisë, por ata përdornin emra të veçantë për secilin prej tyre, si kaukonë, lapitë, flekë, aonë dhe jontë" dhe ai përfundon se "ata ishin kolonë pellazgë aziatikë". (Fq. 119)

Cesare Cantu, princi i historisë italiane, ... shkruan:" Javani, biri i katërt i Jafetit, populloi ishujt pranë bregut perëndimor të Azisë

së Vogël, nga ku pasardhësit u shpërndanë nëpër Europë. Kjo racë jafete u shpërnda në Veri dhe u vendos në zonën e Kaukazit, ku sot ndodhen Gjeorgjia, Çirkasia, Mingrelia dhe Avogasia ose Abasia." Këto katër zona, siç siguron Straboni, formonin dikur Albaninë e lashtë, gjë që e kemi thënë më parë edhe ne, dhe na habit fakti se si Cantuja nuk ka bërë asnjë shënim për këto zona. Kjo tregon se për të albanët ishin popuj ose me pak rëndësi, ose pa asnjë rëndësi apo ata ishin të ashtuquajturit pellazgë dhe ai ka të njëjtin mendim me ne duke i konsideruar ata si albanë, dhe ... (Fq. 121)

Pas këtyre fakteve të shkurtra që hedhin dritë mbi çështjen problematike të origjinës së pellazgëve, përsërisim këtu thënien e historiografit të nderuar Cantu, sipas të cilit, asaj zone të pafundme të Azisë Zoti i kishte bërë dhuratën që ajo të ishte djepi i njerëzimit dhe popujt e asaj zone aq të rëndësishme, që ishin albanët ose pellazgo-albanët, pasardhësit e Jafetit, erdhën për të banuar në Europën tonë. Në faqen 417, volumi i parë i Historisë Universale, Cantu shkruan: " Pellazgët ishin shumë më të hershëm se grekët e lashtë dhe përbënin një racë legjendare si Titanët dhe Ciklopët. Historia e tyre na u përcoll vetëm nga pushtuesit e tyre, të cilët ishin tepër barbarë për të na dhënë hollësi, kështu që pellazgët mbeten si një sfond i errët dhe i sfumuar i gojëdhënave klasike". Dhe gjetkë ai shkruan: "Por më shumë duken si një degë e familjes së madhe Kaukaze, si ajo indo-perse, kaldea siriake dhe gjermanike, e shpërndarë në pjesën më të madhe të Azisë së Vogël (Larisa, Kuma, etj), në ishujt e arqipelagut (Lemnos, Imbros, Samos, Kretë, Euboea), në gjithë Greqinë dhe në një pjesë të Italisë. (Fq. 124)

Shënim B.P.: po aty, pak më poshtë vazhdon të citohet Cantuja: "Mendojmë se rreth vitit 1900 para Krishtit pellazgët banonin në trojet që shtrihen nga lumi Arno deri në ngushticën e Bosforit. …" (Fq. 125)

Tashmë pellazgët, siç e kemi përsëritur shpeshherë, janë popuj të grupit jafet, ndërsa kadmejtë ose fenikasit të grupit semit ose aramaik, pra, ata janë popuj të ndryshëm, të huaj nga njeri-tjetri. Nga bashkimi i pellazgëve apo popujve të vjetër (që ishin albanët)

me kadmejtë apo fenikasit dolën athinasit, më pas helenët dhe pastaj grekët, që me të drejtë mund të konsiderohen si degë apo pasardhës të pellazgëve. Por as Bertolini, as shoqata e studiuesve të Historisë së përgjithshme të Italisë dhe as autorët e përmendur atje, si Niebur, Grote, Müller dhe Duncker, nuk janë përpjekur të qartësojnë terrin që ekziston rreth pellazgëve, për të përcaktuar se cilët ishin ata, cila ishte natyra dhe gjuha e tyre dhe sidomos për të treguar se cilit grup të njerëzimit i përkisnin. (Fq. 133)

Popujt jafetë të Kaukazit, të cilët, sipas nesh, janë thjesht pellazgo-albanë, ... (Fq. 136)

EDUARD SHNAIDER (SCHNEIDER)

"PELLAZGËT E PASARDHËSIT E TYRE"

Përkthyer e paraqitur nga Lek Pervizi
Botuar nga I.H.P.V.K.A
Tiranë, 2009

Botuar për herë të parë: Kostantinopojë, Dhjetor 1893

Shënim B.P.: Në parathënien e këtij libri, të shkruar nga Lek Pervizi, ky i fundit thekson:

Autori (Eduard Shnaider) mbështetet mbi banorët e Mirditës, sepse autori i konsideron ata si trashëguesit më të afërt të Pellazgëve. Sipas tij, për kohën që ai jetoi në mes tyre para 130 vjetësh, kur e gjithë Shqipëria ndodhej nën sundimin Turk, në errësirën e injorancës, pa asnjë frymëmarrje qytetërimi, mirditorët kishin mundur t'i mbajnë zakonet e gjuhën siç kishin qenë para mija vjetëve, atje midis maleve të tyre, me pak ndryshime në veshje e në disa forma banesash ma të përshtatëshme se shpellat. Invadimet e hueja u kishin shkuar për rrëzë. Dihet historikisht nga historiani Tit Livi, se kur Romakët pushtuan gjithë Ilirinë, nga deti Adriatik deri në lumin Danub, pra gjithë Ballkanin, *e vetmja krahinë e papushtuar kishte mbetur ajo e Pirustëve, pra Mirdita.* (fq. 12)

Shënim B.P.: Këtu e më poshtë i përket shkrimeve të Eduard Shnaider.

Pellasgët, thotë Paul Guerin, banorët primitivë të Italisë dhe Greqisë, duket se kanë ardhur nga Lindja dhe i përkasin racës Indo-Europiane. Duke ardhur nga Danubi, një pjesë e kaloi lumin dhe hyri në gadishullin Ballkanik; të tjerët u ngjitën përgjatë lumit Sava dhe mbërritën në Itali. Prej atje dy degë të Pellasgëve kaluan, ajo lindorja në Greqi dhe tjetra perëndimorja në gadishullin Italian. Përafërsisht është rreth vitit 2 000 para Krishtit që Pellasgët arritën në Danub[1]. Kështu, me dy fjalë, na shpjegohet emigrimi i këtij populli të madh, ose të këtyre *barbarëve (të huajve),* për të cilët na flet Herodoti, babai i historisë, që jetoi në shekullin e katërt para Krishtit, dhe prej të cilëve, sipas tij, sikur do ta shikojmë, e kishin zanafillën Helenët.

Duke e kërkuar etimologjinë e fjalës Pellasg, ne e shikojmë se me këtë emër Grekët përcaktonin *banorët e largët të detit*[2]*.* Shqiptarët në gjuhën e tyre e përkthejnë atë fjalë me, *banorët e pyllit,* nga *Pell* për *pyll* dhe *gjin* për *njerëz (gjind).*

Pellasgët, pra, na ishin *Pyllgjin,* nga ku, Pellasgët, *banorë të pyjeve,* d.m.th., njeriu që i parapriu banorët e shpellave, Trogloditët. (fq. 37-38).

Shënim B.P.: Duke analizuar një kushtim gjetur në Kretë, autori (Eduard Shnaider) shkruan:

Mbishkrim kushtimi gjetur në Kretë në alfabetin kretez-pellasgjik, poshtë shkrimi shqip që i përgjigjet fjalisë. Çdo shqiptar

---

[1] *Shënim E. Shnaider:* Teoria e jonë është e kundërt. Pellasgët mbetën si populli më i vjetër autokton e proto-europian, që u dukën së pari në Europën perëndimore: Francë, Gjermani, Spanjë, dhe zbritën poshtë në epokën e akullnajave, në vende më të ngrohta: Itali, Ballkan, Arçipelag Azi e Vogël, Mesopotami dhe në gjithë pellgun mesdhetar. Kurse termi "barbar" që përdor autori, duhet kuptuar për "i huaj" dhe jo "i egër". Helenët, "barbarë" quanin "të huajt".

[2] *Shënim E. Shnaider:* Pellasgët, të quajtur nga helenët Pelasgoi, Pelagoi, Pelargoi, lidhen me etimologjinë Shqipe, "prej detit" (pellg), "prej së largu", emër që nuk ka lidhje fare me gjuhën Greke.

është në gjëndje me ja nxjerrë vetë kuptimin. Ne do ta japim në Shqipen e tashme.

"Pas mrekullisë nga ana e virgjëreshës që e shpëtoi Arkian, Arkakoklesi (i shoqi) i ban dhuratë *Anaisit* (hyjneshës.)" (përkthyesi) (fq. 149)

Emigrimi i Pellasgëve drejt Lindjes ka ndodhur për shkak të zbritjes së akullnajave në Europën veriore (10 000 vjet para Krishtit). Pastaj janë rikthyer përsëri në Europë, me emrin Arianë, sepse në rrëzë të Kaukazit në veri të Persisë ishte zhvilluar një qytetërim Arian-Pellasgjik. Ky rikthim është konsideruar si i një populli Indo-Europian, teori që po bie poshtë, sepse janë pikërisht Pellasgët, që u rikthyen në trojet e vjetra të tyre, pas tërheqjes së akullnajave, gjë që shkaktoi edhe përhapjen e gjuhës së tyre fillestare. (Shënimi në fund të fq. 162)

Sido që të jetë, pa i pranuar faktet (që të mos tregohemi autoritarë) ne besojmë si Helenët, se të parët e tyre ishin Pellasgë autoktonë dhe se këta i krijuan racat që mund të quheshin Pellasgo-ariane ose Kopto-pellasgjike. Të parët përfaqësoheshin nga disa popuj, si Helenët e Latinët, gjuha e të cilëve është ruajtur në rrënjët e gjuhës-nënë pellasgjike.

Të dytët, si Egjiptianët dhe Arabët, që nuk ruajnë prej kohësh gjurmët e asaj gjuhe, e shohin gjuhën e tyre të ngjitet pas rrënjëve të gjuhës-nënë semitike. (fq. 164)

Fonetika e vërtetë e Shqipes duhet kërkuar në Shqipërinë e veriut tek Gegët. (fq. 194)

SIR PATRICK COLQUHOUN & VASO PASHA

“PELLAZGËT. PASARDHËSIT E TYRE TË SOTËM DHE ORIGJINA PELLAZGE E POEMAVE TË HOMERIT”

Botime Artini
Prishtinë 2017

Botuar për herë të parë nga: Instituti i Universitetit Oriental, Woking, 1894

Të vërtetosh me saktësi bindëse se cilët ishin Pellazgët, që kanë ekzistuar historikisht 4000 vjet para erës sonë, në pamje të parë duket si një detyrë e pashpresë, aq më tepër kur edhe ato gjurmë që ekzistojnë, në rastin më të mirë jo vetëm që mbështeten në themelet e pasigurta të legjendave, por edhe janë shfytyruar nga poezia dhe shtrembëruar nga mitet.

Për këtë arësye, çdo studim i këtij lloji nuk ka se si të mos jetë hamendësues deri në njëfarë mase dhe, si i tillë, do të duhet t’i kërkojë ndihmë analogjisë: ... (fq. 12)

Po të mos kishte qenë për shkrimet në monumentet e Egjiptit, nuk do të kishim pasur asnjë të dhënë për historinë e hershme të Pellazgëve; dhe gabimet e mëdha të studjuesve të Grekëve të lashtë nuk do të ishin zbuluar kurrë. E vetmja gjë, për të cilën mund të bëheshin hamendje, do të ishte se ka ekzistuar një racë Ariane e antikitetit shumë të lashtë, që vinte nga “djepi” i kombeve, qoftë në

se ky ishte në malet Urale, siç thotë Red'house, prej nga udhëtuan drejt lindjes dhe perëndimit nëpërmjet Kaspikut, apo në rrafshnaltën e lartë të Indisë, siç është pranuar gjerësisht deri më sot. (fq. 13)

Teoria, që pranohet më gjerësisht nga etnologët e sotëm, *e nxjerr prejardhjen e fisit të Pellazgëve,* përveç qendrës së tyre më të lashtë, *nga zona malore e Armenisë:* ajo pjesë që del në detin Kaspik dhe kufizohet nga Kaukazi, sot Dagestani (banesë e maleve) dhe Shirvani, *"Shqipëria e hershme"*[1]. (fq. 33)

Në gjuhën Galike malësorët quhen Albanaich, kurse Kaledonianët quhen Albanian ose Forrester (njerëz të pyllit). ... Po kështu emri "Pellazg" duket se ka qenë emërtimi Grek për Shqiptarët. Janë sugjeruar shumë prejardhje: por ndonëse këto kanë baza në Greqishte, nuk kanë asnjë bazë në Shqipe. Në fakt, nuk ka asnjë bazë të arsyeshme në Greqishte. Fjala mund të jetë ndoshta një version i korruptuar i *Palesta.* Por nëqoftëse do të kërkohet ndonjë prejardhje nga Greqishtja, ka shumë të ngjarë që kjo të jetë fjala Πελασ – *fqinjë;* dhe ky emërtim daton që nga krijimi i kolonive të një race tjetër (për të cilat, megjithatë, nuk ka asnjë gjurmë) në Pellazgji. (fq. 59)

Prejardhja e fjalës duhet të kërkohet ndoshta në ndonjë fjalë të përafërt Sanskrite. (fq. 60)

Gjuha Shqipe, pra, nuk duhet interpretuar përmes Greqishtes, por përmes Sanskritishtes[2]. (fq. 65)

Shqiptari dallohet qartë edhe nga pamja fizike, sepse etnologjikisht rrjedh nga racat Shemitike[3]. (fq. 72)

Pra rrjedh që:

1. I gjithë gadishulli i Azisë së Vogël ishte pushtuar dhe banuar nga një racë Pellazge, e cila zëvendësoi ose çrrënjosi popullatën e mëparshme ose u përzie me të duke i marrë femrat e tyre si gra dhe konkubina – dhe nga kjo e folmja e të ardhurve u korruptua dhe u krijua një gjuhë e re;

---

[1] *Shënim B.P.:* Mendoj se me emërtimin "Shqipëria e hershme" përkthyesi apo ndoshta vetë autori ka pasur ndërmend vendin e quajtur në kohët e hershme "Albania e Kaukazit"

2. Një fis tjetër, i të njëjtës racë Pellazge, kaloi Hellespontin dhe erdhi në Trakë, dhe pastaj vazhdoi më tej përmes Maqedonisë për në Iliri, duke e shpronësuar racën e mëparshme, ndoshta me origjinë Iberike, Turanike ose Ariane greqisht – folëse, dhe duke pushtuar më në fund të gjithë vendin dhe ishujt në jug, pra Peloponezin dhe ishujt ngjitur të Arkipelagut;
3. Në një periudhë të mëtejshme ata kaluan lumin Po, kolonizuan Toskanën, ose Etrurinë, dhe depërtuan në drejtim të jugut, dhe u ndoqën dhe u shtynë më tej nga Tirrenianët e së njëjtës racë;

...

9. Raca Greke nuk u dynd në numër të madh në zonën Pellazge, por ishin vendosur atje përpara Pellazgëve[4]; ata i kishin paraprirë Fenikasve si tregtarë, duke përhapur gjuhën e tyre si gjuhë të qytetërimit dhe tregtisë; dhe më në fund grekëzuan një pjesë të madhe të banorëve, sidomos në Peloponez dhe Atikë;
10. Ata që e rrethuan Trojën, ashtu si edhe vetë Trojanët, ishin Pellazgë që më vonë u kthyen në një racë Greqisht – folëse;
11. Pellazgët, që nga ajo kohë kanë qëndruar në mënyrë të pandërprerë në zonën ku u vendosën në fillim;
12. Ata arritën kulmin e fuqisë së tyre nën Aleksandrin e madh; (fq. 104, 105, 106)

Vaso Pasha ka vënë në dukje me shumë mençuri se është e vështirë të supozohet që, nga njera anë, një popull kaq barbar si ai që përshkruhet në poemat Homerike të kishte një gjuhë aq të plotë, të ndërlikuar dhe të rafinuar si Greqishtja; dhe, nga ana tjetër, që një popull me një gjuhë që dëshmonte një nivel aq të lartë kulture, të ketë qenë aq barbar dhe i egër, siç paraqitet në poemat Homerike.

[2, 3, 4] *Shënim B.P.:* Nuk e di sa qëndrojnë sot këto pohime?

Pranohet se raca Pellazge ka qenë mjaft e përhapur, dhe shtrihej në një zonë mjaft më të madhe se çdo tjetër, përveç paraardhëses së saj, Galicishtes – që lëvizi më me këmbëngulje dhe përmes rrugëve të ndryshme, drejt perëndimit. Mendohet se dyndja e valës së dytë, ose asaj Pellazge, të ketë qenë një prej shkaqeve të këtij eksodi Galik; sepse nuk dimë për asnjë racë tjetër që të ketë qenë midis Galëve dhe Pellazgëve[5]. (fq. 133)

E vetmja çështje që mbetet për t'u zgjidhur është origjina e racës Greke; nëse ardhja e tyre ka qenë apo jo mërgim, njësoj si e dy të parave që përmendëm... . Që ajo ishte racë më e hershme se Pellazgët, nuk vihet në dyshim dhe, që nga ajo kohë, siç e kemi thënë edhe më parë, nuk ka asnjë shenjë të ndonjë pushtimi të madh[6] . (fq. 134)

Poemat në gjuhën origjinale Pellazge duhet të kenë qenë shumë më të lashta, sepse është krejt e papranueshme të mendohet që kjo ekspeditë e famshme të jetë bërë dhe përkujtuar nga fise jo-Pellazge dhe nga bardë jo-Pellazgë. Gjithashtu është krejt e qartë që Pellazgët nuk flisnin as Greqishte e as ndonjë gjuhë të përafërt me të, ndonëse si ata dhe Grekët, flisnin një gjuhë që lidhej me Sanskritishten. Kjo rrethanë e qartë, ndonëse i shpëtoi pa vënë re zotit Gladstone (ose ai e kaloi atë në heshtje), ishte vënë re më parë nga Dr. Marsh, i cili e përballoi problemin në të vetmen mënyrë që kishte mundësi ta luftonte: *duke bërë deklarimin e guximshëm, por të pabazuar, se Pellazgjishtja dhe Greqishtja ishin e njëjta gjuhë.* (fq. 136)

Troja ishte pa dyshim një qytet Pellazg, *ashtu siç ishte Pellazge edhe zona përreth saj, madje deri në Siri.* Sidoqoftë, Karia e kishte humbur gjuhën Pellazge, ose kjo ishte korruptuar kaq shumë, sa që nuk njihej. (fq. 141)

Në fakt, deri kohët e fundit, etnografët nuk dinin as se në cilën kategori bënte pjesë raca Shqiptare: ndër të tjera, për shembull, janë

---

[5] *Shënim B.P:* N.q.s. Galët u shtynë drejt perëndimit nga Pellazgët, atëhere detyrimisht këta të fundit vinin nga Lindja; po nga çfarë Lindje?

[6] *Shënim B.P:* N.q.s. ishte më e hershme se Pellazgët, atëhere detyrimisht duhet të kenë qenë më të hershëm edhe se poemat Homerike ?? Po në raport kohor me Galët si qëndrojnë?

hedhur edhe hipoteza se ata janë Finlandezë! Të gjitha këto hamendje e hipoteza tani janë hedhur poshtë: dhe është përcaktuar pa pikën e dyshimit se ata janë pasardhësit e banorëve të dytë më të vjetër të Evropës që njohim – Pellazgët ose Palestët[7]. (fq. 157)

Raca Greke ose ka ardhur përpara, ose mbrapa migrimit Pellazg. Nga ana filologjike, lashtësia e të dy gjuhëve është ndoshta gati e njëjtë, po të marrim parasysh se nga Greqishtja arkaike nuk ka mbetur asgjë.

Tani, nëse raca Greke erdhi e para në perëndim dhe u vendos aty, dhe u pushtua e u nënshtrua nga Pellazgët – raca më luftarake – dhe mbeti në një pozitë të nënshtruar, duhet supozuar që kultura e saj, më superiore se ajo e pushtueve, çau përmes barbarizmit të klasës sunduese. Duhet mbajtur parasysh, se kjo duhet të ketë ndodhur shumë më përpara se të shpikej shkrimi. Kjo teori, pra, nuk mund të na shpjegojë se përse u bë Greqishtja gjuha e shkruar, dhe jo Pellazgjishtja. Nga ana tjetër, historianët Grekë, as nuk e përmendin këtë teori. Përkundrazi, ata lënë të kuptohet që, ngado që kanë ardhur Grekët, ata kanë ardhur pas mbërritjes së Pellazgëve dhe asnjëherë nuk e vënë në dyshim dallimin, si në racë dhe në gjuhë, midis tyre dhe Pellazgëve. Megjithatë, informacioni nga Herodoti është i paktë, i rrallë dhe konfuz. Është e qartë që ai nuk dinte asnjë gjuhë tjetër përveç së vetës dhe as nuk ishte në gjendje të vlerësonte gjuhën Pellazge përveç se për të thënë që ishte një gjuhë "barbare" – ndonëse është mjaftueshmërisht e qartë se, Pellazgjishtja duhet të jetë folur gjerësisht në kohën e tij edhe në rrugët e Athinës[8]. (fq. 158, 159)

Vaso Pasha

(Lindur: 30 Qershor 1825, Shkodër)

(Vdekur: 29 Qershor 1892, Bejrut, Liban)

---

[7] *Shënim B.P:* Po të parët kush janë? Galët apo Grekët ? Sipas autorit i bie të kenë qenë Galët?

[8] *Shënim B.P:* Kam përshtypjen se ky studim është paksa konfuz pasi përmban shumë kundërshti brenda tij.

KARL GRIMBERG

"HISTORIA BOTËRORE DHE QYTETËRIMI"

(Libri 1)
Botuar 1963, Stokholm

Për botimin Shqip, *Uegen,* 2003

Mbreti i parë, që bashkoi nën skeptrin e tij Egjiptin e sipërm dhe atë të Poshtëm, do të ketë qenë Menesi, me prejardhje nga Egjipti i Sipërm. Do të ketë qenë një personazh historik, apo një figurë legjendare, vallë? Mos ngatërrohet gjë me Narmerin? Nuk e dimë. Nuk dimë bile nëse kryeqyteti Memfis njohu një lulëzim të menjëhershëm. Sot mendimi më i pranuar, e vendos Menesin rreth 3100 vjet përpara Krishtit, ...(Fq. 26)

Në të vërtetë, feja dhe arti e kishin çuar gjer atje Akhenatonin (Amenofisi IV – Faraoni i Egjiptit, që mbretëroi 1375-1360 para Krishtit), sa të linte pas dore detyrat në fushën e politikës së jashtme. Kjo bëhej më e rrezikshme ngaqë një perandori e fuqishme ishte formuar në Azinë e Vogël, ajo e Hititëve, një popull kurreshtar, që ngre një nga problemet më të mëdha etnografike të historisë. *Hititët nuk ishin as Semitë, as Indoevropianë, por formonin me sa duket një popull të përzier, gjuha e të cilëve duhet rradhitur tek ajo e popujve Indo-Evropianë.* ... Në Boghaz-Keui u gjetën (vitet 1906-1907) arkivat e perandorisë Hitite; fati bëri që këto dokumenta të

qenë shkruar me germa kuneiforme Babilonase. Pa këtë rastësi të lumtur, do të braktiseshin gjithmonë mbishkrimet, sepse shkrimet e vërteta të Hititëve, një lloj hieroglife, sfidojnë edhe sot të gjitha orvajtjet për t'i dëshifruar. (Fq. 56)

Gjatë periudhës së perëndimit, që pasoi mbretërimin energjik të Ramsesit të II (1301-1234 para Krishtit), Libianët u treguan të padenjë për besimin që u ishte dhënë gjer më tani. Duke grabitur dhe plaçkitur ata pushtuan pjesën më të madhe të deltës dhe zaptuan vendet gjer në rrethinat e Memfisit. Libianët ishin akoma më të rrezikshëm kur bashkoheshin me "Popujt e Detit"; Egjiptianët quanin kështu banorët e ishujve dhe brigjeve të Mesdheut Lindor. Nga fundi i dinastisë së nëntëmbëdhjetë kishte ndodhur një lloj shpërngulje midis këtyre fiseve luftarake, të shtyrë mbase nga popuj të tjerë, që vinin nga veriu dhe lindja. Anijet e Popujve të Detit zbarkuan mbi brigjet e Sirisë dhe, këta të padëshirueshëm, pushtuan gjithë Sirinë veriore. (Fq. 62-63)

Ditët e perandorisë së fuqishme Hitite, një brezni pas Ramsesit të II, ishin të numëruara. Ka mundësi që ajo të ketë rënë nën goditjet e "Popujve të Detit", të cilët kërcënonin në të njëjtën kohë edhe Egjiptin. Perandoria Hitite u bë thërmia, duke krijuar një numër të madh shtetesh të vegjël. Hititët u zhdukën në malet e pakapërcyeshme të Azisë së Vogël, në mënyrë po aq të papritur, sa edhe ishin shfaqur në skenën e historisë. (Fq. 64-65)

Babilonia qe më e vjetra dhe më e pasura e shteteve, që lindën nga lumenjtë binjakë. (Fq. 127)

Rreth 3000 vjet para Krishtit u dyndën fise të reja. ... Asirianët, që ishin pa dyshim me origjinë nga Kaukazi, por tashmë të përzier me Semitët, banonin më larg, përpjetë lumit të Tigrit. Nga ardhacakët e rinj, më interesantët qenë, pa dyshim, Shumerët, që u vendosën në grykëderdhjet e lumenjve. Origjina e tyre është akoma enigmë. Shumë gjëra provojnë se ishin me origjinë nga malet, mbase të Persëve, dhe kultura e tyre duket se ka të njëjtat rrënjë si ajo e

popujve që, në po atë kohë, krijuan një shoqëri të zhvilluar në luginën e Indusit.

Rreth 3 000 vjet para Krishtit, Shumerët kishin krijuar, ose kishin huazuar prej vendit të tyre të ri, një qytetërim të bazuar mbi shkëmbimin e prodhimeve. (Fq. 129)

Të gjitha qytetet Shumeriane, nëqoftëse s'u zhdukën fare nga harta, të paktën u prekën rëndë nga përmbytja e vitit 3 000 para Krishtit. Personazhi i parë Shumerian, që njohim me siguri nga shkrimet Urase, është Mesanepada, mbreti i Urit. Ka të ngjarë, që ai të ketë jetuar në vitin 2500 para Krishtit. (Fq. 130)

Në vitin 2 350 para Krishtit nisi një periudhë rënie e dalluar nga luftërat civile dhe ekspeditat e popujve të maleve të veriut. Zgjati afërsisht prej vitit 1 750, para Krishtit, gjer në çastin kur mbreti Hamurab i Babelit – disa shikojnë tek ai Amrafaelin e Biblës – arriti të vendosë njëjtësimin mbretëror dhe ta bëjë Babelin, Babiloninë, kryeqytet. (Fq. 138)

Në vitin 1 530, para Krishtit, ajo (Mbretëria Babilonase) pësoi një disfatë ndaj Hititëve dhe pushtuesve të tjerë të huaj. (Fq. 149)

Asirianët, ashtu si Babilonasit, ishin një popull Semitik. Pushtuesit Asirianë nënshtruan Babiloninë, Sirinë, Palestinën dhe, për një farë kohe, edhe Egjiptin. Njeri prej mbretërve më të etur për pushtime qe Teglapileseri, i cili jetoi rreth viteve 1100, para Krishtit. (Fq. 149)

Veç të tjerash ai tregon (*Shënim B.P.:* Bëhet fjalë për Teglapileseri) ... se e ka shtrirë perandorinë prej brigjeve të Mesdheut gjer në malet e Armenisë. (Fq. 149)

Përpara gërmimeve, lidhjet historike ndërmjet Babilonisë dhe Asirisë, shikoheshin në mënyrë krejt të kundërt nga kjo e sotmja. Historia e perandorisë Asiriane, në këtë kohë, ishte fshehur nën gërmadhat e qyteteve. Në të vërtetë, gjithë mbretëria do të jetë asgjësuar prej ndonjë katastrofe të madhe, meqenëse qe rrafshuar

nga sipërfaqja e tokës. ... Historianët Grekë, veçanërisht Herodoti, mundën të na jepnin një tabllo më konkrete të tallandisjeve të mëtejshme të Babilonasve, tablo e mbështetur mbi gojëdhënat e vetë popullit Babilonas. Sa për Asirinë, Grekërit nuk kishin veçse informata të shpërndara dhe shpesh krejtësisht të pasakta. (Fq. 159)

Për shkak të kësaj katastrofe, e cila në vitin 612 para Krishtit preku të gjitha qytetet Asiriane, burimet e historisë Asiriane kanë mbetur të paprekura gjer në ditët tona. (Fq. 159)

Zbulimet e El-Amarnasë dhe Boghaz-Keui provuan që gjuha Babilonase ishte gjuhë e gjithë botës. (Fq. 171)

Mitologjia babilonase

Ashtu siç u bë Anu zot i qiellit dhe Enlili zot i tokës, Ea, djali i Anusë, u bë zot i ujërave. ... Djali i Eas, *Marduk* ose *Bel,* trashëgoi filantropinë nga i jati dhe pasi kishte shpëtuar nga zgjedha e Anusë dhe Enlilit, u bë zot i qiellit dhe i tokës. ... Sa më shumë zhvillohej Babeli aq më shumë merrte rëndësi *Marduku.* (Fq. 175 -176)

Hititët

Për dy shtete, perandorinë Hitite dhe mbretërinë Hurrite, që u shfaqën në fillim të mijëvjeçarit të dytë, është e vështirë të përcaktohen kufijtë. Kjo ngaqë kanë ndryshuar vazhdimisht.

... Një shkrim Akkadian, që daton në kohën e Naram-Sinit, pra në vitin 2160 para Krishtit përmend një farë mbreti Pamba i Hatit, domethënë i vendit të Hititëve.

Të përforcuar nga grupe Indo-Evropiane, me origjinë nga Thraka, Hititët krijuan një fuqi ushtarake, duke përdorur kuajt në luftë. Ata ndërmorën inkursione të guximshme, plaçkitën në Lindjen e Afërt, dhe ...

Mbreti më i fuqishëm i Perandorisë së vjetër ishte Mursili I, i cili jetoi rreth vitit 1550, para Krishtit.

Pas një periudhe krize, që përfundoi me sulme dhe shkatërrimin e Hatusit (kryeqytet i Hititëve) nga "Popujt e Detit" (rreth vitit 1420, para Krishtit), një perandori e re arriti kulmin e pushtetit politik nën mbretërimin e Supiluliumas (1380 -1346, para Krishtit).

... Rreth vitit 1190, para Krishtit, Hatusi u shemb nga "Popujt e Detit" (mes të cilëve edhe Filistinët, të ardhur nga Azia e Vogël). Qyteti nuk u ngrit kurrë pas rrënimit.

... Gjatë gjithë gjysmës së parë të mijëvjeçarit të parë, Assirianët e ruajtën emrin Hati, për të treguar territoret e perandorisë së vjetër Hitite, ndonëse Hititët s'qenë më zotër të saj.

Në Anatolinë qendrore, shtete të shumta lindën mbi rrënojat e perandorisë Hitite. Midis tyre ndodhej edhe mbretëria e Frigjisë dhe ... (Fq. 194 - 195)

"Shkrimi i Sinait" paraqet ende shumë enigma. Tekstet akoma nuk janë deshifruar të gjitha, por mendohet që ato datojnë në vitet 1850-1500 para Krishtit, dhe përbëhen nga tridhjetë e dy shenja. Mbishkrimet më të vjetra Fenikase janë zbuluar në Ougarit dhe datojnë në vitet 1500 – 950, para Krishtit. Bëhet fjalë për një shkrim thjesht alfabetik, që numëron njëzet e dy shkronja, të gjitha bashkëtingëllore. Rreth viteve 1 000 para Krishtit, alfabeti Hebre lindi nga ky alphabet Fenikas; ndoshta një çikë më vonë u shfaq alfabeti primitiv Grek, i cili shërbeu si model i alfabetit Latin. (Fq. 217)

Popujt Indoevropianë nuk formojnë një racë homogjene, por një njësi gjuhësore; është fjala për popujt që flasin gjuhën Indoevropiane. (Fq. 218)

Djepi i këtyre popujve është kërkuar të paktën në njëzet vende të ndryshme, që prej Evropës veri -perëndimore, tek rrafshnalta e Azisë qendrore dhe gjer në Indi. Sidoqoftë shumë specialistë mendojnë se zanafilla e Indoevropianëve është në jetën nomade mbi pllajat e mëdha të Azisë Qendrore, aty nga ku kanë ardhur edhe shumë popuj. ... Ndofta popujt Indoevropianë janë dëbuar drejt perëndimit nga popuj të tjerë me origjinë lindore, që banonin në krahinat kufitare me

Kinën. ... Përse është i vështirë, në mos po i pamundur, të përcaktohet me saktësi vendi i origjinës së Indoevropianëve? Ne nuk zotërojmë të dhëna historike, që mund të shërbejnë si pikënisje. Vetëm gjuhësia, përmes studimit krahasues të gjuhëve Indoevropiane, mund të na japë disa të dhëna. (Fq. 218)

Fjalori Indoevropian primitiv vërteton një gjë: njerëzit që flisnin këtë gjuhë banonin në një krahinë ku dëborërat dhe ngricat nuk përbënin ndonjë përjashtim, po ashtu si edhe shiu. (Fq. 219)

Vendi i Indoevropianëve ishte malor dhe po të gjykohet nga fjalori ata nuk e njihnin detin. (Fq. 219)

Kiri i Madh

Persiani Kiri, mposhtësi i Babilonasve dhe çliruesi i Çifutëve, në origjinë ishte një vasal i Medëve. Por, rreth vitit 550, para Krishtit, u revoltua dhe e rrëzoi perandorinë Mede. Katër vjet më vonë ai theu Kresusin, mbretin e pasur të Lidisë, nënshtroi mbretërinë e tij, që shtrihej pothuajse në të gjithë Azinë e Vogël. Në vitin 539, para Krishtit, ai ishte zoti i Babilonisë. (Fq. 224)

Në Babel ai bëri kurbane për Mardukun ...(Fq. 225)

Periudhat Heladike

Të parët e Agamemnonit vinin nga veriu, me ata luftëtarët e egër që kanë rrafshuar kulturën më të vjetër Greke të moshës së bronzit. Në këtë përfundim do kishim arritur edhe nga një rrugë tjetër. Pushtuesit nuk ishin barbarë të palëvruar. Kemi rrënoja të qytetërimit të tyre shumë të lartë. Gjejmë tek ata gjithçka, që dallon përfaqësuesit e kulturës Mikenase dhe të Kretës Minoene. (Fq. 244)

Kultuar Mikenase e njohu zhvillimin më të madh në tokën Greke; fiset pushtuese të veriut sillnin një farë qytetërimi; ato iu dhanë diçka edhe pasardhësve të Heladikës së lashtë.... Po cilët ishin këta stërgjyshër të Grekëve? (Fq. 245)

... është e pamundur të kuptohet krejtësisht kultura Mikenase pa njohur lidhjet kulturore që bashkonin popujt e pellgut mesdhetar. (Fq. 247)

Grekët, që rrethuan Trojën, Homeri i quan "akej"; ... (Fq. 249)

Burimet Hitite përmendin në disa pjesë qytetin e Vilusas, ku mbretëronte Alaksandus dhe në vende të tjera qytetin Taroisa. Këta ndoshta janë dy emra të të njëjtit qytet, atij të Trojës, që Grekët e quajnë gjithashtu Ilion. (Fq. 250)

Nga fundi i shekullit të trembëdhjetë, para Krishtit, perandoria Hitite, shumë e dobësuar, nuk ishte më në gjendje ta mbante pushtetin. (Fq. 250)

Grekët nuk kishin hiç frikë t'iu jepnin një datë të saktë gjithë këtyre ngjarjeve gjysmë-legjendare. Kështu gojëdhënat e lashta e vendosin rënien e Trojës më 1183, para Krishtit, dhe kjo përputhet dukshëm me zbulimet e arkeologjisë moderne.

Ndërkaq duhet të vendosim theksin mbi të keqen, që karakterizonte fazën finale të epokës Mikenase. "Ishujt ishin shqetësues", thotë një burim Egjiptian. Dhe midis tribuve të tjera, ata të "Aqaiwasta"- akejtë - vinin në Egjipt, plaçkisnin dhe pushtonin vendin. Si shpjegohet e gjitha kjo? (Fq. 251)

Babai i tij, Priami, ishte mbreti i Trojës, ose Ilionit, siç quhej ndryshe qyteti. (Fq. 254)

Nëse është e saktë që Homeri ka jetuar në fillim të shekullit të tetë, para Krishtit, Lojërat e para Olimpike janë bërë në epokën e tij; sipas gojëdhënave ato kanë filluar në vitin 776, para Krishtit. (Fq. 276)

Shfaqja e monedhës, duhet të ketë ndihmuar në shekullin e shtatë, para Krishtit, në nisjen e një vale të vërtetë njerëzore, e cila helenizoi më shumë brigjet e Mesdheut dhe të Detit të Zi. Emigrimet e mëdha në shekullin e tetë, të shtatë dhe të gjashtë, para Krishtit, janë quajtur kolonizimi i dytë Grek, për ta dalluar nga i pari, që ishte përbërë prej emigrimeve "akeje" dhe "dore". (Fq. 296 - 297)

SPIRO KONDA

"ALBANËT (SHQIPTARËT) DHE PROBLEMI PELLAZGJIK"

Nxjerrë nga:
Kumtesë mbajtur në Konferencën e Parë të Studimeve Albanologjike
Tiranë 15-21 Nëntor 1962

Unë jam i bindur, dhe këtë e dëshmon edhe realiteti, se një nga mungesat shumë të rëndësishme të studiozëve, që janë marrë me Pelasgët, është mosnjohja e gjuhës Shqipe nga ana e tyre ose njohja e saj në mënyrë të pamjaftueshme. Kjo mungesë i ka lënë punët e tyre në mes të rrugës. (fq. 145)

SPIRO KONDA

"SHQIPTARËT DHE PROBLEMI PELLAZGJIK"

Uegen 2011
Botimi i parë: Tiranë 1964

Ai, që do të marrë përsipër të shkruajë historinë e kombit shqiptar që nga kohët parahistorike dhe gjer në ditët e Gjergj Kastriotit ose Skënderbeut, duhet medoemos të ketë këto cilësira, domethënë, të jetë:

1. Filolog Helenist

2. Filolog Latinist

3. Gjuhëtar (glosolog)

4. Indolog

dhe

5. Gjuhën Shqipe ta ketë shumë amtare dhe ta zotërojë shkencërisht (fq. 19)

Gjuhë më të përsosura janë ato të racës Kaukaziane, që banojnë në Europë, Azi dhe Afrikë. Këtyre gjuhëve shkencëtarët-gjuhëtarët u dhanë emrat e tre djemve të Noes, duke i quajtur Hametike, Semitike dhe Japetike. Popujt që flasin gjuhën Japetike hyjnë në racën Ariane,

ose Indigjermane ose Indo-europiane. Këto gjuhë i flasin ata që banojnë në Europë, përveç Turqve, Hungarezëve, Laponëve, Finëve dhe Gaskonëve, që banojnë në Francën jugore dhe në Spanjë. Në të njëjtën familje hyjnë Indianët, Persët dhe Armenët prej popujve të Azisë.

Nuk janë ruajtur kujtime mbi vendin ku kanë jetuar bashkë popujt Arianë. Por duket se atdheu i tyre i përbashkët ka qenë Azia qendrore, aty nga veriu i Indisë. Prej këtej zunë të shkëputen dhe të drejtohen nga perëndimi disa nga këta popuj, që përbënin familjen Japetike. (fq. 32-33)

Origjina e Shqiptarëve, domethënë atdheu ynë i parë, gjendet po të zgjidhet më parë çështja e gjuhës; se kjo është për të gjithë karakteristika kryesore e kombësisë. (fq. 33)

Rreshtimi i gjuhëve që rreshtohen në tabelën III është bërë kështu: E para vihet mëmë e të gjithave, Japetikja; pas kësaj vjen Sanskritishtja, gjuhë e shkruar, më e vjetra nga gjuhët e tjera; pastaj vijnë Greqishtja, Latinishtja, Gjermanishtja, Anglishtja, Sllavishtja dhe Shqipja. (fq. 34)

Sanskritishtja, nga San-Scrita, d.m.th. gjuhë e përsosur, është gjuhë e periudhës klasike të intelektualëve të Indisë[1].

...

Pas Sanskritishtes vihet Greqishtja e vjetër, se kjo u fol dhe u shkrua në shek. XI[të] të erës së vjetër (Homeri-Derpfel). ...(fq. 34)

Shënim B.P.: të kihet parasysh që flitet për Greqishten e vjetër dhe jo të re !!

---

[1] *Shënim B.P.:* (nxjerrë nga Wikipedia) Sanskritishtja është një gjuhë e Indisë antike me një histori 3.500-vjeçare. Është gjuha kryesore liturgjike e hinduizmit dhe gjuha mbizotëruese e shumicës së veprave të filozofisë hindu, si dhe disa nga tekstet kryesore të Budizmit dhe Xhainism (Jainism)

Familja gjuhësore: Gjuhët Indo-Europiane, Gjuhët Indo-Ariane, Gjuhët Indo-Iraniane

Sistemi i shkrimit: shkrimi Brahmi

Gjuhë zyrtare në: Uttarakhand

Forma e lashtë: Vedik Sanskrit

Pas Greqishtes vjen Latinishtja; ... (fq. 35)

(*Shënim BP:* Të shihet krahasimi i foljes "jam" në Shqip dhe Armenisht, tabela VI, fq. 52 – si edhe diferenca me gjuhët e tjera po aty)

Japetike	Shqipe (S.Konda)	Shqipe (B.Piran.)	Ermene (S.Konda)	Armene (B.Piran.)
As-mi	*Jam*	*Jam*	*Em*	*Jem*
As-si	*Je*	*Je*	*Es*	*Jes*
As-ti	*Asht*	*Është (Asht, A)*	*E*	*E*
As-mas	*Jena (Jemi)*	*Jemi(Jena)*	*Enk*	*Jenk*
As-tas	*Jeni (Ini)*	*Jeni (Jini)*	*Ek*	*Jek*
As-nti	*Jan*	*Janë*	*En*	*Jen*

3) Gjuha shqipe është më konservatore nga tërë gjuhët e krahasuara, në krahasim me gjuhën mëmë Japetike ose Sanskritike. (fq. 68)

Në bazë të atyre që kemi trajtuar, e quajmë të nevojshme të tregojmë dhe nënvizojmë në vija të përgjithshme *elementet e qytetërimit,* që muarën me vete të parët e lashtë të Shqiptarëve të sotëm, kur u ndanë nga atdheu i tyre i parë, nga India. Elementet në fjalë shkurt janë këto:

1. Të familjes: (Patr, mater, motër, bhratr, brazer, snusa, nus-e).
2. Të banesës: (dyer-dvar).
3. Të blegtorisë: (Gaus, dam, vat-sa, mus, çvan, marg).
4. Të të thururit: (vas-esthes).
5. Të bujqësisë: (Jug-zygos, ajr-as = ar-a, rrath-as).
6. Të masave dhe peshave (Mat=mërron, bhar = fortos)

7. Të numërimit sipas sistemit dhjetor: (dya, tri, katur, etj.).

8. Feja: mbi këtë do të flasim gjatë në pjesën e dytë ("Libër XI") të kësaj vepre nën titullin "Perënditë e Pellasgëve". (fq. 69)

Kjo provohet edhe nga vepra "Parime të përgjithshme të gjuhësisë së krahasuar" e gjuhëtarëve të dëgjuar Whitney dhe Jolly; ...

"Në gadishullin e Ballkanit, në veri të Greqisë dhe në jug të Malit të Zi, në Shqipëri, u ruajt një gjuhë e veçantë Japetike, gjuha Shqipe, që rrjedh nga Ilirishtja. ... Të dhjetë gjuhët për të cilat folëm më sipër dhe të cilat janë të një fisi, domethënë, Indishtja, Iranishtja, *Armenishtja, Greqishtja, Shqipja,* Latinishtja, Italishtja, Sllavishtja, Baltishtja, Gjermanishtja dhe Keltishtja, bashkë me dialektet e tyre të shumta, formojnë një familje gjuhësore të madhe e të rëndësishme, të cilën në krye e quajtën me emrat e dy popujve, që gjenden në dy skajet më të largëta dhe përmbledhin krejt familjen e madhe të këtyre kombeve, domethënë të Indianëve dhe Gjermanëve duke e quajtur "familje Indogjermane" (fq. 71)

Shënim B.P.: Duke cituar shkrimtarë të vjetër Grekë, Spiro Konda konkludon:

Pra, nga këto dëshmi del se populli që banonte në Greqi përpara Helenëve, ishte Pellasgjik, ...(fq. 121)

... simbas Homerit, në Kretë banonin në kohën e tij pesë kombe me gjuhë të ndryshme: Eteokretasit, Kydonët, Akejtë, Dorianët dhe Pellasgët. (Odisea, kën. 19 v. 172-177). Po midis këtyre kombeve nuk përmendet emri Shqiptar (Albanoi) (fq. 121)

... Në Etruri përmenden si banorë *Etruskët* ose *Juskët.* Po, sipas Strabonit, Etruskë ose Juskë quheshin prej romanëve Tyrenët.

"Tyrenët, pra, quhen prej romakëve *Etruskë* ose *Tuskë.*" (Strab., Kap. 219,2).

Po, sipas Dionisit të Halikarnaseas, Tyrenë u quajtën *Pellasgët* që u vendosën në Itali.

"Elaniku Lesbiani thotë se Tyrenët, që quheshin më parë *Pellasgë,*

pasi erdhën dhe banuan në Itali, e muarën emrin që kanë sot". (Dion. Alikarn. Vol. A XXVIII, 3). (fq. 124)

Nga kombësia e parë Pellasgjike e fjalës *gur* del edhe kombësia e parë e shqiptarëve të sotëm, që është patjetër *Pellasgjike.* Pra emri i vjetër i shqiptarëve është *Pellasgjik,* domethënë Shqiptarët quheshin në fillim Pellasgë dhe Tyrrenë dhe Etruskë dhe Tuskë. (fq. 127)

... siç dëshmohet nga Straboni, i cili shkruan: "Që Pellasgët ishin një *komb i madh,* thonë se edhe nga historia tjetër vërtetohet; Menekrati Elaiti në veprën mbi kolonitë thotë se tërë anëdetja e sotme jonike, duke filluar nga Mykali, si edhe ishujt e afërm, banohej më parë prej *Pellasgësh*". (Kap. 621, 3, 15-25)

Straboni thotë se edhe në Azinë e Vogël banonin *Pellasgë*" (Kap. 620, 2, 5-10)

Shënim B.P.: Në fq. 271-294 (Pjesë e Dytë, Libri IX) bëhet argumentimi i ekzistencës së Pellasgëve në krahinat që sot janë pjesë përbërëse e shtetit Grek dhe konkretisht:

Pellasgë në Atikë; Pellasgë në Orkomeno; Pellasgë në Thesali; Pellasgë në Thrakë dhe Samothrakë; Pellasgë në Micenë; Pellasgë në Tirynth; Pellasgë në Argos.

...sipas Hellanikut nga Lesboja, "Pellasgët, kur erdhën në Itali, u quajtën Tyrrenë". (Dion. Halikarnasi, Vëll. I, A, XXVIII, 3) (fq. 349)

2) Gjithashtu Dionis Halikarnasi (Vëll. I, A, XXX, 5) përmend këto më poshtë: "Fisi i Pellasgëvet, pra, që nuk u zhduk dhe që u shpërndanë nëpër kolonitë dhe që prej shumë kohe mbetën kështu të pakët, qëndruan duke jetuar bashkë me aborigjenët si qytetarë nëpër këto vende, ku me kohë pasardhësit e tyre bashkë me të tjerët ndërtuan qytetin e Romës". (fq. 349)

3) Plutarku nga Kerona, ("Jetët paralele – Romuli", I, 18), shkruan për Romën sa më poshtë: "Por Pellasgët, pasi u endën nëpër vendet

më të shumta të botës dhe sunduan mbi shumicën e njerëzve, u vendosën për të banuar aty (domethënë në Romë) dhe e quajtën qytetin ashtu për shkak të fuqisë së tyre në luftë". (fq. 349-350)

... pamë se kjo botë e *perëndivet* të *Pellasgëvet,* si kuptim esencial ka dhe shpreh: *"i dhelindur".* Kuptimin e dheut, si nënë e të gjithavet, nga e cila lindin, ushqehen dhe mbahen të gjitha. Kjo fuqi jetëdhënëse e Dheut Nënë na solli në atë etapë, e cila mban emrin "Pellasg". Me fjalë të tjera, emri "Pellasg", etimologjia dhe shpjegimi i të cilit bëhet drejt vetëm me anë të *gjuhës shqipe,* shpjegon dhe përmban kuptimin themelor të fjalës *"i dhelindur",* lidhur me pellasgët. (fq. 437)

Shënim B.P.: Në PJESA E TRETË, LIBRI I DYMBËDHJETË, KAPITULLI I PARË, fq. 439 – 450, ndodhet shkrimi i titulluar "Mendimet që janë çfaqur rreth pellasgëvet prej dijetarëve të ndryshëm (historianë, arkeologë, gjuhëtarë, etj.) që nga kohët e vjetra dhe gjer më sot."

Në të përmbahen citime nga autorë të ndryshëm me emër në fushën e historisë, arkeologjisë, gjuhësisë, etj., citime të cilat hedhin dritë mbi opinionin e tyre rreth problemit "Pellasgjik", ndërmjet të tjerëve: Herodoti, Thuqidhidhi, Straboni, etj.

Mendoj se është një kapitull me shumë interes për t'u lexuar për këdo, që është i interesuar të hulumtojë në sferën e gjuhësisë Indo-Europiane, apo në prejardhjen e popullit Shqiptar.

18) *D. Olimpi,* në (*"Fjalorin Homerik",* përkthim nga gjermanishtja, Athinë, viti 1900, faqe 250), përmend këto fjalë: "Fjala Pellasg konsiderohet fjalë Aziatike" (fq. 446)

Si rrjedhim, nga të gjitha sa u thanë, del konkluzioni i padiskutueshëm se shqiptarët janë një popull i stërlashtë, dhe në kuptim relativ, janë populli më i vjetër i gadishullit Ballkanik, një popull para-Grek, dhe konkretisht, pasardhës i Pellasgëvet. (fq. 486)

ZACHARIE MAYANI

"ETRUSKËT FILLOJNË TË FLASIN"

Shtëpia Botuese " Fan Noli",
Tiranë, 2018

Botuar për herë të parë: Francë, 1973

Shënim B.P: Duke folur për alfabetin Etrusk, Zacharie Mayani shpjegon:

P -ja e tyre shprehej *p, b, bh.*

C -ja mund të dëftente *k, g, q, tz, tch.*

Zanorja *U,* ishte si *o* ose *u.*

V -ja tregonte shpesh *u* -në. (fq. 14)

..., Etruskët, sidomos ata të shekujve të fundit përpara erës sonë, kishin imituar zakonin e keq të Semitëve, atë të tejkalimit në shkrim të disa zanoreve. Për shembull, në gjuhën Fenikase, fjala *malkat* (mbretëreshë) shkruhet mlkt dhe ajo, që mungon, duhet marrë me mend. Kësisoj, Etruskët shkruanin *Elxsntre* në vend të Aleksandër. (fq. 14 - 15)

4. Kjo është edhe arsyeja, se përse, tepër shpesh, ne nuk dimë se si duhet shqiptuar saktësisht kjo apo ajo fjalë Etruske.[1] (fq. 15)

[1] *Shënim B.P:* Të njëtat fenomene i hasim edhe tek gjuha Armene, me të vetmin ndryshim, që në të nuk ka vend për paqartësi apo çorientim, pasi duke qenë gjuhë e gjallë ekzistuese dhe e përpunuar, gjithçka është pasqyruar qartë nëpërmjet rregullave të përcaktuara në Gramatikën e Gjuhës Armene.

Origjinat e këtij populli që quhej *tursk, tusk, etrusk,* janë pjesërisht të lidhura me popullsinë *Tursha,* ai fis luftarak që në shekujt XIII[të] dhe XII[të] para Krishtit, i shoqëruar me *Licët* dhe fise të tjera endacake, kishin sulmuar nëpërmjet detit Egjyptin faraonik. Turshat do të arrinin të vendoseshin, rreth pesë ose gjashtë shekuj më vonë në Etruri. (fq. 103)

Megjithatë, as të parët dhe as të dytët e këtyre studjuesve nuk ofrojnë, për shembull, as shpjegim as identitet rreth emrave etnikë *Tursha* dhe *Tursk,* për faktin që emri kombëtar i etruskëve, *Tarkuin,* është ai i një hyjnie të Azisë së Vogël, *Tarku* ose *Tarkon.* (fq. 103)

Por Turshat, të cilët shfaqen në Itali në shekujt IX[të] – VIII[të] para Krishtit dhe që e quajnë veten e tyre *Rasna,* do të sillnin aty pa diskutim shumë elemente të rinj, që lidheshin me civilizimin Anadollas: rite, tipare të arkitekturës mortore, motive arti, një farë luksi oriental, si edhe emrin *Tarkon,* depërtimi i të cilit në Etruri nuk mund të shpjegohet vetëm nëpërmjet ndryshimeve tregtare. (fq. 104)

Emërtimet e disa territoreve Lidase prej ku vinin Turshat ishin: *Malea* (nga shqipja – mal), *Plakia* (nga shqipja – plak, i vjetër) që të gjitha Ilire. Të ardhurit rishtas ishin që të gjithë njerëz të trungut Ilir, as Lidas, as Aziatikë, por Thrako-Iliras të vendosur në Lidi. Me mbërritjen e tyre në Itali, atdheu i tyre i ri, ata do të gjenin aty një popullsi të së njëjtës rrënjë dhe që fliste të njëjtën gjuhë ilire, dhe ata do të integroheshin aty pa shumë vështirësi. (fq. 105)

b) Sipas Plutarkut, në Tarketia jetonte mbreti mizor i *Albanëve,* ... (fq. 108)

Përpara se të angazhohemi në rrugën që çon nga Etruria në Mesopotami, a nuk duhet të ndalemi për një çast edhe në *Shqipëri?* (fq. 110)

Faktikisht, *Etruskishtja paraqet disa pika kontakti me Armenishten, ashtu si edhe Shqipja.* (fq. 130)

..., Në epokën e Romës perandorake, tri provincat e Ilirisë ishin

të vendosura njera pas tjetrës midis Danubit dhe Adriatikut; Panonia, Iliria dhe Dalmacia do të romanizoheshin nga ngulimet dhe kampet ushtarake Romake.

Lidhjet midis *Ilirishtes dhe Shqipes* janë vënë në dukje, më 1950, nga C. Coon, drejtuesi i ekspeditës etnografike të dërguar në Shqipëri nga Universiteti i Harvardit, tashmë i cituar.

Coon përmend tri fjalë të zakonshme për popullsinë e lashtë të këtij vendi dhe për shqiptarët: *peeligo,* "i vjetër, i moshuar" (plak), *Emathia,* "Emadhja" (e madhia, emër i një fisi) dhe *Molotti,* "malësorë" (maltsor). Coon shton: "Gjuha gege (shqipe) është kryesisht Ilire" (Malet e Gjigandëve", fq. 39 dhe 41). (fq. 451)

..., të gjitha huazimet që Shqipja mund të ketë bërë gjatë shekujve nga gjuhët e tjera, nuk e ndryshojnë aspak faktin vendimtar: atë të vazhdimësisë midis *Ilirishtes së lashtë (Etruskishtes)* dhe *Ilirishtes moderne (Shqipes).* Falë kësaj vijimësie, gjuha Shqipe ka ruajtur shumë *nocione themelore Etruske,* ...(fq. 452)

Shënim B.P: Duke cituar studjuesin B. Hrozny, i cili në vitin 1929 kishte botuar një artikull të titulluar "Gjuha Etruske dhe gjuhët Hittite", Mayani shkruan:

..., dhe ai përfundon: *"Etruskët kanë ardhur në Itali nga një rajon i vendosur fare pranë Hittitëve,* domethënë nga Azia e Vogël", gjë që sipas nesh, paraqet një imazh jo të plotë të situatës. (fq. 456)

Sipas Herodotit dhe Strabonit, Etruskët ishin Lidas të ardhur nga Italia. Romakët i quanin me ironi "Sardianë", sipas emrit të kryeqytetit të Lidisë, Sarda. (fq. 456)

Nuk ka asgjë për t'u habitur që në Armenisht gjejmë shumë terma korrespondues me terma Ilirë, sepse, sipas Herodotit, Armenët janë me origjinë Thrako-Frigjiase (ose trashëgimtarë të Brigëve të lashtë Ballkanikë). Le të nënvizojmë disa pika kontakti midis Armenishtes dhe Shqipes: 1) të dy gjuhët kanë një nyje shquese *të pasvendosur; 2) erthal* në Armenisht është "shkoj, erdha" krahaso me Shqipen

ardh; 3) *ges* është "gjysmë"; krahaso me Shqipen "gjysmë"; *gtanem,* "unë gjej"; krahaso me Shqipen *gjet;* 5) *tzain,* "zë"; krahaso me Shqipen *za;* 6) *medz,* Armenisht "i madh", në Shqip është *madh.* Prej kohësh janë nxjerrë në pah edhe ngjashmëri të tjera, ku ndër më të rëndësishmit është: shumësi *-ik* i Armenishtes formohet nga mbaresa *–er, -eri (doun,* "shtëpi", shumës "dounerë"). Tashmë kjo është krahasuar me *–ar* të Etruskishtes (dhe *–eri?* "krahaso *shoqëri, vëtëra* (vite) të shqipes).

Kohët e fundit, G. Kapantzian ka nënvizuar një prapashtesë të lashtë të Armenishtes, për emrat etnikë, -ali: *Manali,* vendi i Manit (fqinj i Araratit, *Mini* e Dhjatës së Vjetër); etj. Kjo njëjtësohet me prapashtesën e gjinores së mirënjohur Etruske *–al*[158]. Interesante është të konstatojmë mbetjen e *Tark* në Armenisht. Ajo gjendet nën formën e *Torqom.* Por sipas Hommel-it, legjendat Armene të periudhës së paganizmit bëjnë fjalë për një bari gjigand, të quajtur Tork. [159]

Një tjetër emër i përveçëm, femëror kësaj radhe, meriton krejt vëmendjen tonë, pasi ai është përgjithësisht jo vetëm Armen dhe Kaukazian, por edhe një emër i vogël i ndërkallur, shenjë e fisnikërisë së familjeve të mëdha Etruske. Bëhet fjalë për *Satenig, Satinik.* Atë e gjejmë tek Osetët; ky term tregon një fallxhore ose magjistare legjendare, ngushtësisht e lidhur me epopenë e Nartëve, heronj legjendarë prej të cilëve ka mbetur vetëm një kujtim i mjegullt i depërtimit të parë Indo-Evropian në Kaukaz. Rreth origjinës së Nartëve nuk dihet asgjë. Në parantezë mund të themi se ky emër etnik gjendet në emërtimin e një vendbanimi Ilir, *Nareste* (pranë lumit Naron). (fq. 475 - 476)

Shënim B.P.: Po "Narta" në Vlorë ???

Së fundi me gjuhët e Kaukazit lidhet gjuha Baske. Sipas një teorie të Trombetti-t kjo gjuhë është një mbetje e Kaukazishtes së lashtë,

---

[158] *Shënim Z. Mayani: Studime historiko-linguistike mbi Historinë e Lashtë* të Armenëve, Erevan, 1956, fq. 182 (në Rusisht)

[159] *Shënim Z. Mayani: Ethnologie u. Geogr. Des Alten Orientes, 1926*

hapësira e të folurës të së cilës dikur shtrihej nga Kaukazi deri në Pirene dhe prej së cilës sot kanë mbetur vetëm dy ekstremitete: gjuha Baske dhe idiomat e Kaukazit.

Megjithatë, *ne vërejmë se ekzistojnë disa pika kontakti midis gjuhës Baske dhe asaj Shqipe.* (fq. 477 - 478)

Shënim B.P: Në "KONKLUZIONE" (fq. 506), Mayani shkruan:

...: problemi është ai i origjinës së Etruskëve.

Dëshmia e epigrafisë Etruske në masën që ajo është interpretuar këtu, është e prirur të konfirmojë praninë, tanimë të theksuar, të dy rrymave, që gërshetohen dhe ekuilibrohen në këtë qytetërim të çuditshëm: një rrymë e ardhur nga vendet e Danubit dhe një tjetër nga Anadolli. Gjithsesi me rezervën që, për të mos qenë robër të fiksioneve gjeografike, ne të shmangim së konsideruari Gadishullin Ballkanik, nga njëra anë, dhe Anadollin nga ana tjetër, si dy botë të kundërta, njëra "Evropë" dhe tjetra "Azi". Për epokën e dyndjeve të popujve dhe të vendosjes së Thrako-Ilirëve në Anadoll, kjo do të ishte anakronizëm.

Stepa Euraziatike shtrihet nga Bohemia dhe Hungaria aktuale deri në veri të Detit të Zi dhe të Kaukazit, dhe përmes rajonit Kaspik deri në Siberinë jugore, e cila konsiderohej njëherazi edhe Evropë edhe Azi. Paralelisht, një ecejake e vazhdueshme grupesh etnike nga më të larmishmet kryhej përmes Bosforit në të dy drejtimet, dhe kjo qysh prej epokave më të largëta. (fq. 506- 507)

Ja edhe një tjetër dëshmi e ndikimit oriental në artin dekorativ Etrusk. Asgjë nuk është më kuptimplotë se sa ngjashmëria e shtyllave, që gjenden në brendësi të shumë varreve Etruske (në Cerveteri e gjetkë), basoreliefet e të cilave paraqesin shqyta, armë, enë të ndryshme, etj., nga njëra anë dhe pilastre të një tempulli Anadollian, nga ana tjetër. Fjala është për tempullin e Musasir-t, pranë territoreve të Araratit, i plaçkitur nga Asirasit gjatë shekullit të VIII^{të} dhe i pikturuar prej tyre mbi një basorelief, të gjetur në Khorsabad. (fq. 511)

Andre Piganjoli i ka shtuar tezës së origjinës orientale të Etruskëve edhe disa argumente të tjera. Ai mënjanon si të pathemeltë teorinë e Wiesner-it, sipas së cilës Etruskët ishin barinj kalorës, që të nisur nga kufijtë e Kaukazit dhe Iranit, duhet të kenë kaluar Thrakën dhe Ilirinë. Por ai thekson lidhje të shumta midis një vendbanimi Anadollian të rëndësishëm, Toprakkale dhe Etrurisë; prania, në këtë vendbanim i një monumenti tipik Etrusk, dhe pikërisht tre gurë të shenjtë, të ngritur drejt qiellit dhe të vendosur mbi një bazë cilindrike; praktikën e vaditjes; dhomat mortore të rrethuara me banko, etj. Një gjë e tillë i jep mundësinë autorit të mbërrijë në përfundimin se "afërsia midis Etruskëve dhe popujve të lashtë të Azisë së Vogël nuk mund të vihet në dyshim" (Les Etrusques, people d'Orient, fq. 338). (fq. 513- 514)

... Gjuha Etruske përafrohet dhe lidhet me disa gjuhë të Orientit, d.m.th. të Azisë së Vogël. Por këto gjuhë nuk janë me origjinë lindore. Ato janë gjuhë me bazë Indo-Evropiane, të vendosura në Azinë e Vogël. Po kështu, gjuha Etruske nuk është orientale.

Origjina e saj të shpie drejt Danubit.

Etruskët janë, pjesërisht, trashëgimtarët e Tursha-ve. Por Turshat nuk janë një popull me origjinë orientale. Ata janë Ilirë të lashtë (ose Thrako-Ilirë) të vendosur në Azinë e Vogël. (fq. 515)

Megjithatë, tipari vendimtar, që shënjon para së gjithash popullsinë Ilire në fjalë, është sigurisht gjuha e saj. Kjo gjuhë është në thelb Indo-Evropiane. Duket se ajo nuk ka munguar të huazojë shumë elemente nga gjuhët e Anadollit dhe të Kaukazit, por ajo është depërtuar prej këtyre prurjeve të jashtme më pak se Hittitishtja dhe Armenishtja. Për më tepër ajo na ka treguar analogji të shumëfishta me gjuhët Balto - Sllave. Pra, vatra e saj mund të vendosej vetëm në një rajon që përfshihej midis Danubit dhe Karpateve. (fq. 516)

SHABAN DEMIRAJ

"EPIRI, PELLAZGËT, ETRUSKËT DHE SHQIPTARËT"

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, *INFBOTUES,*
Tiranë 2008.

...

Ajo (Gjuha Pellazge – *Shënim B.P.*), si në Armenishte, i ka çaspiruar bashkëtingëlloret mbylltore të zëshme të aspiruara dhe mbylltoret e zëshme i ka shndrruar në të pazëshme, kurse mbylltoret e pazëshme i ka kthyer në të aspiruara. "Pellazgjishtja jep vetëm një shembull të një Indoeuropianishteje të pazëshme të aspiruar: *th,* e cila ruhet si e tillë ashtu si në Armenishte" (po aty fq.13 - e ka fjalën për veprën "Le Pelasgique" të Van Vindekens – *Shënim B.P.*). (fq. 32)

Për më tepër, në mesjetë në disa qarqe Europiane emri Epirot-ë është përdorur edhe për të emërtuar Arbëreshët a Shqiptarët në përgjithësi, por ata atëhere zakonisht njiheshin me emrin Arbënese a Albanese, që e ka burimin tek emri i fisit Ilir të Arbanëve a Albanëve të Shqipërisë së mesme, që përmend edhe Ptolemeu në shek. e dytë të erës sonë. (fq. 53)

Shaban Demiraj
(Lindur: 1 Janar 1920, Vlorë, Shqipëri)
(Vdekur: 30 Gusht 2014)

EQREM ÇABEJ

"HYRJE NË INDOEUROPIANISTIKË" (Leksionet e Prishtinës)

Botimet *"Çabej",*
Tiranë 2008

Duke ardhur më nga perëndimi, në jug të Kaukazit, në Armeni flitet *Armenishtja.* Armenët nga sa duket janë me burim Europian. Vetë Herodoti thotë se Armenët rrjedhin nga Frigasit e Azisë së Vogël. Ata duhet të jenë shpërngulur në Armeni aty nga shekulli i shtatë para epokës së re. Armenishtja ka dy perioda të traditës së shkrimit. Njera është *Armenishtja e vjetër,* afërsisht e shekullit V-VI të erës së re, të kohës së Justinianit, me shkrime më fort fetare, kronika historike, etj, dhe *Armenishtja e re* në shek. XV e këtej. Ndërkaq shkrimet e gjuhës kishtare edhe sot nuk përdoren në Armenishte të re, aty ruhet tradita e Armenishtes së vjetër.

Siç thamë, Herodoti thotë se Armenët rrjedhin prej Frigasvet. Vërtet ka njëfarë afërie ndërmjet Armenishtes dhe Frigishtes, veçse kjo nuk mund të përcaktohet, për shkak se Frigishtja është një gjuhë e vdekur dhe Armenishtja një gjuhë e gjallë. (fq.62, 63)

Eqerem Çabej
(Lindur: 6 Gusht 1908, Gjirokastër, Shqipëri)
(Vdekur: 13 Gusht 1980, Romë, Itali)

ROBERT D'ANGELY

"ENIGMA, NGA PELLAZGËT TEK SHQIPTARËT"

"Botimet TOENA"
Tiranë, 1998

Botuar për herë të parë: Francë, 1962

ALBANËT DHE IBERËT E KAUKAZIT

Këto dy popullsi Pellazge të pastra i kanë bërë fort kureshtarë gjuhëtarët dhe etnologët e të gjithë botës. Dhe nuk mund të ndodhte ndryshe, po të mbajmë parasysh se, duke u nisur nga hipoteza e një prejardhjeje të vetme të njeriut, p.sh nga Pamiri dhe një loje të dyndjeve të njerëzimit, që është krejt në kundërshtim me atë që ka ndodhur në realitet, - d.m.th. që kurrë nuk ka pasur Indoeuropianë ose Indogjermanë, që do të kenë emigruar nga India drejt Europës, por që ka pasur Pellazgë, Argë, ... ose Arias, të cilët duke u nisur, përkundrazi, nga Europa drejt Azisë, kanë pushtuar Indinë dhe i kanë kthyer në Ariase popullsitë e saj dhe kanë krijuar kastat e saj, - nuk do të shpjegohej ekzistenca e këtyre popujve, të izoluar në këtë drejtim.

Kështu, emri Albani, të cilin gjeografët e lashtë i japin një vendi në Kaukazin Lindor, atje ku sot gjendet Republika Socialiste Sovjetike e Dagestanit (vendi i maleve), nuk është vënë kot dhe rastësisht. (fq. 62)

Edhe Straboni (XI, 4-1-10) e ka përshkruar këtë vend si të përbërë nga lugina e madhe dhe e bukur e lumit *Kuro,*... Në veri të kësaj

lugine ngrihen malet e Kaukazit dhe në jug shtrihet Armenia. (fq. 63). Është vënë re se shkrimi ideografik i Kretës i ngjet në mënyrë të habitshme shkrimit ideografik të Hittitëve në Azinë e Vogël, që njihet gjithashtu nga Dhjata e Vjetër dhe që mbishkrimet kunjore Asire e japin tashmë për vitin 3000 para Krishtit se përbënte një perandori të madhe e të gjerë, që shtrihej nga Armenia deri në Siri. Po ashtu, nga ana tjetër, Homeri citon një popull Eteokretas në Kretë, dhe me të drejtë e kanë marrë këtë emër Eteokretas se shënon Heteenët, Hetheenët ose Hittitët. Lidhur me këta të fundit ne e dimë, se në Armeni, ku ata formonin mbretërinë Vanien ose të liqenit Van, ata kishin në veri si fqinjë Albanët dhe Akejtë e rajonit të Kaukazit. Veç kësaj, mbishkrimet Asirase na mësojnë se Kilikiasit, Likaonët dhe Likiasit, popuj të Azisë së Vogël, një pjesë e të cilëve zbarkoi gjithashtu në Kretë dhe Greqi me emrin Pellazgë, janë popuj Hittitë. Si rrjedhim, Hittitët dhe Pellazgët nuk janë gjë tjetër, veçse i njëjti popull me dy emërtime të ndryshme, gjë që gjithnjë ka qenë e zakonshme. (fq. 172-173).

Pra nga njera anë Hittitët e Armenisë afrohen – gjeografikisht dhe gjuhësisht të paktën – me Albanët e Kaukazit, dhe nga ana tjetër, Eteokretasit ose Hittitët kretas afrohen me Albanët e Ilirisë së lashtë, d.m.th. me Shqiptarët e sotëm. (fq. 174).

Për të konfirmuar faktin, që Shqiptarët toskë të sotëm ua detyrojnë emërtimin e tyre Etruskëve, të cilët erdhën nga Italia për t'u vendosur në këtë krahinë, të quajtur me të drejtë Toskëni, kemi emërtimin e ndryshëm të gjysmës tjetër të Shqiptarëve. Në të vërtetë për të përballuar ose për t'u kundërvënë këtyre toskëve të imigruar në Shqipëri, kjo gjysmë tjetër e Shqiptarëve, duke qenë *rrënjës,* u quajtën GEGË, prej fjalës greke Γηγενης, që do të thotë indigjen, kurse krahina: GEGËNI-A.

Një provë tjetër se Shqiptarët toskë janë pasardhës të Etruskëve të lashtë të ardhur nga Italia, për t'u vendosur në Shqipërinë jugore, pikërisht në disa rajone nga ato, që Pal Emili tashmë i kishte shkretuar në vitet 168 – 164 para Krishtit, është fakti se dialekti i

tyre, edhe sot, në vend që të jetë më afër me atë të Greqisë dhe në kontakt me të, megjithatë i shëmbëllen shumë më tepër latinishtes se sa greqishtes së vjetër; ndërsa dialekti gegë, i cili ndonëse ka qenë i shkëputur nga kontakti me Greqinë nga krahinat ku pikërisht flitet dialekti toskë, i ngjet më shumë greqishtes së vjetër se sa latinishtes. Ky vëzhgim dhe ky konstatim nuk do të mund të bëheshin, nëse këta shqiptarë, të quajtur sot toskë, nuk do të ndodheshin atje, në rajonet që zenë, qysh prej antikitetit të largët, siç është rasti për gegët. (fq. 221).

Armenët janë një popull Mesopotamas. Nëse gjuha e tyre çfaq ngjashmëri me gjuhë të tilla, si Shqipja, Sanskritishtja, Greqishtja e të tjera, ky fakt nuk ka asgjë të veçantë, për shkak të kontakteve dhe marrëdhënieve të të gjitha llojeve, që populli Armen ka pasur që në origjinë me Argienët e ekspeditës së parë Ariane ose Pellazge drejt Indisë. Na mjafton si provë e këtij kontakti ose e marrëdhënieve të Armenëve me Shqiptarët ndikimi i gjuhës së këtyre të fundit, që ka ushtruar lidhur me përdorimin e nyjes që vihet pas emrit. Ky ndikim i nyjes së pasme të Shqipes është ushtruar edhe mbi Rumanishten dhe Bullgarishten.

Qoftë nëse kanë ardhur nga pllaja e Pamirit, qoftë nëse janë pasardhës të Jafetit, qoftë nëse e kanë origjinën nga Frigët, që bënin pjesë në Pellazgët e lashtë, të ekspeditës së parë drejt Indisë, Armenët e sotëm janë rezultat etnik i këtyre tre elementëve, të përzier me një element të katërt primitiv, i cili tashmë gjëndej, që nga antikiteti më i largët, në viset e Armenisë. Përzierja e tyre me Persët dhe feja e tyre e sektit të Ariusit heretik, na shpjegon përse dijetarët nuk kanë bërë dallimin ndërmjet Ariasve nga pikëpamja fetare (d.m.th.: pasues të Ariusit 325 pas Krishtit), dhe Arianëve të racës primitive të bardhë.

Për të provuar rëndësinë e madhe të elementit Frigas tek Armenët, ne do të japim këtu atë që ka shkruar Herodoti (VII, 73) për këtë çështje: "po ashtu Frigasit, ashtu siç thonë Maqedonasit (d.m.th. Albanët, si në Europë edhe në Albaninë e Kaukazit), quheshin Brigë (Brygë), ndonëse ishin Europianë dhe fqinjë të Maqedonasve; por

kur u nisën për në Azi e deri sa arritën gjithashtu e ndryshuan emrin në Frigas". Janë këta Frigas, gjuha e përditëshme e të cilëve ka qenë Shqipja, të cilët kanë ndikuar shumë mbi gjuhën Armene.

Meqë ne flasim për Frigasit si raca primitive, që hyri në përbërjen e popullit Armen, ... (fq. 234).

Mund të thuhet, se Armenët e kanë prejardhjen nga Trakët dhe Maqedonasit, d.m.th. nga Europianë të lashtë, po gjithashtu nga popuj Mesopotamas. (fq. 236).

Në fakt, studimi i thelluar i Shqipes, i Greqishtes dhe i Latinishtes bën të dalë qartë, se marrëdhënia e afërisë që i lidh, është ai i nënës për Shqipen, dhe i bijave për dy të tjerat: Greqishten dhe Latinishten. (fq. 277).

Robert d'Angely

(Lindur: 1893, Paris, Francë)

(Vdekur: 1966, Paris, Francë)

LUIGI LUCA CAVALLI-SFORZA

"GJENET, POPUJT DHE GJUHËT"

Punime të referuara gjatë viteve 1981-1990, Francë

Përkthyer nga origjinali prej: Agim Doksani

Besa, 2012

Njeriu tirolez i Epokës së Bronzit ka treguar se është i ngjashëm me njerëzit modernë të rajonit, pasi në këtë zonë nuk ka pasur imigracion të madh nga vende të largëta pas Epokës së Bronzit. (Fq. 50)

Meqë të gjithë njerëzit e tokës kanë origjinë të përbashkët, mund të themi se të gjithë rrjedhin nga e njëjta popullsi, që është rritur në numër dhe ka filluar të përhapet dhe të copëzohet, duke u shpërndarë nga pika e origjinës. (Fq. 78)

Sot është vërtetuar se europianët janë pasardhës të afrikanëve dhe orientalëve. Nëse kërkohen përqindje më të sakta, rezulton se përzierja është e përbërë nga dy të tretat prej popullsive të Lindjes së largët dhe një e treta nga popullsi me prejardhje afrikane. Kur duhet të ketë ndodhur kjo përzierje? Të dhënat bëjnë fjalë për një epokë mjaft të lashtë, rreth 30 000 vjet më parë. (Fq. 104)

Është e vërtetë që analizat e migrimeve, për të cilat do të flasim në kapitullin e ardhshëm, kanë treguar se një pjesë e rëndësishme

e gjeneve tona vijnë nga Lindja e Mesme, një rajon i botës, që nuk është, gjenetikisht, i ndryshëm nga Europa. (Fq. 105)

Në Afrikë gjenden dy zona të rëndësishme përzierjeje me kaukazoidët. E para është Afrika e Veriut, që ka patur kontakte të mëdha më Europianët, nëpërmjet Suezit dhe Mesdheut. E dyta është Afrika Lindore, që ka patur shumë shkëmbime me Lindjen e Mesme dhe me Arabinë, për të cilat ekzistojnë prova të shumta historike. (Fq. 153)

Ekspansioni i parë në Azi ka të ngjarë të jetë bërë nga bashkësitë kurgan, që ndodheshin në verilindje të Kaukazit dhe Detit Kaspik, rreth 5000 vjet më parë, duke kaluar nëpër Turkmenistan, Afganistan, Iran, Pakistan dhe Indi. Ky ekspansion ndihmoi në zhdukjen, rreth vitit 1500 para erës së re, të qytetërimit të luginës së Indit (qytetet më të njohura këtu ishin Harappa dhe Moenjo-daro). Edhe në Mesopotami, në të njëjtën periudhë, kishte dinasti të lidhura me indoeuropianët: është fjala për mitanët. Ato ishin popullsi kaukazoide, që flisnin gjuhë indoeuropiane dhe, gjatë dy mijëvjeçarëve të fundit para erës së re, sunduan stepat dhe malet e Altait. (Fq. 157-158)

Barinjtë që okupuan subkontinentin Indian u quajtën arianë. Ata ndërtuan një shoqëri kastash, me endogami të ngushtë dhe me një hierarki të rreptë, të përcaktuar nga pushteti fetar.Në tërë shtetet e Indisë, kasta më e lartë është ajo e brahmanëve, priftërinj-filozofë me prejardhje ariane. (Fq. 162)

Në rastin e Europës mund të vërehet ky rregull. Ekspansioni i parë, ai neolitik, i nisur nga Lindja e Mesme, ka filluar 9500 vjet më parë dhe ka zgjatur 4000 vjet.I dyti ka ndodhur ndoshta më vonë, edhe pse nuk ka të dhëna arkeologjike e gjuhësore të sigurta mbi origjinën e familjes së gjuhëve uralike. Për Europën, ndikimet uralike janë bërë 2000 vjet më parë, por ka të ngjarë që të jenë më të vjetra. Ndërsa origjina e kurganëve është më e vonë se ajo neolitike; mund të ketë filluar rreth 5000 vjet më parë dhe ka përfunduar në fund

të Perandorisë Romake. Migrimet nga Greqia kanë filluar 2800 deri 4000 vjet më parë. (Fq. 163)

Sot në botë fliten rreth 5000 gjuhë. ... Që në shekullin e XVIII ishte vënë re që gjuha indiane klasike, sanskritishtja, ngjason me gjuhët europiane të lashta dhe moderne. (Fq. 168-169)

Para se t'a lë çështjen e klasifikimit gjuhësor, dua të nënvizoj faktin se ekzistojnë pesë a gjashtë gjuhë, që nuk kanë gjetur vend në shtatëmbëdhjetë familjet e Ruhlenit (dhe në asnjë klasifikim). Një nga këto gjuhë të "izoluara", e njohur për ne, është gjuha baske. ... Disa gjuhëtarë vërejnë ngjashmëri midis gjuhës baske, kaukazike, gjuhëve sinotibetiane dhe nadene (Amerika e Veriut). Mbi baza që nuk marr përsipër t'i gjykoj, Ivanovi pohon se edhe gjuha sumere, etruske dhe të tjera gjuhë të zhdukura ishin të së njëjtës familje, një familje e lashtë që shtrihej në veriun e Europës dhe të Azisë. (Fq. 177)

E dimë se ka patur lidhje shumë të ngushta mes arabëve dhe afrikanëve në Etiopi në mijëvjeçarin e parë para erës së re dhe në mijëvjeçarin e dytë para erës së re; aty ka pasur një perandori arabo-etiopiane, që në fillim kishte si kryeqytet Saban (në Arabi) dhe më pas Aksumin (në Etiopi). (Fq. 183-184)

Megjithëse koncepti i ri i përhapjes leksikore është promovuar kohët e fundit, nuk është traditë e gjuhësisë ta shtrijë këtë koncept në dukuri të njohura prej dy shekujsh. Një shembull tipik i korrespondencës së tingujve është ligji i Grimmit, sipas të cilit shkronjat p, t, k, të gjuhëve më të lashta, si p.sh. sanskritishtja, greqishtja apo latinishtja, në anglisht janë bërë f, th, h dhe në gjermanisht f, d, h. Në anglisht rregullat e shkrimit janë përcaktuar para Rilindjes dhe para një ndryshimi të rëndësishëm në ndryshimin e zanoreve, që filloi në periudhën e fundit të Mesjetës. (Fq. 252-253)

EDWIN JACQUES

"SHQIPTARËT. HISTORIA E POPULLIT SHQIPTAR NGA LASHTËSIA DERI NË DITËT E SOTME''

"Kartë e Pendë", Fondacioni Abraham Linkoln
Tiranë, 1996

Vetëm gjatë periudhës së bronzit të vonë (rreth viteve 1500 – 1100 B.C.E.) kushtet ekonomiko – shoqërore bënë të mundur themelimin e komuniteteve të para të mëdha fisnore, që më vonë do të njiheshin si Ilirë. (fq. 24).

Troja e pasur u shkatërrua aty rreth viteve 1250 B.C.E., …(fq. 24).

Që këtej e tutje burimet tona historike demonstrojnë vazhdimësinë përmes shekujve nga këta stërgjyshër Pellazgë e Ilirë deri tek Shqiptarët e sotëm. (fq. 29).

Etimologjia – *gjurmimi i prejardhjes së një fjale në gjuhën e origjinës, zhvillimi i saj nëpër vite si dhe transmetimi i saj nga një gjuhë në një tjetër.* (fq. 35).

Shënim B.P. Duke folur për gjuhëtarin gjerman Franz Bop (1791 – 1867) Jacques thotë:

Ai vërejti ngjashmëri midis fjalorit të Shqipes, nga njera anë, dhe atij të Armenishtes ose të gjuhëve balltike, Letonishtes dhe

Lituanishtes nga ana tjetër,... Bopi e botoi veprën e tij më 1854, duke vërtetuar përfundimisht se Shqipja bën pjesë në familjen e gjuhëve Indoeuropiane dhe nuk rrjedh nga ndonjë gjuhë tjetër simotër në kontinent, si edhe Greqishtja. (fq. 36).

Një tjetër është anglezi Jozef Suajer, i cili më 1929, pas pesë vjet kërkimesh të gjithanëshme në Shqipëri e gjetkë, botoi librin e tij "Shqipëria: Lindja e një mbretërie". Ai arriti në përfundimin se *raca Shqiptare e ka prejardhjen nga emigrantët e hershëm Arianë*...(fq. 39).

Emri kombëtar Albania ka ardhur prej fjalës "Albanoi", një fis Ilir që përmendet nga gjeografi Ptoleme i Aleksandrisë rreth vitit 150 C.E. (fq. 42).

Në të vërtetë është pohuar se "çdo alfabet i botës së qytetëruar e ka prejardhjen nga alfabeti Fenikas" (fq. 46).

Van Vindekens arriti në përfundimin, se Grekët, Ilirët dhe Italianët nuk mund të kenë qenë Indoeuropianët e parë, që u vendosën në Europën Jugore dhe në Azinë e Vogël. ... Autori është i bindur se Pellazgët u larguan nga djepi i tyre Indoeuropian në të njëjtën kohë me Hittitët, shpërngulja e të cilëve sigurisht që i parapriu asaj të Grekëve. (fq. 48).

Çuditërisht ky diagram tregon se ndër 47 gjuhë moderne me bazë *Indoeuropiane, vetëm dy prej tyre, Shqipja dhe Armenishtja, kanë një prejardhje të drejtpërdrejtë nga Indoeuropianishtja, pa ndonjë prind të ndërmjetëm gjuhësor.* (fq. 48).

Kjo i bëri studjuesit që, logjikisht, ta përcaktonin qendrën apo bazën Indoeuropiane përreth maleve të Kaukazit apo Uraleve. (fq. 49).

Gjuhët më të vjetra Indoeuropiane të shkruara, të dëshmuara rreth vitit 1400 B.C.E., ishin Hittitishtja, Sanskritishtja, gjuha Mikenase dhe Greqishtja[1]...

... Kjo do të thotë se Indoeuropianët si folës të një gjuhe të përbashkët, datohen rreth vitit 4000 ose 5000 B.C.E. (fq. 50).

Dionisi i Halikarnasit (historian Grek i shek I^{rë} B.C.E.).

Ai deklaroi se Shqiptarët, ashtu si shumica e popujve të lashtë, erdhën nga Eufrati dhe Gangu. Ata u vendosën në brigjet e detit Kaspik dhe në malet e Kaukazit, që më vonë u quajtën Armeni, ku jetuan si blegtorë dhe luftëtarë. Në Azi njiheshin si Albanë; trevat e tyre tregoheshin në hartat e kohës si Albania, kurse grykat shkëmbore të maleve të Kaukazit quheshin "Portat Albane". (fq. 55).

Straboni i përmend shumë Pellazgët e Kaukazit, të cilët i quan Albanë. (fq. 57).

Një varg aluzionesh të vjetra historike e poetike për Pellazgët përkojnë fare mirë me përfundimet e arkeologëve e gjuhëtarëve të sotëm. Edhe pa u përpjekur të bëjmë një vlerësim apo harmonizim të dorëshkrimeve të vjetra, në to vërehet një rregullsi e përgjithëshme. Pellazgët parahistorike bënin pjesë në familjen Indoeuropiane të kombeve. Në të kaluarën e largët këta popuj banonin në kufirin midis Europës dhe Indisë. Ata të gjithë flisnin gjuhë të njëjtë. Bënin një jetesë primitive si nomadë në tenda, merreshin me rritjen e dhive, mbledhjen e frutave, peshkim e gjueti kafshësh të egra për ushqim dhe veshje. Me sa duket, aty rreth viteve 3000 B.C.E., ndodhi një shpërbërje e madhe, që i shpërndau këto familje fisnore në mënyrë centrifugale në të gjitha drejtimet. Nga burimi Arian u bë një shpërngulje në jug për në Indi; ndërsa të tjerët u shpërngulën nga ky djep Indoeuropian i njerëzimit drejt perëndimit. Më e saktë do të ishte shprehja, që ata "depërtuan" në perëndim, pasi dihet se "popujt shtegtojnë shumë ngadalë, kur nuk e dinë se ku po shkojnë".

Disa prej këtyre fiseve mbetën në malet e Kaukazit, ku njihen me emrin Albanë. Historianë të mëvonshëm do të vinin në dukje se si u përfshinë në perandorinë Perse Albanët kaukazianë, si luftuan kundër farefisit të tyre, Aleksandrit të Madh, dhe si u gjetën midis pengjeve, që Pompei fitimtar mori me vete në Romë. Pas pushtimit nga fisi Turk i Selxhukëve, më vonë, ata u asimiluan nga Rusia cariste dhe u zhdukën për fare nga faqja e historisë. *Megjithatë, gjuhëtarët* vërejnë disa ngjashmëri midis *Shqipes dhe Armenishtes.* (fq. 63, 64).

Megjithatë, pas Grekëve dhe Dorëve, në Ballkan u dyndën fise të tjera Indoeuropiane. Midis tyre ishin Frigasit dhe Armenët. Rreth vitit 1200 B.C.E. ata kaluan Helespontin dhe u hodhën në Azinë e Vogël, duke zhdukur nga faqja e dheut Hittitët e lashtë. Etruskët, Siçilianët dhe Sardenjasit u larguan nga Azia e Vogël dhe shumë prej tyre u vendosën përgjatë bregut perëndimor të Italisë. (fq. 69).

Gjuha Shqipe dhe Shqiptarët kanë lidhje me Keltët dhe gjuhën Kelte. (fq. 80).

[1] (*Shënim B.P. :* Në pikëpamje kohore, përsa i përket Greqishtes, kjo do parë??)

KRISTO FRASHËRI

"ETNOGJENEZA E SHQIPTAREVE"

Vështrim historik

Botimet *"M&B"*, Tiranë 2013

Monografia[1] mbyllet me shfaqjen në vitin *1043* në fushën e dokumentacionit historik, të emrave *Arbër* dhe *Albani* si apelativa krahinorë dhe shndrrimin e tyre më vonë në emërtime kombëtare. (fq. 7).

Problemi i gjenezës së Shqiptarëve u shtrua në një bazë më shkencore kur nga fundi i shek. të XVIII (18^{të}) filluan vëzhgimet e para, të cilat treguan se midis shumicës së popullsive të sotme dhe të vjetra të Europës (Grekëve, Latinëve, Sllavëve, Gjermanikëve), dhe të disa popullsive të Azisë (Iranikëve, Indianëve, *Armenëve*), ekzistonin afërsi dhe lidhje të tilla, që dëshmojnë për një origjinë të përbashkët. U arrit kështu në përfundimin, se këto popullsi rridhnin nga një trung i vetëm etnik (trungu *Arian*) dhe nga një gjuhë mëmë e përbashkët (gjuha e lashtë *Indoeuropiane*), të cilët më vonë u ndanë në kombësi të veçanta dhe gjuhë të veçanta. (fq. 12).

Argumenti, që kanë përdorur disa albanologë, se Shqiptarët janë pasardhës të Ilirëve vetëm për faktin se emrin e tyre mesjetar *Albanë*

[1] *Shënim B.P.:* Bëhet fjalë për monografinë e Prof. Muzafer Korkuti

apo *Arbër* e ka mbajtur fisi ilir *Alban* (Albanoi), i cili sipas gjeografit aleksandrin të shek. II[të] Klaud Ptolemeu, banonte në trevën midis Durrësit dhe Dibrës, nuk është pa vlerë. Por si argument vendimtar është i pamjaftueshëm. (fq. 13).

Meqenëse gjuha Ilire deri sot ka mbetur e panjohur në tërësinë e saj, vërtetimi se Shqipja është bijë e saj është ende në diskutim. (fq. 16).

Emrat e popullatave që banonin në periudhën e Neolitit[2] të vonë në hapësirën e sotme shqiptare nuk i njohim, pasi asnjë burim i shkruar nuk i zë ato në gojë. Interesimi, se cilat qenë këto popullata dhe nëse ato bënin pjesë në një grup të përbashkët etnogjuhësor me popullatat e tjera të pellgut mesdhetar, filloi afërsisht 200 vjet më parë.

Orvajtjen e parë e filloi filologu gjerman Karl Vilhelm von Humboldt (1767 – 1835). Ai vërtetoi se popullsitë Baske, që sot banojnë në shpatet e Pirenejve, në veriperëndim të Spanjës dhe në jugperëndim të Francës, janë pasardhës të Iberëve të lashtë. *Tashmë është provuar se si Baskët, si Iberët nuk i përkasin familjes etnogjuhësore Indoeuropiane, ku bëjnë pjesë shumica e popullsive të sotme të Europës.* Duke gjykuar nga stërlashtësia e Baskëve, mendohet se ata janë ashkla të grupit etnik jo-Arian, pra jo-Indoeuropian, por para-Indoeuropian. Për këtë arësye, gjuha e tyre së bashku me disa të dhëna të kulturës së tyre materiale, hodhi dritë edhe mbi popullatat e tjera të stërlashta para-Indoeuropiane, që banonin në Europën jugore. Më 1836 dijetari freng Antoine d'Abbadie (Antuan d'Abadi), vuri re afrinë gjuhësore midis Baskishtes dhe gjuhëve Kaukaziane.

Mjaft dijetarë e përkrahën këtë tezë. Rezultati më i rëndësishëm u arrit kur shkencat shoqërore mundën të shihnin lidhjen gjenetike jo vetëm të Baskishtes me Kaukazishten, por edhe me gjuhët e fiseve jo-Indoeuropiane, që banonin në brigjet e Mesdheut. Në bazë të

---

[2] *Shënim B. P.:* Neoliti i vonë – (4 000 – 2 500 p.e.s.);
Eneoliti – (2 500 – 2 000 p.e.s.);
Bronzi – (2 000 – 1 000 p.e.s.);
Hekuri - (që nga fillimi i viteve 1 000 p.e.s.)

këtyre gjurmëve u formua bindja se këto popullata, që kanë banuar në brigjet jugore, lindore dhe veriore të Mesdheut, bënin pjesë në një familje të përbashkët etnogjuhësore, të cilën Hommeli, në dallim me grupin Indoeuropian, e quajti grupi ose familja Alarodike. Në fund të shek. 19 [të] antropologu italian Giuseppe Sergi (Xhuzepe Serxhi), me anë të matjeve të kafkave të banorëve të lashtë të kësaj treve, vuri re se ato kishin afri midis tyre dhe se i përkisnin të njëjtës racë – një racë e ndryshme nga ajo e popujve Indoeuropiane. Banorët e këtyre popullatave qenë shtatmesatarë, flokëgështenjë, syzinj, ndryshe nga popullatat Indoeuropiane, të cilët në përgjithësi janë shtatlartë, flokëverdhë dhe sykaltëroshë. Në mbështetje të këtij konstatimi, antropologu Serxhi këto popullata i quajti pjestarë të grupit etnogjuhësor mesdhetar, emërtim të cilin e kanë pranuar pothuajse të gjithë dijetarët e kësaj fushe. Më 1902 gjuhëtari italian Alfredo Trombetti vërtetoi përfundimisht lidhjen gjuhësore midis Baskishtes dhe Kaukazishtes. Më vonë A. Trombetti, në veprën e vet mbi prejardhjen e gjuhës Baske, mbrojti pikëpamjen se lidhja gjuhësore midis Baskishtes dhe Kaukazishtes nuk ishte rezultat i kontakteve, por i prejardhjes gjenetike. (fq. 37 – 38).

Vetëm dy prej tyre[3] mbijetojnë në ditët tona – në perëndim Baskët, me gjuhën e tyre Baskishte në shpatet e Pirenejve, kurse në lindje pasardhësit e Kaukazianëve të stërlashtë, dialektet Kaukazishte të të cilëve fliten edhe sot në Kaukazin jugor. (fq. 38 – 39).

Kjo nuk e përjashton mundësinë, që ilirët Indoeuropianë të kenë bashkëjetuar ose të paktën të kenë pasur marrëdhënie me popullatën mesdhetare të Neolitit të vonë përpara se kjo popullsi të jetë asimiluar nga ardhacakët ose të jetë larguar gjetkë. Për të sqaruar këto lidhje, dijetarët filluan të hetojnë afritë, që mund të ekzistonin ndërmjet *Shqiptarëve* dhe dy popullatave me origjinë mesdhetare, që mbijetojnë edhe sot, *Baskët dhe Kaukazianët.*

[3] *Shënim B.P.:* Bëhet fjalë për popullatat e grupit etnogjuhësor mesdhetar

Përçapjet e para u bënë në vëzhgimin e lidhjeve të mundshme midis Shqiptarëve dhe popullatave Kaukaziane. Kjo për arësye se në trevën ku banojnë folësit e Kaukazishtes në Antikitet bënte pjesë edhe një vend që quhej Albania, emër tepër i ngjashëm me emrin Albania, që edhe sot e përdorin të huajt për Shqipërinë tonë. Si rrjedhim nuk është pa vend të thuhen disa fjalë për Albaninë e Kaukazit.

Popullsia e trevës Albania e Kaukazit banonte në hapësirën e sotme të Azerbaixhanit, në brigjet e Detit Kaspik, fqinj me territorin e Armenisë dhe Dagestanit. ... Ata u bënë të njohur sidomos gjatë luftërave që zhvilluan kundër legjioneve romake, kurse emri i tyre zhduket përfundimisht nga lëmi i historisë me pushtimin në shek. e VII[të] të kësaj treve nga arabët. ... ata qenë të ndarë në 60 fise. Ndarja e tyre ishte aq e thellë, sa edhe gjuha e tyre ishte e ndarë në një shumicë dialektesh.

Straboni thotë se në vargmalin e Kaukazit fliteshin 70 gjuhë, kurse vetëm në trevën e Albanëve 22. Gjuhëtari i njohur rus N. J. Marr në veprën e vet rusisht për gjuhët e Kaukazit, ka nxjerrë përfundimin se gjuha e Albanëve të Kaukazit përfaqëson elementin e tretë etnik në formimin e qytetërimit mesdhetar. Ka pasur gjuhëtarë, që mendonin se Shqipja e Ballkanit e ka origjinën nga njera prej dialekteve të shumta të Albanëve të Kaukazit. Ngjashmëria e emrit të të dy vendeve ka nxitur me kohë përpjekje për të gjetur një lidhje midis Albanëve të Kaukazit dhe Albanëve (Shqiptarëve) të Ballkanit. (fq.39 – 40).

Në orvajtjet për të ndriçuar lidhjet e mundshme midis Albanëve të Kaukazit dhe Albanëve të Ballkanit mori pjesë edhe arbëreshi i Italisë Francesko Tajani, ... Ai u orvat të zbulonte nëpërmjet legjendave dhe shënimeve biblike dhe faraonike gjurmë lidhjesh të Shqiptarëve të Ballkanit me Albanët e Kaukazit, fqinjë të Armenëve. (fq. 40).

Në bazë të argumentave që parashtroi, ai shfaqi pikëpamjen se midis Albanëve të Ballkanit dhe Albanëve të Kaukazit kishte afri gjenetike, me fjalë të tjera, të dy këta popuj dikur përbënin një trung të vetëm

etnik. Si rrjedhim, ai mendonte se këtë trung historia e kishte ndarë në dysh, duke lënë njerën pjesë në Gadishullin Ballkanik, pjesën tjetër duke e degdisur në hapësirën e Kaukazit. Por argumentet, që parashtroi historiani arbëresh, nuk patën fuqi bindëse në rrethet e dijetarëve. Para së gjithash, sepse ato mbështeten mbi legjenda dhe hamendësime. Veç kësaj, fakti se Albanët e Kaukazit i përkisnin grupit gjuhësor Jafetik, pra mesdhetar, kurse Shqiptarët e Ballkanit, sikurse e ka vërtetuar me kohë gjuhëtari gjerman Franz Bopp (Franc Bop, 1791 – 1867), grupit etnogjuhësor Arian, pra Indoeuropian, e përjashton mundësinë e lidhjeve gjenetike midis tyre. Më në fund, pikat e takimit të disa fjalëve të gjuhës Kaukaziane me gjuhën Shqipe, në fakt me dialektin Arbëresh të Italisë, që ai ka marrë për bazë, nuk janë bindëse.

Përsa i përket ngjashmërisë së emrit gjeografik Albania e Kaukazit me atë të Ballkanit – nuk duhet detyrimisht të shpjegohet me përkatësinë e tyre në të njëjtën etni, sikur njeri grup u shkëput nga tjetri. Sipas N. Joklit dhe të tjerëve, rrënja Alb – e përbashkët në të dy emërtimet etnogjeografike i përket gjuhëve të popullsive të stërlashta para-Indoeuropiane, pra mesdhetare. Në atë gjuhë të stërlashtë kishte kuptimin *"lartësi", "mal i lartë".* Me këtë kuptim fjalën *alb* (mal i lartë) e kanë huazuar popullatat e mëvonshme Indoeuropiane, duke e shndrruar edhe në emërtim të përveçëm, si Alpet e Zvicrës, Alpet e Italisë, Alpet Dinarike, Alpet Shqiptare dhe mjaft toponimi të botës mesdhetare që kanë rrënjë në fjalën *Alb* dhe *Alp.* Për këtë arësye, teza e F. Tajanit mbeti hipotezë. Madje ajo u la pas dore dhe më vonë nuk u përfill nga askush. (fq. 42 – 43).

Sipas antropologëve, prania e tipit nordik pranë atij mesdhetar që ndeshet në popullsinë e sotme ballkanike, përfshirë edhe në popullsinë shqiptare, është rezultat i përzierjes së dy grupeve etnike – të Indoeuropianëve dhe Mesdhetarëve. (fq. 56).

Me sa dihet, për të parën herë në burimet historike, Pellazgët përmenden në marrëveshjen e paqes nënshkruar në Kadesh në vitin 1296 p.e.s. midis mbretit fitimtar të Hititëve Nurëatallish dhe faraonit të Egjiptit Ramses II. Marrëveshja është nënshkruar në dy gjuhë –

në gjuhën Egjiptiane dhe Babilonase. Në këtë luftë përmenden si pjesëmarrës përkrah Hititëve edhe Pellazgët, të cilët në marrëveshjen e Kadeshit quheshin "njerëzit e detit". (fq. 58).

Ilirët, vazhdon Hahn, nuk arritën në kohën antike të formonin një trung të vetëm etnik. Për shkak të jetës së tyre të veçuar krahinore, ata zhvilluan një jetë të veçuar edhe në fushën politike. Ky veçim e ndau trungun e lashtë Ilir në tre degëzime: në Ilirë, Epirotë dhe Maqedonë. (fq. 83).

Si pikënisje të tezës së vazhdimësisë Iliro – Shqiptare qëndron emri i fisit Albanoi. Siç dihet, emri i fisit Ilir përmendet për të parën herë prej Ptolemeut, gjeografit aleksandrin të shek. II^{të}, si emri i një fisi Ilir që banonte sipas hartës së tij në gjatësinë gjeografike 46^{0} dhe në gjerësinë gjeografike 41^{0} 5', pra në krahinat që ndodhen midis Durrësit dhe Dibrës, të cilat kufizohen pak a shumë prej lumenjve Mat dhe Shkumbin.

Po në këtë trevë të ngushtë përmenden në shek. XI^{të} shqiptarët të quajtur "Arvanitë", "Albanë" nga shkrimtarët bizantinë Mihal Attaliati dhe Anna Komnena... Është e vërtetë se emri i shqiptarëve në trajtën "Albanë" ose "Arbanitë" nuk përmendet shprehimisht në burimet e shkruara pas shek. II^{të} dhe para shek. XI^{të}, por ... (fq. 110).

Ptolemeu përmend pranë fisit të Albanëve edhe qytetin e tyre në trajtën greqishte Albanopolis (qyteti i Albanëve), gërmadhat e të cilit janë zbuluar në fshatin Zgërdhesh, në afërsitë perëndimore të kalasë së Krujës. (fq. 225).

Kristo Frashëri

(Lindur: 17 Dhjetor 1920, Stamboll, Turqi)

(Vdekur: 31 Janar 2016, Tiranë, Shqipëri)

ALEKSANDER MEKSI

ALBANIA E KAUKAZIT DHE SHQIPTARËT

Kopjuar nga botimi në "Univers" 11,
Tiranë 2009

Herë pas here në literaturën shkencore, e jo vetëm në të, shfaqet hipoteza se shqiptarët, aty ku ndodhen sot, kanë ardhur nga Kaukazi. Një hipotezë e tillë shtrohet përpara studiuesve dhe publikut duke u nisur nga përmendja në burimet historike në atë rajon e një territori me emrin Albani. Dukuria nuk është vetëm shkencore, sepse ajo përdoret dhe nga politika. Kështu, në këto 150 vjetët e fundit, kur historia shumë shpesh është në shërbim të politikave nacionaliste afatshkurtër, ajo është keqpërdorur sidomos në Ballkan, ku interesat e shteteve të krijuara më përpara se të tjerët nëpërkëmbnin ato të popujve fqinj, që nuk kishin krijuar ende shtetin e tyre. Nuk kursehen në këtë betejë, gjithnjë të humbur pa e nisur, për të përdorur *"teza"* e *"argumente historike",* për të ngritur teori dhe rivendikime territoriale në dëm të të tjerëve. Një rast i tillë është ai i Nikokles, që në disertacionin e tij rimerr këtë tezë të cilën e hedh poshtë Fallmerayer[1].

Një përdorim të tillë ka dhe ajo për ardhjen e shqiptarëve nga Kaukazi, diku nga shekujt X-XI, me qenë se atëherë përmendemi për

[1] J.Ph.Fallmerayer, *Elementi shqiptar në Greqi,* Tiranë 2003, 95

herë të parë në burimet Bizantine me emrin *albanoi - arbanoi* në trojet e sotme. Përgjithësisht historiografia shqiptare, dhe jo vetëm ajo, e ka refuzuar këtë pseudoteori në mënyrë intuitive, pa i hyrë në brendësi të dhënave historike, që lidhen me *Albanët* e Kaukazit. Për studiuesit shqiptarë me të drejtë ka mjaftuar teza e prejardhjes Ilire dhe autoktonia e shqiptarëve, vazhdimësia e gjuhës dhe të qënit e saj Indoevropiane, gjë që vërtetohet nga shumë disiplina.

Pavarësisht nga sa shprehëm më sipër, për ta quajtur të mbyllur këtë diskutim, na u duk me interes të hetojmë kush janë *Albanët e Kaukazit*[2], ku jetonte ajo popullsi, pra ku shtrihej shteti i tyre, çfarë thotë historia e dokumentuar për ta, gjuhën e tyre dhe cili ishte fati historik i tyre deri në ditët tona.

Përmendja e parë e *Albanisë* dhe e banorëve të saj, *Albanëve,* është në betejën e Gaugamelës në vitin 331 para erës sonë, kur ata u rreshtuan së bashku me Persët kundër ushtrisë së Aleksandrit të Madh[3]. Ata përmenden në burimet si një popull që jeton pranë Armenisë dhe Iberisë (Gjeorgjia e sotme), pra si një entitet politik i rëndësishëm i rajonit të Kaukazit. Për ta ka përmendje të vazhdueshme ndër burimet Greke dhe Romake, por dhe ato Armene, Bizantine, Arabe, që nga shekulli i I^{rë} deri tek shekulli i VIII^{të} e më vonë. E megjithatë, për këtë popull njihen pak gjëra. Ka fare pak dëshmi gjuhësore dhe pak të dhëna arkeologjike (Mingeçam-Azerbajxhan). Në se kanë pasur një literaturë të shkruar, ajo sot është e humbur, kanë mbijetuar vetëm alfabeti dhe pak mbishkrime të fragmentuara e që presin sot e kësaj dite zbërthimin.

Gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit janë kryer mjaftë studime për këto probleme dhe në përgjithësi për historinë e gjuhët e popujve

---

[2] Dokumentacioni historik për ta mund të konsultohet në: K.V.Trever, *Oçerki po istorij i kulture kavkazkoj Albanij,* Moskva-Leningrad,1959 dhe A.H.Akopian, *Albanija-Aluank v greko-latinskih i drevnoarmeiskih istoçnikah,* Erevan 1987.

[3] Strabon,ed. 1873, 409(XI,4.6), Moïse de Khorene, Histoire de l'Armenie, Paris 1993,148. Nga ai mësojmë se vendi i tyre quhej Alvank.

banorë të lashtë të rajonit të Kaukazit, të nxitura këto studime edhe nga probleme territoriale ndërmjet shteteve të krijuara rishtas pas viteve '90. Po kështu, ndërkohë, janë botuar në disa gjuhë burimet historike, si dhe janë studiuar ato në mënyrë krahasuese dhe të përbashkët. Po ashtu, sot nuk mungojnë monografitë për historinë e vjetër të popujve të Kaukazit dhe po aq për Albanët.

Albanët e Kaukazit, si një popullsi dhe shtet, përmenden gjithnjë në burimet historike krahas Armenëve dhe Iberëve (Gjeorgjianët) me emra të ndryshme sipas gjuhës së burimeve:

greqisht - *alvania;*

latinisht - *albania;*

armenisht - *aluank;*

gjeorgjisht - *rani;*

siriane - *aran;*

medo - persisht - *ar(r)an;*

arabisht - *arran* [4)] .

Është gjithashtu me interes e dhëna e Stefan Bizantinit, i cili thotë se ata janë arianoi, me sa duket termi fillestar duhet të ketë qenë *aran,* prej nga nën influencën e Armenishtes kemi *alvan - aluan* nga dhe rrjedh greqishtja *alvanoi. "Çuditërisht"* në të gjitha botimet e burimeve dhe studimet për rajonin, dhe në mënyrë të veçantë në ato për *Albanët* dhe *Albaninë e Kaukazit,* askush, d.m.th. as dhe një studiues, nuk merret dhe as nuk i ka shkuar në mendje që të gjejë lidhje ndërmjet tyre dhe Shqiptarëve, për arsyen e vetme sepse ato as që ekzistojnë.

Për gjuhët e popujve të Kaukazit Straboni thotë se në qytetin

[4] M.Bais, A*lbania Caucasica, Ethnos, storia, territorio attraverso le fonti greche, latine e armene,* Milano 2001, 9. Ky disertacion është një studim me mjaft vlerë për temën tonë.

tregtar Dioskuride (Suhumi i sotëm) fliteshin 70 gjuhë, sepse aq ishin fiset, që bënin tregti aty, shifër kjo, që tjerë e shpien në 300, e më tej akoma, udhëtari arab al-Masudi thotë se janë aq shumë popuj, që vetëm zoti mund t'i numërojë. Për *albanët* Straboni[5] na tregon se ata kanë një mbret, por që janë 26 grupe etnike me gjuhën e vet secili, dhe se nxjerrin nën armë 60000 këmbësorë dhe 22000 kalorës (me kaq përballën Pompeun).

Sot aty fliten gjuhët *Indoevropiane, Altaike, Semitike e Kaukaziane* (me shumë nëngrupe, një prej të cilëve gjuhët *lezge*). Për gjuhën e Albanëve kemi, siç thamë, alfabetin me 52 shkronja, pak mbishkrime, emrat e muajve, fjalë jo Armene në historitë e hershme të Armenëve (shek. VII-X), nga të cilat rezultojnë elementë të gjuhës me studimin e të cilave gjenden lidhje me atë të *Gargark-ve,* duke e futur kështu në grupin e gjuhëve *Lezge* dhe i gjenden lidhje me gjuhën e sotme të etnisë *Udi* që banon sot në dy fshatra: Vartashen dhe Nidzh, jo shumë larg vendbanimit ku janë bërë gërmimet arkeologjike të sipërpërmendura dhe janë gjetur mbishkrimet e gjuhës Albane[6].

Ndër dëshmitë e vjetra për këtë popull kemi *"Historinë e Armenëve"* të Moise Khoren-it[7], ku përmenden faktet e njohura për *Aluan – Alvank,* si dhe fakti, që në kohën e perandorit Theodos (fundi i shek. IV), Mesrop Mashtoc shkon tek Iberët dhe ju krijoi shkrimin, pastaj tek Alvanët pranë mbretit të tyre Arsralen dhe peshkopit Jeremia, ku me ndihmën e përkthyesit, priftit vendas Beniamin, pasi studioi gjuhën e tyre, krijoi për ta shkronjat për këtë gjuhë të Gargark'si, guturale, të ashpër, barbare, të ngjirur[8]. Të njëjtat të dhëna jep dhe historiani i shekullit VII[të], Movses Kalankatuaci, në veprën e tij *"Historia e Aluank",* shkruar

[5] *Po aty,* 23.

[6] Z.Aleksidze, *Novie pamjatniki pismenosti kavkazskoi Albanij,* Hristianski Vestnik, novaja serija1(7), 1994, 5, 7.

[7] M. Khorene, *vep. cit,* 148.

[8] *Po aty,* 301.

në shekullin VII[të] dhe vazhduar në shekullin X[të] nga Movses Daskuranci (mundet kryeprifti i *Aluank*)[9].

Për sa i përket territorit të fiseve të ndryshme (në antikitet ishin 26), që përbëjnë Albanët (Aluank), ai shtrihej, sipas të dhënave të shumicës të burimeve historike, nga shpati jugor i pjesës lindore të vargmalit Kaukaz deri në lumin Kur, që derdhet në detin Kaspik, duke pasur në jug (në territoret në krahun e djathtë të lumit) Armeninë dhe në perëndim Iberinë. Gjatë shekujve shteti i tyre ka pasur shtrirje edhe më të madhe, duke u përfshirë në territore të Armenisë dhe të tjera. Sot këto territore gjeografike bëjnë pjesë në Azerbaixhan.

Së fundi, duhet të flasim për fatin historik të *Aluanëve* (Albanëve të Kaukazit). Ata dalin që në fillim si një etni e rëndësishme në rajon dhe si një bashkëbisedues i rëndësishëm për Romakët, të cilët kuptuan aspektin më karakterizues të tyre si njerëz të kufirit ndërmjet sub-Kaukazisë dhe nomadëve të veriut (Hunët dhe Skithët), çka kontribuoi për dhënien e një rëndësie të veçantë vendit të Albanëve në kontaktet e perëndimit me vendasit. Këto kontakte filluan me Grekët dhe vazhduan me Romën, Bizantin dhe Persët, që ndërkohë zvogëlonin vendin e Albanëve (Aluanve) në rajon, për t'u pasuar me arabët, me të cilët merr fund pavarësia e tyre, gjë që shënon dhe fillimin e një procesi ende të paqartë për studiuesit, atë të çthurjes dhe tjetërsimit kulturalo-etnik, që do t'i zhduki ata si komb nga hapësira e Kaukazit dhe nga skena e Historisë. Persët e sidomos Arabët krijuan njësi administrative më të mëdha, në të cilat Albanët, me gjithë rolin parësor të tyre, nuk qenë në gjendje të afirmohen si komb përtej territorit fillestar të tyre. Në këtë mënyrë shtrirja e nocionit gjeopolitik Aluan-Alban nuk u pasua me mbijetesë në kushtet e pranisë së presionit apo shtytjes ideologjike-kulturore Arabe.

---

[9] Cituar sipas V.A.Arutjunova-Fidanian, *Povestvovanie o dellah Armjanskih VII veka,* Moskva 2004, 91 shën.94. Po kështu po aty,175, përmendet letra drejtuar nga eretikët Abas, katolikonit të vendit Albania.

Nga kjo tablo kuptohet se nuk ekziston as lidhja më e vogël ndërmjet Shqiptarëve (Albanitë-Arvanitë) me Aluanët (Albanët e Kaukazit). Lidhja e tyre ka qënë dhe mbetet e sajuar apo e kërkuar dhe keqdashëse. Aq më tepër kjo, përderisa as dhe një, përsëris këtë, studiues i Aluanëve dhe i popujve të Kaukazit, gjatë më shumë se një shekulli, nuk i ka shkuar në mendje për një lidhje të tillë, sepse realisht ajo absolutisht nuk ka ekzistuar.

Aleksandër Meksi

(Lindur: 8 Mars 1939)

NERMIN VLORA FALASKI

"PELLAZGËT, ILIRËT, ETRUSKËT, SHQIPTARËT"

Shtëpia Botuese *"Faik Konica"*, Prishtinë
(Me një parathënie të Prof. Dr. Skënder Rizaj, Korrik 1998, Prishtinë.)

Sipas Nermin Vlora Falaschi-it, "Stërgjyshërit e Shqiptarëve të sotëm kanë banuar qysh në kohën parahistorike në pjesën më të madhe të botës që njihej aso kohe, me ç'rast kanë zhvilluar një qytetërim shumë të rëndësishëm dhe kanë ngritur vepra me vlera të jashtëzakonshme [...].

Pellazgët, si popull shumë i lashtë, banonin në periudhën parahistorike në Greqi, në Arkipelag, në brigjet e Azisë së Vogël dhe të Italisë [...]. (Fq. 8) *(Shënim i: Prof. Dr. Skënder Rizaj)*

Nermin Vlora Falaschi flet edhe për përkimet ndërmjet gjuhës Etruske dhe Shqipe dhe për fjalët Ilire që gjenden në gjuhën Baske, Izraelite, Palestineze, etj. (Fq. 17) *(Shënim i: Prof. Dr. Skënder Rizaj)*

Sipas anglezit B.D.Hughes (1830) është vështirë të përkufizohet vendi i quajtur tani Albania. Në fillim ishte i kufizuar në trevën e vogël Albanopolis (tani Elbasan) në Iliricum-in Jugor, i cili më vonë u quajt Epiri i Ri. Mirëpo gjatë qeverisjes së pafuqishme të Perandorisë Bizantine emri Albania u zgjerua mbi pjesën më të madhe të Ilirisë (Iliricum) [emërtimi Ilirikum ishte sinonim i emrit Bizantia] dhe të Epirit.

Ç'është e vërteta, Perandoria Bizantine ishte perandori e Ilirëve dhe jo e Grekëve mesjetarë, siç mbizotëron mendimi, sepse në Mesjetë nuk ka pasur grekë-helenë. Grekët-helenët antikë, numri i të cilëve ka qenë i vogël, janë zhdukur qëmoti. Grekët e sotëm janë, në të vërtetë, konglomerat i etnosit Shqiptar, Vllah dhe Turk.

Lordi anglez G.C.B. Broughton (1855), ndërkaq, i dallon albanët evropianë, të cilët jetonin në Ilirinë Jugore, d.m.th. në Albanopolis ose Albasano dhe Albanët aziatikë, të cilët jetonin në Albani (Kaukaz), në mes të Iberisë dhe Detit Kaspik. E prej Albanëve aziatikë, të cilët quheshin edhe Arnavudë doli sinonimi modern Arnavud për gjithë Shqiptarët (pellazgët, ilirët, shqiptarët), pa marrë parasysh se a ishin të Azisë apo të Evropës (1855). (Fq. 21-22) *(Shënim i: Prof. Dr. Skënder Rizaj)*

Vetëm nga një pikë e Pellazgëve, që mbetën pa u asimiluar, u krijua kombi Shqiptar, e kjo pikë ishte nga dega e Ilirëve. (fq. 24) *(Shënim i: Prof. Dr. Skënder Rizaj)*

Emri *"gjerman"* është Ilirisht; ... (fq. 28) *(Shënim i: Prof. Dr. Skënder Rizaj)*

Epoka e madhe e përhapjes së Indoevropianëve [pellazgëve] duhet të ketë qenë para vitit 1200 para Krishtit.

Atëhere, popujt Indoevropianë [pellazgët] mësyjnë Dardanelet (Trojën), rrëzojnë Hatushën (shpartallimi i Hititëve), kalojnë qafën e Kaiberit dhe hyjnë në Penxhab (Indi). (fq. 29) *(Shënim i: Prof. Dr. Skënder Rizaj)*

..., përmes këtyre deftereve *(bëhet fjalë për "Tapu Tahrir Defterleri"- Shënim B.P.)* pasqyrohet "gjuha- nënë" si gjuhë e parë në ruzullin tokësor.

Pasqyrohen edhe gjuhët e tjera:

- "gjuha-bijë" (shqipja)

- "gjuhët-mbesa"(armenishtja, persishtja, anglishtja, arabishtja, etj)

- "gjuhët-stërmbesa"(turqishtja, kinezishtja, japonishtja, etj

- "Gjuha- nënë" nuk është tjetër pos Adamishtja, më saktë pellazgjishtja-ilirishtja-shqipja e moçme. (fq. 33-34) *(Shënim i: Prof. Dr. Skënder Rizaj)*

Në fq. 36 vijon shpjegimi i emrit "Mesopotamia" dhe "Baltik" nëpërmjet Pellazgjishtes-Ilirishtes-Shqipes së vjetër. - Shënim B.P.)

Autorë të ndryshëm kanë shkrojtur mbi Pellazgët e shpesh me teorira kontradiktore. Vetëm në një pikë opinioni i tyre ka qenë i njëzëri: në të mohuar çfardolloj afërsie gjenetike midis Pellazgëve dhe popujve Helenikë ardhur më vonë. Tashmë është vërtetuar se Pellazgët ishin autoktonë dhe Grekët imigrantë.

Herodoti, at i historisë, na jep lajme shumë interesante. Ai rrojti në shekullin VI[të] para Krishtit, kur shkrimi ishte konsoliduar, prandaj rrëfimet e tij janë interesante:

"Grekët mësuan nga Pellazgët artin e punimit të bronzit, të themelimit të qyteteve dhe fortifikimeve". Akoma sot, muret e ngritur me masa të mëdhaja guri quhen: "muret pelazgjike".

Në këtë përmasë Herodoti informon se Pellazgët e ngritën murin rrethues t'Akropolit t'Athinës e se Grekët morën prej tyre mitet e perënditë dhe se në kohërat e lashta Greqia quhej Pellazgji. (Fq. 47-48)

Autorë të ndryshëm informojnë se Dorët ishin Ilirë. Të shohim se çfarë shkruan Tuqididi mbi këtë popull të shquar:

"Përveç disa përjashtimeve të vogla, banorët e Korinthit ishin Dorët, një fis Ilir. Dorët u shtynë në veri dhe në drejtime të tjera duke kryer një rol të rëndësishëm në përhapjen e kulturës në Botë"

Studjuesi Hans Krahe është interesuar për gjuhën e Dorëve dhe midis informatash të ndryshme interesante kemi edhe këtë:

"Një numër i madh fjalësh të dialektit Dorik nuk mund të shpjegohet me Greqishten, por shpjegohet me ligjet gjuhësore të Ilirishtes"(Fq. 48)

Ku duhet kërkuar misteri i ruajtjes së gjuhës ilire?

Në të vërtetë ajo nuk u helenizua, megjithëse përdori shkrimin Grek për shumë shekuj; nuk u latinizua pas zaptimit nga Roma më 168 para Krishtit; nuk u sllavizua si tek fqinjët e tjerë, kur Sllavët zbritën në jug rreth shekullit të gjashtë; nuk u turqizua gjatë pesë shekujve të zaptimit Otoman.

...

..., si mund të shpjegohet përhapja e kësaj gjuhe në gadishullin e Apenineve?

Edhe njëherë po na vjen në ndihmë Herodoti:

"Etruskët flisnin gjuhën e një populli të lashtë, që jetonte në krahinat e Mesdheut para ardhjes së Grekëve"

Ne e dimë se ai ishte populli Pellazg. (Fq. 52)

Seneka na e konfirmon ardhjen e Etruskëve në Itali, ..., me këto fjalë:

"Etruskët numëronin me "Saecula" historinë e tyre dhe mendonin se "Saecolum" i parë fillonte në vitet 1200-1100, para Krishtit". (Fq. 53)

Alfredo Trombetti e ka mbështetur monogjenezën e të gjitha gjuhëve. (Fq. 128)

Tashmë është vërtetuar se Pellazgët ishin detarë të shkathët, aq shumë sa e merituan të quheshin "populli i detit". Po ashtu edhe pasardhësit e tyre, Ilirët, Trakët, Etruskët, Dorët, etj. ishin popuj detarë dhe ... (Fq. 191)

Së pari, na duket e përshtatshme ta bëjmë të qartë faktin se mbishkrimet Etruske mund të kuptohen vetëm përmes gjuhës shqipe, dhe kjo është një pyetje e lehtë për t'iu përgjigjur sepse, idioma që sot quhet "Shqipe" nga vendasit, *nuk është tërësisht Shqipe, por Pellazgjike.*

...

Një detaj i vogël mund të jetë i dobishëm për të kuptuar domethënien dhe ndoshta arsyen e fjalës *Shqipe,* fjalë kjo që rrjedh nga fjala *Shqiptuar,* që domethënë *shqiptim i mirë.* (Fq. 206)

Është shumë e dobishme të thellohemi në rrënjët e fjalëve sipas një metode multidisiplinare të krahasimit, sepse gjendet gjithmonë afinitet dhe vazhdimësi në zhvillimin e gjuhëve. ...

Pikërisht duke hulumtuar rrënjët e fjalëve sipas udhërrëfyesit të eruditëve që nga kohërat më të errëta, si Homeri, Herodoti, Thuqididi, deri tek studjuesit e sotëm, kam arritur që të dëshifroj dokumentat epigrafike të Evropës mediterane.

Për fillim jam mbështetur në tezën e monogjenezës të të gjitha gjuhëve, të përkrahur nga prof. Alfredo Trombetti i Universitetit të Bolonjës. (Fq. 225-226)

PLU është pikërisht bazë e të gjitha fjalëve të të njëjtit kuptim në të gjitha gjuhët neo-latine. (Fq. 234)

(*Shënim B.P.:* Bëhet fjalë për fjalët tip – PLUHUR - POLVERE – POWDER, etj;)

Mund të vërejmë që fjala MIIA, ka mbetur pothuaj e pandryshuar në gjuhët e sotme evropiane. (Fq. 235) (*Shënim B.P:* Bëhet fjalë për fjalët tip MIIA – MIA – MY, etj.)

Përsa i përket fisit të Etruskëve, Seneka na thotë se ata kanë ardhur më 1200 para Krishtit. (Fq. 271)

Në kohrat e lashta Greqia quhej Pellazgji, na shpjegon Herodoti (490-424 p.e.s.) dhe se kur erdhën Helenët në ato troje, shkruan ai, mësuan prej Pellazgëve artin e punimit të metaleve, ...

Straboni (66 para Krishtit – 24 pas Krishtit), në veprën e tij "Gjeografia", shkruan se të gjithë studjuesit janë të një mendimi në të konsideruar Pellazgët si popullin më të lashtë që njihet. (Fq. 271)

...

Pyetja: "Populli shqiptar, sipas mendimit Tuaj, pasardhës i cilit komb apo fis prej këtyre asht?"

Përgjigja: Sipas mendimit tim, duke u mbështetur mbi shkrimet e studjuesve ma të shquar e në mënyrë të veçantë mbi dokumentet epigrafike Ruro-Mesdhetare, që kam studjuar trembëdhjetë vitet e fundit, ky problem më duket krejt i qartë.

Pellazgët ishin lundrues të aftë, të lirë, prandaj vendbanimin e tyre e quajtën Iliri, që do të thotë vendbanimi i njerëzve të lirë.

Iliria fillonte nga Danubi dhe shtrihej deri në Azinë e Vogël. Por pjesa më e zhvilluar e saj ishte Iliria e Jugut, që mund të themi se përfshinte trojet nga Kosova në Çamëri. (Fq. 271-272)

Ne shqiptarët e dimë, se "pellg" do të thotë ujë i thellë, nga ku vjen shprehja popullore: "U bënë rrugët pellg", ku shiu i fortë i mbush gropat e udhave me ujë. (Fq. 274)

Pellazgët ishin paraardhësit e fisëve të ndryshme Ilire, dhe Ilirët, paraardhësit e Shqiptarëve. Këtë fakt na e dëshmojnë autorë të ndryshëm.

Të marrim si shembull L. Benlöw-in, i cili në veprën e tij: "Greqia përpara ardhjes së Grekëve", botuar më 1877 në Paris, shkruan:

"Shumë emra të vendeve, maleve, të lumenjve, të personazheve legjendarë, nuk mund të shpjegohen me etimologjinë Greke. Vetëm një gjuhë ka qenë në gjendje të hedhë dritë mbi emrat e këtyre vendeve, e kjo gjuhë është Shqipja". (Fq. 275)

Shënim B.P.: Epigrafia është studimi i mbishkrimeve, ose epigrafeve, si shkrime; është shkencë e identifikimit të grafemave, sqarimit të kuptimeve të tyre, klasifikimit të përdorimeve të tyre sipas datave dhe konteksteve kulturore, dhe nxjerrjes së konkluzioneve rreth shkrimit dhe shkrimtarëve.

Homeri shkruan se Pellazgët ishin një popull autokton që rronte në vendet pjellore si Larisa, Argos e Kreta. (Fq. 278)

Këtu na duket e rastit të bëjmë dy vërejtje interesante. Vërejtja e parë është se në kohë të Homerit, në shek. e IX[të] para Krishtit, ai na jep të kuptojmë se, Pellazgët ishin tërhequr në këto troje mbas ardhjes së Helenëve, përndryshe nuk do të kishte kuptim të shkruante se ata ishin autoktonë vetëm në këto vende. ...

Homeri, në veprën "Odisea", shkruan se Kreta ose më mirë Kandia, ishte ishull i 100 qyteteve. Atje rronin fiset e ndryshme të Pellazgëve, por fisi më i madh e më i rëndësishëm nga çdo pikëpamje ishte ai i DORËVE. (Fq. 279)

Nga Tuqididi, Trakas i shek. V[të] para Krishtit, mësojmë gjëra fort të rëndësishme. Ai shkruan:

"Përpos disa përjashtimeve të vogla, banorët e Korintit ishin Dorët, një nga fiset Ilire. Dorët u shtynë në veri e në drejtime të tjera, duke luajtur një rol të rëndësishëm në përhapjen e kulturës në botë".

...

Nga ana tjetër, shkencëtari Hans Krahe, i cili ka bërë studime mbi të folmen e fisit të DORËVE, shprehet pikërisht me këto fjalë:

"Një numër fort i madh fjalësh të dialektit Dorik, nuk mund të shpjegohet me Greqishten, por shpjegohet me anë të ligjeve gjuhësore të Ilirishtes".

Një tjetër lajm interesant, që kemi prej Tuqididit, është se qyteti i Durrësit u themelua nga fiset Ilire të Dorëve, më 626 para Krishtit afër qytetit të një fisi tjetër Ilir: Taulantët. (Fq. 280)

..., një sasi e madhe mbishkrimesh të Italisë i ngjasojnë të folmes së dialektit *gegë.* Karakteristika ma e dukshme është zanorja *"A"* hundore. Duket se folja "është" u formua më vonë. (Fq. 289)

Shënim B.P.: zanorja *"A"* hundore në gegërisht ka të njëjtin kuptim si folja "është" e gjuhës së sotme Shqipe të standartizuar

Pa dyshim është interesante të vërtetohet vazhdimësia e fjalës pellazgo-ilire PLU, në gjuhët e ndryshme.

Në shqip bëhet "PLUHUR", në italisht "POLVERE", në latinisht "PULVIS", në frengjisht "POUSSIER" ose "POUDRE", në spanjisht "POLVO", në anglisht "POWDER". (Fq. 310)

Është një tezë me interes të madh fakti, se gjuhët e ndryshme të botës të kenë një prejardhje të përbashkët. Dëshiroj edhe unë ta kuptoj sistemin me të cilin Trombetti arriti në këtë përfundim. (Fq. 312)

Duket se Pellazgo-Ilirët flisnin dhe shkruanin në gegërisht (Fq. 329)

Për të përkrahur tezën që kemi ndjekur deri tani mbi interpretimet e mbishkrimeve të lashtësisë me anën e një gjuhe të përbashkët, që është ajo e Pellazgëve, besoj se është e rastit të përmendim edhe një tjetër studjues anglez, Sir William Jones, i cili ishte orientalist dhe prandaj kishte studjuar edhe gjuhën Sanskrite. ... Në fjalimin e tij ai tha:

"Gjuha Sanskrite, cilado qoftë lashtësia e saj, përbëhet prej një strukture të mrekullueshme; më e përsosur se Greqishtja, më e artikuluar se Latinishtja dhe më e rafinuar se të dyja së bashku. Megjithatë, ka afërsi me njerën dhe me tjetrën, si në rrënjët e foljeve ashtu edhe në format gramatikore. Dhe këto afërsira janë kaq të forta sa, në të vërtetë, asnjë filolog nuk mund t'i shqyrtojë ato, pa u bindur se rrjedhin nga një burim i përbashkët". (Fq. 358)

Në përgjithësi, shkencëtarët anglo-saksonë, që kemi përmendur rishtazi, e përkrahin tezën e origjinës së gjuhëve Indoevropiane me prejardhje prej Sanskritishtes, me përjashtimin e tezës së Prof, Gordon Child, i cili përkrah një origjinë Anatolike, duke konstatuar se gjuhët Indoevropiane kishin arritur në Evropën qendrore dhe të veriut vetëm në periudhën e vonshme të bronzit. (Fq. 360)

... në dëshminë e pestë, të cilën Konda e ka nxjerrë nga Libri I, Kap. 3, i Tuqididit:

"Para helenit Deukalion, ky emër (Hellas) aspak nuk ekzistonte; popuj veç e veç të tjerë, dhe populli Pellazgjik i dhanë vendit emrin e tyre, në një gjerësi të madhe". (Fq. 370)

E vërteta historike nxirret në dritë duke i ngjitur së bashku unazat e ndryshme të ngjarjeve, për ta formuar zinxhirin e madh të historisë. Dhe në gjurmimet që po bëjmë ne, unazat e vlefshme janë dëshmitë historike të shkrimtarëve të lashtësisë si Homeri, Herodoti, Tuqididi, të cilët nuk kishin paragjykime mbi kufijtë politikë të një shteti a të një tjetri, prandaj i përshkruanin ngjarjet ashtu si paraqiteshin.

Më vonë, me Polibin (210 para Krishtit), me Strabonin (58 para Krishtit), përshkrimet e lajmeve të tyre, sidomos përsa i përkiste Ilirisë, iu përshtatën më shumë interesave të pushtuesve se sa paanësisë të së vërtetës. (Fq. 371)

Shënim B.P.: Duke cituar Spiro Kondën nga libri "Shqiptarët dhe problemi Pellazgjik" autorja thotë:

Këto dy lajmet e fundit janë jashtzakonisht sqaruese, meqë nga një anë vërtetohet se Pellazgët dhe Jonët ishin i njëjti popull, dhe nga ana tjetër kuptohet se në kohën e Herodotit, kur shkruanin për Greqinë, kishin nevojë të përmendnin se ai vend përpara quhej Pellazgji. Një gjë e tillë ndodh kur diçkaje i ndrrohet emri, dhe për ca kohë duhet përmendur edhe emri i mëparshëm, deri sa të gjithë ta kenë përvetësuar emrin e fundit.

Si duket, në kohën e Herodotit (484-425 para Krishtit), kishin ende nevojë të shkruanin se ky vend, që sot quhet Greqi, përpara quhej Pellazgji. (Fq. 371-372)

Tani, duke konsideruar se fjala "GUR" gjendet vetëm në gjuhën Shqipe, nuk ka dyshim se kjo fjalë ishte Pellazgjike, por pa dyshim, në Azinë e Vogël përdorej edhe nga fiset e tjera. Dhe ndoshta me të drejtë, mund t'i konsiderojmë popullsirat e tjera, si fise të ndryshëm, të shkëputur nga Pellazgët.

...

Nuk ka dyshim se nga fjala "GOURASION", është formuar "GARNIZONI" i shqipes, "GUARNIGIONE" e italishtes dhe "GARRISON" i anglishtes. Është krejt e natyrshme që kështjellat, garnizonet dhe banesat të ngriheshin me gurë, dhe të ishin të ngurta. (Fq. 376-377)

Nuk ka dyshim se vëllimi: "Shqiptarët dhe problemi pellazgjik" i Spiro Kondës, është vepër e përsosur nga çdo pikëpamje. Ai i tregon, i shpjegon, i provon dhe i dëshmon faktet, prandaj është e rastit të konsiderohet si një nga veprat më serioze në fushën e popujve të lashtë e të gjuhës së tyre. (Fq. 379)

... në historinë e Albanologjisë, ai konsiderohet si studjuesi i parë që vuri bazat e morfologjisë barazuese ose komparative të gjuhës Shqipe. (Fq. 402)

Mbas këtyre studimeve Franz Bopp (lindur në qytetin Meinz të Gjermanisë më 14 Shtator 1791) arrin të përfundojë se Shqipja, nga përbërja e saj gramatikore, gjithashtu edhe në bazë të fjalorit, është me prejardhje fonetike të Sanskritishtes. (Fq. 403)

Homeri në "Iliadën", kur flet për popujt që luftuan në ushtrinë trojane kundër Grekëve, përmend edhe Dardanët dhe i cilëson "me origjinë Ilire", të kryesuar nga Enea, i biri i Ankasit, i cili, sipas legjendës, mbas shkatërrimit të Trojës, themeloi qytetin Lavinio, në jug të Romës. (Fq. 405)

… ne e dimë nga burime të sigurta dhe sidomos nga shkrimet e Tuqididit se Epidamno (Durrësi) u themelua në vitin 627 para Krishtit nga fisi Ilir i DORËVE, të cilët u nisën nga Korinti dhe vajtën të themelojnë banesën e tyre të re pranë fisit Ilir të Taulantëve, afër Durrësit, në Ilirinë e Jugut.

DORËT, po të ishin Grekë, nuk besojmë se as Taulantët dhe as fiset e tjerë Ilirë, do t'i pranonin ata me krahë hapur! (Fq. 406)

Një tjetër përkrahës i monogjenezës së gjuhëve është profesori Colin Renfrew, i Universitetit Cambridge (Angli). (Fq. 438)

Mbi origjinën e Pellazgëve ka kryer studime të rëndësishme shkrimtari francez Robert d'Angely, i cili në veprën e tij "Les Pelasges" (Paris 1990) shkruan se forma primitive greke"pelargos" ishte me prejardhje nga Pellazgjishtja "pielharg", e cila në shqipen e sotme ka kuptimin e "pjelljes": (pjellje e bardhë); d'Angely e shpjegon këtë kështu: "pielh [b]ardh" (letra "b" konsiderohet si një epentesë e mëvonshme). Kështu, sipas teorisë së tij, kuptimi i kësaj fjale është: "lindur i bardhë".

Teza e Robert d'Angely mund të shpjegohet edhe me origjinën boreale të popujve të veriut, meqë baza e kësaj fjale është "bora" e pellazgëve, e cila mbijeton në Shqipen e sotme. Dhe sipas disa teorive të studjuesve të ndryshëm, pellazgët ndoshta u detyruan të zbresin në tokat e Mesdheut, nga shkaku i ndryshimit të aksit të Globit. (Fq. 438)

Në Durrës është zbuluar një epigraf, i cili ka afërsi mendore e shpirtërore me atë të Viterbo-s: KAE=qaje, në Shqipen e sotme. Në alfabetin pellazgo-iliro-etrusk, letra (germa) "q" nuk ekzistonte fare: ajo është formuar në kohëra shumë të mëvonshme. (Fq. 449)

Përsa i përket alfabetit të parë fonetik, i cili quhet "pellazgjik" meqë u krijua prej tyre, DIODOR SIQILIOTI na informon se poetët para Homerit shkruanin po me atë alfabet. Dhe nga i njëjti burim mësojmë se së pakut dhjetë shekuj para Krishtit përdorej po ai alfabet i Pellazgëvet. Diodori nënvizon se, të parët që e sollën alfabetin e tyre në Itali e në Evropë, duke bërë disa përmirësime dhe përshtatje, ishin vetë Pellazgët.

Edhe PLINI PLAK e konfirmon lajmin se Pellazgët ishin ata që e sollën në Itali alfabetin fonetik.

Virgjili në Eneidën, VIII, v. 62-63, ashtu si dhe shumë autorë të tjerë që do përmendim më poshtë, shkruan:

"Thuhet se banorët e parë të Italisë sonë ishin Pellazgët".

Ne e dimë nga historianët e lashtësisë se, para se të vinin Grekët, ato troje quheshin Pellazgji. (Fq. 484 -485)

Për ta trajtuar argumentin e vështirë të gjuhësisë, nuk mjafton vetëm njohja e Greqishtes ose e Latinishtes, por, përpos gjuhëve Evropiane, duhet të njihet, së pakut, një gjuhë Aziatike ashtu si duhen edhe sadopak dijeni mbi Sanskritishten. (Fq. 490)

... nuk duhet të harrojmë se në përgjithësi, *dokumentet epigrafike të lashtësisë na paraqiten në dialektin e gegërishtes,* duke filluar nga vetë folja "A" = Asht, d.m.th. folja e qenies. (Fq. 492)

Shënim B.P.: ... folja *"A" = Asht,* d.m.th. folja e qenies, e të qenurit, e ekzistencës (unë jam, ti je, etj.)

Problemin e prejardhjes së popullit shqiptar dhe të gjuhës së tij, e trajtoi për herë të parë, mbi baza shkencore, historiani gjerman Johan Thunmann (Leipzig, 1774). Ai u mbështet në faktet historike, gjeografike dhe, duke përdorur materialet gjuhësore, vërtetoi se Shqiptarët ishin me prejardhje Ilire, të cilët i konsideroi të afërt me Trakët. Mandej, nga fundi i shekullit të XIX[të], teoria e lidhjes së Shqipes me Trakishten u pranuan nga shumë glotologë. Dhe këtë teori e paraqiti me argumentime më të përsosura albanologu G. WEIGAND, në veprën e tij: "Sind die Albaner die Nachkommen der Illyrier oder der Traken" ("Ballkan Archiv" 1927, III, f.227-251"). Këtë vepër e shqipëroi A. XHUVANI dhe u botua në revistën DITURIA më 1918, nr.8, f.291; nr. 9-11, f. 333-334.

Por, në vitin 1863, linguisti gjerman, August Schleicher, botoi një dru gjenealogjik të gjuhëve të ndryshme, me prejardhje Indoevropiane, ku gjuha Shqipe paraqitet krejt në fillim. (Fq. 521-522)

Shënim B.P.: Glotolog – Glosolog – linguist– gjuhëtar

Vetëm një gjë nuk arrij të kuptoj: Në Shqipëri ka dokumente epigrafike të shumta, nga ato më të lashtat Pellazgjike, deri ato të periudhës Ilire dhe të kohëve më të vonshme ku, alfabeti i mëparshëm Pellazgjik me ndërmjetësinë e Greqishtes, është bërë gjuhë divulgative, dhe çdokush është në gjendje t'i lexojë ato pa asnjë problem, pra, duke pasur në dispozitë një pasuri epigrafike aq

të madhe, pse kjo pasuri është lënë pas dore dhe gjuhëtarët shprehen gjithmonë e vetëm me fjalë abstrakte dhe nuk e vënë në zbatim atë që kanë kuptuar e zbuluar. (Fq. 523)

Shënim B.P.: Gjuhë divulgative – gjuhë edukative, mësimore, didaktike; popullore, publike; gjuhë në përdorim popullor, masiv (Fq. 523)

Në vitin 1996, Luigi Luca Cavalli-Sforza, i cili ka dhënë mësim në universitetet Cambridge, Parma, Pavia, dhe tashti është profesor i gjenetikës në Universitetin Stanford të Kalifornisë, rishtazi botoi një libër shumë interesant, sidomos nga pikëpamja gjuhësore, përsa i përket studimit që jam duke bërë. Ky libër me titull: "Geni, popoli e Lingue" (Adelphi, 1996), ... (Fq. 532)

Cavalli-Sforza e mbështet tezën se të gjitha gjuhët moderne kanë përbërje strukturale pak a shumë të barazueshme dhe, nga ky parim nuk përjashtohen gjuhët e grupeve etnike, që jetojnë në një përmasë ekonomike "primitive", por gjuha e tyre, shkruan ai, nuk është aspak më "primitive" se gjuhët tona.

Në faqen 234 të të njëjtit vëllim, po citoj një kalesë fort interesante, që e mbështet tezën që kam paraqitur gjatë këtyre njëzet viteve të fundit:

"Është ndoshta diçka e jashtëzakonshme se, me gjithë ndryshimet që ka pësuar gjenetika dhe gjuhësia, të ketë mundësi ende sot, në mozaikën e gjenetikës dhe të gjuhësisë së botës moderne, për ndërtimin e një druri gjenealogjik përsa i përket dy evoluimeve".

Në përmasën e këtij citimi, mund të nënvizohet me të drejtë pjesa ku Cavalli-Sforza përmend tezën e dy autorëve: Eric Minch dhe Alberto Piazza, të cilët kanë vizatuar një përmbledhje, ose dru gjenealogjik të formimit të gjuhëve indoevropiane ku, në fillim të grafikës gjendet gjuha Shqipe. Mandej me rradhë vijnë gjuha *Armene*, ajo Greke, Keltike, Baltike, Slave, Gjermanike, Italike, Indiane dhe Iranike. (Fq. 533)

(*Shënim B.P.:* Fq. 534 dhe 535 janë fotografuar dhe vendosur ashtu siç janë. Për këtë shih: Kapitulli 4, Pema e gjuhëve Indo-Europiane, Fq. 325, 326

Cavalli-Sforza, në fq. 215 të veprës sipërcituar shkruan:

"Megjithëse nuk gjendet ende një dru evolutiv i përsosur i familjeve gjuhësore, megjithatë, jemi në gjendje, që tani, ta barazojmë drurin gjenetik me anë të të dhënave që njihen në drurin e linguistikës. A ka gjasime?

Mund të vërehet se, megjithëse druri i gjuhëve nuk është i përplotë, por gjasimet midis gjuhëve bëjnë, pa dyshim, përshtypje të madhe". (Fq. 537)

Tani nuk mund t'i shmangemi një pyetjeje: pse gjuha e Pellazgëve, të pasardhësve të tyre Ilirë dhe Etruskë ka mbijetuar posaçërisht në Shqip? Përgjigja mund të ishte thjeshtësisht: nga shkaku i transmetimit të gjeneve nga një gjeneratë në tjetrën. Por tani kemi të drejtë, që përsëri t'i bëjmë vetes një pyetje tjetër: por për çfarë arësye Etruskishtja u zhduk krejtësisht dhe Ilirishtja mbijetoi? Pyetje fort e ligjshme: Etruskishtja i dha shtytjen kulturës Latine dhe "gjenet" e saj pësuan një ndryshim të madh, kurse Ilirishtja mbas rrezatimeve të para, u mbyll në vetvete, nën shtytjen e zaptuesve nga jashtë, e mbrojtur nga male të pakapërcyeshme, pa patur mundësi për ndryshime evolutive të shumta. *Ka mbijetuar, duke e ngrirë kulturën e vet, ndryshe nga kulturat e tjera që u shteruan krejtësisht.* (Fq. 540-541)

Iliria e lashtë me prejardhje Pellazgjike, ishte vendi i njerëzve të lirë ("i lir"), e cila shtrihej gjatë Ballkanit perëndimor. Përbëhej nga një shoqëri fisnore e zhvilluar, me një mbret të vetëm për gjithë Ilirinë. Do të përmend vetëm tre të fundit e këtij vendi që, mbasi arriti majën e qytetërimit, më të shquarën e asaj kohe, me shkolla të përpikta, ku u arsimuan njerëzit më të rëndësishëm, mandej, si ndodh për të gjitha gjërat e kësaj bote, edhe për Ilirinë filloi dekadenca. (Fq. 542)

Mbreti GLAUKO (mbretërimi i tij filloi rreth vitit 330 para Krishtit)

Mbreti AGRON (mbretëroi 250-231para Krishtit) (*shtuar nga unë. Shënim B.P.*)

Mbretëresha TEUTA, gruaja e AGRONIT (mbretëroi 231-227 para Krishtit)

Mbreti GENCI (Genti) (mbretëroi 181-168 para Krishtit)

Në vitin 168, GENCI (Genti) u mund nga Romakët, dhe që nga ajo kohë Iliria ra nën pushtimin Romak.

Nermin Vlora

(Lindur: 19 Prill 1921)

(Vdekur: 28 Nëntor 2004)

ARISTIDH P. KOLA

"ARVANITASIT DHE PREJARDHJA E GREKËVE"

Përktheu nga origjinali: Aldior Agora

Shtëpia Botuese *"55"*
Tiranë, 2002

Një libër kërkimi pa gabime është një libër jopjellor. Në asnjë rast ai nuk do "të lindë" një libër tjetër. (Parathënie, Fq. 27)

Legjendat dhe traditat e lashta, pohojnë se njerëzit e parë që banuan Greqinë ishin pellazgët. Greqia quhej më parë Pellazgioti ose Pellazgji dhe banorët e saj pellazgjiotë ose pellazgë (shih Herodotin, A 56,57, -B 171, etj.) (Fq. 36)

Si populli më i lashtë i Greqisë përmenden Arkadet, që, sipas hipotezash të cilat i them i rezervuar, ishte populli që shpëtoi nga një përmbytje katastrofike, që kaloi në traditat Helene si "Përmbytja e Defklionës". Është e logjikshme që banorët e Arkadisë malësore të largoheshin prej krahinës pas një përmbytjeje të tillë.

Nga mitet, si mbret i popullit të lashtë akadian përmendet të ishte Pellazgu, i cili nuk mund të jetë bir njeriu, por perëndie. Është pra, Pellazgu, biri i Perëndisë dhe Tokës (i babait Diell dhe i nënës Tokë). (Fq. 37)

Gjuhët e lashta ishin me pak rrokje dhe përmbanin shumë

bashkëtingëllore. Ndërhyrja e zanoreve ishte shpikje e popujve të civilizuar. (Fq. 47)

ETIMOLOGJIA E EMRIT KOMBËTAR "PELLAZG" (FQ. 50-51)

Do të përmend versionet kryesore për prejardhjen e emrit kombëtar "Pellazg".

Sipas një varianti, fjala "Pellazg", vjen nga fjala "Plasin" dhe "Pelago", sepse siç pohon (*Shënim B.P.:* kush??; mendoj se është harresë apo gabim gjatë përkthimit apo shtypshkrimit) pellazgët erdhën nga Pelagu. Fillimisht, askund nuk thuhet se erdhën nga Pelagu, por edhe po të ishte kështu, do të quheshin pelagë dhe jo pellazgë.

Mitropoliti bizantin, Evstathio, quan banorët e Azisë së Vogël si pellazgë. E nxjerr emrin e tyre nga Pelas Jis, që do të thotë "Tokë e afërt" dhe si të tillë e mendon Azinë e Vogël. Por edhe sikur ky version të ishte i saktë, përse Evstathio sheh si tokë të afërt Azinë e Vogël dhe jo Italinë ose akoma më pranë, Ilirinë?

Gjeografi i madh i lashtësisë, Stravoni, nxjerr fjalën "Pellazg" nga "pelarg", por që është emri i dytë i tyre, që u a kanë dhënë helenët dhe më saktë athinejtë.

Që Myleri e nxjerr prejardhjen nga fjala "Pelin" dhe "Argo" ku fjala "argo" është pellazge dhe do të thotë fushë, ndërsa i gjithë togfjalëshi ka kuptimin e atij që jeton nëpër fusha.

Homeri e quan Tesalinë "argo pellazg", që do të thotë fushë pellazge. Në Greqi ekziston fusha (Argo) e Thesprotisë e Peleponezit, etj.. Shqipja e ruan rrënjën e fjalës argo (ar-) dhe e përdor si "arë", që do të thotë fushë e mbjellur.

Profesor Saqelariu e gjykon etimologjinë e fjalës nga rrënjët

indoevropiane Bhel = cel dhe Osqho = degë, bis. Është një version që u formua më 1958-ën dhe me ndryshime a me modifikime të germave nxjerr përfundimin se pellazg do të thotë "degë e çelur". Sigurisht që nuk ka se ku të mbështetet, por autori e arsyeton me faktin se pellazgët lidhen me përhapjen e ushqimit në Tokë. Por unë nuk shoh ndonjë lidhje të degës së çelur me pellazgët dhe të kësaj veçorie të tyre, e cila është një nga të shumtat dhe së fundi nuk përmendet diku, por del në bazë konkluzionesh. Pastaj, vetitë kryesore të pellazgëve janë heroizmi dhe braktisja e fushave, që ata shfrytëzonin për të siguruar ushqimin.

Kush, pra, është version më i saktë etimologjik?

Personalisht mendoj se, mendimi i Stravon-Myler është më i saktë, sepse mbulon si nga ana gjuhësore ashtu dhe nga ana kuptimore fjalën "Pellazg". D.m.th., Stravoni dhe Myleri kanë të njëjtën ide me atë të athinejve të lashtë. E nxjerrin prejardhjen e pellazgut nga "pelargu", që do të thotë lejlek në shqip (shën. i përkth.). Fjala pelarg del nga "Pelin" dhe "argo", siç pamë më lart dhe me të vërtetë lejlekut i pëlqejnë zonat fushore.

Lejleku ka dhe ngjashmëri të tjera me pellazgët. Jeton në toka fushore dhe moçalore. Pellazgët kanë të bëjnë me ndërtimin e veprave të mëdha kanalizuese dhe për ujitjen e zonave të mëdha si ajo e Kopadies.

Një veçori tjetër e ngjashme midis pellazgëve dhe lejlekëve është emigrimi. Aristofani në një komedi të tij thotë se pellazgët emigrojnë ashtu si lejlekët.

Një tjetër veti është dhe mbrojtja deri në sakrificë e prindërve të tyre. Aristoteli na tregon (historia e kafshëve 2, 9, 13.) se lejlekët e rinj i marrin më të moshuarit në shpatulla me qëllim që të emigrojnë. Kjo dashuri, detyrim, madje dhe respekt i dekretuar ndaj prindërve të tyre është dhe një nga elementët bazë të ideologjisë së helenëve të lashtë. E theksoj se në Greqi dashuria dhe respekti për prindërit ishte i caktuar me ligje, të cilat quheshin "Ligjet e Lejlekut" (Ligjet

Pelarge). Pra ekzistojnë shumë fakte mbi etimologjinë e fjalës pellazg nga fjalët "pelin" dhe "argo" nga të cilat formohet pelargu. Fakti që helenët i quanin pellazgët, pelargë, e vërteton këtë version. (Fq. 50-51)

Herodoti, siç thamë, përcjell perceptimin popullor se jonët janë fis pellazg dhe dorët helenë. Diku tjetër quan edhe dorët pellazgë dhe vetëm për athinejtë thotë në mënyrë lajkatare se edhe ata janë pellazgë, por u greqizuan. Mirëpo, nëqoftëse do të ishin edhe ata pellazgë, atëhere, nga kush u greqizuan, duke qenë se të gjitha fiset e tjera athinase ishin me prejardhje nga fiset molose, thesprote ose lape, që ishin po pellazgë. Nga erdhën, pra, grekët që greqizuan jonët pellazgë? (Fq. 71)

..., jonët dhe athinejtë e Atikës nuk janë veçse pellazgë të vjetër të cilëve iu shtuan kohë pas kohe pellazgë të rinj që vinin nga origjinat e kombit pellazg, si emigrantë të rinj më të prapambetur. (Fq. 71)

Jonët janë pellazgë, që për njerën apo tjetrën arsye nuk arritën ta realizojnë vetveten ndaj vringëllimave dhe pasojave të luftës me Trojën dhe më pas ndaj dyndjes së fshatarëve pellazgë, që u quajtën dorë. (Fq. 72)

Dorët me sa duket janë fisi i fundit nga të ashtuquajturit helenë që zbritën në Greqi.

Zbritja e dorëve në Greqi duket se krijoi një revoltim të madh. Ata erdhën nga po i njëjti vend prej nga erdhën edhe pellazgët, eolët, jonët dhe akejtë. E që të bëhem më i qartë "erdhën" duhet thënë vetëm për pellazgët dhe dorët. Të gjithë të tjerët thjesht e kanë prejardhjen nga të njëjtat vende, prej nga erdhën pellazgët dhe dorët. Nuk u dëgjua asnjëherë ndonjë "zbritje" e akejve, jonëve, etj. Gjë që do të thotë se banorët e parë, pra pellazgët, nuk erdhën nga malet shkëmbore të Shqipërisë për verim, por për të banuar. (Fq. 75-76)

Tukididi thotë se 80 vjet pas pushtimit të Trojës "Dorët erdhën në Peloponezin e Herkulit" (A13). Edhe Platoni thekson zbritjen e Dorëve, por shton se ata nuk janë veçse akej që ndërruan emrin,

ndërsa Pindari i quan këta pasardhës spartanë "pasardhës të Herkulëve dhe disa prej tyre të rekrutuar në ushtri". (Fq. 77)

Mirëpo dilema e Kordatit, të cilën ai e përmend vetëm në një frazë të shënimit të tij, është pikërisht vendi i pathënë i prejardhjes së dorëve: "Dorët, megjithëse erdhën të fundit në Greqi, dallojnë nga helenët e tjerë jo nga qytetërimi, por nga shkalla e zhvillimit, duke u kujtuar për këtë qëllim helenëve të këtushëm rregullat e trashëguara të jetës shoqërore dhe zakoneve të tyre të lashta".

Të gjitha këto ç'duan të thonë? *Duan të thonë se dorët që erdhën këtu të fundit nga të gjithë helenët e tjerë nuk janë veçse pjesë e të njëjtit popull, që vonesa e tij qytetërore shpjegohet plotësisht, përderisa vijnë nga malet e Ilirisë, shumë shekuj pas zbritjes së bashkëatdhetarëve të tyre pellazgë.* (Fq. 92-93)

Është, pra, tejësisht i gabuar mendimi i Kordatit dhe i disa studjuesve të huaj, që hedhin hipoteza – sigurisht nuk i vërtetojnë dot – sipas të cilave helenët erdhën nga Mesopotamia dhe jo nga Iliria. (Fq. 93)

Kordati duke u mbështetur në disa kërkues të huaj krahason epet e Homerit, me epin e madh asirobabilonas të Gilgameshit dhe pohon se ato përbëjnë modelin në të cilin u bazua Homeri. (Fq. 95)

Helenët, siç dihet, edhe sot kanë një emërtim tjetër. Quhen Grekë, por edhe këtë emërtim na e tha më lart Aristoteli dhe ka qenë emërtimi i vjetër i helenëve. Këtë na e thonë dhe na e sigurojnë dhe mbishkrimet e lashta në mermerët e famshme të Parios. (Fq. 98)

Po përtej kësaj, identiteti i akejve dhe i pellazgëve rrjedh nga identiteti i akejve dhe trojanëve. Sa Homeri aq edhe gërmimet arkeologjike provojnë, që si akejtë ashtu edhe trojanët përbëjnë të njëjtin fis. (Fq. 104)

Pas ngjarjeve të Trojës, shtetet e para të fuqishme u tronditën. Kjo luftë ishte në thelb një mundje për rregjimet e Greqisë. Mbretërit, shenjtorët dhe ushtarakët munguan 10 vjet dhe sado që rregjimet të dukeshin të qëndrueshme, ishte e pritshme, që ato të lëkundeshin.

Forcat politike kundërshtare e shfrytëzuan këtë mungesë dhe forcuan pozitat e tyre. Duke qenë se ishin akoma të pafuqishme, kërkuan ndihmë nga atdheu i tyre i vjetër, Iliria. Kështu që, për hedhjen poshtë të rregjimeve të vjetra akease, ndihmuan të ashtuquajturit mercenarë *"dorë"*. Duket, që dueli të ketë qenë i gjatë, pasi dorët nuk u vendosën pas ndonjë përleshjeje vendimtare. Përveç kësaj, kemi edhe një zbritje të dytë grupore nga Iliria, pas zbritjes së parë të pellazgëve dhe përsëri nga i njëjti vend dhe nga i njëjti popull, Iliria. *Nuk e quaj aspak të pamundur që dorët* të ishin të parët që përdorën hekurin. (Fq. 104)

Një çështje e rëndësishme që pason, është teoria mjaft e përhapur e prejardhjes së popujve europianë nga India nëpërmjet Kaukazit, etj. Flasim këtu për një emigrim të supozuar të një populli nga brigjet e Gangut apo Indit, që etnologët e quajtën popull arian ose racë ariane.

Është një hipotezë, që gjermanët e hodhën para luftës dhe mbetet e tillë akoma edhe sot. Ekziston sigurisht edhe gjuha transkriptike, e cila ka mjaft ngjashmëri me atë greke dhe kjo është e rëndësishme. Por duhet sqaruar, nëse ndonjë popull (arianët) erdhi nga Gangu, apo ndonjë popull (po ata) shkoi nga Europa në Gang. Duke qenë se nuk ekzistojnë dëshmi të ndonjë qytetërimi më të vjetër në Indi se sa ai pellazg, i cili theksoj, paraqiti një zhvillim të ngadaltë por të qëndrueshëm, atëhere rrjedh se në emigrimin e madh pellazg, një pjesë prej tyre që shkuan në Azinë e Vogël, të kenë vazhduar për në jug të Kaspikut dhe të ketë mbërritur në Indi. (Fq. 109)

Le të shohim tani si u formua emri *helen* dhe *hellas,* emër ky që shfaqet si një emër i përbashkët i gjithë banorëve të Greqisë, pas zbritjes së dorëve. ...

"Hellas" – përmendet nga Homeri si një vend i vogël pranë Pindit dhe që karakteristika e tij më e veçantë ishte se kish gra të bukura ("Greqia grabukura" – siç e quan Homeri) dhe prijës i tij ishte një ndër heronjtë më të lavdishëm të luftës së Trojës, Akili.

Tukididi kapet pas mitit të Helenit, gjoja prijësit të parë të

helenëve dhe thotë se ky emër u ruajt pas Diasporës dhe në Greqi, tek bijtë e Helenit. (Fq. 110)

*... sipas gërmimeve të fundit në Shqipëri, ilirët deri në shek. I*rë*, para erës sonë (p.e.s.), kohë në të cilën romakët hynë në vendin e tyre (pra, në Iliri. Shënim B.P.), përdornin shkrimin dhe alfabetin grek në shkresat e tyre.* (Fq. 121)

*Emri kombëtar Iliri dhe Ilir dëgjohet deri në shekullin e VI*të*. Në 5 shekujt e mëpasshëm nuk bëhet fjalë fare për ilirët.*

...

... hera e fundit, që përmenden ilirët apo ndoshta edhe Iliria, është në "Mrekullitë e Shën Dhimitrit", një kronikë, që u shkrua në shekullin e VII[të]. Më pas ndjek një heshtje e fakteve historike deri në shekullin e XI[të], kur historiani bizantin Mihal Ataliati përmend jo më Iliri dhe ilirë, por Arbëri dhe arbëreshë, që ishin aleatë të Jorgo Maniaqit, i cili doli kundër Kostandinopojës më 1043.

Më 1078, përmenden "Arbëreshët" të marrin pjesë në qëndrimin që mbante duka i Durrësit, Niqifor Vasilaqi.

Pas Ataliatit kemi Joani Sqiliçin dhe Ana Komnenin, që e përmendin emrin "arbëreshë" në një territor të quajtur "Arbëri" dhe që ishte në Shqipërinë e sotme Qëndrore. *Duhet përmendur këtu se 9 shekuj përpara, gjeografi aleksandrin, Klaudio Ptolemeu, përmend fisin ilir të Albanëve (Albanë, Albanopolis), që i vendos në të njëjtën zonë.* (Fq. 131-132)

Kundërshtimi i kësaj teze (*Shënim B.P.:* sipas së cilës shqiptarët nuk kanë asnjë lidhje me ilirët, por erdhën gjatë emigrimeve të mëdha barbare nga thellësitë e Ballkanit, që flisnin latinisht dhe danubisht) nuk është fare i kënaqshëm nga Pollo-Puto. Jani Vreto, në "Apollogjinë" e tij të famshme, që u botua më 1878, duke përmbysur një tezë të ngjashme, që i përputh shqiptarët me banorët e Albanisë në Kaukaz, parashtron një seri dokumentesh dhe fjalësh të letërsisë klasike dhe paraklasike, që janë të njërrënjshme me ato përkatëse shqiptare.

"Në qoftë se, - thotë Vreto, - shqiptarët nuk do të ishin vendosur ngahera aty, por do të ishin barbarë të ardhur gjatë fushatave pas viteve të krishterimit, atëhere si shpjegohet identiteti i përbashkët i shqipes me greqishten e vjetër homerike të viteve të lashtësisë paraklasike, në një çast, kur ne dimë se në shekullin VII apo X nuk flitej më gjuha e epeve homerike, por gjuha e njohur si e Ptohopodromit?". (Fq. 132)

Historiano-filologu gjerman, Falmerajer, formuloi teorinë e njohur, sipas së cilës, vendbanimet sllave në Greqi dhe murtaja e zhdukën kombin e lavdishëm të helenëve. Këtë tezë e hodhën poshtë shumë historianë grekë e të huaj dhe më vonë vetë Falmerajeri pranoi se sllavët u dëbuan nga arbëreshët, që e populluan në mënyrë të dendur Greqinë, por arbëreshët – thotë ai, - nuk i përzuri askush. Pra, nëse quajmë Greqinë "Shqipëri të re", kemi kapur thelbin e teorisë.

Kjo tezë e dytë, në thelb, mbeti pa përgjigje, sepse të gjithë historianët grekë përpiqeshin të vërtetonin se arbëreshët nuk kishin ardhur në Greqi përpara shekullit XIV, rrjedhimisht ... nuk ishin ata, që i dëbuan sllavët apo se nuk ka asnjë lloj arbëreshi në Greqi.

Më 1854, gjermani Hahn botoi veprën e tij "Albanesische Studien" (Studime Shqiptare), pas një qëndrimi udhëtimi dhe studimi të gjatë të fisit shqiptar, të zakoneve dhe dokeve, si dhe të gjuhës, të cilën ai e mësoi. Kështu, për herë të parë, çështja shqiptare e bëri Evropën që të merrej gjallërisht me të dhe mendimi i Hahn-it se shqiptarët janë një popull i afërt me helenët e lashtë dhe hallka lidhëse e të dytëve me romakët, bëri përshtypje të madhe. (Fq. 168)

Hahnin donte ta kundërshtonte pedanti grek me emrin e lashtë Nikokli, i cili shkruante studime në dialektin e Atikës dhe u përpoq të vërtetonte se shqiptarët nuk kanë asnjë lidhje me helenët dhe madje as me Ilirët, por se ata erdhën në Ballkan për herë të parë në shekullin X^{të}, me sulmet barbare, nga Kaukazi, ku në lashtësi ekzistonte një vend me emrin Albania.

Në këtë dyluftim, ndërhyn Falmerajeri, i cili që nga viti 1857

deri më 1860 boti tre studime (Das Albanesische element in Griechenland), ku hidhte poshtë tezat e Nikoklit, por njëkohësisht vinte në dyshim edhe ato të Hahnit. "Gjuha shqipe, - thoshte Falmerajeri, - nuk ka asnjë lidhje me atë greke apo latine, por as me atë turke dhe as me atë sllave. Shqiptarët, - thotë ai, - përmenden për herë të parë në shek. II[të] të erës sonë nga Klaudio Ptolemeu dhe hyjnë në skenën historike vetëm në shek. XI[të]. (Fq. 169)

Por kur themi albanë, nuk e kemi fjalën vetëm për albanët e Ptolemeut të shek. II[të] të e.s., por për të gjithë fiset ilire, të cilat, që nga shek. XI[të], u quajtën nga të huajt "albanë ose arbanë", për shkak të fisit ilir të albanëve, që asaj periudhe luante një rol të rëndësishëm në Ballkan. Falmerajeri i kufizon shqiptarët dhe i përputh vetëm dhe plotësisht me "albanët" të Klaudio Ptolemeut dhe meqënëse prania e tyre përmendet vetëm në shek. II[të], vetëm atëhere e konsideron ekzistencën e tyre të dhënë.

(*Shënim i Aristidh P. Kola:* Sigurisht, ky përfundim i Falmerajerit nuk është aspak i drejtë. Meqenëse K. Ptolemeu në shek. II[të] përmend se midis popujve ilirë ekzistonin edhe albanët, nuk do të thotë se pikërisht atëhere lindi ky popull. Logjika thotë që mosha e këtij populli të vihet krahas moshës së popujve të tjerë të afërt fisnorë me ata të Ilirisë dhe Greqisë. Meqë nuk përmendet nga shkrimtarët e lashtë nuk do të thotë që nuk ekzistonte...)

Në vazhdim pranon se këta albanë nuk kishin e as kanë ndonjë lidhje me helenët dhe gjuha e tyre është krejtësisht e veçantë dhe nuk ka asnjë lidhje as me greqishten dhe as me latinishten.

Ky mendim është dhe thelbi i teorisë së fundit të Falmerajerit dhe në këtë bazohet për të vërtetuar se shqiptarët nuk kanë asnjë lidhje me grekët dhe si rrjedhim fisi helen me të vërtetë u zhduk, siç kishte mbështetur edhe më përpara.

Por ky mendim i Falmerajerit hidhet poshtë me lehtësi, mjafton të shtojmë një listë të vogël fjalësh Shqipe, Greke dhe Helene të lashta dhe nga krahasimi i tyre i drejtpërdrejtë të vërtetohet se shqipja është

krejtësisht e njëjtë me greqishten homerike, gjë që nuk ndodh me greqishten e re. D.m.th. vërtetohet një lidhje më e madhe e shqipes me dialektin homerik se sa me atë të greqishtes së re dhe, megjithëse kjo duket e çuditshme dhe e pabesueshme, është e vërtetë. (Fq. 170)

Tabela Krahasuese e Fjalëve (Fq. 170 - 173)

*Shqipe**	*Homerike***	*Neogreke*
sy	o-se	mati
dor-ë, dor-a	ekedeka-dor-o	qheri
lesh	lasios	mala
mi, miu	mis	pondaqi
heq, (helkj=tërheq)	elko	travae
marr (mar)	mar-pto	perno
edhe, dhe	idhe, te	qe
arë, ara	arura	horafi
qas, kias	qio, kio	simono
punë (puna)	ponos	dhulia
kalë, kali	kelis-tos	alogo
krye (krie)	krithen, kari	qefali
re, retë	Rea (perëndia e reve)	sinefo
vesh, vishem	ves-this, vesnimi	forae, forao
anda (ënda)	andha-no	efkharitsisi
lepur	leporis	lagaes
qen, qeni	qion	sqilos
rronjë (rroj, jetoj)	ronio, ronimi	zo, akmazo
ruaj, rojtar	rio, ritor	filaso
iki, ike	iko	fevgo

lig	lig-ios, lig-aes	adhinatos
ethe (kam ethe)	ethir, ethae	piretos
rrah	rahso, raso	dherno, htipae
mjeshtër	mistor	tehnitis
ne (neve)	noi	emis
rri (qëndroj)	e-ri-dhome	kathome
vend (ved)	ved-os, vedh-os	edhafos, topos
mend, mendoj	mendohem	medhome sqeftome, nus
më duket	dhokei mi	nomizo
errët (errësirë)	ere-vos	skotos
thërres (thrres-thrras)	threo, throos	fonazo
elbë, elbi	alfiton	krithari
para (përpara)	paros	mbrosta
për-apa (për-apsh)	apsh, aps	piso
për ty	par ti	ja sena
ai që nëm dhe nëm (si folje)	neme-sis, neme-sao	katara
vanë (shkuan)	van	pigan
hedh	heo	rhino, tinazo, sio
enë (veshje)	enimi	ruho
dhe, dheu	jea, dhor, dha	ji
nuk	ni uk	dhen
udhë, udha	udhos	dhromos
verë (stina e verës)	vear	kaloqeri
shkop	skipon, skiptro	ravdhi
torrë	tornoo	jiro
korr	kiro	thiro

mëri – mëni (dial. ver.)	minis	thimos
marrë (i marrë)	margos	trelaes
nisem	nisome	kseqinae
flas	flio, fliarae	milao, omilae
lehem (lind)	leho, lohia	jenieme
fryma – frima (dial. jug.)	frimao	fisima
shkel	skel-os	patao, patae
deti	theti-s	thasala
ndaj – daj (dial. ver.)	dheo, deo	horizo
krua, kroi	krunos	vrisi
dru	dris, drimos, driti	ksilo
lutem	litome	parakalae
nuse	nisos, nios	nifi
ter (thaj)	ter-so	stegnaeno
vesa – versa	versi	dhrosos
dera	thira	porta
kall (djeg)	kileo	qeo
zien	zei	vrazi
loz – ljoz (arbër.)	lizo	pezo
bashkë ec	vask ithi	porevume
mjet	mitos	nima hondrae
tata, ati, i jati	tata, ata, jetas	pateras

Ekziston gjithashtu një numër i konsiderueshëm fjalësh, që ka mbetur tek fjalori i Isihios dhe shumë nga të cilat përkojnë me ato të shqipes së sotme. (Fq. 173)

Gjuhëtarët e viteve të kaluara, me bazë Biblën hebraike, e nxjerrin prejardhjen e të gjitha fjalëve, që nuk i dinë nga ana etimologjike, nga një fis i hamendësuar "iapësh", të cilët përmenden si një fis veriperëndimor. Gjuhëtarët e mëpasshëm i vendosin këto fjalë të panjohura tek një fis i hamendësuar indo-evropian apo indo-gjerman, që, sipas tyre, u nis nga lumi i Indit dhe nëpërmjet Kaukazit mbërriti deri në Evropë. Por unë shikoj se shumica e këtyre rrënjëve "iape" apo "indo-evropiane" gjenden në shqip.

...

Populli pellazg kishte fqinjë nga veriperëndimi keltët dhe anglosaksonët dhe nga juglindja mesopotamët dhe egjiptianët, duke qenë se me qendër Ballkanin veriperëndimor, u dynd (pas një përmbytjeje historike botërore, që përmendet në legjendat e çdo populli) në Greqi, Itali, Azi të Vogël, Mesopotami dhe nëpërmjet Kaukazit dhe Kaspikut arriti deri në lumin Ind. (Fq. 174)

Që t'i rikthehemi gjuhës, themi se do të ishte naive të hamendësohet se shqiptarët ruajtën fjalë Helene në gjuhën e tyre, për shkak të kontaktit të vazhdueshëm të tyre me helenët që pas shek. II^{të} të erës sonë, siç thotë edhe Falmerajeri. Nëse me të vërtetë do të ishte kështu, duhet të ruanin një gjuhë të ngjashme me gjuhën "aleksandrine" të asaj kohe, sepse është e palogjikshme, që sot pranë nesh të vijë një popull dhe të mësojë jo gjuhën "dhimotike", por dialektin e ... Atikës. *(Shënim i përkth: Gjuha dhimotike, e përkthyer dhe publike, është gjuha që flitej nga populli.)* D.m.th. kuptohet se do të mësojë gjuhën e përditshme, e cila ruan disa fjalë të dialektit Atikas dhe Homerik, p.sh.: andras = burrë; ieron = i shenjtë; polis – qytet, etj., por është e pakuptueshme të mësojë fjalë, që nuk përdoren dhe nuk dëgjohen askund, p.sh.: Rea (re, retë), anë, që vjen nga "anio" (anoj), mend, që vjen nga "mendomë" (mendohem), nisem, që vjen nga "nisomë", përveç rastit, nëse do të ishte një popull, që do të studjonte pambarimisht Homerin. Por shqiptarët ishin analfabetë. Pra, ku e mësuan gjuhën homerike dhe

parahomerike, nëse me të vërtetë, ashtu siç thotë Falmerajeri, u afruan me Grekët vetëm në shek. II[të] të e.s., apo nëse ishin shfaqur vetëm në shek. X[të], siç thotë dhe antishqiptari i tërbuar, Nikokli? (Fq. 178)

Gjuhëtarët që nuk e njohin mirë shqipen, nuk është e mundur t'i përgjigjen një sërë problemesh të periudhës prehistorike, që kanë të bëjnë me territorin, i cili përfshin hapësirën nga gadishulli Italian deri në lumin Ind të Indisë. Si është e mundur të eksplorojne periudhën prehistorike duke injoruar gjuhën pellazge (shqipe)?

...

Fjalët e fjalorit neogrek, që ekzistojnë edhe në shqip, nuk i përmend të gjitha, sepse nuk hedhin dritë mbi identitetin e të dy popujve, por tregojnë vetëm një huazim të dyanshëm nga njeri tjetri.

Megjithatë, ekzistojnë disa fjalë, që ruhen edhe në greqishten e re dhe po ashtu në shqip. (Fq. 179)

Tabela Krahasuese e Fjalëve (Fq. 180 - 181)

Greke	*Shqipe*
Bora, qhioni	bora
Vorias	veriu
Noti	notos
Krini, krunos, vrisi	krua, kroi
Kleo	qaj (klian – dial. Arbër.)
Pio, pino	pi, pij
Zei, vra-zi	zien, valon, vlon (nga fjala "Zien" mund të vijë emri i dytë i Diellit (Zeusit) si Zin, Zinaes, përderisa Zeusi ishte fillimisht hyjnizim i "Zeondos Iliu"; shiko edhe "zjarrm")

Ipevi	hipi, hipën
Strono nga (storeo, stronimi)	shtron
Luo	laj (shih – lumë, lumi)
En ora, vor-is	në orë (në kohë, herët)
Ster-evi, sterume	shteron, shterem
Statir, kandari	stater, kandar
Stira	shterpë
Dhrapani	drapëri
Lehona, lohia	lehem (lindem)
Iroas	burrë
Voi, thorivos	vui (buçet)
Fara, fatria	fare
Thira, porta	dera
Mikitas, muh-k-la	myku
Buqia (në Qipro)	bukë, buka
Dhris, dris	dru
Thimon-onos, thimonia	mullar (thimonje – dialekt arbër.)
Kokos	kokë
Dhra-skel-izo	shkel
a-mil-on	miell
vus	viç
dam-alis	dem, demi
avgo, foon	ve (veza)
prinis, primnidhon	përdhe (përdhese, barkas)
eh-mi, eh-miro	mpr-eh, gr-ih
nin	nani

Në rastin e këtyre fjalëve përsëri nuk mund të hamendësojmë huazimin e shqipes nga greqishtja, sepse këtu fjalët e huazuara duhet të ishin të njëjta, p.sh. ...

...

Prandaj themi se këto fjalë dhe rrënjë janë ruajtur si në shqip, ashtu edhe në greqisht, që nga gjuha e lashtë dhe nuk janë huazime të ndonjë populli nga tjetri, por identitet i të dy popujve. (. (Fq. 181)

Helenët pas zbritjes së dorianëve, ishin po njësoj egoistë, krenarë, të pabindur, dinjitozë, etj., me ata që u shuan në luftrat e gjata peloponeziane. (Fq. 315)

Nuk është e rastësishme që shqiptarët e Shqipërisë dhe Greqisë, bashkë me ata të Italisë së poshtme, nuk ruajnë absolutisht asgjë për Bizantin dhe ndonjë madhështi të tij të mundshme në traditat e tyre, ndërkohë që ruajtën deri në ditët tona traditat, legjendat dhe mitet nga lashtësia Helene. (Fq. 332)

Ritheksoj, edhe një herë, se për të provuar që je Helen, më përpara duhet të provosh që je arvanitas. (Fq. 335)

Mësuesi i madh patriot i Jenosit J. Jenadhi (nuk ka të bëjë me patriarkun turkofil) kishte konstatuar prejardhjen Helene të shqiptarëve:

"Albanët apo Shqiptarët apo Arnautët janë pasardhës dhe përfaqësues të pellazgëve të lashtë të Ilirisë. Janë helenë në gjendjen e tyre fillestare. Ky identitet provohet jo vetëm me filologjinë krahasuese por edhe me karakterin e tyre nacionalist" (Fq. 343)

Një tezë e imja, që vjen nga shumë elementë krahasues, është se *suliotët dhe himariotët ishin gegë,* që pas vdekjes së Skënderbeut zbritën në ato vende.

...

Megjithatë, unë mbështes tezën se helenët më autentikë janë gegët. (Fq. 511)

Në 1864, K. Kristoforidhi, shqiptar i krishterë, që kishte studiuar në Angli, themelon një këshill në Stamboll, me qëllim krijimin e shkollave dhe teksteve në gjuhën shqipe. Vështirësia e kësaj çështjeje qëndron në faktin se nuk ka alfabet shqiptar dhe intelektualët përpiqen të krijojnë një të tillë. Duke parë se shqipja ka shkronja greke dhe latine, disa propozojnë alfabetin latin dhe të tjerët atë grek. Kristoforidhi madje përparon më tej në krijimin e një vepre të rëndësishme, në krijimin e fjalorit greko-shqiptar. Deri atëhere intelektualët shqiptarë shikonin një farë ngjashmërie midis fjalëve greke dhe shqiptare, por pedanti i shquar shqiptar i Italisë qëndrore, *Dhimitër Kamarda, ishte ai që konstatoi i pari se shqipja përveç disa fjalëve të njëjta me greqishten, ka dhe fjalë e rrënjë që hasen vetëm në poemat homerike dhe shfaqi mendimin se shqipja përbën një "idiomë gjuhësore parahomerike".* Dhe se "gjuha e famshme e zotave", që përmend Homeri, nuk është veçse idioma e vjetër gjuhësore që, me mosekzistencën e arsimit dhe gjuhëformimit, populli shqiptar kishte arritur ta ruante gjatë mijëvjeçarëve.

Më vonë u konstatua se shqipja ruante pjesën më të madhe të gjuhës së lashtë pellazge dhe se ajo është çelësi për të kërkuar origjinën e shqiptarëve dhe të të gjitha fiseve Helene, të lidhim frerët e fisit helen dhe të provojmë kompaktësinë dhe vazhdimësinë e tij të pandërprerë. Me lidhjen e shqipes dhe pellazgjishtes, të shqiptarëve me pellazgët, të pellazgëve me të gjitha fiset e lashta Helene, mund të kërkojmë e të shikojmë nga një këndvështrim i ri tashmë historinë Helene që nga vitet e lashtësisë e deri tani. (Fq. 525)

Varianti zyrtar i shtetit shqiptar është se shqiptarët janë popull autokton, i ndryshëm nga grekët. Për pellazgët, për të cilët na flisnin të gjithë gjigantët e Rilindjes shqiptare të shekullit XIX[të], s'bëhet fjalë. Po kështu dhe historianët e rinj të Greqisë. Pellazgët nuk janë helenët e parë, - thonë, - por ... parahelenë. D.m.th. nuk janë helenë. Pra, këta pellazgë plangprishës dalin nga horizonti dhe

gjërat shkojnë në vendin e vet, e kështu qetësohemi. Hem, "t'ndar edhe t'zez". Pellazgët nuk janë mizë në qumësht, që ta nxjerrim e të pimë qumështin. Gjenden kudo ...

Gjenden në gjuhën greke dhe shqiptare. ... (Fq. 544)

Aristidh P. Kola

(Lindur: 8 Korrik 1944, Thiva, Greqi)

(Vdekur: 1 Tetor 2000, Athinë, Greqi)

MUZAFER KORKUTI

PARAILIRËT, ILIRËT, ARBËRIT

Histori e Shkurtër

Botimet *"TOENA"*
Tiranë 2003

Fiset me kulturë të njëjtë ose të ngjashme mund të flasin gjuhë të ndryshme.

Do të ishte e vështirë të pretendohej se vetëm gjuha paraqet tiparin etnik të një grupi.

Kur flasin për marrëdhëniet midis kulturës dhe etnosit duhet të kemi parasysh lidhjet midis gjuhës dhe kulturës, mbasi dihet se gjuha është një nga tiparet që përcakton karakterin etnik. Por ky nuk është tipar i vetëm, e aq më tepër për epokën *pre dhe protohistorike*[1], ku ka edhe një varg tiparesh të tjera të rëndësishme, të cilat në tërësinë e tyre formojnë historinë etno-kulturore të një popullsie. Prandaj historinë e gjuhës nuk mund ta barazojmë me historinë etnike e aq më pak, në tërësi, me historinë e një popullsie që e flet, e cila ka një përmbajtje shumë më të gjerë e më të plotë. (fq. 17)

---

[1] *Shënim B.P.:* prehistoria = parahistoria.

Protohistoria është një periudhë midis parahistorisë (prehistorisë) dhe historisë, gjatë së cilës një kulturë apo civilizim ende nuk e ka zhvilluar shkrimin, por kulturat e tjera tashmë e kanë vërejtur ekzistencën e saj në shkrimet e tyre. ...

Të dhënat e para për emërtimin e kësaj popullsie *(bëhet fjalë për Pellazgët: Shënim B.P.)* do t'i gjejmë tek autorët më të vjetër të Greqisë së Lashtë, tek Homeri, Hesiodi, Herodoti dhe tek mbi 100 autorë të tjerë Grekë e Latinë, të cilët flasin për Pellazgët si një popullsi jo Greke. (Në mënyrë të plotë këto të dhëna gjenden në veprën e Fr. Lochner-Hüttenboch, "Die Pelasger"). Homeri i përmend Pellazgët si banorë të Thesalisë e të Kretës; shkrimtarë më të rinj si Hesiodi, Herodoti, Hekateu, Tuqididi, na japin njoftime të tjera, duke i vendosur Pellazgët herë në Peloponez, herë në Azi të Vogël e herë në Itali, ndërsa gjuhën e tyre, Pellazgjishten, e quajnë gjuhë barbare, d.m.th. jo Greke. (fq. 21)

Termi Pellazg, që trashëgojmë nga burimet antike dhe që mendojmë se gjen mbështetje pjesërisht nga të dhënat arkeologjike, mund të përdoret në kuptimin konvencional, me një përmbajtje dhe domethënie të caktuar. Kështu, bashkësia e gjerë kulturore, kultike dhe pjesërisht etno-gjuhësore, që u formua gjatë Eneolitit[2] në Ballkanin Perëndimor, mund të quhet Pellazgjike. ... Duke përdorur emrin konvencional Pellazg për nënshtresën para-Ilire, *themelore nuk është emri vetë, por evidentimi dhe përcaktimi i rolit që luajti ky substrat etnolinguistik në periudhën e kalimit nga eneoliti në bronz,* me fjalë të tjera, të vihet në dukje ajo që ndodhi në planin kulturor dhe etnik në fund të mijëvjeçarit të katërt dhe në fillim të mijëvjeçarit të tretë para erës sonë në Ballkanin Perëndimor. (fq. 23)

Për rolin e përbërësit eneolitik vendas na dëshmojnë edhe disa të dhëna antropologjike nga skeletet e varreve të bronzit të hershëm, të cilat dëshmojnë se popullsia e ardhur u asimilua nga popullsia vendase më e shumtë në numër.

---

[2] *Shënim B.P.:* Epoka e Neolitit ose ndryshe Epoka e Gurit të Ri; Epoka e Eneolitit ose ndryshe Epoka e Bakrit (Për më tepër shih:"Kristo Frashëri", po në këtë libër)

Si shtrirje kohore këto dy epoka kapin periudhën midis mijëvjecarit të shtatë dhe mijëvjecarit të katërt para e.s. (sipas M. Korkuti; nxjerrë po nga ky libër fq. 12)

Këto janë disa të dhëna arkeologjike të dorës së parë, që na lejojnë të shprehemi për një vazhdimësi kulturore dhe etnike nga epoka eneolitike në atë të bronzit të hershëm. ... Më shkoqur, me vazhdimësi ne nënkuptojmë përbërësin etno-kulturor eneolitik, i cili mori pjesë aktive në formimin e etnosit Ilir gjatë epokës së bronzit.

Ky përbërës është edhe nyja lidhëse midis banorëve Ilirë të epokës së bronzit dhe të banorëve të tejlashtë të epokës eneolitike të para-Ilirëve, të cilët i quajtëm konvencionalisht Pellazgë. Këto përfundime na japin të drejtën të shprehemi se Ilirët janë një nga popujt më të vjetër të gadishullit. (fq. 25)

Për herë të fundit, Ilirët përmenden në vitin 601 të erës sonë në kronikën e Shën Demetrit të Selanikut. Ndërsa më 1018, nga kronisti bizantin Mihail Ataliati, mësojmë emrin e provincës së Arbanonit, që zinte përafërsisht territorin, që në antikitet banohej nga fisi Ilir i Albanëve (Frashëri K., 57).

E quajmë të nevojshme të japim sqarimet e mundshme lidhur me lindjen dhe përdorimin e emrit Ilir. Termin Ilir (Illyris, Hyllirus), për herë të parë e ndeshim në burimet e shkruara tek Herodoti (Herodoti VIII, 137), por që ka mjaft të ngjarë të jetë përdorur akoma më herët. Në fillim ai ka pasur një kuptim të ngushtë gjeografik, me të cilin quheshin nga Grekët një a më shumë fise, që banonin në veri të tyre gjatë bregut të detit Adriatik. Ndoshta edhe ata e kanë thirrur veten e tyre Ilir. (fq. 31)

Në burimet e mëvonshme, emri Ilir dhe Iliriku, si provincë, e ndeshim deri aty nga shek. VI^{të} i erës sonë. (fq. 32)

Në fillim të shek. XX^{të} u shfaqën mendimet e para për përkatësinë racore të Ilirëve. *Sipas këtyre pikëpamjeve Ilirët, e ardhur në Evropën Juglindore, i përkasin racës nordike.* Ata gjetën në këtë trevë një popullsi, e cila në pjesën më të madhe ishte e racës mesdhetare. Nga përzierja e dy popullsive, sipas tyre, u formua një lidhje e re antropologjike, nordiko-mesdhetare. ... (fq. 38)

Ata *(studjuesit e ndryshëm: Shënim B.P.)* i bashkon vetëm fakti, që i bëjnë Ilirët të ardhur në trevën kur ata njihen nga burimet historike; kurse, përsa i takon vatrës më të hershme se nga erdhën Ilirët, ashtu edhe kohës së ardhjes së tyre, mendimet e parashtruara për këtë tezë ndahen me njera tjetrën, ose, shumë pak afrojnë midis tyre. (fq. 38)

Edhe një varg linguistësh, ... janë mbështetur në tezën sipas të cilës zona Skandinave ka qenë jo vetëm atdheu i protoindoevropianëve, por edhe djepi i qytetërimit Ballkano-Anatolik. Pikërisht këtu qëndron një e metë tjetër e prehistorianëve dhe e linguistëve që, siç pohon me të drejtë M. Budimir, - në studimin e prehistorisë Europiane ata nisen nga mjegulla Skandinave pa monumente të shkruara, dhe jo nga dielli Ballkano- Anatolik dhe shkrimi i hershëm i tij (Budimir. M, 1953, 28-29). (fq. 39)

J. G. Hahn, një shekull e gjysëm më parë (1854), është i pari që ka parashtruar tezën e tij se Shqiptarët janë pasardhës të Ilirëve dhe këta të fundit pasardhës të Pellazgëve (Hahn J. G. 213). Sipas tij Ilirishtja është një gjuhë Pellazgjike, në një kuptim më të gjerë Iliriano-Pellazge. Në tezën e tij Hahn përfshin tek Ilirët edhe Epirotët dhe Maqedonët; të gjithë këta popuj ai i bën të prejardhur prej Pellazgëve. Kjo tezë shpreh karakterin autokton të formimit të popullsisë Ilire nga një popullsi më e lashtë mesdhetare, të cilën e quan Pellazge. Njëqind vjet më vonë, më 1952, linguisti M. Budimir, duke analizuar të dhënat gjuhësore për Ilirët dhe paraIlirët, midis të tjerash arrin në përfundimin se Indoevropianët më të vjetër të zonës së pellgut të Mesdheut kanë qenë të ashtuquajturit Pelastë, të cilët kanë banuar në truallin e Ballkanit dhe të Italisë shumë kohë më parë se të vinin këtu Indoevropianët klasikë, fiset Greke e Italike. Sipas tij, Pelastëve u përkasin edhe Ilirët, që kanë lënë mjaft gjurmë linguistike (Budimir M., 1952, 10). (fq. 40)

Si rrjedhim, gjithnjë sipas tij *(bëhet fjalë për M. Garasanin; Shënim B.P.),* origjinën e Pellazgëve duhet ta lidhim me kompleksin Ballkano-Anatolik të kohës së hershme të bronzit, në të cilën duhet

të kërkojmë medoemos edhe origjinën e Ilirëve dhe të Trakëve të vjetër, të lidhur ngushtë me Pellazgët. Nga kjo bashkësi fisesh të ndryshme, të lidhura me kulturë dhe gjuhë të ngjashme, më vonë, pa kurrfarë ndërprerjeje gjatë zhvillimit historik Ilirët ndahen në perëndim, kurse Trakasit në lindje të Moravës (Garasanin M., 1956, 323, 332). (fq. 41)

Më 1955, S. Islami, H. Ceka, F. Prendi, S. Anamali, pasi shqyrtuan materialet e zbuluara në tumat e Matit, vunë re se një varg objektesh të epokës së hekurit kishin lidhje me objektet e epokës së bronzit. Këto të dhëna i çuan ata në përfundimin se ky vazhdim i traditave të bronzit në qeramikë na jep të drejtën të pohojmë: "Ilirët nuk kanë qenë vetëm bartës të kulturës së hekurit në vendin tonë, sikurse kanë shkruar shkencëtarët e huaj, por përkundrazi, ata kanë banuar në atdheun tonë edhe në kohën e bronzit" (Islami S., etj., 1955, 154). (fq. 43)

Më 1962, S. Islami dhe H. Ceka, duke interpretuar materialet arkeologjike të reja të Pazhokut dhe të Maliqit, arrijnë në përfundimin se dukjen e etnosit Ilir e shohim jo në mesin e mijëvjeçarit të dytë para erës sonë, por që në fillim të epokës së bronzit. Madje, pikëpamjen për lashtësinë e bartësve të kulturës së epokës së bronzit e çojnë edhe më tej, në epokën eneolitike (Islami S., Ceka H., 447). (fq. 43)

Madje në vendbanimet e Maliqit e të Trenit jo vetëm që provohet se Ilirët janë autoktonë, por edhe vijimësia kulturore etnike mund të ndiqet që nga epoka e bakrit e këtej (Anamali S., Korkuti M., 1969, 17). (fq. 44)

Përsa i takon periudhës së fillimit të formimit të etnosit Ilir pikëpamjet kanë ndryshuar nga koha në kohë, në një diapazon që shtrihet midis eneolitit dhe mesit të epokës së bronzit. Këto pikëpamje të ndryshme janë të dobishme e me vlerë se nxisin mendimin shkencor, por në të njëjtën kohë shprehin edhe pamjaftueshmërinë e argumentave e të fakteve për zgjidhjen përfundimtare të problemit. (fq. 45)

Në literaturën arkeologjike Shqiptare janë sjellë të dhëna të mjaftueshme, *që provojnë vijimësinë e pandërprerë kulturore në trevën e vendit tonë që nga periudha e bronzit të hershëm e këtej.* Mbi këtë bazë është shprehur pikëpamja se *që këtu fillon edhe etnogjeneza Ilire.* Pra sipas kësaj pikëpamjeje, fillimet e autoktonisë përputhen me fillimin e etnosit. (fq. 47)

Ne kemi shprehur pikëpamjen se, etnosi Ilir fillon të formohet mbi një bazë autoktone në bronzin e mesëm dhe me këtë nuk kemi parasysh ndonjë fazë të veçantë, por gjithë periudhën e bronzit të mesëm, të marrë si një tërësi, gjatë së cilës u shënuan ndryshime të rëndësishme në bazën ekonomike. ... Edhe në rrafshin gjuhësor, disa studjues kanë shprehur mendimin se, të dhënat gjuhësore për Ilirët shtrihen deri në kohën e kulturës së mesme Kreto-Mikeniane (Gavela B., 1965, 149). (fq. 50)

Me ndarjen e Perandorisë Romake në Perandorinë e Lindjes dhe Perandorinë e Perëndimit më 395 të erës sonë, Ilirët e jugut u përfshinë në Perandorinë e Lindjes ose siç u quajt ndryshe në Perandorinë e Bizantit. (fq. 51)

Gjuha ka qenë dhe mbetet një nga treguesit më parësorë në formimin dhe natyrisht edhe në përcaktimin e karakterit etnik të një populli....

I takon merita albanologut J. G. Hahn, i cili qysh në mesin e shek. XIX^{të} formuloi tezën e lidhjeve: Pellazgë – Ilirë – Shqiptarë. ... Kështu, Hahni arriti në përfundimin se Shqipja është vazhduese e drejtpërdrejtë e njerit prej dialekteve më të vjetër të Ilirishtes dhe Ilirët, si një nga popujt më të vjetër të Ballkanit, kanë lidhje me Pellazgët. Fakti që autori i kësaj pikëpamjeje e kërkon lidhjen e Shqipes me Pellazgjishten, pra shumë më herët në kohë dhe mbi bazën e Pellazgjishtes shumë të diskutueshme, e bëri tezën e autoktonisë së shqiptarëve shumë pak të besueshme. (fq. 59)

Krahas tezës Iliro-Shqiptare u parashtruan pikëpamje dhe teza të tjera, midis të cilave veçohet teza, sipas së cilës Shqiptarët janë

stërnipër të Trakëve e për rrjedhojë origjina e Shqipes duhet kërkuar tek Trakishtja dhe se Ilirishtja nuk është gjë tjetër veçse një dialekt Trak i ilirizuar (Bariae H., Albanorumanische Studien I, 125). Një qëndrim të ndërmjetëm kanë mbajtur disa gjuhëtarë të tjerë, të cilët bëjnë një bashkim të dy tezave. Sipas N. Joklit, karakteri Iliro-Thrakas i gjuhës Shqipe shpjegohet me faktin se karakteristikat gjuhësore të Ilirishtes përputhen me karakteristikat e njëjta të gjuhës Thrake (Jokli N., 24). (fq. 60)

..., edhe për Shqipen, dokumenti i parë i shkruar, formula e pagëzimit e vitit 1462, e cila është një fjali e vogël në Shqip, në mes të një shkrimi latinisht, është e një kohe shumë të largët me kohën kur është folur për herë të fundit Ilirishtja. (fq. 61)

Në rradhën e këtyre toponimeve, të cilat E. Çabej i quan nga provat më shteruese për të provuar autoktoninë e popullit Shqiptar, duhet përmendur edhe emri i fisit ilir Albanoi, që banonte në shpinë të Durrësit, emri nacional i vjetër i popullit dhe i vendit tonë, që u ruajt në formën Arbëri, Arbër, në truallin e Shqipërisë dhe në ngulimet Shqiptare të Italisë dhe Greqisë. (fq. 62)

Ndikimet e Greqishtes mbi Ilirishten e antikitetit të vonë e më pas mbi Arbërishten e periudhës së Mesjetës së hershme janë të dukshme, sidomos pas vendosjes së Greqishtes si gjuhë zyrtare e Perandorisë Bizantine. Në huazimin e fjalëve greke ka ndikuar edhe fakti se një pjesë e madhe e popullsisë së krishterë të territorit të vendit tonë ishte ortodokse e për rrjedhojë gjuha liturgjike ishte Greqisht (Demiraj Sh., 1988, 107-117). (fq. 65)

Bartësit e kulturës së Komanit kanë qenë një etnos, një popullsi autoktone vendase prejardhëse e popullsisë Ilire, e cila në burimet e shkruara të mëvonshme del me emrat Albanë, Arbanitë, Arbër. Ky emër është i njëjtë me emrin Albanët, që përmend Ptolemeu (Ptolemeu, III, 12, 20), të cilët shtriheshin në shpinë të Durrësit (fq. 76).

Në burimet e shkruara, për herë të fundit Ilirët do të përmenden në historinë e krishterë të Euagrit (Euagr, II, 18), kur bëhet fjalë

për luftën e Bizantit kundër Avarëve[3] në vitin 584; kurse kronistët bizantinë të shek. XI[të] të erës sonë e më pas do të përdorin emrin Albanoi, Arbanoi. (fq. 76)

Emri kombëtar mesjetar Arbër e Arbëri (Albani) është trashëguar nga onomastika Ilire. ...

... Në burimet e shkruara Latine përdorej etnikoni "Alvanoi", kurse në gjuhën e folur të vendasve u ruajt në trajtën "Arbanoi". (fq. 89)

Tërësia e të dhënavë gjuhësore e arkeologjike dhe interpretimi historik i tyre të çon në konkluzionin se teza e autoktonisë së Shqiptarëve lidhet drejtpërdrejt me burimin Ilir. Shqiptarët e sotëm banojnë në një truall, i cili në kohën e tejlashtë ka qenë banuar nga një popullsi paleoindoevropiane, në kohën historike (antike) ka qenë banuar nga Ilirët dhe në kohën e Mesjetës së hershme nga pasardhësit e tyre – Arbërit. (fq. 90)

Muzafer Korkuti

(Lindur: 1936, Fterrë)

[3] *Shënim B.P.:* Avarët janë një grup etnik vendas i Kaukazit Verilindor, i cili është mbizotërues në mesin e disa grupeve etnike, që jetojnë në Republikën Ruse të Dagestanit.

MUHARREM ABAZAJ

KODI I GJUHËS PELLAZGO – SHQIPE

Botim i Shtëpisë Botuese: "*EMAL*"
Tiranë 2011.

6.3 Arbër / Arbëri

Dokumentimi më i hershëm i këtij emërtimi është bërë nga Ptolemeu i Aleksandrisë në shek. II[të] të erës sonë, i cili e përmend atë si një fis Ilir që banonte diku në territorin e Durrësit. Ai e përmend këtë fis me emrin Albanoi dhe thotë se ata kanë edhe kryeqendrën e tyre Albanopolis. Ky dokumentim nga ana e Ptolemeut në shek. II të erës sonë nuk do të thotë se ky emërtim i përket kësaj periudhe; ai mund të ketë ekzistuar shumë kohë para se të jetë venë re nga Ptolemeu.

Për prejardhjen e këtij emërtimi janë shprehur mendime të ndryshme nga shumë studjues shqiptarë dhe të huaj. Një grup studjuesish, i përbërë nga gjuhëtarë shqiptarë dhe të huaj, ndër ta Çabej, Domi, Krahe, Majer, Sprache, e konsiderojnë të padiskutueshëm emërtimin e Ptolemeut "Albanoi" dhe janë të mendimit se fjala "Albanoi" është një fjalë e përbërë nga fjala e parme *"Alb"* dhe prapashtesa Ilire *"ano"*. Për këtë prapashtesë ata janë të mendimit se ajo mund të jetë një përzierje midis Ilirishtes dhe Latinishtes. Nga ana e Demirajt, tema *"Alb"* është konsideruar si jo e natyrës së gjuhës shqipe dhe këtë ai e trajton në trajtën *"Arb"*.

Duke mos qenë dakord me përfundimet e tyre për prejardhjen e këtij emërtimi, po shtjellojmë më poshtë pikëpamjen tonë.

Duke qenë se të gjitha fiset Ilire janë fise Pellazge, edhe emërtimi i përbashkët i tyre duhet të jetë bërë mbi bazën e kësaj gjuhe, të gjuhës Pellazgo – Shqipe. Por, si e kemi theksuar disa herë, këto emërtime kanë vetëm një mënyrë ndërtimi të vetme, e cila bëhet mbi bazën e një kompozimi disa fjalësh. Për rastin që po shqyrtojmë, Albanoi, duhet të bëjmë edhe një sqarim tjetër.

Edhe Ptolemeu, si shumë autorë të lashtësisë, nuk ka arritur të përputhë shqiptimin e kësaj fjale nga ana e vet banorëve vendas me mënyrën e paraqitjes grafike (me shkrim) në gjuhën e tij. Trajta Albanoi nuk është e saktë. Në vend të trajtës "Alban" duhej të përdorej trajta "Arban", e cila është në natyrë të Pellazgo – Shqipes.

Emërtimi "Arban" është i ndërtuar mbi bazën e kompozimit: *Ar – ban,* ndërsa prapashtesa (oi) është shtesim i mëvonshëm, nuk hyn në emërtimin fillestar.

Pjesa e parë e togfjalëshit – *Ar* (arë) për ne tani është fare e qartë. Ajo ka kuptimin e tokës së punueshme, të arës. Ndërsa elementi i dytë i kompozimit, *"ban"* është kuptimi i foljes *"bëj"* por në trajtën e gegërishtes. Kuptimi i plotë i emërtimit Arban është shumë i kuptueshëm; *Arban = bën + arë,* njeri që ka si mjeshtëri të bërit e një pjese toke të çfarëdoshme në tokë pjellore, njeri që është mjeshtër i punëve bujqësore, bujk. (fq. 123 – 124).

Nga ky emërtim i banorëve si *Arbër,* e mori emrin edhe krahina e tyre Arbana. Sot kemi një fshat pranë Tiranës me emrin Arbana, i cili përfshihet në atë territor ku kanë banuar *Arbanët* dhe ky emërtim nuk duhet të jetë i rastësishëm. (fq. 125).

Shtrohet problemi: pse ky emërtim *"Arbër"* u përgjithësua për të gjitha fiset e tjera ilire? (fq. 125).

ELENA KOCAQI

"ALBANËT"

Botim i Shtëpisë Botuese: "*EMAL*"
Korrik 2012.

Nuk është rastësi që populli shqiptar i sotëm quhet me emrin më të vjetër të Europës, Alban, me të cilin janë quajtur tërë popujt e Europës së vjetër. Kështu, Britania është quajtur Albion dhe Skocia, Albani, fiset gjermane teutono – trojane janë quajtur nga Straboni me emrin Albane, në Itali trojanët ngritën qytet me emrin Alban, në Detin e Zi Skithët e quanin veten Albanë, etj…. (fq.11).

Emri Albanë, sipas të gjitha burimeve historike dhe shkencore, do të thotë *"i Bardhë"*. Skithët që banonin në veri të Detit të Zi, të cilët ishin të së njëjtës racë me Iliro – Trojanët, thonë në kronikat e tyre *"se flokët tanë bjondë na vendosën emrin Albanë"*. Në të gjithë fjalorët fjala "albino" do të thotë "njeri i bardhë", Me një fjalë, emri Albanë me të cilin njihen shqiptarët e sotëm nga bota, ka kuptimin - *i bardhë.* (fq.12).

ELENA KOCAQI

"ROLI PELLAZGO – ILIR NË FORMIMIN E KOMBEVE DHE GJUHËVE EUROPIANE"

Botim i tretë i Shtëpisë Botuese: "*EMAL*"

Sumerët, që kanë qytetërimin dhe shkrimin më të lashtë në botë, dalin me tregues koke Brakicefal, ashtu siç ka qenë popullsia Europiane e epokës së bronzit dhe siç janë sot shqiptarët dhe raca gjermanike.

Banorët e vjetër të Armenisë, ashtu siç na tregon Herodoti, ishin me origjinë Frige.

Por sipas Strabonit, ata ishin me origjinë nga Thesalia, nga qyteti Armenium, të cilët morën pjesë në ekspeditat e Argonautëve.

Këta Armenë, më vonë kolonizuan pjesën e sipërme të Tigrit dhe Eufratit. Në Siri dhe Mesopotami ka gjithashtu një numër vendesh që mbajnë emra pellazgë, si Kaonia, Arimara, Larisa. Në Mesdheun Lindor edhe sot ka një pjesë të popullsisë brakicefalik, që tregon se ajo zonë ka qenë banuar dhe sunduar nga popullsi e bardhë Europiane.

Pra, nga të dhënat që japin, autorët klasikë antikë tregojnë se Armenët, të quajtur ndryshe Albanë, janë nga Thesalia apo nga Frigjia. (fq. 88).

..., etnitë brakicefali janë edhe më të vjetrat e Europës.

Cilat janë etnitë sot që kanë një kokë të pastër brakicefali?

Shqiptarët janë me një tregues qafalik nga më të lartët në Europë, me tregues 85 – 90, që shpesh quhen edhe si hiperbrakicefali. Shqipëria e jugut ka edhe hiperbrakicefalin më të lartë, ndoshta më të lartin në Europë. (fq. 97).

Edhe Armenia në Kaukaz ka të njëjtin tregues qafalik. Kjo racë është quajtur ndryshe edhe si raca Alpine. (fq. 98).

Duhet thënë se popullsia e vjetër Europiane është ruajtur nga malet. Vërejmë se është ruajtur nga Alpet Europiane, malet Karpate, Dinarike, Pirenejtë dhe malet e Kaukazit. . (fq. 100).

Shqiptarët quhen nga të huajt si Albanë dhe këtë emër duket se ata e lidhin me fisin e Albanëve që përmend gjeografi Ptoleme në shek. e II[të] para erës sonë (p.e.s.).

Fjalët Alban, Arban dhe Arian kanë të njëjtin kuptim – i Bardhë. (fq.101).

.., të dhënat antropologjike dëshmojnë se në deltën e Nilit dhe tek Sumerët, tremijë vjet para Krishtit, ka banuar një popullsi e bardhë. (fq. 224).

Teoria e gjuhëve indoeuropiane është një teori që duhet rishikuar, pasi ajo është ngritur pa studjuar gjuhën Shqipe, e cila është gjuha që kanë folur edhe popujt e vjetër të Europës dhe shumë e quajnë gjuhën e racës së bardhë, asaj Japetike.

Fjalët, që gjenden sot tek gjuha Indiane dhe Iraniane, nuk janë fjalë, që gjenden nga gjuhët Europiane me këto gjuhë, por gjenden midis Shqipes dhe këtyre gjuhëve. (fq. 227).

ELENA KOCAQI

"SHQIPJA – ÇELSI I GJUHËVE INDOEUROPIANE"

Botim i Shtëpisë Botuese: "*EMAL*"

Në Kaukaz gjendet gjuha Armene, që quhet gjuhë Indoeuropiane, dhe shkrimet e saj më të vjetra janë të shek. V^{të} – VII^{të} pas Krishtit. Gjuha e Frigasve në Azi të Vogël, që Herodoti e quan gjuhën më të vjetër në botë, rrjedh nga gjuha Hite *(Hittite – Shënim B.P.),* që është edhe gjuha më e vjetër e shkruar Indoeuropiane, që mund të datojë që në vitet 1600 para lindjes së Krishtit. (fq.7).

Tani lind pyetja: cila ka qenë gjuha bazë që ka lindur gjuhët Indoeuropiane?

Gjuhëtarët nuk kanë mundur të vërtetojnë se kush është gjuha bazë, që lindi të gjitha këto gjuhë. Gjuhëtari dhe albanologu Frank Boppi ka hedhur mendimin se Sanskritishtja ka qenë bazë e këtyre gjuhëve, gjë që nuk është vërtetuar. Ka pasur gjuhëtarë, që kanë menduar se duhet të ishte Armenishtja, por nga studimi i saj nuk dilnin aq shumë elementë të përbashkët që ta vërtetonin këtë teori.

...

Gjuha Shqipe është më afër nga të gjitha gjuhët me gjuhën mëmë Japetike, ose me gjuhën origjinale të popullsisë së racës së bardhë. (fq.9)

ARISTOTEL MICI

"PREJARDHJA E EMRIT SHQIPTAR"

Botim i dytë, *"Botimet DUDAJ"*
Tiranë, 2012.

Gjithë albanologët janë të mendimit se emërtimi i moçëm i kombit të shqiptarëve, *arbën-esh* ose *arbër-esh,* e ka prejardhjen prej fisit *Alban-oi,* që gjeografi aleksandrin i shek.II[të] pas Krishtit, Ptolemeu, e ka shkruar në hartën e tij si një fis ilir, që banonte diku në viset midis Durrësit dhe Matit.

... Italisht, shqiptari quhet *albanese,* frengjisht *albanais,* anglisht *albanian,* greqisht *arvanitis,* sllavisht *arbanas,* turqisht *Arnaut,* etj. (fq.7-8)

Shënim B.P.: (*të bie në sy fakti,* që në gjuhët me bazë latine emërtimi fillon me – al.., ndërsa në të tjerat me –ar;)

Kështu, emri *shqiptar* dhe emri *Shqipëri* nuk kishin dalë ende deri në fund të shek. XV. (fq. 13)

...

Dhe më vonë, siç pohohet në Historinë e Shqipërisë, në vitin 1336, Principata e Arbrit qe forcuar aq shumë sa Ludoviku, i biri i Karlit të Anzhuinëve, i njohu Andrea Muzakës titullin Despot i Arbërisë. Tri dekada më pas, kur Andrea Muzaka II[të] i mundi Bullgarët tek mali i Peristerit, në vitin 1372, pozita e despotatit u

forcua edhe më tepër. Në ndihmë të këtij mendimi na vjen princi Gjon Muzaka, i cili, në *Memorie-n* e vet, shkruar më 1510, tregon se si "Perandori i Kostantinopolit u kënaq shumë që zoti Andrea Muzaka kishte pasur një fitore të tillë, meqë kishte larguar nga muret e Adrianopolit armikun e tij të madh... I përmenduri Perandor urdhëroi që t'i jepnin atij stemën, d.m.th. *shqiponjën me dy krerë*..., i dha një titull despotal... në të cilin ishte përvijuar me gurë xhevahiri shqiponja që thamë". (fq. 20-21).

Me këtë flamur me shqiponjë Andrea Muzaka, në krye të luftëtarëve të tij, do të shkonte në betejën e Fushë Kosovës më 1389 kundër ushtrisë së Sulltan Muratit të Parë. (fq. 21).

Ky emër i ri i popullit duhet të jetë përftuar përgjatë udhës së historisë, përmes luftës së vazhdueshme kundër pushtuesit otoman. (fq. 32).

Shënim B.P.: Bëhet fjalë për emrin - shqiptar

Aleksandër Mici

(Lindur: 1935, Fier)

MARIKA BUTSKHRIKIDZE

"STUDJUESJA GJEORGJIANE: NGJASHMËRI INTRIGUESE NDËRMJET SHQIPES DHE ARMENISHTES"

Nxjerrë nga artikulli:

Botuar në gazetën *"Standart"*
fq. 18, të datës "E Hënë, 09.12.2013".

Duke pasur në dispozicion fjalorë të ndryshëm etimologjikë të Shqipes dhe Armenishtes, po ashtu edhe revista shkencore, kuptova se të parët që i kishin kushtuar vëmendje e që kishin shkruar për afërsinë mes gjuhës Shqipe dhe Armenishtes ishin H. Pedersen (1906) dhe V. Pisani (1950, 1959). Artikujt e botuar së fundmi për këtë çështje ishin nga Kortlandt (1980) dhe Martirosian (2013). Martirosiani (2010) në fjalorin "Etymological Dictionary of the Armenian Inherited Lexicon" jep një listë me 49 (dyzet e nëntë) fjalë Shqipe, që ngjasojnë me Armenishten. Këto fjalë janë:

"bletëz, botë, bredh, dal, dele, dell, derë, det, dhallë, dhi, dhje, dhjetë, djathë, djersë, dorë, dredh, drithë, dru/drũ, end/ẽn(d), ëndërrë, fjalë, gjalpë, gogël, herdhë, hudhër, im, lerë, mat, mish, mjaltë, mjekër, mo, nënë, nëntë, një, nuse, rrënjë, sorrë, tatë, -a, thërí/th(ë)ní, thjër(r), thur, trishe, udhë, verë/v në, verrë, veth, vidh, zog".

...

Përveç ngjashmërive tashmë tepër të njohura mes Shqipes e Armenishtes, si p.sh:

Armenisht	*Shqip*
ğerm/ğem "ngroht"	zjarm;
atamn	dhembë (dhëmb)
anurğ	ëndërr (Gegërisht - anerr);
asem	them (thom)
arğ	ari

shënimet e mia tregojnë që janë edhe 30 (tridhjetë) fjalë të tjera, që mund të konsiderohen si të ngjashme, p. sh:

Armenisht	*Shqip*
ašuçs (ałuēs)	dhelpër
ašbewr/ašbiwr (ałbewr/ałbiwr)	burim
ari	marr (mora)
astowac {ast(ow)-ac}	zot
eran (fllad)	era
erek	err
ëmpem	(unë) pi
cownr	gju- gjû
cuc	cucla *(kapëz, biberon; Shënim B.P.)*
kašğin (kałǰin)	argjilë *(baltë; Shënim B.P.)*
kask-eni	gështenjë
kov	ka
jev	edhe/dhe
ğur (jur)	ujë

lk‘nem	me lan
mçg (mẽg)	mjegull
mnam	me nejt
mozi “viq”	mazi/mezi *(mëz; Shënim B.P.)*
pagow (pagenam, pagi)	puth/puthje
tam	me dhanë
t‘aYamim/t‘aYšamim (t’aŕamim/t’aŕšamim)	me terë, me tha

Përveç disa studimeve fragmentare për këtë çështje, unë deri më tani nuk kam hasur në studime të thella e sistematike për ngjashmëritë midis Armenishtes dhe Shqipes. Mendoj se një studim i tillë do të hidhte më shumë dritë sa i përket vendit që kanë këto gjuhë të izoluara brenda familjes së gjuhëve indo-evropiane dhe për historitë e tyre përkatëse.

Shënime Sqaruese B.P.:

1. Duke analizuar shenjat konvencionale, që janë përdorur për të shprehur germa dhe shqiptime, që nuk janë në alfabetin Shqip, më poshtë po përpiqem të jap transkriptin e tyre:

dru	drũ – dri (Shih tek fjalët e Martirosian më sipër)
end	ẽn – n(d) (Shih tek fjalët e Martirosian më sipër)
verë	vẽnë - v në (siç duket, germa - **ẽ** - përfaqëson një -**ë**- të pazëshme) (Shih tek fjalët e Martirosian më sipër)
ğ	(është transkripti i germës **xh** ose ***ç*** të gjuhës Shqipe)
ŕ	(është transkripti i germës ***n*** të gjuhës Armene = ***rr*** e gjuhës Shqipe)

2. Materiali i mësipërm është marrë nga shkrimi në gazetën "Standart", fq. 18, të datës "E Hënë, 09.12.2013"; mbi të ka plotësime dhe shënime të nxjerra nga po ky material, me po këtë përmbajtje, por i botuar në Internet në gjuhën Angleze, pa hequr dhe pa cënuar asgjë nga materiali i gazetës në gjuhën Shqipe.

LUFTULLA PEZA, LILJANA PEZA

"GJUHËT E LASHTA TË BALLKANIT DHE ANADOLLIT DHE FAMILJA PELLAZGJIKE E GJUHËVE"

Geer
Tiranë 2018

Gjuha Hitite ka rëndësi të madhe për gjuhësinë perëndimore, *sepse dokumenti i parë i shkruar i kësaj gjuhe njihet si më i vjetri dokument i shkruar i gjuhëve të familjes Indo-Europiane.*

...

... Perandoria Hitite (afërsisht në periudhën 1650-1180 p.e.s.) në kulmin e zhvillimit të saj, ka qenë njera nga fuqitë më të mëdha të kohës, krahas Egjiptit, Asirisë, Babilonisë dhe mbretërisë së Mikenës në Pellazgji[1]. (fq. 7)

Gjuha Pellazge është njëkohësisht gjuha e shkruar më herët se të gjitha gjuhët e botës, që gjatë mijëvjeçarit të 6të p.e.s., siç është dëshmuar në kulturën Pellazge Vinkë-Turdas, kjo është gjuha e folur

[1] (Në kohrat parahistorike rajoni i Egjeut dhe i Ballkanit, sipas Herodotit quhej Pellazgjia [2.56.1], sepse banohej vetëm nga fiset e ndryshme Pellazge, ku kishin ngritur qytetërimin e tyre, të njohur si qytetërimi Pellazg)

në mbarë Ballkanin, Azinë e Vogël dhe në rajone të tjera, po ashtu është edhe gjuha e Homerit dhe e kryeveprave letrare të letërsisë Europiane "Ilias" dhe "Odisea".

...

Familja Pellazge e gjuhëve ndahet në dy nënfamilje të mëdha gjuhësh:

1. Nënfamilja e gjuhëve të lashta të Ballkanit dhe të Anadollit. Në këtë nënfamilje gjuhësh bëjnë pjesë gjuhët e lashta: ilire, epirote, dardane, maqedone, thrake, dake si dhe gjuha etruske dhe ajo Sarde. Grupi tjetër janë gjuhët e lashta të Anadollit, ku përfshihen gjuhët: hitite, luviane, palaike, like, lide, kariane, frige, jone dhe shumere. Këto gjuhë janë të gjitha gjuhë pasardhëse të gjuhës së lashtë Pellazge.

2. Nënfamilja Indo-Europiane e gjuhëve, ku përfshihen degët e njohura të gjuhëve: tokare, armene, gjermanike, greke, kelte, indo-ariane, iraniane, latine, baltike dhe sllave. Të gjitha këto gjuhë gjatë procesit të formimit të tyre janë ndikuar shumë nga gjuha Pellazge, Para-Indo-Europiane dhe gjuhët e tjera, që e kanë origjinën tek ajo

Për të arritur në këto përfundime ndihmë të veçantë jep gjuha e sotme Shqipe. Gjuha Shqipe nga disa studjues të saj paraqitet gjuhë fare e re, por në fakt ajo i ka rrënjët në lashtësinë e largët Pellazge. Ajo rrjedh direkt nga gjuha Pellazge dhe dokumentet më të hershme shkrimore të gjuhës Pellazge dhe të gjuhës Shqipe ndodhen në kulturën Vinkë-Turdas. (fq. 11)

Dijetarët mendojnë se Hititët dhe popujt e tjerë të Anadollit të kohës së bronzit nuk janë vendas, autoktonë, por të ardhur në Anadoll gjatë mijëvjeçarit të tretë p.e.s. Historianët mendojnë se gjatë mijëvjeçarit të tretë p.e.s., një fis, që fliste një dialekt indo-europian, arriti në Anadollin qendror, ku banonte fisi Hatti. Hipoteza kurgan, ngritur nga arkeologia M. Gimbutas (1973, 1982), vendin e lindjes së gjuhëve Indo-Europiane e vendos në stepën Pontike, në veri të detit të Zi dhe të detit Kaspik. Duke u bazuar në këtë teori, disa dijetarë mendojnë se folësit e gjuhëve të Anadollit kanë ardhë pikërisht nga

këto stepat në jug të Rusisë nëpërmjet dy rrugëve të mundshme: Kaukazit apo Ballkanit. (fq. 13 - 14)

...

Nga ana tjetër Russel e bashkëpuntorë (2003) dhe Bouckaert e bashkëpuntorë (2012) mbështesin përhapjen e gjuhëve Indo-Europiane nga Anadolli në Europë me përhapjen e bujqësisë, filluar 8000 vjet deri 9500 vjet më parë, d.m.th. gjatë Mesolitit. Kjo do të thotë se popujt e Anadollit dhe bashkë me ta edhe gjuhët e lashta të Anadollit, janë vendas dhe jo të ardhur. (fq. 14)

Zeuastika në Indi njihet si shenjë Ariane. Arianët janë fis i lashtë Pellazg, larguar nga rajoni i Egjeut rreth 4-5 mijë vjet p.e.s., kjo do të thotë gjatë fundit të neolitit (gurvonit), fillimit të kohës së bronzit dhe arriti në Indi. Me vete Arianët, ndër të tjera, morën edhe Zeuastikën pellazge. (fq. 22)

Pellazgët kanë shkruar me shkrimin e tyre alfabetik qysh gjatë mijëvjeçarit të 6 p.e.s., gjë që është shfaqur për herë të parë në kulturën Pellazge të Vinkë-Turdas. (fq. 23)

Gjuha Etruske është gjuhë e folur dhe e shkruar në Itali gjatë mijëvjeçarit të fundit p.e.s., ndërsa gjuha Latine lindi dhe u zhvillua nën ndikimin e saj të drejtpërdrejtë gjatë shekujve të fundit p.e.s. dhe në fillim të erës sonë. Qytetërimi Etrusk dhe gjuha Etruske kanë qenë djepi, ku lindi dhe u zhvillua qytetërimi i mëvonshëm Romako-Latin. Latinishtja huazoi jo vetëm fjalorin e pasur të gjuhës së shkruar Etruske, por edhe shkronjat dhe alfabetin Etrusk, që e ka zanafillën në alfabetin Pellazg.

Le të kujtojmë se Roma është themeluar në vitin 753 p.e.s. nga pasardhës të princit trojan Enea, i cili pas luftës së Trojës (rreth vitit 1250 p.e.s.) dhe shkatërrimit të saj nga Akejt dhe aleatët e tyre, erdhi dhe u vendos në Lat. (fq. 24)

Gjuha Hitite është gjuha e folur nga Hititët dhe më e njohur dhe më e rëndësishme e rajonit të Anadollit gjatë kohës së bronzit.

Ajo është gjuhë e familjes Indo-Europiane dhe përmendet se është gjuhë e vdekur, sepse deri tani mendohet se nuk ka ngjashmëri me asnjë gjuhë, që flitet sot në botë. (fq. 27)

Hrozny[2] ka pasur mendimin se gjuha Hitite është gjuhë e familjes Europiane deri në Indi, është gjuhë e vdekur dhe që nuk ka asnjë lidhje me ndonjë gjuhë të gjallë të sotme. (fq. 33)

Nga afërsia e madhe e gjuhëve të Anadollit me gjuhën Shqipe mendojmë, që edhe gjuhët e Anadollit rrjedhin nga gjuha më e lashtë, Pellazge. (fq. 68)

Ngjashmëria e gjuhëve të Anadollit me gjuhën e sotme Shqipe vërteton tezën tonë se në Ballkan dhe në Anadoll, gjatë kohës së bronzit është folur një gjuhë e lashtë, gjuha Pellazge, e përfaqësuar nga shumë dialekte, që më pas kanë vazhduar si dialekte të ndryshme. Kjo do të thotë se ky rajon i gjerë ka qenë banuar nga një popull, që ka folur një gjuhë të ndarë në shumë dialekte, që e ka origjinën tek gjuha e lashtë Pellazge, që mbijeton sot në gjuhën Shqipe. (fq. 69)

Ruma (Roma e sotme) u themelua nga Pellazgët trojanë në vitin 753 p.e.s. (fq. 74)

I pari, që mundi të zbardhë mbishkrimet Etruske me ndihmën e gjuhës Shqipe, ka qenë studjuesi arvanitas Jakov Thomopulos, i cili botoi veprën Pellazgjia, 1912. Por vepra e tij mbeti vetëm në greqisht dhe kështu është fare pak e njohur për lexuesit.

Z. Majani dhe N. Vlora-Falaski ndoqën rrugën e filluar nga Thomopulos dhe arritën suksese. Në sajë të punës së tyre, sot në Itali, që në shkollat 7 vjeçare, nxënësit mësojnë se gjuha Etruske është shumë e afërt me gjuhën Shqipe. (fq. 74 -75)

Megjithë këtë punë kolosale të vërtetimit të afrimit të madh të Etruskishtes me gjuhën Shqipe, të habit përfundimi i Sh. Demiraj (2008, 49) që deklaron se "nuk ka asnjë element, që mund të dëshmojë

[2] *Shënim B.P.:* Hrozny - gjuhëtar Çek, 1879 - 1952

për ndonjë lidhje gjuhësore midis Etruskishtes dhe Shqipes". Kjo deklaratë, në kundërshtim të plotë me të vërtetën shkencore, e paraqit Demirajn jo serioz dhe mohues i së vërtetës. Këtë qëndrim mbajnë edhe nxënësit e tij mbi gjuhën Etruske dhe të lidhjes së saj me gjuhën Shqipe. (fq. 84)

Ishulli i Sardenjës, ashtu si gjithë Italia, gjatë periudhës së bronzit ka qenë banuar nga Pellazgët ose njerëzit e detit, siç i quajnë disa autorë. (fq. 85)

Nga dyndjet e popujve të ndryshëm që erdhën në Ballkan, duke filluar me Grekët nga mesi i mijëvjeçarit të fundit p.e.s. dhe ndikimin e tyre mbi gjuhët e popujve vendas, autoktonë, këto gjuhë pak nga pak u tkurrën dhe disa u asimiluan. Shkrimtarët e vjetër Grekë dhe Romakë na bëjnë të ditur se këto gjuhë të lashta të folura në Ballkan janë: ilirishtja, epirotja, maqedonishtja e vjetër, thrakishtja, dakishtja, mesapishtja, gjuhët mise dhe paone. Sipas dëshmive nga shumë mbishkrime të lashta, këto gjuhë të gjitha kanë lidhje të ngushtë me gjuhën e sotme Shqipe, mbasi kanë shumë fjalë të përbashkëta me Shqipen. (fq. 96)

Ilirët kanë qenë një grup shqipfolës shumë i madh, që përmenden për herë të parë në histori gjatë shekullit të 6^{të} p.e.s. nga autorët antikë. Por fise të veçanta Ilire përmenden edhe nga Homeri në Iliadë, kështu që, Ilirët njihen nga historia qysh nga shekulli i 8^{të} p.e.s. (fq. 96)

Majani (1973) dhe N. Vlora (2004) kanë vërtetuar plotësisht lidhjen e gjuhës Etruske me gjuhën Shqipe, me anë të analizës së mjaft mbishkrimeve Etruske. (fq. 117)

Siç shihet, alfabeti i shpikur nga Pellazgët qysh në mijëvjeçarin e 6^{të} p.e.s. është trashëguar nga Ilirët brez pas brezi, duke e përdorur për të shkruar gjuhën e tyre. Ky alfabet, më pas, nga fundi i mijëvjeçarit të fundit p.e.s. u përshtat nga Grekët për gjuhën e tyre dhe gjatë kohës klasike e përshtatën Romakët për të shkruar në gjuhën Latine. Këta e morën dhe e përshtatën me alfabetin Etrusk.

Përfundimi ynë për këtë pjesë të studimit është ky:

Ilirët kanë folur dhe e kanë shkruar gjuhën e tyre me alfabetin Pellazg/Ilir, e cila vazhdoi pa ndërprerje në kohrat më të reja në gjuhën Shqipe. (fq. 119)

I biri i Filipit dhe i princeshës epirote Olimpia, Aleksandri i III[të] i Madh (356-323 p.e.s.), ..., me ushtrinë e tij të përbërë nga 35 000 vetë, kryesisht Maqedonas, Ilirë dhe Thrakë. ... (fq. 126)

Emri Grekë dhe Greqi ka dalë shumë vonë, që u fut nga Romakët gjatë kohës së Perandorisë Bizantine. Shteti i quajtur Greqi për herë të parë u ngrit me revolucionin Arvanit në vitin 1821 dhe fitimin e pavarësisë nga Turqia. (fq. 126)

Emërtimi "Dhrahmi" i parasë Maqedonase është i njëjtë si ai i popujve të tjerë të lashtë të Ballkanit, që kanë përdorur dhrahminë si para. (fq. 129)

Thraka ka një histori mjaft të lashtë, që e ka fillimin e saj rreth 4-5 mijë vjet p.e.s.. Mbretëria e Thrakës është themeluar gjatë shekujve 5-1 p.e.s.. Herodoti ka shkruar se Thrakasit, përsa i përket numrit të popullsisë, vinin të parët në Europë dhe të dytët në botë, pas Indianëve. (fq. 137)

Thraka dhe Thrakët përmenden në Iliasin e Homerit dhe në luftën e Trojës, se kanë qenë aleatë të Trojanëve, farefis të një gjaku dhe flisnin të njëjtën gjuhë. (fq. 137)

Thrakasit kanë folur një gjuhë Indo-Europiane, që është përdorur edhe e shkruar deri në shekullin e 6[të] p.e.s. në jug të gadishullit Ballkanik. Ajo nga shkenca sot njihet si një gjuhë e vdekur, pa lënë gjurmë në ndonjë gjuhë tjetër të gjallë. Por studimi ynë vërteton të kundërtën, sepse gjuha Thrake ka afërsi të madhe me gjuhën Shqipe dhe kështu që ajo nuk është gjuhë e vdekur. (fq. 139)

Grekët kanë ardhur në Ballkan si barinj dhe pa asnjë nivel kulturor gjatë shekullit të 5[të] p.e.s. Grekët nuk dihet se nga kanë ardhur, sepse në vendin e origjinës nuk kanë lënë asnjë dokument

kulturor dhe asnjë të tillë nuk sollën me vete, kur erdhën. Dokumentet e para kulturore Greke në Ballkan dhe në Rajonin e Egjeut fillojnë të shfaqen gjatë shekullit të 5të p.e.s. në Trojë dhe ishullin e Lemnit. Por këto nuk janë dokumente shkrimore. Fiset Greke kur erdhën nuk kishin as emër. (fq. 146)

Emërtimin "Pellazg" për herë të parë në histori e gjejmë të përdoret nga Omeri në Ilias dhe Odise dhe nga Hesiodi, që sipas të gjitha datimeve në kohën e sotme, janë formuluar nga gojëdhënat popullore gjatë shekullit 8të p.e.s.. Këta autorë në epikat e tyre sjellin mjaft të dhëna të rëndësishme për jetën gjatë kohës së bronzit në rajonin e Egjeut, Ballkan dhe Azi të Vogël dhe për banorët Pellazgë, që kanë banuar në rajon shumë shekuj para autorëve. (fq. 159)

Të dy poetët në poemat e tyre nuk i përmendin asnjëherë Grekët apo Helenët, sepse ata nuk i kanë njohur, për arsye se Grekët në kohën e tyre ende nuk kishin ardhur në rajonin e Egjeut dhe në Ballkan. (fq. 159)

Të dhënat e Omerit[3] dhe Hesiodit kanë rëndësi të madhe të gjithanshme për shkencën dhe kulturën, sepse janë plotësisht të besueshme, sepse në kohën e tyre në rajonin e Egjeut popullsia Pellazge ishte e vetme dhe nuk kishte ndikime etnike dhe nacionaliste. (fq. 159)

Pellazgët përmenden gjerësisht edhe nga autorët e mëvonshëm pas Omerit, Herodoti (Historia 1.57), Thuciditi (Gjeogr. 4,109), Straboni, Dionisi i Halikarnasit, Plini plak, Eskili, Sofokliu, Euripidi, Virgjili, etj., të cilët emërtimin Pellazgë dhe Pellazgjia i kanë përdorur për të treguar popullatën para-Greke, që ka jetuar në rajonin e Ballkanit, Egjeut, Anadollit, Kretë dhe ishujt e mesdheut. Pellazgjia është quajtur i gjithë ky rajon në kohrat e lashta parahistorike, deri kur u pushtuan nga Perandoria Maqedone dhe më pas nga ajo Romake. (fq. 160)

[3] *Shënim L.L. Peza:* Në vend të emrit "Homer" është përdorur emri "Omer" sepse është emër Pellazg i trashëguar nga kohë shumë të largëta. Edhe në ditët e sotme ne kemi të trashëguar nga e kaluara emrat: Omer, Ymer, Imer.

Emërtimi "Grekë" nuk ka ekzistuar në lashtësi; ai për herë të parë është futur në përdorim nga Romakët dhe është përdorur gjatë Perandorisë Bizantine. Ndërsa shteti me emrin "Greqi" u shpall pas revolucionit Arvanit më 1821 dhe mbreti i parë i vendit ka qenë Oto nga Bavaria. (fq. 160)

Gjuha e përdorur nga Homeri në "Iliadë" dhe "Odise" është gjuha Pellazge, siç vërtetohet nga mjaft studjues, që i kanë studjuar këto vepra. .... Nga ana tjetër në enciklopeditë botërore shkruhet se në epikat e Homerit Grekët apo Helenët asnjëherë nuk përmenden, sepse Omeri ata nuk i njihte. Kjo të çon në përfundimin se epikat e Omerit janë shkruar në gjuhën Pellazge. (fq. 161)

Shënim B.P.: Duke analizuar fillimet e epikave të Homerit (Iliasin dhe Odisenë) autori L.L. Peza konkludon si më poshtë:

Nga kjo paraqitje shohim, që të gjitha fjalët në rreshtat e parë të epikave të Omerit janë në gjuhën Pellazge, e vetmja gjuhë e folur dhe e shkruar në rajonin e Egjeut, Ballkan, Anadoll dhe më gjerë gjatë kohës së bronzit dhe antike. Edhe alfabeti i përdorur në këto epika është alfabeti Pellazg, i vetmi i njohur qysh nga qytetërimi Vinkë-Turdas. Ky alfabet u kopjua më pas nga Grekët, për të shkruar gjuhën e tyre, ndërsa Latinët përshtatën për gjuhën e tyre alfabetin Etrusk, një formë e alfabetit Pellazg. (fq. 162)

Me rëndësi të madhe është fakti se të gjitha fjalët, që ndodhen në rreshtat e parë të Iliasit dhe Odisesë, si dhe nga disa pjesë të tjera të këtyre veprave, janë sot në përdorim në gjuhën Shqipe. Është përdorur dialekti *"Gegë"* dhe fjalët janë Omerike, nga një herë janë të bashkuara ose të shkurtuara. Asnjë fjalë Greke nuk ka në Ilias dhe Odise dhe teorikisht nuk mund të ketë, *sepse Grekët kanë ardhë në rajonin e Egjeut 400-500 vjet pasi janë shkruar poemat Homerike.* (fq. 162)

I pari studjues, që e ka vënë re praninë e fjalëve të gjuhës Pellazge në veprat e autorëve antikë është Z. Krispi, arbëresh i Kalabrisë, i cili gjuhën Shqipe e kishte gjuhë amtare. ... *Krispi (1832) ndërtoi edhe fjalorin e parë Pellazgjisht – Shqip.* (fq. 162)

Në fund të epokës së bronzit – fillim të kohës së hekurit shoqëria Pellazge pëson transformime rrënjësore dhe nga një perandori e madhe Pellazge, që shtrihej nga Europa në Mesdhe, Anadoll deri në Iran, formohen mbretëri më të vogla, me shumë fise, por me një gjuhë të ndarë në dialekte të ndryshme. Në këtë kohë në histori në Ballkan shfaqen mbretëritë Ilire, Maqedone, Dardane, Thrake, Epirote, Dake, etj.; në Anadoll shfaqen mbretëritë Hitite, Luviane, Lide, Like, Kariane, etj. Të gjithë këta popuj, sipas studimit të kryer më sipër, mbi bazën e mbishkrimeve të ndryshme, kanë folur një gjuhë, por në dialektet e tyre. ...

Ndërsa në Anadoll dhe në një pjesë të Ballkanit popujt u asimiluan nga popuj të rinj të ardhur dhe për pasojë pak nga pak edhe gjuhët u zhdukën, Ilirët, Dardanët, Maqedonët, Epirotët, Arvanitët dhe Arbëreshët nuk u asimiluan, e ruajtën gjuhën e tyre, disa e ruajtën edhe territorin e tyre. (fq. 164)

Dëshmi të tjera të gjuhës Pellazge ndodhen edhe në gjuhën Greke. Para mjaft vitesh është vërtetuar se në fjalorin e gjuhës Greke ka një përqindje të lartë fjalësh, emra të përgjithshëm, njerzish dhe emra vendesh, që nuk gjejnë shpjegim në vetë gjuhën Greke, sepse i përkasin një gjuhe tjetër, më të vjetër se gjuha Greke dhe janë huazuar nga kjo gjuhë. Këto fjalë i përkasin gjuhës paraGreke ose Pellazge. (fq. 165)

"Historia e Greqisë", në të vërtetë, në pjesën më të madhe është historia e Pellazgjisë. E gjithë Europa jugore gjatë kohrave më të lashta e deri në shekujt e parë të mijëvjeçarit të fundit p.e.s. përbënte Pellazgjinë dhe banohej nga Pellazgët. ...(fq. 171)

Shënim B.P.: Duke folur për "rajonet më jugore të Ballkanit, ..., ku spikasin qytet–shtetet e Thebës, Athinës, Korinthit, Spartës, Mikenës, Pillit, etj." (fq. 117-172), autori L.L. Peza vazhdon:

Në të gjitha këto rajone është folur një gjuhë e vetme, gjuha Pellazge, që vërtetohet nga mbishkrimet e ndeshura dhe të studjuara. Nga këta Pellazgë më pas lindën Arvanitët, që janë i vetmi popull

autokton në këto rajone. Më pas, gjatë shekujve 5-4 p.e.s. erdhën fiset Greke, që nuk kishin asnjë shkallë kulture dhe zhvillimi, që nuk dihet se nga erdhën, sepse asnjë dokument kulturor nuk kanë lënë në vendin nga erdhën, dhe asnjë të tillë nuk sollën në vendin e ri. (fq. 172)

Me të dhënat e grumbulluara gjer më tani nga shkenca dhe me të dhënat tona të reja vitet e fundit, gjatë studimit të gjuhëve të lashta të Ballkanit dhe të Anadollit, mendojmë se gjuha Para-Indo-Europiane (Hitite) është gjuha Pellazge, gjuha më e vjetër e folur dhe e shkruar e Europës, që më pas pak nga pak u përhap në të gjithë rruzullin tokësor. (fq. 172)

Gjuha e lashtë Pellazge është gjuha origjinale nga lindën gjuhët e lashta të Ballkanit dhe të Anadollit. (fq. 172)

I pari studjues që ka hedhur idenë e prejardhjes së gjuhës Shqipe dhe të Shqiptarëve nga Pellazgët është Nikollë Keta (1740 - 1803).

Më gjatë gjuhës Shqipe ju kushtua Zef Krispi (1781 - 1859), profesor i gjuhës Shqipe, Greke dhe Latine në Universitetin e Palermos dhe rektor i këtij universiteti. ... Krispi ndërtoi fjalorin e parë Pellazgjisht-Shqip, me fjalë të nxjerra nga Homeri dhe autorët e tjerë antikë. (fq. 175)

Johan Georg von Hahn (1811 - 1869), ..., arriti në përfundimin se Shqipja rrjedh nga Pellazgjishtja dhe Shqiptarët, Maqedonët, Epirotët i përkasin një gjaku dhe një gjuhe dhe rrjedhin nga Pellazgët. (fq. 177)

Autorët antikë: Omeri, Hesiodi dhe më vonë Herodoti etj., na bëjnë të ditur se ajo që sot quhet Greqi, para ardhjes së fiseve Greke në gadishullin Ballkanik dhe rajonin e Egjeut, ka qenë njohur me emrin e përbashkët "Pellazgjia", sepse banohej vetëm nga fiset Pellazge. (fq. 179)

Epikat e Omerit janë shkruar në gjuhën e popullit, me gjuhën Pellazge. (fq. 181)

Duke e studjuar tekstin e Iliasit me vëmendje kemi arritur të

zbërthejmë më tepër se 50-60 rreshta dhe na del se të gjitha fjalët e tekstit Omerik janë të kuptueshme, sepse janë në dialektin *gegë* të lashtë të gjuhës Shqipe. ...

Iliasi dhe Odisea të Homerit mund të përshtaten në gjuhën Shqipe, duke njohur dialektin *gegë* dhe duke e parë me kujdes dhe vëmendje tekstin Homerik. (fq. 182)

Deri tani Iliasi është menduar si vepër letrare e shkruar në gjuhën Greke, në bazë të keqinterpretimit të disa fjalëve dhe shprehjeve dhe falsifikimeve të ndryshme. Kërkimet e reja vërtetojnë se epikat e Homerit dhe të Hesiodit i përkasin gjuhës Pellazge. Në ndihmë të kësaj vijnë edhe mjaft të dhëna nga arkeologjia dhe studime të autorëve të ndryshëm. (fq. 191)

Hesiodi (shekulli 8-7 p.e.s.) përshkruan besimin pagan Pellazg dhe perënditë e tij. Ai përmend faltoren e Dodonës, ku jetojnë Pellazgët dhe Zeusi Pellazg. (fq. 192)

Herodoti (484-425 p.e.s.) na njofton se Atika ka qenë banuar fillimisht nga Pellazgët. ... Herodoti na njofton njëkohësisht, se rajoni ka qenë quajtur Pellazgjia dhe se Pellazgët kanë folur "gjuhë barbare", sepse ishte ndryshe nga gjuha Greke. (fq. 192)

Straboni (64 p.e.s. – 19-24 e.s.) në veprën e tij "Gjeografia" i ka kushtuar një kapitull të gjerë Pellazgëve. (fq. 192)

Gjatë kohës, që rajoni jugor i Ballkanit ishte i pushtuar nga Persianët, erdhën në rajon edhe fiset Greke, të cilat erdhën nga lindja, por nuk kishin as emër dhe asnjë nivel kulturor, sepse në vendin e origjinës nuk lanë asnjë të tillë dhe asnjë të tillë nuk sollën në vendin e ri. Sapo erdhën u vunë në shërbim të ushtrisë Persiane, kundra pushtuesve Maqedonë. Prandaj gjatë luftrave të Filipit të II dhe të Aleksandrit të Madh kundra forcave Persiane, Grekët gjithmonë kanë qenë në anën e Persianëve, pa ndonjë rol të rëndësishëm. (fq. 224)

Ndërsa Perandoria Romake Perëndimore ra në vitin 400 e.s,

Perandoria Bizantine ra në vitin 1400 e.s., me ardhjen e Osmanëve në rajon. (fq. 225)

Nga gërmimet arkeologjike të bëra në Trojë, ishullin e Lemnit, Mikenë, Kretë etj. është vërtetuar se dokumente më të hershme të kulturës Greke nuk ka para shekullit të 5të p.e.s. (Peza&Peza 2009, 2013). (fq. 226)

Edhe sot në Greqi mbi 62% e popullatës është Shqipfolëse, arvanitë me prejardhje direkt Pellazgjike .... (fq. 227)

Megjithatë, në literaturë ndeshet termi "gjuha e lashtë Greke", që gjoja është folur në kohët e lashta në rajonin e Egjeut nga shekulli i 9të p.e.s. deri në shekullin e 4të p.e.s. (Wikip. encicl.), që, sipas falsifikatorëve, ka pasur disa dialekte dhe është e ndryshme nga Greqishtja moderne (Woodart 2008). Për ta mbështetur këtë tezë janë përdorur disa dokumente shkrimore si Iliasi dhe Odisea e Omerit dhe mbishkrime të ndryshme, të cilat janë falsifikuar sikur janë në gjuhën Greke, por në fakt, nga studimet e sotme, janë vërtetuar që i përkasin gjuhës Pellazge. Por që gjuha e vjetër të ndryshojë kaq shumë nga një gjuhë e re, tregon që kemi të bëjmë me gjuhë të ndryshme dhe jo me një gjuhë. (fq. 228)

Gjuha e vjetër Greke paraqitet si formë e Greqishtes në botën e vjetër, gjatë periudhës nga shekulli i 9të p.e.s. deri në shekullin e 4të p.e.s., që ndryshe quhet edhe periudha arkaike. (fq. 228)

Me mbishkrimin e Lemnit vërtetohet se pas Luftës së Trojës dhe gjatë asaj që quhet Dark Ages of Greece (1100-500 B.C.), shkrimi i gjuhës Pellazge ka vazhduar normalisht në Pelasgji, siç quhej në kohërat parahistorike rajoni i Egjeut. (fq. 231)

Në historinë e alfabetit shkruhet se, alfabeti më i vjetër është afabeti Egjiptian, i krijuar rreth vitit 1900 p.e.s. Mbishkrimi i tij është gjetur në një pllakë guri në Wadi el-Hol në Egjiptin e poshtëm, ...

Nga alfabeti Wadi el-Hol, më pas mendohet se vjen në rradhë alfabeti Fenikas, i shekullit të 11të p.e.s., i cili kishte vetëm

bashkëtingëlloret, ndërsa zanoret nënkuptoheshin. (fq. 260)

...

Nga kërkimet tona të fundit mbi alfabetet, puna qëndron krejt ndryshe. Njerëzit e parë që kanë shpikur dhe përdorur shkrimin dhe ndërtuan alfabetin për të shkruar gjuhën e tyre, kanë qenë Pellazgët, populli më i vjetër i identifikuar në botë dhe kjo gjatë mijëvjeçarit të 6 p.e.s., ndoshta edhe më parë, në rajonin e Ballkanit qendror. (fq. 260)

...

Alfabeti Pellazg përbën shkrimin e parë alfabetik në botë, që i kishte të dyja, zanoret dhe bashkëtingëlloret (Peza&Peza 2012). (fq. 260)

Mbishkrimi i fundit që njihet është mbishkrimi Ilir i Mesaplikut i shekullit të 6^{të}. Deri në vitin 1210 kur u shkrua dorëshkrimi i Teodor Shkodranit (Ahmeti 2002) nuk kemi shkrime të gjuhës sonë *(gjuhës Shqipe: Shënim B.P.).* (fq. 272)

Teksti i Iliasit të Omerit është shkruar me alfabetin Pellazg në gjuhën Pellazge gjatë shekullit të 8^{të} p.e.s., një variant i lashtë i gjuhës Shqipe. Gjuha është 2800 vjet më parë dhe fjalët janë po ato, që kemi sot në gjuhën Shqipe. (fq. 279)

Të tjera faltore të Zeusit kanë qenë ngritur: Olimpia në Peloponez, Lisi (Në Lezhë), Bilisi (në Vlorë), Bilis (Bilishti i sotëm), Tbilisi (në Gjeorgji), etj. (fq. 281)

Shënim B.P.: Sipas autorëve (Peza&Peza 2018) i japin kuptim Pellazgjik dhe i zbërthejnë kështu këta dy emra:

Kaukaz = kau kaz, kau i zi; Armeni = ar meni, vend malor, që i ka mëni arat (fq. 290) (arat – me kuptimin – fushat)

Siç dihet, banorët e parë të identifikuar në Itali janë Pellazgët dhe më pas pasardhësit e tyre Etruskët. ... Veprat e para letrare në Itali janë në gjuhën Etruske.

Gjuha Etruske përfaqëson një dialekt të gjuhës Pellazge.

... Edhe germat e alfabetit Latinët i morën nga alfabeti Etrusk.

Izzo (1972) thekson se mjaft fjalë Etruske janë trashëguar në gjuhën Latine dhe përbëjnë substratin para-Latin. Izzo shkruan se Toskana përputhet gjeografikisht me Etrurinë e lashtë dhe ka po ata kufinj si ajo. (fq. 304)

... është e domosdoshme ndërmarrja e masave urgjente që të studjohen mbarë gjërat: çfarë huazuan gjuhët më të reja Greke dhe Latine nga gjuha më e lashtë Pellazge dhe format më të reja të saj. (fq. 307)

Turqit kur erdhën në Anadoll gjatë shekullit 14^{të} ishin barinj, pa asnjë nivel kulture. Kjo dëshmohet nga fakti se ata kur erdhën në Anadoll nuk sollën asnjë objekt kulturor.

Nga ana tjetër, në Anadoll ata gjetën popullin të ndarë në shumë shtete të vegjël, por me kulturë dhe zhvillim të madh ekonomik dhe kulturor, që gjuhën e tyre kishin shekuj që e shkruanin. Këta popuj, që jetonin në Anadoll para ardhjes së Turqve, sipas studimit tonë, të gjithë kanë folur një gjuhë të ndarë në disa dialekte, ku më të rëndësishme janë gjuha Hitite, gjuha Luviane, gjuha Joniane, Lidiane, Likiane, Frige, Trojane, etj. Të gjitha këto gjuhë apo dialekte, deri tani kanë lidhje të ngushtë me gjuhën e sotme Shqipe. (fq. 308)

Prof. S. Riza njofton se, sipas Biblës dhe Koranit, në kohë të hershme "mbarë toka kishte vetëm një gjuhë dhe fjalë të njëjta". Kjo ishte gjuha hyjnore e profetëve, "gjuha nënë", më saktë ishte Pellazgjishtja-Ilirishtja-Shqipja e hershme. Latinishtja, Greqishtja, Sllavishtja e vjetër dhe Osmanishtja kanë qenë gjuhë administrative të perandorive Romake, Bizantine dhe Osmane dhe kur ranë perandoritë, ranë edhe gjuhët e tyre administrative. Për këtë arsye, sot Latinishtja, Sllavishtja dhe Osmanishtja janë gjuhë të vdekura. (fq. 309)

Kështu, arritëm në përfundimin se gjuha më e lashtë e Europës, rajonit të Egjeut dhe Anadollit është gjuha Pellazge, dokumentet

shkrimore të së cilës zenë fill qysh në kulturën Pellazge Vinkë-Turdas gjatë neolitit të mesëm (mijëvjeçari 6të p.e.s.). (fq. 311)

Gjuha përbën elementin bazë dhe më të rëndësishëm për të përcaktuar identitetin e një populli. (fq. 312)

Janë dhënë disa teori për lindjen e gjuhëve Indo-Europiane dhe të vetë Europianëve. Për këtë qëllim janë shprehur katër teori kryesore:

1. *Teoria "Kurgan" (Gimbutas 1970, 1977, 1980)* – sipas së cilës vendlindja e gjuhës së lashtë Para-Indo-Europiane (Para-Indo-Hitite) ndodhet në stepat Aziatike në veri të detit të Zi dhe Detit Kaspik. Prej këtu, sipas saj, erdhën luftëtarët kalorës kurganë, gjatë mijëvjeçarit të 4 p.e.s. dhe u shtrinë nëpër Europë. (fq. 313)

2. *Hipoteza e Anadollit ose e ardhjes së gjuhës Para-Indo-Europiane nga Anadolli* bashkë me përhapjen e gjuhësisë, fillon në epokën e neolitit të Anadollit (Renfrew 1987, 2000).

Sipas kësaj teorie folësit e gjuhës Para-Indo-Europiane kanë jetuar në Anadoll gjatë neolitit dhe gjatë mijëvjeçarit 7të dhe 6të p.e.s. erdhën në Europë dhe ... (fq. 314)

Teoria e Anadollit mbështetet edhe nga dy studiues Neozelandezë (Gray & Atkinson 2003, 2011). Ata kanë arritur në përfundimin se nga gjuha Para-Indo-Europiane (Indo-Hitite) e Anadollit fillon degëzimi i gjuhëve më të reja rreth vitit 8700 para kohës së sotme në dy drejtime: njëri drejtim përfaqëson gjuhën Hitite (bashkë me gjuhët e tjera të Anadollit) dhe drejtimi tjetër përfaqëson të gjitha gjuhët e tjera të grupimit Indo-Europian, që më pas degëzohen më tej. (fig. 97 sipas librit L&L. Peza)

Sipas këtyre autorëve nga grupimi Indo-Europian i gjuhëve degëzohet sërish rreth vitit 7900 para kohës së sotme në dy degë: gjuha Tokariane (gjuhë e zhdukur në rajonin kufitar Pakistan-Kinë) dhe dega tjetër përfshin të gjitha gjuhët e grupit Indo-Europian. Rreth vitit 7300 para kohës së sotme ndodh një ndarje e dytë në grupin Indo-Europian me degën e gjuhës Greke dhe Armene. Gjuha Shqipe bashkë me gjuhët Indiane është degëzuar,

sipas autorëve, rreth vitit 6900 para kohës së sotme nga grupi Indo-Europian. (fq. 315)

3. *Teoria e vazhdimësisë Paleolitike.* Kjo teori, e shprehur nga studjuesi italian Alinei, e mendon origjinën e Indo-Europianëve dhe lindjen dhe zhvillimin e gjuhës të tyre nga zhvillimi gradual i gjuhëve të popullatave paleolitike në Europë (Alinei, etj., 2003, 2014) (fq. 315)

Megjithëse prej vitesh është zgjidhur enigma e gjuhës Etruske nga Konda (1964), Majani (1973), dhe N. Vlora-Fallaski (1988), të cilët e lidhin ngushtë këtë gjuhë me gjuhën Pellazge dhe Shqipe, Alinei e lidh Etruskishten e Lashtë me gjuhën Hungareze (Alinei 2003), me të cilën nuk ka asnjë ngjashmëri. (fq. 316)

4. *Teoria e re: Origjina Pellazgjike e Gjuhëve Indo-Europiane.* Teoria e prejardhjes Pellazgjike të gjuhëve Indo-Europiane është paraqitur nga ne në vitin 2013 dhe në detaje më të plotë paraqitet në këtë studim. Sipas kësaj teorie, të gjitha gjuhët e familjes së madhe Indo-Europiane e kanë origjinën tek gjuha më e lashtë e kontinentit të vjetër, gjuha Para-Indo-Europiane, ose ndryshe gjuha Pellazge. (fq. 316)

Gjuha Hitite konsiderohet sot nga shkenca, si gjuha më e lashtë e dokumentuar me shkrim, që e ka origjinën tek gjuha më e vjetër, d.m.th. tek gjuha Para-Indo-Hitite (Para-Indo-Europiane). Nga analiza jemi të mendimit se gjuha Para-Indo-Hitite është tamam gjuha Pellazge, gjuha e popullit më të vjetër të identifikuar në Europë. Kjo është gjuha e banorëve autoktonë të Ballkanit, që quhej "gjuhë barbare" nga autorët e lashtë. ... Këtë gjuhë të lashtë disa autorë e quajnë Pre-Greek substratum, disa të tjerë Para-Indo-Europiane, ose më saktë Para-Indo-Hitite. (fq. 319)

Fakti që fjalët e gjuhës Hitite ndodhen edhe në gjuhën Shqipe ka rëndësi të madhe, sepse hap horizonte të reja për gjuhësinë dhe historinë. Kjo vërteton se gjuha Hitite tashmë nuk është gjuhë e vdekur, siç është mendimi i gjuhëtarëve sot, por vazhdon në gjuhën

Shqipe (Peza&Peza 2015) (fq. 320)

Nën ndikimin direkt të gjuhës "mëmë" Pellazge dhe të dialekteve të saj, gjatë mijëvjeçarit të dytë dhe të parë p.e.s., u zhvilluan gjuhët e tjera Indo-Europiane, përkatësisht degët: Tokariane, Armene, Greke, Kelte, Indo-Ariane, Iraniane, Latine, Baltike dhe Slave. (fq. 321)

Për ne gjuha Pellazge është gjuha më e vjetër e folur dhe e shkruar, e cila njësohet me gjuhën Para-Indo-Hitite. (fq. 323)

Gjuha Pellazge përputhet me dialektin gegë të gjuhës Shqipe. Në të gjithë mbishkrimet e lashta të analizuara dhe në Ilias dhe në Odise të Omerit, dialekti gegë është kudo i pranishëm. (fq. 326)

Në të gjitha mbishkrimet e lashta dhe në gjuhët e lashta të Ballkanit, Anadollit, etj., vërtetohet prania e përdorimit të dialektit gegë të gjuhës Shqipe, gjë që tregon se ky është dialekti më i vjetër i saj.

...

Gjuhësia dhe historia institucionale shqiptare në Shqipëri, Kosovë, etj., janë plotësisht të dështuar. Institucionet e saj studimin e gjuhës Shqipe, origjinën e saj dhe historinë e shqiptarëve e kanë lënë në gjendje të mjeruar. Ata, të rejat që janë zbuluar nga shumë studjues si Keta, Krispi, De Rada, Adamidi, Thomopoulo, Konda, Majani, N.Vlora dhe dijetarë të tjerë të ditëve tona, i përbuzin dhe i luftojnë. Asnjë e re nuk është sjellë nga këta përbuzës të gjuhës Pellazge/Shqipe. (fq. 331)

Konkluzion B.P:

Ja vlen të ripërsëritet shprehja me të cilën mbyllet parathënia:

Zhvillimi shumë i vonshëm i Shqipes së shkruar përbën sa fatkeqësi ashtu edhe një mrekulli, si për vetë popullin shqiptar, ashtu edhe për mbarë qytetërimin, të paktën, atij Europian.

Përbën fatkeqësi pasi la në errësirën e harresës një komb dhe një

gjuhë për një kohë të gjatë, duke i mohuar qytetërimit një mundësi më tepër zhvillimi dhe nga ana tjetër një mrekulli, pasi në errësirën e harresës, ndën pluhurin e kohërave të dhunshme ruajtën të pacënuar një komb dhe një gjuhë të lashtë.

Një diamant mbase, që po të pastrohet me kujdes, do të pasqyrojë aq dritë sa të mposhtte errësirën, që rrethon atë pjesë të hapësirës historike Europiane lidhur me formimin e kombeve dhe gjuhëve Europiane.

KAPITULLI 2

INDO-EUROPA DHE ARMENËT

(Nxjerrë nga shkrime të studjuesve Armenë dhe të Huaj)

PËRMBAJTJA

(Renditja sipas datës së botimit për herë të parë)

1. Robert Ellis: "Armenian origin of Etruscans", 1861
   a. Origjina Armene e Etruskëve 231
2. Artashes Abegian: "Geschichte Armeniens",
   Stuttgart, 1948 243
3. Kim Ghahramanyan: "1500-Years-Old Fundaments
   of Law and Order in Artsakh", Yerevan, 2010 257
4. Christopher J. Walker: "Armenia" A Very Brief History
   Yerevan, 2014 259
5. Vahan Setian: "Armenian origins of Basque", 2017 261
6. Artak Movsisjan: "Historia e Armenisë", Tiranë, 2019 267
7. Moisi Kaghankatvaci (Daskhuranci):
   "Historia e Albanëve të Kaukazit", Tiranë, 2019 275
8. Garegin D. Nalbandian:
   "Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit", Tiranë, 2020 279

NË VEND TË PARATHËNIES

Nxjerrë nga libri *"Hyrje në Indoeuropianistikë"* (Leksionet e Prishtinës) i Eqrem Çabej, Botimet "Çabej", 2008

... H. Hübschmann është themelues i gjuhësisë armene. Gjuhëtari i shquar danez Holger Pedersen çeli rrugë të reja në studimin e shqipes, armenishtes, keltishtes, hetitishtes, tokarishtes e të tjerave gjuhë indoeuropiane. (fq. 50)

Duke ardhur më nga perëndimi, në jug të Kaukazit, në Armeni flitet *Armenishtja.* Armenët nga sa duket janë me burim Europian. Vetë Herodoti thotë se Armenët rrjedhin nga Frigasit e Azisë së Vogël. Ata duhet të jenë shpërngulur në Armeni aty nga shekulli i shtatë para epokës së re. Armenishtja ka dy perioda të traditës së shkrimit. Njera është *Armenishtja e vjetër,* afërsisht e shekullit V-VI të erës së re, të kohës së Justinianit, me shkrime më fort fetare, kronika historike, etj, dhe *Armenishtja e re* në shek. XV e këtej. Ndërkaq shkrimet e gjuhës kishtare edhe sot nuk përdoren në Armenishte të re, aty ruhet tradita e Armenishtes së vjetër.

Siç thamë, Herodoti thotë se Armenët rrjedhin prej Frigasvet. Vërtet ka njëfarë afërie ndërmjet Armenishtes dhe Frigishtes, veçse kjo nuk mund të përcaktohet, për shkak se Frigishtja është një gjuhë e vdekur dhe Armenishtja një gjuhë e gjallë. (fq.62, 63)

ROBERT ELLIS

ORIGJINA ARMENE E ETRUSKËVE

Nxjerrë dhe përkthyer nga libri
"Armenian origin of Etruscans" i Robert Ellis, London, 1861

Origjina Armene e Etruskëve
(R. Ellis, Fq. 1-11)
(Përktheu nga Anglishtja Berzh Piranjani)

Subjekti i faqeve në vijim është një vazhdim i argumentit të trajtuar në pjesën e fundit të librit tim *"Kontribute në Etnografinë e Italisë dhe Greqisë".* Përsa i përket pjesës së parë (pjesa I), ajo nuk ka lidhje me këtë, çfarë është paraqitur këtu: ajo shërben thjesht si nevojë për t'i bërë një përmbledhje pikëpamjeve, që unë kam paraqitur rreth popullizimit të Europës.

Raca Indo-Gjermanike, ose, duke përdorur tashmë termin e mirënjohur dhe më të shkurtër, raca Ariane, mund të ndahet në dy grupe të mëdha: Arianët e Veriut ose Arianët Europianë, dhe Arianët e Jugut ose Arianët Aziatikë. Duke marrë për bazë gjuhën dhe duke pasë numër të vogël antarësh, *Arianët Europianë janë nënndarë në tre degë të mëdha: dega Latine, Gjermane dhe Sllave.* Por gjuha Latine është një gjuhë e ndërfutur (intrusive), që rrjedh nga një qytet i vetëm ose nga një distrikt shumë i vogël dhe duke u shpërndarë nëpër shtete të tjerë, kryesisht të pushtuar nga Keltët, të cilët janë gjithashtu Arianë. Kështu që, të tri këto degë të mëdha

të Arianëve Europianë, duke u nisur nga pikëpamja etnike, do të quheshin Keltët, Gjermanët dhe Sllavët.

Në mënyrë të ngjashme, Arianët e Jugut ose Arianët Aziatikë do të ndaheshin në tri degë kryesore: Armenët, Persianët dhe Indianët. Kurdët dhe Afganët janë të një rëndësie etnike më të vogël. Armenët, ashtu si edhe Keltët, tashmë janë në një numër të vogël. *Unë do të përpiqem të provoj që raca, të cilës ata i përkasin, dikur shtrihej në një territor shumë më të madh, dhe shtrihej në drejtim të perëndimit nga Armenia në Itali nën emrin e Frigëve (Phrygians), Thrakëve, Pellasgëve, Etruskëve e të tjerë si këta.*

Të vetmit antarë të grupit të Arianëve, me të cilët unë do të merrem, do të jenë Thrakët, d.m.th. raca, pjesë e së cilës janë edhe Armenët, si edhe Keltët: *ose me degën perëndimore të Arianëve të Veriut, dhe degën perëndimore të Arianëve të Jugut.* Këto dy degë, duke gjykuar nga pozicioni i tyre, duhet të kenë qenë banorët e parë në Europë nga ndarjet të cilave u përkasin. Unë mendoj që, Keltët kanë hyrë në Europë kryesisht nëpërmjet Skithisë ose Rusisë; ndërsa Thrakët, të paktën kryesisht, nëpërmjet Azisë së Vogël dhe Turqisë. Pasi kishin hyrë në Europë, një pjesë e Keltëve do të jenë drejtuar për nga Jug-Perëndimi, dhe duhet të jenë vendosur përfundimisht në Itali.

Kësaj dege duhet t'i kenë përkitur edhe banorët e Umbrias, për të cilët nga disa thuhet që të kenë qenë degë e Keltëve të vjetër, d.m.th., e Keltëve, që ndodheshin në Itali përpara invazionit Kelt, i cili përfundimisht përfundoi me pushtimin e Romës. Thrakët, nga ana tjetër, duke përparuar në drejtim të Perëndimit dhe Veri – Perëndimit nga Azia e Vogël, do të formonin popullimin original Arian në Turqi dhe Greqi, do të vinin në kontakt me Keltët përgjatë vijës kufitare të Dakias (Dacia), Pannonias, Norikumit dhe Retias (Rhaetias), dhe do të kalonin në Itali, kryesisht nën emrin e Tirrenianëve (Tyrrhenians) në një periudhë, që pason datën e ngulimeve Kelte në këtë gadishull.

Por duhet të kenë qenë dy raca në Europë përpara ardhjes së ndonjerit prej banorëve Arianë. Një prej këtyre racave duhet të ketë qenë raca Baske ose Iberike, me të cilën unë do të merrem vetëm fare pak. Nëqoftëse ka pasur një racë jo Baske në Europë, dhe më e hershme se e Keltëve, nga kjo rrjedh direkt në rrugë etnologjike, që kjo racë duhet të ketë qenë raca Fin.

Nga kjo racë, unë mendoj që, mbetje të tyre në Itali janë Ligurianët, dhe që Finët, ose disa të afërm Tirrenianë, formuan bazën mbi gjithë Italinë, Greqinë, Turqinë, Shtetet Austriake, dhe Azinë e Vogël. Kështu që, përfaqësuesit e të tre racave dhe gjuhëve Italiane: Ligurianët, Umbrianët dhe Tirreneasit ose Etruskët, unë besoj, tashmë do të duhej të gjendeshin respektivisht – në Lapland[1], Finland dhe Estoni; në Britani, Uells, Irlandë dhe Skoci; dhe në Armeni. Vërtetimi i këtyre pikave të fundit është objektivi im aktual. Përfaqësuesit e racës së katërt ndër racat më të vjetra Europiane, Iberikët, në të njëjtën mënyrë do të mund të gjendeshin në Biskajë.

PASQYRIM HISTORIK I ZGJERIMIT TË RACËS THRAKE NGA ARMENIA NË ETRURI

Në përpjekje për të përcaktuar grupin e kombeve në të cilin bëjnë pjesë Etruskët, fillimisht është e domosdoshme të ngremë pyetjen se prej kujt kombeve ata kanë rrjedhur tradicionalisht, ose me kë ata janë identifikuar. Në lidhje me pjesën e parë të këtyre pikave ka një unanimitet të madh. Zëri i përgjithshëm i antikitetit i bën ata të prejardhur nga Lidianët, opinion ky, të cilin edhe vetë Etruskët parapëlqejnë ta pranojnë. Etruskët, gjithashtu, në përgjithësi identifikohen me racën e përhapur gjerësisht të quajtur Pellasge, ndonëse Tirrenasit dhe Pellasgët në Etruri, dhe gjithashtu edhe në

[1] *Shënim B.P.:* Lapland është rajoni më i madh dhe më verior i Finlandës (marrë nga Wikipedia)

Kampania, janë konsideruar si popuj të veçantë, por në lidhje të vazhdueshme me njeri tjetrin. Etruskët duket kështu të jenë të afërm me Lidianët dhe Pellasgët.[10]

Nga kjo racë e fundit, e cila ishte pothuajse tërësisht e shuar si *emër* në kohën e Herodotit*, shumë pak gjë dihet dhe akoma asgjë nuk mund të thuhet. Tashmë neve na duhet të hetojmë, se kujt familje i përkisnin Lidianët; pasi historia e prejardhjes së Etruskëve prej Lidianëve zor se mund të konsiderohet si e qëndrueshme nga pikëpamja historike, por thjesht si një pranim që të dy këto kombe i përkisnin të njëjtës familje; një fakt etnik, i cili shfaqet në formën historike të një migrimi nga Lidia në Etruri.

Për herë të parë Lidianët janë të lidhur me Misianët (Mysianët) dhe Karianët. Është përmendur prej Herodotit që Misianët (Mysianët) dhe Lidianët janë κασίγνητοι *(vëllezër)* me Karianët

---

[10] *Shënim i Robert Ellis:* {Këto afëri janë trajtuar nga një shkrimtar i lashtë, Dionisi i Halikarnasit* (lib.i, cc.29, 30). Ai thotë: "Sipas mendimit tim, sidoqoftë, të gjithë ata që mendojnë se kombet e Etruskëve dhe Pellasgëve janë të afërm (farefis) e kanë gabim". Pas kësaj vijon një argument për të provuar këtë, i cili e ka bazën në gabimin e mirënjohur të Crotoniates, d.m.th. Cortoniates, për Crestoniares në Herodotusin. Dionisi vazhdon më tej: "Pikërisht për këtë arsye, unë besoj se Etruskët janë të ndryshëm nga Pellasgët.

Aq më pak mendoj se Etruskët janë kolonistë Lidianë. Pasi ata nuk përdorin të njëjtën gjuhë si edhe Lidianët; as nuk mund të thuhet, që ndonëse ata nuk janë vërtet të ngjashëm me Lidianët në gjuhë, megjithatë ata akoma kanë disa veçori të vendit-mëmë. Pasi ata nuk adhurojnë të njëjtët zota si edhe Lidianët, as edhe nuk i ngjajnë atyre në ligje dhe zakone; por në këto gjëra ata ndryshojnë akoma më shumë prej Lidianëve se sa prej Pellasgëve. Në favor të tyre, sidoqoftë, është më i pranueshëm ai, që deklaron se kombi (Etrusk) nuk është i huaj, por vendas (në Etruri); kjo duke qenë se ai është shumë i lashtë, dhe nuk është gjetur ndonjë i ngjashëm me të, si në gjuhë ashtu edhe në sjellje".

Megjithatë ka tre opinione përsa i përket Etruskëve. Ata janë konsideruar si:

1. Pellasgë, një racë e cila ishte një racë e thjeshtë në kohën e Dionisit;

2. Lidianë;

3. Një racë e izoluar e papërzier me asnjë tjetër (një propozim ky, i pranuar nga Armenët një gjysëm shekulli më parë).

Zgjidhja, unë besoj se është që Pellasgët, Lidianët dhe Etruskët e kanë origjinën e tyre në një periudhë të largët nga Armenia.}: Shënim i Robert Ellis

dhe që mitikët Misus (Mysus), Lidus (Lydus) dhe Kar ishin vëllezër. Ai, gjithashtu, thotë që, Misianët janë kolonistë Lidianë. Në lidhje me aferësi të tjera të përgjithshme ndërmjet Lidianëve dhe Karianëve ne nuk kemi pohime të veçanta, por është lënë të deduktohet (të merret me mend, të arrihet në përfundim) ashtu si në rastin e Misianëve, të cilët janë përshkruar si kolonistë Thrakë (sipas Strabo*, pp. 542, 566). Nga kjo mund të arrijmë në përfundimin, që Lidianët dhe Karianët i përkasin gjithashtu familjes së Thrakëve.

Ka mundësi, që tashmë të kemi arritur te emri i familjes së madhe, të cilës i përkasin Etruskët, d.m.th. Thrakës. Pasi Thrakët nuk janë një tribu apo popull i vetëm. Emri, ashtu si edhe ai i Keltëve apo Gjermanëve, përshkruan një prej familjeve Ariane, e cila, sipas Herodotit, është raca me numrin më të madh të njerëzve pas asaj Indiane. Thrakët, ka shumë të ngjarë, mund të kenë lëvizur nga kufijtë me Median për në Itali dhe në Alpe, dhe mund të kenë përfshirë edhe Armenët në Lindje dhe Retianët (Rhaetians) dhe Etruskët në perëndim. Sa paraqitet më poshtë, janë treguesit kryesorë të një zinxhiri kombesh të afërm brenda këtyre kufijve, të cilin të lashtët kanë arritur ta transmetojnë deri tek neve.

Më lindorët e të gjithë këtyre tribuve, për të cilët është thënë shprehimisht se janë Thrakë, janë Saraparae, të cilët janë përmendur nga Strabo* si një tribu Thrake, që banonte përtej Armenisë, pranë Medëve dhe Gurianianëve. Në provincën Armene të Persarmenisë, një krahinë që kufizohet ose edhe e përfshin liqenin Urmia, *Gjeografia* Armene, që i dedikohet Moisi Khorenacit* (Movses of Chorene) përmend një zonë që quhet Thraki.

Vetë Armenët i përkasin të njëjtës familje si edhe Frigët (Phrygians), prej të cilëve, thuhet, se ata rrjedhin, dhe me gjuhën e të cilëve, vetë gjuha e tyre ka shumë ngjashmëri.

{(Ἀρμένιοι ... Φρυγών ἄποικοι - Armenët ... koloni Frige - sipas Herodoti vii 73); (Ἀρμένιοι τό γένος ἑκ Φρυγίας καί τϋ φωνϋ πολλά φρυγίξουσιν - Armenët e genit Phrygias dhe ... – sipas Eustath. On Dion v 694)

Por tashmë dihet mirë, që Frigët konsiderohen si një tribu Thrake (sipas Strabo*, pp. 295, 471); si pasojë, Armenët me shumë mundësi i përkasin të njëjtës familje. Duke vazhduar nga Armenia për në drejtim të perëndimit, ne arrijmë në Kappadokia, një vend që zotërohet nga raca Siriane, e cila me shumë mundësi, në kohë shumë të hershme, ka ardhur nga jugu dhe ka ndarë Armenët prej racës së afërt të Frigëve. Pjesa lindore e krahinës, e quajtur Kappadokia, ishte, sidoqoftë, Armene dhe formonte krahinën e Armenia Parva *(bëhet fjalë për Armeninë e Vogël. Shënim B.P.)*. Kappadokia formon shkëputjen (të çarën) e vetme në zinxhirin e vendeve Thrake ndërmjet Medias dhe Helvetisë.

Frigët, siç është vënë në dukje, janë racë Thrake: οί Φρίγες Θράκών ἄποικοί είσι. (janë koloni e Prygianëve të Thrakës). Misët (Mysët), Lidianët dhe Karianët gjithashtu i përkasin të njëjtës familje. Kështu, gjithashtu, sipas Strabo, kjo vlen edhe për Migdonët, Bebrikët, Medobitnianët, Bitnianët, Thinianët dhe Mariandianët (Migdones, Bebryces, Medobithynians, Bithynians, Thynians, dhe Mariandynians), si edhe për Mesianët në Danub dhe Getaet[2]. Për më tepër ai thotë që Getaet janë ὁμόγλωττοι (homologë; që flasin të njëjtën gjuhë) me Thrakët, të cilët në këtë mënyrë shtriheshin deri në kufijtë e Maqedonisë, Ilirisë dhe Panonisë. Por Pierianët në Maqedoni ishin një tribu Thrakësh (sipas Strabo*, pp. 410), dhe Maqedonasit gjithashtu pohojnë që Frigët fillimisht kanë banuar në vendin e tyre me emrin Brigë (Brygë) (sipas Herodotit*, vii. 73). *Përsëri, po ky Strabo, flet për Brigë në jug të Ilirisë;* kështu që ne mund t'i gjejmë Frigët në

[2] *Shënim B.P.:* Duke mos qenë në gjendje ta zbërthej për cilin fis e ka fjalën autori, po e le ashtu siç e ka shkrojtur ai; mbase është fjala për Gotët??).

Maqedoni dhe Iliri, ashtu si edhe në Azi, dhe në këtë mënyrë e hasim emrin e Frigëve nga Armenia deri në Adriatik. [11]

Është pikërisht atëhere koha, kur Thrakët u shfaqën në Iliri. Istrianët, gjithashtu, përshkruhen si Thrakë. Venetët, përsëri, janë klasifikuar prej Herodotit ndërmjet Ilirëve, dhe prej një shkrimtari është raportuar që të kenë ardhur nga Kappadokia, dhe që janë vendosur në grup së bashku me Thrakët në Adriatik, d.m.th., në Venetia* (*Strabo p.552).

Po kështu Thrakët shihet të gjenden në Pannonia dhe Norikum. Të tre kombet Kelte, ose kryesisht kombet Kelte, Boii, Tauriskët dhe Skordiskët, mbulojnë të gjithë territorin e të dy këtyre vendeve. Por për të tre këto kombe thuhet që kanë qenë të përzier me Thrakët* (Ib. p.296) dhe Skordiskët, gjithashtu, me Ilirët* (Ib. p.313).

---

[11] *Shënim i Robert Ellis:* {Për një histori të plotë dhe të shkëlqyer mbi Frigët, shih art. Phrygia në librin "Gjeografia" të Dr. Smith. Shkrimtari, sidoqoftë, ka rënë në gabimin, në të cilin ka rënë gjithashtu edhe Dr. Hahn në botimin e tij "Studime Albanistike", dhe nëpërmjet tij edhe unë vetë. Fjalët, Δαλμάται Ἀρμένοι εἰναί μοι δοκοῦσι καί Φρύγες, {Armenët dalmatë janë më duket (me ngjajnë) edhe Phrygianët} (Cramer. Anecd. Gr. Oxon. V. iv. P. 257) nuk i referohen njerëzve, por kuajve. Duket sikur mënyra se si i mbarështojnë Dalmatët kuajt ka të njëjtat tipare si edhe ai i gjetur në Frigji dhe Armeni, dhe madje edhe në Kappadokia (ib.), duke pasë parasysh që kuajt e këtyre dy vendeve të fundit kishin një reputacion të lartë ndërmjet njerëzve të lashtë.

Tre drejtues Ilirë kanë mbajtur emrin Bato. Njeri ishte Dardan, tjetri ishte Dalmat dhe i treti Pannonian. Kjo lë shteg për të hamendësuar që "Bato" ashtu si edhe Brennus, ka kuptimin "shef, drejtues, udhëheqës". Termi Armen "pet, bed" = Sanskrishten "pati", "dominus," = Zend "paiti", = Persishten. "bad" ka të njëjtin kuptim. Herodoti përmend se Skithët e quanin veten e tyre "Scoloti", dhe ne gjejmë një mbret Skith të quajtur "Scolo-pitus". Duket sikur pjesa e fjalës "pit" ka kuptimin, ose nënkupton fjalën "shef, drejtues, udhëheqës" në gjuhën Skithe. Një tjetër mbret Skith, i përmendur nga Herodoti, është Ariapithes, i cili mund të shpjegohet nga Armenishtja "ajr - burrë, njeri" dhe "pet, bed - shef, drejtues, udhëheqës", pra "shefi i burrave, i njerëzve". Herodoti, gjithashtu, përmend një mbret të Agathyrsi, të quajtur Spargapithes, dhe një udhëheqës (στρατηγέοντα – strateg, prijës) të Massagetae, djali i Tomiris, i emëruar Spargapises. Këta emra i përngjajnë emrave të gjuhës Armene "sparapet – general, shef, drejtues". Krahasoni gjithashtu: Armenisht: zor – ushtri, zorapet – gjeneral; azg – komb, azgapet – princ; karapet – udhëheqës; vardapet – mësues. Mbeturinat e gjuhës Skithe do të trajtohen në vazhdim.}

Kur populli Etrusk mori në zotërim luginën e lumit Po, përpara invazionit Gal, kufiri i tyre duhet të ketë qenë i shtrirë deri në Venetia dhe Reti (Rhaetia). Ne tashmë kemi gjetur gjurmë të Thrakëve në Venetia dhe Norikum, vende këto, kufitare me Retinë (Rhaetia) dhe Etrurinë e vjetër. Shtimi i kombeve të afërme (farefis) të Retianëve dhe Etruskëve, i pari direkt, dhe i dyti indirekt, si kombe të prejardhur nga Lidianët, kompleton listën e popujve Thrakë që shtriheshin nga deti Kaspik deri në detin Tirrenian (e Tirreneve). [12]

Dy emra të tjerë etnikë të rëndësishëm, Tuskanët (Tuskët) dhe Dardanët, kanë pothuajse të njëjtën shtrirje territoriale. Të dy janë të lidhur me Etrurinë, ndonëse Dardanët, sidoqoftë, vetëm nëpërmjet Dardanusit mitik. Megjithatë, emri është Dardan, pasi Dardanus ishte emri i një qyteti Apulian në kënetat Salpit * (La Martiniere, Geog. Dict.), dhe Dardi nga një popull i vjetër Apulian* (Plin. H. N. iii.16.). Të dy këto emra duket të jenë Ilirë; pasi Dardanii ose Dardaniate janë një komb Ilir, dhe ky ka qenë një vend që shtrihej në Mesia (Maesia), të quajtur Dardania. Një pjesë e madhe e Albanëve (Shqiptarëve) të

[12] *Shënim i Robert Ellis:* {Vindelikianët, madje, prej një shkrimtari, pa ndonjë autoritet të spikatur, janë renditur ndërmjet Thrakëve. Vështirë se ka ndonjë vlerë për t'u përmendur, se çfarë ëndërrojnë skolastikët për prejardhjen e Vindelicit. Servius, i cili në komentin mbi Virgjilin* (Aen. i. 244), nga poeti i tij zbulon (nxjerr, gjen) që ata janë Liburnë, dhe në ta për shkak të Horacit * (iv. 4) sheh pasardhësit e Amazonëve dhe Porfiri tek Horaci, nga një këndvështrim tjetër më i hershëm, mendon se ata kanë qenë Thrakas të shpërndarë nga Amazonët. – Zeusss, Die Deutchen, p. 231. Këto opinione kanë fare pak vlerë; dhe megjithatë është për t'u shënuar që, ato do të ishin kaq afër konfirmimit për shkak të dëshmisë së afërisë së gjuhës në aludimin, që bëhet për vendet origjinale të kombeve në këto pjesë. Pasi ata thjesht zëvëndësojnë Kappadokian, prej së cilës ka shumë të ngjarë që të jenë dëbuar Thrakasit, kur Armenët janë ndarë nga Frigët (Phrygians), në vendin e Armenisë.

Në tregime të tjera ka më shumë qëndrueshmëri. Një shkrimtar tregon se Venetët vijnë nga Kappadokia dhe janë vendosur së bashku me Thrakët në Adriatik; një tjetër i nxjerr Vindelianët (të konsideruar nga një i tretë si Liburnianë, ndërsa Venetët, nga një i katërt, janë renditur ndërmjet Ilirëve) të prejardhur nga Amazonët, d.m.th. nga Kappadokia; ndërsa një i pestë i konsideron po këta Vindelianë, si Thrakas të dëbuar prej Amazonëve, me shumë gjasa nga ndonjë pjesë e Azisë së Vogël, nëqoftëse jo prej Kappadokisë. Prejardhja Lidiane e Retianëve dhe Etruskëve është një vazhdim i të njëjtit besim mbi origjinën e dy kombeve të tjerë të afërm. }

sotëm quhen Toskë. Në Azi këto emra vazhdojnë të shfaqen. Ka një Dardanus në Misia (Mysia). Herodoti flet për Dardanë në atë vend që sot quhet Kurdistan* (i.189. Rrënja mund të jetë fjala Armene "*dar* - lartësi" ose nga Osetishtja "*dard* – largësi"). Ptolemeu përmend Tuskë në Sarmantinë Aziatike, dhe vazhdon të ekzistojë akoma edhe një tribu e quajtur Tuski ose Tuskethi në vendin nga ku buron lumi Alazan, lum ky që ushqen lumin Kur[13]

Këta janë treguesit historikë dhe tradicionalë kryesorë të shtrirjes së një prej familjeve të mëdha të kombeve, të cilëve mund t'u atribuohet emri Thrakas, nga Armenia në Etruri. [14]

Shënim B.P.: (më poshtë citohen pasazhet në gjuhën Greke të Herodotit, nxjerrë nga faqet: Herod. i. 94; Herod. i. 171; Herod. Vii. 74:).

...

Gjuhët e degëve të ndryshme të kësaj familjeje do të kenë qenë dalluar nga njera tjetra nga variacione dialektale; dhe mospërputhjet, që shfaqen në një rast të tillë, gjithashtu, duhet të jenë thelluar nga përzierja e Thrakëve me raca të tjera në vendet e pushtuara nga Thrakët. Në Azi, gjuha e tyre mund të jetë ndikuar në mënyrë të veçantë nga elemente Semitike të jugut. Thrakët Europianë, nga ana tjetër, siç i gjejmë tek Strabo, janë përzier me Keltët dhe Skithët, ndërsa Etruskët duhet të kenë qenë shoqërizuar me Umbrianët, një komb me origjinë të dalluar Kelte. Përfundimisht, të gjithë kombet Thrake duhet të kenë qenë, kush më pak e kush më shumë, të ndikuar nga prezenca e tribuve Finne (Finnish tribe) ose Turaniane, paraardhësit e Keltëve dhe Thrakasve Arianë në pothuajse të gjitha vendet ku dikur shtriheshin vetë Thrakasit.

---

[13] *Shënim B.P.:* Lumi Kur - lum që buron nga malet e Kaukazit dhe përshkon Gjeorgjinë dhe Azerbaixhanin.

[14] *Shënim i Robert Ellis:* {Pasazhet në gjuhën Greke, të cilat duhet të provojnë ose lënë të kuptohet afërsinë ndërmjet Etruskëve dhe Armenëvë, janë këto, që japin këtë lidhje ndërmjet hallkave – Etruria, Lidia, Mysia (Misia) Thraka, Frigia, Armenia; }

DËSHMI GJUHËSORE TË SHTRIRJES SË RACËS THRAKASE NGA ARMENIA NË ETRURI.

Konkluzioni, sipas të cilit, ka ekzistuar një prej familjeve të kombeve, e cila ka qenë e shtrirë nga Armenia në Etruri, duhet tani të vihet përballë një prove të madhe, asaj të gjuhës. Ne duhet të përpiqemi të sqarojmë, nëse mund të tregojmë, që ka qenë një gjuhë e vetme e folur në vendet që ndodheshin brenda këtyre kufijve – një gjuhë, si të thuash, në një kuptim më të gjerë, ashtu siç sot Anglishtja, Gjermanishtja, Suedishtja, Dutch, ose ndonjë dialekt tjetër Teuton, të gjitha së bashku formojnë një gjuhë. *Tashmë një zinxhir i plotë i kombeve, për shtrirjen e kërkuar, do të mund të formohej nga Armenia, Kappadokia, Frigia, Misia, Thrakia, Iliria, Retia (Rhaetia), dhe Etruria, duke qenë se Iliria dhe Thrakia e mbyllin plotësisht hapësirën ndërmjet Retisë (Rhaetisë) dhe Italisë nga njera anë dhe Azia e Vogël nga ana tjetër.* Strabo, në fillim të librit të tij të shtatë, flet për Ilirët dhe Thrakët, pjesërisht të përzier me Keltët, si tribu që zinin të gjithë hapësirën në jug të Danubit deri në kufi me Greqinë. Pak më tej (Fq. 312) ai shton Maqedonasit dhe Epirotët, të cilët duhet të kenë qenë hallkat lidhëse ndërmjet Ilirëve dhe Grekëve.

Nga të tetë vendet, që formojnë zinxhirin ndërmjet Armenisë dhe Etrurisë, gjuha e vetëm njerit prej tyre është zhdukur. Kjo është Misia: por duke qenë se gjuha Misiane ka qenë pohuar bindshëm të ketë qenë gjysëm Lidiane dhe gjysëm Frige, zinxhiri i vendeve vazhdon të qëndrojë i padëmtuar (i pandërprerë), nëqoftëse listës i shtohet gjuha Lidiane. Ajo do të mund të kompozohej në këtë mënyrë:

Vendi:	*Gjuha:*
Armenia	Armenishtja e vjetër ose letrare; një gjuhë e kompletuar, që vazhdon të shkruhet, por që nuk flitet dhe që daton që nga viti 400 A.D. [15]

[15] *Shënim B.P.:* {duhet ta ketë me kuptimin që nuk është gjuhë zyrtare, pasi në atë kohë ashtu ka qenë, si në Perandorinë Osmane ashtu edhe në atë Ruse.}

Kappadokia	Janë vetëm tre fjalë Kapadokase
Frigia}	Pesëdhjetë fjalë Frigiane, dhe disa pak mbishkrime.
Misia}	
Lidia}	Tridhjetë e tetë fjalë Lidiane
Thrakia	Njëzet e tetë fjalë Thrakase
Iliria	Çfarë mbetet nga gjuha Albane (Shqipe), pasi të largohen fjalët e huazuara nga gjuha Turke, Greke, Latine dhe gjuhë të tjera të huaja.
Rhaetia	Çfarë mbetet nga gjuha Rhaeto-Romansh, pasi të largohen fjalët e huazuara nga gjuha Gjermane, Latine dhe gjuhë të tjera të huaja.
Etruria	Disa fjalë, dhe një numër i madh mbishkrimesh.

Nga kjo tabelë duket, që ne duhet të na ketë mbetur vetëm një dialekt Thrak, ai Armen; dhe që nga të gjitha dialektet e tjera të afërta të kenë mbijetuar vetëm disa mbeturina të zbehta.[16]

Në këtë mënyrë Armenishtja mbetet të jetë përfaqësuese e gjuhës Thrake; dhe nëqoftëse do të ishte e vërtetë që të gjitha dialektet e tjera në vendet sipërpërmendur do t'i përkisnin kryesisht të paktën, me përjashtim të Kappadokias dhe kjo ndoshta pjesërisht, së njëjtës familje Thrake, atëhere mbeturinat e këtyre dialekteve duhet të shfaqin afërsi me fjalët e gjuhës Armene. Pikërisht këtë po përpiqem të provoj për secilën prej këtyre dialekteve sipas rradhës, duke filluar

[16] *Shënim B.P.:* {Këtu mendoj se autori ka gabuar; natyrisht si rezultat i mosnjohjes nga afër të realitetit të kohës kur ka jetuar, duke mos marrë në konsideratë gjuhën Shqipe, e cila vërtet asokohe nuk kishte alfabetin e vet dhe nuk shkruhej, si edhe nuk ishte gjuhë zyrtare në të folur, por flitej nga një masë e madhe njerëzish, të cilët Turqit i quanin Arnautë dhe që banonin në tokat, që përbëjnë trevat Shqiptare sot në Ballkan.}

me atë Kappadokian. Dhe këtu, që në fillim, mund të paraqitet një rrethanë, ndërkohë që përpiqemi të tregojmë, që ekzistenca e afërsive (ngjashmërive) të tilla është një gjë që mund të hamendësohet. *Gjuha Armene qëndron e vetme, një degë e shquar e grupit Arian, dhe e konsideruar me një individualitet të tillë të theksuar sa që ka çuar shumë studjues të mendojnë për të si një formë e izoluar të foluri dhe ta përjashtojnë atë nga grupi i Arianëve.* Tashmë, kur një gjuhë mban një pozicion të tillë të veçantë (karakteristik), kur ajo nuk është thjesht, si p.sh gjuha Angleze, një antar i një familjeje, Teutonike, por kur ajo përfaqëson, e vetme, dhe në një vend (hapësirë) të vogël dhe malor, pothuajse njëlloj si edhe Baskët, një familje të kompletuar dhe të veçantë, jo pa arësye ngrihet çështja: çfarë është bërë me antarët e tjerë të kësaj familjeje të gjuhëve? Është pikërisht kjo pyetje, të cilës në vijim do përpiqen t'i japin përgjigje, aq sa është e mundur, faqet e këtij libri. (R. Ellis, Fq. 1-11).

ARTASHES ABEGIAN

Nxjerrë dhe përkthyer nga libri

GESCHICHTE ARMENIENS

Shtutgart, 1948; (Faqe 1-7)
(përktheu nga Gjermanishtja: Berzh Piranjani)

ORIGJINA DHE GJUHA E ARMENËVE

Armenët i përkasin grupit të popujve Indo-Europianë Lindorë të tipit Satem. Sipas shënimeve të Herodotit (shek. 5të para Krishtit), "babait të historisë", si edhe të Eudoksos (shek. 4të para Krishtit), Strabonit (viti 63 para Krishtit – viti 19 pas Krishtit) dhe autorëve të tjerë të lashtësisë, paraardhësit e Armenëve e kanë origjinën nga Thraka dhe kanë qenë të afërt me Frigët. Njoftime të tilla të ngjashme gjenden edhe tek Koriun[1] (shek. 5të pas Krishtit) dhe historianë të tjerë Armenë. Historiani Johhanes Draskhanakertsi[2] (shek. 9 të pas

[1] *Shënim B.P.:* Koriun: Armenisht shkruhet *"Կորյուն"*, Shqip lexohet "Koriun"; ishte autori i shkrimeve më të hershme në gjuhën Armene. E shkruar në shekullin e pestë, vepra e tij "Jeta e Mashtotsit" përmban shumë detaje në lidhje me ungjillëzimin e Armenisë dhe shpikjen e alfabetit Armen nga Mesrop Mashtots. Ai e mbaroi punën e tij para betejës së Avarairit të vitit 451.

[2] *Shënim B.P.:* Johhanes Draskhanakertsi: (Armenisht shkruhet *"Հովհաննէս Դրասխանակէրտցի*" dhe në Shqip lexohet Hovhannes Dras'hanakertci; njihet si Johhanes Draskhanakertsi ose Gjoni i Draskhanakertsit). Ka qenë Katolikos i Armenisë nga viti 897 deri në vitin 925, si edhe një kronikan dhe historian i njohur. Ai ka qenë quajtur Gjoni i V-të Historiani, dhe është i njohur për veprën e tij "Historia e Armenisë", që është shtypur në fund të shekullit të 17-të. Tashmë gjendet e përkthyer edhe në gjuhën Angleze (1987) prej Krikor Maksudian.

Krishtit) e shpreh qartë Thrakën si vend të origjinës së Armenëve. Po kështu në lidhje të ngushta me njera tjetrën ishin edhe gjuhët e të dy popujve, Armenëve dhe Frigëve. Më vonë, zhvillimi i shkencës së gjuhësisë krahasuese konstatoi që, *gjuha Armene është një antare e grupit Europian të gjuhës Indo-Europiane, që formon një degë të pavarur të kësaj familje gjuhësore dhe që qëndron në një pozicion marrëdhënie të dukshme ndërmjet gjuhës Sllavo-Balltike dhe asaj Shqipe,* ndërkaq fjalori përmban edhe disa përputhje të rastësishme me Greqishten, njëlloj si gjuha Frige*. Nisur nga këto fakte, shkenca del në përfundimin se të parët e Armenëve fillimisht kanë jetuar në Europë dhe pikërisht në afërsi të paraardhësve të Grekëve dhe Thrakëve.*

Armenët vetëquhen Haj, vendin e quajnë Hajk ose Hajastan. Emri i vetë paraardhësit të Armenëve, Hajk, si edhe një sërë emrash të tjerë të vjetër të personave historikë apo vendeve historike si edhe sagat më të vjetra tregojnë për të njëjtën lidhje. Fjala Haj në përgjithësi gjurmohet në fjalën *"pati"* Indo-evropiane (krahaso fjalën Armene *pet* = Chef, Haupt, Herr = Shef, Kokë, Zotëri). P. Xhensen (P. Jensen) e orienton atë nga Hati (Çhatti), emri vendas për Hittitët. Më pas, gjithashtu, si etnikisht ashtu edhe gjuhësisht ai i përcakton Armenët si pasardhësit e Hittitëve. Gjeorgjianët, populli fqinj i Armenëve, i cilëson ata *Someçi (Somechi),* vendin e tyre *Somçethi (Somchethi).* Të gjithë popujt e tjerë e quajnë atë me emrin, me të cilin e quanin Persët e lashtë. Ata e quanin atë *Armina.* Më pas, po kështu u quajtën edhe nga Grekët, të cilët e huazuan këtë emër nga Persët. Më pas është shprehur mendimi, që sipas katalogut Homerik të anijeve (Katalogu i udhëtimeve) (Ilias Libri 783), populli i përmendur nën emrin Arimoi duhet të kenë qenë Armenët. Gjithashtu, ka mundësi, që fjala *Urmeni* e përmendur në një mbishkrim të mbretit Menua të Urartu-së (viti 828-784 para Krishtit) të bëjë fjalë për popullin Armen.

POPULLSIA

Gjatë formimit etnik të kombit Armen dy janë elementet, që duhet të kenë vepruar në mënyrë përcaktuese:

1. Armenët e lashtë të ardhur nga Europa

2. Popullsia paraArmene vendase

Në këtë proces duhet të ketë pasur pjesën e vet edhe popullsia Hittite si element etnik-formues. Dhe në fund nuk duhet të kalojnë pa u përmendur kohërat parahistorike të vendit. Në formimin përfundimtar etnik të popullit Armen, sidoqoftë, koha nuk mund të kalojë pa lënë gjurmë. Nga bashkëveprimi i të gjithë elementeve sipërpërmendur mendohet të jetë krijuar popullsia Armene. Si çdo popull tjetër, edhe vetë populli Armen është një popull i përzier. Në përgjithësi popuj me një racë absolutisht të pastër nuk njihet të ketë. Madje, në krahasim me shumë nga popujt e tjerë të botës, populli Armen konsiderohet ndër popujt më pak të përzier. Kjo për arsye se procesi i formimit etnik të popullit Armen, në pjesën më të madhe dhe përfundimisht, ka mbaruar në kohërat parahistorike. Atdheu historik i Armenëve, i rrethuar dhe mbyllur nga vargmalet e larta malore dhe grykat e thella, si edhe pozicioni i tyre fetar rreptësisht i veçantë, gjithashtu, kontribuan shumë për këtë.

Popujt kryesorë të Europës, Azisë së Vogël, Armenët, popujt e Kaukazit, dhe të Lindjes së Afërme dhe të Mesme duhet të numërohen (përfshihen) në grupin e racës Euripide. Për më tepër, lidhja e afërt racore ose ngjashmëria njihet përgjithësisht nga njëra anë midis shumicës së popujve të Gadishullit Ballkanik dhe zonave fqinje, dhe nga ana tjetër midis atyre të Azisë së Vogël, Armenisë, Kaukazit dhe Lindjes së Afërme dhe të Mesme. Ata shpesh janë referuar kolektivisht si raca Dinarike. Akoma më tej, studiues të tjerë e përdorin këtë emër të fundit për t'ju referuar vetëm njerëzve, që bëjnë pjesë në popujt e grupit të parë, atyre të Gadishullit Ballkanik dhe atyre të zonave fqinje me Alpet Dinarike, që konsiderohen si zona qëndrore e tyre (bërthama). Nga ana tjetër, shpesh përfshihen

në të njëjtin grup racash popujt e vjetër Hittitë dhe Kaldë (Çaldë) si edhe popujt më të vjetër e të rinj të Azisë së Vogël, Armenët, të Kaukazit dhe të vendeve fqinje me to. Nga studiues të ndryshëm ka pasur edhe emërtime të ndryshme, si p.sh.: hittitë, alarodikë, homo tauricus, homo dinaricus, kaukazianë, armenoidë, paraaziatikë, etj. Karakteristikat e mëposhtëme antropologjike për anëtarët e këtij grupi racor janë pothuajse gjithmonë të njëjta si për ato që paraqet grupi i afërt Dinarik: kafkë e shkurtër, sy të zinj, flokë të zinj, fytyrë me gjerësi mesatare, ngjyra e lëkurës – kafe e hapur, etj. *Gadishulli Ballkanik, atdheu i racës Dinarike, ka qenë njohur si vendi i origjinës së Armenëve.*

Në popullsinë Armene takohet, gjithashtu, edhe tipi i racës së Europës Veriore (NordEuropiane), pra njerëz me kafkë të gjatë, sy ngjyrë blu, flokë të verdhë, fytyrë të ngushtë, ngjyra e lëkurës – e bardhë në të kuq, etj. Udhëtarë dhe studiues Europianë, që kanë bërë vrojtime në Armeni, e konfirmojnë një gjë të tillë.

Fridtjof Nansen, i cili më 1925 kishte ndërmarrë një udhëtim studimor në Armeni, ka ardhur në të njëjtin përfundim. "Ndër njerëzit e mbledhur këtu", thoshte ai, "unë shoh tipa të ndryshëm Armenësh: nga armenoidë të pastër, me tipare zeshkane, deri tek ata të tipit Nordik". Në këngët bashkëkohore Armene i këndohet me dashuri vajzave dhe djemve bjondë, që zakonisht i përkasin klasave fisnike. Në sytë e poetëve popullorë Armenë janë kryesisht brunet, që konsiderohen ideali i tyre i bukurisë, por si të tilla gjenden shpesh edhe bjondet. Më pas, në këngët e vjetra mitologjike dhe legjendat historike të Armenëve do të gjeni të përshkruar paraardhësit dhe heronjtë e tyre fisnorë me lëkurë në ngjyrë të hapur, flokë të verdhë, sy në ngjyrë blu dhe shtat të lartë. Rezultatet e zbulimeve të bëra në varrezat e gjetura nga gërmimet në Armeninë e sotme, që i përkasin kohëve të afërta të epokës së hekurit dhe të bronzit, na tregojnë që popullimi paraKaldian (paraÇaldian) i vendit ka qenë i përbërë nga një racë me kafkë të gjatë. Ky popull qëndroi për një kohë të gjatë, afërsisht deri rreth mesit të mijëvjeçarit të 2^{të} para Krishtit,

në Armeni. Fiset me kafkë të shkurtër kanë emigruar atje vetëm më vonë si pasues të atyre me kafkë të gjatë. "Edhe këta vendas (Çhaldët, Kaldët, aborigjenët) shfaqin që të kenë pasur në përgjithësi një ndikim të caktuar të gjakut Europiano-Verior (NordEuropian)", shkruan Reche. Armenët pasuan vetëm më vonë, "fillimisht një fis që emigronte nga Evropa dhe që i përkiste racës së Evropës Veriore.

KARAKTERISTIKAT

Bazën e jetës shoqërore të Armenëve e përbën familja. Për popullsinë, që jeton në fshat, e cila përbën shumicën dërmuese të popullsisë të Armenisë, akoma edhe sot, pa folur për një gjeneratë të mëparshme, familja Armene paraqet një pamje patriarkale. Jo rrallë ajo përbëhet prej 20 apo më shumë antarësh, ndërkohë që ajo përfshin brenda saj (nën të njëjtën çati) njerëz të 3 deri në 4 gjenerata. Pjelloria e tyre arrihet vetëm nga disa njerëz. Nusja Armene në përgjithësi dhe gruaja fshatare në veçanti njihet si nënë me shumë fëmijë. Të mos pasurit fëmijë konsiderohet nga Armenët si fatkeqësia më e madhe, sidomos në fshat. Një fjalë e urtë thotë: "Familja pa fëmijë është si një trup pa shpirt". Në krye të familjes patriarkale qëndron gjyshi. Pas vdekjes së tij, si shtyllë e familjes vendoset e shoqja e tij. Një fjalë e urtë Armene thotë: "Burri është muri i jashtëm i shtëpisë, ndërsa gruaja është muri i brendshëm". Ajo është një bashkëshorte mjaft besnike. Familja fshatare pothuajse nuk e njeh fare ndarjen (divorcin). Gruaja fshatare Armene, së fundmi, është e lidhur shumë ngushtë me jetën ekonomike të fshatit. Mbështetja fort në tokë e këmbëve të fshatarit Armen dhe lidhja e thellë e njeriut Armen me popullin dhe atdheun e tij, me gjuhën dhe besimin e tij, me tërë mjedisin, qëndresa dhe këmbëngulja e tij, janë disa nga tiparet e karakterit tëj tij. Toka shterpë e atdheut është bërë frutdhënëse vetëm nëpërmjet punës së palodhur të fshatarit Armen. Qytetari paraqitet me një iniciativë të madhe, ndërkohë që fshatari mbetet më i ngurtë dhe konservator. Si njeri ashtu edhe tjetri kanë një prirje të madhe për të ndërtuar. Për t'i siguruar këto për fëmijët e tyre, ata janë të

gatshëm t'i nënshtrohen sakrificave të mëdha. Armeni dallohet për inteligjencë dhe karakterizohet nga një forcë e madhe perceptimi. Është jashtëzakonisht i talentuar në gjuhë. Tipar tjetër karakteristik i tij, veçanërisht i theksuar tek malësorët, është guximi dhe trimëria. Historia e popullit të tij është një luftë e vazhdueshme. Mikpritja përbën, gjithashtu, një nga vetitë e Armenit. Dhe së fundmi, si një popull i lashtë Arian botkuptimi i përgjithshëm i popullit Armen dallohet nëpërmjet disa tipareve karakteristike, të cilat në përgjithësi janë veti të racës Ariane. Lufta e përjetëshme ndërmjet dritës dhe errësirës dhe fitorja e së parës mbi të dytën, lufta ndërmjet së mirës dhe të keqes dhe fitorja përfundimtare e të parës – kjo është baza mbi të cilën mbështetet botkuptimi edhe i njerëzve më të thjeshtë Armenë. Dielli, i cili në besimin e mëparshëm të Armenëve luante një rol kyç, akoma edhe sot zë një vend qendror në masat e popullit Armen. Armenistët Europianë dhe udhëtarët Europianë, që vizitojnë Armeninë, të cilët u njohën me popullin Armen në atdheun e tyre nga afër, konfirmojnë gjithë sa është thënë këtu më sipër. Në vijim do të paraqesim disa vlerësime të bëra nga ana e tyre.

VLERËSIME NGA NJOHËS TË NJOHUR TË ARMENISË

Baroni *August fon Hakst'hausen* (August von Haxthausen): Mënyra e jetesës dhe organizimi i familjes tek populli Armen ka natyrë pothuajse patriarkale. Në një pjesë ato ndryshojnë thellësisht dhe ndjeshëm nga ato të pjesës tjetër të popujve aziatikë. Bëhet fjalë për pozicionin e gjinisë femërore, njohjen e pavarësisë, të drejtat e barabarta dhe dinjiteti, të cilat shprehen dhe pasqyrohen në "kushtetutën" e familjes Armene si dhe në personin e saj. Për mendimin tim, prirja e Armenëve drejt kulturës më të lartë njerëzore, si dhe mbështetja në aftësitë e tyre të shquara intelektuale për të synuar të ardhmen e tyre, kjo duket se ka qenë arsyeja që i kanë quajtur ata si lidhja midis Evropës dhe Azisë. August fon Hakst'hausen e quan këtë "prirje të Armenëve ndaj historisë botërore". Dhe më poshtë: "Me besimin më të thellë në Atdheun

e tyre, në gjuhën e tyre, në zakonet e tyre, në Krishterimin dhe përfaqësuesit e tij, në organizimin shtetëror, Armenët janë mbajtur fort e në mënyrë të palëkundur". – *"Lehtësia për të mësuar gjuhë të huaja është e admirueshme tek Armenët."* – "Armenët i përkasin popujve më të bukur të Tokës; konstrukti i trupave të tyre është jashtëzakonisht proporcional."

Herman Abich: "Është vula e mbetur, pavarësisht ndryshimeve që kanë ndodhur nëpër kohëra, e një fisnikërie të shenjtë dhe me baza të forta intelektuale, ajo që e nxjerr në pah këtë popull të çuditshëm para gjithë popujve, që e rrethojnë". – "Kam parë Armene shumë të bukura dhe ka mundësi që çmimi i bukurisë t'u takojë atyre".

Heinrich Hubschmann: "Nga popujt e shumtë, të cilët popullonin Azinë e Afërme veriperëndimore, padyshim, vetëm Armenët janë që kanë ruajtur deri në ditët e sotme folklorin dhe gjuhën e tyre, jo lehtësisht dhe pa mundime, jo në kushtet e një jetese paqësore, por nëpërmjet një lufte të vazhdueshme të jashtme dhe të brendshme."

Graf (Konti) **Eberhard Joachim von Westarp:** "Tek ne qarkullojnë pikëpamje të gabuara mbi Armenët. Unë kam një eksperiencë krejt të ndryshme nga kontaktet me Armenët, dhe unë jam i kënaqur që kam hasur në eksperienca të tilla, të cilat ndryshojnë nga publiku i gjerë, edhe në vende të tjera." – "Armenët janë një popull jashtëzakonisht i talentuar, elementi kulturor i vërtetë i atyre zonave, dhe i të gjithë njerëzve në mesin e të cilëve ata jetojnë në Azi, ndoshta më inteligjentët, në çdo rast ata janë shumë më të mirë se ata për sa i përket energjisë dhe vullnetit. – Forca me të cilën ata kapen pas folklorit të tyre është tashmë e njohur." – "Armenët janë ushtarë të shkëlqyer".

Friedrich Rosen: "Kush, ashtu si edhe unë, ka jetuar 4 (katër) vjet pranë Armenëve, ai e di, gjithashtu, se sa punëtor, i matur dhe ambicioz është ai popull, i cili merret kryesisht me bujqësi, mbarështim dhensh dhe punim qilimash dhe padyshim mund të konsiderohet si populli më i aftë dhe më i kulturuar në tërë Azinë e Afërme (Lindjen e Afërme).

PARAHISTORIA E ARMENËVE

Atdheu i paraardhësve të Armenëve thuhet se ka qenë në zonat lindore të Detit Balltik. Armenët e lashtë më pas janë shtrirë në drejtim të jugut, ashtu si më parë Grekët, duke u shtrirë drejt jugut gjetën në gadishullin Ballkanik një atdhe të tyre. *Në fund të mijëvjeçarit të dytë para Krishtit fiset Indo-Gjermanike (Indo-Europiane) të Frigëve dhe Armenëve emigruan nga vendi i tyre drejt Ballkanit dhe më pas gradualisht u shtynë nëpërmjet ngushticave detare drejt lindjes për në Azinë e Vogël.* Frigët, pastaj, u ngulën fort atje dhe themeluan vendbanimet e tyre të përhershme historike, ndërsa Armenët, dalëngadalë, u shtynë më tutje në drejtim të burimeve të Eufratit. Për një kohë të gjatë ata zunë vend në zonat në perëndim të Eufratit, e cila në histori njihet me emrin Armenia e Vogël.

Në kohën e emigrimit të Armenëve të vjetër, në zonat përtej Eufratit ishin rezidentë banorët Kaldë (Çaldë, Chaldë) ose Urartianë. Vendi i tyre, Urartu-ja, me qendër në Arcaskun (tashmë - Arcn) dhe Tushpa (tashmë -Van) në Detin (Liqenin) Van, në periudhën nga shekulli i 9^{të} deri në të 7^{të} para Krishtit ishte një nga shtetet më të fuqishëm dhe me një kulturë shumë të zhvilluar të Azisë së Afërme dhe ndërmerrte shpesh luftëra të rëndësishme ndaj fqinjit të vet të fuqishëm, Asirisë. Ndërmjet mbretërve të Urartusë vlerësohet veçanërisht mbreti Arame' (859-844 para Krishtit), nën sundimin e të cilit perandoria njohu kulmin e vet. Në përgjithësi akoma nuk është vendosur, nëse emri Aram, të cilin historiografët Armenë e njohin si më të rëndësishmin ndërmjet pasardhësve të Hajkut, paraardhësit të tyre, dhe sipas të cilit Armenët quhen edhe si "populli i Aramit, ka lidhje me emrin Arame', gjithashtu një nga sundimtarët më të rëndësishëm të popullit paraArmen të Armenisë, Kaldëve (Çaldëve, Chaldëve). Moisi Korenaci (Libri 12) thotë, se popujt e huaj i emërtuan Armenët sipas emrit të paraardhësit të tyre, Aram. Pasuesit e Arame's e qeverisën vendin e tyre me shumë sukses. Një numër i madh shkrimesh kuneiforme (në formë pyke),

që ata lanë pas tyre për pasardhësit, na tregojnë neve për luftërat e tyre fitimtare dhe për lavditë.

Në shekullin e 7të para Krishtit perandoria e Urartusë shkoi drejt rënies. Ky shtet, që kishte filluar të dobësohej nën goditjet e vazhdueshme të Asirianëve, nuk mundi t'i rezistojë sulmeve (dyndjeve) të fiseve të reja Indo-Gjermanike dhe shumë shpejt ju nënshtrua atyre. Në vazhdën e pushtimeve të fiseve Kimmeriane dhe Skithiane, Armenët depërtuan përtej Eufratit në tokën e Urartusë, deri në Araksestal. Ata e zotëruan atë gradualisht dhe e vendosën popullin Kald nën zotërimin e tyre. Këta u tërhoqën gjithnjë e më shumë deri sa u shkrinë në një masë të vetme së bashku me zotëruesit e rinj. Gjuha e tyre, që nuk ishte as Indo-Gjermanike dhe as Semitike – ajo shpesh i afrohet më tepër gjuhëve Kaukaziane -, do të duhej të zhdukej gradualisht. Në vend të saj mori përdorim të përgjithshëm gjuha Armene. Në kohën e Strabonit, ky zhvillim, siç e pohon vetë ai, tashmë ishte një proces i përfunduar (Gjeografia XI. 14/5). Që prej asaj kohe vendi vazhdon të njihet si *"Armeni"*. Për herë të parë në histori ne e gjejmë atë të përmendur si të tillë, pra si "Armeni", duke zëvëndësuar tashmë emrin e mëparshëm të vendit, "Urartu", në mbishkrimin Bisituner të mbretit të madh të Persisë, Darius, në vitin 521 para Krishtit.

HISTORIA E HERSHME E ARMENËVE

DINASTIA ARTAKSIADE

Në kohët e hershme të historisë së tyre, Armenët paraqiten si aleatë të fisit Iranian. Kiri i Irë (536-529 para Krishtit), themeluesi i perandorisë së madhe Perse dhe i pari i fisit të Akamenidëve, dhe bashkëkohësi i tij Tigrani i Irë (535-525 para Krishtit), mbreti i Armenëve, ishin miq të rinisë dhe aleatë. Si i tillë, Tigrani mori pjesë në rrethimin e Babilonisë nga Kiri. Në kohën e Darit të Madh (521-486 para Krishtit) e gjithë Azia e Vogël, nga India deri në Detin Egje, ndodhej nën skeptrin e tij; Armenia, gjithashtu u

deklarua Satrapi', pjesë përbërëse e perandorisë së madhe Perse. Kur Ksenofoni në krye të një trupe luftarake Greke prej 10 000 vetësh kaloi nëpër Armeni (Dimër 420/419 para Krishtit) vendi u nda në dy pjesë, në Armeninë Lindore dhe atë Perëndimore, në krye të të cilave qëndronin dy princa vendas, por sidoqoftë vazhdoi të mbetej si pjesë përbërëse e perandorisë Perse. Epoka e Aleksandrit të Madh (356-323 para Krishtit), fitoret e tij vendimtare mbi mbretin e fundit të Akamenidëve Darios Kodomanos (333 dhe 331 para Krishtit), e ndryshuan rrënjësisht situatën e përgjithshme në Azinë e Vogël. Pak kohë pas vdekjes së Aleksandrit të Madh, dhe nën pasuesin e tij, Diadokun, Armenia u bë pjesë përbërëse (që nga viti 301 para Krishtit) e zotërimeve Seleukide. Dobësitë dhe kryengritjet e vazhdueshme e çuan trashëgiminë e Aleksandrit drejt fundit. Dy princër Armenë, Artashes (Artaksias) dhe Sareh (Zareh, Sariadres) u shkëputën nga perandoria Seleukide dhe themeluan në Armeninë Lindore dhe atë Perëndimore shtetet e tyre. Pas kësaj, shumë shpejt Artashesi i I^{rë} (189-160 para Krishtit), i bashkoi të dy këto pjesë në një shtet të vetëm dhe themeloi Dinastinë Artaksiade të Armenëve. Gjatë kohës së sundimit të tij Armenia arriti një lulëzim të madh. Themelimi i kryeqytetit Artashat (Artaksata) në brigjet e lumit Arakses, sipas këshillës së gjeneralit Kartagjenas, Hanibalit, (sipas dëshmisë së Strabonit), i cili pasi kishte shpëtuar nga Romakët kishte gjetur strehim tek Artashesi, ishte kurorëzimi i veprimtarisë së tij. Gjithashtu, populli Armen i kushtoi këngë personit të tij dhe u thurri lavde bëmave të tij heroike, të cilat për qindra vjet qëndruan të gjalla në gojën e popullit dhe vetëm shumë vonë u arrit të rregjistrohen.

Tigrani i 2^{të} (95-56 para Krishtit), i ashtuquajtur Tigrani i Madh, nga Dinastia Artaksiade udhëhoqi një sërë luftërash fitimtare kundër Iranit, Kapadokisë dhe vendeve të tjera. Ai, tashmë "Mbret mbi Mbretërit" ose "Mbreti më i madh i Azisë", siç e quan Ciceroni, i shtriu kufijtë e Armenisë nga luginat e lumit Arakses dhe Kur deri në kufijtë e Fenikisë dhe nga vargmalet Pontike deri në ultësirat e Mesopotamisë dhe themeloi Mbretërinë e Armenisë së Madhe. Në bashkëpunim me

Mbretin e madh të Pontëve dhe vjehrin e vet, Mitridatin e II[të] Eupator (132-63 para Krishtit), për dekada me rradhë, ai zhvilloi luftëra të ndryshme kundër Romës dhe ushtarakëve të saj të shquar si Sula, Lukulus dhe Pompeu, derisa të dy aleatët u detyruan t'i nënshtrohen epërsisë së Romës. Pas kësaj Tigrani i II[të] arriti, ndonëse në kufij tashmë më të reduktuar, të ruajë pavarësinë e Armenisë brenda kufijve të rinj. Veprat e tij të lavdishme, ndërmjet të cilave ja vlen të përmendet edhe themelimi i kryeqytetit Tigranakert në pjesën jugore të Armenisë, janë kënduar me entuziazëm nga populli Armen dhe janë ruajtur me kujdes për gjatë qindravjeçarëve. Edhe këto më pas janë rregjistruar dhe kanë qenë kurdoherë burim frymëzimi patriotik.

GJURMË ARMENE NË HISTORINË DHE KULTURËN BOTËRORE

Armenët kanë luajtur një rol të nderuar në Historinë dhe Kulturën Botërore. Këtu është rasti për të përmendur disa emra: Artavazdi, djali dhe pasuesi në fron i Tigranit të Madh (Shekulli i I[rë] para Krishtit), ishte autori i një sërë tragjedish të vlerësuara, të shkruara në gjuhën Greke; armeni Prohairesios, një mik i Julian "Femohuesit" në Athinë, ishte oratori dhe mësuesi më i kërkuar i kohës së vet në Shkollën e Lartë (shekulli i 4[t]). Në Romë atij i ngritën një përmendore në bronz me mbishkrimin: "Roma perandorake, Oratorit perandorak". Gjithashtu, nderime të mëdha ju përkushtuan atij edhe në Athinë. Komandanti i shquar i Perandorit të Perandorisë Romake të Lindjes Justinian i I[rë], Narsesi, mundësi i Vandalëve, zaptuesi dhe guvernatori i Mbretërisë Gotike të Lindjes (shekulli i 6[të]), ishte gjithashtu Armen. Një sërë komandantësh të tjerë Armenë të Perandorisë Bizantine, në sajë të trimërisë dhe bëmave të tyre të dukshme, në disa raste kanë arritur deri në fronin perandorak. P.sh. Perandori Basileus i I[rë] (shekulli i 9[të]) rridhte nga një familje Armene; ai është themeluesi i të ashtuquajturës Dinastia "Maqedonase", e cila në realitet ishte një dinasti Armene.

Nga periudhat më të reja të historisë mund të përmenden këta emra: Princi Loris-Melikoff, komandant dhe burrë shteti i Rusisë gjatë rregjimit të Aleksandrit të II, dhe piktori me famë botërore i detrave Ajvazovski ishin po ashtu Armenë si edhe Murati, kunat i Napoleonit dhe Mbret i Napolit. E njëjta gjë vlen të thuhet edhe për Nubar Pashain, novatori i sistemit juridik të Egjyptit të sotëm, si edhe për burrin e shtetit të njohur Persian të shekullit të 19të, Malkon.

Për ta përmbyllur, mund të përmenden edhe disa personalitete nga koha e sotme, të cilët gjithashtu kanë fituar një famë botërore dhe janë Armenë: Michael Arlen, një nga shkrimtarët më të njohur modernë në gjininë e romaneve në Angli, William Saroyan, një nga tregimtarët dhe dramaturgët më të lexuar dhe më të vlerësuar në Amerikën e sotshme, dhe së fundi kompozitori sovjetik Aram Kaçaturian, i cili numërohet si një ndër tre muzikantët më të mëdhenj të Bashkimit Sovjetik. Sa është thënë më sipër vlen gjithashtu edhe për Ruben Mamulian, regjizorin e njohur të filmave në Holywood, si dhe për Kalust Gylbengian, një nga manjatët e parë të naftës dhe të financës në botë.

"Populli Armen", thotë Fridtjof Nansen, "mundi që në hapësirën e maleve të veta, të zhvillojë një kulturë nacionale të llojit të vet dhe e ruan fort krijimtarinë e vet, shpesh deri në fanatizëm. Kjo kulturë, në shumë pikëpamje, e pavarur, e ka bërë të aftë këtë popull të talentuar, të kontribuojë ndjeshëm jo vetëm në zhvillimin e kulturës Bizantine, por edhe asaj të Europës Perëndimore.

PËRMBLEDHJE:

Përgjatë historisë, populli Armen i ka shpalosur forcat e veta në fusha të ndryshme të jetës publike dhe kulturore, dhe ka mundur të realizojë arritje të jashtëzakonshme – madje të tilla "me rëndësi historike botërore", thotë Markwart, - arritje që e vendosin atë në rangun e kombeve më të përparuara kulturore në botë. Moisi Korenaci, "Babai i historisë së shkruar Armene", depërton në

zemrën e historisë Armene kur thotë: "Ne jemi një *pjesëz e vogël kopshti,* jo shumë i madh në numër, por edhe në vendin tonë, gjithashtu, janë kryer shumë akte trimërie, të cilat e meritojnë të dokumentohen me shkrim".

Shumë prej popujve të kohëve të lashta: Assirianët dhe Babilonasit, Hittitët dhe Kaldeasit (Chalder), Medët dhe shumë kombe të tjera janë zhdukur prej kohësh, por *"pjesëza e vogël e kopshtit",* populli Armen, ka mundur të mbijetojë deri në ditët e sotme. Dhe ka gjithashtu, vullnetin e patundur të mbijetojë deri në përjetësi.

Shënim: Njohuri dhe Vlerësime për figurën e Artashes Abegian:

1. Harutiun Hajrapetian për - Artashes Abegian: Filolog dhe figurë e madhe publike

Pas vendosjes së pushtetit sovjetik në Armeni, shumë figura publike, shkencëtarë dhe artistë u larguan nga atdheu i tyre dhe u bënë mërgimtarë, përfshirë studiuesin e madh, kritikun letrar, politikanin Artashes Abegian, i cili u detyrua të vazhdojë aktivitetet e tij shkencore dhe publike në Gjermani. Ai luajti një rol të madh në jetën e komunitetit Armen në Europë dhe veçanërisht në Gjermani. Periudha më aktive e karrierës së tij është e lidhur me ardhjen e nazistëve në pushtet. Dhe ishte gjatë kësaj periudhe, që zoti Abegian, duke përdorur autoritetin e tij dhe ndikimin e madh, shpëtoi jetën e qindra mijra Armenëve, pasi së bashku me lëvizjen e vazhdueshme anti-Semitike në Gjermani po rritej edhe lëvizja anti-Armene, e cila u provokua dhe u financua nga Turqia.

2. Nxjerrë nga libri "Historia e Armenisë", Artak Movsisjan

Turqit, duke u afruar në aleancë me Gjermanët, në vitin 1939 u përpoqën t'i bindnin këta të fundit, se gjoja Armenët kishin origjinë semite dhe si rrjedhim duhet të asgjësoheshin së bashku me çifutët. Armenët e Europës i dolën përpara këtij veprimi falë Këshillit

Kombëtar Armen të Berlinit (kryetar i së cilës ishte profesori i Universitetit të Berlinit, Artashes Abegian), publikimet e të cilit, si edhe të studimeve të shkencëtarëve të tjerë Europianë, që mbështesnin tezën "Armenët janë racë Ariane", të cilët arritën të bindin elitën shoqërore hitleriane, që Armenët ishin racë Ariane (IndoEuropiane).

3. Artashes Abegian (Armenisht: Արտաշես Գաբրիելի Աբեղյան) - lindi më 1 Janar 1877, Astabad, Nahiçevan – vdiq më 13 mars 1955, Mynih, Gjermani); ishte filolog, historian, arsimtar, aktivist dhe politikan Armen. Ka dhënë mësim në Universitetin e Berlinit.

KIM GAHRAMANIAN

Nxjerrë dhe përkthyer nga libri

1500-YEARS-OLD FUNDAMENTS OF LAW AND ORDER IN ARTSAKH

Yerevan, 2010
Përktheu nga Anglishtja: Berzh Piranjani

Pas luftërave të gjata e të vazhdueshme, në vitin 387 pas Krishtit, Mbretëria Armene u nda ndërmjet Perandorisë Bizantine dhe Persisë. Pjesa perëndimore e vendit u aneksua nga Perandoria Bizantine, ndërsa tokat lindore (përfshirë Arcah-un) ju dhanë Persisë. Përfundimisht, në vitin 428 pas Krishtit, Mbretëria Armene tashmë ndodhej e shkatërruar. Ajo u reformua dhe u shndërrua në një Marz (Krahinë periferike); dhe me qëllim që të siguronte sa më lehtë qeverisjen e kësaj njësie të re administrative, Persianët eleminuan të gjitha rrugët e mundshme të rivendosjes së pavarësisë dhe shkëputën prej saj krahinat lindore – Arcah dhe Utik, të cilat gjithnjë ishin quajtur si "Pjesa Lindore" ose "Bota Lindore". Këto të fundit ju aneksuan *fiseve Albane,* që në atë kohë qeveriseshin nga Persia, dhe që zinin një hapësirë, që fillonte nga lumi Kura deri në vargmalet Kaukaziane, duke krijuar kështu një tjetër provincë të quajtur *Aghvank (të njohur ndryshe si Albania e Kaukazit ose Alvania).*

Krahina e porsakrijuar Aghvank përbëhej nga dy pjesë, të cilat nuk kishin kurrfarë afërie me njera tjetrën, arsyeja kryesore kjo,

që kjo provincë nuk arriti kurrë të bëhej një njësi administrative e unifikuar. Zona në veri të lumit Kura ishte e banuar nga një duzinë fisesh të vogla, të cilët jetonin të veçuar nga njeri tjetri dhe nuk kishin një tregti, gjuhë, kulturë apo besim të përbashkët. Në kontrast me ta, Bota Perëndimore Armene, jetonte si një bashkësi unike, fliste të njëjtën gjuhë, duke kultivuar bashkarisht të njëjtat vlera kulturore dhe fetare.

Bile edhe historianët Grekë dhe Romakë të kohës së vjetër kanë shkruajtur se Armenia ndahej prej fiseve Albane nga lumi Kura. Në përpjekje për të rishikuar këto burime informacioni, i ashtuquajturi themelues i disiplinës historike të Azerbaixhanit, Abass-Kuli-Aga Bakikanov ka shkruajtur: "Kufiri Armen shtrihet përgjatë bregut të djathtë të lumit Kura deri në pikën ku lumi Araks fillon rrjedhën" (Gjylistan-Iram, Baku, 1926, c,8).

Zonat në veri të lumit Kura ishin të populluara nga një duzinë fisesh të vogla, dhe përgjithësisht nga historianët e vjetër ishin *të njohura si "Albania", që do të thotë "vendi i maleve". Ja vlen të përmendim këtu që këto vende kanë këtë emër akoma edhe sot, pasi "Dagestan" në gjuhën e vendit përkthehet si "Vendi i Maleve".* Sot, këto vende banohen prej shumë grupeve të ndryshme etnike, ashtu siç ka qenë edhe në të kaluarën. (fq. 111, 112, 113).

Me qëllim evitimin e konfuzionit që mund të krijohej për shkak të emrit të kësaj krahine Armene dhe vendit *Albania,* që shtrihej në bregun e majtë të lumit Kura, për shkak se që të dyja, me ristrukturimin krahinor që bëri Persia, u futën në një Marz (Krahinë) të emërtuar *Aghvank,* shkrimtarët e kohës gjithnjë e diferenconin *Aghvankun Armen* nga vete *Aghvanku historik, Albania.* (fq. 116).

Është me interes të përmendet që, Movses Kaghankavatski i paraqet *fiset (tributë) Albane* si "njerëz të ashpër" dhe sundimtarët e tyre si "mizorë" (Libri 1, Kapitulli 11). Kjo nënkupton që autori i "Historia e Aghvankut" i paraqet *fiset Albane* si të pazakonshëm dhe armiqësore. (fq. 120).

Shënim B.P.: I kujtoj lexuesit që ky libër, ""Historia e Aghvankut" i Movses Kaghankavatskit, tashmë ndodhet në qarkullim edhe në botën e shkrimeve shqiptare i përkthyer në gjuhën shqipe nën titullin "Historia e Albanëve të Kaukazit", përkthim i bërë nga Berzh Piranjani.

CHRISTOPHER J. WALKER

Nxjerrë dhe përkthyer nga libri

"ARMENIA" A VERY BRIEF HISTORY

Yerevan, 2014
Përktheu nga Anglishtja: Berzh Piranjani

Armenët janë një popull shumë i lashtë. Ata janë pasardhës të njerëzve që kanë jetuar në këtë vend që nga kohët parahistorike. Arkeologët kanë regjistruar aty një vazhdimësi të ekzistencës njerëzore që nga Epoka e Gurit të Vjetër. Rreth 1000 vjet para Krishtit, në territorin e Armenisë ishte mbretëria Urartu (emër ky, i ngjashëm me emrin "Ararat"), i cili rreth viteve 600 para Krishtit u shkel nga pushtues të ndryshëm (Scythians, Medët, dhe "Hasaya"), disa prej të cilëve të ardhur nga shteti i vjetër i Hittitëve në Anadollin Qendror (Anatolinë Qendrore). *Gjuha e përdorur, si rezultat edhe i ndikimit të të ardhurve të rinj, i përkiste një dege të qartë të grupit të gjuhëve indo-europiane.* Ajo kishte disa ngjashmëri me gjuhët Iraniane. Burimet Iraniane dhe Greke filluan të flisnin për Armeninë dhe Armenët duke nisur nga vitet 500 para Krishtit. Mbretërit e mëdhenj Darius dhe Kserksi i njihnin këta popuj me këta emra, ashtu si edhe Herodotusi. Në 401 para Krishtit, Ksenofoni kaloi nëpër Armeni dhe aty vuri re zakonin e vendasve për të pirë birrën nëpërmjet një kallami prej kashte.

Kështu, të dhënat tregojnë se Armenët kanë një vazhdimësi të ekzistencës në atdheun e tyre prej të paktën dy mijëvjeçarë e gjysëm, deri në shkatërrimin e tyre gjenocidal dhe shpërndarjes në 1915 (me përjashtim të zonës së vogël të ish Armenisë Ruse).

Në shekullin e parë para Krishtit, në kohën e Pompeit dhe Cezarit, brenda një kohe të shkurtër Armenia ishte rritur fuqimisht, duke marrë tiparet e një perandorie. Perandoria e arriti shtrirjen e saj më të madhe gjatë kohës së sundimit të mbretit Tigran i II[të] (Tigrani i Madh), i cili sundoi nga viti 95 deri në vitin 55 para Krishtit. Mbretëria e tij shtrihej nga deti Kaspik deri në kufi me Egjyptin. Por Roma u ndje e kërcënuar, dhe ndërmori fushata të ndryshme nga Lukulus (Lucullus) dhe Pompei, dhe në shekullin e ardhshëm nga Korbulo, duke e reduktuar perandorinë nga një fuqi botërore në një fuqi rajonale. (fq. 8)

Njëqind vjet më vonë *(bëhet fjalë për vitin 405.: Shënim B.P.)* një shkrues i devotshëm shpiku një dorëshkrim për gjuhën Armene. Deri atëhere kishte qenë përdorur shkrimi kuneiform Grek dhe Aramaik; tashmë ishte krijuar një alfabet i mirë, i cili pasqyronte me saktësi tingujt e gjuhës Armene. Bibla ishte libri i parë, që u përkthye në Armenisht me shkrimin e ri; kjo pasoi me të tjera tekste dhe vepra, që përmbanin shkrime të shenjta, duke kulmuar kështu në shekullin e pestë të njohur si "Epoka e Artë" e shkrimit Armen. (fq. 8, 9)

VAHAN SETIAN

Nxjerrë dhe përkthyer nga libri

ARMENIAN ORIGINS OF BASQUE

The Linguistic Verdict, 2017
Përktheu nga Anglishtja: Berzh Piranjani

"Nga fundi i shekullit të 19[të] linguisti Eduard Spenser Dodgson (Edward Spencer Dodgson, 1857-1922) ngeli i shtangur përpara një zbulimi intrigues. Studjues i njohur në fushën e studimeve Baske, Dodgsoni kishte filluar të mësonte gjuhën Armene për të zgjeruar horizontin e tij linguistik. Rezultati ishte krejt i papritur: pas vetëm dy muajsh, Dodgsoni vuri re që fjalë Baske dhe Armene ishin praktikisht njëlloj. Dodgsoni i publikoi gjetjet e tij në vitin 1894 në revistën "Euskera" (Gjuha Baske). Ishin më tepër se 59 fjalë të përfshira në listën e Dodgsonit si fjalë të njëllojta. Kjo ishte si

---

Shënim B.P.: Shënime paraprake sqaruese: Në librin e tij "Armenian Origins of Basque", Vahan Setian ka futur edhe pjesë nga botime të gjuhëtarit dhe Baskologut të njohur Armen, Vahan Sarkisian. Me qëllim që të shmang keqkuptimet u detyrova që poshtë çdo pjese të nxjerrë nga ky libër të vendos edhe emrin e autorit të cilit i përket kjo pjesë.Shkrimet që i përkasin Vahan Sarkisian do shoqërohen në fund me shënimin V. Sarkisian ndërsa ato që i përkasin Vahan Setian do shoqërohen në fund me shënimin V. Setian.

Shënim: Sot ky libër ndodhet i botuar edhe në gjuhë Shqipe nën titullin: "Origjinat Armene të Baskëve", i Vahan Setyan, përkthyer dhe përshtatur nga botimi në gjuhën Angleze nga Berzh Piranjani, Botuar: albPAPER, Tiranë, 2020.

një bubullimë në qiell të kthjellët, veçanërisht për ata shkencëtarë që kishin mbështetur për një kohë të gjatë origjinën Gjeorgjiane të gjuhës Baske. (Fq. xvii) (*V. Sarkisian,* Gjuhëtar dhe Baskolog Armen, 1954 - 2011)

Karsti (1928) (linguisti Gjerman Josef Karst) guxoi të rishikojë hartën gjuhësore të Europës, duke hedhur dyshime mbi konsiderata tradicionale. Gjuha Armene ishte konsideruar Indo-Europiane ndërsa ajo Baske jo, kështu që qindra koincidenca, legjenda popullore, dhe të dhëna historike dilnin pa kuptim. (Fq. xix) *(V. Sarkisian)*

Shkencëtarët kanë zhvilluar listën më të plotë deri më sot me ngjashmëritë linguistike Baske, duke përfshirë më se 1000 fjalë dhe elemente gramatikorë. (Fq. xix) *(V. Sarkisian)*

Natyrisht, askush nuk mund të thotë që të gjitha çështjet, që lidhen me teorinë e afërisë Basko-Armene, janë të zgjidhura përfundimisht, por pika kryesore mbetet përtej çdo dyshimi: që civilizimi Bask përmban një shtresë të thellë Armene si rezultat i procesit të migrimit në kohë prehistorike. Njihet gjerësisht që Baskët janë populli më i vjetër i Europës Perëndimore. Ata u shfaqën përpara se të mbërrinin Indo-Europianët, me invazionet fillestare që datojnë rreth viteve 1000 BC (para Krishtit). Duke filluar prej asaj kohe elementi Armen tashmë ekzistonte në Europën Perëndimore dhe rrjedhimisht pati një influencë të dukshme në zhvillimin e civilizimit Europian. (Fq. xx-xxi) *(V. Sarkisian)*

Jozef Karst (Joseph Karst), gjuhëtar dhe filolog Gjerman, ka paraqitur më shumë se 300 ngjashmëri (paralelizma) leksikore Basko-Armene dhe elemente të gramatikës dhe fonetikës, të cilat përfshijnë sistemet e zgjedhimit dhe përdorimin e shkencave të etnografisë dhe antropologjisë (Karst, 1928). Bazuar në evidencat, ai arriti në përfundimin që gjuha Armene kishte influencuar mbi gjuhën Gjeorgjiane dhe që gjuha Baske dhe ajo Armene janë dy forma të së njëjtës gjuhë. Bernard Lasa, akademik Bask, u pajtua me këtë argument. (Fq. 35) *(V. Setian)*

Në librin e I[rë] të Khorenacit, ai thotë: "Hajku ... pasi u bë me fëmijë në Armanjak të Babilonisë, shkoi tek kombet Araratiane". (Fq. 41) *(V. Setian)*

Ne mund ta konsiderojmë si të sigurtë faktin se përdorimi i gjuhës në punimet agrokulturore ka qenë një mundësi për t'i lidhur këto gjuhë *"të ndryshme"* së bashku. Për shembull, Fransis Hjut (Francis Hewitt) shpalli se ishin migrantët nga Armenia ata, që sollën verën (pijen e verës) nëpërmjet anijeve Thrake tek Grekët në Trojë", duke vënë në dukje se e ashtuquajtura "Goinos" në gjuhën Frige, "Ganos" në gjuhën Thrake, "Vinum" në gjuhën Latine, dhe së fundmi "Wine" në gjuhën Angleze, rrjedh nga fjala Armene "Gini = verë", dhe se Asirianët ishin të parët, që zbuluan prodhimin e verës prej Armenëve. (Fq. 48) *(V. Setian)*

H.V. Hilprecht (1859-1925), një Assiriologjist Gjermano-Amerikan (studjues i Assirianëve – Profesor i Assiriologjisë dhe Drejtor Shkencor i Ekspeditave Babilonase, Universiteti i Pensilvanisë), i cili udhëhoqi gërmime në shkallë të gjerë dhe u mor me interpretimin e mbishkrimeve Hittite, ka thënë:

"Përpara se të jemi në gjendje të bëjmë ndonjë pohim përcaktues (që zgjidh çështjen përfundimisht) përsa i përket leximit të mbishkrimeve, *ne duhet të marrim parasysh që gjuha Hittite ka qenë Armenishtja.* Kjo tashmë nuk është më hamendje; leximi aktual i mbishkrimeve e ka transformuar tashmë këtë hamendje në një fakt të sigurtë. Pasi çdo gjë, që neve tashmë dimë në gjuhën Hittite,

[31] *Shënim V. Setian:* Venice, Venezia ose Venetiae rrjedh nga njerëzit që migruan fillimisht në Iliri nga Armenia e lashtë, veçanërisht nga Kapadokia. Emri rrjedh nga Veneti. Ndonëse ajo është Ilirisht nga afërsia, në origjinë ajo është Armene – Vanetsi ose Vanits, si shprehje e formës "prej Vanit", ose "si të ardhur prej Krahinës së Vanit" në Armeninë e lashtë. Kjo mund të na ndihmojë në nxjerrjen e kuptimit të kësaj fjale, si edhe, të vendlindjes së saj. Sipas një informacioni shtesë, Iliria ka, gjithashtu, një qytet të quajtur Arukia (Arucia), të ngjashëm me emrin Armen "Arusiak", që gjendet vetëm në Armenisht, i cili natyrisht sot është një emër, që përdoret nga gratë Armene. (Fq. 48)

është Armenisht, ose më mirë të themi, Armenishte e vjetër, dhe që format korresponduese në Armenishten moderne janë zhvilluar duke e tejkaluar të vjetrën në përputhje të plotë me ligjet e njohura të fonetikës Armene... Në rrethana të tilla, ne shumë pak kemi nevojë për këtë fakt shtesë, që vlerat fonetike të hieroglifëve, për aq kohë sa këto hieroglife njihen si piktura, kanë lidhje me fjalë të caktuara Armene, duke na treguar kështu, që shkrimi Hittit është krijuar nga paraardhësit e Armenëve modernë". (Fq. 51-52) *(V. Setian)*

---

[97] *Shënim V. Setian:* Grekët i kanë quajtur "Pellasgët" si populli, i cili ka sunduar tokat përpara se ata të lëviznin në Egje. Natyrisht, Pellazgët origjinalë nuk mund të flisnin gjuhën Helenike. Një nga atributet e mëdha, që u është dhënë Pellazgëve, është vendosja nga ana e tyre e civilizimit Mikenian rreth para 4000 vjetësh. Problemi është se asnjë shpjegim etimologjik nuk është i kënaqshëm ose i afrohet shpjegimit të emrit të këtyre popujve. Madje edhe Grekët e përmendin që Pellazgët nuk flisnin Greqisht. Arkeologë të ndryshëm e kanë konsideruar kulturën si kulturë të natyrës Neolitike. Mikena është i pari qytet i ndërtuar në Greqi dhe është konsideruar ekstravagant dhe "i artë" nga natyra. A ka vallë mundësi që të ardhurit rishtas Grekë t'i konsideronin banorët vendas dhe fqinjët e tyre Pellazgë si "pajl-azg" (Në gjuhën Armene shkruhet *"փայլ ազգ",* lexohet "pajl azg", që do të thotë "Populli Ndriçues") për shkak të nivelit më të lartë dhe natyrës më të zhvilluar? Grekët në shkrimet e tyre nuk shprehin admirim për civilizimin Pellazg. Homeri është një nga të parët që i përmend Pellazgët si edhe afërsitë dhe natyrën e ngjashme me Trojanët. Ne mund të sjellim në vëmendje se Troja është etimologjikisht derivativ (i prejardhur) i emrit të Zotit Armen të Letërsisë, Tir, dhe i zgjatuar me prapashtesën Greke – oi (oj), që i jep asaj kuptimin e saj original Armen. Në mbështetje të mëtejshme të këtij shpjegimi, ne mund të përmendim se qyteti i Trojës është themeluar nga mbreti legjendar i Frigjisë (Phrygia) – Tiros. Madje edhe vetë emri Tir mund të kqyret si emri Armen "Ter", që do të thotë "Zotërues", "Drejtues", "Sundues", "Zot", term, i cili sot aktualisht përdoret edhe për "Mbret". Ka edhe konsiderata, të cilat e trajtojnë emrin (fjalën) Tir si të prejardhur nga fjala Armene "gir" – shkrim, pasi "Tiri" Armen ka qenë Zoti i Letërsisë. Ne sigurisht mund t'i argumentojmë afërsitë që janë gjetur ndërmjet Armenëve, Pellazgëve, Lidianëve, Frigëve dhe Etruskëve nga disa historianë dhe gjuhëtarë, përfshirë Ellis (1861) dhe Drews (1994) dhe ato nuk do të kalojnë pa u vënë re. Robert Ellis nuk u pajtua me supozimet që George Rawlinson bëri mbi këtë temë, të cilën ai ishte i aftë ta mbështeste me argumentet e tij të bazuara në zbulimet dhe mbetjet gjuhësorë dhe arkeologjike. Për më tepër, afërsitë etimologjike dhe arkeologjike, dhe tani, edhe afërsitë gjenetike, i mbështesin këto nocione të ndërfutjes (ndërlidhjes) ndërmjet grupeve, që rreth 150 vjet më parë konsideroheshin si të tillë (pra si grupe të veçantë). Ja vlen të përmendet edhe një shënim shtesë: "Porta e Luanëve" e Hittitëve, që është ndërtuar në Hatussa në vitin 1400 BCE, është pothuajse identike me "Portën e Luanëve" të Mikenës në Greqi. (Fq. 96) (V. Setian)

Profesorët Xhensen, Hilprecht dhe A. H. Sayce (1845-1933), ndërmjet shumë të tjerave, *kanë konsideruar që gjuha Hittite dhe Armene janë të njëjta.* (Fq. 52) *(V. Setian)*

Tambovcevi (Tambovtsev, 2003) theksoi, se një qënie humane është në gjendje të perceptojë nëse një gjuhë e caktuar mund të tingëllojë e ngjashme me gjuhën e tij amtare, pa arritur të kuptojë kuptimin (fq. 775), dhe kjo është një perspektivë që haset rrallë të përdoret. (Fq. 60) *(V. Setian)*

Gjetjet e famshme të Gray dhe Atkinson (2003) u bënë më pas elektrizuese kur erdhën rezultatet nga Serva dhe Petroni (2008). Duke marrë parasysh teorinë e zbatueshmërisë së distancës të Levenshteinit në gjuhësi, Serva dhe Petroni krahasuan 50 gjuhë, që ndodheshin brenda pemës së gjuhëve Indo-Europiane. Rezultatet e tyre e mbështetën akoma më tej Hipotezën Anatoliane me disa pak kontraste interesante. Në kontrast me grupimin që i bënë Gray dhe Atkinson gjuhës Armene dhe asaj Greke duke i vendosur në një degë të veçantë, Serva dhe Petroni e trajtuan gjuhën Armene si një degë fare më vete, shumë pranë rrënjës, ndërsa dega tjetër - si degë që përmbante të gjitha gjuhët e tjera Indo-Europiane të mbetura. Për më tepër, rezultatet e tyre e vendosën gjuhën Greke në fazën fillestare të ndarjes, duke vendosur, gjithashtu, gjuhën Shqipe si pjesë e gjuhëve Indo-Europiane në krahasim me pozicionimin Indo-Iranian të propozuar më parë nga Gray dhe Atkinson. Kështu, ata vendosën gjuhën Armene dhe pastaj atë Greke në rradhën e atyre, që u shkëputën fillimisht nga pema e gjuhëve Indo-Europiane. (Fq. 98) *(V. Setian)*

Natyrisht, ka popuj primitivë në vendet Baske, të cilët mërmërisin gjuhë primitive, siç ndodhte në të gjithë Gadishullin Iberik, siç janë edhe Ligurianët apo Tartesianët, ose Keltët, ose "Malagenjos" (Malaguenos) nga shpellat Nerja; por trungu i korpusit gjuhësor të Spanjës Veriore dhe Francës jugperëndimore është gjuha Armene, që tashmë quhet "Baskishte", me shtesa të

ndikimeve të gjuhëve Romane, tashmë fqinje me të, në gjuhën Baske, të cilën gjuhëtarët profesionistë e quajnë shtresë (Stratum), e cila ka lënë kaq shumë gjurmë në dialektet e shumta të luginave Baske". – Jesus Garcia Castrillo[103]

Probabiliteti statistikor, që thjesht një shans apo një koincidence e vetme të mund të shërbejë si shpjegim për shqiptimin (tingëllimin) e njëllojtë të fjalëve të ngjashme Basko – Armene, dhe që njëkohësisht të kenë të njëjtin kuptim, do të ishte i pakuptimtë (absurd). Nga ngjashmëritë e dukshme të fjalëve ne mund të arrijmë në përfundimin e afërsisë (bashkësisë) ndërmjet tyre, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe të përfytyrueshëm. (Fq. 105) *(V. Setian)*

A është e mundur që vrojtimi i Ellis se "çfarëdo ngjashmëri Armene që gjendet në Europë duhet të jetë e një hyrjeje shumë të hershme: Pasi asnjë pushtim apo migrim Armen nuk mund të jetë bërë kaq thellë në perëndim, me përjashtim të rastit kur kjo mund të ketë ndodhur në kohërat parahistorike, ose mbase edhe në kohërat para-tradicionale …" të mund të konsiderohet si një element tjetër kritik që zgjidh një çështje kritike? Pyetja se përse ne shohim ngjashmëri ndërmjet gjuhës Armene dhe të gjuhëve të tjera nëpër botë, si ato të vdekura ashtu edhe ato aktualisht të gjalla, mund të na tregojë neve, se i njëjti grup migrator guxoi të largohej në drejtim të pjesëve të tjera të botës, duke marrë me vete njohuritë e veta mbi agrikulturën, zbutjen e kafshëve shtëpiake dhe shumë elemente të dorës së parë të civilizimit, të mbështjella (të ruajtura) me gjuhën e tyre. (Fq. 106) *(V. Setian)*

[103] *Shënim V. Setian:* Publikuar elektronikisht në 29 Korrik 2013. (Fq. 105) (V. Setian)

ARTAK MOVSISJAN

HISTORIA E ARMENISË

Përkthyer dhe përshtatur nga origjinali Armenisht :
Berzh Piranjani

Botuar: albPAPER, Tiranë, 2019

LINDJA E KOMBIT ARMEN

Ku e ka origjinën kombi Armen, kur është formuar si një bashkim etnik i pavarur dhe në çfarë kohe përmendet si i tillë në shkrimet e gjetura në monumentet më të vjetra. Për t'i dhënë përgjigje këtyre pyetjeve, fillimisht duhet të kthehemi prapa në kohë, në legjendat që na kanë mbërritur të shkruajtura nga shekujt e kohëve të vjetra dhe të mesme dhe më pas historisë së lindjes së kombit Armen sipas fakteve të dala në dritë nga studimet shkencore të ditëve të sotme.

LEGJENDAT QË FLASIN PËR LINDJEN E KOMBIT ARMEN.

Ka shumë legjenda me shkrim, lidhur me historinë e lindjes së kombit Armen, që i përkasin periudhave të hershme dhe shumë të hershme kohore. Legjendat Armene janë krijuar që në kohë shumë të hershme dhe deri tek ne kanë arritur falë shkrimit "Historia e Armenisë" të Moisi Horenacit (Movses Horenatsi).

Në periudhat e paraKrishterimit, paraardhësit e Armenëve të sotëm besonin që ishin pasardhës të Patriarkut të Madh, Hajk. "Të parët e zotave ishin të frikshëm dhe të jashtëzakonshëm si edhe

shkaku i krijimit të mrekullive të mëdha, i krijimit të botës dhe popullimit të saj. Prej tyre doli fillimisht brezi i gjigantëve ... një prej të cilëve ishte ... Hajku."

Sipas shkrimeve të vjetra (shumero – akkadiane) kuneiforme (në formë pyke) të gjetura në monumentet e zbuluara në zonën e Lindjes së Mesme merret informacioni, që zoti mbrojtës i mbretërisë më të vjetër të Malësive Armene (në shekujt 28-27 para Krishtit) ka qenë Hajku, djali i zotit të urtësisë dhe i ujrave të gjithësisë - Haj(a).

Adhurimi i Haj(as) si zot lidhej me burimet e Tigrit dhe Eufratit, që e kishin zanafillën e tyre në Malësitë Armene, dhe nuk është rastësi, që ai paraqitej si krijuesi i këtyre burimeve.

Në vitin 301, kur Krishterimi u deklarua besim shtetëror brenda Armenisë, çdo besim tjetër i mëparshëm u ndalua ose ju përshtat botkuptimit Kristian. Sipas Biblës, në librin e parë mbi Gjenezën (lindjen e gjërave), të gjithë kombet e kanë prejardhjen nga tre bijtë e Noes: Japeti, Kami dhe Semi. Në këto kushte, legjenda Armene e periudhës së paraKrishterimit ju përshtat Librit të Shenjtë, Biblës. U krijua një legjendë e re, sipas së cilës Patriarku Hajk i përkiste grupit të pasardhësve të Japetit, djalit të Noes dhe ishte i biri i Patriarkut Torkom. (Torkomi sipas Biblës paraqitet si paraardhës i famshëm i Shtëpisë (Familjes) Torkom dhe një nga Patriarkët më të vjetër, që kanë kontribuar në formimin e shtetit Armen. Shtëpia e Torkomëve është zbuluar në zonën e pellgut të sipërm të lumit Eufrat dhe përmendet deri në shekujt 20 – 18 para Krishtit). Prej këtej rrjedhin edhe emrat e përmendur në burimet e shkruara të shekujve të Mesjetës, që i atribuohen kombit Armen si: "Pasardhësit e Japetit", "Pasardhësit e Torkomit", "Kombi i Torkomit".

Sipas legjendave, të përshtatura rishtas në Bibël në lidhje me gjenealogjinë Armene në kushtet e lindjes së Krishterimit, Armenët shfaqen si banorë vendas (autoktonë) në Malësitë Armene, që janë atdheu i tyre si edhe atdheu stërgjyshor i Armenëve të mbetur.

Në legjendën, që bën fjalë për lindjen e kombit Armen, pjesën më

të rëndësishme e përbën tregimi "Hajku dhe Beli", në të cilin është reflektuar konflikti i zgjatur shumëshekullor ndërmjet Mesopotamisë së Lashtë dhe Malësive Armene. Sipas legjendës, Kalendari Origjinal (Fillestar) Armen e ka fillesën në ditën kur Patriarku Hajk mundi gjigantin Bel. Sipas llogaritjeve të Kevond Alishanit kjo ka ndodhur në 11 Gusht të vitit 2492 para Krishtit (këtu duhet thënë që ka edhe llogaritje të tjera).

Sipas legjendës Armene, duke marrë shkas nga emri i Patriarkut Hajk, populli Armen u quajt "Haj" dhe vendi "Hajk" ose "Hajasdan", dhe më pas, nisur nga emri i njerit prej Patriarkëve pasardhës, Aramit, i shtuan edhe emrat "Armen" dhe "Armenia". Me emrin e Hajkut dhe të shumë Armenëve të tjerë u emërtuan edhe shumë vende brenda Malësive Armene (Aramajis – Armavir, Jerasti - lumi Jeras'h (ose Araks), Sharaji – krahina Shirak, Amasiaji – malet Masis dhe krahina Masiacit, Kehami – Deti Kehamjaj ose Keharkun'jac (Liqeni Sevan, sot) dhe krahina Keharkunik (Gegharkunik), Sisaki – krahina Sisakan (Sjunik), Bukuroshja Ara – krahina e Araratit, etj.

Për historinë e lindjes së kombit Armen janë marrë në konsideratë edhe burimet e vjetra të shkruajtura Greke, ato Ebreje të vjetra (Judish), Gjeorgjiane dhe Arabe, brenda të cilave Armenët gjithnjë janë paraqitur me tipare mjaft pozitive; të pasurit lidhje gjaku me ta është konsideruar nder dhe e dëshirueshme.

Të njëjtën konsideratë e gjejmë edhe brenda një sërë legjendash të shumë popujve Europianë, të cilët lindjen e kombit të tyre e gjejnë të lidhur me Armeninë.

Në "Kronikat Anglo – Saksone" të shkruara në shek. e 9^{të} pohohet që, në Ishujt Britanikë" banorët e parë kanë qenë Bretonët, të cilët kishin ardhur nga Armenia". Sipas "Kronika Bavareze", "Kënga e Anës", "Kënga e Rolandit" dhe burimeve të tjera të Mesjetës del që Bavarezët e kanë zanafillën e tyre në Armeni, në malin Ararat, atje ku Noe qëndroi me barkën e tij. Zanafillën e tyre e lidhin me Armeninë edhe Baskët. Shënime interesante, të ruajtura deri në ditët e sotme,

që kanë lidhje me Armeninë, ka edhe në përrallat ruse. Brenda tyre, më i famshmi, më i dashuri hero i Rusëve, Ilia Muromjeci, e merr fuqinë e tij nga vëllai i madh, Svjatogori (Svjatogor – në Rusisht do të përkthehej – Mali i Shenjtë), i cili banonte në "malet Ararat"….

HISTORIA E LINDJES SË KOMBIT ARMEN SIPAS HISTORIOGRAFISË MODERNE:

Duke filluar nga shek. i 5^{të} dhe deri në mesin e shek. të 19^{të}, në trajtimin e çështjes së zanafillës së kombit Armen, një efekt subjektiv të padyshimtë pati edhe legjenda me ndikim Kristianizues mbi këtë çështje, e cila gjeti pasqyrim në faqet e librit "Historia e Armenisë" e historianit Armen, Moisi Horenaci.

Në gjysmën e dytë të Shek. të 19^{të}, në shkencat muarrën hov disa teori të reja shkencore, ndërmjet të cilave edhe disa nga ato, të cilat vinin në pikëpyetje çështjen e autoktonisë së popullit Armen. Por pas disa dekadash u bë e qartë se këto teori ishin krejt pa baza.

Në fillim të viteve 1980 u konfirmua, që atdheu i stërlashtë i botës Indo-Europiane në mijëvjeçarin e 5^{të} – 4^{t} para Krishtit, ishte zbuluar në veri të Azisë Perëndimore, më saktësisht, në Malësitë Armene, në krahinat lindore të Azisë së Vogël, ndërmjet Mesopotamisë veriore dhe krahinave veri-perëndimore të zëna nga pllaja Iraniane. Kështu, atdheu i stërlashtë i Indo-Europianëve është gjetur pikërisht brenda asaj hapësire ku është formuar dhe nëpër të cilën ka kaluar historia e popullit Armen.

TË DHËNA TË VJETRA HISTORIKE MBI ARMENINË DHE POPULLIN ARMEN:

Për Malësitë Armene, të dhënat e para të njohura deri më tani, janë ato të ruajtura në mbishkrimet e përmendoreve (statujave) Shumere dhe që i përkasin shekujve 28 – 27 të kohës para Krishtit. Brenda tyre përmendet formimi i shtetit të hershëm Aratta. Emri

Aratta, në të vërtetë, është i ngjashëm me emrin Ararat, gjë që të bën ta mendosh këtë të fundit si pararendës të emrit Aratta.

Duke filluar nga shek. i 26^{të} para Krishtit shkrimet origjinale Mesopotamase përmendin (kujtojnë) zotin Haj(a), si edhe tokën dhe popullin me të njëjtin emër.

Është e ditur, që popujt e tjerë e njohin tokën dhe popullin Armen më tepër me emrat "Armenia" dhe "Armen". Duke filluar nga shekujt 24-23, brenda Malësive Armene fillojnë të shfaqen emrat "Arman(i)", "Armi", "Aram" si dhe emra të tjerë vendi, të cilët ishin pararendësit e emrit "Armenia".

Në shkrimet e vjetra mbi statujat e shekujve 24-23 para Krishtit të zbuluara në Ebla (qytet i lashtë në veri të Sirisë së sotme) përmenden "bijtë e "Hajaji-s" (fëmijët e Armenisë – Armenët) që banonin brenda tokave të quajtura Armi.

Kështu, në periudhën ndërmjet shekujve 28-23 para Krishtit, brenda Malësive Armene përmenden emrat që i atribuohen Armenisë dhe Armenëve, si Aratta, Haja dhe Arman(i), të cilët vazhdojnë të mbeten të gjallë deri në ditët e sotme në formën si: Ararat, Hajk-Hajasdan dhe Armenia.

Sot mund të thuhet me bindje të plotë, që Armenët janë pjesë e kombit mëmë IndoEuropian, dhe duhet të jenë ndarë prej saj (dalë si degëzim më vete) nga fundi i mijëvjeçarit të 4^{t} para Krishtit (sipas disa studimeve të kohëve të fundit mendohet që kjo ndarje të ketë ndodhur në gjysmën e dytë të mijëvjeçarit të 6^{të} para Krishtit). Rreth atyre kohëve, tributë Armene fillojnë të marrin formën e "etnisë" dhe të shfaqen format e para të organizimeve "shtetërore", dhe vetëm në gjysmën e parë të mijëvjeçarit të parë para Krishtit, Armenët shfaqen si një organizim shtetëror mbarëArmen i unifikuar. (Fq. 15 - 20)

Në legjendat dhe mitet e Lindjes së Lashtë janë ruajtur të dhëna shumë interesante për Armenët dhe vendbanimin e tyre.

Në Bibël thuhet që Zoti e krijoi njerëzimin brenda parajsës,

të quajtur Eden, nga ku buronin 4 lumenj: Eufrati, Tigri, Gehoni dhe Pisoni. Kjo nënkuptonte, që parajsa e quajtur Eden ishte vetë Armenia, toka ku ishin krijuar njerëzit e parë dhe ku ruheshin (fshiheshin) simbolet e Pavdeksisë dhe Diturisë: Genaci (simboli i Pavdeksisë) dhe Pemët e Diturisë – E Mira dhe E Keqja. (Fq. 21)

Brenda Librave të Shenjtë, Edeni përmendet si *"Ana Lindore",* gjë të cilës i duhet kushtuar vëmendje e veçantë. Po në atë libër, brenda një paragrafi tjetër tregohet që Arka e Noes ngeci mbi Malet Ararat (brenda Armenisë), nga ku më pas, njerëz që flisnin të njëjtën gjuhë, nga "pjesa lindore" shkuan në tokat Senaari (Shumer) dhe vendosën të ngrenë "Kullën e Babilonit", një kullë që të arrinte deri në qiell; në të dy rastet Armenia paraqitet si "*toka e Lindjes* (Lindore)", ndërsa sipas shkrimeve në Testamentin e Vjetër, thuhet, që ajo ndodhet në veri të tokave të Hebrenjve.

Tregime të tilla, tashmë janë prezente edhe në një sërë burimesh të tjera. Brenda legjendës Mesopotamase "Gilgameshi", kufijtë e parajsës dhe Tokës së Pavdeksisë janë malet Mashu, vendi ku lindte dhe perëndonte dielli. Kjo do të thotë, që Malësitë Armene, të ndodhura në veri të Mesopotamisë dhe Palestinës, nuk janë *"Lindje"* vetëm në kuptimin gjeografik të fjalës, por edhe në kuptimin *"Vendi ku lind dielli".* Me kalimin e kohës, ky kuptim fillestar u harrua, dhe kjo fjalë u përdor më tepër në kuptimin gjeografik të saj. (Fq. 24)

Armenia, brenda legjendës Armene, quhet *"Toka e mbretit të Lindjes",* një emërtim karakteristik ky, që mund të lindte dhe të ruhej vetëm dhe vetëm në kohët e lashta. (Fq. 25)

Shënim B.P.: Më poshtë flitet për besimin Armen paraKristian, ku në pika kryesore vihet në dukje:

Panteoni i Zotave i Vanit përfaqëson paraqitjen më të shkëlqyer të treshes; Haldin (babain e zotave, krijuesin e tokës dhe qiellit), Tejshebanin (zotin e luftës, trimërisë dhe shtërngatës) dhe Shivinin (zotin e Diellit, qendra kryesore e adhurimit të të cilit ishte Tushpa, kryeqyteti i Vanit). Adhuroheshin gjithashtu edhe zotat e

fushave, maleve, detrave, etj. Pas panteonit të mbretërisë së Vanit u shfaqën edhe forma të tjera panteonesh dhe, në prag të pranimit të Krishterimit, panteoni Armen shfaqet me një formë të re. (Fq. 78)

Në krye të panteonit përsëri është treshja superiore: Aramazdi, Anahiti dhe Vahagu. Babai i zotave Aramazdi adhurohej si krijuesi i tokës dhe qiellit, i mirësisë, bollëkut, trimërisë.

Nënës Perëndeshë Anahitit, së cilës i kishin mveshur titullin "Nëna e Artë", i atribuoheshin ndriçimi i tokës dhe ushqimi, të gjithë veprat mirëbërëse si edhe vigjiluese dhe mbrojtëse e kryeqytetit.

Vahagu (brenda vendit të shenjtë Nemrut: Artak) adhurohej si zoti i luftës, trimërisë dhe shtërngatës; sipas një të dhëne, ai para së gjithash nderohej si "Zoti i Diellit". (Fq. 79)

Ndër perënditë më kryesore dhe më të dashura ishte Astiku (աստղիկ – astik, në gjuhën Armene quhet Venusi), perëndesha e dritës qiellore, dashurisë dhe bukurisë, së cilës i kushtohet edhe festa e Vardavarit (sipas shkrimeve të hershme Kristiane, kjo festë lidhet me përmbytjen e madhe, kurse Astiku paraqitet si vajza e Noes). Ajo konsiderohet si gruaja e Vahagut, ose e dashura e tij, ... (Fq. 79)

... Nane - paraqitet si perëndesha mbrojtëse e mëmësisë dhe e familjes, e cila fillimisht kishte qenë edhe perëndeshë e luftës. (Fq. 79)

Areg-Mihra ishte zoti i diellit, dritës dhe drejtësisë. Sipas besimit Armen, në zemër të diellit jetonin 365 shenjtorë, secili prej të cilëve ruante drejtësinë mbi tokë një ditë në vit. (Fq. 79)

... Tiri ishte perëndia e të mësuarit (arsimimit), të cilit i ishte ngarkuar detyra e sekretarit të Aramazdit, zot i plotfuqishëm i shkrim-këndimit, i mjeshtërisë (zejeve) dhe i dijes, …. (Fq. 79)

Në periudhën e helenizimit, perëndive Armene ju vendosën korrespondenca me perënditë Greke (Aramzd - Zeusi, Anahit – Artemisi, Vahag – Heraklesi, Astik – Afrodita, Arek – Heliosi, Tir – Apolloni, etj). (Fq. 80)

MOISI DASKHURANCI OSE MOISI KAGHANKATVACI

HISTORIA E ALBANËVE TË KAUKAZIT

Përkthyer dhe përshtatur në Shqip nga Anglishtja: Berzh Piranjani

Botuar: albPAPER, Tiranë, 2019

KREU 1.
PARATHËNIE PËR LIBRIN HISTORIA E ALBANËVE

Njeriu i parë i krijuar nga Zoti, babai ynë Adam, jetoi 230 vjet dhe lindi Sethin. Sethi jetoi 205 vjet dhe lindi Enosin. Enosi jetoi 190 vjet dhe lindi Kainanin. Kainani jetoi 170 vjet dhe lindi Mahalaliilin (Maleleilin). Mahalaliili jetoi 165 vjet dhe lindi Xharedin. Xharedi jetoi 162 vjet dhe lindi Methjuselahun. Methjuselahu jetoi 167 vjet dhe lindi Lameçin (Lamekun). Lameçi jetoi 168 vjet dhe lindi Noan. Noa jetoi 500 vjet dhe lindi tre djem – Shemin (Semin), Hamin dhe Xhafetin (Jafetin). Dhe, 100 vjet pas lindjes së Shemit erdhi përmbytja, në vitin e gjashtëqindtë të Noas, dhe nga Adami tek përmbytja janë 2 242 vjet dhe dhjetë gjenerata.

KREU 2.
GJENEALOGJIA E XHAFETIT DHE PASARDHËSVE TË TIJ

Këtu do të gjeni informacion lidhur me kufijtë e pronës (së familjes) së Xhafetit dhe etnologjinë e tij, gjithçka sipas radhës së

vet. *(Etnologjia – shkenca që merret me studimin e karakteristikave të popujve të ndryshëm dhe dallimet dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre; Shënim BP).* Kufijtë e Xhafetit janë ato, të cilat Noa, duke insistuar që vëllezërit duhet të betoheshin se nuk do të luftonin dhe nuk do të zinin e përdornin si rob njeri tjetrin, ja dha si pjesën e tij të trashëgimisë, (respektivisht tokat) nga Media në Gadiron (Kadiz) në veri dhe poshtë deri në lumin Tigër, që ndante Median dhe Babiloninë. Djemtë e Xhafetit ishin: Gomer, nga i cili rrodhën Gamirkët (Cimmerianët); Magog, paraardhësi i Çetëve dhe Galatianëve; Madai, paraardhësi i Medëve; *Xhavan, paraardhësi i Grekëve;* Tubal, paraardhësi i Tetalk (Tetahk); Mesheç, paraardhësi i Lurikaçikëve; *Tiras, paraardhësi i Thrakëve;* Çitim, paraardhësi i Maqedonëve.

Fëmijët e Tirasit ishin: Ashkenazi, paraardhësi i Sarmantëve; Rifathi (Rifat), paraardhësi i Sauromatianëve; Togarmahu, paraardhësi i Armenëve.

Djemtë e Xhavanit ishin: Elishah, paraardhësi i Siçilianëve dhe Athinasve; Tarshishi, paraardhësi i Gjeogjianëve dhe Turanianëve; Kitris, paraardhësi i Romanëve, Latinëve dhe Rodianëve.

Gjithsej, 15 gjenerata (popuj).

Prej këtyre fëmijëve të Xhafetit, pasardhës të Kituraçikut (Kitrit), lëvizën dhe u shpërndanë nëpër ishujt paganë, siç ishin ato të Qipros, dhe prej atyre që mbetën në veri dhe që ishin të afërm (kushërinj) të Kituraçikut, dolën pasardhësit e Albanëve (Aluank). *Ndërsa raca që populloi tokën e Hellas rrjedh prej atyre që më pas migroi atje, siç ishin Ajetaçikët,* që u dyndën në Athinë, duke ardhur nga Grekët e nderuar (Yoynk - Hjunk). Dhe nga Teba emigruan Sidonianët, të cilët rridhnin nga Kadmosi, që ishte djali i Agenorit. Kartagjenasit janë imigrantë prej Tirit.

Në kohën e konfuzionit të gjuhëve të krijuar nga ekzistenca e këtyre 15 racave të prejardhura nga Xhafeti, hapësira në të cilën këto shtriheshin fillonte nga Media deri në Hesperia, që

shtrihej deri në Oceanus dhe takonte veriun. Territoret në të cilat ata banonin ishin: Atrpatakan, Albania, Amazonia, Armenia e Madhe dhe e Vogël, Kappadokia, Galatia, Kolçis, India, Bosforia, Makotis, Deris, Sarmatia, Tyrini, Skithia, Maqedonia, Dalmacija, Malkh, Thesalia, Lokris, Beotia, Hetalia (Hetaghia), Attika, Akea, Telenim (Teghenim, Pelenis, Peghenis, Poliponesios), Akarnia, Hupiristim (Hipirotis), Ghiuria *(Iliria)*, Liknitis, *Adriakë (prej nga vjen emri Deti Adriatik),* Galia (Gaul), Spanogalia, Iberia, Hispania e Madhe. Prej këtu e deri në Ishujt Britanikë shtrihen kufijtë e (familjes së) Xhafetit, që tashmë shohin drejt veriut (tentojnë të shtrihen drejt veriut).

KREU 3.
KOMBET QË KANË PASË NJOHUR ARTIN E TË SHKRUARIT

Ndër kombet që kanë pasë njohur artin e të shkruarit kanë qenë Hebrenjtë, Latinët, prej të cilëve Romanët kanë pasë qenë qeverisur, Spaniardët *(banorët e Spanjës: Shënim BP),* Grekët, Medët, Armenët, Albanët. Nga Media, në drejtim të veriut deri në kufijtë e Gadironit (Kadiz), duke u shtrirë nga lumi Pargamitos deri tek ai Mastosis, *ky vend që quhet Ilion;* dhe në Ishujt e Siçilisë, Eubesë, Rodesë, Kios, Zakinthis, Kefalonia, Itaka, Kerkira (Korfu), Kisadës (Kisadis), dhe pjesa e Azisë e quajtur Ionia; dhe lumi Tigri që rrjedh ndërmjet Medias dhe Babilonisë. Këta janë kufijtë e (familjes së) Xhafetit. Shemi mori pjesën lindore të botës, Hami mori jugun, ndërsa Xhafeti mori pjesën perëndimore dhe veriore, pjesën ku ishin vendosur Albanët, Deti Kaspik dhe malet më të lartë, që gjendeshin në botën lindore; dhe në perëndim këta popuj shtriheshin deri në Trapon (Trapezus, Trapezunda) (Fq. 15 - 17)

Shënim B.P.: Shkurtimisht, elementë të veçantë të shkëputur po nga ky libër, që mund të paraqesin interes:

1. ... Të dhëna mbi mënyrën se si Zoti u shfaq tek *ne lindorët*.....Fq. 12
2. …për *ne lindorët*.....Fq. 12
3. ...i konvertimit të mbarë *ne lindorëve*.....Fq. 13
4. ...diversiteti i *popujve të Lindjes*.....Fq. 14
5. ... ushtria e *Arianëve*.....Fq. 17
6. … Khazarët kanë vendosur zemrën e tyre për të trashëguar lavditë e vendit të *Arianëve*.....Fq. 110
7. ... kur lajmi i tmerrshëm ... u përhap në të gjithë *vendin tonë lindor*.....Fq. 144
8. ... atë të guvernatorit (sahmanakal) të *rajoneve lindore* dhe sundimtar të të gjithë mbretërisë së Albanisë dhe provincës së Uti.....Fq. 149
9. Megjithatë, ata nuk e shkatërruan pallatin e *patriarkut të lindjes,* i cili ende qëndron atje .....Fq. 201
10. ... Në ditët e tij Mesrobi i bekuar shpiku *alfabetin Alban,* ai që shpiku edhe atë të Armenëve dhe Gjeorgjianëve..... Fq. 215

Shënim B.P.: Të shihet si e thekson binomin “ne Lindorët”

GAREGIN D. NALBANDIAN

LEGJENDA E HAJKUT DHE BEL NIMRODIT

Përktheu nga botimi në gjuhën Angleze: Berzh Piranjani, Kevin Piranjani

Shtëpia Botuese "albPaper", Tiranë, 2020

Çoroditja me germat dhe gramatikën Hurro-Urartiane vazhdon akoma edhe sot në dialektin Perëndimor të gjuhës Armene, sepse ajo nuk pësoi aq shumë ndryshime sa ç'pati fatin të pësojë dialekti Armeno Lindor. (Fq. 26)

Bretonët kanë pohuar se paraardhësit e tyre kanë ardhur nga Armenia. (Fq. 27)

Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit na siguron prova që shkrirja e hekurit ka filluar që në Epokën e Bronzit. (Fq. 39)

Tirasi i quajti njerëzit e tij Tirasianë ose Tirakians (Thrakians) sipas emrit të tij, dhe sipas Ksenofonit të Kolofonit, Thrakët ishin "të zbehtë dhe flokë-kuq", që nënkupton njerëz me flokë të kuq ose bjondë dhe me ngjyrë të lëkurës të bardhë apo të hapur, gjë që përkon me përshkrimin, që i është bërë Gomerit dhe pasardhësve të tij prej shumë historianëve. (Fq. 43)

Tirasi ishte babai i Askanazit, Rifatit, dhe Torgomit (Togarmahut) dhe duke qenë se Hajku ishte një nga shumë nipërit e Tirasit, Armenët mund të konsiderohen një popull Thrak. (Fq. 44)

..., Thrakinë dhe pjesë të tjera të Gadishullit Ballkanik, Etrurinë ose Tirenin (Etruria gjithashtu u quajt Tirenia prej Tirenit, një pasardhës i Tirasit) e cila ndodhej në tokat veriore të Gadishullit Italian, (Fq. 45)

Robert Ellis ka pohuar se Thrakët në origjinë të tyre kanë banuar në Armeni, ndërmjet Detit Kaspik dhe Liqenit Urmia, në jug të Lumit Araks ose Araz (Fq. 46)

Hajku ishte paraardhësi i popullit Armen, Hurro-Urartian dhe popujve të tjerë Arianë. (Fq. 46)

Askanazi ka qenë paraardhësi i popullit Skandinav. (Fq. 47)

Kjo ndodh për arsye se Maqedonasit dhe Frigët ishin popuj Thrakë, ... (Fq. 48)

..., kjo ndodh për arsye se si Trojanët ashtu edhe Paflagonët ishin popuj Thrakë. (Fq. 48)

Populli Çeçen, të cilët e quajnë veten Nokçi, pretendojnë se janë njerëz të Noes, dhe mund të jenë degë e popullit Nairi. Ata pretendojnë se janë pasardhës të populli Matian (Mitan), të cilët jetonin në Mbretërinë Armene Hurro-Mitane (Fq. 48)

Nimrodi e përshtati Flamurin e Titanëve për Babiloninë dhe luani u bë simboli i Perandorisë Babilonase) dhe ai luan ishte i drejtuar në të djathtë, ose drejt lindjes. (Fq. 52)

Libri i Ngjarjeve (Ngjarja tridhjetë e dy) pohon se Nebrodi ose Nimrodi ishte babai i Azuradit, dhe Azurati më vonë u bë nëna e Pelegut. Pelegu ishte një paraardhëse e Abrahamit; kështu rezulton që, Nimrodi ishte paraardhës i Abrahamit. (Fq. 54)

Sipas Sir Henry Rawlinson, Kush ishte i pari Belus dhe i pari mbret i Babilonisë dhe Nimrodi ishte Belusi i dytë. (Fq. 61)

Sipas Xhuanshirit, Hajku dhe vëllezërit e tij ishin të njohur si vëllezërit Torgomianë. Në kohën e tyre ata flisnin të njëjtën gjuhë, dhe kjo ishte Armenishtja e Vjetër (Nairi ose Noi-ri) ose një dialekt

i gjuhës Thrake. Ajo ishte gjuha amtare e vendit, ku ishin vendosur Noe dhe pasardhësit e tij. (Fq. 66)

Vëllezërit Torgomianë ishin të gjatë dhe kockëmëdhenj; pra, ata përfaqësonin pasardhësit e tjerë të Xhafet Oste. Ata ishin luftëtarë të fortë dhe të aftë. Ata kishin lëkurë të bukur në ngjyrë të hapur dhe flokë po në ngjyrë të hapur (bjondë) siç i kishin edhe pasardhësit e tjerë të Gomerit. (Fq. 66 - 67)

Emri Izrael i është dhënë vendit, që është njohur si Izrael në kohën e Abrahamit, i cili ka jetuar disa gjenerata më pas. (Fq. 67)

Në periudhat e luftës Torgomi dhe pasardhësit e tij qëndruan përkrah Thrakëve dhe pasardhësve të tjerë të Xhapetit. (Fq. 67)

Hajku ishte i gjatë, trim dhe i fortë, me sy ngjyrë blu, flokë të verdhë dhe lëkurë në ngjyrë të hapur të shndritshme. (Fq. 68)

Në realitet, kur Nimrodi dërgoi ftesa për njerëzit që të merrnin pjesë në ndërtimin e Kullës së Madhe, njerëzit nga vendet pranë Babilonisë arritën të parët. Më vonë, me kalimin e muajve dhe viteve, filluan të vijnë gjithnjë e më tepër njerëz; tashmë ata vinin nga Skithia, Kina, Baktria, Lumi Indus, Afrika, Tirrenia dhe vendet Bretone (Fq. 71)

Kishte një pengesë gjuhësore. Shumë njerëz ishin të paaftë të komunikonin dhe të merreshin vesh me njeri tjetrin, sepse flisnin gjuhë të ndryshme (Fq. 71)

Pasi Nimrodi shpalli vendimin për ndalimin e punimeve tek Kulla e Babelit, njerëzit që kishin punuar për ndërtimin e saj u ndjenë të zhgënjyer dhe dëshironin të ktheheshin në vendet e tyre dhe të bashkoheshin me familjet e tyre. (Fq. 73)

Nimrodi bëri gjithçka, me qëllim që t'i mbante të zënë me punë vartësit e tij, me qëllim që atyre mos t'u shkonte mendja për lirinë. Ai, gjithashtu, u përpoq të krijonte një qytetërim Babilonas, duke detyruar shtetasit e tij të merrnin gra të racave të ndryshme dhe nga grupe të ndryshme etnike. (Fq. 75)

Natën, kur të gjithë ishin në gjumë, Hajku dhe familja e tij e përdorën errësirën e natës dhe u larguan nga Qyteti i Babilonit me ndihmën e treqind burrave trima, të cilët i shërbenin Hajkut. (Fq. 76)

Kaspiani ishte vendosur pranë Detit të Lindjes (Detit Kaspik). (Fq. 78)

Torgomianët ishin të famshëm në mbarështimin e kuajve. (Fq. 79)

Pak pasi kishte pushtuar tokat e pasardhësve të Tubalit, Nimrodi u dha atyre rastin që të dorëzoheshin; sidoqoftë, ata vendosën të hipin nëpër anije dhe të ikin larg prej andej, në vende përtej detit. Gauli dhe pasardhësit e tij, gjithashtu, ja lanë tokat e tyre Nimrodit, pasi kishin humbur disa beteja, dhe edhe ata lundruan larg drejt perëndimit, dhe ata që nuk mundën të hipnin nëpër anije, u përpoqën të shpëtojnë duke gjetur strehim në tokat e Thrakasve (Azia e Vogël) dhe u njohën si Galatianë apo Keltë. (Fq. 83 - 84)

Beli vinte si konditë, që t'i lejonte të jetonin dhe të punonin në mbretërinë e Nimrodit, me kusht që, Hajku dhe pasardhësit e Torgomit të pranonin të adhuronin Zotat e Babilonit dhe të flisnin gjuhën e popullit të Babilonit (gjuhën Kushite). ... N.q.s Hajku dhe vëllezërit e tij do t'i plotësonin vetëm pjesërisht këto kërkesa, atëhere ata do të ishin të detyruar të braktisnin tokat e tyre dhe të gjenin strehim në toka të largëta, përtej detit ashtu siç kishin bërë edhe frikacakët e tjerë. (Fq. 85)

Farkëtarët në Azinë e Vogël dhe Lindjen e Mesme e shkrinin hekurin për të bërë zbukurime, tenxhere dhe tiganë që 2500 vjet B.C. (Fq. 87)

Papritur, Hajku ishte kthyer në atë, që Mbreti Maniton kishte parashikuar se do të shkatërronte mbretin më të fuqishëm, që bota kishte parë ndonjëherë, një zot për së gjalli, të cilit të gjithë i frikësoheshin dhe të cilin të gjithë e njihnin si Ba'al ose Bel, që do të thoshte Perëndi ose Zot. (Fq. 103)

Për shembull, Paflagonët u bashkuan me Trojanët kundër Grekëve. (Fq. 113)

Legjenda thotë se, pasi morën lajmin që Hajku e kishte mposhtur Belin dhe ushtritë e Nimrodit u zotuan për besnikërinë e tyre ndaj Hajkut, vëllezërit e Nimrodit, pasardhës të tjerë dhe të afërm të Kushit, si edhe ndjekës të tyre, i braktisën tokat e tyre. Disa prej tyre u kthyen në Afrikë, prej nga kishin ardhur, të tjerë shkuan drejt lindjes në kërkim të tokave të reja për t'u strehuar (Fq. 123)

Hajku vdiq në vitin 2446 përpara lindjes së Jezu Krishtit. Legjenda thotë, që përpara vdekjes, Hajku ja la mbretërinë dhe popullin e tij djalit të tij, Aramaneakut (Aramaneak – gjithashtu është i njohur si Armen ose Armenak në historinë Armene, dhe ai konsiderohet si themeluesi i kombit Armen, që mundi t'i mbajë të grupuar tributë Armene si një komb i vetëm) (Fq. 126)

Arritja më e madhe ishte fakti, që Hajku dhe aleatët e tij arritën të bashkojnë të gjithë folësit e së njëjtës gjuhë, të cilët tanimë quheshin Armenë. (Fq. 127)

Hajku u bë i riu Bel

Dhe u çvendos për në Babel. (Fq. 132)

Sveonët ose Svionët ishin një degëzim i Soanëve ose Svenit, dhe ata janë të njohur për themelimin e Mbretërisë së Suedisë në Skandinavi. (Fq. 134)

...; sidoqoftë Araza ishte nënë e dy figurave mashkullore, të quajtur Skita dhe Breton, prej nga rrodhën Skithët dhe Bretonët (Fq. 137)

Ka shumë fjalë të përbashkëta në gjuhën Armene dhe atë Uellsiane, gjë që provon, se Uellsianët e lashtë ose Cimmerianët dhe Armenët e lashtë kanë qenë i njëjti popull ose popuj shumë të afërt. (Fq. 139-140)

... dhe duke qenë se Hajku ishte njëri prej shumë nipave të Tirasit, Armenët mund të konsiderohen edhe si popull Thrakas. (Fq. 140)

Thrakët e Dor-ëve në Kanaan u bënë Dorianët në Gadishullin Ballkanik. (Fq. 140)

Tokat e popullit Thrak, duke u shtrirë shumë nga veriu, arritën deri në Skandinavi, e cila u emërtua sipas Askanazit ose Askanusit, vëllait të Torgomit ose Rifatit. (Fq. 140)

Korintasit (Korinthasit janë populli i përmendur në Bibël) janë pasardhës të Khorit (Fq. 144)

Hajku kurorëzoi nipin e tij, Kadmosin, si mbret të Fenikias, pasi që nga momenti që Feneçi kishte vdekur në mënyrë të mistershme, tokat i kishin kaluar në administrim Nimrodit, dhe pas vrasjes së këtij të fundit nga Hajku, Fenikasit kishin nevojë për një mbret të ri; kështu Kadmosi u bë mbreti Fenikasve në momentin që Hajku u bë mbret i mbretërisë së Nimrodit. (Fq. 145)

Bazi, djali i Manavazit dhe nipi i Hajkut, ishte babai i fisnikëve Bznuni dhe Basean, të cilët jetuan në perëndim të Liqenit Van, dhe prej tij rrodhi edhe populli Bask. (Fq. 145-146)

Frig (Phryg) ose Vrig, djali i Manavazit dhe nipi i Hajkut, nxorri në dritë popullin Frigian. Frigu ndërtoi Frigian si vendqëndrim të tij. (Fq. 146)

Aleksandri i mori Iberianët, popullin që banonte në Gadishullin Iberik, dhe i vendosi ata në tokat e Kartlisë (Fq. 147)

Gegh ose Gel, djali i Amasias, dhe gruaja e tij, Gegham (Gegham ose Gegh-Am nënkupton "Gruaja e Geghut"; Urartianët e lashtë përdornin L në vend të Gh, U në vend të O, etj.) patën si trashëgimtarë dy fëmijë: Sisak dhe Arma (Fq. 147)

Anushavan në gjuhën Armene ose Aluavan në gjuhët Hurro-Urartiane ishte djali i Aranit. Nga Arani dhe Aluavani rrjedhin fisnikët e Arranit dhe vendi mori emrin Aluank ose Alvank, që njihet gjithashtu si Albania, një mbretëri në veri të Arranit. Kjo sipërfaqe ishte pjesë e Armenisë deri sa u pushtua prej Persianëve, dhe mori emrin Arran-Albania, dhe populli i Alvankut mori emrin populli Alban. (Fq. 148)

Shekuj më vonë, Armenia dhe Albania u pushtuan prej Romakëve, dhe shumë Armenë dhe Albanë u lëvizën në drejtim të

Gadishullit Ballkanik dhe pjesëve të tjera të Europës prej Romakëve dhe Greko-Bizantinëve. (Fq. 149)

Bardosi themeloi një qytet në perëndim të bregut të Lumit Kur dhe e quajti atë Barda. (Fq. 151)

Gegh ose Gel, një pasardhës i Movkanit, u martua me Geghamin ose Gelamin, një pasardhëse e Hajkut. Gegham do të thotë gruaja e Geghut ose Znj. Gegh. Geghard dhe Gegharkunik në Armeni dhe Geghajk ose Gelam në Persi i morën emrat nga Geghu. Geghajk ose Gelam ishin toka midis Maleve Talish dhe Detit Kaspik në Persi. Gel dhe Gelam ishin paraardhës të popullit Gelian në Arran-Albania. (Fq. 152)

Heran dhe pasardhësit e tij i zgjeruan tokat e tyre në drejtim të lindjes së maleve Alborz dhe themeluan Ti-Hiran ose Teheran. (Fq. 154)

Gjatë luftës së Trojës, Paflagonët, Gargareanët dhe Amazonët, si edhe Armenët dhe Frigët, Thrakasit dhe Palasgianët, si edhe Arianë të tjerë luftuan përkrah Trojanëve kundër Grekëve Akeanë (Akej), Spartanëve dhe Grekëve të tjerë. (Fq. 155)

Ilirët identifikohen si pasardhës të Mesheçit në një kronikë të shkruajtur nga Hipoliti (Hippolytus) i Romës. (Fq. 156)

Ar ishte Dielli-Zot për Arianët. (Fq. 159)

Etruria ka qenë quajtur, gjithashtu, Tirrhenia sipas Tirrhenusit, që ishte një pasardhës i Tirasit. (Fq. 162)

Libri i Ngjarjeve (Ngjarja e tridhjetë e dytë) deklaron se Nebrodi ose Nimrodi ishte babai i Azuradit, dhe Azuradi më pas u bë mamaja e Pelegut. Pelegu ishte një paraardhës i Abrahamit; … (Fq. 168)

Feneç (Phennech) ka qenë njohur gjithashtu si Fineus nga Grekët dhe Romakët; Feneçi ishte paraardhësi i Fenikasve dhe qyteti i banimit të tij ishte Tiri. (Fq. 169)

Tyrrhenia (Tyrrhenia ka qenë quajtur, gjithashtu, edhe Etruria) e ka marrë emrin nga Tyrrhenus, një pasardhës i Tirasit. (Fq. 171)

KAPITULLI 3

INDO-EUROPA DHE HISTORI TË LASHTA

(Nxjerrë nga WIKIPEDIA)

PËRMBAJTJA

1. Historia e Arkës së Noes 291
2. Dyluftimi Hajk-Bel 299
3. Hittitët 305
4. Urartu 307
5. Frigët 309
6. Aleksandri i Madh 311
7. Shën Bartolomeu 315
7. Albania e Kaukazit 317

HISTORIA E ARKËS SË NOES


MATERIALI 1

Mitologjia krahasuese: Origjina Babilonase e Arkës së Noas

Artikulli kryesor: Miti i përmbytjeve

Për më shumë se një shekull studiuesit kanë pranuar se historia e Biblës mbi Arkën e Noes është e bazuar në modelet e vjetra Mesopotame. Për shkak se të gjitha këto histori, që kanë lidhje me përmbytjen e madhe, janë të lidhura me ngjarje, që pretendohet se kanë ndodhur në fillimet e historisë, ato të japin përshtypjen se vetë mitet duhet të vijnë nga origjina shumë primitive. Por në fakt, miti i përmbytjes globale, që shkatërron të gjithë jetën, fillon të shfaqet vetëm në *periudhën e Vjetër Babilonase* (në shekujt 20-16 para erës sonë). Arsyeja për shfaqjen e këtij miti, që ka lidhje me përmbytjet tipike Mesopotame, mund të ketë lidhje të ngushtë me rrethanat e veçanta të krijuara në periudhën e fundit të *Dinastisë së Tretë të Urit* rreth vitit 2004 para erës sonë dhe rivendosjes së rendit nga *Dinastia e Parë e Isin-it.*

Dinastia e Tretë e Urit, e njohur edhe si Perandoria Neo-Sumeriane, i referohet shekullit 22-21 para erës sonë (periudha afërsisht 2112 - 2004 para erës sonë sipas metodikës matëse të kohës të quajtur "Kronologji e Mesme") të dinastisë sunduese Sumere të vendosur në



Harta 1

qytetin e Urit. Dinastia e Tretë e Urit shkurtimisht shkruhet *Ur III* nga historianët që studiojnë periudhën në fjalë. Dinastia e Tretë e Urit ishte dinastia e fundit dhe më e fuqishme Sumere, e cila kishte ardhur ndonjëherë në pushtet në zonën e Mesopotamisë.

Dinastia Isin qëndroi në pushtet në periudhën afërsisht 1953 – 1730 para erës sonë dhe ishte vendosur në qytetin Isin, që ndodhej rreth 32 km. në jug të qytetit Nippur *.

* (*Shënim:* Nippur ishte ndër qytetet më të lashta të Sumeriane. Ishte vendi i posaçëm i adhurimit të perëndisë sumeriane Enlil, "Zot i Erës", sundimtar i kozmosit, që i nënshtrohej vetëm Anit. Nippur ishte vendosur në vendin ku ndodhet sot qyteti modern Nuffar në Afak, Guvernatoriati i Al-Qādisiyyah, Irak. Shih Harta1)

Janë nëntë versione të njohura të historisë së përmbytjes Mesopotame; secili pak a shumë i përshtatur nga një version më i hershëm. Në versionin më të vjetër, heroi është *Mbreti Ziusudra,* dhe ky version është shkruar rreth viteve 1600 para erës sonë në qytetin Sumerian të *Nippur-it.* Kjo është e njohur si historia e përmbytjes Sumeriane, dhe ndoshta rrjedh nga një version më i hershëm. Versioni i Ziusudra-s tregon se si ai ndërton një varkë dhe shpëton jetën në tokë në një kohë kur perënditë kishin vendosur ta shkatërrojnë atë. Kjo mbetet edhe intriga themelore për disa histori përmbytjesh dhe heronjsh që pasuan më vonë, përfshirë edhe historinë e Noes. Në versionin Sumerian, emri Ziusudra do të thotë -"Ai i jetës së gjatë, ose, ai që jetoi gjatë". Në versionet Babilonase, emri i tij është *Atrahasis,* por kuptimi është i njëjtë. Në versionin e Atrahasis, përmbytja është një përmbytje lumi (përmbytje që ka ardhur si rezultat i vërshimit të lumit).

Ndoshta versioni më i famshëm është ai, që gjendet në një punim më të gjatë të quajtur *Eposi i Gilgameshit,* tashmë i njohur vetëm nga një kopje *Asiriane* e mijëvjeçarit të parë, në të cilën heroi i përmbytjes është quajtur *Utnapishtim* ("He-found-life" – "Ai krijoi jetën" – "Ai gjeti jetën"). (Gilgameshi është heroi i komplet epopesë dhe jo vetëm heroi i historisë së përmbytjes).

Versioni më i fundit i njohur i historisë së përmbytjes Mesopotame është ai i shkruar në gjuhën Greke në shekullin e 3të para erës sonë prej një prifti Babilonas të quajtur *Berossus.* Nga fragmentet, që kanë mbijetuar prej kësaj historie, ky version duket pak ndryshe nga versionet e rreth dy mijë viteve më parë.

Versioni më i afërt me tregimin Biblik të Noes, dhe me shumë gjasa burimi kryesor për këtë, është ai i Utnapishtimit në Eposin e Gilgameshit. Teksti më i plotë i historisë së Utnapishtimit është një pllakë argjile, që daton nga shekulli i 7të para erës sonë, fragmente të së cilës janë zbuluar jo më parë se në shekullin e 19të.

Duke studjuar paralelisht të dy historitë, vihet re se ngjashmëritë

dhe dallimet ndërmjet tyre, asaj të Arkës së Noes dhe varkës së heroit të përmbytjes babilonase *Atrahasis,* janë të shpeshta.

Arka e Noes është *drejtkëndore,* ndërsa Atrahasis ishte udhëzuar për të ndërtuar të tijën në formën e një *kubi;* Arka e Atrahasis ka shtatë kuverta me nëntë ndarje në çdo nivel, ndërsa e Noes ka tre kuverta, por atij nuk i është dhënë asnjë udhëzim për numrin e ndarjeve që duhen ndërtuar. Fjala e përdorur për "katran" (diçka si zift ose rrëshirë) nuk është fjalë normale hebraike, por është e lidhur ngushtë me fjalën e përdorur në tregimet Babilonase.

Shkaqet, që Perëndia / Perënditë kanë dërguar përmbytjen, gjithashtu paraqiten ndryshe: në rrëfimet Hebraike përmbytja vjen si rezultat i gjykimit të tyre mbi shoqërinë njerëzore si një shoqëri njerëzore e ligë; në *Eposin e Gilgameshit* Babilonas arsyet nuk janë dhënë dhe përmbytja duket të jetë rezultat i kapriçove të perëndive, ndërsa në versionin e *Atrahasis* të tregimit të përmbytjes Babilonase, përmbytja ishte dërguar nga perënditë për të zvogëluar mbipopullimin njerëzor dhe pas përmbytjes u ndërmorën masa të tjera për të parandaluar përsëritjen e problemit.

MATERIALI 2

Gjeneza (zanafilla) e tregimeve të përmbytjes.

Nga Wikipedia, Enciklopedia e Lirë.

Teksti Masoretik i Torahut e vendos Përmbytjen e Madhe 1.656 vjet pas *Krijimit,* ose 1656 *AM (Anno Mundi* - "Viti i krijimit të Botës"). Shumë përpjekje janë bërë për të vendosur këtë interval kohor si një datë të caktuar në histori. Në fillim të shekullit të 17, Joseph Scaliger e vendosi *Krijimin* në vitin 3950 para erës sonë, Petavius llogariti 3982 para erës sonë, dhe sipas *Ussher kronologji të James Ussher, Krijimi* zuri vend në vitin 4004 para erës sonë, gjë që e daton Përmbytjen e Madhe në vitin 2348 para erës sonë.

Shënim: Termi *"Torah"* nënkupton "Instruksion" (ose "Mësime" apo "Udhëzime") dhe ofron një mënyrë jetese për ata që e ndjekin atë.

MATERIALI 3

Tregime sipas Biblës

A. Shfaqja e parë e Noes në Bibël ndodhet në Librin e Gjenezës (Book of Genesis)

Noe ishte i dhjeti nga Patriarkët e periudhës para përmbytjes. Babai i tij ishte *Lameku* dhe nëna e tij është e panjohur, por mendohet të jetë ose *Ada* apo *Zilah,* që ishin gratë e *Lamekut.* Kur Noa ishte në moshën pesëqind vjeçare, ai lindi *Shemin, Hamin* dhe *Jafetin. (Zanafilla 5:32)*

(*Shënim:* Në versionin anglisht këta emra janë shkruajtur – *Shem, Ham and Japheth*)

B. Pas përmbytjes

Artikulli kryesor: Marrëveshja Biblike e Noes me Zotin

Mbas përmbytjes, Noe i propozoi një ofertë shteruese (që nuk pranon diskutime të mëtejshme) Zotit, i cili i tha: "Unë nuk do ta mallkoj më tokën për shkak të njeriut, duke pranuar që djalli ndodhet në zemrën e njeriut që në fëmijërinë e tij dhe nuk do të godas më çdo gjë të gjallë, siç kam bërë." *(8: 20-21)*

"Pastaj Perëndia bekoi Noen dhe djemtë e tij, dhe u tha atyre: Qofshi frytëdhënës, shumëfishohuni dhe mbusheni tokën." *(9: 1)*

Noe vdiq 350 vjet pas përmbytjes, në moshën 950 vjeçare, i fundit ndër Patriarkët tepër jetëgjatë të periudhës para përmbytjes. Pas kësaj jetëgjatësia maksimale e njeriut, siç përshkruhet nga Bibla, zvogëlohet me shpejtësi nga afërsisht 1000 vjet në 120 vjet të Moisiut. *(Zanafilla 6: 3; Ligji i Përtërirë 31:22; 34:37)*

(Judaizmi Rabbinik llogariti një jetëgjatësi të Moisiut që korrespondonte me 1391–1271 p.e.s.; Jerome jep 1592 p.e.s., dhe James Ussher 1571 p.e.s., si vit i lindjes së tij).

Djemtë e Noes: Shemi, Hami dhe Jafeti

Historia e përmbytjes *(Flood Story)* tregon se si Noe dhe tre djemtë e tij, së bashku me gratë e tyre, shpëtuan nga përmbytja për të ripopulluar më pas tokën.

Kjo histori i paraprin historisë së *Kullës së Babelit,* e cila thotë se e gjithë popullsia ishte në një vend para se ajo të shpërndahej.

Zanafilla 10 përcakton pasardhësit e Semit, Kamit dhe Jafetit, nga e cila kombet zgjerohen mbi tokë pas përmbytjes.



Harta 2. Shpërndarja e pasardhësve të Shemit, Hamit dhe Jafetit
(hartë e nxjerrë nga Libri i Historisë i vitit 1854 dhe Atlasi i Gjeografisë Biblike)



Harta 3 "Harta T dhe O"

Kjo hartë e quajtur *"Harta T* dhe *O"*, e nxjerrë nga versioni i parë i shtypur i librit "Etimologjia" e Isidorit (Isidori - Arkbishop i Seviljes në |Spanjë, që jetoi në vitet 560 – 636 të erës sonë), i paraqet të tre kontinentet e njohur deri më atëhere (bëhet fjalë për vitet kur jetoi Isidori) të populluar nga pasardhësit e Noes ashtu siç është shënuar në hartë:

Azia nga *Shemi* *Afrika* nga *Hami* *Europa* nga *Jafeti*

DYLUFTIMI HAJK-BEL

Hajku i Madh (Armenisht shkruhet: *Հայկ;* lexohet: *Hajk* ose *Hajg),* i njohur gjithashtu si Patriarku Hajk (Armenisht shkruhet: Հայկ Նահապետ, lexohet: Hajk Nahapet), është patriarku legjendar dhe themeluesi i kombit Armen. Historia e tij tregohet në Historinë e Armenisë, që i atribuohet historianit Armen Moisiu i Korene[1] (ose Movses Khorenatsi, viti 410 - 490).

(*Shënim B.P.:* transkriptuar në Shqip do e përdorim Moisi Korenaci).

Etimologjia

Emri i patriarkut Hajk, nuk është saktësisht homofon[2] me emrin "Armenia". Hajk është shumësi i rasës emërore në Armenishten klasike i emrit Haj, që është termi Armen për fjalën "Armen". Disa pohojnë se etimologjia e Hajk nga *(Հայկ)* është e pamundur dhe se origjina e termit Haj ("Armen") është e verifikueshme. Sidoqoftë, Hajk dhe Hajg janë zakonisht të lidhura me fjalën *(հայ)* dhe *(հայէր),* shumësi i rasës emërore në Armenishten moderne i emrit Haj, vetë-përcaktimi i Armenëve (ajo se si e quajnë Armenët veten e tyre). Armen Petrosian beson se emri Hajk mund të rrjedhë, "me shumë mundësi", nga fjala Indo-Europiane "poti" – zot, zot shtëpie, burrë shtëpie.

[2] Shënim: Homofon - përdoret për një fjalë që shqiptohet njësoj si një fjalë tjetër, por ndryshon në kuptim. Një homofon gjithashtu mund të ndryshojë në drejtshkrim.

Hajk atëherë do të ishte një figurë themeluese etiologjike[3], si p.sh. Asshur për asirianët, etj. Një nga pasardhësit më të famshme të Hajkut, Arami, u vendos në Armeninë Lindore nga mbretëria Mitanni (Armenia Perëndimore), kur Sargoni II përmend një mbret të një pjese të Armenisë, që krijoi emrin (Armeno-Indo-Iranian) Bagatadi (ashtu si emri me bazë nga Greqishtja "Theodore" dhe ai nga Hebraishtja "Jonathan", do të thotë "i dhënë nga Zoti"). Disa burime pohojnë se Hajk rrjedh nga hyjnia Urartiane *Haldi.*

Historiografia Armene e epokës Sovjetike e lidhte Hajkun me Hajasa, të përmendur në mbishkrimet Hittite.

Fjala Armene Hajkakan ose Hajgagan (që do të thotë "ajo që i përket Armenëve") gjen rrënjën e saj në këtë pasardhës. Për më tepër, emrat poetikë për Armenët, Hajkazun *(հայկազուն)* ose Hajkazn *(հայկազն),* gjithashtu rrjedhin nga Hajk

Gjenealogjia

Moisi Korenaci e përshkruan gjenealogjinë e Hajkut sipas kësaj renditjeje: Xhafet (Japhet), Gomer dhe Tiras, Torgom. Si pasardhës të Hajkut janë dhënë: Amasia, Ara, Aram, Aramais, Armanak, *Gegham* dhe Harma. Thuhet gjithashtu se Hajku ishte themeluesi i Dinastisë Hajkazuni.

Sipas Xhuansherit, Hajku "ishte princi i shtatë vëllezërve dhe qëndroi në shërbim të gjigantit Nimrod, i cili sundoi për herë të parë të gjithë botën si mbret".

Sipas Moisi Korenacit, familja fisnike Armene, Haykazuni, e cila përfshinte një numër mbretërish legjendarë (si Aram, Ara, Skajordi, Parjur dhe Vahe), rridhte nga Hajku.

[3] Shënim: Etiologjia – merret me hetimin ose atribuimin e shkakut ose arsyes së diçkaje, e shprehur shpesh nëpërmjet shpjegimit të kuptimit historik ose mitik.

Folklori

Sipas rrëfimeve të Moisi Korenacit dhe Sestus Julius Africanus, beteja ndodhi midis dinastisë së Hajkut dhe një dinastie Kaldease në gjeneratën e saj të tretë, që kishte kontrollin e Babilonisë dhe territorin e mbetur të Akkadisë nën mbretin Bel, një Zot/Lufte simbolik Babilono/Akkadian, ose themeluesi i Babilonisë, në varësi të traditës mitologjike.

Sipas tregimit të Moisi Korenacit, Hajku, biri i Torgomit, pati një fëmijë të quajtur Armanak ndërkohë që jetonte në Babiloni. Pasi arroganti titanik Bel e bëri veten mbret mbi gjithçka, Hajku emigroi në rajonin pranë malit Ararat. Hajku u zhvendos pranë malit të Araratit me një familje të madhe prej të paktën 300 vetësh dhe u vendos atje, duke themeluar një fshat, të cilin e quajti Hajkashen. Gjatë rrugës ai kishte lënë një repart luftarak në një vendqëndrim tjetër me nipin e tij Kadmos në krye. Bel dërgoi një nga djemtë e tij për ta lutur që të kthehej, por u refuzua. Bel vendosi të marshojë kundër tij me një forcë të madhe, por Hajku u paralajmërua para kohe nga Kadmosi për afrimin e tij të shpejtë. Ai mblodhi ushtrinë e tij përgjatë bregut të Liqenit Van dhe u tha atyre se, ata duhet të mposhtnin dhe të vrisnin Belin, ose të vdisnin duke u përpjekur ta bëjnë këtë në vend që të bëhen skllevërit e tij. Në shkrimet e tij Moisiu shprehet se:

Hajku ishte një njeri i pashëm, miqësor, me flokë kaçurrela, sy të shndritshëm dhe krahë të fortë. Ai ishte një njeri me shtat gjigant, një harkëtar i fuqishëm dhe një luftëtar i patrembur. Hajku dhe njerëzit e tij, që nga koha e paraardhësve të tyre, Noes dhe Xhafetit (Japhethit), kishin emigruar në jug drejt tokave më të ngrohta afër Babilonisë. Në atë tokë atëkohë sundonte një gjigant i lig me emrin Bel. Bel u përpoq të imponontë tiraninë e tij mbi njerëzit e Hajkut. Por krenari Hajk nuk pranoi t'i nënshtrohej Belit. Sapo lindi djali i tij Armanak, Hajku u ngrit dhe e çoi popullin e tij drejt veriut në tokën e Araratit. Në rrëzë të malit ai ndërtoi një fshat dhe ia dha emrin, duke e quajtur Hajkashen.

Beteja e gjigantëve dhe humbja e Belit

Hajku dhe njerëzit e tij së shpejti zbuluan ushtrinë e Belit të pozicionuar në një kalim malor *(Moisi Korenaci e vendosi vendin si Dastakert),* me mbretin në pararojë.

Në Djucaznamart (Armenisht shkruhet – *Դյուցազնամարտ;* lexohet – Djucaznamart; Shqip përkthehet "Beteja e gjigantëve"), afër Xhulamerkut në juglindje të Liqenit Van, më 11 gusht 2492 para Krishtit (sipas kronologjisë tradicionale Armene përkon me muajin e parë të kalendarit Armen, Navasard ose 2107 para Krishtit (sipas "Tabela Kronologjike" e Mikael Chamchian ose Mihal Çamçian), Hajku e vrau Belin me një gjuajtje gati të pamundur duke përdorur një hark të gjatë, dhe duke shkaktuar tek forcat e mbretit një çorientim dhe rrëmujë të përgjithshme.

Kodrën ku ra gjiganti Bel me luftëtarët e tij, Hajku e quajti Gerezmank që do të thotë "vendi i varreve, varret, varrezat". Ai e balsamosi kufomën e Belit dhe urdhëroi që ta çonin në Hark, ku duhej të varrosej në një vend të lartë në prani të grave dhe djemve të mbretit.

Menjëherë pas kësaj, Hajku vendosi kështjellën e Hajkaberdit (Armenisht shkruhet - *Հայկաբերդ;* lexohet – Hajkaberd; është një fjalë e përngjitur, e formuar nga Hajk dhe berd - kala, kështjellë, dhe do të thotë: Kështjella e Hajkut) në vendin e betejës dhe qytetin e Hajkashenit në provincën Armene të Vaspurakanit (në Turqinë e sotme). Ai e quajti rajonin e betejës Hajk dhe vendin e betejës Hajoc Xor[4]

Mitologjia Krahasuese

Figura e vrarë nga shigjeta e Hajkut në variante të ndryshme është dhënë si Bel ose ndryshe si Nimrod. Hajk është gjithashtu emri i yjësisë Orion në përkthimin Armenisht të Biblës. Fluturimi i

[4] *Shënim B.P.:* Armenisht shkruhet: *Հայոց Զոր* - që do të thotë – Lugina e njerëzve të Hajkut.

Hajkut nga Babilonia dhe fitorja e tij e rastësishme mbi Belin, është krahasuar historikisht me ikjen e Zeusit në Kaukaz dhe humbjen e rastësishme të Titanëve.

Shënim Plus, nxjerrë nga Wikipedia:

Belus ose Belos (Greqishtja e lashtë: Βῆλος, Bēlos) në tekste klasike Greke ose klasike Latine (dhe materiale të mëvonshme bazuar në to) në një kontekst Babilonas i referohet perëndisë Babilonase Bel Marduk. Megjithëse shpesh i identifikuar me Zeusin Grek dhe Jupiterin Latin si Zeus Belos ose Jupiter Belus, në raste të tjera Belus është euhemerized[5] si një mbret i lashtë që themeloi Babiloninë dhe ndërtoi ziggurat[6]. Ai njihet dhe adhurohet si Zoti i luftës.

[5] Shënim: Euhemerism - është një përpjekje për interpretim të mitologjisë, në të cilën ngjarjet mitologjike supozohet se e kanë origjinën nga ngjarje apo personazhe të vërteta historike.

[6] Shënim: Ziggurat - (në Mesopotaminë e lashtë) një kullë e ngritur drejtkëndëshe, nganjëherë me një tempull sipër saj.

HITTITËT

Hittitët ishin një popull i lashtë *Anatolian,* të cilët, rreth viteve 1600 para erës sonë, themeluan një perandori të madhe me qendër në Hattusa, të ndodhur në zonën veri-qendrore te Anatolisë (Anadolli i sotëm). Kjo perandori arriti kulmin e saj gjatë mesit të shekullit të 14të para erës sonë nën sundimin e *Suppiluliuma I,* kur brenda saj përfshihej një zonë që përmbidhte pjesën më të madhe të *Azisë së Vogël,* si dhe pjesë të *Levantinit* të veriut dhe të *Mesopotamisë së Sipërme.* Pas viteve, afërsisht 1180 para erës sonë, periudhë kjo, që korrespondon me fundin e *Epokës së Bronzit,* perandoria e humbi fuqinë e saj, duke u shpërbërë në disa qytet-shtete *"te reja Hittite"* të pavarura, që u quajtën *"Hittitët e Rinj",* disa prej të cilëve mbijetuan deri në shekullin e 8të para erës sonë. *Gjuha Hittite* ishte një antare e shquar e *degës Anatoliane* të familjes se *gjuhëve Indo-Evropiane,* gjuha më e vjetër e vërtetuar e kësaj familjeje. Ata i referoheshin atdheut së tyre, si *Hatti:* Emri konvencional, "Hittitët", vjen për shkak të identifikimit të tyre fillestar nga arkeologët e shekullit të 19të me *Hittitët Biblike* si rezultat i studimeve arkeologjike të shekullit të 19të të erës sonë.

Pavarësisht nga përdorimi i emrit *"Hatti"* për territorin - vendbanim i tyre, *Hittitët* duhet të dallohen nga *Hattianët*, një popull më i hershëm, i cili kishte banuar në të njëjtën zonë (deri në fillim të mijëvjeçarit 2të para erës sonë) dhe fliste një gjuhë, që ndoshta i përkiste grupit të *gjuhëve të Kaukazit veri-perëndimor* të njohur si gjuha *"Hattik".*



Harta e Perandorise Hittite në kulmin e saj
(mesi i shekullit të 14-të para erës sonë)

Ushtria Hittite vuri në përdorim me sukses të ashtuquajturat "Qerre Luftarake"(një lloj karroce e vogël me dy rrota dhe që tërhiqej nga dy kuaj, e cila përdorej për gara ose për qëllime luftarake). Ndonëse i përkasin *Epokës së Bronzit,* ata ishin pararendësit e *Epokës së Hekurit,* duke zhvilluar zejtarinë e prodhimeve prej hekuri që në fillimet e shekullit të 18^{të} para erës sonë.

Pas viteve 1180 para erës sonë, në *Levant* pati trazira të përgjithshme, të cilat supozohet që të kenë qenë të lidhura me ardhjen e papritur të *Njerëzve të Detit.* Mbretëria u shpërbërë në disa qytet-shtete *"të reja Hittite"* të pavarura, që u quajtën *"Hittitët e Rinj",* disa prej të cilëve mbijetuan deri në shekullin e 8^{të} para erës sonë. Historia e qytetërimit Hittit është e njohur më së shumti nga tekstet *"kuneiforme"* (gdhendje në formë pyke në gur ose baltë e pjekur) të gjetura në zonën ku shtrihej mbretëria e tyre, dhe nga korrespondenca diplomatike dhe tregtare e gjetur në arkivat e ndryshme në Egjipt dhe në Lindjen e Mesme.

URARTU

Urartu (që në gjuhën Armene lexohet – Urartu; në gjuhën Asiriane - Urartu; në gjuhën Babilonase - Urashtu) i korrespondon Mbretërisë biblike të Araratit ose *Mbretërisë Van* (sipas Armenëve – *Mbretëria e Vanit*, sipas Urartianëve – *Biai, Biainili*). Ajo ishte një mbretëri e Epokës së Hekurit e përqëndruar në *Liqenin Van,* që ndodhej në Malësitë Armene. (Sot *Liqeni Van* së bashku me ish Malësitë Armene përreth



Mbretëria URARTU (Biainili) në periudhën ndërmjet viteve (860 – 590) para erës sonë

tij janë pjesë e territorit të Republikës së Turqisë – *shënim B.P.*). Më korrekte do ishte të thuhej që Urartu është një term Asirian për një *zonë gjeografike të kufizuar dhe të përcaktuar,* ndërsa *"Mbretëria Urartu"* ose *"Tokat Biainili"* janë terma që përdoren në historiografinë moderne për shtetin që u ngrit në atë zonë në kohën e Epokës së Hekurit dhe që kishte në përdorim gjuhën *Urartiane.* Kjo gjuhë shfaqet në mbishkrimet kuneiforme që datojnë të asaj kohe. Është argumentuar mbi baza gjuhësore që gjuha *proto-Armene* ka ardhur në kontakt me gjuhën *Urartiane* në një datë të hershme (mijëvjeçari 3te -2te para erës sonë), përpara formimit të mbretërisë *Urartiane.*

Nga König (1955) është theksuar, që duhet bërë një dallim i qartë ndërmjet organizimit gjeografik dhe atij politik të asaj kohe. (F. W. König, *Handbuch der chaldischen Inschriften* (1955). Territori, ku shtrihej Mbretëria Urartu, korrespondon me pllajën malore, që ndodhet ndërmjet *Anatolisë* (Anadolli i sotëm), *Mesopotamisë, Pllajës Iraniane* dhe *Maleve të Kaukazit,* territor ky i njohur më vonë si Malësitë Armene. Mbretëria Urartu u ngrit në pushtet në mes të shekullit të 9^{të} para erës sonë, por u pushtua nga *Medët* në fillim të shekullit të 6^{të} para erës sonë. Trashëgimtarët e Urartu janë Armenët dhe mbretëritë e tyre të njëpasnjëshme që vijuan në shekujt në vazhdim.

FRIGËT

Frigët (Phruges ose Phryges) ishin një popull i lashtë *Indo-Europian,* që - sipas *Herodotit,* - banonin fillimisht në Ballkanin Jugor nën emrin e *Bryges* (Briges) dhe më pas, pas migrimit të tyre të fundit në *Anatoli* nëpërmjet *Hellespontit* (sot – Dardanelet), e ndërruan atë në *Phruges.*

Nga format fillestare të organizimit, ato fisnore (tribu) fillimisht dhe më pas organizimet në formë fshati, në shekullin e 8^{të} para erës sonë gjejmë të formuar shtetin e *Frigias* me qendër në *Gordium,* që ishte njëkohësisht edhe kryeqyteti i tij. Gjatë kësaj periudhe, Frigët shtrihen drejt lindjes dhe u futën edhe në territoret e Mbretërisë *Urartu,* pasardhës të fiseve *Hurrian,* rivalë të hershëm të Hittitëve.

Rreth viteve 690 para erës sonë Mbretërinë Frigiane e gjejmë të pushtuar nga *Cimmerianët (Cimmerianët* – kanë qenë një popull i vjetër, të cilët u shfaqën rreth viteve 1000 para erës sonë dhe përmenden edhe më vonë në shekullin e 8^{të} para erës sonë në shënimet Assiriane): më pas për një periudhë të shkurtër kohore kanë qenë të pushtuar nga fqinjët e tyre, *Lidia,* për të kaluar akoma më pas rradhazi nën *Perandorinë Persiane të Kirit të Madh, Perandorinë e Aleksandrit të Madh* dhe pasardhësve të tij; më pas ra nën sundimin e Dinastisë *Attalid të Pergamonit* (Dinastia *Attalid* ishte një dinasti heleniste, që sundoi në qytetin e Pergamonit pas vdekjes së Lisimakut, një gjeneral i Aleksandrit të Madh), për të



Vendndodhja e Frigisë në krahinën e Anatolisë (Anadolli i sotëm)

përfunduar përfundimisht si pjesë e *Perandorisë Romake.* Përmendja e fundit e *gjuhës Frigiane* në literaturë daton në shekullin e 5[të] të erës sonë dhe mendohet të jetë zhdukur përfundimisht rreth shekullit të 7[të] të erës sonë.

Frigët flisnin *Frigisht,* një gjuhë Indo-Europiane.



Azia e Vogël në periudhën Greko - Romake

ALEKSANDRI I MADH

Aleksandri i III[të] *i Maqedonisë* (lindi më 20/21 Korrik 356 para erës sonë – vdiq më 10/11 Qershor të vitit 323 para erës sonë), i njohur si *Aleksandri i Madh* ishte një mbret i mbretërisë Greke të *Maqedonisë.* I lindur në Pella në vitin 356 para erës sonë, Aleksandri pasoi në fron babain e tij, Filipin e II[të], në moshën njëzet vjeçare. Shumicën e viteve, që ishte në pushtet, ai e kaloi në një fushatë ushtarake të pashoq nëpër Azi dhe Afrikën verilindore. Në moshën 30 (tridhjetë) vjeçare, ai kishte krijuar një prej perandorive më të mëdha të botës së lashtë, që shtrihej nga Greqia në Egjipt dhe deri në territoret e Pakistanit të sotëm. Ai ishte i pamposhtur në betejë dhe është konsideruar si një nga komandantët më të suksesshëm të historisë botërore.

Aleksandri konsiderohet që është lindur në ditën e 6[të] të muajit Hekatombaion sipas kalendarit të lashtë grek, që me shumë gjasa i korrespondon datës 20 korrik 356 para erës sonë sipas kalendarit tonë, ndonëse data e saktë nuk dihet. Ka lindur në Pella, në kryeqytetin e Mbretërisë së Lashtë Greke të Maqedonisë. Ai ishte djali i mbretit të Maqedonisë, Filipit II[të] dhe Olimpias (gruas së katërt të Filipit II[të]), e bija e mbretit të Epirit, Neoptolemusit të I[rë]. Ndonëse Filipi kishte shtatë ose tetë gra, Olympia ishte gruaja e tij kryesore për disa kohë, me shumë gjasa si rezultat i lindjes së djalit, Aleksandrit.



Pushtimet e Aleksandrit të Madh gjatë viteve 334 – 323 para erës sonë

Ushtria e Aleksandrit kaloi Helespontin në vitin 334 para erës sonë me përafësisht 48.100 ushtarë, nga të cilët 6.100 ishin kalorës, si edhe me një flotë prej 120 anijesh të ngarkuara me 38.000 trupa, të mbledhura nga Maqedonia dhe qytet-shtetet e ndryshme Greke, mercenarë, dhe ushtarë të mbledhur nga feudalët e Trakës (Thrakës), Paionia-s dhe Ilirisë. Ai e shfaqi hapur qëllimin e tij për të pushtuar të gjithë Perandorinë Persiane duke sulmuar tokat Aziatike dhe duke deklaruar që e pranonte Azinë si një dhuratë nga perënditë. Kjo gjithashtu tregoi synimin dhe etjen e Aleksandrit për të luftuar, në kontrast me babain e tij, që preferonte rrugën diplomatike.

Testamenti

Diodorusi ka pohuar se Aleksandri i kishte dhënë udhëzime të hollësishme me shkrim Kraterusit disa kohë përpara vdekjes së tij. Kraterusi filloi të vinte në zbatim porositë e Aleksandrit, por pasuesit e Aleksandrit zgjodhën të mos i pranojnë ato më tej, me arsyetimin se ato ishin ekstravagante dhe jo praktike për t'u zbatuar. Megjithatë, Perdikas lexoi vullnetin e Aleksandrit përpara trupave të tij.

Testamenti bënte thirrje për zgjerimin ushtarak në jug dhe në perëndim të Mesdheut, për ndërtime monumentale, dhe për përzierje të popullatave Lindore dhe Perëndimore (emigrim të ndërsjelltë dhe kryqëzim racor). Ai përfshinte:

Ndërtimin i një varri monumental për babain e tij Filipin. "të krahasueshëm me madhështinë e piramidave të Egjyptit"

Ngritja e tempujve të mëdhenj në Delos, Delpi, Dodona, Dium, Amfipoli, dhe një tempulli monumental kushtuar Athinës në Trojë

Pushtimin e Arabisë dhe të gjithë bregdetit Mesdhetar.

Lundrimin rreth Afrikës.

Zhvillimin e qyteteve dhe "shpërnguljen e popullsive nga Azia në Europë dhe në drejtim të kundërt, nga Europa në Azi, për të sjellë unitet dhe miqësi në kontinentin më të madh nëpërmjet martesave të përziera dhe lidhjeve familjare".

Ndarja e perandorisë.

Grindjet dhe rivaliteti ndërmjet gjeneralëve, që filluan pas vdekjes së Aleksandrit, patën ndikim mbi Maqedonasit. Krahinat



Ndarja e Perandorisë pas vdekjes së Aleksandrit të Madh

që ju lanë në administrim gjeneralëve nga Perdikasi gjatë *Ndarjes së Babilonisë,* shërbyen si bazë e fuqishme për çdo gjeneral në luftën për pushtet. Pas vrasjes së Perdikasit në vitin 321 para erës sonë, harmonia Maqedonase u prish dhe u pasua me një luftë afro 40 vjeçare ndërmjet të ashtuquajturve "Trashëgimtarë të Aleksandrit" (Diadoki), derisa bota Helenistike të merrte formën e katër blloqeve të qëndrueshme: Mbretëria e Ptolemeut të Egjiptit, Perandoria Seleucide në lindje, Mbretëria e Pergamonit në Azinë e Vogël, dhe Maqedonia. Në këtë proces grindjesh të vazhdueshme u vranë edhe dy nga pretenduesit për trashëgimtarë të fronit të Maqedonisë, Aleksandri i IV[të] dhe Filipi III[të].

SHËN BARTOLOMEU

Lindur në Judea, Shekulli i I[rë] i erës sonë.
Vdekur në Albanopolis, Armeni, Shekulli I[rë] i erës sonë.

Së bashku me mikun e tij Xhud Tadeus (Jude Thaddeus), Bartolomeu ka reputacionin e njeriut, që solli Krishterimin në Armeni në shek. I[rë] të erës sonë. Kjo është arësyeja, që të dy këta shenjtorë konsiderohen "Shënjtorët Mbrojtës" të Kishës Apostolike Armene.

Thuhet se ai është martirizuar në *Albanopolis, në Armeni*. Sipas një historie, atë e kanë dënuar me prerje koke, ndërsa sipas një historie tjetër, që gëzon më tepër popullaritet, thuhet se ai është vrarë duke u rrjepur i gjallë dhe më pas i kryqëzuar me kokë poshtë. Thuhet që ishte pikërisht ai, që e konvertoi në të krishterë Polimius-in, mbretin e Armenisë. Më pas, vëllai i Polimius-it, Astiexhi (Astyages), kur erdhi në fuqi, urdhëroi ekzekutimin e Bartolomeut.

Manastiri i Shën Bartolomeut është një manastir i famshëm Armen i ndërtuar në shek. e 13[të] të erës sonë në vendin e martirizimit të Apostullit Bartolomeu, në krahinën Vaspurakanit të ish Armenisë së Madhe (krahina e Vaspurakanit sot ndodhet brenda kufijve të Turqisë, në pjesën jug-lindore të saj).

WIKIPEDIA PËR "ALBANIA E KAUKAZIT"

Albania e Kaukazit është një eksonim (eksonim - emërtimi që përdorin të huajt për një vend të caktuar. *Shënim B.P.*) modern për një vend të lashtë në Kaukazin lindor, në territorin e republikës së sotme të Azerbajxhanit (ku ishin të vendosura të dy kryeqytetet e saj) dhe të Dagestanit jugor. Endonimi (endonim - emërtimi që përdorin vendasit për vendin e tyre. *Shënim B.P.*) i tij është i panjohur. Emri Albania rrjedh nga emri i lashtë Grek *Ἀλβανία* dhe ai Latin *Albania.* Prefiksi "Kaukazian" përdoret thjesht për të shmangur ngatërresën me Albaninë moderne të Ballkanit (bëhet fjalë për Shqipërinë; *Shënim B.P.*), e cila nuk ka lidhje të njohura gjeografike apo historike me Albaninë Kaukaziane.

Aghuank (Sipas Armenishtes së Vjetër: *Աղուանք - "Ałuank";* sipas Armenishtes Moderne: *Աղվանք - "Aġvank"*) është emri Armen për Albaninë Kaukaziane. Autorët Armenë përmendin se emri rrjedh nga fjala *"ału" ("աղու" -)* (transkriptimi në Shqip – *aghu: Shënim B.P .*) që do të thotë miqësor (dashamirës) në gjuhën Armene. Termi Aghuank është polysemik dhe është përdorur në burimet Armene, gjithashtu, për të treguar rajonin midis lumenjve Kur dhe Araks si pjesë e Armenisë. Në rastin e fundit ajo nganjëherë përdoret në formën "Aghuanku Armen" ose "Haj-Aghuank". (Armenët e quajnë veten e tyre *"Haj": Shënim B.P.*)

Historiani Armen i kësaj krahine, Moisi Kaghankatvatci, i cili la të vetmen histori të shkruajtur pak a shumë të plotë rreth krahinës,

shpjegon emrin *Aghvank* si i prejardhur nga fjala *Ału* (që në gjuhën Armene do të thotë - i ëmbël, i butë, miqësor), e cila, thotë ai, ishte nofka e guvernatorit të parë të Albanisë Kaukaziane, Arranit, dhe i referohej personalitetit të tij të butë. Moisi Kaghankatvatci dhe burime të tjera të lashta shpjegojnë *Arranin* ose *Arhanin* si emrin e themeluesit legjendar të Albanisë Kaukaziane *(Aghvan)* ose edhe të fisit iranian të njohur si *Alanët (Alan),* i cili në disa versione paraqitet si bir i djalit të Noes, Xhafetit.

James Darmesteter, përkthyes i *Avesta-s,* e krahasoi *Arranin* me *Airiana Vego,* të cilin ai e konsideroi të ketë qenë në krahinën e *Araxes-Ararat,* megjithëse teoritë moderne tentojnë ta vendosin këtë në lindje të Iranit. Partët (Parthët) përdornin për krahinën emrin *Ardhan* (Në Persinë e Mesjetës: *Arran*). Në Arabisht ishte *ar-Rān.* Në gjuhën Gjeorgjiane, ajo njihej si *რანი - Rani.* Në Greqishten e lashtë, ajo ishte *Ἀλβανία - Albanía.* Se si e quanin atë banorët e saj, kjo është e panjohur (nuk dihet).

Kryeqyteti i mbretërisë gjatë antikitetit ishte Qabala (Kabala, Kapalak). Burimet klasike janë unanime në përcaktimin e lumit Kura (Cyros) si vija e kufirit midis Armenisë dhe Albanisë pas pushtimit të territoreve në bregun e djathtë të lumit Kura nga Armenët në shekullin e 2të p.e.s.

Fillimisht, të paktën disa nga Albanët Kaukazianë ndoshta flisnin gjuhën Lezgike, të afërt me atë të atyre që gjenden në Dagestanin e sotëm; gjithsesi, mendohet se mund të jenë folur deri në 26 gjuhë të ndryshme në Albaninë Kaukaziane.

Pas kristianizimit të Albanëve të Kaukazit në shekullin e 4të, pjesë të popullsisë u asimiluan nga Armenët (të cilët dominonin në provincat Arcakh dhe Utik, që ishin më parë të shkëputura nga Mbretëria e Armenisë) dhe nga Gjeorgjianët (në veri), ndërsa pjesët lindore të Albanisë Kaukaziane u islamizuan dhe u asimiluan nga popujt Iranianë dhe më pas nga ata Turq (Azerbajxhani modern).

Mbetje të vogla të këtij grupi vazhdojnë të ekzistojnë në mënyrë të pavarur dhe njihen si populli Udi.

Sipas historianëve Armenë mesjetarë Moisi Khorenaci, Moisi Kaghankatvaci dhe Koriun, alfabeti i Albanëve të Kaukazit u krijua nga murgu, teologu dhe përkthyesi Armen, Mesrob Mashtots, i cili gjithashtu ishte ngarkuar me detyrën e krijimit të alfabetit Armen. Ky alfabet u përdor për të shkruar gjuhën Udi, e cila ndoshta ishte gjuha kryesore e Albanëve të Kaukazit.

Një alfabet i Albanëve të Kaukazit, me pesëdhjetë e dy germa që ruajnë ngjashmëri me karakteret Gjeorgjiane, Etiopiane dhe Armene, ka arritur të mbijetojë nëpërmjet disa pak mbishkrimeve dhe një dorëshkrimi Armen, që datonte nga shekulli i 15-të.

KAPITULLI 4

PEMA E GJUHËVE INDO-EUROPIANE

(Nxjerrë nga shkrime të ndryshme)

Studimi

Kongresi i drejtshkrimit dhe

Bahri **BECI**

I

A. **Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe**

Kanë kaluar 30 vjet nga Kongresi i drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Dhe tradhjetvjetori i një Kongresi, që është vlerësuar si "kuvend i madh shkencor", për ne është një rast për reflektime e analiza të vërteta shkencore, pa paragjykime a shtrembërime të asnjë natyre.

Kushtet në të cilat u mblodh KDGJSH

Kongresi i drejtshkrimit që është vlerësuar nga përfaqësuesit e gjuhësisë zyrtare si "një fitore e vijës marksiste të PPSH për zgjidhjen e problemit të gjuhës sonë letrare kombëtare" i zhvillot punimet në nëntor të viti 1972. Në atë kohë "Në Shqipëri nuk ekzistonte shteti ligjor. PPSH ishte e vetmja forcë politike në pushtet....: makina shtetërore ishte e burokratizuar dhe ushtronte dhunë e represion. Ajo ngjallte kudo psikozën e frikës... Politika e luftës së klasave... i shërbente diktatorit dhe klanit të tij për të luftuar dhe për të zhdukur gjithë kundërshtarët e vet e të regjimit «: ... njerëzit dënoheshin edhe « për shprehjen e një mendimi fare të rëndomtë..."[6].

"1972-shi ishte koha e vendosjes së plotë të bazave të socializmit, të ideizmit dhe të realizmit socialist në kombëtare »[8].


Po sipas atyre që thuhen në Rezolutën e Kongresit, shënderrimet e thella historike ekonomio-shoqërore i kanë dhënë shtytje zhvillimit të gjuhës letrare, zhvillimi i lartë gjuhës letrare e ka bërë të domosdoshëm drejtshkrimin e njësuar.


Mirpo, po në atë faqe të Rezolutës është shkruar e kundërta se « Përhapja dhe zbatimi i një drejtshkrimi të njësuar në të gjitha sferat e veprimit të fjalës së shkruar ka ndihmuar për përvetësimin e ngulitjen e normave të gjuhës letrare »[9]

Në qoftëse deri më1967, pohohej shprehimisht se toskërishtja letrare është gjuhë letrare shqipe, në periudhën pas viti 1967, kjo fshihej dhe flitej për toskërishten letrare si për "shqipe të njësuar". [10] Po kështu, edhe në Rezolutën e Kongresit të drejtshkrimit, flitet për "gjuhë letrare të njësuar".[11]

Fjala "njësimi" është thelbi i çështjes shkruan A. Klosi. Sipas tij, Kongresi i Drejtshkrimit nuk arriti kurrfarë njësimi, sepse nuk mund të njësohen fenomene kaq të ndryshme si rotacizmi, mungesa e infinitit, hundorësia etj. me të kundërtat e tyre. Kongresi thjeshtë standardizoi një variant letrar, duke marrë disa elemente minimale të gegërishtes, psh. në fjalëformim, për ta pasuruar variantin e kodifikuar jugor a për ta justifikuar zhdukjen e variantit letrar verior[12].

Duke bërë vlerësimin e asaj që është quajtur "gjuhë letrare shqipe e njësuar", A. Pipa ka shkruar se "i ashtuquajturi njësim në këtë rrafsh (në rrafshin strukturor fl. fl.) është një mozaik i toskërishtes letrare... »[13]. Madje ai është përpjekur ta arsyetoj zgjidhjen e zbatuar[14].




ACCADEMIA CULTURALE
ILIRIA
SKODRINON
Illirico:
SKODRINON
Albanese:
Shko Drini
Italiano:
Scorre il Dr
Inglese:
The Drin flo
DALL'ETNOCENTRISMO AL
PLURALISMO CULTURALE
NGA ETNOCENTRIZMI NË
PLURALIZËM KULTUROR
FROM ETHNOCENTRISM T
CULTURAL PLURALISM
BARDI EDITORE

PROTOLINGUA e PELASGO-ILLIRO-ETRUSCO

Pag. 169


PROTOGJUHA dhe PELLAZGO-ILIRO-ETRUSKISHTJA

Fq. 177

PROTOLANGUAGE and PELASGO-ILLYRO-ETRUSCAN

Page 185

"Popoli, Geni e Lingue", grafika e prejardhjes së gjuhëve, ndërtuar prej dy nxanësve të Cavalli Sforcë-s: **Alberto Piazza dhe Eric Minch:**



Shqip, Armen, Grek, Çeltik Baltik, Sllav, Gjerman. Italik, Indian, Iranik.

Ne botën tonë ka një horizont që nuk lejon shtyrjen e shikimit tonë përtej tij. Dhe, nuk ka dyshim se, përsa i përket lashtësisë, horizonti ynë ndalet te **Pellazgët Yjnor, "shpikës të alfabetit fonetik"popuj të Detit, të cilët i quajtën "Iliri" trojet e banuara nga njerzit e tyre të lirë.**

E vërteta historike dhe veçanërisht ajo e gjuhësisë, dalin në dritë duke i ngjitur unazat e ndryshme të ngjarjeve, për formimin e një zinxhiri të gjatë, në përmasën e tij më të gjerë, me kujdes të madh e me përkushtim të veçantë, në mënyrë që kultura mos të bëhet peng i propogandës. Dhe, duke i mbetur besnik këtij parimi, ia vura themelet gjurmimeve të mia mbi Pellazgët, thjeshtësisht, duke i vendosur së bashku, njërën pas tjetrës, unazat e çmuara të të dhënave shkencore të shkrimtarëve të mirënjohur të lashtësisë, nga Homeri, Herodoti, Tuqiditi, Virgjili, Pausania, etj. deri tek ata studiues të lirë të diteve tona.

Nëse duam t'a përballojmë me baza shkencore të vërteta dhe me pa anësi këtë studim, duhet të kemi kujdes që mos të bëhemi viktima të **Horror Novi**-it. T'i analizojmë me urtësi dhe pa paragjykime jehonat e lajmeve të çmuara, të ardhura nga lashtësia e hershme, kur emëri i vendeve nuk konsiderohej i huaj nga fiset sapo të ardhur, ashtu si edhe nuk njihej nevoja e këmbimit të emrave, me paragjykim të posatshëm, për t'ia dhënë historisë përmasën e interesit politik ose vetiak të kohës.

Dihet fare mirë se, para ardhjes së Helenëve në trojet që sot njihen si "Greqi", ata vendë quheshin "Pellazgji". Ja se si vërtetohet ky fakt nga autorët e lashtësisë.

Homeri (Iliada-v.681-685):

"Aso kohe, ata që banonin në Argolidën Pellazgjike (...)quheshin Mirmidon, Helen dhe Akej".

Homeri e quan "Pellazgjike" Argolidën dhe jo Akej.

Herodoti (Historia, Libri VIII, kap.44):

"Në kohë kur Pellazgët banonin në trojet që sot quhen Hellad, athinasit ishin pellazgë, të fisit të Kranoit (...)por kur u helenizuan, e ndruan edhe emrin e tyre".

Tuqididi (libri I, kap.3):

"Përpara Helenit Deukalion, ky emër "Hellas" nuk gjindej fare: popullsira të tjera e veçanërisht populli Pellazgjuk ia dhanë vendit emërin e tyre".

Pausania (Arkadia, libri VIII, 1,4,6)
"Arkadët thojnë se Pellazgu ishte njeriu i parë që lindi në tokën e Arkadisë. Dhe, meqë Pellazgu u bë mbret, Vendi u quajt "Pellazgji".
Virgjili (Eneide, VIII, v.602-603):
"Thuhet se banorët e parë të Italisë sonë ishin Pellazgët".

Mos te harrojmë se ende gjinden në Itali vende që e ruajnë emrin e Pellazgve si p.sh. **Isole Pelasgie**, afër Siqilisë dhe në veri, afër Padovas: **Le Terme Pelasgie.** Pak km. përtej Firences, hasemi me vendin që mban emërin **Pelago** dhe afër Modena-s, gjindet qyteti **Pieve-Pelago.**

Pa dyshim, interesë të veçantë gjuhësorë dhe historik dëshmohet nga emri që mbajnë: **Mali Liri, Qyteti Liri** dhe **Lumi Liri,** të cilët gjinden në Lacio të Italisë, nja 40 km. në jugë të Romës.

Për t'a bërë sa më të qartë analizën tonë në këtë shkrim, duhet të kemi të pranishëm, gjithmonë, se **Pellazgët Yjnor** ishin ata që e shpikën alfabetin fonetik. Si dihet, me parë shpreheshin me **"hieroglifike ose me ideograma".** Prandaj, me bindje të plotë mund të themi se qytetërimi i vërtetë fillon me **Pellazgët Yjnor dhe të Lirë, të cilët e quajtën "ILIRI" vendbanimin e tyre. Iliria shtrihej nga Egjeu deri në Danub.**

Nuk ka dyshim se shkrimi është mjeti i vetëm për përhapjen e kulturës në skajet e ndryshme të botës, ashtu si, në fakt, ka ndodhur. Pellazgët, duke qenë lundrues të lirë dhe të aftë, e përcollën gjuhën, alfabetin e kulturën e tyre kudo që vajtën. Dhe, studimi i gjuhësisë, na dëshmon se ata kan vajtur shumë më largë se sa e ka pranuar shkenca e ditëve tona!

Tashti, për vërtetimin e një shkence të përpiktë, duhet të rruhemi, me çdo kusht, nga ai mentalitet i përhapur në ditë tona, me përkrahjen e kësaj shprehjeje të latinishtes **"Damnat quod non intelligit".**(e dënojë, meqë nuk e kuptojë)! Pra, të përpiqemi dhe mos të dënojmë me përbuzje çka është zbuluar, me mundime të mëdhaja, vetëm pse nuk përputhet me tezat tona, ose në kundërshtim me interesat tona. Përsa i përket Italisë, kemi dëshmi nga shkenctarë të ndryshëm, të cilët e përkrahin tezën e prejardhjes **Pellazgo-Ilire** të italianëve. T'a vërtetojmë këtë tezë në formë shkencore:

Diodor Siqilioti na informon se dhjetë shekuj para K. përdorei alfabeti i Pellazgve dhe nënvizon se, të parët që e sollën alfabetin e tyre në Itali dhe në Evropë, duke bërë disa përshtatje, ishin vetë Pellazgët.

Plini Plakë e vërteton lajmin se Pellazgët ishin ata që e sollën në Itali' alfabetin fonetik.

Seneca, me anë të hartës gjeografike të tij, dëshmon periudhën e arrdhjes së Etruskëve në Itali. Ai shprehet pikërisht në këtë mënyrë:

"Etruskët numëronin me "saecula" historinë e tyre dhe mendonin se "saeculum" i parë fillonte në shekullin 1200-1100 para K.

Në këtë përmbledhje të shkurtër të studimit tonë, besoj se nuk është i rastit të zgjatemi më teje me autorë të lashtësisë. Të mësojmë pak edhe mendimin e disa studiuesve të dy shekujve të fundit, për të patur një pamje dëshmuese më të përpiktë, të historisë dhe gjuhësisë sonë me interesë të jashtzakonshme:

Francesco Ribezzo "Iscriptiorum Messapicarum" (1944), pranon concordanca të shumëta midis onomastikës Venete, Japixhe, Ilire dhe shqiptare.

Alfredo Trombetti , confermon se fise Ilire u përhapën në gjith Gadishullin Italik, nga Venediku, në Pulia e në Kalabri.


Elia Lattes, pohon se nuk ka arsye që mos të pranohet origjina Ilire e popujve Italik.

Nxjerrrë nga Libri: “Pellazgët, Ilirët, Etruskët, Pellazgët”; Nermin Vlora

1) Vizatimi paraqitet me gjuhën "ALBANESE", si fillimi i të folmeve, nga ku kanë shpërthyer gjuhët e tjera. Unë do ta quaja Pellazgo-Ilirishte, meqë fjala "Albanese" nuk ekzistonte, por duket se në studimet e tyre ata u bazuan mbi emrat që përdoren sot: emra aktualë për shprehje teknologjike moderne:

2) Edhe fjala "ÇELTË" (gjyrë e çeltë) e ka kuptimin vetëm në gjuhën shqipe, ashtu si edhe "BALTA" (Baltike). Sa për emrat e tjerë, t'i mënjanojmë tash për tash, meqë nuk kam dokumentime të mjaftueshme për transformimin e tyre.

Në faqen 244 të veprës: "GENI, POPOLI E LINGUE" të autorit L.L. Cavalli-Sforza, mund të vështrohet ky vizatim interesat nga pikëpamja e prejardhjes së gjuhëve:



Shqip Armen Grek Çeltik Baltik Sllav Gjerman Itali Indian Iranik

Cavalli-Sforza shkruan se me 1863, linguisti gjerman AUGUST SCHLEICHER botoi një dru të gjuhëve indo-evropiane që u afrohet shumë atyre të sotmeve. Por në atë kohë, shkruan ai, mungonin metodat

534

Nxjerrrë nga Libri: “Pellazgët, Ilirët, Etruskët, Pellazgët”; Nermin Vlora

sasiore, të aplikimeve biologjike, të cilat u zbuluan shumë më vonë, në mesin e dytë të shekullit tonë. Ka mundësi që Schleicher të jetë influencuar nga shkallëzimet e ndryshme të CHARLES DARWIN-it, për ta shpjeguar teorinë e origjinës së organizmave.




DARWIN, në veprën e tij: "ORIGJINA E FARAVE NJERËZORE"; në kapitullin XIV, botuar me 1859, shkruan:

"Po të njihej druri biologjik i grupeve të fiseve të ndryshme të njerëzve, do të ishte e mundur të njihej edhe ai i gjuhëve".

Sidoqoftë, druri gjenealogjik paraqitur nga AUGUST SCHLEICHER, në përmbajtje, nuk ndryshon tepër

535


English
Dutch
Afrikaans
Old Saxon
Flemish
Hindi
Urdu
Bengali
Sanskrit
German
Portuguese
Italian
(LOW GERMAN)
Spanish
French
Yiddish
(HIGH GERMAN)
Romanian
Czech
Bulgarian
Ukrainian
Icelandic
WEST GERMANIC
INDO-IRANIAN
IRANIAN
SLAVIC
BALTIC
Norwegian
NORTH GERMANIC
GERMANIC
LATIN
Greek
BALTO-SLAVIC
Albanian
Armenian
Swedish
Danish
Breton
Gaelic
CELTIC
INDO-EUROPEAN
Welsh
HISTORY OF THE EN
How does a language begin? It isn't born or in
just starts somewhere, with some words of
words. It grows and develops as people use it
is part of the Indo-European family of
they started from the sa
from the cha
http://de.f257.mail.yahoo.com/ym/de/ShowLetter?box=Inbox&MsgId=8054_806999_57... 21.07.05

PEMA FAMILJARE E GJUHËVE I KA RRËNJËT NË ANATOLI (ANADOLL) - KËSHTU THONË BIOLOGËT

Artikull i marrë në Internet; botim i "The New York Times" nën titullin: Family Tree of Languages Has Roots in Anatolia, Biologists Say

August 23, 2012

By NICHOLAS WADE

Biologët, duke përdorur mjete të zhvilluara posaçërisht për të studjuar evolucionin e pemëve familjare të gjuhëve, thonë se ata kanë zgjidhur një problem, që shtrohet prej shumë kohësh përpara arkeologjisë: origjina e familjes së gjuhëve indo-europiane.

Kjo familje përfshin gjuhën Angleze si edhe shumicën e gjuhëve të tjera europiane, si gjuha Persiane, Indiane e të tjera. Pavarësisht nga rëndësia e gjuhëve, për kohë të gjatë specialistët nuk kanë rënë dakord për origjinën e tyre.

Gjuhëtarët besojnë se folësit e parë të gjuhës amtare, të njohur si proto-Indo-Europiane, ishin barinjtë shetitës, që dinin të ngisnin edhe të ashtuquajturat "*Qerre Luftarake* - Charriots"(një lloj karroce e vogël me dy rrota dhe që tërhiqej nga dy kuaj, e cila përdorej për gara ose për qëllime luftarake). Afërsisht 4 000 vjet më parë, ata u

derdhën nga stepat, që ishin vendqendrimi i tyre fillestar (atdheu i tyre), mbi tokat përreth Detit të Zi dhe pushtuan Europën dhe Azinë. Një tjetër teori, që rivalizon me të, thotë se, përkundrazi, folësit e parë Indoeuropianë ishin fermerët paqësorë të Anatolisë (sot – Anadollit), tani Turqi, rreth 9,000 vjet më parë, të cilët e përhapën gjuhën e tyre me shatë (vegël pune, që përdoret në bujqësi për të prashitur tokën), dhe jo me shpatë.

Debutuesi i ri në këtë debat është një biolog evolucionist, Quentin Atkinson, i Universitetit të Oklandit (Auckland) në Zelandën e Re. Ai dhe kolegët e tij kanë marrë fjalorin ekzistues dhe shpërndarjen gjeografike të 103 gjuhëve të ndryshme Indo-Europiane dhe me rrugë kompjuterike i kanë vendosur ato mbrapsht në kohë dhe vend sipas origjinës më të mundshme që rezulton nga statistikat e deritanishme.

Rezultati, të cilin ata e shpallën në "Thursday's issue of the journal Science", është se "kemi gjetur mbështetje të fuqishme vendimtare për një origjinë Anatolike (nga Anadolli) në krahasim me atë të ardhur nga stepat". Si koha ashtu edhe rrënja e pemës së gjuhëve Indo-Europiane "përputhet me një ekspansion agrikultural nga Anatolia duke filluar nga 8,000 deri në 9,500 vjet më parë"- raportojnë ata.

Por pavarësisht metodave të tyre të avancuara statistikore, studimi i tyre nuk mund t'i bindë të gjithë.

Studiuesit filluan me një grup të zgjedhur fjalësh, të cilat njihen të jenë rezistente ndaj ndryshimeve gjuhësore, siç janë përemrat, pjesët e trupit dhe lidhjet familjare, dhe i krahasuan ato me fjalët përkatëse të gjuhëve paraardhëse proto-Indo-Europiane stërgjyshore. Fjalët, që kanë një linjë të qartë të prejardhjes nga e njëjta fjalë stërgjyshore, njihen si *"të afërm"* (prej një burimi). Kështu fjala "mama, nënë" (Shqip), "mother" (Anglisht), "mutter" (Gjermanisht), "mat" (Rusisht), "madar" (Persisht), "matka" (Polonisht) dhe "mater" (Latinisht) janë të gjitha *"të afërm",* që rrjedhin nga fjala proto-Indo-Europiane - "mehter".

Pas kësaj, Dr. Atkinson dhe kolegët e tij, i vendosën nga një shenjë çdo grupi fjalësh në fjalorin që e kishin përcaktuar si "fjalor bazë për studim" për 103 gjuhët e përmendura më sipër. Në gjuhët ku fjala ishte *"i Afërm"*, studiuesit vendosën shenjën *1;* në ato kur *"i afërmi"* ishte zëvendësuar me një fjalë që nuk kishte lidhje me të, u vendos shënja *0*. Kështu, çdo gjuhë mund të përfaqësohej nga një varg 1(njëshash) dhe 0(zerosh), dhe studiuesit mund të llogarisin (hartojnë) kompjuterikisht pemën familjare më të mundshme për të qenë reale, e cila tregon marrëdhëniet midis këtyre 103 gjuhëve.

Më pas, kompjuteri u furnizua me të dhënat e njohura rreth datave kur fillojnë të shfaqen ndarjet gjuhësore. Për shembull, gjuha Rumune dhe ato të tjera me bazë Romane filluan të devijonin nga Latinishtja pas viteve 270 të erës sonë, kur trupat Romake u tërhoqën nga provincat Romake të Dakëve. Duke aplikuar këto të dhëna në disa prej degëve të kësaj peme, kompjuteri ishte në gjendje të vlerësonte të dhënat edhe për gjithë të tjerët.

Gjithashtu, kompjuterit ju dha informacion gjeografik rreth vendpozicionimit aktual të secilës gjuhë dhe ju kërkua që të hartonte rrugët më të mundshme për të qenë reale të shpërndarjes duke filluar nga një origjinë dhe duke pasur parasysh pemën familjare të mundshme të prejardhjes. Përllogaritja fiksoi Anadollin si pikë origjine, sidomos një zonë në formën e një thoi të zgjatur në atë vend, që tani është Turqia jugore, si origjina më e besueshme – rajon ky, që ishte propozuar si origjina e familjes Indo-Europiane edhe nga arkeologu Kolin Renfrew, në vitin 1987, i cili besonte se këtu ishte burimi, nga i cili agrikultura u përhap në Europë.

Puna e Dr. Atkinson ka përmbledhur dhe ndërthurur një sasi të madhe informacioni nëpërmjet një metode kompjuterike, e cila ka rezultuar e suksesshme në studimet me natyrë evolucionare. Por rezultatet e tij nuk mund të lëkundin nga pozicioni i tyre mbështetësit e teorisë rivale, të cilët besojnë se gjuhët Indo-Europiane janë përhapur rreth 5.000 vjet më vonë nga barinjtë (fiset

endacake që merreshin me blegtori) luftarakë, që pushtuan Europën dhe Indinë duke ardhur nga stepat e Detit të Zi.

Një element kyç në arritjen e këtij konkluzioni është fakti, se gjuha proto-Indo-Europiane kishte një fjalor për *"Qerre Luftarake"* (charriots – në Anglisht) dhe *"Qerre-karrocë"* (wagons – në Anglisht), që përfshinte fjalë, që përdoreshin për *"rrota"* (wheel – në Anglisht), *"bosht - aks"* (axle – në Anglisht), "*shufër* – për dy shufrat e karrocës brenda të cilave mbrehet kali "(harness-pole – në Anglisht) dhe "për të shkuar ose për të ngarë një mjet" (to go or convey in a vehicle – në Anglisht) . Këto fjalë kanë pasardhës të shumtë në gjuhët bija Indo-Europiane. Kjo i bën gjuhëtarët historikë të argumentojnë, që vetë gjuha Indo-Europiane nuk mund të jetë fragmentuar në ato gjuhë bija përpara shpikjes së *"Qerres Luftarake"* dhe *"Qerres-karrocë",* shembujt e njohur më të hershëm të së cilës datojnë në vitet 3500 para erës sonë. Kjo do të përjashtonte çdo lidhje midis asaj që quhet Indo-Europiane dhe përhapjes së bujqësisë nga Anatolia (Anadolli), e cila ka ndodhur shumë më herët.

"Unë e shoh faktin e "mjeteve me rrota" si një një element të fortë bindës mbi çdo teori evolucionare të pemës së gjuhëve", thotë David Anthony, një arkeolog në Kolegjin Hartwick, që studion origjinën Indo-Europiane

Gjuhëtarët historikë shohin prova të tjera në atë që folësit e parë Indo-Europianë kishin fjalë për "kalin" dhe "bletën" dhe ju kishin huazuar (dhënë hua) shumë fjalë bazë gjuhës proto-Uralike, gjuhës amtare të finlandezëve dhe hungarezëve. Vendi më i mirë për të gjetur kuaj të egër dhe bletë dhe për të qenë pranë folësve të gjuhës proto- Uralike është zona e stepës mbi Detin e Zi dhe Detin Kaspik. Njerëzit e Kurganit, që pushtuan këtë zonë rreth viteve nga 5000 deri në 3000 para erës sonë, kanë qenë cilësuar prej kohësh si kandidatë për të marrë emrin e "folësve të parë të gjuhës Indo-Europiane.

Në një libër të kohëve të fundit, "Kali, Rrota dhe Gjuha", Dr. Anthony përshkruan se si njerëzit e stepës zhvilluan një shoqëri të

lëvizshme dhe një sistem shoqëror, që u mundësoi atyre të largoheshin nga vendlindja duke u përhapur në disa drejtime, duke përhapur njëkohësisht edhe gjuhën e tyre në lindje, perëndim dhe në jug.

Dr. Anthony thotë se ai e kishte gjetur pemën e gjuhëve Indo-Europiane të hartuar nga Dr. Atkinson të papranueshme (të pambështetur) në disa detaje. Për shembull, gjuha "Tokariane", është një grup gjuhësh Indo-Europiane, që flitet në Kinën veriperëndimore. Dr. Anthony thotë se është e vështirë të përfytyrohet se si gjuha "Tokariane" mund të ketë emigruar atje nga Turqia jugore, ndërkohë që ka një migrim të njohur nga rajoni i Kurganit në malet Altai, që ndodhen në lindje të Azisë Qendrore; pjestarët e këtij migrimi mendohet të jenë paraardhësit e folësve të gjuhës "Tokariane", të cilët jetuan në zonën përgjatë Rrugës së Mëndafshit (Silk Road).


Dr. Atkinson tha se ky ishte një "argument në ajër" dhe se këto supozime duhet të gjykohen në mënyrë sasiore.

Dr. Anthony, duke vënë në dukje se as ai dhe as Dr. Atkinson nuk janë gjuhëtarë, thotë se *"të afërmit"* janë vetëm një element përbërës për rindërtimin e pemëve gjuhësore dhe se duhet të merren në konsideratë gjithashtu edhe ndryshimet gramatikore dhe zanore (tingujt). Dr. Anthony thotë se rindërtimi i Dr. Atkinsonit është "një karrike me një këmbë, kështu që, nuk është për t'u habitur, që pema, që ai ka krijuar, përmban grupime gjuhësore, të cilat nuk do të mund të mbijetonin, nëqoftëse ju do të përfshinit në këtë studim edhe ndryshimet morfologjike dhe zanore (tingujt)".

Në kundërpërgjigjen e tij, Dr. Atkinson thotë se ai në të vërtetë e ndërtoi simulimin e tij kompjuterik në një pemë të bazuar në gramatikë, hartuar nga Don Ringe, një ekspert për çështjet Indo-Europiane në Universitetin e Pensilvanisë; rezultonte që origjina të ishte përsëri Anatolia (Anadolli), dhe jo stepat Pontike.

Tracing the Origins of Indo-European Languages

A new study suggests that the sprawling Indo-European family of languages originated in Anatolia, or modern-day Turkey. Related Article »


Anatolian
Hittite
Luvian
Lycian
Tocharian
Tocharian
Armenian
Classical Armenian
Armenian
Greek
Ancient Greek
Greek
Albanian
Albanian
Indo-Iranian
Avestan
Wakhi
Ossetic
Old Persian
Waziri
Afghan
Baluchi
Kurdish
Persian
Tadzik
Vedic Sanskrit
Romani
Singhalese
Kashmiri
Nepali
Bengali
Oriya
Sindhi
Marwari
Marathi
Gujarati
Bihari
Hindi
Urdu
Lahnda
Balto-Slavic
Old Prussian
Lithuanian
Latvian
Slovenian
Old Church Slavonic
Serbo-Croatian
Macedonian
Bulgarian
Russian
Ukrainian
Belarusian
Polish
Lusatian
Slovak
Czech
Germanic
Gothic
Old Norse
Icelandic
Faroese
Danish
Riksmal
Swedish
ENGLISH
Old English
Frisian
Dutch
Flemish
Old High German
German
Luxembourgish

KAPITULLI 5

SHQIPJA DHE ARMENISHTJA MOTRA APO KUSHËRIRA?!

(Përmbledhje fjalësh të ngjashme)

Tambovcevi (Tambovtsev, 2003) theksoi,
se një qënie humane është në gjendje të perceptojë
nëse një gjuhë e caktuar mund të tingëllojë e ngjashme
me gjuhën e tij amtare,
pa arritur të kuptojë kuptimin (fq. 775),
dhe kjo është një perspektivë që haset rrallë të përdoret.

Vahan Setian

PËRMBAJTJA

1. Fjalori përmbledhës 349
2. Robert Ellis: "Fjalë Shqipe që kanë lidhje me gjuhën Armene" 381
3. Marika Butskhrikidze: "Studjuesja Gjeorgjiane: Ngjashmëri intriguese ndërmjet Shqipes dhe Armenishtes" 423
4. Hraç Martirosian 431
5. Berzh Piranjani "Fjalë Shqipe të ngjashme me ato Armene" 441
6. Vrojtime dhe Interpretime fjalësh të veçanta 453

PARATHËNIE

Ky shkrim, që në fakt do të ishte më e saktë të quhej një grumbullim fjalësh të ngjashme të gjuhës Shqipe me ato Armene dhe një përpjekje për t'i sistemuar ato, e ka zanafillën në fundin e viteve 80 dhe në fillim të viteve 90 të shekullit të kaluar, në atë periudhë kur jeta ekonomike shqiptare dukej sikur kishte filluar të qëndronte në vend, kur dukej sikur asgjë nuk lëvizte në jetën normale, dhe e vetmja mënyrë për të thyer monotoninë e jetës shoqërore ishte leximi i librave apo ndonjë aktivitet sportiv. Për moshën time, natyrisht, kjo e dyta ishte pak si e përpjetë, kështu që merret me mend se leximi do të zinte vendin kryesor në aktivitetin tim për të kaluar kohën e lirë, që në atë periudhë duhet thënë që e kisha me shumicë. Një ndër idetë, që më erdhi ndër mend asokohe dhe që m'u duk shumë interesante, ishte që ta shfrytëzoja kohën për të rifreskuar gjuhën Armene, gjuhë të cilën dikur në vegjëlinë time ma patën mësuar gjyshërit nga ana e tim eti dhe që me kohë, që nga vdekja e gjyshërve, nga mospërdorimi, pothuajse e kisha harruar. Për më tepër që në bibliotekën e tim eti kishte edhe një sasi librash të autorëve Armenë dhe në gjuhën Armene. Kjo ide m'u duk shumë interesante dhe propozonte një preokupim afatgjatë ashtu siç dukej se po e kërkonte koha.

Rifillova me Abetaren, studjova një gramatikë të vjetër, që gjeta në sirtarët e tim eti, dhe ja ku vendosa të lexoj. Libri i parë, që kapa dhe që m'u duk më interesant, ishte një libër historik, historia e

luftës së popullit Armen në vitet 450 të erës sonë kundër perandorisë Persiane që synonte ta nënshtronte. Historia bënte fjalë për një luftë në vetmbrojtje të pavarësisë së popullit Armen nën udhëheqjen e udhëheqësit legjendar Vaçakan, luftë në të cilën ky i fundit vritet, por që në finale pati si përfundim një marrëveshje paqeje ndërmjet dy vendeve, nëpërmjet së cilës garantohej pavarësia e popullit Armen. Një lloj historie e ngjashme me "Historia e Skënderbeut" të shkruajtur nga Fan Noli.

Çuditërisht, gjatë kohës që lexoja, sa më tepër shkoja përpara aq më tepër më dukej se kjo gjuhë nuk ishte e panjohur për mua. Fillimisht e justifikova me faktin se kjo nuk kishte qenë e panjohur për mua, dhe se kisha të bëja me një rikthim të një kujtimi, që kishte qenë i depozituar prej kohësh në një kënd të harruar të trurit tim që nga vegjëlia e hershme. Dhe kjo ishte e vërtetë, pasi edhe vetë një pjesë e fjalëve më rikujtoheshin me theksimin e bërë nga gjyshja apo gjyshi im.

Por ajo që më bënte më tepër përshtypje ishte fakti se në atë libër hasa edhe në shumë fjalë, që ngjasonin në mënyrë të habitshme me fjalët e gjuhës Shqipe, si në shqiptim ashtu edhe në kuptim; po përmend dy-tre prej tyre: girxh për gërxh, im për im, ajn për ai, ajo, etj.

Dhe atëhere më erdhi ndër mend një kujtim interesant, tepër i harruar për momentin, por që pastaj më rrihte gjithë kohës si çekan mbi kokë, sa më tepër zhytesha në botën e shkrimit Armen.

Ne banonim në të njëjtën hyrje me gjyshin dhe gjyshen nga ana e babait. Në raste të grumbullimeve familjare me miq të familjes, ata të dy në përgjithësi nuk ishin të pranishëm, me përjashtim të rasteve kur bëhej fjalë për njerëz që i njihnin mirë dhe prania e të cilëve u jepte kënaqësi. Më tepër shfaqeshin për të respektuar miqtë dhe pastaj mbylleshin në dhomën e tyre, pasi edhe shqipen nuk kishin arritur ta kuptonin dhe flisnin mirë. Në raste të veçanta, kur i ngjiste ambienti, gjyshi qëndronte më gjatë, dhe herë pas here i

kërkonte tim eti t'i përkthente apo sqaronte ndonjë moment që i dukej interesant.

Në një nga këto raste, në të cilat qëllova të isha i pranishëm, dëgjoj gjyshin që i thotë tim eti armenisht me zë të ulët, teksa dëgjonte miqtë që flisnin shqip: "çudi e madhe; i dëgjoj teksa flasin dhe më duket sikur i kuptoj, por në fakt nuk kuptoj asgjë nga ato që thonë."

Të njëjtën ndjenjë fillova të përjetoja edhe unë ndërkohë që lexoja atë libër. Lexoja dhe më dukej e lehtë, por nuk mund të bëja dot përpara pa ndihmën e fjalorit. Aty më lindi ideja që të hedh në një bllok të vogël këto lloj fjalësh, të cilat më dukeshin të njohura, por të cilave nuk u a dija kuptimin, dhe që vetëm pas përkthimit vija re që afëria në shqiptim rezultonte shpesh e tillë edhe në kuptim.

Këtë gjë e përsërita edhe me librat e tjerë, që lexova më pas, por thjesht në mënyrë mekanike, pa ndonjë qëllim të përcaktuar, përveçse si një kuriozitet.

Kjo gjë vazhdoi deri aty nga fillimi i vitit 1993, pas së cilës filloi një jetë intensive e zënë me punë dhe probleme të tjera familjare, e cila nuk linte kohë të lirë për t'u marrë me aktivitete, të cilat nuk i shërbenin interesave të ngushta thjesht ekonomike e familjare.

Afro 20 vjet më pas, aty rreth vitit 2012, mënyra ime e jetesës kishte marrë një tjetër rrjedhë; tashmë kisha më tepër kohë të lirë.

Instiktivisht m'u rizgjua interesi i dikurshëm.

Dhe duke nxjerrë nga sirtarët dhe raftet e librave materialet me të cilat isha marrë dikur, më lindi një ide joshëse; po sikur me të gjitha ato fjalë e shënime të nxjerra përgjatë kohës të bëja një fjalorth të vogël Armenisht-Shqip. Në mos shërbeftë për gjë tjetër, të paktën te mbetet si kuriozitet!

Megjithatë, para se t'i hyja kësaj pune, shkova në Bibliotekën Kombëtare, që të sigurohesha, që një material i tillë nuk ndodhesh aty, pasi nuk do t'ja vlente një lodhje e kotë. Dhe pasi u binda për realitetin që ekzistonte aty, fillova këtë punë, e cila të them të drejtën

më zgjati rreth një vit. Kjo punë e parë ishte tepër e lodhshme por edhe tepër tërheqëse; e lodhshme sepse po ecja në një terren të panjohur dhe për këtë arsye shumë ngadalë, dhe nga ana tjetër tepër tërheqëse pikërisht sepse ishte një rrugëtim interesant nëpër të panjohurën. Dhe përveç kësaj, më largonte vëmendjen nga një realitet shoqëror depresiv e tepër monoton.

Realizimi i botimit të tij, që nuk ishte tjetër veçse një libërth i vockël, një fjalorth Armenisht – Shqip me rreth 2000 fjalë, më dhuroi një kënaqësi të rallë, shijen e së cilës e ndjej edhe sot.

Ky moment shënoi fillimin e një rrugëtimi të pandalshëm drejt një aventure interesante, gërmimit në të kaluarën e largët Dhe ashtu, siç tërhiqen fëmijët nga filmat me dinosaurët parahistorikë, ashtu më tërhoqën edhe mua shkrimet mbi historinë e lashtë njerëzore, mbi mënyrën e tyre të jetesës, mbi mënyrën e komunikimit ndërmjet tyre, dhe shumë kuriozitete të tjera që të tërhiqnin sa më shumë zhyteshe në këtë fushë.

Interneti, librat e reklamuar në Amazon, etj. hapën horizonte të shumta vështrimi dhe njohjeje.

Dhe pa dashur, një ditë fare rastësisht, dhe në një libër fare rastësisht, lexova një shprehje:

"Tambovcevi (Tambovtsev, 2003) theksoi, se një qënie humane është në gjendje të perceptojë nëse një gjuhë e caktuar mund të tingëllojë e ngjashme me gjuhën e tij amtare, pa arritur të kuptojë kuptimin (fq. 775), dhe kjo është një perspektivë që haset rrallë të përdoret."

(Nxjerrë nga libri: Vahan Setian: "Armenian origins of Basque", 2017, Fq. 60)

Pikërisht, kjo shprehje më riktheu shumë e shumë vite pas në kohë, duke më rikujtuar atë ndjesi që kisha përjetuar teksa merresha me lexime në gjuhën Armene, ndjesi që papritmas e gjeta të formuluar e të shprehur në mënyrën e vet më domethënëse.

Përputhej pikë për pikë me atë që kishte dashur të shprehë im gjysh shumë vite më parë.

Dhe vendosa.

Ajo që kisha lexuar për historinë pellazgjike të popullit shqiptar, për gjuhën shqipe si gjuhë nga më të vjetrat e degës Indo-Europiane të gjuhëve dhe pasardhëse direkte e gjuhës pellazgjike, ajo që kisha lexuar për ngjashmërinë e saj, krahas të tjerave, edhe me gjuhën Armene, eksperienca ime personale në këtë fushë, më bindën se midis Shqipes dhe Armenishtes kishte më shumë afëri nga sa prezantonin, për më tepër, ata që nuk kishin asnjerën prej tyre gjuhë amtare.

Do desha të theksoj dy momente nga më të rëndësishmet, që ndikuan në lindjen e kësaj krijese në formën, që po shfaqet sot:

I pari, që është edhe i pari në rradhë kohore, ka të bëjë me një takim të organizuar me studjuesen me origjinë Gjeorgjiane, Marika Butskhrikidze, në Prishtinë, e cila më habiti me faktin, që edhe duke mos pasur asnjerën prej tyre gjuhë amtare, kishte dalluar ngjashmëri midis tyre, i kishte studjuar ato dhe ndërkohë e ndiqte me interes këtë çështje.

Për të dytin duhet falenderuar zhvillimi i teknologjisë informative, i cili më mundësoi rënien në kontakt me veprën e Robert Ellis "Armenian origin of Etruscans" London, 1861.

Të dy këto momente, më forcuan akoma më tepër bindjen se nuk kisha të bëja me një ndjesi, por me një realitet që e kishin parë edhe të tjerë shumë kohë para meje dhe vazhdonin ta shihnin edhe bashkëkohas të mi.

U përpoqa t'i analizoj duke i bërë pjesë të kësaj përmbledhjeje, dhe mendoj se në këtë mënyrë u kam shprehur falenderimet dhe konsideratën time më të lartë për veprën e tyre.

Duke i qenë mirënjohës gjithë atyre që kanë punuar e vazhdojnë të punojnë në këtë drejtim, duke pasur konsideratën më të lartë edhe

për formimin e tyre profesional, të shprehur në vepra me vlerë të konsiderueshme njohëse shkencore, duke respektuar edhe kohën time të vyer kushtuar kësaj çështjeje, duke shprehur vlerësimin tim më të lartë për të gjithë ata, që kontribuan me veprat e tyre në shtytjen që mora për të hedhur në letër gjithë sa më poshtë do të vijojë, shpreh bindjen, se koha do tregojë se ndërmjet Shqipes dhe Armenishtes ka aq shumë ngjashmëri, sa do të jetë e vështirë të dallohet se kush është motra e madhe dhe kush e vogla, në mos qofshin binjake.

Berzh Piranjani

P.S.

"Zhvillimi shumë i vonshëm i Shqipes së shkruar përbën sa fatkeqësi ashtu edhe një mrekulli, si për vetë popullin shqiptar, ashtu edhe për mbarë qytetërimin, të paktën, atij Europian.

Përbën fatkeqësi pasi la në errësirën e harresës një komb dhe një gjuhë për një kohë të gjatë, duke i mohuar qytetërimit një mundësi më tepër zhvillimi dhe nga ana tjetër një mrekulli, pasi në errësirën e harresës, ndën pluhurin e kohërave të dhunshme, ruajtën të pacënuar një komb dhe një gjuhë të lashtë.

Një diamant mbase, që po të pastrohet me kujdes, do të pasqyrojë aq dritë sa të mposhtte errësirën, që rrethon atë pjesë të hapësirës historike Europiane lidhur me formimin e kombeve dhe gjuhëve Europiane"

FJALORI PËRMBLEDHËS

(Fjalë të gjuhës Shqipe të ngjashme me ato të gjuhës Armene)

Shqip	**Armenisht**
a (dial.) (është, eshtë, asht)	*Է* (e) = është
acar (ftohtë, cingërrimë)	*սառ* (sarr) = ngricë, ftohtë, i akullt
acar (ftohtë, cingërrimë)	*գուրտ* (curt, curd) = ftohtë
afër [(1)]	*հուպ* (hup, hub) = afër, i ardhshëm
	հպարտ (hpavor, hbavor) = prekje, takim
	հպում (hpum, hbum) = afrim, takim
ago [(1)] (Zot) ???	*ոգի* (vogi, voki) = shpirt
	հոգի (hogi, hoki) = shpirt
	օդի (oghi, ohi) = raki, spirit
ag, agim: agon	*ակ* (ak, ag) = burim, fillim; gur i çmuar
ahur [(1)] (haur)	*ախոռ* (ahor) = stallë kafshësh shtëpiake
ai, ay [(1)]	(*Shënim BP:* kjo e dyta mbase është edhe – **Aj** – që vazhdon të përdoret në gjuhën e folur akoma edhe sot në veri të Shqipërisë, gjithmonë me kuptimin -Ai); [ai [(1)] (ay, aju, aj) - *այդ* (ajt) = ai] [ai [(1)] (ay, aju, aj) - *այն* (ajn) = ai]

ala, ala [1] – (shpejt, vrik) ???	*վաղ վաղ* (vah vah) = vrik, me shpejtësi, shpejt-shpejt
all, alle (ngjyrë kuq i ndezur)	*ալ* (al) = (ngjyrë kuq i ndezur, kuq ngjyrë alle)
	ալանալ (alanal) = skuqet, përflaket
alpin (i Alpeve)	*ալպյան* (alpjan, albjan) = alpin, malor
amëlë [1] (i ëmbël)	*համեղ* (hameh, hamegh) = i shijshëm
andej	*այնտեղ* (ajndeh, andeh) = andej
anë [1]	*ափ* (ap) = anë, breg, skaj
anije	*նավ* (nav) = anije
arë [1] (fushë bujqësore)	*արտ* (art, ard) = fushë
	վայր (vajr) = poshtë, vend, tokë
arë (tokë bujqësore)	*առ* (arr) = pjesa e dheut që ngrihet gjatë lërimit të tokës; plis
argjend	*արծաթ* (arcat, arxat) = argjend
argjilë [2]	*կավ* (kav; gav) = argjilë ???
ari [1] [2] (Arushë – ari femër)	*արջ* (arxh, arç) = ari
arixhi (arxhi)	*արջ* (arxh, arç) = ari (???)
arkë	*արկղ* (arkh; argh) = arkë
arnoj [1]	*առնել* (arrnel) = marr
azat (i lirë, i lëshuar (frerësh)	*ազատ* (azat, azad) = i lirë, i lëshuar (frerësh)
azgan (trim, i fuqishëm, vigan)	*ազգական* (azgakan, azkagan) = farefis, i afërm; soj, i fisëm
babagjysh	*պապ* (pap, bab) = gjysh, babagjysh
bakër	*պղինձ* (pëhinx, bëhinc) = bakër
bamje	*բամիա* (bamia, pamia) = bamje
ban (banet, bën, bëhet)	*բանել* (banel, panel) = bëj, punoj

ban* (banet, bën, bëhet) — *անել* (anel) = baj, bëj

bardhë (i,e) — *սպիտակ* (spitak, sbidag) = (i, e) bardhë, zbardhur

bark (pjesë e trupit të njeriut) — *պարկ* (park, barg) = thes, shportë, çantë

barth (1) (bardhë) — *բուռ* (burr, purr) = gips, shkumës

bathë — *բակլա* (bakla, pagla) = bathe

bats (1) (bacë) — *մատչելի* (matçeli, matçil) = i pranueshëm

բաց (bac, pac) = i hapur

bëj, baj, bani (1) — *բայ* (baj, paj) = folje; vepror

բան (ban, pan) = gjë, send

beli (1) (bel, lopatë) — *պեհել* (pehel, behel) = gërmoj

bën (bënet bëhet) — *ընել* (ënel) = me bë

bërtas (thërras) — *պոռալ* (porral, borral) = bërtas, klith (brohoras)

bir (djalë) — *որդի* (vorti) = bir, djalë

bjere* (sille) — *բեր* (ber, per) = bjere, sille (mënyra urdhërore) (barte!)

bletëz (3) — *մեղու* (meghu, mehu) = bletë

botë (3) — *աշխարհ* (ashk'harh, ashhark) = botë

bredh (3) (endem, sorollatem) — *թափառել* (t'hap'harrel, taparrel) = endem, sorollatem

bredh (3)* (pemë) — *եղևնի, եղեվնի* (jeghevni, jehevni) = pemë

brohoras (thërras) — *պոռալ* (porral, borral) = bërtas, klith (brohoras)

bronz — *բրոնզ* (bronz, pronz) = bakër

buf — *բու* (bu, pu) = buf

bukë (1) (Shih R. Ellis, fq 15) — *հաց* (hac) = bukë ???

bukhar (1) (oxhak, vatër ngohjeje) — *բուխարի* (buhari, puhari) = këndi oxhaku, sergjen mbi oxhak

bukuroshe (hyri, peri) — *հուրի* (huri, hyri) = bukuroshe, hyri, peri

burim [2]	*աղբյուր* (aghpju'r, ahpju'r] = burim
byrazer	*եղբայր* (jehbajr, jehpajr, jeghpajr) = vëlla
carac (pemë me ... F.GJ.SH.)	*ցարասի* (carasi) = mështeknë
cerlë [1] (Cirlë -lloj zogu si mullenja)	*սարեկ* (sarek, sareg) = gargull, tushë
	սարեակ (sarjak, sarjag) = gargull, tushë
cicë [1] (sisë)	*ծոց* (xoc) = gji, kraharor
cicë (sisë, gji)	*ծիծ* (cic, xix) = sisë, gji (gjoks gruaje)
	ստինք (sdink, stink) = gjinjtë
cik (cik më cik, plot e përplot)	*ձիգ* (cig, cik) = tendosur; ngushtë
cingërë [1] (cingërimë)	*ձյուն* (cjun) = borë
	ձմեռ (cmerr) = dimër
	ցուրտ (curt, curd) = ftohtë
cinguli [1] (Cingëll - lloj fiku i vogël)	*թուզ* (tuz) = fik
	թզենի (tceni) = pemë fiku
cohë [1]	*չուխա* (çuha) = cohë e leshtë
cucla [2] (kapëz, biberon) cuc	*ծուծ* (cuc; xux) = palcë ???
cung [2] *	*ծունկ* (cunk, xung) = gju, gjuri
culë [1] (fyell, pipe)	*սուլել* (sulel) = fishkëllej, vërshëllej
çap [1] (hap)	*չափ* (çap) = masë, dozë; hap (hapi i ecjes)
çark [1] (qark, rreth)	*շուրջ* (shurçxh, shurç) = rreth, afro, përqark, afërsisht
	շրջան (shërxhan, shërçan) = rreth, qark, periudhë kohore
çart (përçart, shkallim, kllapi)	*ջարդ* (xhart, çart) = prishje, shkatërrim
çartoj (shkalloj, prishem menç)	*ջարդել* (xhartel, çartel) = prish, shkatërroj
çartun (i çartun, i shkalluar)	*ջարդված* (xhart, çart) = i prishur, shkatërruar, i dalë mendsh

çbëj (shbaj, …..F.GJ.SH.) — *սպանել* (spanel, sbanel) = vras, asgjësoj

çfarë ka? (ç'ka?) — *ինչ կա* (inç ka, inç ga) = çfarë ka? Ç'ka?

çiban — *չիբան* (çiban, çipan) = çiban

çik (një çikë, pak) — *քիչ* (k^{h}iç) = një çikë, pak
քիչիկ (k^{h}içik, k^{h}içig) = një çikë, pak (forma zvogëluese)

çikë [1] (pak) — *սակավ* (sakav, sagav) = i pakët, pak

çikë * (vajzë, gocë) — *աղջիկ* (ahçik, ahçig) = çikë, vajzë

çikorre (rradhiqe) — *ցիկորի* (cikori, cigori) = çikorre, rradhiqe

çmim (vlerë) — *գին* (gin, kin) = çmim

çoban — *չոբան* (çoban, çopan) = çoban

çurg (çurk uji, lëngu) — *ջուր* (xhur, çur) = ujë

dadë (nanë - F.GJ.SH.) — *տատ* (tat, dad) = gjyshe, nanë

dado (kujdestare fëmijësh) — *տատ* (tat, dad) = gjyshe

dafinë — *դափնի* (dapni, tapni) = dafinë

dal [3] — *դուրս գալ* (turs gal, turs kal) = dal

dal [3]* — *գալ* (gal, kal) = vij, arrij

dal [3]* — *գնալ* (gnal, knal) = dal, shkoj, iki

dal [3]* — *ելնել* (jelnel) = dal

dardhë — *տանձ* (tanx, danc) = dardhë

deki [1] — *դավ* (dav, tav) = mashtrim
դավանել (davanel, tavanel) = mashtroj

dele [3] — *ոչխար* (voçk'har, voçhar) = dele

dell [3] (nerv) — *ջիղ* (xhigh, xhih, çigh, çih) = nerv

dell [3]* (tejzë, tendinë) — *ջիլ* (xhil, çil) = tejzë, tendinë

dënoj — *տանջել* (tanxhel, dançel) = mundoj, torturoj, dënoj, ndëshkoj

derë	*դուռ* (dur, tur) = derë
derë, durë (1) (3)	*դուռ* (durr, turr) = derë
derr (në kuptimin; i fortë, kryeneç)	*տէր* (ter, der) = zotëri, zotërues, zot, pronar
des (1) (vdes); i dekuri	*դի* (di, ti) = kufomë, trup i pajetë, kërmë *դիակ* (diak, tiag) = kufomë, i pajetë, kërmë
det (3)	*ծով* (cov, xov) = det
dhallë (1) (3)	*թան* (tan) = qumësht i skremuar, dhallë
dhallë (3)*	*սերքաշ* (serkash) = dhallë
dham, dhëmb (1)	*ատամ* (adam, atam) = dhëmb
dhanë (me dhanë) (2) *tam*	*տամ* (tam, dam) = jap *տալ* (tal, dal) = me dhanë
dhe (vend, dheu)	*տեղ* (degh, deh) = vend; tokë; dhe, përdhe
dhelpër (2) ałuēs	*աղվես* (aghve's, ahve's) = dhelpër
dhembë (dhëmb) (2) atamn	*ատամ* (atam, adam) = dhëmb
dhëmpës ??? (1) (Dhëmbës – rrashqelë, grabuja)	*դիմել* (dimel, timel) = i drejtohem dikujt
dherë, derë (1) (i hidhur, i thartë)	*դառը* (darrë, tarrë) = i hidhur, thartë
dhi (1)	*տիկ* (tik, dig) = lëkurë dhie *այծ* (ajc, ajx) = dhia
dhi (3)	*այծ* (ajc, ajx) = dhia *նոխազ* (nok'haz, nohaz) = dhi
dhi (3)*	*նոխազ* (nok'haz, nohaz) = dhi
dhje (3)	*ամոթ* (amot'h, amot) = mut, turp
dhjetë (3)	*տասը* (tasë, dasë) = dhjetë
dijetar (i mësuar)	*ասեալ* (usja'l) = i ditur, i mësuar
dimën, dimër (1)	*ձմեռ* (xmerr, cmerr) = dimër
ditë (1)	*տիւ* (tiv) ditë; or (or) = ditë
djalë	*տղա* (dëha, dëgha) = djalë

djathë (3) — *պանիր* (panir, banir) = djathë (ban hir – bën hirë)

djeg — *տաք* (tak, dak) = i nxehtë, i ngrohtë

djersë (3) — *քրտինք* (k^{h}ërtink'h, k^{h}ërdink) = djersë

dorë (1) (3) — *ձեռք* (xerk^{h}, cerk^{h}) = dorë

dori' (kalë qimekuq) — *ջորի* (xhori, çori) = mushkë

dredh (3) — *խուճուճել* (k'huçuçel, huxhuxhel)

"….. Për të, përgjithësisht, pellazgjishtja dhe helenikja janë të shkrira kaq ngushtësisht, sa njera mund të ndahet vetëm në kurriz të tjetrës dhe ai pohon se ndodhet në pozitën e atyre, për të cilët pellazgët janë të pakapshëm, sepse sa më shumë prova gjenden për ta, aq më shumë davariten helenët, aq më e errët bëhet pyetja: Kush ishin ata? Dhe nga erdhën? Gati-gati duket sikur vetë Herodoti këto pyetje ka bërë, kur thotë: " e ndarë nga pellazgjishtja dhe në vetvete e dobët është dega Helene; nga fillesa të vogla, falë vërshimeve të fiseve të shumta barbare, ajo më vonë u bë një masë e madhe popujsh. Përkundrazi, për mendimin tim, populli pellazg, si një popull barbar, nuk ka njohur kurrë ndonjë rritje të ndjeshme." (Fq. 8)

Zakonisht Ana Perenna[171] asht hyjnesha e vitit hanor të romakëve. Gojdhana thotë se ajo ka qenë e bija e Belit, e motra e Didos. (Fq. 322):

Shënim B.P.:

Vrojtim 1:

a. bija e Belit – për cilin Bel e ka fjalën ??

b. Shumë interesante asht lidhja e Anës me Enean, … – do të thotë që kanë qenë bashkëkohas; (n.q.s. bëhet fjalë për Bel Nimrodin e "Legjendës së Hajkut dhe Belit", të kihet parasysh që ndërkohë beteja ndërmjet Hajkut dhe Bel Nimrodit e vitit 2492 p.e.s. dhe luftës së Trojës e viteve 1194 -1184 p.e.s. tregon një distancë kohore prej afro 1300 vjetësh)

53. Pellazgët. Ke fjala Pellazgos ndajmë pel-asgos dhe ke fjala pel vemë fjalën greqishte pelos, pelios, peleios = i zi dhe latinishten pellos = i zi. Tingulli s në fjalën asgos bahet r (pelargos, pelarge) dhe fjala argos për ne asht fjala pellazge për "arë, agros, ager", në të cilën shfaqet r e lëvizshme. Prandaj ne fjalën "pellazgos" e përkthejmë "ai që i takon dheut të zi"[250], këtë na e tregojnë edhe vargjet që gjejmë tek Pausania[251]:

(...Shënim B.P.: më poshtë jepen dy vargje greqisht...)

në të cilat ne nuk shohim thjesht një legjendë, por edhe etimologjinë e fjalës.

Dheu i zi krijohet në mal; përrenjt dhe lumenjt e sjellin atë tëposhtë dhe aty ku dheu ze vend banojnë pellazgët, d.m.th. ata që punojnë arat me dhe të zi (μελάγγάιοι) dhe (τό πελάσγικόν) asht toka e dheut të zi, që nuk i shpëtoi vështrimit të mprehtë të Strabonit, ...[252] (Fq. 331-332)

JANI VRETO:

“VEPRA TË ZGJEDHURA”

Mbledhur dhe përgatitur nga Alfred Uçi

Shtypshkronja “8 Nëntori”, Tiranë, 1973

Përveç kësaj, në gjuhën shqipe është ruajtur dhe përdoret edhe emri pelazgos, pëlak, plak (këtej vjen fjala pelag, e cila me futjen e s -së midis a -së dhe g -së, u bë pelasg, siç ndodh p.sh. me foljen greke migo-misgo, dhe me prapashtesën os fjala pelasg bëhet pelasgos) që do të thotë njeri i vjetër, i lashtë. (Fq. 211)

Gjithë gojëdhanat mitologjike e të dyshimta provojnë ekzistencën e fiseve dhe dialekteve të afërta midis tyre, që përmblidheshin nën emrin e pellazgëve. Nga këto, një pjesë, që u përzie me kolonë të qytetëruar të ardhur nga Egjypti e Finikia, dhe që shkroi e kultivoi dialektin e vet, u ndriçua, u qytetërua e u quajt komb Grek. (Fq. 217)

Shënim B.P.: (Marrë nga artikulli “Apollogjia”, me nëntitull “Apologjia kundër artikullit ‘Epiri, djep i helenizmit, Shqipëri!!!’ “) (shih Fq. 175-228)

EDUARD SHNAIDER (SCHNEIDER):

"PELLAZGËT E PASARDHËSIT E TYRE"

Përkthyer e paraqitur nga Lek Pervizi

Botuar nga I.H.P.V.K.A, Tiranë, 2009

Duke e kërkuar etimologjinë e fjalës Pellasg, ne e shikojmë se me këtë emër Grekët përcaktonin banorët e largët të detit[2]. Shqiptarët në gjuhën e tyre e përkthejnë atë fjalë me, banorët e pyllit, nga Pell për pyll dhe gjin për njerëz (gjind).

Pellasgët pra na ishin Pyllgjin, nga ku, Pellasgët, banorë të pyjeve, d.m.th., njeriu që i parapriu banorët e shpellave, Trogloditët. (fq. 37-38)

[1] *Shënim E. Shnaider:* Teoria e jonë është e kundërt. Pellasgët mbetën si populli më i vjetër autokton e proto-europian, që u dukën së pari në Europën perëndimore: Francë, Gjermani, Spanjë, dhe zbritën poshtë në epokën e akullnajave, në vende më të ngrohta: Itali, Ballkan, Arçipelag Azi e Vogël, Mesopotami dhe në gjithë pellgun mesdhetar. Kurse termi "barbar" që përdor autori, duhet kuptuar për "i huaj" dhe jo "i egër". Helenët, "barbarë" quanin "të huajt". (fq. 37)

[2] *Shënim E. Shnaider::* Pellasgët, të quajtur nga helenët Pelasgoi, Pelagoi, Pelargoi, lidhen me etimologjinë Shqipe, "prej detit" (pellg), "prej së largu", emër që nuk ka lidhje fare me gjuhën Greke. (fq. 38)

SIR PATRICK COLQUHOUN & VASO PASHA

"PELLAZGËT. PASARDHËSIT E TYRE TË SOTËM DHE ORIGJINA PELLAZGE E POEMAVE TË HOMERIT"

Botime Artini, Prishtinë, 2017

Teoria, që pranohet më gjerësisht nga etnologët e sotëm, e nxjerr prejardhjen e fisit të Pellazgëve, përveç qendrës së tyre më të lashtë, nga zona malore e Armenisë : ajo pjesë që del në detin Kaspik dhe kufizohet nga Kaukazi, sot Dagestani (banesë e maleve) dhe Shirvani, "Shqipëria e hershme"[1]. (fq. 33)

[1] *Shënim B.P.:* Mendoj se me emërtimin "Shqipëria e hershme" përkthyesi apo ndoshta vetë autori ka pasur ndërmend vendin e quajtur në kohët e hershme "Albania e Kaukazit" (fq. 33)

Po kështu emri "Pellazg" duket se ka qenë emërtimi Grek për Shqiptarët. Janë sugjeruar shumë prejardhje: por ndonëse këto kanë baza në Greqishte, nuk kanë asnjë bazë në Shqipe. Në fakt, nuk ka asnjë bazë të arsyeshme në Greqishte. Fjala mund të jetë ndoshta një version i korruptuar i Palesta. Por nëqoftëse do të kërkohet ndonjë prejardhje nga Greqishtja, ka shumë të ngjarë që kjo të jetë fjala Πελασ – fqinjë ; dhe ky emërtim daton që nga krijimi i kolonive të një race tjetër (për të cilat, megjithatë, nuk ka asnjë gjurmë) në Pellazgji. (fq. 59)

Prejardhja e fjalës duhet të kërkohet ndoshta në ndonjë fjalë të përafërt Sanskrite. (fq. 60)

SPIRO KONDA

"SHQIPTARËT DHE PROBLEMI PELLAZGJIK"

Uegen 2011,
(Botimi i parë : Tiranë 1964)

...pamë se kjo botë e perëndivet të Pellasgëvet, si kuptim esencial ka dhe shpreh: "i dhelindur". Kuptimin e dheut, si nënë e të gjithavet, nga e cila lindin, ushqehen dhe mbahen të gjitha. Kjo fuqi jetëdhënëse e Dheut Nënë na solli në atë etapë, e cila mban emrin "Pellasg". Me fjalë të tjera, emri "Pellasg", etimologjia dhe shpjegimi i të cilit bëhet drejt vetëm me anë të gjuhës shqipe, shpjegon dhe përmban kuptimin themelor të fjalës "i dhelindur", lidhur me pellasgët. (S.K. fq. 437)

Duke cituar Louis Benlow, Spiro Konda, vazhdon: "Fjala "Pellasg", pra, s'mund të ishte gjë tjetër veçse përkthimi i një emri të përgjithshëm (apelativ) shqip, që u kthye në një emër të përveçëm. Emri "Pelishtim", të cilin e përdorin çifutët e Lindjes për të treguar shqiptarët nuk do të ishte gjithaqë tjetër gjë veçse po ajo fjalë (Pellasg) e deformuar, ose në daç më mirë, e transformuar në bazë kombinimesh historike shumë a pak të gabuara. (S.K. Fq. 441)

Duke cituar D. Olimpi, Spiro Konda, vazhdon: D. Olimpi, në ("Fjalorin Homerik", përkthim nga gjermanishtja, Athinë, viti 1900, faqe 250), përmend këto: "Fjala Pellasg konsiderohet fjalë aziatike. (S.K. Fq. 446-447)

Dhe tani po kalojmë në etimologjinë dhe shpjegimin e fjalës Pelazg (greqisht: Pelasgos = Πελασγός)

Siç u tha, fjala Pelasgos, po të hiqet mbaresa greke "os", përbëhet nga "tri fjalë më vete", të cilat përmbahen në: "Pelasg". Këto të tri fjalë, d.m.th. Pel-as-g, formojnë një fjali të mbaruar (duke u kuptuar kryefjala nga konteksti) e cila e ka shprehur foljen: as=jam, predikatin "pel" (d.m.th. i lindur) dhe dhanoren "ga" (..), d.m.th. dhanoren e vepronjësit (agjentit). Kjo fjali, fjalë për fjalë është: Pel-as-gai = πελ–ασ-γά (gai - në sintezën e fjalisë bëhet –g).

...

Dhe meqënëse fjala Pelasg është sintezë e fjalisë: "Pel-as-gai" në një fjalë, kuptimi i saj është i plotë, i njëjtë me atë të fjalisë. D.m.th.:

a) Pelasg = lindur jam (je, është) prej dheut

b) Pelasgë = lindur jemi (jeni, janë) prej dheut

c) Spiro Konda (Fq. 458-459)

Shënim B.P.: (Nga Spiro Konda) Në PJESA E TRETË, LIBRI I DYMBËDHJETË, KAPITULLI I PARË, fq. 439 – 450, ndodhet shkrimi i titulluar "Mendimet që janë çfaqur rreth pellasgëvet prej dijetarëve të ndryshëm (historianë, arkeologë, gjuhëtarë, etj.) që nga kohët e vjetra dhe gjer më sot."

Në të përmbahen citime nga autorë të ndryshëm me emër në fushën e historisë, arkeologjisë, gjuhësisë, etj., citime të cilat hedhin dritë mbi opinionin e tyre rreth problemit "Pellasgjik", ndërmjet të tjerëve: Herodoti, Thuqidhidhi, Straboni, etj.

Mendoj se është një kapitull me shumë interes për t'u lexuar për këdo, që është i interesuar të hulumtojë në sferën e gjuhësisë Indo-Europiane, apo në prejardhjen e popullit Shqiptar.

NERMIN VLORA FALASKI

"PELLAZGËT, ILIRËT, ETRUSKËT, SHQIPTARËT"

Shtëpia Botuese "Faik Konica", Prishtinë
(Me një parathënie të Prof. Dr. Skënder Rizaj, Korrik 1998, Prishtinë.)

Autorë të ndryshëm kanë shkrojtur mbi Pellazgët e shpesh me teorira kontradiktore. Vetëm në një pikë opinioni i tyre ka qenë i njëzëri: në të mohuar çfardolloj afërsie gjenetike midis Pellazgëve dhe popujve Helenikë ardhur më vonë. Tashmë është vërtetuar se Pellazgët ishin autoktonë dhe Grekët imigrantë.

Herodoti, at i historisë, na jep lajme shumë interesante. Ai rrojti në shekullin VI[të] para Krishtit, kur shkrimi ishte konsoliduar, prandaj rrëfimet e tij janë interesante:

"Grekët mësuan nga Pellazgët artin e punimit të bronzit, të themelimit të qyteteve dhe fortifikimeve". Akoma sot, muret e ngritur me masa të mëdhaja guri quhen: "muret pelazgjike".

Në këtë përmasë Herodoti informon se Pellazgët e ngritën murin rrethues t'Akropolit t'Athinës e se Grekët morën prej tyre mitet e perënditë dhe se në kohërat e lashta Greqia quhej Pellazgji. (Fq. 47-48)

Shënim B.P.: Vrojtim 2:

N.q.s pranojmë të vërtetë pohimin e Herodotit lidhur me artin e punimit të Bronzit, shtrohet pyetja: përse përmendet arti i punimit të Bronzit dhe jo edhe ai i punimit të Hekurit, kur dihet që

në periudhën e hamendësuar nga Herodoti për ardhjen e grekëve, pellazgët e kishin të zhvilluar artin e punimit të hekurit, i cili kishte sjellë risi në çdo sferë të zhvillimit të jetës shoqërore, sidomos në artin luftarak!?

1. Ne shqiptarët e dimë, se "pellg" do të thotë ujë i thellë, nga ku vjen shprehja popullore: "U bënë rrugët pellg", ku shiu i fortë i mbush gropat e udhave me ujë. (Fq. 274)

...mund edhe të pranohet hipoteza se Pellazgët mund të kenë zbritur nga Veriu në Mesdhe.

Nga ana tjetër, emri i tyre ka lidhje edhe me namin që ata kishin si lundrues të aftë. Në shqipen e sotme, Pellazg ka lidhje me "pellgun"; "u bënë rrugët pellg" – thotë populli, kur bie shi me fërtymë dhe mbushen gropat me ujë. Pra, "pellg" – sinonim i ujit të thellë, dhe populli që lundron në ujëra të thella është populli Pellazgjik. (Fq. 442)

2. Mbi origjinën e Pellazgëve ka kryer studime të rëndësishme shkrimtari francez Robert d'Angely, i cili në veprën e tij "Les Pelasges" (Paris 1990) shkruan se forma primitive greke"pelargos" ishte me prejardhje nga Pellazgjishtja "pielharg", e cila në shqipen e sotme ka kuptimin e "pjelljes": (pjellje e bardhë); d'Angely e shpjegon këtë kështu: "pielh [b]ardh" (letra "b" konsiderohet si një epentesë e mëvonshme). Kështu, sipas teorisë së tij, kuptimi i kësaj fjale është: "lindur i bardhë".

Teza e Robert d'Angely mund të shpjegohet edhe me origjinën boreale të popujve të veriut, meqë baza e kësaj fjale është "bora" e pellazgëve, e cila mbijeton në Shqipen e sotme. Dhe sipas disa teorive të studjuesve të ndryshëm, pellazgët ndoshta u detyruan të zbresin në tokat e Mesdheut, nga shkaku i ndryshimit të aksit të Globit. (Fq. 442)

ARISTIDH P. KOLA

"ARVANITASIT DHE PREJARDHJA E GREKËVE"

Përktheu nga origjinali: Aldior Agora

Shtëpia Botuese "55"
Tiranë, 2002

Legjendat dhe traditat e lashta, pohojnë se njerëzit e parë që banuan Greqinë ishin pellazgët. Greqia quhej më parë Pellazgioti ose Pellazgji dhe banorët e saj pellazgjiotë ose pellazgë (shih Herodotin, A 56,57, -B 171, etj.) (Fq. 36)

Si popull më i lashtë i Greqisë përmenden Arkadet, që, sipas hipotezash të cilat i them i rezervuar, ishte populli që shpëtoi nga një përmbytje katastrofike, që kaloi në traditat Helene si "Përmbytja e Defklionës". Është e logjikshme që banorët e Arkadisë malësore të largoheshin prej krahinës pas një përmbytjeje të tillë.

Nga mitet, si mbret i popullit të lashtë akadian përmendet të ishte Pellazgu, i cili nuk mund të jetë bir njeriu, por perëndie. Është pra, Pellazgu, biri i Perëndisë dhe Tokës (i babait Diell dhe i nënës Tokë). (Fq. 37)

ETIMOLOGJIA E EMRIT KOMBËTAR "PELLAZG" (Fq. 50-51)

Do të përmend versionet kryesore për prejardhjen e emrit kombëtar "Pellazg".

Sipas një varianti, fjala "Pellazg", vjen nga fjala "Plasin" dhe "Pelago", sepse siç pohon (Shënim B.P.: kush??), pellazgët erdhën nga Pelagu. Fillimisht, askund nuk thuhet se erdhën nga Pelagu, por edhe po të ishte kështu, do të quheshin pelagë dhe jo pellazgë.

Mitropoliti bizantin, Evstathio, quan banorët e Azisë së Vogël si pellazgë. E nxjerr emrin e tyre nga Pelas Jis, që do të thotë "Tokë e afërt" dhe si të tillë e mendon Azinë e Vogël. Por edhe sikur ky version të ishte i saktë, përse Evstathio sheh si tokë të afërt Azinë e Vogël dhe jo Italinë ose akoma më pranë, Ilirinë?

Gjeografi i madh i lashtësisë, Stravoni, nxjerr fjalën "Pellazg" nga "pelarg", por që është emri i dytë i tyre, që u a kanë dhënë helenët dhe më saktë athinejtë.

Që Myleri e nxjerr prejardhjen nga fjala "Pelin" dhe "Argo" ku fjala "argo" është pellazge dhe do të thotë fushë, ndërsa i gjithë togfjalëshi ka kuptimin e atij që jeton nëpër fusha.

Homeri e quan Tesalinë "argo pellazg", që do të thotë fushë pellazge. Në Greqi ekziston fusha (Argo) e Thesprotisë e Peleponezit, etj.. Shqipja e ruan rrënjën e fjalës argo (ar-) dhe e përdor si "arë" që do të thotë fushë e mbjellur.

Profesor Saqelariu e gjykon etimologjinë e fjalës nga rrënjët indoevropiane Bhel=cel dhe Osqho=degë, bis. Është një version që u formua më 1958-ën dhe me ndryshime a me modifikime të gërmave nxjerr përfundimin se pellazg do të thotë "degë e çelur". Sigurisht që nuk ka se ku të mbështetet, por autori e arsyeton me faktin se pellazgët lidhen me përhapjen e ushqimit në Tokë. Por unë nuk shoh ndonjë lidhje të degës së çelur me pellazgët dhe të kësaj veçorie të tyre, e cila është një nga të shumtat dhe së fundi nuk përmendet diku, por del në bazë konkluzionesh. Pastaj, vetitë kryesore të pellazgëve janë heroizmi dhe braktisja e fushave, që ata shfrytëzonin për të siguruar ushqimin.

Kush, pra, është version më i saktë etimologjik?

Personalisht mendoj se, mendimi i Stravon-Myler është më i saktë, sepse mbulon si nga ana gjuhësore ashtu dhe nga ana kuptimore fjalën "Pellazg". D.m.th., Stravoni dhe Myleri kanë të njëjtën ide me atë të athinejve të lashtë. E nxjerrin prejardhjen e pellazgut nga "pelargu", që do të thotë lejlek në shqip (shën. i përkth.). Fjala pelarg del nga "Pelin" dhe "argo", siç pamë më lart dhe me të vërtetë lejlekut i pëlqejnë zonat fushore.

Lejleku ka dhe ngjashmëri të tjera me pellazgët. Jeton në toka fushore dhe moçalore. Pellazgët kanë të bëjnë me ndërtimin e veprave të mëdha kanalizuese dhe për ujitjen e zonave të mëdha si ajo e Kopadies.

Një veçori tjetër e ngjashme midis pellazgëve dhe lejlekëve është emigrimi. Aristofani në një komedi të tij thotë se pellazgët emigrojnë ashtu si lejlekët.

Një tjetër veti është dhe mbrojtja deri në sakrificë e prindërve të tyre. Aristoteli na tregon (historia e kafshëve 2, 9, 13.) se lejlekët e rinj i marrin më të moshuarit në shpatulla me qëllim që të emigrojnë. Kjo dashuri, detyrim, madje dhe respekt i dekretuar ndaj prindërve të tyre është dhe një nga elementët bazë të ideologjisë së helenëve të lashtë. E theksoj se në Greqi dashuria dhe respekti për prindërit ishte i caktuar me ligje, të cilat quheshin "Ligjet e Lejlekut" (Ligjet Pelarge). Pra ekzistojnë shumë fakte mbi etimologjinë e fjalës pellazg nga fjalët "pelin" dhe "argo" nga të cilat formohet pelargu. Fakti që helenët i quanin pellazgët, pelargë, e vërteton këtë version. (Fq. 50-51)

KRISTO FRASHËRI

"ETNOGJENEZA E SHQIPTARËVE"

Vështrim historik

botimet M&B, Tiranë 2013

Me sa dihet, për të parën herë në burimet historike, Pellazgët përmenden në marrëveshjen e paqes nënshkruar në Kadesh në vitin 1296 p.e.s. midis mbretit fitimtar të Hititëve Nurëatallish dhe faraonit të Egjiptit Ramses II. Marrëveshja është nënshkruar në dy gjuhë – në gjuhën Egjiptiane dhe Babilonase. Në këtë luftë përmenden si pjesëmarrës përkrah Hititëve edhe Pellazgët, të cilët në marrëveshjen e Kadeshit quheshin "njerëzit e detit". (fq. 58).

Samiu (e ka fjalën për Sami Frashërin; *Shënim B.P.*) mendonte se emri pelasxh ose pelasg, sic përmendet në disa burime antike, është një shpërbërje e fjalës plak, në kuptimin i vjetër, emër të cilin të rinjtë ua vënë të moshuarve. (fq. 89).

Ai shkruan tekstualisht:

"Më të vjetrit prindërit tanë bota i quajnë Pelazgë, fjal' e mbetur nga prindërit tanë më të pastajmë, të cilët quanin më të parët e tyre Plak e Pleq" (fq. 90).

ROBERT ELLIS

"ARMENIAN ORIGIN OF ETRUSCANS"

London, 1861

...; dhe emri i tyre Pelasgi, duke qenë se nuk gjen asnjë shpjegim nëpërmjet gjuhës Greke, është ndoshta Pellasg nga vetvetja (Robert Ellis, Kapitulli "Pellazgët, parag. 2, Fq. 176)

3. Pelasgus. Zakonisht kjo fjalë trajtohet kështu: pel – asgus.

"Batmani sugjeroi kohë më parë, që dy rrokjet e fundit ishin një përcaktim etnik, të lidhur me emrin asca – nius, shumë i përhapur në Frigi, Lidi dhe Bitnia, si edhe me vetë emrin e Azisë (Azia, Asia). Kjo rrënjë, as (az) – që supozohet të ekzistojë në As-ia, fare lehtë mund të identifikohet me rrënjën Armene – as – e cila shfaqet në as-g dhe az-n , dy fjalë këto, që përfaqësojnë fjalët "komb" dhe e dyta ndoshta ndoshta = "έθνος" (komb) në Greqisht. Ascanius mund të krahasohet me fjalën Armene"azgajin – kombëtar, i afërm". Për elementin e dytë të Pel-asg ne morëm, pra kështu, nga Armenishtja pjesën "azg – komb, racë, familje, tribu, njerëz, popull", një fjalë që unë pak më parë kisha supozuar se hynte në formacionin e fjalës Etruske Matulnask, Matulnian me kuptimin "gens or familia – farefis ose familje".

Tashmë ngelet të përcaktojmë pjesën Pel-. Tani, çfarë race (azg) janë Pel-asgi? Ata janë racë e vjetër, autoktonë, apo banorë

të lashtë, të Greqisë dhe të vendeve nga veriu. Kjo na çon neve të bëjmë lidhjen e Pel- me fjalën Armene “vagh, vah – i hershëm, i vjetër = Greqishten “παλαιός” (i vjetër) = Epirot πέλιός, = Alb (gjuhën Shqipen) “pliak – plak”. Kuptimi old race = vagh-azg = racë e vjetër duket si përcaktimi më i mirë që mund t’i jepet emrit Pel-asgi. Strabo (p. 220) thotë për Pellasgët, që ka qenë një e njohur universale, (ότι μέν άρχαίον τι φϋλον κατά τήν Ελλάδα πάσαν έπεπόλασε); dhe përsëri (p. 327), (οί δέ Πελασγοί τών περί τήν Ελλάδα δυναστευσάντων άρχαιοτατοι λέγονται). Dionisi (lib. i. c. 17) flet për Pellasgët si (αύτόχθονες, ώς οί πολλοί περί αύτών λέγονσι - autoktone, siç thoshin shumë prej tyre); Dhe Pausanias përsëri, në fillimet e Arkadikas së tij, vë në dukje traditën Arkadiane, që Pellasgu ishte i pari që jetonte në atë vend. (φασί δέ Αρκάδες, ώς Πελασγός γένοιτο έν τή γή τανρή πρώος); Pausanias ka vështirësi të konsiderueshme në përshtatjen e këtij pohimi me historinë e mbretit të tij Pelasgus: (ποίων γάρ άν καί ήρχεν ό Μελασγός άνθρώπων); por nëqoftëse ne interpretojmë (Πελασγός = Pelasgu) “pel-asg” ose “racë e vjetër” atëhere tradita Arkadiane reduktohet thjesht në një të vërtetë të rëndomtë. Me Virgjilin (AEn. Viii. 600) pellasgët janë “veteres - të parët, pleqtë”.

Ndonëse emri Pelasgi, nëqoftëse pranohet shpjegimi i tij nëpërmjet gjuhës Armene, do të mund, pra, të pranohej Thrakas, megjithatë nga kjo, jo domosdoshmërisht, mund të nxirret përfundimi, gjë që mund të jetë e vërtetë, se çdo komb i quajtur Pellasg është me origjinë Thrake; pasi Thrakët mund të kenë quajtur Pellasgë ndonjë racë vendase, që i përkiste qoftë familjes së tyre, qoftë ndonjë familjeje tjetër. Sido që të jetë, për çdo rast, duhet të kenë qenë Thrakët në këtë vend, që i kanë dhënë racës emrin Pellasg.

Fjala Armene asg, azg, nuk është gjetur, që po në gjuhën Armene, të gjendet e kombinuar në një fjalë të vetme me fjalën vagh, vah; por gjithashtu nuk duket, që të mund të formojë fjalë si Pelasgus, në kombinim me disa mbiemra.

1. Me “ajl – tjetër, i ndryshëm, por”; Ajlazg – i ndryshëm, tjetërsoj

   Ajlazgi – i huaj, i ndryshëm, tjetërsoj

2. Me avtar ose oetar - i huaj, i largët, tjetër

   Oetarazgi – i huaj, një i huaj; oetarazgi – heterogjen; hamazgi – homogjen

3. Me lav – mirë;

   Lavazgi – fisnik, nga familje e mirë

   Disa emra Etruskë fillojnë me lau- ose lav-. Kështu, p.sh. Laukin ose Lavkin është një emër gruaje, që shfaqet në format: Laukin, Lavkinal, Laukine, Lavkinasa. Në gjuhën Armene , fjala “lav-kin” ose “lav-gin” përkthehet “grua e mirë”. Një tjetër emër Etrusk është Lautn, i cili mund të krahasohet me fjalën e gjuhës Armene “lav-toun” ose “lav-dovn” që përkthehet “shtëpi e mirë” ose “familje e mirë”. Një emër i tretë është Lauchme, që supozohet të jetë forma Etruske e Lucumo.

VAHAN SETIAN

"ORIGJINAT ARMENE TË BASKËVE"

Botimet albPAPER, Tiranë, 2020

Grekët i kanë quajtur "Pellasgët" si populli, i cili ka sunduar tokat përpara se ata të lëviznin në Egje. Natyrisht, Pellazgët origjinalë nuk mund të flisnin gjuhën Helenike. Një nga atributet e mëdha që u është dhënë Pellazgëve është vendosja nga ana e tyre e civilizimit Mikenian rreth para 4000 vjetësh. Problemi është se asnjë shpjegim etimologjik nuk është i kënaqshëm ose i afrohet shpjegimit të emrit të këtyre popujve. Madje edhe Grekët e përmendin që Pellazgët nuk flisnin Greqisht. Arkeologë të ndryshëm e kanë konsideruar kulturën si kulturë të natyrës Neolitike. Mikena është i pari qytet i ndërtuar në Greqi dhe është konsideruar ekstravagant dhe "i artë" nga natyra. A ka vallë mundësi që të ardhurit rishtas Grekë t'i konsideronin banorët vendas dhe fqinjët e tyre Pellazgë si "pajl-azg" (Në gjuhën Armene shkruhet "փայլ ազգ", lexohet "pajl azg", që do të thotë "Populli Ndriçues") për shkak të nivelit më të lartë dhe natyrës më të zhvilluar? Grekët në shkrimet e tyre nuk shprehin admirim për civilizimin Pellazg. Homeri është një nga të parët që i përmend Pellazgët si edhe afërsitë dhe natyrën e ngjashme me Trojanët. Ne mund të sjellim në vëmendje se Troja është etimologjikisht derivativ (i prejardhur) i emrit të Zotit Armen të Letërsisë, Tir, dhe i zgjatuar me prapashtesën Greke – oi (oj), që i jep asaj kuptimin e saj original

Armen. Në mbështetje të mëtejshme të këtij shpjegimi, ne mund të përmendim se qyteti i Trojës është themeluar nga mbreti legjendar i Frigjisë (Phrygia) – Tiros. Madje edhe vetë emri Tir mund të kqyret si emri Armen "Ter", që do të thotë "Zotërues", "Drejtues", "Sundues", "Zot", term, i cili sot aktualisht përdoret edhe për "Mbret". Ka edhe konsiderata, të cilat e trajtojnë emrin (fjalën) Tir si të prejardhur nga fjala Armene "gir" – shkrim, pasi "Tiri" Armen ka qenë Zoti i Letërsisë. Ne sigurisht mund t'i argumentojmë afërsitë që janë gjetur ndërmjet Armenëve, Pellazgëve, Lidianëve, Frigëve dhe Etruskëve nga disa historianë dhe gjuhëtarë, përfshirë Ellis (1861) dhe Drews (1994) dhe ato nuk do të kalojnë pa u vënë re. Robert Ellis nuk u pajtua me supozimet që George Rawlinson bëri mbi këtë temë, të cilën ai ishte i aftë ta mbështeste me argumentet e tij të bazuara në zbulimet dhe mbetjet gjuhësorë dhe arkeologjike. Për më tepër, afërsitë etimologjike dhe arkeologjike, dhe tani, edhe afërsitë gjenetike, i mbështesin këto nocione të ndërfutjes (ndërlidhjes) ndërmjet grupeve që rreth 150 vjet më parë konsideroheshin si të tillë (pra si grupe të veçantë). Ja vlen të përmendet edhe një shënim shtesë: "Porta e Luanëve" e Hittitëve, që është ndërtuar në Hatussa në vitin 1400 BCE është pothuajse identike me "Portën e Luanëve" të Mikenës në Greqi. ([97] Shënim V. Setian) (Shih botimi shqip, Fq. 104)

BERZH PIRANJANI

INTERPRETIM

Kur bëhet fjalë për Pellasgët – përse nuk merret në konsideratë edhe fjala e përngjitur Bel-asg ose Pel-azg?

Bel Nimrod – ka qenë armiku, nga i cili Hajku shpëtoi fisin e tij gjatë ikjes nga Babilonia, ndërsa asg (azg) – do të thotë – fis, komb, nacion – në gjuhën Armene. Atëhere:

Bel-asg apo Pel-asg

Bel-azg apo Pel-azg

janë e njëjta gjë, pasi në gjuhën Armene, e cila përbëhet nga dy dialekte, ai Lindor (që përkon me atë të Republikës Armene sot) dhe ai Perëndimor (që i korrespondonte Armenëve, të cilët banonin kryesisht në pjesën që i takonte Perandorisë Otomane dhe sot Armenëve të Diasporës), zakonisht germa b dhe p, si edhe germa g me k konfondohen me njera tjetrën, p.sh: fjala Bel ose Pel:

Për ta ilustruar këtë marrim një paragraf nga libri "Historia e Armenisë" (Kreu 2, faqe 17):

Në legjendën, që bën fjalë për lindjen e kombit Armen, pjesën më të rëndësishme e përbën tregimi "Hajku dhe Beli", në të cilin është reflektuar konflikti i zgjatur shumëshekullor ndërmjet Mesopotamisë së Lashtë dhe Malësive Armene. Sipas legjendës, Kalendari Origjinal (Fillestar) Armen e ka fillesën në ditën kur Patriarku Hajk mundi gjigantin Bel. Sipas llogaritjeve të Kevond Alishanit kjo ka ndodhur

në 11 Gusht të vitit 2492 para Krishtit (këtu duhet thënë që ka edhe llogaritje të tjera).

Në librin original në gjuhën Armene, fjala Bel shkruhet *Բել*

E shkruajtur *Բել*, Armeno–Lindorët do ta lexonin dhe shqiptonin – Bel; ndërsa Armeno – Perëndimorët do ta lexonin dhe shqiptonin – Pel

E njëjta gjë ndodh edhe me fjalën –asg ose –azg

Në librin original në gjuhën Armene, fjala asg shkruhet *ազգ*

E shkruajtur *ազգ*, Armeno–Lindorët do ta lexonin dhe shqiptonin – asg; ndërsa Armeno–Perëndimorët do ta lexonin dhe shqiptonin – azk

Në këtë mënyrë, sipas Armeno Lindorëve do kishim: Belasg – kombi i Belit, ose Fisi i Belit; ndërsa sipas Armeno Perëndimorëve do kishim: Pelazk – kombi i Pelit, ose Fisi i Pelit.

Për t'i ardhur në ndihmë argumentit të mësipërm, po përmend disa shprehje, që i përkasin shkrimit "Legjenda e Hajkut dhe Belit", libër ky me autor Garegin Nalbandian (sot gjendet i përkthyer edhe në gjuhën shqipe) dhe që do të ndihmonin sadopak në ndriçimin e figurës së të ashtuquajturit Bel apo Pel:

Të falenderoj lexues; legjenda që lexon,
Për Mitikun Hajk dhe mbretin e Babelit tregon,
Mbretit të Kushitëve dhe shigjetarit me Hark,
Mbreti quhej Nimrod, heroi quhej Hajk.
...
Ky mbret Biblik që quhej Nimrod,
Dhe Mbret Fuqiplot' dhe Zoti Bel,
Thirri gjithë popujt për të të ndërtojn'
Një kullë në vendin që quhej Babel. (Fq. 9)

...

Tashmë që mbaruat leximin,

Më lini t'ju tregoj përfundimin.

Lufta si u mbarua

Dhe faktet si u zhvillua.

...

Kombe të rinj si u zhvilluan

Kombe që Hajku dhe Nimrodi krijuan.

Një palë qëndroi në të vetin atdhe

Tjetra kërkoi një tjetër atdhe. (Fq. 131)

...

Hajku u bë i riu Bel

Dhe u çvendos për në Babel. (Fq. 132)

Ba'al ose Bel (El) nënkupton Zot ose Perëndi në gjuhët Babilonase dhe Assiriane. (Fq. 160)

Bab-Bel ose Bab-bili nënkupton Bel Bab ose Zoti (Perëndia) Bab, një nga djemtë e Nimrodit Biblik. (Fq. 160)

Bel nënkupton "Zot" në gjuhët Assiriane dhe Babilonase. Bel Nimrod ka qenë njohur si "Bilu Nipru" në Babiloni. (Fq. 161)

Shënim B.P.: Këtu ngrihet një pikëpyetje e madhe: ???

N.q.s. "pelasgët" do të etimologjoheshin si "fiset e Pelit apo Belit" – për cilin Pel apo Bel bëhet fjalë, - për Nimrodin Bel apo për Hajkun Bel ?

Shumë historianë Armenë kanë përmendur se Hajku ishte i gjatë sa gjatësia e tridhjetë e gjashtë burrave të hipur mbi njeri tjetrin, gjë që në fakt nuk është gjë tjetër, përveçse një paraqitje mitologjike e të tridhjetë e gjashtë tribuve apo kombeve, që ishin aleatë dhe

mbështetës të tij, dhe mbështetësit e Hajkut vinin duke u shtuar, për shkak të refugjatëve, që lëviznin nga vendet e Gogut dhe Askanazit, si edhe prej vendeve të pushtuara prej Nimrodit. Ata kërkonin liri; prandaj, ata shkuan tek Hajku, pasi ai u dha atyre toka dhe shpresë. (Fq. 104)

Shënim B.P.:

Koment 1: Ku i gjeti Hajku tokat, në të cilat vendosi të ikurit, përveçse në mbretërinë e Tij, që ndodhej në zonën Anatoliane të Malësive Armene!?

Shumë studjues të mitologjisë përmendin se Nimrodi ishte një gjigant (Titan) i gjatë sa gjatësia e gjashtëdhjetë burrave të hipur mbi njeri tjetrin. Nuk ka ndonjë dokument shkencor, që të pohojë ekzistencën e qënieve humane të këtyre përmasave në Tokë. Ajo është thjesht një paraqitje mitologjike e gjashtëdhjetë tribuve apo kombeve, që ishin aleatë dhe mbështetës të tij. Disa nga aleatët kryesorë të Nimrodit ishin Kushitët, Egjiptianët, Libianët, Kanaanitët, Babilonasit, Akkadianët, Elamitët, Suzanët, Assirianët, Lulubët, Mannaeanët, Azhit dhe qytet-shtete të tjera vasale. (Fq. 106)

Tirasi i quajti njerëzit e tij Tirasianë ose Tirakians (Thrakians) sipas emrit të tij, dhe sipas Ksenofonit të Kolofonit, Thrakët ishin "të zbehtë dhe flokë-kuq", që nënkupton njerëz me flokë të kuq ose bjondë dhe me ngjyrë të lëkurës të bardhë apo të hapur, gjë që përkon me përshkrimin, që i është bërë Gomerit dhe pasardhësve të tij prej shumë historianëve. (Fq. 43)

Vëllezërit Torgomianë ishin të gjatë dhe kockëmëdhenj; pra, ata përfaqësonin pasardhësit e tjerë të Xhafet Oste. Ata ishin luftëtarë të fortë dhe të aftë. Ata kishin lëkurë të bukur në ngjyrë të hapur dhe flokë po në ngjyrë të hapur (bjondë), siç i kishin edhe pasardhësit e tjerë të Gomerit. (Fq. 66 - 67)

Hajku ishte i gjatë, trim dhe i fortë, me sy ngjyrë blu, flokë të verdhë dhe lëkurë në ngjyrë të hapur të shndritshme. (Fq. 68)

Pasi vdiq Hami, Kushi u bë mbret i Titanëve (Kushitëve) dhe i Hamitikëve të tjerë, që kishin zbritur në Egjiptin e Sipërm dhe Afrikën e Veriut. (Fq. 50)

Duke cituar Berossusin, George Rawlinson pohon se Nimrodi dhe Babilonasit (Kushitët) ishin gjuetarë të mëdhenj; ... Ai pohon se Babilonasit (Kushitët) kishin çehre të errët ose të zezë dhe kishin hundë dhe nofulla, që u ngjanin hundës dhe nofullave të Indo-Europianëve. Kjo provon se Kushitët nuk ishin të racës vendase Afrikane. Kushitët ishin të afërm me Egjiptianët, Etiopianët dhe popuj të tjerë të lashtë Hamitikë. (Fq. 51)

Shënim B.P.: Le të ballafaqohemi me disa veçori që bien në sy gjatë leximit të rreshtave të mësipërm:

Së pari, dallimi në pamje të jashtme është i dukshëm; pasardhësit Xhafetikë, në të cilët bënte pjesë edhe Hajku, kishin "lëkurë të bukur në ngjyrë të hapur dhe flokë po në ngjyrë të hapur (bjondë)", ndërsa .. "Babilonasit (Kushitët) kishin çehre të errët ose të zezë dhe kishin hundë dhe nofulla që u ngjanin hundës dhe nofullave të Indo-Europianëve. Kushitët ishin të afërm me Egjiptianët, Etiopianët dhe popuj të tjerë të lashtë Hamitikë".

Së dyti, vendbanimi i fisit Xhapetik ishin malësitë që ndodhen në zonën lindore të Anatolisë dhe në kufirin verior të Iranit të sotëm, pak a shumë ato, që në kohën e re kanë pasë qenë emërtuar si "Malësitë Armene" (kryesisht zona ndërmjet tre liqeneve: Van, Sevan dhe Urmia). Ndërsa për vendbanimin fillestar të fisit Hamitik, përpara se Kushi të pushtonte Babiloninë, duhet marrë në konsideratë shprehja: "Pasi vdiq Hami, Kushi u bë mbret i Titanëve (Kushitëve) dhe i Hamitikëve të tjerë, që kishin zbritur në Egjiptin e Sipërm dhe Afrikën e Veriut. Kushitët ishin të afërm me Egjiptianët, Etiopianët dhe popuj të tjerë të lashtë Hamitikë".

Së treti, kur bëhet fjalë për përplasjen ndërmjet Hajkut dhe Belit duhet marrë në konsideratë fakti, që në çdo rast flitet për fise Xhafetike dhe fise Hamitike, pra në numrin shumës dhe jo për një fis

Xhafetik të Hajkut apo për një fis Hamitik të Bel Nimrodit. Supozohet për 36 fise Xhafetike përkrahëse të Hajkut dhe 60 fise Hamitike ose jo Hamitike mbështetëse të Bel Nimrodit. Them Hamitike ose jo Hamitike, pasi në kohën për të cilën bën fjalë legjenda, Bel Nimrodi dhe i jati i tij, Kushi, që nga ana e tij ishte i biri i Hamit, kishin pushtuar, përveç Babilonisë, edhe pjesën më të madhe të botës së njohur të deriatëhershme dhe kishin vënë nën sundimin ose vasalitetin e tyre edhe një sërë fisesh, që nuk i përkisnin pemës Hamitike; "Kushitët ishin të afërm me Egjiptianët, Etiopianët dhe popuj të tjerë të lashtë Hamitikë".

Së katërti, gjatë luftërave të zhvilluara nga Bel Nimrodi dhe i jati i tij, Kushi, për pushtimin e Babilonisë dhe një sërë tokash të tjera, apo për nënshtrimin e tyre me kushte vasaliteti, jo të gjitha fiset pranuan të nënshtroheshin ose të pranonin kushtet e robërisë. Në këto rrethana, siç tregohet në legjendë, por siç e pranon edhe logjika e thjeshtë, një pjesë e tyre u detyruan të largoheshin nga vendbanimet e tyre atërore dhe të shpërnguleshin në vende të tjera. Sipas rrethanave, këto lëvizje u kryen nëpërmjet tokës ose detit. Normalisht do të duhej të pranonim që fiset e shpërngulura i takonte të ishin fise jo Hamitike.

Së pesti, të njëjtën gjë mund të themi edhe për periudhën e luftës ndërmjet Hajkut dhe Bel Nimrodit, dhe me përfundimin e saj. Të dy këto momente u shoqëruan me çvendosje masive njerëzish nga të dy anët.

Së gjashti, do të duhet të pranojmë se me fitoren e Hajkut, pjesa më e madhe e njerëzve të lidhur me Bel Nimrodin dhe të ardhur bashkë me të në viset e pushtuara, nga frika e hakmarrjeve të mundshme u larguan në viset nga kishin ardhur ose në kërkim të vendbanimeve të reja, gjë që flitet edhe në legjendë. Ndërsa periudha e pas Hajkut njihet si një periudhë e një qetësie relative, që u shoqërua me një forcim të fiseve Xhafetike, si edhe me një shtrirje të ndikimit të tyre në zonën e Anatolisë lindore e deri poshtë në Babiloni, e që më vonë u shfaq edhe në zonën e Anatolisë qendrore.

Tani,

n.q.s. do të pranonim si reale pemën gjenealogjike të fisit Xhafetik, ashtu siç është përshkruar në shkrimin "Legjenda e Hajkut dhe Belit", me autor Garegin Nalbandian, ku Thrakasit dalin si fiset më të lashta se fiset e përfaqësuara nga Hajku

n.q.s. do të pranonim që, përpara luftës së Trojës, fiset të cilët popullonin zonën e Ballkanit perëndimor deri poshtë në Greqi, si edhe fiset që popullonin viset e bregdetit perëndimor të Anatolisë, ku ndërmjet qytet-shteteve të tjerë bënte pjesë edhe Troja, ishin pjesë përbërëse e të njëjtit trung, atij pellazgjik

n.q.s. do të pranonim që në kohën e luftës së Trojës kemi të bëjmë me përplasje fisesh, të cilët i përkisnin të njëjtit trung, atij pellazgjik,

n.q.s. do të pranonim që zona e Ballkanit lindor dhe pjesa e bregdetit veriperëndimor të Anatolisë popullohej nga fise Thrake, që konsiderohen fis Xhafetik,

n.q.s. do të pranonim që fiset pellasge janë fise të ardhura nga krahinat e Anatolisë Qendrore dhe Lindore,

n.q.s. do të pranonim që të gjitha këto fise flisnin të njëjtën gjuhë,

n.q.s. do të pranonim që në periudhën ndërmjet dy luftrave (asaj ndërmjet Hajkut dhe Bel Nimrodit e vitit 2492 p.e.s. dhe luftës së Trojës e viteve 1194 -1184 p.e.s.), të cilat lidhen me dy legjenda, nuk kemi ndonjë shpërngulje tjetër të madhe e të spikatur nga Anatolia në drejtim të Ballkanit,

n.q.s. do të pranonim që shpërnguljet e mundshme në këtë drejtim lëvizjeje kanë qenë të qeta dhe pa përplasje me fiset e fuqishme të asaj kohe, siç ishin Thrakët,

do të dilnim në disa konkluzione:

Së pari që, kalimi nga Anatolia qendrore e lindore, ku banonin fiset Xhapetike, në drejtim të Ballkanit nëpërmjet zonave të banuara nga fise Thrake është bërë pa përplasje, gjë që do të thotë se Thrakët i kanë konsideruar këto fise si fise mike ose të afërm me ta; kjo përjashton mundësinë që këto fise të kenë qenë Hamitike, si rrjedhim

as fise të mbretit Nimrod.

Së dyti, kalimi nëpërmjet zonave Thrake nuk është shoqëruar me ngulime të tyre në këto zona ose shpopullime thrakase, por ka shërbyer si urë kalimi e përkohshme, për të mbërritur në destinacionin e ri, që në këtë rast do të ishte Ballkani perëndimor dhe Greqia, vende me klimë dhe reliev të ngjashëm me atë të vendbanimit të origjinës së fiseve Xhapetike, në ndryshim me vendet e ulta e me klimë të nxehtë siç ishin vendbanimet e fiseve Hamitike,

Së treti, duke pasë parasysh që në atë kohë nuk flitet për ndonjë kontakt me ndonjë komb apo fis grek apo helen, është e natyrshme të mendohet se emërtimi i kësaj popullsie lëvizëse të jetë bërë nga banorët e vendeve nëpërmjet të cilëve këto fise kanë lëvizur, ose të jetë përgjigje e kësaj popullsie lëvizëse ndaj pyetjes, e cila u bëhej nga banorët e zonave nga kalonin,

Së katërti, fitorja e Hajkut mbi Belin, duhet konsideruar jo vetëm si fitore e një prijësi mbi një tjetër, por ajo pati një jehonë më të madhe, jehonën e fitores së fisit Xhafetik mbi atë Hamitik, jehonën e shtrirjes së ndikimit Xhafetik në të gjithë botën e njohur të deriatëhershme, veçanërisht të asaj që ndodhej pranë brigjeve të lumenjve Tigër dhe Eufrat. Dhe kjo, bënte krenarë të gjitha fiset që kishin prejardhje Xhafetike, si ato që kishin qenë pjesë përbërëse e betejës, ashtu edhe ato, që për arsye gjeografike, nuk kishin qenë pjesë përbërëse e saj.

Së pesti, fiset shtegtuese duhet të kenë arritur në Ballkanin perëndimor dhe Greqi si fise me "lëkurë të bukur në ngjyrë të hapur dhe flokë po në ngjyrë të hapur (bjondë)", ashtu siç përshkruhen edhe në luftën e Trojës dhe jo me "çehre të errët ose të zezë".

Dy mundësi janë:

Ose Thrakasit i kanë quajtur këto grupe shtegtuese "Pelasgë" (fiset e Belit apo Pelit), duke shprehur në këtë mënyrë simpatinë e tyre për mbretin Hajk (Belin apo Pelin Hajk) dhe fiset që ai përfaqësonte,

Ose këto grupe shtegtarësh i përgjigjeshin me krenari pyetjes që u bëhej nga banorët e zonave ku kalonin: "Ne jemi Pelasgë" që do të nënkuptonte: "Ne jemi fiset e Belit apo Pelit Hajk; Ne jemi fiset e Zotit apo Zotit Hajk; Ne jemi fiset e Mbretit apo Mbretit Hajk".

Në mbështetje të kësaj origjine të emërtimit "Pellasg", që unë po përpiqem të argumentoj, po risjell edhe një herë disa copëza nga pjesët e shkëputura nga librat sipërpërmendur:

1. Teoria, që pranohet më gjerësisht nga etnologët e sotëm, e nxjerr prejardhjen e fisit të Pellazgëve, përveç qendrës së tyre më të lashtë, nga zona malore e Armenisë. (Sir Patrick Colquhoun & Vaso Pasha, Fq. 33)
2. Duke cituar D. Olimpi, Spiro Konda, vazhdon: D. Olimpi, në ("Fjalorin Homerik", përkthim nga gjermanishtja, Athinë, viti 1900, faqe 250), përmend këto: "Fjala Pellasg konsiderohet fjalë aziatike. (S.K. Fq. 446-447)
3. Si popull më i lashtë i Greqisë përmenden Arkadet, që, sipas hipotezash të cilat i them i rezervuar, ishte populli që shpëtoi nga një përmbytje katastrofike, që kaloi në traditat Helene si "Përmbytja e Defklionës". (Aristidh P. Kola: "Arvanitasit dhe prejardhja e grekëve", Fq. 37)

   Shënim B.P.: Koment 2:

   Në shqip për fjalën arkë (si për atë të madhe ashtu edhe për atë të vogël) përdoret fjala - arkë (arkë e madhe)

   Në gjuhë të tjera kemi:

Armenisht:	*արկղ* (arkh, argh)
Spanjisht:	*arcon*
Italisht:	*arca*
Anglisht:	*ark*
Greqisht:	*κιβωτός* (kivotós)

Të bën përshtypje ngjashmëria në të shkruar, në të shqiptuar dhe në kuptim e fjalës sipërparaqitur në tre gjuhë të lashta: Armenisht, Shqip dhe në gjuhët me bazë latine

Mbase etimologjia e fjalës emërtuese "Arkadet" për popullin e pranuar si më i lashti i Greqisë duhet kërkuar në fjalën "Arka", e cila ka lidhje me Përmbytjen e Madhe dhe Arkën e Noes!? Mendoj se do të ishte jo pa kuptim, që popullin e shpëtuar nga përmbytja nëpërmjet "Arkës" ta emërtonin "banorët e Arkës"!?

Sido që të jetë, n.q.s. do pranonim burimet Biblike për shpërndarjen e djemve të Noes, si rezultat do kishim që populli i Arkadeve dhe fisi pellazgjik kanë pasur prejardhje dhe gjuhë të njëjtë, pavarësisht deformimeve dialektale si pasojë e ardhjeve në kohë të ndryshme në të njëjtin vend.

4. Me sa dihet, për të parën herë në burimet historike, Pellazgët përmenden në marrëveshjen e paqes nënshkruar në Kadesh në vitin 1296 p.e.s. midis mbretit fitimtar të Hititëve Nurëatallish dhe faraonit të Egjiptit Ramses II. (Kristo Frashëri: "Etnogjeneza e shqiptarëve", Fq. 58)
5. Ndonëse emri Pelasgi, nëqoftëse pranohet shpjegimi i tij nëpërmjet gjuhës Armene, do të mund, pra, të pranohej Thrakas, megjithatë nga kjo, jo domosdoshmërisht, mund të nxirret përfundimi, gjë që mund të jetë e vërtetë, se çdo komb i quajtur Pellasg është me origjinë Thrake; pasi Thrakët mund të kenë quajtur Pellasgë ndonjë racë vendase, që i përkiste qoftë familjes së tyre, qoftë ndonjë familjeje tjetër. Sido që të jetë, për çdo rast, duhet të kenë qenë Thrakët në këtë vend, që i kanë dhënë racës emrin Pellasg. (Robert Ellis : "Armenian origin of Etruscans")
6. A ka vallë mundësi që të ardhurit rishtas Grekë t'i konsideronin banorët vendas dhe fqinjët e tyre Pellazgë si "pajl-azg" (Në gjuhën Armene shkruhet "փայլ ազգ", lexohet "pajl azg", që do të thotë "Populli Ndriçues") për shkak të nivelit më të lartë dhe natyrës

më të zhvilluar? Grekët në shkrimet e tyre nuk shprehin admirim për civilizimin Pellazg. (Vahan Setian, "Origjinat Armene të Baskëve" Shih botimi shqip, Fq. 104)

Shënime B.P.:

Vrojtim 1:

Gjatë leximit të librit "Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit" me autor Garegin Nalbandian, botimi shqip, Tiranë, 2020, Fq. 155, hasim në paragrafin:

"Gjatë luftës së Trojës, Paflagonët, Gargareanët dhe Amazonët, si edhe Armenët dhe Frigët, Thrakasit dhe Palasgianët, si edhe Arianë të tjerë luftuan përkrah Trojanëve kundër Grekëve Akeanë (Akej), Spartanëve dhe Grekëve të tjerë."

Palasgianët? – mbetet për t'u sqaruar ky emërtim; cilit fis i përket ky emërtim?; apo mbase dialektalisht apo gabimisht është shkruar "Palasgianë" duke dashur të thonë "Pelasgianë"?

Armenët? – sipas më sipër, del që duhet të kenë pasë qenë formuar dhe njohur si komb, apo si bashkësi e mirëorganizuar në periudhën e luftës së Trojës.!?

Vrojtim 2:

Rreth viteve 1980 kam pasur rastin të punoj në një zonë të thellë mineralmbajtëse të krahinës së Mirditës. Një ndër gjërat që më ka bërë përshtypje të thellë, të cilën e ruaj akoma edhe sot të gjallë në kujtesë, sikur ta kem parasysh, ishte fakti se në kontrast me fytyrat e lodhura e të rreshkura, me flokë ngjyrë gruri të zbehur të malësorëve vendas mirditorë, fëmijët e tyre të posalindur dhe të moshës (po flas për ato që mbaj mend) 3-5 vjeçare kishin tipare shumë të bukura: ishin buçko, me ngjyrë të lëkurës së hapur, flokë po me ngjyrë të hapur (ngjyrë gruri e çelët; do t'i klasifikoja bjondë tipikë), sy ngjyrë qielli të qeshur. Në atë kohë, me veten time, i kisha cilësuar: "bjondë nordikë".

Kur pyeta prindin e njerit prej tyre, se si shpjegohej që fëmijët e tij ishin aq të bukur, ai m'u përgjigj: "Edhe unë ashtu kam qenë, kur kam qenë i vogël. Por klima, puna, hallet me kohë bëjnë të vetën. Është ndryshe me ju që jetoni në qytet."

Tani, mbas afo 40 vitesh, tek lexoja librin "Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit", dhe pikërisht kur hasa në frazën: "Hajku ishte i gjatë, trim dhe i fortë, me sy ngjyrë blu, flokë të verdhë dhe lëkurë në ngjyrë të hapur të shndritshme. (Fq. 68)" më erdhi ndër mend ajo që kisha përjetuar vite më parë dhe instiktivisht bërë një lidhje: Fis Xhafetik – Hajk – Pellazg – Arian – Alban - Mirditorë (banorë shqiptarë autoktonë në Shqipëri, të paktën prej 600 vjetësh).

Ndërfutje informative B.P.:

Në librin e tij "Ndërfana", Tiranë, 2008, autori Gjon Marku shkruan:

Një legjendë e vjetër thotë se: "Ndërfana ka qenë përpara Krishtit", ç'ka nënkupton se Ndërfana ka qenë një vend i populluar që përpara dymijë vjetësh. (Fq. 23)

Gjetjet arkeologjike nuk mungojnë të hedhin dritë e të sjellin tek ne dëshmi të jetës në Gëziq (Shënim B.P.: Gëziq – fshat në Mirditë) edhe për periudhën e bakrit 3000-2100 përpara Krishtit. Edhe sot në Gëziq gjenden mbeturina të zhirës e skorjes së ngurtësuar, që na çojnë drejt mendimit se metali i bakrit punohej që herët në Gëziq. (Fq. 24)

Emri "Ndërfanë", është njeri ndër emrat më të vjetër, që vjen në ditët tona ashtu siç përdorej shekuj më parë dhe lidhet me shtrirjen e territoreve të kësaj treve në mes të dy lumenjve të Fanit. ….

Dokumentet perëndimore këtë emër e sjellin që nga shekulli VII-VIII të erës sonë, së bashku me emrat shqiptarë: Arbania, Arbanon, Roban, Albanum, etj. Përdorimi i këtij emri që herët nga autorë të huaj të çon drejt mendimit se Ndërfana ka qenë një qendër e njohur që në kohët e hershme.

...

... në dokumentet paraosmane, Mirdita e sotme quhet herë Ndërfanë, herë Dukagjin. Kalimi i emrit nga Dukagjin në Mirditë është bërë shkallë-shkallë, madje disi përzitas. (Fq. 26)

... Gëziqi i sotëm ka qenë qendra e Ndërfanës së hershme. (Fq. 27)

"Ndërkohë, në Mat (*Shënim B.P.:* Mati – krahinë kufitare me Mirditën), në anën tjetër të këtyre trevave, zënë fill ngjarje të mëdha kombëtare. Kryeipeshkvi i Durrësit, Imzot Pal Engjëlli (1417-1470), i cili hyri në historinë e kombit tonë si bashkëpuntor i Gjergj Kastriotit, prelat i kishës katolike shqiptare, gjatë një vizite baritore në Mat (Emathia), vuri re çrregullime të mëdha në punët dhe në veprimtarinë fetare. Me këtë rast, më 8 Nëntor të vitit 1462 nënshkruan në kishën e Dukagjinit të Matit "Formulën e Pagëzimit", që më vonë do të rezultojë si dokumenti më i vjetër i shqipes së shkruar." (Fq. 38)

Nuk mungojnë dokumentet, që zanafillën e kësaj familjeje e kërkojnë në epokat më të vjetra. I tillë është edhe kronikani shqiptar Gjon Muzaka, i cili duke u mbështetur në një gojëdhënë të vjetër, pohon se pasardhësit e Dukagjinëve vijnë që prej kohës së Trojës. Po të njëjtën gjë pohon edhe studjuesi Hopf. (Fq. 51)

Duke vështruar ansamblin përreth Ndërfanës, pa droje thuhet se territoret e Mirditës banoheshin nga shqiptarët që herët dhe se kjo trevë ka të akumuluar një kulturë të veçantë e të pastër, që hedh dritë mbi autoktoninë. (Fq. 66)

Po ky autor, në librin "Mirdita, vendi i kuvendeve vetëqeverisëse", Tiranë, 2014, shkruan:

"Fakti, që ndër fragmentet e mermerta të një portreti të Shën Mërisë së Ndërfanës, gjendet stema e Dukagjinëve, së bashku me mbishkrimin që flet për principatën e Arbërit të viteve 1190-1216, të bën të mendosh se këta ishin nga fisi ose dera e Dukagjinëve. (Fq. 51)

PËRMBLEDHJE

Duke i bërë një përmbledhje sa më sipër, arrij në këto përfundime:

1. "Formula e Pagëzimit" e vitit 1462 në gjuhën shqipe, krahas faktit që populli i Mirditës ka folur dhe vazhdon të flasë gjuhën shqipe, krahas faktit që Mirdita nuk i është nënshtruar pushtimit Turk, krahas faktit që ka qenë dhe vazhdon të jetë e besimit katolik deri në ditët tona, vërteton se në ato zona, në periudhën nga viti 1462 e në vazhdim, ka pasë jetuar dhe vazhdon të jetojë një popullsi autoktone, që e quan veten shqiptare – pasardhëse e arbërorëve të kohës së Gjergj Kastriotit - Skënderbeut

2. Dyndjet sllave u shfaqën në Ballkan në shekujt 5-6 të erës sonë dhe u shoqëruan me pushtime dhe ngulime në këto toka deri në ndalimin e tyre me futjen e turqve në këto zona të Ballkanit. Në zonat ku u ngulitën, qoftë sllavët serbë, qoftë ata bullgarë vendosën forcërisht gjuhën dhe besimin e tyre fetar, që ishte besimi ortodoks.

Fakti që në Mirditë dhe në malësitë përreth saj, deri në periudhën e shfaqjes së pushtuesve turq në këto zona të Ballkanit, kishte një popullsi të besimit fetar katolik, që fliste një gjuhë të ndryshme nga ajo serbe apo bullgare, maqedonase apo greke, një gjuhë që shfaqet tek "Formula e Pagëzimit" dhe vazhdon të flitet akoma edhe sot e që quhet gjuha shqipe, fakti që në periudhën ndërmjet dy dyndjeve të fuqishme, masive e të shtrira në kohë, asaj sllave nga veriu dhe asaj turke nga jugu, historia ballkanike nuk flet për ndonjë dyndje apo ngulim fisesh të tjerë, që t'i jetë imponuar ngulimeve sllave, fakti që bota Europiane flet për principatën e Arbërit në kohën e Skënderbeut, kur si e tillë ajo figuron edhe në mbishkrimin e viteve 1190 - 1206, është një provë bindëse se kjo popullsi dhe ajo gjuhë kanë qenë aty përgjatë gjithë periudhës, nga periudha e shfaqjes së dyndjeve sllave (shek. V-VI pas Krishtit) e deri në shfaqjen e dyndjeve turke, rrjedhimisht deri më sot. Rrjedhimish autoktonë, që nga ai çast.

3. Mbetet të analizohet periudha e pushtimit romak të këtyre viseve Ballkanike, që sot popullohen nga banorë shqipfolës.

Në këtë zonë, qëndresa më e madhe kundër romakëve i detyrohet dy prej fiseve më të fuqishme: epirotëve në jug të Shqipërisë së sotme, me në krye Pirron e Epirit (319-272 p.e.s.), dhe ilirëve në hapësirën Shkodër-Durrës që u përfaqësuan nga Agroni (sundoi 250-231), Teuta (sundoi 231-228 p.e.s.), Genti (mbreti i fundit i Ilirisë, sundoi 181-168 p.e.s.).

Në periudhën 356 p.e.s. deri 168 p.e.s. historia përmend Aleksandrin e Madh të Maqedonisë, Pirron e Epirit dhe Agronin me Gentin e Ilirisë. Për një periudhë afro 200 vjeçare ishin këto tre kombe, që shkruan historinë e kësaj pjese të Ballkanit. Mirdita shtrihet në zonën, që dikur i përkiste Ilirisë. Po të kemi parasysh, që në zonën, që mbulonin dikur këto mbretëri, sot fliten tre gjuhë kryesore: greqisht që përdorej edhe në Epir e Maqedoni, sllavisht që përdoret sot në Maqedoni dhe shqip që përdoret sot në Shqipëri dhe zonat kufitare të shteteve fqinje me të, pyetja që shtrohet përpara çdo njeriu të interesuar është: mirë greqishtja që dihet se nga rrjedh e që dihet se përdorej në Greqi, Epir dhe Maqedoni, mirë sllavishtja që po e pranojmë të futur në Maqedoni me dyndjet sllave të shekujve 6-7 të erës sonë, po shqipja nga vjen, kush e ka futur dhe kush e ka pasë folur? Po fisi i madh i Ilirëve, i përmendur nga historiografia romane dhe ajo bizantine përgjatë gjithë ekzistencës së tyre, e i përbërë nga një shumicë bashkësish fisnore, siç ishin Pirustët, që popullonin zonën ku shtrihet Mirdita sot, Dardanët, që popullonin zonën ku shtrihet Kosova sot, etj. çfarë gjuhe flisnin? Një gjë është e sigurtë nga historia, që nuk flisnin gjuhën romake, as para pushtimit prej tyre dhe as pas rënies së Perandorisë Bizantine nga dyndjet sllave në këtë zonë.

4. Duke marrë në analizë vetëm zonën e Mirditës, që ndodhet në zemër të Shqipërisë së sotme, përpara se të kalohet në përgjithësim për gjithë zonën shqipfolëse:

a) Mirdita, në kohën e pushtimit romak ka qenë e banuar nga një popullsi që nuk fliste gjuhën romake (latinishten); prej Perandorisë Romake dhe asaj Bizantine ajo ka qenë njohur si pjesë e Ilirisë (Pirustët).

b) Ka folur një gjuhë, që me siguri nuk ka qenë latinishtja.

c) Në kohën e dyndjeve sllave ka qenë e banuar nga një popullsi, që nuk fliste gjuhën sllave.

d) Ka folur një gjuhë, që me siguri nuk ka qenë sllavishtja.

e) Në kohën e dyndjeve turke ka qenë e banuar nga një popullsi që nuk fliste gjuhën turke.

f) Ka folur një gjuhë, që me siguri nuk ka qenë turqishtja.

g) Në ditën e pavarësisë 28 Nëntor 1912 ka qenë e banuar nga një popullsi që nuk fliste gjuhën latine apo italishten e sotme, nuk fliste gjuhën serbe apo bullgare apo maqedonase, nuk fliste gjuhën greke, nuk fliste gjuhën turke, por fliste një gjuhë krejt ndryshe prej tyre, fliste gjuhën shqipe.

Atëhere, rrjedhimisht i takon të analizojmë dy variante mbijetese për gjuhën dhe popullin që e bart atë:

Varianti I.

Që banorët e sotëm të Mirditës përfaqësojnë një shartim të banorëve vendas me pushtuesit dhe gjuha e tyre, gjithashtu, përfaqëson një shartim të gjuhës fillestare të banorëve vendas (autoktonë) dhe gjuhëve të pushtuesve (pra një përzierje të greqishtes, latinishtes, sllavishtes, turqishtes).

Varianti II.

Që banorët e sotëm të Mirditës përfaqësojnë një popullsi autoktone, praktikisht të pastër etnikisht dhe që flasin një gjuhë të tyren origjinale, të ashtuquajtur "barbare" nga fqinjët e tyre grekë.

ANALIZË

Që Mirdita mund të ketë përthithur grupe njerëzish nga jashtë krahinës së vet, pavarësisht etnisë, kjo nuk është një gjë e pamundur; por që kjo përthithje të jetë shoqëruar edhe me ndryshimin e gjuhës së vendasve nga të ardhurit kjo nuk shfaqet gjëkundi dhe nuk e pretendon askush nga fqinjët, që deri dje i kanë quajtur shqiptarët "barbarë" dhe gjuhën shqipe gjuhë "barbare", duke mohuar çdo lidhje me të. Është i padiskutueshëm fakti, që gjuha greke, italishtja, gjuha sllave (serbe, maqedone apo bullgare) apo turqishtja, që kanë rrethuar e rrethojnë shqipen, kanë qenë dhe janë gjuhë më të kultivuara se shqipja, dhe do të ishte jashtë llogjikës normale që çdonjëra prej tyre të degradohej nga popullsia që e bartte atë (në rastin e grupeve të përthithura nga popullsia vendase autoktone mirditore) deri në një ndryshim rrënjësor në formën e gjuhës shqipe, apo që popullsia vendase autoktone të përthithte një gjuhë të kultivuar nga grupet e ardhura dhe pastaj ta deformonte atë drejt degradimit gjuhësor për të krijuar një gjuhë të re, aspak të ngjashme me gjuhën origjinale.

Kështu që, mendimi im është se, në Mirditë banon një popullsi autoktone (mbase edhe me përthithje të jashtme) të paktën që nga shekulli i IV (katërt) p.e.s, që ka sjellë me vete deri në ditët tona një gjuhë origjinale autoktone po kaq të lashtë sa vetë ajo, gjuhën që sot ne e quajmë gjuha shqipe dhe të huajt e emërtojnë gjuha Albane.

N.q.s. kjo vlen për Mirditën, që ndodhet në zemër të shqipfolësisë, atëhere pyetja që shtrohet përpara studiuesve është kjo: çfarë e pengon studiuesin t'i japë karakter përgjithësues këtij mendimi për të gjithë zonën shqipfolëse?

Përgjigja ime do të ishte: Asgjë!

RIKTHIM NË ANALIZË:

Po më herët, çfarë ka ndodhur? Bëhet fjalë për periudhën para shek. IV p.e.s., të paktën deri në thellësitë e kohëve kur vjen e dokumentuar historikisht "Lufta e Trojës" e vitit 1194 - 1184 p.e.s.. Çfarë popullsie banonte në këto zona, çfarë gjuhe fliste, deri ku shtrihej?

Këtu duhen marrë në konsideratë disa fakte:

a) pohimi i Homerit se lufta e Trojës është betejë ndërmjet fiseve të të njëjtit trung e që flisnin të njëjtën gjuhë.
b) se Homeri bën fjalë për luftë në gjirin e "Pellazgëve".
c) se për Hekateusin dhe Herodotin popullsia paraGreke dhe paraHelene mendohej të ishte ajo që përmendte Homeri, "Pellazge".
d) se në kohën e Hekateusit dhe Herodotit Greqia nuk banohej vetëm nga greqishtfolës, por edhe nga popullsi, që ata e quanin pasardhëse të "Pellazgëve" të Homerit.
e) se në kohën e Hekateusit dhe Herodotit popullsia, që ata e quanin pasardhëse të "Pellazgëve" të Homerit, fliste një gjuhë jo greke por "barbare"

N.q.s. biem dakord me mendimin mbizotërues të shumicës së studiuesve të mirënjohur, të cilët kanë pasur në qendër të punës së tyre studimore pikërisht zgjidhjen e kësaj enigme, se popullsia para Homerike e asaj pjese të Ballkanit, në të cilën shtrihet shteti i sotëm grek, si edhe e krahinave veriore në kufi me të, ku mendohej të ishte Dodona fillestare dhe që sot supozohet të identifikohet me Malin e Tomorrit në Berat, ka pasë emërtimin "Pellazg", atëhere mendoj që edhe pyetja më sipër e ka marrë përgjigjen.

Erdhëm deri në pikën kur pranojmë se në kohën e Herodotit (shek. V p.e.s.), në zonën ku shtrihet shteti i sotëm Grek, kishte akoma grupe shoqërore, që identifikoheshin si "Pellazgë" dhe që flisnin një gjuhë të ndryshme nga gjuha e shkruar greke, e që grekët e quanin "barbare".

Nga kjo periudhë e deri në pushtimin romak, në veri të Greqisë janë shfaqur dy shtete, që në periudhën paraRomake (Shek 4-3 p.e.s.) arritën një fuqi të konsiderueshme: Epirotët, që asokohe zinin toka që aktualisht ndodhen në veri të shtetit të sotëm grek dhe një pjesë të tokave që ndodhen në jug të shtetit të sotëm shqiptar dhe Ilirët në veri të tyre, që kapërcenin kufijtë veriorë dhe verilindorë të shtetit të sotëm shqiptar.

N.q.s. do të pranojmë që epirotët kanë qenë një shtet ndërmjetës ndërmjet grekëve dhe ilirëve, një përzierje popullsish me origjinë greke dhe pellazge, një përzierje popullsish që flisnin gjuhën greke por edhe atë "barbare" (pra, jo greke), pyetja e parë që të vjen në mend është: po Ilirët çfarë gjuhe flisnin?

N.q.s i rikthemi analizës së bërë më sipër, sipas së cilës gjuha shqipe është vazhdimësi e gjuhës që ka pasë folur popullsia që ka pasë banuar në trojet ku sot shtrihen banorët shqipfolës në Ballkan, dhe që në shek. IV p.e.s e më pas shfaqet si pjesë e Ilirikumit të njohur nga romakët, n.q.s. kjo gjuhë në atë kohë cilësohej si "barbare" nga fqinjët grekë dhe më pas pushtuesit romakë, atëhere ja vlen të bëhet një hamendësim: që cilësimi nga ana e grekëve "gjuhë barbare" e gjuhës së folur nga epirotët dhe po ashtu cilësimi nga ana e grekëve dhe romakëve "gjuhë barbare" e gjuhës së folur nga ilirët, mbase është cilësim, që i vihet po të njëjtës gjuhë.

Dhe n.q.s. kjo gjuhë është po ajo që përmendet nga Homeri, Herodoti e të tjerë historianë të vjetër grekë, e që pranojnë pellazgët e Homerit si bartës të saj, atëhere natyrshëm bëhet lidhja:

N.q.s. "gjuha barbare" me të cilën historianët e lashtë grekë cilësojnë gjuhën e folur nga "Pellazgët", dhe "gjuha barbare" me të cilën historianët e lashtë grekë dhe romakë cilësojnë gjuhën e folur nga epirotët dhe ilirët është e njëjta, atëhere rrjedhimisht edhe epirotët edhe ilirët kanë lidhje me trungun pellazgjik dhe gjuha "barbare" e folur prej tyre nuk është gjë tjetër, veçse gjuha shqipe e sotme.

Pra, hamendësimin e shtrirjes së popullsisë "Pellazge" nëpër

territorin e Greqisë dhe Shqipërisë mund ta nxjerrim vetëm pas hamendësimit se në kohët e lashta në këto zona flitej e njëjta gjuhë "barbare", që praktikisht duke filluar nga periudha ilire identifikohet me gjuhën shqipe.

Duke ecur mbrapsht në kohë në emërtimin e banorëve që flisnin këtë gjuhë shqipe ("barbare") do kishim:

SHQIPTARË – ARBËRORË - ILIRË - PELLAZGË

Me këtë hamendësim kemi ardhur deri në periudhën e "Luftës së Trojës" së vitit 1194 - 1184 p.e.s., për të cilën Homeri pohon se lufta e Trojës është betejë ndërmjet fiseve të të njëjtit trung e që flisnin të njëjtën gjuhë, për të cilën Homeri pohon se bëhet fjalë për luftë në gjirin e fiseve "Pellazge".

Prej këtej mund të shkojmë diçka më në thellësi të kohës; bëhet fjalë për vitin 1296 p.e.s., kur "Me sa dihet, për të parën herë në burimet historike, Pellazgët përmenden në marrëveshjen e paqes nënshkruar në Kadesh në vitin 1296 p.e.s. midis mbretit fitimtar të Hititëve Nurëatallish dhe faraonit të Egjiptit Ramses II." (K.Frashëri, Etnogjeneza e shqiptarëve, Fq. 58)

Nga kjo datë deri në vitin 2492 p.e.s. kur sipas legjendës kemi të bëjmë me fise të Belit (Mbretit, Zotit), gjë që do t'i jepte një përforcim idesë së prejardhjes së emrit "Pellasg" nga fjala e përngjitur Armene "Pelasg" ("Pelasg" = Fiset e Pelit = Fiset e Belit) kemi një hapësirë kohore prej afro 1100 vjet, e cila, duke marrë në konsideratë pjesëmarrjen në luftë të Pellazgëve përkrah Hittitëve kundër Egjiptianëve, fton në studimin e mëtejshëm të prejardhjes pellazgjike në hapësirat Anatolike.

Këtu e ndërpres këtë analizë, pasi vazhdimin e gjej jashtë mundësive të mia.

INTERPRETIME TË EMRIT - "ALBAN"

Renditja e Interpretimeve sipas Autorëve poshtëshënuar:

1. Jani Vreto: "Vepra të Zgjedhura" 529
2. Kristo Frashëri: "Etnogjeneza e shqiptarëve" 531
3. Kristo Frashëri: "Principata e Arbërisë", 1190 – 1215, vështrim historik 534
4. Fallmerayer: "Elementi shqiptar në Greqi" 535
5. Sir Patrick Colquhoun & Vaso Pasha: "Pellazgët. Pasardhësit e tyre të sotëm dhe origjina pellazge e poemave të Homerit" 537
6. Aleksandër Meksi: "Albania e Kaukazit dhe shqiptarët" 538
7. Muharrem Abazaj: "Kodi i gjuhës pellazgo - shqipe" 539
8. Elena Kocaqi: "Albanët" 541
9. Elena Kocaqi: "Roli Pellazgo – Ilir në formimin e kombeve dhe gjuhëve europiane" 542
10. Moisi Kaghankatvaci: "Historia e Albanëve të Kaukazit" 543
11. Garegin D. Nalbandian: "Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit" 545
12. Kim Hahramanian: "1500 – Vjetori i Kanunit të shkruar Armen" 547
13. Informacione (Nxjerrë nga WIKIPEDIA) 549
14. Berzh Piranjani: Interpretim 553

JANI VRETO

"VEPRA TË ZGJEDHURA"

Mbledhur dhe përgatitur nga Alfred Uçi

Shtypshkronja "8 Nëntori", Tiranë, 1973

Ky qytet është Albanopolis-i i Ptolemeut ose Alvanon i bizantinëve, të cilët edhe krahinën e tërë e quanin me emrin Albanon, Arbanon, Arbanitian dhe Albanian. (Fq. 183)

Edhe ne e pranojmë se emri Albanoi dhe Albania, nuk njihej jo vetëm nga grekët e lashtë, por ai nuk njihet edhe sot as nga vetë shqiptarët. Të huajt i thërresin shqiptarët Alvanoi. Ai që s'e beson këtë, le të vijë e të thërresë me këtë emër një fëmijë, grua apo burrë, që nuk është shoqëruar ndonjëherë me të huaj; prej tyre asnjeri s'ka për ta kuptuar se cilin thërrasin. Në përgjithësi vehten tonë ne e quajmë shqyptarë ose shqiptarë dhe vendin, në të cilin banojmë, e quajmë Shqypëni ose Shqipëni, sipas dialektit të gegëve, dhe Shqypëri apo Shqipëri, sipas dialektit të toskëve. Po të thërresësh me këtë emër qoftë edhe një foshnjë, kjo ka për të t'u përgjigjur.

Edhe emri Alvanos nuk është as fjalë greke e as fjalë shqipe; të huajtë i thërresin me këtë emër shqiptarët. Dhe, siç thonë ata që dinë gjuhë të huaja, kjo fjalë do të thotë malësor ose i bardhë. Nëqoftëse e quajtën për herë të parë albanë ata që flasin një gjuhë në të cilën kjo fjalë do të thotë malësor, kanë patur të drejtë dhe në këtë punë

s'ka patur ndonjë djallëzi, sepse vendi ku banojmë është në pjesën më të madhe malor. Edhe nëqoftëse e quajtën kështu ata që flasin një gjuhë, në të cilën kjo fjalë do të thotë i bardhë, përsëri kanë të drejtë, sepse vishemi në përgjithësi e prej kohësh të lashta me rroba të bardha. Ata që kanë dashur ta nxjerrin origjinën tonë nga emri Albanos (Albanoi) janë gabuar dhe gënjyer fort. (Fq. 188-189)

KRISTO FRASHËRI

"ETNOGJENEZA E SHQIPTARËVE"

Vështrim historik

Botimet M&B, Tiranë 2013

Përsa i përket ngjashmërisë së emrit gjeografik Albania e Kaukazit me atë të Ballkanit – nuk duhet detyrimisht të shpjegohet me përkatësinë e tyre në të njëjtën etni, sikur njeri grup u shkëput nga tjetri. Sipas N. Joklit dhe të tjerëve, rrënja *Alb* – e përbashkët në të dy emërtimet etnogjeografike i përket gjuhëve të popullsive të stërlashta para-Indoeuropiane, pra mesdhetare. Në atë gjuhë të stërlashtë kishte kuptimin "lartësi", "mal i lartë". Me këtë kuptim fjalën alb (mal i lartë) e kanë huazuar popullatat e mëvonshme Indoeuropiane, duke e shndrruar edhe në emërtim të përveçëm, si Alpet e Zvicrës, Alpet e Italisë, Alpet Dinarike, Alpet Shqiptare dhe mjaft toponimi të botës mesdhetare që kanë rrënjë në fjalën *Alb* dhe *Alp*. Për këtë arësye, teza e F. Tajanit mbeti hipotezë. Madje ajo u la pas dore dhe më vonë nuk u përfill nga askush. (fq. 43).

Tashmë dihet se pikënisje e këtij problemi është njoftimi që na jep gjeografi aleksandrin i Shek. II, Klaud Ptolemeu, i cili në veprën e vet "Gjeografia" përmend ndër të tjerë një fis Ilir me emrin *Albanoi*. Sipas koordinatave që ai jep (gjatësi gjeografike 46 gradë, gjerësi gjeografike 41 gradë e 5 minuta) fisi *Albanoi* (në shqip: *albanë*) banonte në

trevën midis Durrësit dhe Dibrës. Ptolemeu përmend pranë fisit të Albanëve edhe qytetin e tyre në trajtën greqishte Albanopolis (qyteti i Albanëve), gërmadhat e të cilit janë zbuluar në fshatin Zgërdhesh, në afërsitë perëndimore të kalasë së Krujës. (fq. 225)

Për historianë dhe gjuhëtarët që janë marrë me etnogjenezën e shqiptarëve, emri i albanëve pas Ptolemeut zhduket nga burimet e shkruara historike për nëntë shekuj me rradhë. Ai shfaqet në shek. XI në veprën e kronistit bizantin Mihal Attaliati, kur ai flet për ngjarjet që ndodhën në rrethinat e Durrësit në vitet 40 dhe 70 të atij shekulli (fq. 225).

Qysh në vitin 1894 filologu i shquar danez, Holger Pedersen, shfaqi mendimin se në origjinë emri shqiptar duhet të ketë qenë me rrënjën arb dhe duhet të jetë kthyer nga shkrimtarët grekë në alb nën efektin e një asociacioni të errët me emrat gjeografikë të përngjashëm të kohës së lashtë. Është kryesisht fjala për emrin Alba të qytetit të Laciumit italik dhe Albania (Αλβανια) të TransKaukazit të banuar nga popullatat Albanoi (Αλβανοι), të cilat përmenden në literaturën antike greke e latine qysh në shek. IV p.e.s. Për Sufflay-n në këtë asociacion ka ndikuar rrënja paraindoeuropiane *Alb*, që ndeshet në gjeografinë e vjetër të Italisë dhe Kaukazit. (fq. 235)

Në lidhje me tezën e Holger Pedersenit se emri i lashtë i shqiptarëve duhet të ketë pasur rrënjën *arb* (arbanoi) dhe se vetë K. Ptolemeu e ka shndrruar në Albanoi (me rrënjën *alb*) nën ndikimin e emërtimit tepër të njohur të banorëve antikë të Kaukazit albanoi, mbetet hëpërhë një supozim. Megjithatë, edhe nëse apelativi albanoi, që përdor K. Ptolemeu ka qenë i saktë, nuk përjashtohet mundësia që ai gjatë shekujve të jetë shndrruar në arbanitë (me rrënjën *arb*).

Shndrrimi nga albanë në arbanitë mund të shpjegohet me fenomenin e përmendur pak të njohur që ka gjuha shqipe – shndrrimin në disa raste të *"l"* në *"r"*, ose e kundërta të *"r"* në *"l"*. Natyrisht, ky është një shpjegim i thjeshtëzuar. Nëse qëndron ose jo ky shpjegim, fjalën e fundit do ta thonë gjuhëtarët. Për ne ka

rëndësi konkluzioni që del nga ky debat: se në shek. XI dy emërtimet e ndryshme *albanoi* dhe *arbanitë*, që ndeshim tek M. Attaliati përfaqësojnë të njëjtën popullsi, me ndryshim se M. Attaliati me apelativin e parë *(albanoi)* i referohet trajtës së kaluar, kurse me të dytën, *arbanitë*, trajtës së kohës së vet. Që ato përfaqësojnë të njëjtën popullsi kemi si dëshmi kokëfortë se të dy këto trajta vazhduan të bashkëjetojnë deri në ditët tona, me ndryshim se trajta e parë me rrënjën *alb* përdoret nga të gjithë popujt e huaj në trajtat e njohura Albania, Albanien, etj., kurse trajta e dytë me rrënjën *arb* është përdorur në mënyrë të përgjithshme nga mbarë shqiptarët dhe nga fqinjët e tyre. (Fq. 237-238)

KRISTO FRASHËRI

“PRINCIPATA E ARBËRISË”

1190 – 1215, vështrim historik

Botimet M&B, Tiranë 2013

Principata mesjetare e arbërisë është formacioni i parë shtetëror shqiptar. Ajo shfaqet në burimet historike në fund të shek. XII, më saktë në vitin 1190. Principata e Arbërisë jetoi si shtet i lirë njëçerekshekulli (1190 - 1215) (fq. 7)

J. PH. FALLMERAYER

"ELEMENTI SHQIPTAR NË GREQI"

Përktheu nga gjermanishtja: Nestor Nepravishta

Botimet "SARAÇI", Shtypur në shtypshkronjën "Morava"
Tiranë, Nëntor 2003

Pothuajse njëkohësisht me pikëpamjen e paraqitur nga Tunmani dhe të mbrojtur nga Liku, ekzistonte dhe përpiqej të zinte vend, të afirmohej një mendim diametralisht i kundërt, i cili shpallte se *shqiptarët ishin një popull i përzier, (fillimisht) i afërm me bullgarët finë.* Sipas përkrahësve të kësaj pikëpamjeje, ky popull i përzier vetëm mbas shek. VIItë ka imigruar në Shqipërinë ilirike, duke ardhur nga Albania e Kaukazit nëpërmjet Rusisë së Jugut dhe Gadishullit të Krimesë. (Fq. 43)

Përdorimi i emrit Alb, Alp, Alba, Albion dhe Albania shtrihet në një varg pothuaj të pandërprerë nga bregu i detit Kaspik deri tek grykat më të skajshme të Kaledonisë dhe duket se është e pamundur të ketë një kuptim të ndryshëm nga ai i "vend malor" dhe "banor i malësive". Sipas Arndtit, në keltishten e vjetër fjala *al, alb, alp* në të vërtetë ka qenë një emërtim i përgjithshëm për atë që ne e quajmë *mal.* Dhe meqë në gjuhën shqipe *schkep, schkip, schkipe* edhe sot ka kuptimin *shkëmb,* ka mundësi, që me hyrjen e rrokjes së prejardhur mashkullore "tar", të ketë lindur emri vendës

i popullit Schipetar (shqiptar), gjë që pastaj duhej të përkthehej me "banor i një vendi shkëmbor". (Fq. 83-84)

Shndrrimi i *l* -së në *r* është një rregull gjuhësor i stërlashtë i latinishtes dhe i greqishtes. ... Vetë kronistët e Oborrit Bizantin në kohën kur filluan të përmendeshin për herë të parë shqiptarët aty nga fundi i shek. XItë, kudo ku flasin për ta bëjnë fjalë vetëm për një krahinë, vend dhe një grykë mali *Arbanon,* si edhe për një fis luftarak të *Arbanitëve.* (Fq. 85)

Një lidhje të mundshme të stërlashtë të shqiptarëve (albanëve), arbanitëve dhe të Arbërisë në Ilirinë Europiane me ʻΑλβανοι dhe ʻΑρβιες të Eskilit dhe Strabonit në Iran dhe në Kaukaz asnjeri nuk e kundërshton tek z. Nikokles. Vetëm se mënyrën se si e shikon ai tani për tani rrugën se si imigruan këta bartës të emrit në Europë, kështu siç kërkon ta paraqesë dr. Nikokles, do ta hedhim poshtë si arbitrare, shtrembëruese, të pabazuar dhe aventureske. (Fq. 90-91)

Është e qartë se edhe mendjemprehti Tunman i ka rënë në të kur thotë se bizantinët, të cilët i kanë njohur shqiptarët e mirëfilltë së pari në Albanopolisin e krahinës malore, ku përmenden si një popull baritor i pavarur dhe luftarak, më vonë do të kenë përdorur emrin e tyre për cilësimin e përgjithshëm të të gjithë malësorëve të tjerë të Ilirisë dhe të Epirit, meqë këta dhe banorët e Albanopolisit kishin të njëjtën gjuhë dhe të njëjtat zakone.

SIR PATRICK COLQUHOUN & VASO PASHA:

“PELLAZGËT. PASARDHËSIT E TYRE TË SOTËM DHE ORIGJINA PELLAZGE E POEMAVE TË HOMERIT”

Botime Artini, Prishtinë, 2017

Në gjuhën Galike malësorët quhen Albanaich, kurse Kaledonianët quhen Albanian ose Forrester (njerëz të pyllit). (fq. 59)

ALEKSANDËR MEKSI

"ALBANIA E KAUKAZIT DHE SHQIPTARËT"

(Kopjuar nga botimi në "Univers" 11, Tiranë 2009)

Është gjithashtu me interes e dhëna e Stefan Bizantinit, i cili thotë se ata janë arianoi, me sa duket termi fillestar duhet të ketë qenë aran, prej nga nën influencën e Armenishtes kemi *alvan-aluan* nga dhe rrjedh greqishtja *alvanoi*. "Çuditërisht" në të gjitha botimet e burimeve dhe studimet për rajonin, dhe në mënyrë të veçantë në ato për *Albanët* dhe *Albaninë e Kaukazit,* askush, d.m.th. as dhe një studiues, nuk merret dhe as nuk i ka shkuar në mendje që të gjejë lidhje ndërmjet tyre dhe Shqiptarëve, për arsyen e vetme sepse ato as që ekzistojnë.

MUHARREM ABAZAJ

"KODI I GJUHËS PELLAZGO - SHQIPE"

EMAL, Tiranë 2011

6.3 Arbër/Arbëri

Dokumentimi më i hershëm i këtij emërtimi është bërë nga Ptolemeu i Aleksandrisë në shek. II-të të erës sonë, i cili e përmend atë si një fis Ilir që banonte diku në territorin e Durrësit. Ai e përmend këtë fis me emrin Albanoi dhe thotë se ata kanë edhe kryeqendrën e tyre Albanopolis. Ky dokumentim nga ana e Ptolemeut në shek. II të erës sonë nuk do të thotë se ky emërtim i përket kësaj periudhe; ai mund të ketë ekzistuar shumë kohë para se të jetë venë re nga Ptolemeu.

Për prejardhjen e këtij emërtimi janë shprehur mendime të ndryshme nga shumë studjues shqiptarë dhe të huaj. Një grup studjuesish, i përbërë nga gjuhëtarë shqiptarë dhe të huaj, ndër ta Çabej, Domi, Krahe, Majer, Sprache, e konsiderojnë të padiskutueshëm emërtimin e Ptolemeut "Albanoi" dhe janë të mendimit se fjala "Albanoi" është një fjalë e përbërë nga fjala e parme "Alb" dhe prapashtesa Ilire "ano". Për këtë prapashtesë ata janë të mendimit se ajo mund të jetë një përzierje midis Ilirishtes dhe Latinishtes. Nga ana e Demirajt, tema "Alb" është konsideruar si jo e natyrës së gjuhës shqipe dhe këtë ai e trajton në trajtën "Arb".

Duke mos qenë dakord me përfundimet e tyre për prejardhjen e këtij emërtimi, po shtjellojmë më poshtë pikëpamjen tonë :

Duke qenë se të gjitha fiset Ilire janë fise Pellazge, edhe emërtimi i përbashkët i tyre duhet të jetë bërë mbi bazën e kësaj gjuhe, të gjuhës Pellazgo – Shqipe. Por, si e kemi theksuar disa herë, këto emërtime kanë vetëm një mënyrë ndërtimi të vetme, e cila bëhet mbi bazën e një kompozimi disa fjalësh. Për rastin që po shqyrtojmë, Albanoi, duhet të bëjmë edhe një sqarim tjetër.

Edhe Ptolemeu, si shumë autorë të lashtësisë, nuk ka arritur të përputhë shqiptimin e kësaj fjale nga ana e vet banorëve vendas me mënyrën e paraqitjes grafike (me shkrim) në gjuhën e tij. Trajta Albanoi nuk është e saktë. Në vend të trajtës "Alban" duhej të përdorej trajta "Arban", e cila është në natyrë të Pellazgo – Shqipes.

Emërtimi "Arban" është i ndërtuar mbi bazën e kompozimit : *Ar – ban,* ndërsa prapashtesa (oi) është shtesim i mëvonshëm, nuk hyn në emërtimin fillestar.

Pjesa e parë e togfjalëshit – *Ar* (arë) për ne tani është fare e qartë. Ajo ka kuptimin e tokës së punueshme, të arës. Ndërsa elementi i dytë i kompozimit, "ban" është kuptimi i foljes "bëj" por në trajtën e gegërishtes. Kuptimi i plotë i emërtimit Arban është shumë i kuptueshëm; *Arban = bën + arë,* njeri që ka si mjeshtëri të bërit e një pjese toke të çfarëdoshme, në tokë pjellore, njeri që është mjeshtër i punëve bujqësore, bujk. (fq. 123 – 124).

Nga ky emërtim i banorëve si *Arbër,* e mori emrin edhe krahina e tyre Arbana. Sot kemi një fshat pranë Tiranës me emrin Arbana, i cili përfshihet në atë territor ku kanë banuar *Arbanët* dhe ky emërtim nuk duhet të jetë i rastësishëm. (fq. 125).

Shtrohet problemi: pse ky emërtim "Arbër" u përgjithësua për të gjitha fiset e tjera ilire? (fq. 125).

ELENA KOCAQI

"ALBANËT"

Trojanët e kanë quajtur veten dardanë dhe albanë dhe kjo duket tek emrat që u vunë vendeve të reja ku u vendosën pas shpërnguljes së një pjese të popullsisë nga Troja. Kështu, Ene Dardanidi qytetin që themeloi në Itali e quajti Alba. Nipi i tij, Briti, pasi u vendos në Britani e quajti një pjesë të saj Albani,.. . Pra ka fakte që ata e mbanin veten për albanë dhe dardanë, emra që dalin tek dy fiset ilire të dardanëve dhe albanëve në antikitet. Por edhe sot të vetmit popuj që quhen albanë dhe dardanë janë shqiptarët.

Nuk është rastësi që populli shqiptar i sotëm quhet me emrin më të vjetër të Europës "Alban" me të cilin janë quajtur tërë popujt e Europës së vjetër. Kështu Britania është quajtur Albion dhe Skocia, Albani, fiset gjermane teutono – trojane janë quajtur nga Straboni me emrin Albane, në Itali trojanët ngritën qytet me emrin Alban, në Detin e Zi Skithët e quanin veten Alban, etj. (fq.11).

Emri "alban" sipas të gjitha burimeve historike dhe shkencore, do të thotë "i Bardhë". Skithët që banonin në veri të Detit të Zi, të cilët ishin të së njëjtës racë me iliro-trojanët, thonë në kronikat e tyre se flokët tanë bjondë na vendosën emrin "Alban". Në të gjithë fjalorët fjala "albino" do të thotë "njeri i bardhë". Me një fjalë, emri Albanë me të cilin njihen shqiptarët e sotëm nga bota, ka kuptimin - *i bardhë.* (fq.12).

ELENA KOCAQI

"ROLI PELLAZGO – ILIR NË FORMIMIN E KOMBEVE DHE GJUHËVE EUROPIANE"

Shqiptarët quhen nga të huajt si Albanë dhe këtë emër duket se ata e lidhin me fisin e Albanëve që përmend gjeografi Ptoleme në shek. e IItë p.e.s.. Shqiptarët e kanë quajtur veten e tyre "arbën" pra që është e njëjta fjalë me "alban" dhe kjo do të thotë se ata e kanë mbajtur veten e tyre për "alban". Kështu që është një emër i lidhur me etninë shqiptare.

Fjalët *Alban, Arban* dhe *Arian* kanë të njëjtin kuptim – *i bardhë.* Pra, shqiptarët ruajnë në emrin e tyre simbolin e racës së bardhë. (fq.101)

MOISI KAGHANKATVACI

"HISTORIA E ALBANËVE TË KAUKAZIT"

Kreu 4. Vagharshaku emëron një sundimtar mbi Albanët. (Fq. 18)

Këtu fillon qeverisja (historia) e Albanëve. Ne nuk mund të themi diçka përfundimtare në interes të lexuesve tanë rreth popullit që ka pasë populluar Malin e madh të Kaukazit nga krijimi i botës deri në shfaqjen e Vagharshakut, mbretit të Armenisë. *Me vendosjen e sundimit të tij mbi veriorët, ai bashkoi rreth tij tributë e huaja të egra që banonin në rrafshinat veriore dhe ato që ndodheshin në rrëzë të maleve të Kaukazit, si edhe në lëndinat dhe luginat jugore që shërbenin si porta hyrje për në rrafshinat veriore,* dhe i urdhëroi ato të ndalonin plaçkitjet dhe vrasjet dhe të pagonin tribute për mbretin. Ai vendosi mbi ta qeveritarë dhe prefektë, shefi i të cilëve, me urdhër të Vagharshakut, ishte njëfarë Aran, nga familja Sisakan, pasardhës të Xhafetit, i cili mori rrafshinat dhe malet e Albanisë duke filluar nga lumi Arakses deri në fortesën Hnarakert. Dhe ata e quajtën vendin *Aluank (Aghvank)* për shkak të rrugëve nëpër të cilat mund të udhëtohej lehtësisht, pasi e quanin atë *Alu (i ëmbël)* për shkak të ambientit mirëdashës (mikpritës). Dhe prej pasardhësve të tyre, ata thonë, që Vagharshaku - Parthi (pasi e konsideronin të prejardhur nga Parthët), emëroi shumë qeveritarë, njerëz të famshëm dhe me vlera; dhe prej djalit të tij,

thonë ata, rrodhën banorët e principatave të Utikut, Gardmanit, (Kovdkut dhe Gargarkut).

Deri më këtu tashmë kemi paraqitur gjenealogjitë (e ndryshme).

Kreu 5. Pjelloria dhe bollëku në krahinat e Albanisë, dhe në gjithçka që ajo përmbante për nevojat e njeriut. (Fq. 18 – 19)

E vendosur ndërmjet maleve të larta të Kaukazit, toka e Albanisë është e mrekullueshme dhe tërheqëse, me shumë avantazhe natyrale. Lumi i madh Kur rrjedh ëmbël nëpër të, duke sjellë me bollëk peshk të madh e të vogël, dhe duke e përfunduar udhëtimin e tij në Detin Kaspik. Në rrafshinat, që ndodhen rreth e rrotull tij, gjendet me shumicë drithë dhe verë, naftë dhe kripë, mëndafsh dhe pambuk, dhe një numër i pafund pemësh ulliri. Në malet është gjetur ar, argjend, bakër dhe okër (temjan i verdhë). Përsa i përket kafshëve të egra, atje gjenden luanë, leopardë, pantera, dhe gomerë të egjër, ndërsa përsa i përket zogjve, mund të përmendim shqiponjën, skifterin, etj. Dhe si kryeqytet, Albania ka qytetin e madh të Partavit.

Kreu 6. Të dhëna mbi mënyrën se si Zoti u shfaq tek ne lindorët. (Fq. 19)

GAREGIN D. NALBANDIAN

"LEGJENDA E HAJKUT DHE BEL NIMRODIT"

Aran, që nënkupton Ara, gjithashtu, është quajtur Arean Ara nga Moisi Korenaci. Arani është një prej djemve të Aras së Bukur; ai u martua me një pasardhëse të Sisakut dhe pati si trashëgimtar Anushavanin.

Anushavan në gjuhën Armene ose Aluavan në gjuhët Hurro-Urartiane ishte djali i Aranit. Nga Arani dhe Aluavani rrjedhin fisnikët e Arranit dhe vendi mori emrin *Aluank* ose *Alvank,* që njihet gjithashtu si *Albania,* një mbretëri në veri të Arranit. Kjo sipërfaqe ishte pjesë e Armenisë deri sa u pushtua prej Persianëve, dhe mori emrin Arran-Albania, dhe populli i Alvankut mori emrin populli Alban... Arran-Albania përfshinte tokat e Bardos, Lekanit dhe Movkanit. *Shekuj më vonë, Armenia dhe Albania u pushtuan prej Romakëve, dhe shumë Armenë dhe Albanë u lëvizën në drejtim të Gadishullit Ballkanik dhe pjesëve të tjera të Europës prej Romakëve dhe Greko-Bizantinëve.* (Fq. 148)

Bardos në Greqisht dhe Bard ose Bardan në gjuhën Ariane ishte djali i tretë i Torgomit. Ai mori gjysmën e asaj që kishte mbetur nga tokat e Torgomit pas ndarjes së pjesëve për trashëgimitë e vëllezërve të tij më të mëdhenj. Tokat e Bardosit ishin tokat në lindje të Malit Artaz deri në Lumin Kura (Lumi Kura gjithashtu

quhej edhe Qiura Taikh në gjuhët Urartiane dhe Ariane) dhe nga Lumi Kura deri në Malin Savalan ose Sabaghan. Qyteti i banimit të Bardosit quhej Barda; megjithatë, Vardasheni bashkë me vendbanime dhe qytete të tjera e morën emrin po ashtu nga Bardi. Bardosi themeloi një qytet në perëndim të bregut të Lumit Kur dhe e quajti atë Barda. (Fq. 151)

KIM HAHRAMANIAN

"1500 – VJETORI I KANUNIT TË SHKRUAR ARMEN"

..., në vitin 428 pas Krishtit, Mbretëria Armene tashmë ndodhej e shkatërruar. Ajo u reformua dhe u shndërrua ne një Marz (Krahinë periferike); dhe me qëllim që të siguronte sa më lehtë qeverisjen e kësaj njësie të re administrative, Persianët eleminuan të gjitha rrugët e mundshme të rivendosjes së pavarësisë dhe shkëputën prej saj krahinat lindore – Arcah dhe Utik, të cilat gjithnjë ishin quajtur si "Pjesa Lindore" ose "Bota Lindore". Këto të fundit ju aneksuan fiseve Albane, që në atë kohë qeveriseshin nga Persia, dhe që zinin një hapësirë që fillonte nga lumi Kura deri në vargmalet Kaukaziane, duke krijuar kështu një tjetër provincë të quajtur Ahvank (të njohur ndryshe si Albania e Kaukazit ose Alvania). (Fq. 5)

Bile edhe historianët Grekë dhe Romakë të kohës së vjetër kanë shkruajtur se Armenia ndahej prej fiseve Albane nga lumi Kura. Në përpjekje për të rishikuar këto burime informacioni, i ashtuquajturi themelues i disiplinës historike të Azerbaixhanit, Abass-Kuli-Aga Bakikanov ka shkruajtur: " Kufiri Armen shtrihet përgjatë bregut të djathtë të lumit Kura deri në pikën ku lumi Araks fillon rrjedhën" (Gjylistan-Iram, Baku, 1926, c,8).

Zonat në veri të lumit Kura ishin të populluara nga një duzinë fisesh të vogla, dhe përgjithësisht nga historianët e vjetër ishin të njohura si "Albania", që do të thotë "vendi i maleve". Ja vlen të

përmendim këtu që këto vende kanë këtë emër akoma edhe sot , pasi “Dagestan” në gjuhën e vendit përkthehet si “Vendi i Maleve”. Sot, këto vende banohen prej shumë grupeve të ndryshme etnike, ashtu siç ka qenë edhe në të kaluarën. (Fq. 6)

INFORMACIONE (NXJERRË NGA WIKIPEDIA)

A) WIKIPEDIA PËR "ALBANIA E KAUKAZIT"

Albania e Kaukazit është një eksonim *(eksonim - emërtimi që përdorin të huajt për një vend të caktuar)* modern për një vend të lashtë në Kaukazin lindor, në territorin e republikës së sotme të Azerbajxhanit (ku ishin të vendosura të dy kryeqytetet e saj) dhe të Dagestanit jugor. Endonimi *(endonim - emërtimi që përdorin vendasit për vendin e tyre)* i tij është i panjohur. Emri Albania rrjedh nga emri i lashtë Grek Ἀλβανία dhe ai Latin Albania. Prefiksi "Kaukazian" përdoret thjesht për të shmangur ngatërresën me Albaninë moderne të Ballkanit *(bëhet fjalë për Shqipërinë; Shënim BP),* e cila nuk ka lidhje të njohura gjeografike apo historike me Albaninë Kaukaziane.

Aghuank (Sipas Armenishtes së Vjetër: Աղուանք Ałuank '; sipas Armenishtes Moderne: Աղվանք - Aġvank ') është emri Armen për Albaninë Kaukaziane. Autorët Armenë përmendin se emri rrjedh nga fjala "ału" ("աղու" -) *(transkriptimi në Shqip – aghu: Shënim BP)* që do të thotë miqësor (dashamirës) në gjuhën Armene. Termi Aghuank është polysemik dhe është përdorur në burimet Armene, gjithashtu, për të treguar rajonin midis lumenjve Kur dhe Araks si pjesë e Armenisë. Në rastin e fundit ajo nganjëherë përdoret në formën "Aghuanku Armen" ose "Haj-Aghuank"

(Armenët e quajnë veten e tyre "Haj": Shënim BP)

Historiani Armen i kësaj krahine, Moisi Kaghankatvatci, i cili la të vetmen histori të shkruajtur pak a shumë të plotë rreth krahinës, shpjegon emrin *Aghvank* si i prejardhur nga fjala *Ału* (që në gjuhën Armene do të thotë - i ëmbël, i butë, miqësor), e cila, thotë ai, ishte nofka e guvernatorit të parë të Albanisë Kaukaziane, Arranit, dhe i referohej personalitetit të tij të butë. Moisi Kaghankatvatci dhe burime të tjera të lashta shpjegojnë *Arranin* ose *Arhanin* si emrin e themeluesit legjendar të Albanisë Kaukaziane *(Aghvan)* ose edhe të fisit iranian të njohur si *Alanët (Alan),* i cili në disa versione paraqitet si bir i djalit të Noes, Xhafetit.

James Darmesteter, përkthyes i *Avesta-s,* e krahasoi *Arranin me Airiana Vego,* të cilin ai e konsideroi të ketë qenë në krahinën e *Araxes-Ararat,* megjithëse teoritë moderne tentojnë ta vendosin këtë në lindje të Iranit.

Partët (Parthët) përdornin për krahinën emrin *Ardhan (Në Persinë e Mesjetës: Arran).* Në Arabisht ishte *ar-Rān.* Në gjuhën Gjeorgjiane, ajo njihej si *რანი - Rani.* Në Greqishten e lashtë, ajo ishte *Ἀλβανία - Albanía.* Se si e quanin atë banorët e saj, kjo është e panjohur (nuk dihet).

Kryeqyteti i mbretërisë gjatë antikitetit ishte Qabala (Kabala, Kapalak).

Burimet klasike janë unanime në përcaktimin e lumit Kura (Cyros) si vija e kufirit midis Armenisë dhe Albanisë pas pushtimit të territoreve në bregun e djathtë të lumit Kura nga Armenët në shekullin e 2 p.e.s.

Fillimisht, të paktën disa nga Albanët Kaukazianë ndoshta flisnin gjuhën Lezgike, të afërt me atë të atyre që gjenden në Dagestanin e sotëm; gjithsesi, mendohet se mund të jenë folur deri në 26 gjuhë të ndryshme në Albaninë Kaukaziane.

Pas kristianizimit të Albanëve të Kaukazit në shekullin e 4-të, pjesë të popullsisë u asimiluan nga Armenët (të cilët dominonin

në provincat Arcakh dhe Utik, që ishin më parë të shkëputura nga Mbretëria e Armenisë) dhe nga Gjeorgjianët (në veri), ndërsa pjesët lindore të Albanisë Kaukaziane u islamizuan dhe u asimiluan nga popujt Iranianë dhe më pas nga ata Turq (Azerbajxhani modern).

Mbetje të vogla të këtij grupi vazhdojnë të ekzistojnë në mënyrë të pavarur dhe njihen si populli Udi.

Sipas historianëve Armenë mesjetarë Moisi Khorenaci, Moisi Kaghankatvaci dhe Koriun, alfabeti i Albanëve të Kaukazit u krijua nga murgu, teologu dhe përkthyesi Armen, Mesrob Mashtots, i cili gjithashtu ishte ngarkuar me detyrën e krijimit të alfabetit Armen. Ky alfabet u përdor për të shkruar gjuhën Udi, e cila ndoshta ishte gjuha kryesore e Albanëve të Kaukazit.

Një alfabet i Albanëve të Kaukazit, me pesëdhjetë e dy germa që ruajnë ngjashmëri me karakteret Gjeorgjiane, Etiopiane dhe Armene, ka arritur të mbijetojë nëpërmjet disa pak mbishkrimeve dhe një dorëshkrimi Armen që datonte nga shekulli i 15-të.

B) SHËN BARTOLOMEU (NXJERRË NGA WIKIPEDIA)

Lindur në Judea, Shekulli i Irë i erës sonë.

Vdekur në Albanopolis, Armeni, Shekulli Irë i erës sonë.

Së bashku me mikun e tij Xhud Tadeus (Jude Thaddeus), Bartolomeu ka reputacionin e njeriut, që solli Krishterimin në Armeni në shek. Irë të erës sonë. Kjo është arësyeja, që të dy këta shenjtorë konsiderohen "Shënjtorët Mbrojtës" të Kishës Apostolike Armene.

Thuhet se ai është martirizuar në *Albanopolis, në Armeni.* Sipas një historie, atë e kanë dënuar me prerje koke, ndërsa sipas një historie tjetër, që gëzon më tepër popullaritet, thuhet se ai është vrarë duke u rrjepur i gjallë dhe më pas i kryqëzuar me kokë poshtë. Thuhet që ishte pikërisht ai, që e konvertoi në të krishterë Polimius-in,

mbretin e Armenisë. Më pas, vëllai i Polimius-it, Astiexhi (Astyages), kur erdhi në fuqi, urdhëroi ekzekutimin e Bartolomeut.

Manastiri i Shën Bartolomeut është një manastir i famshëm Armen i ndërtuar në shek. e 13të të erës sonë në vendin e martirizimit të Apostullit Bartolomeu, në krahinën Vaspurakanit të ish Armenisë së Madhe (krahina e Vaspurakanit sot ndodhet brenda kufijve të Turqisë, në pjesën jug-lindore të saj).

BERZH PIRANJANI

INTERPRETIM

Kur përpiqesh të trajtosh temën e prejardhjes së emrit Alban, dalin përpara teje një sërë pikëpyetjesh:

1. Kur del për herë të parë në skenën e historisë emri "Alban", në ç'formë dhe nga goja e kujt? Kujt populli i mbivihet?
2. Po njëlloj: Kur del në skenën e historisë Ballkanike emri "Alban", në ç'formë dhe nga goja e kujt? Kujt populli i mbivihet?
3. Përse Romakët apo ajo pjesë e banorëve të Greqisë për të cilët pretendojmë që janë me origjinë Pellazge, pra të të njëjtit grupim me Ilirët apo Shqiptarët e sotëm, do të duhej që t'i emërtonin vëllezërit apo farefisin e tyre (Albanët e Ballkanit), me emrin "Të Bardhët", kur ata vetë ishin të bardhë dhe i përkisnin po asaj race?
4. Si argumentohet emërtimi "Alban" për "Albanët e Kaukazit" nga Grekët dhe Romakët me kuptimin "banor i malësive", kur pjesa më e madhe e territorit të quajtur "Albania e Kaukazit", pra, zona që shtrihet në të majtë të lumit Kura, praktikisht është zonë fushore?
5. Si u shndrrua emri "Alban" në "Arban", apo emri "Alvan" në "Arvan"?
6. A ka ndonjë lidhje emri "Aghvank" i përdorur nga Armenët për "Albanët e Kaukazit" dhe emërtimi "Alban" , "Arban", "Alvan", "Arvan" i përdorur nga Romakët dhe Grekët për "Albanët" e Kaukazit dhe të Ballkanit?

Këto dhe një sërë pikëpyetjesh të tjera, që dalin gjatë rrugës për ndriçimin e origjinës dhe kuptimit të emrit "Alban", do të përpiqemi t'i trajtojmë në vazhdim:

DUKE KRIJUAR NJË HISTORI PËR SHFAQJEN E EMRIT "ALBAN" NË KAUKAZ DHE BALLKAN

Duke u mbështetur në shkrimet sa më sipër, dalin në pah e të padiskutueshme dy pohime:

Pohimi 1.

Që për herë të parë, në skenën Ballkanike, emërtimin "Albanoi" e hasim tek - "njoftimi që na jep gjeografi aleksandrin i shek. II, Klaud Ptolemeu, i cili në veprën e vet "Gjeografia" përmend ndër të tjerë një fis Ilir me emrin Albanoi." (K.Frashëri, Etnogjeneza e shqiptarëve, Fq. 225). Më poshtë, po aty K. Frashëri vazhdon:

"Sipas koordinatave, që ai jep (gjatësi gjeografike 46 gradë, gjerësi gjeografike 41 gradë e 5 minuta), fisi Albanoi (në shqip : albanë) banonte në trevën midis Durrësit dhe Dibrës. Ptolemeu përmend pranë fisit të Albanëve edhe qytetin e tyre në trajtën greqishte Albanopolis (qyteti i Albanëve), gërmadhat e të cilit janë zbuluar në fshatin Zgërdhesh, në afërsitë perëndimore të kalasë së Krujës. (fq. 225)

Për historianë dhe gjuhëtarët që janë marrë me etnogjenezën e shqiptarëve, emri i albanëve pas Ptolemeut zhduket nga burimet e shkruara historike për nëntë shekuj me rradhë. Ai shfaqet në shek. XI në veprën e kronistit bizantin Mihal Attaliati, kur ai flet për ngjarjet që ndodhën në rrethinat e Durrësit në vitet 40 dhe 70 të atij shekulli (fq. 225)."

Po sipas këtij autori (Kristo Frashëri: "Principata e Arbërisë", 1190 –1215, vështrim historik) kemi:

"Principata mesjetare e arbërisë është formacioni i parë shtetëror shqiptar. Ajo shfaqet në burimet historike në fund të shek. XII, më saktë në vitin 1190. Principata e Arbërisë jetoi si shtet i lirë njëçerekshekulli (1190 - 1215) (fq. 7)"

Them pohime të padiskutueshme, sepse janë dy fakte të pranuara botërisht nga të gjithë studiusit e këtij problemi. Pra, shfaqet në trajtën "Albanoi" në periudhën e pushtimit romak të kësaj treve, kur si gjuhë zyrtare e perandorisë ishte gjuha romake (latinishtja) dhe shfaqet "Principata e Arbërisë" në periudhën Bizantine, kur si gjuhë zyrtare e perandorisë ishte bërë gjuha greke. Interesant, është fakti që për qytetin e tyre, Ptolemeu shprehet në trajtën greqishte "Albanopolis".

Pohimi 2.

Në legjendat Armene dhe në historinë moderne shkencore të shtetit Armen, kur bëhet fjalë për kohët e lashta, si shtet fqinj kufitar i tij në anën verilindore përmendet shteti i Albanisë. Si kufi ndarës ndërmjet tyre përmendet lumi Kura, ndërsa në anën lindore shteti i Albanisë shtrihej deri në detin Kaspik.

Ja ç'thotë legjenda për të:

"Nga Arani dhe Aluavani rrjedhin fisnikët e Arranit dhe vendi mori emrin Aluank ose Alvank, që njihet gjithashtu si Albania, një mbretëri në veri të Arranit. Kjo sipërfaqe ishte pjesë e Armenisë deri sa u pushtua prej Persianëve, dhe mori emrin Arran-Albania, dhe populli i Alvankut mori emrin populli Alban. (G. D. Nalbandian: "Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit", Fq. 148)

Ja ç'thotë Moisi Kaghankatvaci tek: "Historia e Albanëve të Kaukazit" për ta:

Vagharshaku emëron një sundimtar mbi Albanët. (Fq. 18)

...

Dhe ata e quajtën vendin Aluank (Aghvank) për shkak të rrugëve nëpër të cilat mund të udhëtohej lehtësisht, pasi e quanin atë Alu (i ëmbël) për shkak të ambientit mirëdashës (mikpritës).

Në librin "Historia e Armenisë" me autor Artak Movsisjan shkruhet: "Sovraniteti i Mediave ra në mesin e shek. të 6të para Krishtit, kur djali i Jervantit të Irë, Tigran Jervantani, duke u bashkuar me mbretin e Persisë, me Kirin e Madh, u ngrit në kryengritje kundër Medias. Ortaku kryesor i Kirit të Madh në këtë kryengritje ishte Tigrani, sundimi i të cilit, përveç se mbi gjithë Armeninë, shtrihej gjithashtu edhe mbi Kapadokinë, Gjeorgjinë dhe Albanët (bëhet fjalë për Albanët e Kaukazit – *Shënim B.P.*). (Fq. 40)

Duke kërkuar në Wikipedia nën titullin "Albania e Kaukazit" ndeshesh me këtë shkrim:

"Sipas Strabonit, Albanët ishin një grup prej 26 fisesh që jetonin në veri të lumit Kura dhe secili prej tyre kishte mbretin dhe gjuhën e vet. Diku para shekullit të Irë para Krishtit ata u bashkuan në një shtet dhe drejtoheshin nga një mbret."

"Pas kristianizimit të Albanëve të Kaukazit në shekullin e 4të, pjesë të popullsisë u asimiluan nga Armenët (të cilët dominonin në provincat Arcakh dhe Utik, që ishin më parë të shkëputura nga Mbretëria e Armenisë) dhe nga Gjeorgjianët (në veri), ndërsa pjesët lindore të Albanisë Kaukaziane u islamizuan dhe u asimiluan nga popujt Iranianë dhe më pas nga ata Turq (Azerbajxhani modern).

Mbetje të vogla të këtij grupi vazhdojnë të ekzistojnë në mënyrë të pavarur dhe njihen si populli Udi."

Përsëri sipas Moisi Kaghankatvacit tek: "Historia e Albanëve të Kaukazit" hasim:

"Në mbyllje të vitit të 300të të epokës Armene (28.4.851-26.4.852), princat e krishterë të Armenisë dhe Albanisë paguanin çmimin e mëkateve të tyre, sepse në këtë vit ata u morën robër, dhe të lidhur në pranga nga Arabët u larguan nga shtëpitë e tyre dhe u dërguan kundër vullnetit të tyre në Bagdad." (Fq. 250)

Po sipas M. Kaghankatvacit, tek "Kreu 23, fq. 257", kur flet për "Emrat e patriarkëve të Albanisë dhe veprat e tyre", në fund të listës kemi:

...

Imzot Gagik, katërmbëdhjetë vjet, nga peshkopata e Gardmanit. Viti i tij i katërt i qëndrimit në fron korrespondon me vitin e 400të të epokës Armene (3.4.951- 1.4.952).

Imzot David, shtatë vjet, nga peshkopata e Kapalakut.

Imzot David, gjashtë vjet. Ai u shenjtërua nga Anania, Katolikos i Armenisë.

Imzot Petros, tetëmbëdhjetë vjet, nga peshkopata e Gardmanit.

Imzot Moisi, gjashtë vjet nga paria e manastirit të Parisos.

Nisur nga sa më sipër del se si patriark i fundit i Albanisë së Kaukazit përmendet Imzot Moisi, i cili duket ka qenë në detyrë deri në vitin 999 - 1000. Pas kësaj date Peshkopata e Albanisë dhe vetë Principata e Albanisë nuk duket të përmenden më si lojtarë të historisë së asaj zone. Nën sundimin e ashpër afro 200 vjeçar të Arabëve dhe më pas nën presionin e fortë të dyndjeve turke, popullsia vendase u detyrua të shpërngulet ose të pranojë mbijetesën në kushte sundimi, duke pranuar njëkohësisht edhe kalimin në besimin e pushtuesit.

ANALIZË

Çasti 1

Nga përmbajtja e shkrimeve që ndodhen në Pohimin 1 dhe 2 mund të nxjerrim:

1. Alban - si emër fillimisht shfaqet në Kaukaz dhe më pas në Ballkan.
2. Albanët e Kaukazit, sipas shkrimeve sipërpërmendur shfaqen rreth shek. 6të p.e.s. dhe në formën e shumësit "Albanët" dhe jo në numrin njëjës e në formën e një shteti të formësuar "Albania"

siç përmendet Gjeorgjia dhe Kapadokia dhe zhduken nga skena e historisë nga fundi i shek. 10të pas Krishtit (rreth viteve 1000 pas Krishtit). (*Shënim B.P.:* E trajtuar "Albanët" lë të kuptosh se bëhet fjalë për emërtimin e banorëve apo fiseve që e popullojnë atë jo në formën e një shteti të organizuar).

3. Albania e Kaukazit shfaqet në formën e një shteti të formësuar si shtet vasal në kohën e Tigranit të Madh (Perandori i Armenisë, 140 – 55 p.e.s.) dhe po kështu trajtohet më pas në përballje me Romakët, Bizantin, Arabët, Turqit deri në asgjësimin përfundimtar si shtet.
4. Albania e Ballkanit (Shqipëria sot) shfaqet rreth shek. 2të pas Krishtit në formën e një fisi ilir të emërtuar "Albanoi", për t'u zhdukur dhe rishfaqur përsëri në po ato krahina në vitet 1190, tashmë në formën "Arbëria".
5. Në Ballkan termi "Albanoi" shfaqet në periudhën e pushtimeve Romake kur në perandorinë Romake gjuhë zyrtare ishte latinishtja, ndërsa termi "Arbër" shfaqet në periudhën Bizantine kur gjuhë zyrtare e Perandorisë Bizantine ishte gjuha greke.

Çasti 2

Nga përmbajtja e shkrimeve që ndodhen në Pohimin 1 dhe 2 mund të nxjerrim, gjithashtu:

Ky emër fillimisht shfaqet si eksonim në formën *Աղուան - Աղվանք* (Aghvank, Ahvank, Arvank, Alvank), të përdorur nga Armenët për popullsinë kufitare me të, që banonte në bregun e majtë të lumit Kura e që shtrihej deri në detin Kaspik në lindje.

Tek libri "Historia e Albanëve të Kaukazit" i Moisi Kaghankatvacit hasim shpesh rastin kur Albanët, duke folur për veten e tyre, përmendin dyfjalëshin "Ne Lindorët", në vend që të thonë "Ne Albanët".

Më pas këtë emër e shohim të shfaqet në forma të ndryshme, siç e kemi paraqitur më sipër: Kjo për faktin se germa Armene *"ղ"* është një

bashkëtingëllore guturale e zëshme e ngjashme në shqiptim me tingullin uvular "r" , që përdorin francezët parizienë. Sipas gjuhëve dhe vendeve të ndryshme ajo mund të transkriptohet "gh", "g", "h", "r", "l". Prandaj kemi edhe *Աղուան - Աղվանք* (Aghvank, Ahvank, Arvank, Alvank).

N.q.s. interpretimit të mësipërm i shtojmë edhe faktin që "Shndrrimi i *l* -së në *r* është një rregull gjuhësor i stërlashtë i latinishtes dhe i greqishtes" të përmendur nga J. Ph. Fallmerayer: "Elementi shqiptar në Greqi, Fq. 85", atëhere mund të kuptohet fare mirë evoluimi në gjuhët europiane i emrit Arvank – Alvank të përdorur nga Armenët.

Shënim B.P: Duke folur për alfabetin Etrusk, Zacharie Mayani shpjegon :

P - ja e tyre shprehej p, b, bh.

Shënim B.P: Një gjë të ngjashme mund të themi për përdorimin e germës "p" dhe "b" nga dy dialektet e gjuhës Armene", e cila kur shkruhet "p" nga Armeno-Lindorët lexohet "b", ndërsa nga Armeno-Perëndimorët lexohet "p".

Shënim B.P: Një dukuri të ngjashme të shndrrimit të germës "v" në "b" dhe anasjelltas e vëmë re edhe në rastin e përdorimit të emrit Albania në formën "Alvanoi" nga grekët dhe "Albanoi" nga romakët.

Sot, Shqipëria në arenën ndërkombëtare njihet dhe shkruhet ''Albania''; po kështu shkruhet në artikujt historikë (të paktën ata europianë) edhe emri i Albanisë së Kaukazit, por për ta dalluar nga "Albania" ballkanike shkruhet "Albania e Kaukazit". Pra, në të dy rastet shkruhet njëlloj e lexohet njëlloj, por nuk bëhet fjalë për të njëjtin vend dhe bëhet fjalë për banorë, që praktikisht sot përdorin emër të ndryshëm për të emërtuar veten e tyre. Sipas Wikipedia "Mbetje të vogla të këtij grupi vazhdojnë të ekzistojnë në mënyrë të pavarur dhe njihen si populli Udi". Praktikisht, nuk ka asnjë material të shkruar, që të mund të pohojë se si e quanin veten e tyre këta banorë në kohët e vjetra, nga ku po kërkojmë të nxjerrim kuptimin e fjalës "Alban apo Arban".

Çasti 3

a) Interpretime të transkriptit të emrit *"Աղուանք – Աղվանք"* nga gjuha Armene në gjuhë të tjera Europiane

Arm. (Perëndimore)	*Աղուանք* (Aghvank, Ahvank, Arvank, Alvank)
Arm. (Lindore)	*Աղվանք* (Aghvank, Ahvank, Arvank, Alvank)
Rusisht	*Աղուանք* - *Աղվանք* - Алуанк (aluank)
Anglisht	*Աղուանք* - *Աղվանք* (Aghvank)
Greqisht	*Աղուանք* - *Աղվանք* (Arvank, Alvank)
Latinisht	*Աղուանք* - *Աղվանք* (Alvank, Arvank)
Shqip	*Աղուանք* - *Աղվանք* (Aghvank, Ahvank, Arvank, Alvank)

b) Interpretimi i rrënjës *Աղ* dhe *Աղու*

PËR RASTIN E RRËNJËS *ԱՂ*

Copëzojmë për një çast fjalën Armene *"Աղվանք"* në dy pjesë, ku secila prej tyre ka kuptim në këtë gjuhë, në *Աղ - վանք.*

N.q.s do të përkthenim nga gjuha Armene në gjuhën Shqipe fjalën *"Աղ"* do kishim *Աղ* (agh, ar, al, ah) = kripë.

N.q.s do të përkthenim nga gjuha Armene në gjuhën Shqipe fjalën *"վանք"* do kishim վանք (vank) = manastir.

Bashkimi i këtyre dy fjalëve do të jepte "Manastir kripe" ??

Ky bashkim fjalësh do të merrte njëfarë kuptimi n.q.s fjalës "manastir" do t'i jepnim edhe kuptimin "vend grumbullimi, vend strehimi, vend sistemimi" pa bërë dallim nëse bëhet fjalë për njerëz apo objekte të tjera. Në këtë rast do të mund të krijonim togfjalëshin "vend grumbullimi kripe", nga e cila mund të dilnim në hamendësimin se ky vend quhej i tillë për shkak se merrej me

grumbullimin e kripës duke qenë pranë detit, dhe se po për këtë arsye edhe banorët e tyre i quanin me këtë emër "Grumbullues kripe".

Edhe n.q.s do ta pranonim për një moment një hamendësim të tillë, pyetja shtrohet:

Mirë po pranohet ky hamendësim për "Albanët e Kaukazit", por a vlen edhe për Albanët e Ballkanit, pasi për një përputhje rastësore edhe Albania e Ballkanit ndodhet pranë bregdetit Adriatik dhe Jon; a vlen kjo për Albanët e Skocisë, etj?

PËR RASTIN E RRËNJËS *ԱՂՈՒ*

N.q.s do të përkthenim nga gjuha Armene në gjuhën Shqipe fjalën *"Աղու"* do kishim *Աղու* (aghu, aru, alu, ahu) = i butë, miqësor, mirëdashës, dashamirës, mikpritës.

Pavarësisht nëse bëhet fjalë për natyrën e vendit apo të banorëve që e popullonin atë, ndoshta edhe për natyrën e prijësit të tyre, kjo nuk luan ndonjë rol në hamendësimin se ky tipar mund të ketë qenë ai, që i ka dhënë emrin vendit dhe banorëve të saj në formën e përdorur fillimisht nga Armenët - *Աղուանք* (Aghvank, Ahvank, Arvank, Alvank).

Mbetet për t'u përcaktur çfarë roli luan prapashtesa *"անք"* të cilës nuk i gjej asnjë shpjegim në gjuhën Armene: këtu duhet pasur parasysh se në dialektin Armeno-Perëndimor fjala e shkruar *"Աղուանք"* është e barasvlershme me fjalën e shkruar *"Աղվանք"* në dialektin Armeno-Lindor dhe shqiptohet po njëlloj (Aghvank, Ahvank, Arvank, Alvank). Në këtë rast i bie që të rikthehemi përsëri aty ku ishim: në trajtimin e fjalës (Aghvank, Ahvank, Arvank, Alvank) si një fjalë të përngjitur *Աղ – վանք.*

Le të pranojmë për një çast se forma fillestare e emrit Աղուանք (Aghvank, Ahvank, Arvank, Alvank) ka qenë *Աղուանձ* (Aghvanc, Ahvanc, Arvanc, Alvanc), pra germa e fundit "ք - k" fillimisht ka qenë "ձ - c" dhe është shndrruar më pas në "ք - k". Në këtë rast do

kishim të bënim me fjalën e përngjitur *Աղու - անձ*, ku

"Աղու" do kishim *Աղու* (aghu, aru, alu, ahu) = i butë, miqësor, mirëdashës, dashamirës, mikpritës

dhe

անձ (anc) - dikush, person, vetë

Kështu, fjala *Աղու - անձ* (Aghvanc, Ahvanc, Arvanc, Alvanc) do përkthehej në Shqip në formën *Աղուանձ* = njeri i butë, miqësor, dashamir

Nuk jam në gjendje të them se sa qëndron në gjuhën Armene ky shndrrim i germës "c" në "k", që të mund të ngulja këmbë në prejardhjen e emrit "Alban" nga kjo formë hamendësimi.

Gjithashtu, në këtë rast nuk e di sa mund të vinte në ndihmë pohimi i Zacharie Mayanit në librin "Etruskët fillojnë të flasin, Fq. 14-15" kur, duke folur për alfabetin Etrusk, ndër të tjera thotë:

C -ja mund të dëftente k, g, q, tz, tch

c) Interpretimi në gjuhën Shqipe i rrënjës Ar dhe Arr

Sipas Muharrem Abazaj, tek libri "Kodi i gjuhës pellazgo - shqipe, Fq. 124", etimologjia e emrit "Arban" trajtohet në këtë mënyrë:

Arban = bën + arë, njeri që ka si mjeshtëri të bërit e një pjese toke të çfarëdoshme, në tokë pjellore, njeri që është mjeshtër i punëve bujqësore, bujk. (Fq. 124).

Po këtu, autori në fund thotë: Shtrohet problemi: pse ky emërtim "Arbër" u përgjithësua për të gjitha fiset e tjera ilire? (fq. 125).

d) Interpretimi i rrënjës "*ար* (arr)" në gjuhën Armene

Shënime vrojtimi të rastësishëm

- *ար* (arr) – пласт земли, поднимаемой при вспашке - tokë e lëruar; pjesa e dheut që ngrihet gjatë lërimit të tokës

- *բան* (ban, pan) – слово, дело, работа, вещь, предмет - fjalë, vepër, punë, send, lëndë

- *առ + բան = առբան* (arrban, arrpan) – tokëlërim, tokëlërues; punë për lërimin e tokës ???

Nxjerrë nga libri :

"Армяно-русский словарь; *Հայ-ռուսերեն բառարան";*

Ա.Ս.Ղարիբյան, Ե.Գ.Տեր-Մինասյան, Մ.Ա.Գևորգյան;

Botim i dytë i plotësuar; *Երևան,* 1960

(Gjendet në: Biblioteka Kombëtare, Tiranë)

Kujdes: Përdorimi i parë dhe i përgjithshëm i fjalës *առ* është:

առ (arr) = te, tek, për.

e) Përdorime të fjalës *"արտ"* (art, ard) – fushë; arë

արտ (art, ard) – fushë; arë (tokë e punueshme)

արտավար (artavar, ardavar) – fusharak; bujk; fshatar

արտատեր (artater, ardader) – pronar tokash bujqësore

Çasti 4

Duke analizuar shkrimin e Kristo Frashërit "Etnogjeneza e shqiptarëve "hasim"

"Ptolemeu përmend pranë fisit të Albanëve edhe qytetin e tyre në trajtën greqishte Albanopolis (qyteti i Albanëve), gërmadhat e të cilit janë zbuluar në fshatin Zgërdhesh, në afërsitë perëndimore të kalasë së Krujës." (fq. 225)

Duke lexuar në Wikipedia për futjen e Krishterimit në Armeni hasim në figurën e Shën Bartolomeut.

Lindur në Judea, Shekulli i I^{rë} i erës sonë.

Vdekur në Albanopolis, Armeni, Shekulli I^{rë} i erës sonë.

Së bashku me mikun e tij Xhud Tadeus (Jude Thaddeus), Bartolomeu ka reputacionin e njeriut, që solli Krishterimin në Armeni në shek. I[rë] të erës sonë.

Thuhet se ai është martirizuar në Albanopolis, në Armeni.

Shënim B.P.: Praktikisht nuk dihet vendndodhja e saktë e këtij qyteti të vjetër. Ka disa hipoteza nga të cilat asnjë e vërtetuar. Njera prej tyre e hamendëson këtë qytet në zonën e Kaukazit, në hapësirën që mbulojnë sot shtetet e Armenisë dhe Azerbaixhanit. I saktë është vetëm fakti që Manastiri i Shën Bartolomeut, i cili shërbente edhe si vend pelegrinazhi për Armenët, ka qenë në afërsi të qytetit të sotëm turk Bashkale, në jugperëndim të Turqisë, në kufi me Iranin.

A kanë ndonjë lidhje faktet e mëposhtëme? :

Të jetë rastësi ekzistenca e këtyre dy qyteteve me të njëjtin emër në të njëjtën periudhë kohore në dy vende kaq larg me njeri tjetrin?

Të jetë rastësi shfaqja e tyre në të njëjtën trajtë, në trajtën greqishte *Albanopolis* (qyteti i Albanëve), në kohën kur gjuhë zyrtare në këto zona ishte latinishtja dhe jo greqishtja ?

Periudha më e afërt kohore, që flet për krijimin e një ure njerëzore Ballkan-Armeni-Albani e Kaukazit, ka qenë periudha e Aleksandrit të Madh.

Pas tij të njëjtën urë krijon Perandoria Romake.

Çasti 5

Duke lexuar librin e Garegin D. Nalbandian: "Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit" hasim:

"Aran, që nënkupton Ara, gjithashtu, është quajtur Arean Ara nga Moisi Korenaci. Arani është një prej djemve të Aras së Bukur; ai u martua me një pasardhëse të Sisakut dhe pati si trashëgimtar Anushavanin.

Anushavan në gjuhën Armene ose Aluavan në gjuhët Hurro-Urartiane ishte djali i Aranit. Nga Arani dhe Aluavani rrjedhin

fisnikët e Arranit dhe vendi mori emrin *Aluank* ose *Alvank,* që njihet gjithashtu si Albania, një mbretëri në veri të Arranit. Kjo sipërfaqe ishte pjesë e Armenisë deri sa u pushtua prej Persianëve, dhe mori emrin Arran-Albania, dhe populli i Alvankut mori emrin populli Alban." (Fq. 148).

Mbase *Anushavani* (Armenisht) dhe *Aluavani* (Hurro-Urartianisht) e shpjegojnë më mirë origjinën e emrit *"Aluank* ose *Alvank,* që njihet gjithashtu si *Albania",* me të cilin u emërtua ky vend, që ndodhet rrëzë maleve të Kaukazit.

Këtu duhet vënë në dukje që rrënja *Anush* e fjalës *Anushavan (Անուշավան)* dhe rrënja *Alu* e fjalës *Aluank (Աղուանք)* kanë pothuajse të njëjtin kuptim në gjuhën Armene:

Anush – i ëmbël, i shijshëm, i mirë, ëmbëlsirë

Alu – i butë, miqësor, mirëdashës, dashamirës, mikpritës.

Çasti 6

Tani të vijmë tek emërtimi *"Albania".*

Të thuash që ky emër është transmetuar në kohën e Aleksandrit të Madh dhe nëpërmjet tij nga Ballkani në Kaukaz, kjo nuk do të ishte e mundur, pasi atëkohë në Ballkan nuk bëhej fjalë për ndonjë Albani apo Arbëri, por për fise Ilire prej të cilëve më vonë mendohet se e kanë origjinën shqiptarët e sotëm.

Të thuash që nëpërmjet pasardhësve të Aleksandrit të Madh ky emërtim kaloi nga Kaukazi në Ballkan, edhe kjo gjë ka pak gjasa, pasi ndërmjet kohës së pushtimeve të Aleksandrit të Madh dhe ardhjes së Romakëve në Kaukaz është një distancë kohore afro 300 vjeçare, aq më tepër po t'i referohemi Ptolemeut, kohë gjatë së cilës nuk kemi asnjë njoftim për ndonjë fis Alban në Ballkan.

Duke lexuar librin e Garegin D. Nalbandian: "Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit" hasim:

"Shekuj më vonë, Armenia dhe Albania u pushtuan prej

Romakëve, dhe shumë Armenë dhe Albanë u lëvizën në drejtim të Gadishullit Ballkanik dhe pjesëve të tjera të Europës prej Romakëve dhe Greko-Bizantinëve." (Fq. 148)

Emri "Alban" për Albanët e Kaukazit fillon të shfaqet dukshëm në histori në periudhën e luftimeve ndërmjet Romakëve dhe Armenëve, veçanërisht të kohës së Tigranit të Madh (140 – 55 B.C), ku Albanët dhe Gjeorgjianët përmenden si aleatë të Armenëve.

Mendimi im është, që emri *Aluank (Աղուանք)* i përdorur nga Armenët është perceptuar si "Alban" nga Romakët, e cila ndoshta është lidhur edhe me fjalën "Alba" të përdorur nga latinët për të treguar lindjen e diellit, në këtë rast ndoshta edhe lindjen si drejtim i horizontit, në krahasim me vendndodhjen e Romës.

Shënim B.P: Urartianët e lashtë përdornin L në vend të Gh, U në vend të O, etj.) (G. Nalbandian: "Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit", Fq. 147)

Kur flitet për Albanët e Kaukazit në përgjithësi përdoret termi "fiset Albane të Kaukazit", pra flitet në numrin shumës, pasi në fakt e tillë ishte përbërja e popullsisë në atë zonë. Krijimi i alfabetit dhe shkrimit të Albanëve të Kaukazit nga Mesrop Mashtotc në fillim të shek. 5^{të} pas Krishtit, që ishte edhe krijuesi i alfabetit Armen dhe atij Gjeorgjian, u bë me kërkesën e sundimtarit që mbretëronte në atë kohë mbi krahinën e Albanisë, dhe me siguri përfaqësonte gjuhën e folur nga fisi mbizotërues i asaj kohe. Sipas Wikipedia "ky alfabet u përdor për të shkruar gjuhën Udi, e cila ndoshta ishte gjuha kryesore e Albanëve të Kaukazit". Alfabeti Alban kishte 52 germa dhe ishte i ndryshëm nga ai Armen, që kishte 36 germa. Kuptohet që edhe gjuha e folur ishte e ndryshme në të dy vendet.

Kur lexon librin "Historia e Albanëve të Kaukazit" të Moisi Kaghankatvacit, në pjesët ku vendasit flasin për veten e tyre ndesh shpesh togfjalëshin "Ne Lindorët" në vend të përdorimit të togfjalëshit "Ne Albanët", që do të ishte një dukuri normale të të shprehurit për vetveten. Këtu të bën përshtypje fakti se duket sikur

vendasit pajtohen me cilësimin “Alban”, që u bëjnë atyre Romakët.

Por, edhe për ne, sot do ishte e llogjikshme që Romakët t’i përgjithësonin nën një emër të vetëm të gjitha këto fise, që banonin në lindje të Armenisë (asokohe komb dhe shtet i konsoliduar) dhe në skajin më lindor të Azisë së Vogël dhe njëkohësisht të Perandorisë së atëhershme Romake.

Le t’i rikthehemi librit “Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit” e Garegin D. Nalbandian, ku thuhet: “Shekuj më vonë, Armenia dhe Albania u pushtuan prej Romakëve, dhe shumë Armenë dhe Albanë u lëvizën në drejtim të Gadishullit Ballkanik dhe pjesëve të tjera të Europës prej Romakëve dhe Greko-Bizantinëve.” (Fq. 148)

Këtu mund të hedhim dy hamendësime:

Hamendësimi 1.

Le të sjellim në vëmendje njërën nga pikat e testamentit të Aleksandrit të Madh: “Zhvillimin e qyteteve dhe shpërnguljen e popullsive nga Azia në Europë dhe në drejtim të kundërt, nga Europa në Azi, për të sjellë unitet dhe miqësi në kontinentin më të madh nëpërmjet martesave të përziera dhe lidhjeve familjare”, si edhe faktin se për të bërë realitet këtë gjë, ai në vendet që pushtonte, qoftë në qytetet e rinj që krijonte, qoftë në ato të vjetrat të pushtuara, linte prapa tij garnizone ushtarake, të cilët i martonte me gra vendase ose robinja.

Le të hamendësojmë se, pas vdekjes së Aleksandrit ndonjeri prej këtyre garnizoneve, tashmë i familiarizuar dhe i shtuar me bij e bija, apo mbase trashëgimtarët e afërm të tyre, si pasojë e grindjes ndërmjet fiseve vendase apo e armiqësisë së shfaqur kundrejt tyre, duke i konsideruar si trup i huaj pushtues, vendos të kthehet andej nga ka ardhur, praktikisht në Ballkan. Kuptohet se n.q.s kjo trupë i përkiste trupave të mobilizuara nga Aleksandri në Iliri, destinacioni i tyre do të ishte Iliria.

N.q.s ky fenomen ka ndodhur përpara pushtimit Romak, është e natyrshme që për banorët vendas, pavarësisht se të ardhurit kishin lidhje gjaku me ta, ata të konsideroheshin si të ardhur nga vendet e lindjes; kjo mund të ketë çuar në cilësimin e tyre si "Fisi i Lindjes ose Lindorët", gjë që më pas Romakët e kohës së Ptolemeut në latinisht e kanë përkthyer si "Albanët", me kuptimin "Lindorët".

E njëjta mënyrë arsyetimi do vlente për rastin, kur kjo lloj lëvizjeje do të kishte ndodhur pas pushtimit Romak të këtyre zonave, dhe ndonjë grupim, sado i vogël, i këtyre fiseve të kishte lëvizur drejt Ballkanit për t'u vendosur në zonat Ilirike, ku fillon të shfaqet emri "Albanoi" nga Ptolemeu.

Ky hamendësim do t'i shkonte për shtat edhe dhënies së një përgjigjeje pyetjes së ngritur më sipër: "A është rastësi shfaqja pothuajse e njëkohshme e emrit "Albanopolis" në trajtën greqishte e dy qyteteve, që ndodhen në dy vende kaq larg njeri tjetrit, por që përsëri çuditërisht të banuar nga fise që po nga Romakët emërtohen po njëlloj: "Alban" (*Shënim B.P.:* mendoj me kuptimin "Lindor").

Hamendësimi 2.

Pranojmë që nuk kemi lëvizje fisesh apo grupe njerëzish nga Kaukazi drejt Ballkanit. Në këtë rast do të duhet të pranojmë të njëjtën llogjikë që pranuam kur hamendësuam mënyrën se si Romakët mund ta kenë përgjithësuar emrin "Alban" për banorët e "Albanisë së Kaukazit", pra duke e konsideruar këtë fis ilir si "Albanoi" m.q.s ishte në lindje të Romës. Por këtu shfaqet përsëri pikëpyetja: Përse në morinë e fiseve Ilire u quajt pikërisht ky dhe jo edhe fiset e tjera Ilire, pasi që të gjitha këto ndodheshin, po njëlloj, në lindje të Romës ?

Tani vazhdojmë me disa çaste të tjera:

Çasti 7

Në gjuhën Shqipe fjala "ag-u" ka kuptimin :

1. errësirë (për rastin kur flitet për sa po ngryset)
2. sa ka zënë të dalë drita (për rastin kur flitet për mëngjesin)
3. bebja, nusja e syrit (për rastin kur flitet për syrin)

Në gjuhën Shqipe fjala "agim" e prejardhur prej fjalës "ag-u" ka kuptimin: "të zbardhëllyerit e qiellit pa gdhirë akoma mirë dita, pa dalë akoma dielli" (Fjalor i Gjuhës Shqipe, Tiranë 1954, Fq. 3)

Në gjuhën Armene fjala "*ակ* (ak, ag)" ka kuptimin :

1. burim, fillim
2. gur i çmuar

Po të shihet me kujdes, si në gjuhën Shqipe ashtu edhe në atë Armene, në rastin e parë kemi të bëjmë me një kuptim të fjalës që shpjegon një veprim fillestar, apo kalimtar nga një gjendje në një tjetër. Në rastin e dytë kemi të shprehur një send, i cili për nga vetitë meriton vlerësim.

Lidhur me sa më sipër trajtova, mendoj se kur flasim për rrënjët "al, agh, ar" për të shpjeguar etimologjinë e fjalës "Alban, Arban, Aghvank, Aluank" etj. do të ishte mirë të merrej në konsideratë edhe fjala-rrokje-rrënjë "ag" e gjuhës shqipe apo gjuhës Armene, e cila pa shtesa të tjera shpreh plotësisht atë që shpreh gjuha latine në formën "Alb apo Alba" – mëngjesin e hershëm në pragun apo çastin e lindjes së diellit.

Çasti 8

a) Në gjuhën Shqipe fjala "all, alle" ka kuptimin: ngjyrë kuq i ndezur

(Fjalor i Gjuhës Shqipe, Tiranë 1954, Fq. 8)

all, alle - ngjyrë kuq i ndezur

b) Në gjuhën Armene fjala "*ալ* (al)" ka kuptimin: ngjyrë kuq i ndezur, kuq ngjyrë alle

ալ (al) = (ngjyrë kuq i ndezur, kuq ngjyrë alle)

Siç shihet, në të dy këto gjuhë ngjashmëria është e dukshme në shkrimin, shqiptimin dhe kuptimin e fjalës-rrokje- rrënjë "al".

Ngjyra e kuqe e ndezur (e shprehur shkurt - al) ashtu siç mund të jetë një cilësim për të treguar një qiell të përflakur, ashtu mund të jetë një cilësim për të treguar një agim apo perëndim të bukur dielli.

Duke risjellë edhe një herë në vëmendje fjalën e gjuhës latine në formën "Alb apo Alba", që nënkupton mëngjesin e hershëm në pragun apo çastin e lindjes së diellit, na shkon në mendje të bëjmë pyetjen:

Kur flasim për prejardhje të përbashkët Indo-Europiane të këtyre tre gjuhëve Shqipes – Italishtes – Armenishtes, përse të mos pranojmë si të vërtetë faktin, që të tre këto gjuhë fjalë bazë për të shprehur lindjen e diellit kanë fjalën-rrokje-rrënjë: "AL"?

Po të shohësh pozicionin gjeografik të këtyre tre vendeve (Alba Longa e Italisë, Albanopolis e Shqipërisë dhe Armenia), të bie në sy që lindja e Diellit në këto vende shfaqet nga malet

Kjo mbase është arsyeja, që kur bëhet fjalë për këto vende apo banorët e tyre, mali, bora e bardhë dhe lindja e diellit marrin formën e një uniteti kuptimor: "lindja e diellit mbi majën e malit të mbuluar me borë të bardhë si një sy stërmadh ngjyrë alle që përflak qiellin".

Kjo mbase është arsyeja që cilësimi "Alban - Lindor" nga ana e Romakëve të banorëve të këtyre zonave, me kalimin e kohës ka marrë kuptimin "Alpin – Malësor", ose "Albin – Bardhosh", dhe në rastin më të keq, atë keqdashës dhe përçmues për banorët e zonave lindore "Lindor-malok", që për Romakët do të nënkuptonte "një banor të dorës së dytë, injorant, të pagdhendur".

Fakti që emri Albanopolis (qyteti i Albanëve), është shprehur në trajtën greqishte në kohën kur gjuhë zyrtare në këto zona ishte latinishtja dhe jo greqishtja, mendoj se mund të trajtohet kështu:

Mundësia 1:

Qyteti Albanopolis, me vendndodhje në Kaukaz, mund të ketë qenë themeluar që në kohën e Aleksandrit të Madh dhe prej këtej nëpërmjet çvendosjes njerëzore Kaukaz-Ballkan, hamendësuar në Hamendësimin 1, të jetë eksportuar në Ballkan në formën po Albanopolis në zonën e përmendur nga Ptolemeu. Duke pasë parasysh rëndësinë e gjuhës greke në formimin e kastës udhëheqëse maqedonase dhe përdorimin e saj në Maqedoni, është e llogjikshme të pranojmë se Aleksandri dhe pasardhësit e tij t'i emërtonin qytetet që ndërtonin sipas modelit grek – me shtesën Polis prapa (polis – në gjuhën greke do të thotë - qytet), pra Alban + Polis (Albanopolis).

Këtu përsëri do të hasnim në një pengesë: mirë "Polis" është greqisht, po "Alban" nga e nxorri Aleksandri ?

Në këtë rast do të na duhej të kërkonim ndihmë tek fjala Armene e trajtuar më sipër "Աղուանք - Աղվանք (Aghvank, Ahvank, Arvank, Alvank)". Po e thjeshtojmë arsyetimin duke pranuar që emërtimi i këtij qyteti është bërë nga qeveritarët e emëruar nga Aleksandri. Ky emërtim është krijuar duke marrë për bazë emërtimin e mësipërm prej Armenëve të banorëve vendas dhe prapashtesës "polis" të zakonshme në emërtimin e qyteteve. Atëhere, gjasa më e madhe do ishte që qyteti të emërtohej "Arvankapolis apo "Arvanapolis" dhe që më pas, në kohën e Romakëve të jetë shndrruar në "Albanapolis" apo "Albanopolis" , duke i dhënë edhe kuptimin "Qyteti i Lindjes, Qyteti Lindor apo Qyteti i Lindorëve".

Mundësia 2:

Studimet tregojnë gjurmë të kulturës helenistike në qytetin e Durrësit, që mendohet të jetë themeluar nga kolonistë greke rreth shek. 7të B.C..

Në lindje të Durrësit, në Zgërdhesh, atje ku mendohet të ketë qenë qyteti "Albanopolis", mund të ketë ekzistuar një qytet, që në

shembullin e qyteteve greke të ketë pasur prapashtesën “polis”. Me ardhjen e Romakëve, këtë qytet të ndodhur në lindje të Durrësit, ata e kanë emërtuar “Qyteti i Lindjes - Albanopolis”, duke ruajtur prapashtesën “polis”.

Gjatë kohës së pushtimeve Romake në zonën e Kaukazit, duke ruajtur konceptin e “Qytetit të Lindjes”, mundet që qytetin e lashtë të themeluar nga Aleksandri apo pasardhësit e tij ta kenë shndrruar nga “Arvanapolis”, në “Albanopolis”.

Ky është mendimi im lidhur me këtë çështje.

Shënim B.P.:

Shqip: al – mal - malësor

Italisht: al – alp – alpin – malësor; alb – albin - bardhosh

INTERPRETIME TË EMRIT “GEG - TOSK

Renditja e Interpretimeve sipas Autorëve poshtëshënuar:

1. Hyrje 575
2. Interpretime të emrit “Geg” nga autorë të ndryshëm 579
3. Interpretime të emrit “Tosk” nga autorë të ndryshëm 587
4. Berzh Piranjani: Interpretime të emrit “Geg – Tosk” 597

HYRJE

Kur flitet për origjinën Indoeuropiane të Shqiptarëve dhe gjuhës së sotme Shqipe, kur flitet për origjinën Indoeuropiane të Armenëve dhe gjuhës së sotme Armene, kur flitet për afërsi të Etruskëve dhe Shqiptarëve të sotëm dhe shpjegim të mbishkrimeve Etruske me gjuhën e sotme Shqipe, kur flitet për gjurmë ngjashmërie ndërmjet Shqipes dhe gjuhës Baske dhe kur po këto hamendësime i atribuohen edhe gjuhës Armene, kur hamendësohet apo pranohet pohimi i Homerit dhe Herodotit që lufta e Trojës ishte luftë brenda fiseve të një trungu, trungut Pellazgjik, kur flitet për lëvizje popullsish farefisnore brenda trungut Pellazgjik dhe më gjerë atij Indo-Europian nga Azia Perëndimore drejt Mesdheut dhe anasjelltas, kur hamendësohet përdorimi i një gjuhe të vetme, asaj Pellazgjike në pellgun e Mesdheut, kur hamendësohet gjuha Shqipe si zbërthyese e gjuhës së lashtë Greke të Homerit, kur gjuha Shqipe dhe gjuha Armene paraqiten si dy gjuhë autoktone dhe si degët gjuhësore më afër rrënjës së pemës Indo-Europiane të gjuhëve Europiane, madje përpara asaj Greke, atëhere me të drejtë lind pyetja:

Po ndërmjet vetë këtyre dy gjuhëve dhe këtyre dy popujve a ka ndonjë lidhje?

Dy popuj të vegjël sot, që kanë përjetuar furtuna pushtuesish të ndryshëm, që kanë përjetuar periudha të lavdishme dhe të errëta në historinë e tyre mijravjeçare, popuj që ndriçuan historinë në kohën kur ajo pati nevojë për ta dhe që historia i falenderoi me harresë kur ata kishin nevojë për të. Dy popuj të vegjël sot, por me histori

të lashtë e të lavdishme, që panë të ngrihen e të bien perandori, që panë lindjen dhe vdekjen e shumë kombeve e gjuhëve, por që mbijetuan duke sjellë të gjallë me vete deri në ditët e sotme edhe gjuhën e tyre, atë që përbën një nga vetitë më jetësore, e cila mban të gjallë një komb.

Pavarësisht se sot Shqipëria ka një gjuhë zyrtare të unifikuar, si në çdo vend tjetër të botës edhe në Shqipëri dallohen dialektalizma në të folur; dy janë grupet më të mëdha: toskërishtja, që mbizotëron në krahinat jugore të Shqipërisë dhe gegnishtja, që mbizotëron në krahinat veriore të Shqipërisë. Mbi këtë bazë edhe njerëzit, që i flasin ato, shpesh i emërtojnë Toskë ose Gegë.

Të thuash dialekti jugor ose dialekti verior është diçka më se e kuptueshme, jo vetëm për shqiptarët por edhe për të huajt, por kur thua dialekti Tosk apo dialekti Geg, apo kur për njerëzit përdor termin "Tosk" apo Geg", detyrimisht në kontakt me të huajin ndodhesh përpara pyetjes: Përse ata quhen "Toskë" dhe këta të tjerët "Gegë"?

Kjo është një pyetje enigmë, me të cilën besoj se haset çdo drejtues grupi turistik, që përshkon Shqipërinë nga veriu në jug, një enigmë së cilës janë përpjekur t'i japin shpjegim studiues të ndryshëm shqiptarë dhe të huaj, një enigmë që zgjon interesimin e çdo turisti intelektual, i cili do kishte kënaqësinë të dëgjonte një çfarëdo interpretimi, mjaft që të mos largohej pa mësuar diçka.

Po flasim për jo shqiptarët, por cili shqiptar, vizitor muzesh apo vendesh historike, visitor në veri apo jug, nuk do të ishte i interesuar të merrte një përgjigje për këtë pyetje?

Cili drejtues grupi turistik nuk do të kishte dëshirën për të pasur sa më shumë informacion rreth kësaj çështjeje, me qëllim që ta bënte sa më tërheqëse punën e tij, bisedën informative me antarët e grupeve që udhëheq?

Pa pasur fare ndërmend që t'i shërbeja një guide turistike, i nxitur nga kurreshtja thjesht qytetare, pa pretenduar t'i hyj zgjidhjes

shkencore të këtij problemi kaq kurreshtjendjellës, duke menduar se njohuritë që kisha marrë nga leximi i një literature historike dhe letrare albanologjike do të ishte mirë t'i grumbulloja për t'i shërbyer dikujt apo diçkaje, me pretendimin modest për t'i shtuar një hamendësim timin, që më erdhi ndër mend kur po lexoja mbi mitologjinë dhe historinë e lindjes së kombit Armen në zonën e pllajave Anatoliane, shpesh të trajtuar edhe si origjina e popujve pellazgjikë, vendosa të veproj në këtë mënyrë:

1 Fillimisht po i paraqis të përmbledhura shkurt ato fraza apo grumbull frazash, të nxjerra nga librat e lexuar, që mendova se paraqisnin interes në ndriçimin e kësaj enigme.

2 Më pas, duke u bazuar mbi to dhe leximet e literaturës së veçantë sipërpërmendur, po provoj të hedh në letër hamendësimin tim.

3 Në mos qoftë çelësi që hap portën për zgjidhjen e enigmës, të paktën është një provë e dështuar për zgjidhjen e saj.

INTERPRETIME TË EMRIT "GEG"

Renditja e Interpretimeve sipas Autorëve poshtëshënuar:

1. Moisi Kaghankatvaci: Historia e Albanëve të Kaukazit..... 581
2. Johann George von Hahn: Studime Shqiptare 582
3. Jani Vreto: Vepra të Zgjedhura 582
4. Wilhelm Obermüller: Popujt e Alpeve 582
5. Eduard Shnaider: Pellazgët e pasardhësit e tyre 583
6. Zacharie Mayani: Etruskët fillojnë të flasin..... 583
7. Nermin Vlora Falaski: Pellazgët, Ilirët, Etruskët, Shqiptarët..... 584
8. Nxjerrë nga Wikipedia..... 584
9. Garegin Nalbandian: Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit.... 584
10. Berzh Piranjani: Fjalor me fjalën-rrokje-rrënjë: "Geg"..... 585

MOISI KAGHANKATVACI

"Historia e Albanëve të Kaukazit"

Artashesi erdhi dhe i mblodhi gjithë Albanët nën komandën e tij, marshoi drejt Liqenit Gegham. (Fq. 22) *(Gegham, Gelam – Liqeni Sevan i sotëm; Shënim BP)*

U zhvillua një betejë e madhe ndërmjet Papit dhe Mehruzhanit. Ishte pikërisht në këtë betejë, që trimi Shergir, mbreti i *Ghekëve* (Lekëve), vdiq në duart e Spandarat Kamsarakanit. Ishte pikërisht në këtë betejë që mbreti i *Albanisë,* Urnairi, u plagos nga Mushel Mamikoniani, djali i Vasakut. (Fq. 34)

Kreu 15. Lista e emrave të sundimtarëve të vendosur në fronin e Albanisë nga Xhafeti tek Arani e më pas deri tek Vaçakani.

Xhafet, Gomer, Tiras, Togarmah (Torgom), Hajk, Armenak, Aramais, Amasia, *Gegham,* Harmai, Aram (bashkëkohës i Abrahamit), Arai i Hijshmi (bashkëkohës i Isakut), Anushavan, ... (Fq. 41)

Duke mos i kushtuar respekt asnjërit prej tyre, u ktheva në fshatin tim të Puhavankut në Gegharkunik (Gelarkunik), … (Fq. 212)

Pas kësaj, të gjithë shenjtorët në krahinën e Geghamit ishin të kënaqur; .. (Fq. 212)

JOHANN GEORGE VON HAHN

"Studime Shqiptare"

Shënimi 69/7 : Shumë gjurma tregojnë se ndër dialektet e helenëve, dialekti i dorëve i përngjan ma fort gegnishtes. (Fq 351)

JANI VRETO:

"Vepra të Zgjedhura"

Gegëtë duketë se ruanjënë me mirë fytyrën e vjetërë të fjalëzëvet. (Fq. 55)

WILHELM OBERMÜLLER

"Popujt e Alpeve"

Në kapitujt e kaluar besoj të kem treguar, që në kohët më të lashta, menjëherë pas së ashtuquajturës"Epoka e Akullit" nga brigjet e detit Egje deri në thellësi të Alpeve ishte përhapur një popullsi ilire, e njëjtë me atë që hyri në Italinë jugore e quajtur me emrin "Enotri". Ky popull njihet në gojëdhënat e heronjve grekë me emrin "gjigantët", ndërsa tek albanët në ditët e sotme me emrin "gegët". (Fq. 52)

Kësisoj, nuk mbetet gjë tjetër veçse të shihen ata që grekët i quanin "gjigantë" dhe "titanë". Në legjendat poetike, gjigantët paraqiten si paraardhësit e gegëve të sotëm në Albani dhe titanët si popull arian, të cilët nën udhëheqjen e Kronosit dhe Zeusit, duke u nisur nga Siçilia dhe Kreta, që fillimisht banoheshin nga gjigantët, pushtuan pjesën jugore të Italisë dhe të Greqisë, dhe banorët e vjetër, pra, autoktonët e vërtetë, gegët, u detyruan të zmbrapseshin. Ndërkaq ata konsiderohen si albanë deri në ditët e sotme. Banorët

e pjesës veriore të vendit, me shtate të tilla të bukura, të gjata e të forta, mbajnë sot ende emrin "gegë" dhe Straboni përmend në librin IV, kapitulli 6, edhe "kuajt gegë" në Liguria.

Shënim B.P.: Është interesante mënyra e zbërthimit të emrave "Albanë", "Ilirë", "Jonë", "Grekë" dhe "Gegë" nga ana e Wilhelm Obermüller ???

EDUARD SHNAIDER

"Pellazgët e pasardhësit e tyre"

Një tjetër meritë asht ajo e përdorimit paraprak të alfabetit Shqip, që u vendos afro 20 vjet më vonë nga studimet e tij. Me pak mungesa, ai ka ditur të na japë të saktë shqiptimin e fjalëve nga malësorët e para 130 vjetëve, ku "ë " e pazanë nuk figuron, sepse e folmja gegënishte nuk e pranon. (Fq. 14)

Shënim B.P : E njëjta vërejtje qëndron për "ë " e pazanë të gjuhës Armene (që qëndron në fuqi akoma edhe sot).

Fonetika e vërtetë e Shqipes duhet kërkuar në Shqipërinë e veriut tek Gegët. (fq. 194)

ZACHARIE MAYANI

"Etruskët fillojnë të flasin"

Coon përmend tri fjalë të zakonshme për popullsinë e lashtë të këtij vendi dhe për shqiptarët: *peeligo,* "i vjetër, i moshuar"(plak), *Emathia,* "Emadhja" (e madhia, emër i një fisi) dhe *Molotti,* "malësorë" (maltsor). Coon shton: "Gjuha gege (shqipe) është kryesisht Ilire" (Malet e Gjigandëve", fq.39 dhe 41). (fq. 451)

NERMIN VLORA FALASKI

"Pellazgët, Ilirët, Etruskët, Shqiptarët"

..., një sasi e madhe mbishkrimesh të Italisë i ngjasojnë të folmes së dialektit *gegë.* Karakteristika ma e dukshme është zanorja *"A"* hundore. Duket se folja "është" u formua më vonë. (Fq. 289).

Shënim B.P.: zanorja *"A"* hundore në gegërisht ka të njëjtin kuptim si folja "është" e gjuhës së sotme Shqipe të standartizuar

Ky mbishkrim, pa dyshim i përket dialektit të gegërishtes, ashtu si shumica dërmuese e mbishkrimeve të lashtësisë. Duket se Pellazgo-Ilirët flisnin dhe shkruanin në gegërisht (Fq. 329).

NXJERRË NGA WIKIPEDIA

Emri i Gegharkunik rrjedh nga Gegham, një mbret i gjeneratës së 5të Haykazuni dhe një nga pasardhësit e patriarkut legjendar dhe themeluesit të kombit armen Hayk. Gegham ishte babai i Sisak (themeluesi i dinastisë Siunia), dhe Harma (gjyshi i Ara bukuroshes). Malet Gegham dhe Liqeni i Gegham (i njohur aktualisht si Liqeni Sevan) u emëruan gjithashtu pas Geghamit.

Gegharkunik ka një peizazh malor. Territori dominohet nga malet Gegham nga perëndimi, ...

Lartësia e maleve varion midis 2500 dhe 3500 metra.

GAREGIN D. NALBANDIAN

"Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit"

Gegh ose Gel, djali i Amasias, dhe gruaja e tij, Gegham (Gegham ose Gegh-Am nënkupton "Gruaja e Geghut"; Urartianët e lashtë përdornin L në vend të Gh, U në vend të O, etj.) patën si

trashëgimtarë dy fëmijë: Sisak dhe Arma. Gjatë kësaj kohe, Liqeni Sa-Avan (Liqeni Sevan) u riemërtua në Liqeni Geghama.

Sisak, djali i *Gegh dhe Gegham,* janë prindërit e fisnikëve Sisakianë, të cilët njihen si fisnikët Sjuni të Krahinës së Sjunikut. (Fq. 147).

Gegh ose Gel, një pasardhës i Movkanit, u martua me Geghamin ose Gelamin, një pasardhëse e Hajkut. Gegham do të thotë gruaja e Geghut ose Znj. Gegh. Geghard dhe Gegharkunik në Armeni dhe Geghajk ose Gelam në Persi i morën emrat nga Geghu. Geghajk ose Gelam ishin toka midis Maleve Talish dhe Detit Kaspik në Persi. Gel dhe Gelam ishin paraardhës të popullit Gelian në Arran-Albania. (Fq. 152).

BERZH PIRANJANI

(Fjalor me fjalën-rrokje-rrënjë "Geg")

գեղ (gegh, gel, ger; kegh, kel, ker) – fshat, vend; vilë

գեղ (gegh, gel, ger; kegh, kel, ker) - bukuri, dashuri, hijeshi

E shkruajtur *գեղ,* Armeno–Lindorët do ta lexonin dhe shqiptonin – gegh; ndërsa Armeno – Perëndimorët do ta lexonin dhe shqiptonin – kegh

գեղանի (geghani, gelani, gerani; keghani, kelani, kerani) - i/e drejtë, elegante, i/e bukur, bukuroshe

գեղացի (geghaci, gelaci, geraci; keghaci, kelaci, keraci) - fshatar

գեղեցիկ (geghecik, gelecik, gerecik; keghecik, kelecik, kerecik) – i/e bukur, i/e ndershme, i/e hijshme, elegante

գեղջային (geghxhajin, gelxhajin, gerçajin; keghçajin, kelçajin, kerçajin) – fshatar, fshataresk

գեղջկական (geghxhkakan, gelxhkakan, gerxhkakan; geghçgagan, gelçgagan, gerçgagan) – fshatar, fshataresk

գեղջուկ (geghxhuk, gelxhuk, gerxhuk; keghçug, keghçug, keghçuk) – fshatar

գեղարդ (geghard, gelard, gerard; keghart, kelart, kerart) – shtizë, heshtë

գյուղ (g'jugh, g'jul, g'jur; kjugh, kjul, kjur) – fshat, vend; vile

գյուղացի (g'jughaci, g'julaci, g'juraci; kjughaci, kjulaci, kjuraci) – fshatar

Duke pasë parasysh se në gjuhën Armene, rrënja e fjalës pushtues është *"կեղեկ",* që transkriptohet (Keghek, kerek, kelek; Gegheg, gereg, geleg), nuk do të ishte çudi që pikërisht kjo fjalë e deformuar në Greg apo Grek të jetë etimologjia e fjalës "Grek" të ditëve të sotme.

Shënim B.P.: Lidhur me shumëllojshmërinë e transkriptimit edhe këtu vlen shpjegimi që i është bërë transkriptimit të germës Armene *"ղ"* gjatë interpretimit të emrit *"Աղուան – Աղվանք"* në Kapitullin "Interpretime të emrit - "ALBAN"

INTERPRETIME TË EMRIT "TOSK"

Renditja e Interpretimeve sipas Autorëve poshtëshënuar:

1. Johann Thunmann: Historia dhe gjuha e Shqiptarëve dhe Vllehëve 589
2. Wilhelm Obermüller: Popujt e Alpeve 589
3. Robert Ellis: The Armenian origin of the Etruscans..... 590
4. Sir Patrick Colquhoun & Vaso Pasha: Pellazgët, pasardhësit e tyre të sotëm dhe origjina pellazge e poemave të Homerit 591
5. Artashes Abegian: Geschichte Armeniens 591
6. Zacharie Mayani: Etruskët fillojnë të flasin..... 592
7. Spiro Konda: Shqiptarët dhe problemi Pellazgjik 593
8. Artak Movsisjan: Historia e Armenisë..... 594
9. Nxjerrë nga Wikipedia..... 595

JOHANN THUNMANN

"Historia dhe gjuha e Shqiptarëve dhe Vllehëve"

Plinio i vjetri në librin e tretë shkruan: "Në periudhat antike, Pellasgët shtynë më tej Umbrët (Umbri), ndërsa këta të fundit Lidët (Lidy), nga mbreti i të cilëve u quajtën "Tyrreni" dhe më pas ata, për traditën e sakrifikimit, u quajtën *Tusci/Tuski.* Në Enciklopedinë gjermane të viteve 1880-1890 shkruhet: "Shqiptarët janë një nga popujt më të vjetër, ku tashmë është e sigurtë, pa asnjë dyshim, që janë pasardhësit e drejtpërdrejtë të Pellazgëve të vjetër". (Fq. 219-220).

WILHELM OBERMÜLLER

"Popujt e Alpeve"

Me shfaqjen e Tuskëve në Italinë e sipërme, të ardhur nga Lidia dhe Qipro, filloi periudha e pestë për trojet e Alpeve. Ky popull ndërtues dhe trim e detyroi popullsinë italiane umbre të tërhiqej drejt jugut, në malet në pjesën e mesme dhe të sipërme të Teveres, pushtoi vetë luginën e Arnos dhe më pas u të luginave të Alpeve ku, si mjeshtra të zotë në përpunimin e metalit, edhe nëse u romanizuan, u vendosën në luginat e Trompia-s dhe Camonica-s, në pjesën veriore të Brescia-s. Edhe lugina e sotme italiane e Etschit, në veri të Veronës, ishte e banuar nga Tuskët. (Fq. 52)

ROBERT ELLIS

"The Armenian origin of the Etruscans"

(Pellasgët, Fq. 175 - 179)

Është përmendur në fillim që Etruskët, sipas tregimeve të të lashtëve, ka shumë të ngjarë të kenë qenë të lidhur me dy kombe: me Lidianët dhe Pellasgët. Gjurmimi i këtyre afërsive të para dhe e pasojave, që rrjedhin si rezultat i deduksioneve mbi to, është ajo që na ka çuar deri në këtë pikë, dhe na ka çuar në përfundimin që të përdorim supozimin e afërsisë së Etruskëve me Lidianët, të njërës prej familjeve më të mëdha të grupit Arian, një familje, degët e së cilës flisnin dialekte të ngjashme (farefisnore, të afërta) me atë Armene, që tashmë është i vetmi dialekt i gjallë (i mbijetuar) i kësaj familjeje, që në kohët e lashta shtrihej nga Armenia në Etruri. Nëqoftëse kjo është e vërtetë, dhe nëqoftëse Etruskët, njëkohësisht janë të afërm me Pellasgët, atëhere Pellasgët duhet të jenë pjesë e kësaj familjeje, dhe po në të njëjtën mënyrë duhet të jenë të lidhur me Armenët.

[10] *Shënim i Robert Ellis :* Zgjidhja, unë besoj se është që Pellasgët, Lidianët dhe Etruskët e kanë origjinën e tyre në një periudhë të largët nga Armenia.}: Shënim i Robert Ellis

Dy emra të tjerë etnikë të rëndësishëm, Tuskanët (Tuskët) dhe Dardanët, kanë pothuajse të njëjtën shtrirje territoriale. Të dy janë të lidhur me Etrurinë, ndonëse Dardanët, sidoqoftë, vetëm nëpërmjet Dardanusit mitik. Megjithatë, emri është Dardan, pasi Dardanus ishte emri i një qyteti Apulian në kënetat Salpit * (La Martiniere, Geog. Dict.), dhe Dardi nga një popull i vjetër Apulian* (Plin. H. N. iii.16.). Të dy këto emra duket të jenë Ilirë; pasi Dardanii ose Dardaniate janë një komb Ilir, dhe ky ka qenë një vend që shtrihej në Mesia (Maesia), të quajtur Dardania. Një pjesë e madhe e Albanëve (Shqiptarëve) të sotëm quhen Toskë. Në Azi këto emra vazhdojnë të shfaqen. Ka një Dardanus në Misia (Mysia). Herodoti flet për Dardanë në atë vend, që sot quhet Kurdistan* (i.189. Rrënja mund të jetë fjala Armene

"dar - lartësi" ose nga Osetishtja "dard – largësi"). Ptolemeu përmend Tuskë në Sarmantinë Aziatike, dhe vazhdon të ekzistojë akoma edhe një tribu e quajtur Tuski ose Tuskethi në vendin nga ku buron lumi Alazan, lum ky që ushqen lumin Kur[13]

SIR PATRICK COLQUHOUN & VASO PASHA

"Pellazgët, pasardhësit e tyre të sotëm dhe origjina pellazge e poemave të Homerit"

Një fis tjetër, i të njëjtës racë Pellazge, kaloi Hellespontin dhe erdhi në Trakë, dhe pastaj vazhdoi më tej përmes Maqedonisë për në Iliri, duke e shpronësuar racën e mëparshme, ndoshta me origjinë Iberike, Turanike ose Ariane greqisht – folëse, dhe duke pushtuar më në fund të gjithë vendin dhe ishujt në jug, pra Peloponezin dhe ishujt ngjitur të Arkipelagut;

Në një periudhë të mëtejshme ata kaluan lumin Po, kolonizuan Toskanën, ose Etrurinë, dhe depërtuan në drejtim të jugut, dhe u ndoqën dhe u shtynë më tej nga Tirrenianët e së njëjtës racë; (fq. 104, 105)

ARTASHES ABEGIAN

"Geschichte Armeniens"

Në kohën e emigrimit të Armenëve të vjetër, në zonat përtej Eufratit ishin rezidentë banorët Kaldë (Çaldë, Chaldë) ose Urartianë. Vendi i tyre, Urartu-ja, me qendër në Arcaskun (tashmë - Arcn) dhe Tushpa (tashmë -Van) në Detin (Liqenin) Van, në periudhën nga shekulli i 9^{të} deri në të 7^{të} para Krishtit ishte një nga shtetet më të fuqishëm dhe me një kulturë shumë të zhvilluar të Azisë së Afërme dhe ndërmerrte shpesh luftëra të rëndësishme ndaj fqinjit të vet të fuqishëm, Asirisë.

Panteoni i Zotave i Vanit përfaqëson paraqitjen më të shkëlqyer të treshes; Haldin (babain e zotave, krijuesin e tokës dhe qiellit), Tejshebanin (zotin e luftës, trimërisë dhe shtërngatës) dhe Shivinin (zotin e Diellit, qendra kryesore e adhurimit të të cilit ishte Tushpa, kryeqyteti i Vanit). Adhuroheshin gjithashtu edhe zotat e fushave, maleve, detrave, etj. Pas panteonit të mbretërisë së Vanit u shfaqën edhe forma të tjera panteonesh dhe, në prag të pranimit të Krishterimit, panteoni Armen shfaqet me një formë të re. (Fq. 78)

ZACHARIE MAYANI

"Etruskët fillojnë të flasin"

Origjinat e këtij populli që quhej *tursk, tusk, etrusk,* janë pjesërisht të lidhura me popullsinë *Tursha,* ai fis luftarak që në shekujt XIII[të] dhe XII[të] para Krishtit, i shoqëruar me *Licët* dhe fise të tjera endacake, kishin sulmuar nëpërmjet detit Egjyptin faraonik. Turshat do të arrinin të vendoseshin, rreth pesë ose gjashtë shekuj më vonë në Etruri. (fq. 103)

Megjithatë, as të parët dhe as të dytët e këtyre studjuesve nuk ofrojnë, për shembull, as shpjegim as identitet rreth emrave etnikë *Tursha* dhe *Tursk,* për faktin që emri kombëtar i etruskëve, *Tarkuin,* është ai i një hyjnie të Azisë së Vogël, *Tarku* ose *Tarkon.* (fq. 103)

Por *Turshat,* të cilët shfaqen në Itali në shekujt IX[të] – VIII[të] para Krishtit dhe që e quajnë veten e tyre *Rasna,* do të sillnin aty pa diskutim shumë elemente të rinj, që lidheshin me civilizimin Anadollas: rite, tipare të arkitekturës mortore, motive arti, një farë luksi oriental, si edhe emrin *Tarkon,* depërtimi i të cilit në Etruri nuk mund të shpjegohet vetëm nëpërmjet ndryshimeve tregtare. (fq. 104)

Emërtimet e disa territoreve Lidase prej ku vinin *Turshat* ishin: *Malea* (nga shqipja – mal), *Plakia* (nga shqipja – plak, i vjetër) që të gjitha Ilire. Të ardhurit rishtas ishin që të gjithë njerëz të trungut

Ilir, as Lidas, as Aziatikë, por Thrako-Iliras të vendosur në Lidi. Me mbërritjen e tyre në Itali, atdheu i tyre i ri, ata do të gjenin aty një popullsi të së njëjtës rrënjë dhe që fliste të njëjtën gjuhë ilire, dhe ata do të integroheshin aty pa shumë vështirësi. (fq. 105)

Faktikisht, Etruskishtja paraqet disa pika kontakti me Armenishten, ashtu si edhe Shqipja. (fq. 130)

Shënim B.P: Duke cituar studjuesin B. Hrozny, i cili në vitin 1929 kishte botuar një artikull të titulluar "Gjuha Etruske dhe gjuhët Hittite", Mayani shkruan:

..., dhe ai përfundon: "Etruskët kanë ardhur në Itali nga një rajon i vendosur fare pranë Hittitëve, domethënë nga Azia e Vogël", gjë që sipas nesh, paraqet një imazh jo të plotë të situatës. (fq. 456)

SPIRO KONDA

" Shqiptarët dhe problemi Pellazgjik"

... Në Etruri përmenden si banorë *Etruskët* ose *Juskët.* Po, sipas Strabonit, Etruskë ose Juskë quheshin prej romanëve Tyrenët.

"Tyrenët, pra, quhen prej romakëve *Etruskë* ose *Tuskë."* (Strab., Kap. 219,2).

Po, sipas Dionisit të Halikarnaseas, Tyrenë u quajtën *Pellasgët* që u vendosën në Itali.

"Elaniku Lesbiani thotë se Tyrenët, që quheshin më parë *Pellasgë*, pasi erdhën dhe banuan në Itali, e muarën emrin që kanë sot". (Dion. Alikarn. Vol. A XXVIII, 3). (fq. 124)

Etruskët janë, pjesërisht, trashëgimtarët e Tursha-ve. Por *Tursha*t nuk janë një popull me origjinë orientale. Ata janë Ilirë të lashtë (ose Thrako-Ilirë) të vendosur në Azinë e Vogël. (fq. 515)

ARTAK MOVSISJAN

"Historia e Armenisë"

Në "Kronikat Anglo – Saksone" të shkruara në shek. e 9të pohohet që, në Ishujt Britanikë" banorët e parë kanë qenë Bretonët, të cilët kishin ardhur nga Armenia". Sipas "Kronika Bavareze", "Kënga e Anës", "Kënga e Rolandit" dhe burimeve të tjera të Mesjetës del që Bavarezët e kanë zanafillën e tyre në Armeni, në malin Ararat, atje ku Noe qëndroi me barkën e tij. Zanafillën e tyre e lidhin me Armeninë edhe Baskët. (Fq. 18)

Në fillim të viteve 1980 u konfirmua, që atdheu i stërlashtë i botës Indo-Europiane në mijëvjeçarin e 5të – 4t para Krishtit, ishte zbuluar në veri të Azisë Perëndimore, më saktësisht, në Malësitë Armene, në krahinat lindore të Azisë së Vogël, ndërmjet Mesopotamisë veriore dhe krahinave veri-perëndimore të zëna nga pllaja Iraniane. Kështu, atdheu i stërlashtë i Indo-Europianëve është gjetur pikërisht brenda asaj hapësire ku është formuar dhe nëpër të cilën ka kaluar historia e popullit Armen. (Fq. 18 - 19)

Banorët e Arattës ishin importues të prodhimeve bujqësore, dhe në këmbim eksportonin metale dhe gurë të çmuar. Përveç këtyre, dërgonin në jug edhe një sasi të madhe "gurë malorë" që shërbenin për ndërtime. Në burimet e shkruara, përmendja për herë të parë e mbarështimit (zbutjes, trajnimit dhe përdorimit për nevoja të njerëzve) të kuajve i referohet tokave të Arattës. Më pas, përdorimi i kuajve në ekonomi dhe ushtri, i dha këtyre një përparësi të paimagjinueshme. (Fq. 27 - 28)

Në burimet e shkruara Asore, si pasues i këtij mbreti, përmendet mbreti "urartian" Sarturi i Irë, i cili themeloi dhe ndërtoi si kryeqytet të tij qytetin *Tushpa (Tosp, Van).* Në vitet 830të para Krishtit të sundimit të tij, në mbishkrimet e gjetura në qytetin e tij, ai përmendet si "mbreti i tokave të Najirit" duke u marrë Asorëve titujt mbretërorë si "Mbret i Madh, Mbret i Botës, Mbret i Mbretërve.." (Fq. 33)

WIKIPEDIA

Tushpa (armenisht: Տուշպ Tosp, asirisht: Turuspa, turqisht: Tuşpa) ishte kryeqyteti i Urartusë në shekullin e 9të para Krishtit; më vonë u bë i njohur si Van, që rrjedh nga Biainili, emri vendas i Urartusë. Rrënojat antike ndodhen pikërisht në perëndim të qytetit Van dhe në lindje të Liqenit Van në Provincën Van të Turqisë.

Mund të shqiptohej si "Tospa" në kohët e lashta, pasi në shkrimin simbolik kuneiform Akkadian nuk kishte asnjë ekuivalent të germës O, kështu që, shpesh zëvendësohej duke përdorur simbolin U.

BERZH PIRANJANI

(Interpretime të emrit "Geg – Tosk")

Atëhere, në vazhdim të asaj që parapriu si "Hyrje", vazhdojmë me shtjellimin e pikës 2, hamendësim lidhur me prejardhjen emrit "Geg" dhe "Tosk":

Hamendësimi im priret ta gjejë shtjellimin e çështjes duke u nisur nga pllajat Anatoliane, nga historitë që tregohen lidhur me paraardhësit dhe pasardhësit Xhafetikë, dhe nga ngjashmëritë që shfaqin këto histori me legjendat dhe historitë Ballkanike të periudhës Pellazgjike.

Ashtu si Shqiptarët sot, edhe Armenët aktualisht kanë dy dialekte kryesore, të cilat i emërtojnë: dialekti Armeno-Lindor dhe dialekti Armeno-Perëndimor. I pari flitet në zonën verilindore të të ashtuquajturave Malësitë Armene, pranë liqenit Sevan, ndërsa tjetri ka pasë qenë folur në zonën jugperëndimore të tyre, pranë liqenit Van.

(*Shënim B.P.:* Them "ka pasë qenë folur ..", pasi sot kjo zonë është pjesë e shtetit të sotëm turk. Megjithatë ky dialekt vazhdon të flitet akoma edhe sot nga Diaspora "Perëndimore".)

Të dy këto zona kanë luajtur rol të rëndësishëm në historinë e Armenisë:

Zona në veri dhe pranë liqenit Sevan sot quhet Gegharkunik dhe mendohet se e ka marrë emrin nga mbreti i saj, që quhej Gegh (apo Gel ose Ger) (*Shënim B.P.:* të kihet parasysh që *"gh"* apo *"l"* dhe *"r"* është transkriptimi i germës Armene *"η"* në gjuhë të ndryshme). Ajo

ishte pronë e marrë në rrugë trashëgimie (shih "pema gjenealogjike e Torgomit" po në këtë libër).

Zona në jug, pranë liqenit Van, gjithashtu në kohët e hershme ka qenë një mbretëri e fuqishme me kryeqytet Tushpën (Tushpa, Tosp), një qytet në jug të liqenit Van.

Në librin "Historia e Armenisë", me autor Artak Movsisjan, në Fq. 33) thuhet:

(Në burimet e shkruara Asore, si pasues i këtij mbreti, përmendet mbreti "urartian" Sarturi i I^{rë}, i cili themeloi dhe ndërtoi si kryeqytet të tij qytetin *Tushpa (Tosp, Van).*

Do ta kisha pasur më të lehtë fluturimin e hamendësimit tim, n.q.s. ky emër i dytë do të më ishte shfaqur në formën "Tushka, Tuska apo Toska", por në këtë rast nuk di nëse germa *"p"* dhe *"k"* justifikojnë zëvendësimin reciprok kur kalohet nga gjuha Armene në atë Shqipe apo Etruske apo Greqishte e vjetër.

Shënim B.P.:

Në librin e tij "Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit", ndër të tjera, autori Garegin Nalbandian shkruan:

"*Gegh ose Gel,* djali i Amasias, dhe gruaja e tij, Gegham (Gegham ose Gegh-Am nënkupton "Gruaja e Geghut"; Urartianët e lashtë përdornin *L* në vend të *Gh, U* në vend të *O,* etj.)... (Fq. 147)"

Në këtë rast do nxitoja të hamendësoja se emërtimet "Geg" dhe "Tosk" mund të ishin pasojë e lëvizjes së grupeve të njerëzve nga krahinat sipërpërmendur në drejtim të Ballkanit, dhe do të isha dakort në parim, që fillimisht kanë lëvizur banorët e Tushpës, që është më afër zonës së Ballkanit. Duke ardhur në Ballkan ata janë ndarë në dy rryma: njera që vendosi të qëndrojë në Ballkan dhe lëvizi në drejtim të jugut dhe perëndimit të Ballkanit dhe tjetra që mori drejtimin e veriut dhe përfundoi në gadishullin Apenin dhe më pas deri në vendet Baske.

Kjo mbase i vjen për shtat teorisë së studiuesit Robert Ellis për

prejardhjen Armene të Etruskëve dhe teorisë së studiuesit armen Vahan Setian mbi "Origjinat Armene të Baskëve"; po pse jo edhe të atyre studiuesve shqiptarë që e lidhin prejardhjen etruske nga banorët toskë të Shqipërisë.

Më pas vjen lëvizja e njerëzve të Geghut, të cilët me ardhjen në Ballkan shtynë paraardhësit e tyre Tushpa drejt jugut. Përsëri më pas historia ka qenë një përpjekje e vazhdueshme e veriorëve për të depërtuar drejt jugut, ku natyra ofronte kushte më të mira jetese.

Depërtimi i tyre drejt jugut është shoqëruar, natyrisht, jo pa rezistencë nga banorët më të hershëm Tushpa, ndonëse janë i njëjti trung. Nuk është çudi që duke përdorur të njëjtën gjuhë, atë Armene, ata emërtimit "Gegë – popull i Geghut" t'i kenë dhënë kuptimin përçmues ofendues "fshatar", pasi nuk besoj që t'i kenë dhënë kuptimin "I bukur".

Shënim B.P.: Në gjuhën Armene fjala "Gegh, Gel" ka këto kuptime:

գեղ (gegh) – village, country; country house - fshat, vend; vilë

գեղ (gegh) – beauty, loveliness, elegance - bukuri, dashuri, hijeshi

Të dy këta grupe popujsh ishin pasardhës Torgomianë, ishin një racë, flisnin të njëjtën gjuhë, por ndoshta dy dialekte, ashtu siç flitet në botën Armene deri në ditët e sotme.

Dy dialekte që mbase në kohën e tyre nuk quheshin dialekti Armeno-Lindor dhe dialekti Armeno-Perëndimor, por dialekti i Geghëve dhe dialekti i Tushpave (Tospëve).

Shënim B.P.: Të kihet parasysh që Mbretëria e Geghut ka qenë kufitare me mbretërinë e Albanisë së Kaukazit.

Një tjetër hamendësim, që do t'i shkonte për shtat lëvizjeve në Ballkan sipas mënyrës së paraqitur më sipër, do të mund të ngrihej mbi bazën e hipotezës së paraqitur nga Wilhelm Obermüller tek "Popujt e Alpeve", Fq. VII, kur thotë: "Kësisoj, nuk mbetet gjë tjetër, veçse të shihen ata, që grekët i quanin "gjigantë" dhe "titanë". Në legjendat poetike, gjigantët paraqiten si paraardhësit e gegëve të

sotëm në Albani dhe titanët si popull arian, të cilët nën udhëheqjen e Kronosit dhe Zeusit, duke u nisur nga Siçilia dhe Kreta, që fillimisht banoheshin nga gjigantët, pushtuan pjesën jugore të Italisë dhe të Greqisë, dhe banorët e vjetër, pra, autoktonët e vërtetë, gegët, u detyruan të zmbrapseshin."

Në librin e tij "Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit", ndër të tjera, autori Garegin Nalbandian shkruan:

""Legjenda Armene e Hajkut dhe Belit" përcakton se, Hajku dhe pasardhësit e tij luftuan kundër ushtrive të Belit në zonën e quajtur Hajoc Cor, dhe se ishte një Betejë Gjigandësh."

...

Është i njohur fakti se, historia e lashtësisë u shkrua duke përdorur një gjuhë të fshehtë, e cila quhet mit ose mitologji. Shumë historiografë të mitologjisë shkruan së Nimrodi ishtë një gjigand (një Titan) i gjatë sa gjashtëdhjetë burra, që qëndronin mbi njëri-tjetrin. Shumë historianë Armenë shkruan se Hajku ishtë një burrë i gjatë sa tridhjetë e gjashtë burra, që qëndronin mbi njëri-tjetrin." (Fq. 16)

Sipas kësaj legjende Hajku ishte pasardhës Xhafetik, ndërsa Nimrodi ishte pasardhës Hamitik. I pari sundonte kryesisht mbi të ashtuquajturat Malësitë Armene, që ndodhen në zonën Anatoliane, i dyti mendohet se e kishte bazën në Etiopi, nga ku mendohet se më pas nëpërmjet pushtimesh e shtriu sundimin e tij mbi Babiloni dhe toka që ndodheshin përgjatë bregdetit Afrikan, siç ishin Egjipti dhe Libia.

Në librin e tij "Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit", ndër të tjera, autori Garegin Nalbandian shkruan:

"Sipas një legjende tjetër, kur Hami mori familjen e tij drejt jugut, pasi ishte mallkuar nga Noe, atij iu desh të ndeshej me një luan për të mbrojtur familjen e tij, dhe Hami e vrau luanin. Kështu, ai u emërtua Titan për shkak të fuqisë së tij të hyjnore. Kushi ishte një Titan, pasi ai ishte pasardhës i Ham Titanit. Kushi, gjithashtu, vrau një luan dhe e vendosi kokën e luanit mbi kësulën e tij, për

të treguar, që ai ishte trashëgues i linjës së gjakut hyjnor të Hamit. Kushi krijoi një traditë për të gjithë Titanët: për t'u përballur dhe për të vrarë një luan. Pasi vdiq Hami, Kushi u bë mbret i Titanëve (Kushitëve) dhe i Hamitikëve të tjerë, që kishin zbritur në Egjiptin e Sipërm dhe Afrikën e Veriut." (Fq. 50)

Më pas, ai vijon:

"Nimrodi ishte djali i Kushit. Ai ishte i fortë dhe trim; prandaj ai u zgjodh nga Kushi për të qenë udhëheqësi i Titanëve dhe i Hamitikëve të tjerë." (Fq. 53)

Nuk është çudi, që jehona e kësaj legjende të jetë përdorur më pas nga popujt, të cilët jetonin në pjesën jugore të Ballkanit (flas për zonën që përkon me Greqinë e sotme) kur flasin për "gjigantë" apo "titanë", që sipas Wilhelm Obermüller "..pushtuan pjesën jugore të Italisë dhe të Greqisë, dhe banorët e vjetër, pra, autoktonët e vërtetë, gegët, u detyruan të zmbrapseshin".

Nuk do të ishte gjë tjetër, veçse një përsëritje e historisë së vjetër të betejës ndërmjet "gjigantëve Xhafetikë" dhe "Titanëve Hamitikë" të treguar në "Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit", por kësaj rradhe si një betejë ndërmjet pasardhësve të tyre.

Duke pasë parasysh pozicionin gjeografik të Greqisë dhe Italisë, do të ishte më se e llogjikshme të mendohet se zbritjet në Ballkan apo Itali nga fise të ardhura nga veriu fillimisht kanë qenë ato të racës Xhafetike, që popullonin Malësitë Armene (në kohën për të cilën bën fjalë legjenda), ndërsa pushtimet nga jugu të jenë bërë nga popullsi Hamitike, që pretendohet se sundonte mbi territoret sipërpërmendur, ose popullsi e përzier (Hamitike, Semitike, banorë afrikanë autoktonë, etj.).

Mbi këtë mënyrë arsyetimi mund të shpjegohet edhe armiqësia ndërmjet të ardhurve nga veriu (që po i pranojmë si Xhafetikë) dhe pushtuesve të ardhur më pas nga jugu (Egjipti, Libia, etj., që po i pranojmë kryesisht si Hamitikë), armiqësi që mund ta kishte bazën në legjendat e trashëguara brez pas brezi.

Ky arsyetim ka një veçori: që kërkon të pranohet si fakt se, në këtë pjesë jugore të Ballkanit ka pasë arritur të depërtojë popullsi e quajtur "Gegë".

Dhe n.q.s. analizojmë historitë e kohëve të reja, nuk është për t'u çuditur, që në grindjet e brendshme për territore apo pushtet ndërmjet "Gegëve" dhe "Toskëve", këta të fundit, që kishin qenë me kohë në kontakt me popujt e brigjeve jugore përballë tyre, të kenë thirrur në ndihmë Hamitikët afrikano-veriorë në përleshjet me "Gegët", që vijonin të dyndeshin nga veriu për në jug të Ballkanit.

Pas gjithë sa thamë më sipër, ndjejmë që brenda këtij hamendësimi ka kundërshti, të cilat duhen zgjidhur, përpara se t'i japim rrugë arsyetimit të mëtejshëm.

Duke marrë në konsideratë faktin që, historikisht lufta e Trojës mban datën 1190-1180 B.C. dhe trajtohet si një luftë e zhvilluar ndërmjet fiseve të të njëjtit trung e që flisnin të njëjtën gjuhë, atëhere pyetjet që lindin janë këto:

Këto dy grupe njerëzish, për të cilët hamendësohet më sipër, kanë lëvizur para kësaj date apo pas kësaj date?

Sipas hamendësimit për kohën kur kanë ardhur në këto vise, çfarë popullsie kanë gjetur?

Këtu, do ndalemi në analizën e dy çasteve:

N.q.s. analizojmë pemën gjenalogjike të Xhafetit, paraqitur më sipër në këtë libër, do të shohim që Geghu shfaqet si pasardhës i brezit të 10të të Xhafetit ose si pasardhës i brezit të 6të të Hajkut.

Në librin e tij "Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit", ndër të tjera, autori Garegin Nalbandian shkruan:

"Sipas Ghevond Alishanit dhe Katolikosit Hovhannes të Armenisë (emri Hovhannes i Armenëve korrespondon me emrin Xhon të Anglezëve), Hajku vdiq në vitin 2446 përpara lindjes së Jezu Krishtit." (Fq. 126)

Nga kjo mund të nxjerrim se, sado e gjatë të ketë qenë jetëgjatësia e pasardhësve të Hajkut, normalisht, Geghu duhet të ketë jetuar dhe mbretëruar përpara se të bëhet fjalë për luftën e Trojës.

Më pas, n.q.s. i drejtohemi autorit Artak Movsisjan, tek libri i tij "Historia e Armenisë", Fq. 33, lexojmë:

Në burimet e shkruara Asore, si pasues i këtij mbreti, përmendet mbreti "urartian" Sarturi i I[rë], i cili themeloi dhe ndërtoi si kryeqytet të tij qytetin *Tushpa (Tosp,* Van). Në vitet 830[të] para Krishtit të sundimit të tij, në mbishkrimet e gjetura në qytetin e tij, ai përmendet si "mbreti i tokave të Najirit" duke u marrë Asorëve titujt mbretërorë si "Mbret i Madh, Mbret i Botës, Mbret i Mbretërve.." (Fq. 33)

Kjo lë të kuptosh se lëvizje banorësh të Tushpas (Tospa, Van) nuk mund të emërtojmë përpara datës së luftës së Trojës.

Si zgjidhet kjo kundërshti ??

Ja si e mendoj unë:

Lëvizja prej hapësirave Anatoliane drej hapësirave Ballkanike dhe më tej ka ndodhur jo në rendin kohor të paraqitur pak më sipër, por sipas kësaj rradhe:

Fillimisht duhet të kenë qenë banorë të mbretërisë së Geghut (Geghët) ata, që kanë lëvizur të parët drejt hapësirave Europiane, duke zbritur së pari në hapësirën Ballkanike dhe më pas në atë të gadishullit Apenin. Hamendësoj se për ata kjo rrugë nuk ka qenë e panjohur, n.q.s. i mbështetem teorisë pellazgjike të trajtuar nga unë në kapitullin më sipër. Duke i qëndruar kësaj linje arsyetimi, mund të them se në këtë lëvizje ata kanë kaluar nëpër fise të të njëjtit trung dhe kanë mbërritur në fise po të të njëjtit trung, nëpër grupin e fiseve që i kemi quajtur "Fise Pellazge" dhe që flisnin të njëjtën gjuhë. Kjo besoj se nuk gjen kundërshti me teorinë e ekzistencës së "Fiseve Pellazge" në zonën Anatoliane dhe atë Ballkanike deri në mbarimin e luftës së Trojës, për të cilën hamendësohet si një luftë e zhvilluar ndërmjet fiseve të të njëjtit trung e që flisnin të njëjtën gjuhë.

Nisur nga shkrimi tek "Historia e Armenisë", Fq. 33, lëvizja e banorëve të Tushpas (Tushpanëve, Tospanëve) nuk duhet të ketë ndodhur para vitit 830[të] para Krishtit, pra rrjedhimisht ka ndodhur, n.q.s. realisht ka ndodhur, në periudhën pas luftës së Trojës. Pra, janë Tushpanët që janë mbivendosur mbi farefisin e tyre "Pellazg" të Geghëve në Ballkan dhe mbase edhe në gadishullin Apenin.

Duke folur për arritje grupimesh njerëzore nga Anatolia në Ballkan dhe gadishullin Apenin, ja vlen të përmendim thëniet e disa studiuesve:

Johann George von Hahn, tek "Studime Shqiptare":

"Shumë gjurma tregojnë se ndër dialektet e helenëve, dialekti i dorëve i përngjan ma fort *gegnishtes.* (Fq 351)"

Nermin Vlora Falaski, tek "Pellazgët, Ilirët, Etruskët, Shqiptarët":

..., një sasi e madhe mbishkrimesh të Italisë i ngjasojnë të folmes së dialektit *gegë.* (Fq. 289)

Zacharie Mayani tek "Etruskët fillojnë të flasin" :

Faktikisht, *Etruskishtja paraqet disa pika kontakti me Armenishten, ashtu si edhe Shqipja.* (fq. 130)

Shënim B.P.: Të shihen edhe frazat e tjera në nxjerra nga punimet e këtyre autorëve në kapitujt "Interpretime të emrit - "TOSK" dhe "Interpretime të emrit - "GEGË"

Sa më sipër, vlen për të treguar se gjurmë të ekzistencës të të njëjtave fise apo fiseve që flisnin të njëjtën gjuhë, sipas teorive të studiuesve të mësipërm, gjenden në të dy këta gadishuj, si në atë Ballkanik ashtu edhe në atë Apenin.

Këtu do të mund të na hynin në punë legjendat greke të përmendura nga Wilhelm Obermüller tek "Popujt e Alpeve", ku flitet për gjigantë dhe Titanë. Ja ç'thotë ai në një vend:

"Përpara mbërritjes së Titanëve, gegët banonin ose zotëronin gjithë Greqinë." (Fq. 3)

Po aty, në Fq. 4 thuhet: "Pushtimi jonik apo pellazg në Greqi ndodhi vetëm 100 vjet pas shkatërrimit të Trojës, pra, nga vitet 1000 apo 1100 para Krishtit."

Kam përshtypjen se këto dy shprehje të zotit Obermüller, kur analizohen të krahasuara me njera tjetrën, kanë diçka që nuk më shkon:

Pranoj hamendësimin se në periudhën ndërmjetëse pas luftës së Trojës deri në vitet 800 para Krishtit, kur mendohet që ka jetuar Homeri, në Greqi ka pasur një pushtim, që vinte nga jugu, nga deti. Pranoj hamendësimin që ky pushtim të konsiderohej një mbërritje e Titanëve dhe këtu kam parasysh ata "Titanë", që përmenden si zotërues të bregdetit verilindor të Afrikës, Egjiptit, Libisë, etj., "Titanë" të përmendur tek "Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit", pranoj hamendësimin se këta "Titanë", kur kanë zbritur në Greqi, kanë gjetur atje "gegët", që "banonin ose zotëronin gjithë Greqinë.", pranoj hamendësimin se kjo "ndodhi vetëm 100 vjet pas shkatërrimit të Trojës, pra, nga vitet 1100 apo 1000 para Krishtit.", por më duket kontradiktor pohimi se ky pushtim ishte "Pushtimi jonik apo pellazg në Greqi", siç është cituar më sipër, pasi kjo do të binte në kundërshtim me interpretimin e shumë personaliteteve të shquara në fushën e studimeve historike dhe gjuhësore, që pranojnë në këto zona ekzistencën e një popullsie paraGreke, të quajtur "Pellazge", në të cilën bëjnë pjesë edhe të ashtuquajturit "Gegë". Pra, nuk më duket me vend të flitet për një "pushtim jonik apo pellazg në Greqi" pas luftës së Trojës, pasi edhe vetë Homeri e pohon këtë luftë si luftë mes fisesh pellazgjike; pellazgjikët kanë qenë aty, nuk kishin pse të vinin si pushtues të vetvetes.

Por edhe këtu ka një shteg arsyetimi që justifikon shprehjen e zotit Obermüller, "Pushtimi jonik apo pellazg në Greqi ndodhi vetëm 100 vjet pas shkatërrimit të Trojës, pra, nga vitet 1100 apo 1000 para Krishtit."

Kjo, n.q.s. do pranonim, që zoti Obermüller ka gabuar me kohën e ndodhjes së këtij "pushtimi". Këtu kam parasysh një tjetër zbritje

pellazgjike në Ballkan dhe gadishullin Apenin nga ana e e banorëve të Tushpas (Tushpanëve, Tospanëve), që duhet të ketë ndodhur pas vitit 830të para Krishtit, menjëherë pas së cilës mendohet edhe lulëzimi i shoqërisë Etruske në gadishullin Apenin dhe zhvillimi në Greqi i një shoqërie, që sipas Herodotit përbëhej nga dy grupe lehtësisht të dallueshme nga njeri tjetri si nga gjuha ashtu edhe nga zakonet; fillon të flitet për Grekë dhe Pellazgë.

Këtu të shkon mendja përsëri në hamendësimin se Tushpanët duhet t'i kenë njohur Geghët, se të ardhurit duhet të kenë pasur një nivel më të lartë zhvillimi se vendasit e hershëm "geghë", pavarësisht se i përkisnin një trungu gjenealogjik, dhe ta kenë përdorur termin "gegh" në kuptimin real që kishte ajo fjalë, pra, pasardhës të Geghut ose në kuptimin përçmues ofendues "fshatar". Unë mendoj se është e para.

Por edhe kjo nuk e shteron diskutimin për pushtimet në Greqi pas luftës së Trojës deri në vitet 800 - 700 para Krishtit.

Madje këtu na vjen përsëri në ndihmë pohimi i zotit Obermüller mbi "mbërritje Titanësh" në Greqi.

Si do të mund të arsyetoja pranimin e këtij pohimi, duke mos hedhur poshtë pohimin e mëparshëm mbi "pushtim jonik apo pellazg në Greqi" të po këtij autori.

Në librin e tij "Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit", ndër të tjera, autori Garegin Nalbandian shkruan:

"Nimrodi dhe ushtritë e tij shkatërruan gjithçka ata pushtuan. Ai i lëvizte vartësit e tij nga një vend në tjetrin. Ai ndërtoi qytete dhe vendbanime të reja. Pastaj, ai i mbushte ato me vartës nga mbretëria e tij, të cilët nuk ishin vendas autoktonë. … Ai, gjithashtu, u përpoq të krijonte një qytetërim Babilonas, duke detyruar shtetasit e tij të merrnin gra të racave të ndryshme dhe nga grupe të ndryshme etnike." (Fq. 75)

"Ndërkohë që përpiqej të krijonte një komb të ri në Babiloni duke përzier Afrikanë, Mesopotamianë dhe popuj të tjerë, të cilët i

shërbenin atij, shumë shpejt ai e kuptoi, se po provonte të realizonte një tjetër projekt, i cili po shkonte drejt dështimit...” (Fq. 76)

Po aty kemi:

“Hajku kurorëzoi nipin e tij, Kadmosin, si mbret të Fenikias, pasi që nga momenti që Feneçi kishte vdekur në mënyrë të mistershme, tokat i kishin kaluar në administrim Nimrodit, dhe pas vrasjes së këtij të fundit nga Hajku, Fenikasit kishin nevojë për një mbret të ri; kështu Kadmosi u bë mbreti Fenikasve në momentin që Hajku u bë mbret i mbretërisë së Nimrodit.” (Fq. 145)

Duke pranuar mendimin, sipas të cilit ishin Fenikasit ata që e sollën shkrimin në Greqi, dhe këtu bëhet fjalë pikërisht për periudhën pas luftës së Trojës, pikërisht kur qytetërimi fenikas ishte në lulëzimin e tij, (bëhet fjalë për shekujt 11-9 para Krishtit) përse të mos pranojmë edhe mendimin se Fenikia iu imponua Greqisë edhe me prurje banorësh, të cilët gjetën aty një burim të mirë pasurimi nëpërmjet zhvillimit të tregtisë apo zejeve të ndryshme, pa folur për fushat që kishin të bënin me kulturën dhe artin.

Por Fenikia kishte qenë një vend, që kishte qenë nën sundimin e Nimrodit dhe Titanëve deri në momentin e vrasjes së Nimrodit nga Hajku. Pavarësisht se në krye të Fenikisë Hajku vendosi Kadmin, i cili ishte një pasardhës Xhafetik, përbërja e popullsisë fenikase ishte e përzier, ashtu siç kishte dashur ta bënte dhe siç e kishte lënë Nimrodi mbretërinë pas vrasjes së tij: Hamitikë, Semitikë, afrikanë, Lidianë, arabë, etj. Por Hamitikët e Nimrodit në kohën e tyre thirreshin Titanë. Kjo mbase do të justifikonte pohimin e mbërritjes së grupimit Titan në Greqi në kuadrin e masës së popullsisë Fenikase të çvendosur drejt Greqisë. Pavarësisht xhafetikut Kadmi që u vu të mbretëronte mbi Feniki, siç e përmendëm edhe më sipër, popullsia fenikase nuk ishte Xhafetike, por e përzier, dhe si e tillë edhe gjuha e saj detyrimisht duhej të kishte dallim prej asaj që përdorte populli Xhafetik.

Ja ç’thotë autori Garegin Nalbandian në librin e tij “Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit”, kur flet për pengesat që dilnin gjatë

ndërtimit të Kullës së Babelit: "Kishte një pengesë gjuhësore. Shumë njerëz ishin të paaftë të komunikonin dhe të merreshin vesh me njeri tjetrin, sepse flisnin gjuhë të ndryshme..." (Fq. 71)

Këtu duhet të kemi parasysh atë që kemi thënë më sipër se, sado e gjatë të ketë qenë jetëgjatësia e pasardhësve të Hajkut, normalisht, Kadmi dhe Geghu, për të cilët bën fjalë legjenda, duhet të kenë jetuar dhe mbretëruar përpara se të bëhet fjalë për luftën e Trojës. Kështu që, kur bëhet fjalë për lëvizje të "gegëve" apo "kadmenëve", duhet pasur parasysh, që bëhet fjalë për lëvizje grupe njerëzish, që nuk ishin gjë tjetër veçse pasardhës të Kadmit apo Geghut.

Duke mos u zgjatur më me këto endje nëpër labirintet e hamendësimeve, po përpiqem të paraqes të përmbledhur sa më shkurt si e përfytyroj shkakun e ngjashmërive ndërmjet kulturave Armene-Shqiptare – Greke –Latine:

Fillimisht, rreth 2500 - 2000 vjet para Krishtit ka pasur një lëvizje popullsish, të quajtura "Pellazgjike" (shih hamendësimin tim në materialin më sipër të titulluar "Interpretime të emrit "Pellazg"), me drejtim nga Pllajat Anatoliane në drejtim të Ballkanit. Me mbërritjen në Ballkan një pjesë është vendosur mbi të duke u shtrirë drejt jugut, ndërsa pjesa tjetër ka vazhduar rrugëtimin drejt veriut për të përfunduar më pas në gadishullin Apenin dhe mbase deri në vendet Baske.

Duke pasë parasysh pozicionin gjeografik të mbretërisë së Geghut në zonën e Anatolisë verilindore, mendoj se një nga fiset që ndodhej në bisht të kësaj lëvizjeje dhe që u ndal e fundit në Ballkan ka qenë fisi i Geghut, nga ku mendoj se më pas u ruajt emri "Gegë".

Rreth 100 vjet pas luftës së Trojës pati një tjetër lëvizje popullsish; kësaj rradhe mendoj se ishin ato të shkaktuara nga zhvillimi i marrëdhënieve tregtare ndërmjet qytet-shteteve greke dhe atyre Fenikase, si rezultat i së cilës në qytet-shtetet greke shohim lulëzimin e tregtisë, futjen e shkrimit dhe lulëzimin e kulturës. Kjo u shoqërua edhe me ardhjen e banorëve të rinj, kryesisht fenikas, të cilët, siç

e kemi thënë edhe më sipër, gjetën aty një burim të mirë pasurimi nëpërmjet zhvillimit të tregtisë apo zejeve të ndryshme, pa folur për fushat që kishin të bënin me kulturën dhe artin.

Ardhja e tyre nuk mund të thuhet se është pritur mirë nga banorët vendas dhe ndoshta mund të jetë kryer në formën që i ka detyruar banorët vendas "gegë" t'i quajnë ata "pushtues".

Duke pasë parasysh se në gjuhën Armene, rrënja e fjalës pushtues është *"կէղեկ"*, që transkriptohet (Gegheg, gereg, geleg), nuk do të ishte çudi që pikërisht kjo fjalë e deformuar në Greg apo Grek të jetë etimologjia e fjalës "Grek" të ditëve të sotme.

Zhvillimi i këtyre qytet-shteteve në perëndim të gadishullit Anatolian, shoqëruar edhe me rënien e mbretërisë Hittite në gadishullin Anatolian dhe krijimin e disa shteteve më të vogla gjithnjë në konflikt me njera tjetrën, natyrisht që ngjalli zilinë e këtyre qytet-shteteve të tjera të asaj zone, dhe me këtë mbase mund të shpjegohet prirja e tyre për të lëvizur në drejtim të perëndimit më të zhvilluar.

Kësaj prirje nuk duhet t'i kenë shpëtuar as banorët e Tushpas, kryeqytetit të mbretërisë "urartiane" të Sarturit të I[rë], pas perëndimit të shkëlqimit të saj. Bëhet fjalë për vitet 800 para Krishtit e më pas.

Lëvizja e Tushpanëve (Tospanëve) duhet të ketë ndjekur rrugën e paraardhësve të tyre Xhapetiko-Pellazgë, rrugën e Geghëve. Duke kaluar nëpër tokat e zëna nga Geghët në Ballkan, një pjesë e tyre kanë vazhduar rrugën drejt jugut dhe kanë ardhur deri në tokat greke, ku janë përballur me një popullsi të përzier jo miqësore, dhe ku janë detyruar të ndalen. Nën presionin e popullsive jo miqësore të jugut dhe të një natyre të ashpër veriore e të vështirë për banim, ata do kenë qenë të detyruar të hidhen në gadishullin Apenin, nga ku më pas mund të hamendësohet se mori fill historia e Tuskëve apo Etruskëve.

Nuk ka përse të mos pranohet edhe hamendësimi se, ndërkohë një pjesë tjetër ka vazhduar rrugëtimin e saj drejt veriut, për të

përfunduar më pas në gadishullin Apenin apo në pjesë të tjera të Europës Perëndimore.

Por kjo nuk përjashton mundësinë e lëvizjes së grupeve të veçanta edhe me rrugë detare nga brigjet e Azisë së Vogël apo atyre Afrikano-Veriore në drejtim të brigjeve greke apo italiane.

Shënim B.P.: Duke ju referuar lëvizjes emigrative të ditëve të sotme, drejtimit të lëvizjes dhe mënyrave për të kaluar nga vendet e Lindjes (Afganistani, Irani, Siria, Kurdistani, etj) drejt perëndimit Europian, më përforcohet mendimi se, e njëjta gjë duhet të ketë ndodhur edhe në të kaluarën, të cilën po trajtojmë.

INTERPRETIME TË EMRIT "GREK – HELEN – ION – DOR"

Renditja e Interpretimeve sipas Autorëve poshtëshënuar:

1. Johann Thunmann: Historia dhe gjuha e Shqiptarëve dhe Vllehëve 613
2. Johan Georg von Hahn Dr. Jur.: "Studime Shqiptare" 613
3. Jani Vreto: "Vepra te Zgjedhura" 615
4. Naim Frashëri: "Homeri, Iliada; Kënga e Parë" 617
5. Stanslao Marchiano: Studime filologjike zhvilluar me gjuhën Pellazgo-Albane 619
6. Karl Grimberg: Historia botërore dhe qytetërimi (Libri 1) 621
7. Nermin Vlora Falaski: "Pellazgët, Ilirët, Etruskët, Shqiptarët" 622
8. Aristidh P. Kola: "Arvanitasit dhe prejardhja e grekëve" 622
9. Luftulla Peza, Liljana Peza: "Gjuhët e Lashta të Ballkanit dhe Anadollit dhe familja Pellazgjike e gjuhëve" 628
10. Moisi Kaghankatvaci (Daskhuranci): "Historia e Albanëve të Kaukazit" 629
11. Garegin D. Nalbandian: "Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit" 631
12. Nxjerrë nga Wikipedia 632
13. Berzh Piranjani: Interpretim 637

JOHANN THUNMANN

"Historia dhe gjuha e Shqiptarëve dhe Vllehëve"

Kadmi duhet të ketë mbretëruar enkelejtë. (Fq. 99)

DR. JUR. JOHAN GEORG VON

"Studime shqiptare"

Në Shqipninë e jugut ishin dy qytete që quheshin *Ilion,* njani qytet gjindej afër Beratit të sotëm, tjetri në krahinën kastrine të Tesprotisë. Leake asht i mendimit që qyteti në fjalë asht identik me qytetin Kestria dhe me Trojën, të cilën e përmend Stefan Bizantini në krahinën e Kestrisë[165]. Sipas gojdhanës, Kestria u themelua prej Kestrinit, djalit të Helenit nga Troja dhe Andromakës, të cilët i prue këtu Pirroja, i biri i Aqilit[166]. Heleni trashëgoi gjysmën e shtetit të Pirros që shtrihej pranë bregut të detit[167]. Stefan Byzantini përmend edhe një tjetër Ilion në Maqedoni "…."[169]. Bile Elimea, emnin e krahinës maqedone e nxjerr nga Heleni; si duket ky Trojan ka figurue edhe në gojdhanat e Maqedonisë.

Gojdhana nuk tregon vetëm që trojanët imigruen në Epir, ajo njef edhe kthimin e Pergamit, djalit të Andromakës dhe Pirros, në Azi të Vogël[170]. Edhe Virgjili tregimin e tij, përsa i përket takimit të Eneas me Helenin dhe Andromakën, e ka marrë nga gojdhana të

Shënimi[169]: Ndoshta ky Ilion është identik me Ilionin që përmend Livi, sepse Maqedonia romake nganjiherë shtrihej deri tek gjini i Vlonës. (Fq. 362)

vjetra, prandaj jemi të mendimit se të gjitha këto pika të përbashkëta që kanë gojdhanat e Epirit dhe të Trojës, do të kenë pasë një fakt historik. (Fq. 321)

Shënim B.P.: Fragmente nga Shënimet: (Fq. 333-335)

Nuk asht nevoja me sjellë prova që shumë emna popujsh të vjetër janë identikë me emnat e perëndive të tyre kombëtare. Jemi të mendimit, që edhe venetasit kanë pasë një perëndeshë kombëtare, që quhej Hënë, ose Hanë, gjurmat e të cilës i gjejmë tek romakët, që janë fis me ta. Zakonisht Ana Perenna[171] asht hyjnesha e vitit hanor të romakëve. Gojdhana thotë se ajo ka qenë e **bija e Belit,** e motra e Didos. Mbas vdekjes së saj, kur Jarba pushtoi Kartagon, u arratis në Maltë dhe prej këndej shkoi tek Enea, i cili e priti shumë mirë... **Shumë interesante asht lidhja e Anës me Enean,** i cili në krahinën e Latiumit asht për ne përfaqësuesi i një imigrimi pellazgo-tyrenas. Themeluesi i fisit të henetëve nuk mund të ishte Enea, sepse atë e kërkonte Roma për vete. Prandaj morën të kushëririn e tij, Antenorin, i cili këtu ndoshta asht përfaqësuesi i një imigrimi tyreno-pellazg-syrien[173], sepse Straboni shkruen kështu: " Disa të tjerë thonë se së bashku me Antenorin shpëtuan nga lufta trojane edhe disa henetas nga Paflagonia dhe mendimi aq i përhapun asht ky, që enetët kanë qenë ma i madhi fis i paflagonasve. Mbas pushtimit të Trojës ata shkuan në Traki dhe ma në fund, tue shetitë andej-këndej, zunë vend në Enetikën e sotme. Disa thonë se Antenori dhe i biri i tij muerrën pjesë në këtë udhëtim dhe u ngulën në skajin e Adriatikut", ma në fund "Antenori dhe djemtë e tij, bashkë me enetët që kishin teprue, shkuen në Traki dhe prej këndej u nisën për në Enetikën e Adriatikut[174]". Por Antenori dhe Enea kanë qenë dardanas dhe dardanasit e vjetër, që banonin në fushën e Kosovës në Mezinë e Sipërme, të cilët Grekët nuk i njifnin, mund të ndërmjetësonin marrëdhëniet nëpër tokë në mes të venetasve ilirë dhe dardanasve të Azisë së Vogël. Po të pranojmë që dardanët dhe henetët kanë imigrue së bashku dhe që në Azi të Vogël ishin fqinj, atëhere mund të spjegojmë shumë lehtë ekzistencën e zakoneve asyriane[175] tek

henetët e Adriatikut, pa dyshue aspak ndaj origjinës ilire të fisit. Sepse kultet e tyne tregojnë se janë pellazgë: ... (Fq. 322)

Shënim B.P.: Roma – themeluar në vitin 753 p.e.s. nga Pellazgët Trojanë.

Jerevani – kryeqytet i Armenisë, themeluar në vitin 782 p.e.s. nga Argishti I[të] (fillimisht quhej - Erebuni)

JANI VRETO

"Vepra të Zgjedhura"

Dihet gjithashtu se midis evropianëve, pellazgët kanë qenë të parët, që i muarrën shkronjat prej finikasve dhe prej pellazgëve i muarrë grekët aty nga fillimi i shekullit të gjashtëmbëdhjetë po para Krishtit, kur, siç është llogaritur, Kadmi, i biri i Agenorit, mbretit të Finikisë, i shoqëruar nga të tjerë, shkoi në Greqi për të kërkuar motrën e tij Evropa, që ia kishin rrëmbyer dhe shpuri atje, siç tregon historia, shkronjat.

Ja ç'thotë për shkronjat ati i historisë, Herodoti, në librin e V[të]: "Këta finikas, që shkuan së bashku me Kadmin në Greqi, midis të cilëve ishin edhe fyreasit, pasi u vendosën mirë e bukur në këtë vënd, u suallë dhe u mësuan gjëra të ndryshme grekëve dhe bile edhe shkronjat, të cilat nuk i kishin më parë grekët, nga sa di unë. Në fillim grekët përdornin të gjithë po ato shkronja që përdornin finikasit, por me kalimin e kohës, në përshtatje me gjuhën e tyre, ndryshuan edhe formën e shkronjave. Rreth e përqark atij vendi ku ndenji Kadmi me finikasit, në shumë pjesë banonin në atë kohë *Grekët që quheshin Jonë,* të cilët, pasi mësuan shkronjat prej finikasve i ndryshuan, ndonëse i përdorën në mënyrë të kufizuar. Këto shkronja Jonët i quajtën shkronja finikase, ashtu siç e kërkonte edhe e drejta, meqë finikasit i sollën të parët në Greqi. Dhe unë vetë kam parë shkronja kadmiane në tempullin e hirshëm të Apollon Ismeniasit në Tebe të

Beotisë, të skalisura mbi tre tripode. Këto shkronja ngjisnin shumë me ato të Jonëve"...

Por edhe [historiani] Diodor Liqelioti, në librin e II[të], 66, thotë: "Thuhet, pra, se midis elenëve, i pari që shpiku rytmat dhe meloditë ka qenë Linos-i, kurse Kadmi solli në Greqi shkronjat e quajtura finikase, të cilat elenët i ndryshuan e ua përshtatën dialekteve të tyre. Përgjithësisht këto shkronja u quajtën finikase nga që u sollën tek elenët prej Finikisë.

Por Diodori, duke thënë se shkronjat e sjellura i përdorën të parët pellazgët, duket sikur nuk pajtohet me Herodotin (shumë më i lashtë se ai) që thotë se midis fiseve elene, Jonët (që banonin në atë kohë në pjesët më të shumta të vendeve rreth e përqark finikasve të ardhur së bashku me Kadmin, midis të cilëve ishin dhe gjefireasit) i morën shkronjat prej këtyre të fundit me anë të mësimit. Kjo do të thotë se Jonët kanë qenë të parët që i muarrë shkronjat prej finikasve. *Por edhe Herodoti të gjithë elenët i quan pellazgë nga emri dhe pohon se gjithë Greqia quhej Pellazgji më parë*. Kështu në librin A (I) ai thotë: "Kresi (mbreti i Lidisë), duke gjurmuar historinë me anë pyetjesh e kërkimesh, gjente se (midis gjithë fiseve elene), shquheshin lekedemonasit dhe athinasit, të parët në krye te fisit dorian dhe të dytët në krye të fisit jonian. *Në kohët e vjetra jonët ishin pellazgë, kurse dorianët ishin komb elen. Pellazgët kurrë nuk kishin dalë jashtë vendit të tyre, kurse dorianët, përkundrazi, kanë qenë shumë të lëvizshëm.* Ata në kohën e mbretit Leukalion banonin në vendet Ftias kurse në kohën e elenit Doros, banonin rrëzë maleve të Osës dhe të Olimpit, në vendin e quajtur Estiea. Nga Estiea u dëbuan prej kadurianëve dhe u hodhën në Pind; në këtë kohë quheshin Makedonas. Prapë u ngritën së këtejmi dhe shkuan në Driopide dhe prej Driopidës në Peleponez, *ku u quajtën fis dorian*"…

Kadmi e shokët e tij finikas, që i sollën këto shkronja, llogaritet prej historianëve se erdhën në Greqi aty nga fillimi i shekullit të gjashtëmbëdhjetë para Krishtit. Por disa filologë të rinj evropianë të shekullit të shtatëmbëdhjetë të erës sonë thonë se para shekullit

të gjashtë e të shtatë para Krishtit elenët nuk kishin shkronja, sepse deri në atë kohë arrijnë mbishkrimet që kanë shpëtuar dhe sepse Homeri (që ishte shumë kurreshtar e që jetoi rreth vitit njëmijë ose nëndëqint para Krishtit, dhe që bën fjalë për shumë gjëra të kohës së vet, bile edhe për gjëra me vlerë shumë të vogël) për punë shkrimi nuk bën fjalë fare. Përsa u përket vjershave të Homerit, thonë se ato u transmetuan verbalisht gojë më gojë dhe se u ruajtën në kujtesë deri në shekullin e shtatë dhe të gjashtë para Krishtit, kur i solli prej Jonie Likurgu dhe Pisistrati i mblodhi dhe i bashkërenditi në dy libra, në Iliadën dhe në Odhisenë…

HOMERI

Iliada

Kënga e parë

Lufta e Bretkosave me minjtë

Botim i Argeta-LGM, Tiranë, 2002

Parathënie shkruar nga Naim Frashëri

Kopjuar siç është në tekstin original paraqitur në libër:

Omiri ka shkruarë dy vjersha të gjata: nga ato njëra tregon luftën e Troësë e thuhetë "Iliadhë", se qytet i Troësë quhej edhe Ilo, pa m'at emër' i thanë Iliadhë vjershës së saj. (Fq. 3)

Grekërit e vjetërë në kohët t'Omirit s'quheshinë as grekë as elinë, por dhanainj, ahainj, etj. Grekërit' e vjetërë nuk ishinë nga far' e pellasgjinjet, por ishinë, si thotë Thuqididi, të mbledhurë nga Finiku, nga Egjypta, etj.

(Shënim B.P. Këtu të shihet historia e Finiqit shqiptar – a ka lidhje me Fenikinë, Fenikasit)

Falmajeri thotë se edhe grekërit' e sotmë s'janë nga far' e grekëret të vjetërë, se far' e atyre është shuarë, po janë nga sllavërë, vlleh, etj. (Fq. 5)

Iliadha tregon, si thamë, Luftën e Troësë, a, si thoën ca, luftërat e bëra në mest të pellasgjinjet, se gjith' ata kombe ishin nga pellasgjinjtë, a, si thonë të tjerët, luftërat e Azisë me Evropënë ngaherë. Tri her' e kanë shpëtuarë nga Azia Evropënë shqipëtarët: Aqilehti mundi Troasitë, Aleksandr' i Madh persianëtë, Skënderbeu turqitë. (Fq. 6)

Ndërron pakë "Odhiseja" nga "Iliadha", prandaj kanë thënë se vjershëtor' i "Odhisjesë" është tjatër e i "Iliadhës" është tjatër, po të tjerë thonë që "Iliadhën" Omiri e ka bërë në djalëri e "Odhisjenë" në pleqëri, e nga vërsa ka ngjarë ndryshimi. Thonë se Omiri rronte njëmijë vjet përpara Krishtit dhe luft' e Troësë qe bërë dyqint vjet përpara Omirit.

Në kohët t'Omirit nuk kish shkronja gjuha greqishte, pastaj i pru Kadhmua shkronjatë nga Finiku, po Omiri në pleqëri is hi verbërë dhe shëndinte derë më derë, duke kënduara vjershat' e Iliadhës e t'Odhisesë; prandaj njerëzia e dininë së jashtësmi, e Likurgu, mbret i Spartësë, i mblodhi më pastaj. Edhe mëmëdheu i Omirit nuk dihetë mirë, po thonë më tepër se ish nga Smirna. (Fq. 6-7)

Afruar me gjuhën e sotme zyrtare:

Homeri ka shkruar dy vjersha të gjata: nga ato njëra tregon luftën e Trojës dhe titullohet "Iliada", *se qytet i Trojës quhej edhe Ilo,* prandaj sipas këtij emri e emërtuan këtë vjershë "Iliada". (Fq. 3)

Grekërit e vjetër në kohë të Homerit s'quheshin as grekë as helenë, por danaij, akej, etj. Grekërit e vjetër nuk ishin nga fara e pellasgëve, por ishin, siç thotë Thuqididi, të mbledhur nga Fenikia, nga Egjypti, etj.

(Shënim B.P. Këtu të shihet historia e Finiqit shqiptar – a ka lidhje me Fenikinë, Fenikasit)

Falmerajeri thotë se edhe grekërit e sotëm s'janë nga fara e grekërve të vjetër, se fara e atyre është shuar, po janë nga sllavët, vllehët, etj. (Fq. 5)

Iliada tregon, siç thamë, Luftën e Trojës, apo, siç thonë disa, luftërat e bëra në mes të pellasgëve, se gjithë ata kombe ishin nga

pellasgët, apo, siç thonë të tjerët, luftërat e përherëshme ndërmjet Azisë dhe Evropës. Tri herë e kanë shpëtuar nga Azia Evropën shqiptarët: Akileu mundi Trojanët, Aleksandri i Madh persianët, Skënderbeu turqit. (Fq. 6)

Ndërron pakë "Odhiseja" nga "Iliadha", prandaj kanë thënë se vjershëtori i "Odisesë" është tjetër dhe i "Iliadës" është tjetër, por të tjerë thonë që "Iliadën" Homeri e ka bërë në djalëri e "Odisenë" në pleqëri, e nga mosha ka ngjarë ndryshimi. Thonë se Homeri rronte njëmijë vjet përpara Krishtit dhe lufta e Trojës qe bërë dyqint vjet përpara Homerit.

Në kohët të Homerit gjuha greke nuk kish shkronja, pastaj i pru Kadmi shkronjat nga Finiku; por Homeri në pleqëri ish i verbër dhe shetiste derë më derë, duke kënduar vjershat e Iliadës e të Odisesë; prandaj njerëzia e dinin së jashtmi, dhe ishte Likurgu, mbret i Spartës, që i mblodhi më pas. Edhe mëmëdheu i Homerit nuk dihet mirë, po thonë më tepër se ish nga Smirna. (Fq. 6-7)

(Shënim B.P.: nxjerrë nga Wikipedia)

Likurgu ishte ligjvënësi pothuajse legjendar i Spartës, i cili zbatoi reformën me orientim ushtarak të shoqërisë Spartane në përputhje me Orakullin e Apollonit në Delfi. Të gjitha reformat e tij promovuan tre virtytet spartane: barazinë, aftësinë ushtarake dhe qëndrueshmërinë.

Lindur në Spartë, 800 BC

Vdekur 730 BC

STANISLAO MARCHIANO

"Studime filologjike zhvilluar me gjuhën Pellazgo-Albane"

Në mbështetje të mendimit tonë, abati Banier shkruan në Mitologjinë e tij si vijon: "Bochart dhe Vossio kanë provuar në mënyrë të sigurtë se alfabeti i sjellë nga Kadmi në Greqi ishte alfabet

fenikas, ndërsa ai që kanë përdorur grekët më përpara ishte alfabeti pellazg dhe nga këto dy gjuhë u formua një e vetme. (Fq. 20)

... Faktin që tezat tona bazohen në të vërtetën, e vërteton edhe historia e grekëve antikë dhe modernë, ku tregohet se në kohët e lashta, Heladha është quajtur Pelazgia, vendi antik, i cili, pas pushtimit nga Kadmi u pagëzua me emrin e ri të Heladhës. (Fq. 24-25-26)

Sipas dëshmive të Herodotit, historianit të madh të lartpërmendur, dy qytetet e famshme, Athina dhe Sparta, u themeluan dhe banoheshin nga pellazgo-albanët, nga gjuha e të cilëve morën edhe emrat. *Pas pushtimit nga Kadmi, Athina u bë fenikase, ndërsa trojet përreth mbetën pellazge dhe u quajtën "Joni".* ...Pra, lufta midis spartanëve dhe athinasve gabimisht quhet luftë civile apo luftë vëllavrasëse, lufta e një populli që flet të njëjtën gjuhë, që ka të njëjtën origjinë dhe të njëjtat tradita. Ishin popujt semitë, që duke pushtuar tokat e banuara nga popull japhet, kërkonin ta shkatërronin pjesën tjetër, ...(Fq. 28-29)

Pa asnjë diskutim, ne ua lemë historianëve dhe gjuhëtarëve të mëdhenj të drejtën për të gjykuar nëse grekët e racës fenikase mund të kenë të drejtën për t'u quajtur heraklidë ose milesë, pasi u hoqën emrin, atdheun, shkrimin apo alfabetin, shkencat dhe artet atyre popujve fatkeqë, por të lavdishëm albanë, të konsideruar përgjithësisht si qeniet më të padenja, të egra dhe barbare të botës. (Fq. 41)

Banorët e parë të Elladës, thotë Paskida *(Shënim B.P.: shkrim i vitit 1879, në Athinë, nga Th.A.Paskida – profesor dhe deputet helen),* janë pasardhësit e Japhetit ose Giapetit, të cilët quheshin ndryshe pellazgë apo fisi Japetonid sipas Pindarit, Hesiodit dhe vetë Homerit të pavdekshëm. Ata zbritën nga troje të Azisë, kryesisht nga Kaukazi, ku ekziston një zonë e gjerë e shtrirë e quajtur Albani dhe një kalim apo grykë e quajtur "porta albane" dhe emri Albania rrjedh nga emri "Alvi/Albi" ose "Alpi", që do të thotë "male të bardha", i cili është emri kombëtar i Albanëve. (Fq. 43)

... Mund të pohojmë me siguri se gjuha pellazge është folur në Europë shumë kohë përpara pushtimit fenikas dhe shumë kohë përpara

gjuhës greke, së cilës i huazoi shkronjat dhe tingujt, duke bërë kështu që ajo të pasurohej e të përhapej më shumë. Gjuha pellazgo-albane u quajt barbare sepse, sipas Kadmejve, çfarë nuk ishte greke, ishte barbare dhe barbarë u konsideruan pellazgo-albanët e varfër. (Fq. 44)

Është i pakundërshtueshëm fakti që pellazgo-albanët ishin banorët e parë të Maqedonisë, Epirit, Albanisë, Thesalisë, Beotisë, Atikës, Bosnjës, Hercegovinës, Bullgarisë, etj.. Mjafton të përmendim edhe dëshminë e Herodotit, sipas të cilit një numër i madh pellazgo-albanësh, pas pushtimit nga Kadmi, u shndrruan duke bërë pakt me fenikasit dhe që atëhere filloi dallimi midis dorëve dhe jonëve. (Fq. 79)

Tashmë pellazgët, siç e kemi përsëritur shpeshherë, janë popuj të grupit jafet, ndërsa kadmejtë ose fenikasit të grupit semit ose aramaik, pra, ata janë popuj të ndryshëm, të huaj nga njeri-tjetri. Nga bashkimi i pellazgëve apo popujve të vjetër (që ishin albanët) me kadmejtë apo fenikasit dolën athinasit, më pas helenët dhe pastaj grekët, që me të drejtë mund të konsiderohen si degë apo pasardhës të pellazgëve. Por as Bertolini, as shoqata e studiuesve të Historisë së përgjithshme të Italisë dhe as autorët e përmendur atje, si Niebur, Grote, Müller dhe Duncker, nuk janë përpjekur të qartësojnë terrin që ekziston rreth pellazgëve, për të përcaktuar se cilët ishin ata, cila ishte natyra dhe gjuha e tyre dhe sidomos për të treguar se cilit grup të njerëzimit i përkisnin. (Fq. 133)

Popujt jafetë të Kaukazit, të cilët, sipas nesh, janë thjesht pellazgo-albanë, ... (Fq. 136)

KARL GRIMBERG

"Historia botërore dhe qytetërimi"

Burimet Hitite përmendin në disa pjesë qytetin e Vilusas, ku mbretëronte Alaksandus dhe në vende të tjera qytetin Taroisa. Këta ndoshta janë dy emra të të njëjtit qytet, atij të Trojës, që Grekët e quajnë gjithashtu *Ilion.* (Fq. 250)

Babai i tij, Priami, ishte mbreti i Trojës, ose *Ilionit,* siç quhej ndryshe qyteti. (Fq. 254)

NERMIN VLORA FALASKI

"Pellazgët, Ilirët, Etruskët, Shqiptarët"

"Një numër fort i madh fjalësh të dialektit *Dorik,* nuk mund të shpjegohet me Greqishten, por shpjegohet me anë të ligjeve gjuhësore të Ilirishtes".

Një tjetër lajm interesant, që kemi prej Tuqididit, është se qyteti i Durrësit u themelua nga fiset Ilire të *Dorëve* më 626 para Krishtit afër qytetit të një fisi tjetër Ilir: Taulantët. (Fq. 280)

ARISTIDH P. KOLA

"Arvanitasit dhe prejardhja e grekëve"

Megjithatë, vetë Homeri zë në gojë si aleatë të trojanëve një popull të Trakës, që e quan Pellazg. Ç'bëhet? (Fq. 37)

Si është e mundur që të quhet Pellazgji: Peloponezi, Epiri dhe Tesalia, Dilo dhe Lesbo dhe gjithë Greqia; si është e mundur të quhen pellazgë të gjithë helenët e lashtë dhe në të njëjtën kohë të quajë pellazgë aleatët e Trojanëve, një popull të Trakës? (Fq. 38)

Pellazgët, siç do ta shohim më poshtë, u vendosën në një hapësirë që fillon me gadishullin Italian, kalon në Ballkan, në Azinë e Vogël dhe përfundon me bregdetin e Afrikës së Veriut. Shekuj pas vendosjes së tyre fillestare, është mjaft llogjike dhe e natyrshme, që gjuha e pellazgëve të Italisë me gjuhën e pellazgëve të Greqisë, të Trakës, të Azisë së Vogël, ose të Afrikës Veriore, të ketë pësuar dallime. (Fq. 40)

Elementët që iu hapën telashe kërkuesve të lashtë e të rinj janë:

1) ndryshimi i gjuhës, gjë që e përcaktoi edhe Herodoti,

2) zhdukja e emrit "pellazg" që nga koha e Homerit

dhe

3) mosekzistenca e një qytetërimi zyrtar pellazg (d.m.th. që të provojë ekzistencën e tij me shkrim, zbulime arkeologjike dhe metoda të tjera). (Fq. 41)

Grekët dhe *helenët* e morën këtë emër rreth shekujve VIII – VII p.e.s. dhe do të shohim në kapitullin përkatës se Homeri nuk i quan asnjëherë helenë apo vendin Hellas të ushtarëve që luftuan kundër Trojës.

Helenët dhe *Greqia* përmenden një ose dy herë nga Homeri si një vend i vogël në rrëzë të Pindit, ku dy gjërat më karakteristike janë se ndodhet nën pushtetin e Akilit dhe se ka gra të bukura. (Fq. 43)

Meqenëse gjuha pellazge ruhej akoma në kohën e Herodotit dhe u quajt barbare, e meqenëse vendet në të cilat u vendosën pellazgët nga Italia Qendrore deri në thellësitë e Azisë së Vogël, nuk paraqesin të njëjtin qytetërim dhe përveç toponimeve dhe emërtimeve të njëjta, që iu kanë nxjerrë telashe kaq kërkuesve, të cilët nuk i marrin parasysh pellazgët, të gjitha karakteristikat e tjera kanë pësuar kaq shumë ndryshime, saqë arrijnë të na krijojnë problem me faktin se përse pikërisht vetëm në Greqi pati një qytetërim të tillë të papërsëritshëm, do të na duhet të themi përsëri disa gjëra.

Për çështjen e parë, duhet të kuptojmë se populli pellazg, i cili para mijëra vjetësh bëri një fushatë të madhe emigruese dhe u ngul nga Italia deri në Azinë e Vogël dhe Afrikën Veriore, pati si rrjedhojë e mënyrës së jetesës e të veprimtarisë dhe qytetërimit të vet, një fjalor të kufizuar në fjalët që kishin të bënin me artin e luftës, gjuetisë, blegtorisë dhe bujqësisë. Kur u vendos në vende të reja, ishte e natyrshme që ai të zhvillonte rrethin

e tij të veprimtarive (tregti, detari, administratë, art, krijim të shkronjave dhe huazimi fjalësh nga popujt e Mesdheut me të cilët ra në kontakt). (Fq. 55)

Herodoti mendonte se gjuha nuk mund të ndryshojë me kalimin e kohës dhe ishte natyrore që helenët të flisnin gjuhën e tyre gjatë gjithë kohës, ndaj dhe rrjedhimisht u gjend në qorrsokak duke qenë se vetë helenët thonin se vinin nga pellazgët, ndërkohë që edhe ai vetë pa dhe dëgjoi popullsinë e Elispondit, Skilakit dhe Plakisë të flisnin pellazgjisht e të pohojnë se e kanë prejardhjen nga pellazgët, d.m.th. konstatoi se pellazgët për të cilët flisnin të gjithë, *nuk ishin helenë, por barbarë,* sepse ai vetë dëgjoi se si ata nuk flisnin helenisht, por një gjuhë të panjohur. (barbar nuk do të thotë vetëm i huaj, por edhe që shqipton gjuhën me gabime). (Fq. 57)

Kadmi është një hero ilir[8], ([8] – *në disa mite përmendet si mbiverior*) që duke ndjekur shembullin e shumë paraardhësve dhe pasardhësve të tij, (Jasoni, Dedaliu, Herkuli, Odisea, Pitagora, Demokriti, Anaksagora, Platoni, Herodoti) dhe përgjithësisht vetinë kryesore të fisit të tij, udhëtoi në vende të ndryshme si p.sh. në Mesopotami, Egjipt, Babiloni. Që të udhëtoje, në kohën për të cilën flasim, duhet të kishe të paktën dy karakteristika: heroizmin dhe etjen për dije.

Kadmi duke rënë në kontakt me civilizime të reja fitoi mjaft përvojë dhe dije. Kur u kthye në Bioti, ku u vendos për një kohë të gjatë, nuk u kthye vetëm për t'u bërë mbret i një populli të huaj. Erdhi me bashkëatdhetarët e tij, Haonët[9] ([9] – *popull pa prijës gjendet, por prijës pa popull është e pakuptimtë*) Ishte i ditur, por edhe reformist i madh, sepse u përpoq të ruajë dhe të përhapë një mënyrë të thjeshtë e të re të të shkruarit. (Fq. 62)

Jonët janë pellazgë që për njerën apo tjetrën arsye nuk arritën ta realizojnë vetveten ndaj vringëllimave dhe pasojave të luftës me Trojën dhe më pas ndaj dyndjes së fshatarëve pellazgë, që u quajtën *dorë.*

Në të vërtetë *dorët* u shpërndanë në të gjithë Peloponezin nga

ngushtica *Rio-Adiro,* duke pasur lidhje me Atikën, e cila vazhdoi në këtë mënyrë pa asnjë ndërprerje dhe plasaritje zhvillimin e saj politik. E njëjta gjë ndodhi edhe me pellazgët e Azisë së Vogël. (Fq. 72)

Dorët me sa duket janë fisi i fundit nga të ashtuquajturit helenë që zbritën në Greqi. (Fq. 75)

Tukididi thotë se 80 vjet pas pushtimit të Trojës "Dorët" erdhën në Peloponezin e Herkulit" (A13); (Fq. 77)

As historiani ynë i madh Kordati nuk merret fare me pellazgët dhe diku pyet veten mos edhe *pellazgët* janë edhe ata të prejardhjes *semite!* I punon mendja me pasion që të vërtetojë se *helenët erdhën nga Azia* (Azia e Vogël dhe Mesopotamia) dhe se ato që na rrëfejnë të lashtët janë përralla. (Fq. 85)

Faktet që parashtrojnë sa Kordati aq edhe Saqelariu për të theksuar lidhjen midis Greqisë dhe Azisë së Vogël, nuk vihen në dyshim. Në të vërtetë, Troja dhe trojanët, sa nga tregimet aq edhe nga gërmimet, vërtetohet se nuk është veçse i njëjti popull me *akejtë,* të cilëve iu deklaruan luftë. (Fq. 85)

Troja qëlloi të quhej edhe Ilio. Por Ilio do të thotë vend i lartë dhe me të vërtetë Troja ishte ndërtuar mbi dy kodra të larta dhe në rrëzë të kësaj ekzistonte një fushë e madhe. Ilida ose Ilia përsëri do të thotë i lartë, vend malor. Iliea quhej dhe gjykata e lartë e Athinës. (Fq. 91)

Në shqip ekziston dhe fjala "i lartë" apo " i lia" në arbërisht. (Fq. 92)

Më tej Kordati nuk beson as në zbritjen historike të dorëve dhe pohon se "Fillimisht, *dorët,* nuk është fare e vërtetuar se erdhën nga Ballkani i veriut (P.10, Fq. 277, shën.). Me sa duket në lidhje me përmbledhjen e tij i konsideron dhe dorët të ardhur nga juglindja dhe "zbritja e dorëve" nuk është veçse një "ngjitje". (Fq. 92)

Mendoj të paktën se për dorët dhe veçanërisht për vendin prej nga ku vijnë nuk ka asnjë dyshim se është Ballkani i Veriut. (Fq. 92)

Mirëpo dilemma e Kordatit, të cilën ai e përmend vetëm në një frazë të shënimit të tij, është pikërisht vendi i pathënë i prejardhjes

së dorëve: "*Dorët,* megjithëse erdhën të fundit në Greqi, dallojnë nga helenët e tjerë jo nga qytetërimi por nga shkalla e zhvillimit, duke u kujtuar për këtë qëllim helenëve të këtushëm, rregullat e trashëguara të jetës shoqërore dhe zakoneve të tyre të lashta.

Të gjitha këto ç'duan të thonë? Duan të thonë se dorët që erdhën këtu të fundit nga të gjithë helenët e tjerë nuk janë veçse pjesë e të njëjtit popull, që vonesa e tij qytetërore shpjegohet plotësisht, përderisa vijnë nga malet e Ilirisë, shumë shekuj pas zbritjes së bashkëatdhetarëve të tyre pellazgë. (Fq. 92 - 93)

Helenët, siç dihet, dhe sot kanë një emërtim tjetër. *Quhen grekë,* por edhe këtë emërtim na e tha më lart Aristoteli dhe ka qenë emërtimi i vjetër i helenëve. Këtë na e thonë e na sigurojnë dhe mbishkrimet e lashta në mermerët e famshëm të Parios.

E përmend gjithashtu Isiodi dhe poeti i shek. VII Alkamani: "Grekë të helenëve, nënat".

Por grekë do të thotë edhe njerëz të shkëmbinjve, pra arrijmë në përfundimet e mëparshme. (Fq. 98-99)

Le të shohim tani se si u formua emri *helen* dhe *hellas,* emër ky që shfaqet si emër i përbashkët i gjithë banorëve të Greqisë, pas zbritjes së dorëve. D.m.th. kur gjërat u qetësuan dhe u rivendosën marrëdhënie midis të gjitha fiseve Helene, u shfaq ky emërtim i përbashkët. Nuk ndodhi ajo që ndodhi në Iliri, por diçka tjetër.

"Hellas" – përmendet nga Homeri si një vend i vogël pranë Pindit dhe që karakteristika e tij më e veçantë ishte se kish gra të bukura ("Greqia grabukura"- siç e quan Homeri) dhe prijës i tij ishte një ndër heronjtë më të lavdishëm të luftës së Trojës, Akili. (Fq. 110)

Në të vërtetë, në kohën kur duhet të kenë ndodhur këto apo pak më vonë (fundi i shek. VIII p.e.s., fillimi i shek. VII p.e.s.) një poet, Alkamani thotë në një varg të tij: "Grekë, nënat e helenëve" (helenët quheshin grekë në lashtësi). Pra Alkamani nuk thotë "Grekë baballarët e helenëve", që do të ishte edhe më e natyrshme për një

shoqëri patriarkale, por përdor fjalën "nënat". (Fq. 111 - 112)

Zbritja e dytë pellazge në Greqi, që është zbritja e dorëve, d.m.th. e pellazgëve që për shekuj mbetën në mes të rrugës në Ilirinë jugore, ishte një ngjarje që shtyu për më vonë zhvillimin e tij kulturor. Jo vetëm ngaqë dorët ishin më të ashpër, bujq dhe disi më të vonuar, por sepse krijuan shqetësime me hyrjen e tyre në një kohë lufte dhe katastrofash. Nga ana tjetër ama ndihmuan, sepse risollën apo rivendosën ligjet e ndryshuara apo të braktisura pellazge, gjë që ishte një forcë kundër ndikimeve orientale dhe të huaja dhe që u vlerësuan shumë nga grekët e tjerë. Me zbritjen e dorëve kemi një bashkim të konservatorizmit (dorët) me progresivitetin (jonët). (Fq. 112)

SHTESË: Teoria pellazge që zhvillova, të çon në përfundimet e mëposhtme:

Fisi heleno-pellazg u shpëtua midis shekujsh dhe mijëvjeçarësh, falë mundësisë së pafundme të rezervave që pozicioni gjeografik dhe morfologjia e terrenit i siguroi. Dmth. burimi më i madh i popullit tonë ndodhej në malet shkëmbore të Epirit dhe Shqipërisë së sotme dhe prej andej, si lumenj grupesh popullore, kohë pak kohe zbriste në Greqi, Itali dhe Azi të Vogël. Në këto vende, si shkak i kushteve pakrahasimisht më të mira, zhvillohej qytetërimi i saj dhe u ndryshua nga njëri vend në tjetrin sipas kushteve ekzistuese. Në çdo rast që popullsia në zonat e reja dobësohej për çfarëdo arsye, kishim zbritje dinamike grupore nga origjina. Zbritja e fundit është ajo e arbëreshëve të shekullit XIV. Tjetër nuk do të ketë... (Fq. 119)

Të keni parasysh se në greqisht mungon tingulli "y", i cili kthehet në "i", "sh" që kthehet në "s", dhe "ë" që kthehet ne "e". Gjithashtu "d" shqipe, në greqishten e lashtë (homerike) ka kaluar në "dh". (Shënim i përkthyesit) (Fq. 171)

(Shënim B. P.: Kjo vlen edhe për arsyetimin e bërë për shndrrimin e "Tushpa" në "Tuspa" në kapitullin:"Interpretimi Geg-Tosk")

LUFTULLA PEZA, LILJANA PEZA:

"Gjuhët e Lashta të Ballkanit dhe Anadollit dhe familja Pellazgjike e gjuhëve"

Emri Grekë dhe Greqi ka dalë shumë vonë, që u fut nga Romakët gjatë kohës së Perandorisë Bizantine. Shteti i quajtur Greqi për herë të parë u ngrit me revolucionin Arvanit në vitin 1821 dhe fitimin e pavarësisë nga Turqia. (fq. 126)

Emërtimi "Dhrahmi" i parasë Maqedonase është i njëjtë si ai i popujve të tjerë të lashtë të Ballkanit, që kanë përdorur dhrahminë si para. (fq. 129)

Shënim B.P.: Po kështu emërtohet edhe paraja Armene "դրամ" e që lexohet "dram, tram".

Fiset Greke kur erdhën nuk kishin as emër. (fq. 146)

Emërtimi "Grekë" nuk ka ekzistuar në lashtësi; ai për herë të parë është futur në përdorim nga Romakët dhe është përdorur gjatë Perandorisë Bizantine. Ndërsa shteti me emrin "Greqi" u shpall pas revolucionit Arvanit më 1821 dhe mbreti i parë i vendit ka qenë Oto nga Bavaria. (fq. 160)

Nga ana tjetër në enciklopeditë botërore shkruhet se në epikat e Homerit Grekët apo Helenët asnjëherë nuk përmenden, sepse Omeri ata nuk i njihte. Kjo të çon në përfundimin se epikat e Omerit janë shkruar në gjuhën Pellazge. (fq. 161)

Gjatë kohës, që rajoni jugor i Ballkanit ishte i pushtuar nga Persianët, erdhën në rajon edhe fiset Greke, të cilat erdhën nga lindja, por nuk kishin as emër dhe asnjë nivel kulturor, ... (Shih fq. 224)

MOISI DASKHURANCI OSE MOISI KAGHANKATVACI

"Historia e Albanëve të Kaukazit"

Prej këtyre fëmijëve të Xhafetit, pasardhës të Kituraçikut (Kitrit), lëvizën dhe u shpërndanë nëpër ishujt paganë, siç ishin ato të Qipros, dhe prej atyre që mbetën në veri dhe që ishin të afërm (kushërinj) të Kituraçikut, dolën pasardhësit e Albanëve (Aluank). *Ndërsa raca që populloi tokën e Hellas rrjedh prej atyre që më pas migroi atje, siç ishin Ajetaçikët, që u dyndën në Athinë, duke ardhur nga Grekët e nderuar (Yoynk - Hjunk).* Dhe nga Teba emigruan Sidonianët, të cilët rridhnin nga Kadmosi, që ishte djali i Agenorit. Kartagjenasit janë imigrantë prej Tirit. (Fq. 16)

Ndër kombet që kanë pasë njohur artin e të shkruarit kanë qenë Hebrenjtë, Latinët, prej të cilëve Romanët kanë pasë qenë qeverisur, Spaniardët *(banorët e Spanjës: Shënim BP),* Grekët, Medët, Armenët, Albanët. Nga Media, në drejtim të veriut deri në kufijtë e Gadironit (Kadiz), duke u shtrirë nga lumi Pargamitos deri tek ai Mastosis, *ky vend që quhet Ilion;* dhe në Ishujt e Siçilisë, Eubesë, Rodesë, Kios, Zakinthis, Kefalonia, Itaka, Kerkira (Korfu), Kisadës (Kisadis), dhe *pjesa e Azisë e quajtur Ionia;* dhe lumi Tigri që rrjedh ndërmjet Medias dhe Babilonisë. Këta janë kufijtë e (familjes së) Xhafetit. (Fq. 17)

Qyteti - ILION

Kreu 18. Në librat e Stefanosit ka për t'u gjendur një tregim mbi shkatërrimin e qytetit Ilion dhe ndërtimin e Romës

Në ditët e Gjykatësit Abdan, *qyteti Ilion* u mor si më poshtë. Ky qytet ishte në vendin e Akenëve (Achaeans – Akejtë ??) ngjitur me Peloponezin në perëndim të Maqedonisë në vendin e Evropës. Në atë kohë Greqia nuk kishte mbret, i gjithë vendi drejtohej nga princat. *Ilioni* ishte një qytet i madh dhe nuk kishte të ngjashëm me të në tokë. Në atë kohë një djalosh i ri nga princat e qytetit shkoi

në qytetin e Thesalonikës, në lindje të Maqedonisë, në kërkim të argëtimeve dhe u prit nga fisnikët e qytetit. Duke u dashuruar me vajzën e një njeriu të madh, ai e rrëmbeu atë dhe e solli në qytetin Ilion. Kur prindërit e saj filluan kërkimet për të, ata morën vesh se ajo ishte marrë nga i riu dhe duke i shkruar një letër popullit të Ilionit, ata morën një përgjigje arrogante. Ai (babai) e lexoi atë me zë të lartë për popullin e tij dhe të etur për hakmarrje, ata thirrën të gjithë popujt fqinjë për t'i ndihmuar ata. Ata krijuan një ushtri të panumërt dhe luftuan me Ilionin për pesëmbëdhjetë vjet, duke e hedhur të gjithë vendin në shkatërrim. Pastaj, duke menduar për një plan tjetër, ata dërguan një mesazh pajtues për qytetarët e vet duke thënë: "Të mëdhenj janë perënditë e Ilionit, dhe është për shkak të tyre, që forca jonë ka dështuar. Ne do të bëjmë paqe dhe tani e tutje do të jemi miq, dhe ne do t'i nderojmë perënditë e Ilionit me dhurata." Ata iu besuan këtyre fjalëve dhe (Grekët) ndërtuan 2 000 kuaj prej druri bosh nga brenda dhe vendosën brenda tyre 40 000 luftëtarë; duke i veshur kuajt me ar dhe argjend, ata i vendosën mbi karroca dhe i tërhoqën dhuratat shkatërruese për në portën e qytetit, ku lajmëtari shpalli me zë të lartë: "Këto janë dhurata për zotat e Ilionit!" Kuajt ishin 9 kubitë të lartë dhe dhe duke qenë se nuk ishte e mundur të kalonin nëpërmjet portës së qytetit, ata shkatërruan një pjesë të murit. Dhe në kohën e caktuar për daljen e tyre jashtë, ata morën në zotërim të çarën e murit, dhe nëpërmjet saj një mori ushtarësh hynë brenda dhe i gjithë qyteti, përfshirë pleqtë dhe fëmijët, u vunë nën shpatë. Duke marrë gratë si robinja, ata hypën përsëri në anijet e tyre për t'u kthyer në vendin e tyre në Azi, por një erë e dhunshme shpërtheu nga lindja dhe i çvendosi anijet e tyre 2 500 milje larg kursit dhe i hodhi në një vend të huaj të quajtur Itali. Ata synonin të lundronin përsëri për në vendin e tyre, por gratë e marra rob, që të mos bëheshin skllave, në mes të natës i vunë zjarr anijeve dhe të gjitha anijet u dogjën. Kur njerëzit panë atë që kishte ndodhur, ata qëndruan kundër vullnetit të tyre në atë vend dhe u martuan me gratë robinja. Pasi kishte kaluar një kohë e gjatë, një

udhëheqës të cilin e kishin caktuar nga gjiri i tyre, njëfarë Romulus (Hromelos), ndërtoi një qytet me emrin e vet - Romë (Hrom) - 25 milje larg nga deti. Këta formuan kombin Romak. Kjo ndodhi 441 vjet pas pushtimit të Ilionit, dhe kur erdhi viti i dyzetë e katërt (44), Filipi u ul si mbret në Romë. Ishte 1 000 vjet pas ndërtimit të Romës koha kur Konstantini e transferoi (fronin e) mbretërisë nga andej në Bizant, i cili tani quhet Konstantinopojë. (Fq. 242)

GAREGIN NALBANDIAN

"Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit"

Babilonia është një variant Grek për emrin Babel. Babeli ka qenë quajtur, gjithashtu, Babili (El ose Eli nënkupton Zot dhe Bab-Ili ose Bab-Eli nënkupton Porta e Zotit në gjuhën Babilonase) dhe konsiderohej të ishte qendra e Tokës; … (Fq. 57)

Sipas një tjetër legjende, Paflagoni ishte djali i Feneçit, dhe kur Paflagoni dëgjoi se si e vrau Nimrodi Feneçin në Babiloni, ai mbajti zi për vdekjen e babait. Paflagoni ishte i qartë për pamundësinë e tij për të vrarë Nimrodin, gjë që kishte krijuar tek fisnikët Fenikas idenë e Paflagonit si një mbret të dobët. Fisnikët Fenikas ngritën krye kundër Paflagonit dhe i kërkuan Nimrodit të ishte mbret i tyre. Paflagoni mori familjen e tij dhe njerëzit që ishin besnikë të tij dhe e lanë Tirin. Ata gjetën strehë tek mbretëria e stërgjyshit të tij (Mbretëria e Rifatit). Kështu, Paflagoni mbeti mbret i Paflagonias dhe Rifati u njoh si paraardhës i Paflagonianëve. (Fq. 83)

Pak pasi kishte pushtuar tokat e pasardhësve të Tubalit, Nimrodi u dha atyre rastin që të dorëzoheshin; sidoqoftë, ata vendosën të hipin nëpër anije dhe të ikin larg prej andej, në vende përtej detit. Gauli dhe pasardhësit e tij, gjithashtu, ja lanë tokat e tyre Nimrodit, pasi kishin humbur disa beteja, dhe edhe ata lundruan larg drejt perëndimit, dhe ata që nuk mundën të hipnin nëpër anije, u përpoqën

të shpëtojnë duke gjetur strehim në tokat e Thrakasve (Azia e Vogël) dhe u njohën si Galatianë apo Keltë. (Fq. 84 - 85)

Shënim B.P.: Shënim informues nxjerrë nga Wikipedia:

[Tubal (hebraisht: תובל ose לבת [tu'val]), te Zanafilla 10 ("Tabela e Kombeve"), ishte emri i një djali të Xhafetit, birit të Noes.

Studimet moderne kanë identifikuar Tubalin biblik me Tabalin, një shtet dhe rajon Anatolik i përmendur në burimet Asiriane.

Tabali ishte një shtet Luvian i periudhës pas-Hittit, në Azinë e Vogël në mijëvjeçarin e parë para Krishtit. Fqinjët e tij, Mushki, janë tradicionalisht të lidhur me Mesheçin.

Shumica e librave referues, duke ndjekur Flavius Josephus, e identifikojnë Tubalin në kohën e Ezekielit si një zonë që tani ndodhet brenda Turqisë.]

Kadmos ose Cadmus, djali i Aramaneakut dhe nipi i Hajkut, ka qenë njohur, gjithashtu, si Kadman në disa shënime. Prej Kadmosit rrodhën fisnikët Kadmeanë, të cilët jetuan në jug të liqenit Van. Kadmosi ndërtoi Korçajkun si vendqëndrim të tij. *Hajku kurorëzoi nipin e tij, Kadmosin, si mbret të Fenikias,* pasi që nga momenti që Feneçi kishte vdekur në mënyrë të mistershme, tokat i kishin kaluar në administrim Nimrodit, dhe pas vrasjes së këtij të fundit nga Hajku, Fenikasit kishin nevojë për një mbret të ri; kështu *Kadmosi u bë mbreti Fenikasve në momentin që Hajku u bë mbret i mbretërisë së Nimrodit.* (Fq. 145)

NXJERRË NGA WIKIPEDIA

Emri i Greqisë ndryshon në Greqisht krahasuar me emrat e përdorur për vendin në gjuhë dhe kultura të tjera, ashtu si emrat e Grekëve. Emri antik dhe modern i vendit është Hellas ose Hellada (Greqisht: Ελλάς, Ελλάδα), dhe emri i tij zyrtar është Republika

Helenike, "Helliniki Dimokratia" (Ελληνική Δημοκρατία). Në anglisht, megjithatë, vendi zakonisht quhet Greqi, që vjen nga latinishtja Graecia (siç përdorej nga Romakët) dhe fjalë për fjalë do të thotë "toka e Grekëve".

Emri anglisht "Greqi" dhe përshtatjet e ngjashme në gjuhë të tjera rrjedhin nga emri latin "Graekia" (greqisht: Γραικία), që do të thotë fjalë për fjalë "toka e Grekëve", e cila u përdor nga Romakët e Lashtë për të treguar zonën e Greqisë së sotme. Në mënyrë të ngjashme, emri latin i kombit ishte Graeki, i cili është edhe origjina e emrit anglez "Grekët".

Aristoteli (384 - 322) ishte i pari që përdori emrin Graeci (Γραικοί), në "Meteorologjinë" e tij. Ai shkroi se zona përreth Dodonës dhe lumit Achelous ishte e banuar nga Selli dhe një popull, të cilët ishin quajtur Graeci, por u quajtën Helenë nga koha e tij.

Nga kjo thënie, pohohet se emri i Graeci-it dikur ishte përdorur gjerësisht në Epir dhe në pjesën tjetër të bregdetit perëndimor të Greqisë. Kështu u bë emri me të cilin helenët ishin të njohur për popujt italikë, të cilët ishin në anën e kundërt të detit Jon.

Përveç gjykatës, administratës dhe ushtrisë Perandorake, gjuha kryesore e përdorur në provincat Romake lindore edhe para rënies së Perandorisë Perëndimore ishte Greqishtja, që flitej në rajon për shekuj me radhë përpara Latinishtes.

Në fillim të shekullit të 5-të, Greqishtja fitoi status të barabartë me Latinishten si gjuhë zyrtare në Lindje dhe perandorët gradualisht filluan të ligjërojnë më tepër në Greqisht sesa në Latinisht duke filluar me mbretërimin e Leo I Thrakianit (Thrakasit) në vitet 460.

Përdorimi i latinishtes si gjuhë e administrimit vazhdoi deri në miratimin e greqishtes si gjuha e vetme zyrtare nga Herakliu në shekullin VII.

Duke trajtuar *Dodonën, Herodoti* shton:

Por mendimi im në lidhje me këtë tregim është ky. Nëse fenikasit

në fakt morën me vete gratë e shenjta dhe shitën një në Libi dhe një në Hellas, atëherë, për mendimin tim, vendi ku kjo grua ishte shitur në atë që tani është Hellas, por që më parë quhej Pellazgji, ishte Thesprotia; dhe pastaj, duke qenë një skllave atje, ajo krijoi një faltore të Zeusit nën një lis që po rritej atje; sepse ishte e arsyeshme që, pasi ajo kishte qenë një shërbëtore e tempullit të Zeusit në Tebë, ajo do të kujtonte atë tempull në vendin në të cilin kishte ardhur. Pas kësaj, posa që arriti ta kuptojë gjuhën greke, ajo filloi të ushtrojë parathënien e fatit; dhe ajo tha se motra e saj ishte shitur në Libi nga të njëjtët fenikas që e shitën atë.

Unë hamendësoj që, këto gra u quajtën "pëllumba" nga njerëzit e Dodonës sepse ato flisnin një gjuhë të çuditshme dhe njerëzve iu duk si britmat e zogjve; atëherë gruaja foli atë që ata mund të kuptonin dhe kjo është arsyeja pse ata thonë se pëllumbi foli në gjuhën e njerëzve; për sa kohë që ajo fliste në një gjuhë të huaj, ata menduan se zëri i saj ishte si zëri i një zogu. Sepse si mund një pëllumb të shqiptojë fjalët e njerëzve? Përralla se pëllumbi ishte i zi tregon se gruaja ishte egjiptiane.

Thesprotia, në bregun perëndimor të Dodonës, do të ketë qenë vend i përshtatshëm qëndrimi për detarët Fenikas, për të cilët lexuesit e Herodotit nuk do ta kishin çuar ndërmend, që ata të mund të kishin depërtuar deri në brendësi të Dodonës.

Sipas *Strabonit,* orakulli u themelua nga Pellazgët:

Ky orakull, sipas Eforit, u themelua nga Pellazgët. Dhe Pellazgët quhen më të hershmit nga të gjithë popujt që kanë mbajtur sundimin në Greqi.

Pindari gjithashtu e raporton si të pasigurt historinë që paraardhësi i orakullit të Dodonës ishte vendosur në Thesali.

... tempulli [orakulli] u transferua nga Thesalia, nga pjesa e Pellazgisë që ka të bëjë me Scotussa (dhe Scotussa bën pjesë në territorin e quajtur Thesalia Pelasgiotis), dhe se, gjithashtu, shumica e grave, pasardhëset e të cilave janë profetesha të sotme, shkuan së

bashku në të njëjtën kohë me të; dhe është nga ky fakt që Zeusi u quajt gjithashtu "Pellazgjik".

Jonët (/ aɪˈoʊniənz /; Greqisht: Ἴωνες, Íōnes, njëjës Ἴων, Íōn) ishin një nga katër fiset kryesore, sipas të cilëve Grekët e konsideronin veten të ndarë në periudhën antike; tre të tjerët janë *Dorianët,* Eolianët dhe Akejtë. Dialekti Jon ishte një nga tre ndarjet kryesore gjuhësore të botës Helene, së bashku me dialektet Doriane dhe Eoliane.

Miti i themelimit, i cili ishte aktual në periudhën Klasike, sugjeroi që Jonët u emëruan sipas Jon, birit të Xuthus, i cili jetonte në rajonin verior të Peloponezit të Aigialeia. *Kur Dorianët pushtuan Peloponezin ata dëbuan Akeasit nga Argolidi dhe Lakedaemonia.* Akejtë e zhvendosur u zhvendosën në Aigialeia (më pas e njohur si Akaea), duke dëbuar Jonët nga Aigialeia. Jonët u transferuan në Atikë dhe u bashkuan me popullsinë lokale të Atikës, dhe shumë më vonë emigruan në bregdetin e Azisë së Vogël duke themeluar rajonin historik të Jonisë.

...

Jonia (/ aɪˈoʊniə /; Greqishtja e lashtë: Ἰονία /i.ɔː.ní.aː/, Iōnía ose Ἰωνίη, Iōníē) ishte një rajon antik në pjesën qendrore të bregdetit perëndimor të Anadollit në Turqinë e sotme, rajoni më i afërt i Izmirit, e cila ishte historikisht Smirna. Ajo përbëhej nga territoret më veriore të Lidhjes Jonike të vendbanimeve Greke. Asnjëherë një shtet i unifikuar, ajo e mori këtë emër sipas fisit Jon, që në Periudhën Arkaike (600–480 p.e.s.) popullonte kryesisht brigjet dhe ishujt e Detit Egje. Shtetet e Jonit tradicionalisht u konsideruan si pjesë e Greqisë Lindore.

Në të vërtetë, Jonia përbënte një brez të ngushtë bregdetar nga Phocaea në veri pranë grykës së lumit Hermus (tani Gediz), deri në Mileti në jug pranë grykës së lumit Maeander dhe përfshinte ishujt Chios dhe Samos. Kufizohej nga Egolia në veri, Lidia në lindje dhe Caria në jug. Qytetet brenda rajonit për një kohë të gjatë ishin objekt i grindjeve të mëdha midis Perandorisë Persiane dhe Grekëve.

Sipas traditës greke, qytetet e Jonisë u themeluan nga kolonistë nga ana tjetër e Egjeut. Vendosja e tyre ishte e lidhur me historinë legjendare të popullit Jon në Atikë, e cila pohon se kolonistët drejtoheshin nga Neleus dhe Androclus, bijtë e Codrus, mbreti i fundit i Athinës. Në përputhje me këtë pikëpamje "migrimi Jon", siç quhej nga kronologët e mëvonshëm, datohej prej tyre njëqind e dyzet vjet pas Luftës së Trojës, ose gjashtëdhjetë vjet pas kthimit të Heracleidaes në Peloponez.

BERZH PIRANJANI

(Interpretime)

Kur përpiqesh të mësosh mbi prejardhjen e emrit Grek - Helen, është e natyrshme që përpara teje të dalin një sërë pikëpyetjesh:

1. Kur del për herë të parë në skenën e historisë Greke, Ballkanike dhe atë Europiane emri "Grekë", në ç'formë dhe nga goja e kujt? Kujt populli i mbivihet? (nga Homeri, shek. 9të p.e.s.)

   (Më pas shfaqet tek vepra "Metereologjia" e Aristotelit (384 - 322 p.e.s.) dhe futet në përdorim normal në kohën e Perandorisë Romake.)

2. Në ç'datë është vendosur Greqishtja si gjuhë zyrtare e Perandorisë Bizantine? (u pranua si gjuhë zyrtare krahas latinishtes në fillim të viteve 400 dhe u vendos si gjuhë e vetme zyrtare e Perandorisë Bizantine në viti 610, nga Heraclius, perandor i Bizantit)

3. A ka mundësi të kenë ndonjë lidhje fjalët "Grekë" dhe "Gegë" ?

4. Kur del në skenën e historisë Greke, Ballkanike dhe atë Europiane emri "Helen", në ç'formë dhe nga goja e kujt? Kujt populli i mbivihet? (nga Homeri, shek. 9të p.e.s.)

5. Kur del për herë të parë në skenën e historisë Greke, Ballkanike dhe atë Europiane emri "Pellazg", në ç'formë dhe nga goja e kujt? Kujt populli i mbivihet? (nga Homeri, shek. 9të p.e.s.)

6. Kur del për herë të parë në skenën e historisë Greke emri "Jonët", në ç'formë dhe nga goja e kujt? Kujt populli i mbivihet? (nga Herodoti, 484 – 425 p.e.s.)

7. Kur del për herë të parë në skenën e historisë Greke emri "Dorët", në ç'formë dhe nga goja e kujt? Kujt populli i mbivihet? (nga Herodoti, 484 – 425 p.e.s.)
8. Nga erdhën dhe kur u shfaqën dorët në Greqi? (shih A. Kola, Arvanitasit dhe prejardhja e Grekëve, Fq. 75)
9. Të shihet lidhja kohore: Pellazgët – Jonët - Dorët – Grekët (shih A. Kola, Arvanitasit dhe prejardhja e Grekëve, Fq. 75)
10. Në çfarë gjuhe ka arritur vepra e Homerit tek ne? (Iliada dhe Odisea janë shkruar në gjuhën Homerike, që quhet gjuha e lashtë Greke dhe që është një përzierje e dialekteve të fiseve që banonin asokohe në tokat e Greqisë së sotme. Është përdorur në shek. 9-6 p.e.s.)

Shënim B.P.: Pyetjeve të mësipërme u është bashkëngjitur një përgjigje e shkurtër e vendosur brenda kllapave, përgjigje që rezulton si rezultat i sa më poshtë po shtjellojmë:

Shtjellim Interpretimi

Përpara se të arrish në ndonjë përfundim, pasi ke lexuar materiale të ndryshme lidhur sqarimin e pikëpyetjeve ngritur më sipër, është mirë të mbahet në qendër të vëmendjes fakti që, kombet dhe shtetet e ndryshme, në formën që janë sot, kanë arritur pas një rrugëtimi të gjatë nëpër kohën e historisë njerëzore. Rrugëtim, gjatë të cilit kanë ndodhur ngjarje të rëndësishme për jetën njerëzore: lindje dhe vdekje fisesh e kombesh, bashkime dhe ndarje fisesh apo kombesh, një luftë për ekzistencë ndërmjet grupeve njerëzore, të cilat ku me dhunë e ku me diplomaci ja arritën të mbijetojnë deri në ditët e sotme në formën, që ne i njohim.

Në kohën e sotme, jo të gjitha shtetet kanë në përbërje të tyre kombe apo fise të origjinës, kombe apo fise të cilat historia i përmend si populluese të atyre zonave në kohëra të hershme; po ashtu jo të gjitha kombet, që njihen sot, janë prodhim i një fisi të origjinës, por sot paraqiten si një unitet kombëtar i realizuar nga një bashkim fisesh të afërta ose jo në paraardhësi'.

Duke pasur parasysh sa më sipër, bazuar edhe mbi përpjekjet sqaruese të studjuesve të shumtë, të cilët janë marrë me këtë çështje, po përpiqem të hamendësoj se çfarë rruge ka ndjekur formimi i atij grupimi njerëzor, që nga të huajt sot quhet kombi "Grek" dhe që vetë qytetarët grekë e quajnë kombi "Helen"; të njëjtën gjë do të thosha edhe për atë që nga të huajt sot quhet shteti "Grek" dhe që vetë qytetarët grekë e quajnë shteti "Helen".

Dikush mund të pyesë: "po ç'punë ke ti se si e quajnë veten e tyre qytetarët e shtetit Grek, apo se si cilësohen ata nga të tjerët?"

Praktikisht - asnjë punë – do përgjigjesha unë.

Por në momentin kur populli shqiptar e kërkon origjinën e vet në popullsinë e ashtuquajtur "Pellazge", që popullonte në lashtësi këtë pjesë të Ballkanit, e cila banohet sot nga popullsi shqiptare, në momentin që lexon dhe mëson se Homeri e cilëson luftën e Trojës si një përleshje mes dy fisesh të afërta midis tyre për nga prejardhja, të cilat ai i konsideron fise "pellazgjike", në momentin që mëson se njeri nga këto fise ndërluftuese në atë kohë popullonte krahinat, që sot shfaqen si pjesë përbërëse të shtetit Grek, ndërsa fisi tjetër popullonte brigjet perëndimore të Anatolisë, sot pjesë përbërëse të shtetit Turk, atëhere detyrimisht përfshihesh në grupin e kureshtarëve, të atyre që duan të dinë diçka më tepër mbi të ashtuquajturin grupim pellazgjik, shtrirjen dhe përbërjen e tij. Dhe këtu, pa dyshim, të lind pyetja: sa afër janë ndërmjet tyre këto grupe popullsie, që sot aktualisht popullojnë Shqipërinë dhe Greqinë; sa e largët apo sa e afërt është farefisnia ndërmjet tyre, n.q.s. hamendësohet, për aq njohuri sa ofrojnë sot shkencat historike dhe gjuhësore, se në të kaluarën jo fort të largët e gjithë kjo zonë banohej nga i njëjti fis i madh, i quajtur fisi "pellazgjik".

Dhe, kur përpiqesh të thellohesh në historinë pellazgjike të Greqisë së lashtë, detyrimisht të dalin përpara emrat dhe bëmat e fiseve mbizotëruese, që mendohet se e përbënin atë: jonët, dorët, eolianët, akejtë; mbi to duket sikur lundrojnë me kohën dy emërtime:

"Grek" dhe Helen", të cilët shfaqen zbehtë për herë të parë tek Homeri, për të marrë më pas një ngjyrim më të dallueshëm tek Herodoti dhe për t'u shfaqur në tërë forcën e vet në ditët e sotme.

Po e filloj hamendësimin tim me mënyrën e formimit të qytetit Ilion ose Troja.

Së pari, dëshiroj të vë në dukje dy pranime, që më rezultojnë nga leximi i materialeve të mësipërme:

1. Lufta e Trojës ishte një luftë ndërmjet fiseve të të njëjtit grup, atij *pellazgjik*
2. *Troja* dhe *Ilioni* janë dy emërtime për të njëjtin qytet, duke i pranuar të njëkohshëm me kohën në të cilën u zhvillua lufta e Trojës.

Fillimisht po hamendësoj origjinën e emrit *"Ilion"*:

Edhe këtu pranoj mundësinë, që një nga prijësit (i quajtur *Ion* apo *Jon*) e fisit të ngulur në këtë vend t'i ketë dhënë banorëve dhe vendit emrin e tij, apo fqinjët përreth t'i kenë krijuar këto emërtime për ta, siç rezulton e zakonshme për qytetet e krijuara në kohët e hershme. Pra, qytetit emrin Ion dhe banorëve emrin Ionët.

Shënim B.P.: Shndrrimi i germës *I* në *J* dhe anasjelltas janë rezultat i zhvillimeve gjuhësore të mëvonshme, prandaj për ta thjeshtuar problemin, tani e tutje do përdor vetëm trajtën me *I*.

Mendoj se Ioni dhe fisi i tij kanë qenë një ndër ato fise Anatolike pellazgjike, që, ashtu si edhe shumë nga farefisët e tyre pellazgjikë, për shkak të grindjeve mes tyre dhe në kërkim të vendeve më të begata për të jetuar, ndërmorën rrugën e emigrimit për në zonat perëndimore të Anatolisë. Në këtë rrugëtim, ata arritën në bregun perëndimor të Anatolisë, ku fillimisht krijuan ngulimet e reja, me kryeqendër Ilionin dhe më pas vazhduan të shtrihen edhe në toka të reja në bregun përballë deri sa arritën në anën tjetër të gadishullit, ku, duke themeluar një koloni bregdetare Ionike, të ngjshme me

atë Anatolike, i dhanë edhe detit, përgjatë të cilit u ngulitën, emrin Deti Ion.

Gjithashtu, mendoj, se shtrirja e tyre edhe në Gadishullin Ballkanik fillimisht ndoqi rrugën tokësore nëpërmjet ngushticave, të cilat lidhin brigjet e gadishullit Anatolik dhe atij Ballkanik (p.sh. ngushtica e Bosforit sot, apo brigjet e Dardaneleve; kjo e dyta duket më afër arsyetimit që po bëjmë). Gjithë sa arsyetojmë më sipër është në vazhdën e idesë së një çvendosjeje të hershme të mundshme pellazgjike, që i korrespondon fundit të mijëvjeçarit të tretë dhe fillimit të mijëvjeçarit të dytë para Krishtit, nga tokat në lindje të gadishullit Anatolik në drejtim të perëndimit të gadishullit Anatolik dhe më pas, akoma më tej në drejtim të perëndimit, përtej gadishullit Anatolik në kërkim të tokave të reja.

Ky hamendësim llogjik nuk duket se shkon aspak kundër pohimit të popullimit pellazgjik të Greqisë së lashtë dhe as kundër pohimit se Lufta e Trojës ishte një luftë ndërmjet fisesh pellazgjike, as kundër pohimit se të dy palët ndërluftuese flisnin të njëjtën gjuhë, pavarësisht dallimeve dialektale që mund të kishin ndërmjet tyre.

Në fakt qyteti emërtohet Ilion dhe jo Ion. Mendoj se këtu mund të na vinte në ndihmë mënyra e shpjegimit të emrit Babilonia, në librin "Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit" me autor G. Nalbandian, sipas të cilit:

"Babilonia është një variant Grek për emrin Babel. Babeli ka qenë quajtur, gjithashtu, Babili (El ose Eli nënkupton Zot dhe Bab-Ili ose Bab-Eli nënkupton Porta e Zotit në gjuhën Babilonase) dhe konsiderohej të ishte qendra e Tokës; … (Fq. 57)"

N.q.s. do të përdornim edhe këtu formën "Il-Ion" me kuptimin "qyteti i mbretit Ion apo qyteti i Zotit Ion", ku "Il apo Ili" nënkupton "Zot" apo "mbret fuqiplotë", mendoj se kjo do t'i jepte zgjidhje problemit. Por si i bëhet që këtu *"Il"* është përpara emrit *"Il-Ion"*, ndërsa tek *"Bab-Ili"* është prapa emrit *"Bab"*. Mendoj se edhe ky hutim mund të sqarohej, n.q.s. i referohemi ndryshimeve gjuhësore

ndërmjet popujve të ndryshëm apo mënyrës së ndryshme të referimit për të njëjtën çështje, si p.sh.: sot dikush thotë *"Imzot"*, ndërsa dikush tjetër me të njëjtin kuptim përdor shprehjen *"Zoti im"*. Pra kemi shprehur të njëtin gjë: *"Im-Zot" = "Zoti im"* (Kjo, të paktën, duke pasë në konsideratë gjuhën Shqipe).

Shënim B.P.: Vëmendje: Në gjuhën Armene si element shtues kemi:

Էլ (el) = edhe, më, akoma

Էլի (eli) = edhe më, përsëri, akoma

Mendoj se ky krahasim, apo mbështetja tek shpjegimi i emrit Babilonia për të shpjeguar prejardhjen e emrit Ilion, nuk do të ishte i pavend, n.q.s. do të kemi parasysh, që bëhet fjalë për kohë të hershme, kur tashmë është i njohur fakti i popullimit të njëkohshëm Anatolik dhe atij Babilonas, kur është i njohur fakti i luftrave të vazhdueshme ndërmjet fuqisë ushtarake pushtuese Babilonase dhe atyre të vendeve fqinje me të, fakti i epërsisë së qytetërimit Babilonas ndaj atyre të fqinjëve, dhe, pa dyshim, ndikimi i pushtimit Babilonas apo i varësisisë ndaj fuqisë Babilonase, që ushtronte trysni në çdo fushë të jetës të popujve, që përbënin mbretërinë Babilonase ose që ishin në marrëdhënie vasaliteti me të.

Posa që pranojmë një hamendësim të tillë si të mundshëm, atëhere shohim që kemi arritur në një çast, kur mund të hamendësojmë një përsëritje të përmbledhur të asaj, që jemi përpjekur të themi më sipër:

Ilioni dhe fisi i tij pellazgjik krijuan një mbretëri të re në bregun perëndimor të Anatolisë me kryeqytet qytetin Ilion, i njohur ndryshe si Troja. Përderisa, në kohën e vet, Troja konsiderohej si një ndër qytet-shtetet më të fuqishme të kohës, është e natyrshme të hamendësohet shtrirja e ndikimit apo e pushtimit edhe në zona kufitare, njera nga të cilat, e cila tërhiqte interesin e saj ishte pa dyshim bregdeti përballë, pra krahinat greke të gadishullit ballkanik. Mendoj se kalimi në bregdetin përballë u shoqërua me një pushtim paqësor apo kolonizim Ionik, i cili u ndalua në bregdetin, që u emërtua sipas tyre bregdeti Ionian. Nuk di të ketë ndonjë ngjarje të

bujshme, që të ketë lënë gjurmë apo të jetë dokumentuar historikisht, në zonën e Detit Egje apo atij Ion, deri në momentin që marrim njoftim nga Homeri për luftën e Trojës, të viteve 1190-1180 p.e.s.. Kjo të lë të kuptosh se ky kalim nga gadishulli Anatolik për në gadishullin Ballkanik ka ndjekur të njëjtën rrjedhë si edhe migrimet e tjera pellazgjike në gadishullin Ballkanik. Jam i prirur të pranoj se, edhe në këtë rast, rruga migrative e ndjekur ka qenë rruga tokësore nëpërmjet ngushticave që ndajnë këta dy gadishuj. Duke ndjekur jug-perëndimin, Ionët më në fund kanë ndaluar në breg të atij deti që mori emrin "Deti Ion" sipas tyre dhe që sot lag brigjet perëndimore të Greqisë tokësore. Praktikisht, Ionët u vendosën në ato toka, që sot bëjnë pjesë në Greqinë veri-perëndimore.

Shënim B.P.: Nuk do të çuditesha po të lexoja apo dëgjoja dikur se themelimi i qytetit Janina (Ioanina) të Greqisë së sotme përkon në kohë pak më përpara Luftës së Trojës.

Sipas këtij hamendësimi, dal në përfundimin, sipas të cilit, Jonët kanë qenë ndër fiset e para të njohura historikisht, që kanë pasë populluar Greqinë e lashtë. Mbase këta kanë qenë edhe fisi më i madh që kanë pasë populluar Greqinë tokësore; mendohet të kenë qenë pjesa përbërëse dominuese e shtetit të Atikës. Mbase këta janë ata, që i dhanë farefisit të tyre verior pellazg Gegh, të cilët i kishin paraprirë këtyre lëvizjeve pellazgjike dhe ishin vendosur në ato vende përpara arritjes Ionike, emërtimin Grek, që përmend Homeri sipas studiuesit Aristidh Kola. Mendoj, që këta janë ata, të cilët, afro 600-700 vjet pas rënies së Trojës, pas rënies së perandorisë Perse dhe fuqizimit të qytet-shteteve Greke, u rikthyen në vendin e origjinës duke kolonizuar bregdetin perëndimor Anatolik dhe duke i dhënë jetë një tjetër grupim shtetesh të quajtura shtetet Ionike, ose shkurt Ionia.

Sidoqoftë, kur flitet për Ionë, mendoj se duhet hamendësuar më gjerë: Me këtë do desha të them që lëvizja Ionike është një lëvizje e shtrirë përgjatë një hapësire të madhe kohore, që fillon me Ionët imgratorë që përpara luftës së Trojës.

Më pas kemi Ionë migratorë në Greqi si robër lufte me mbarimin e Luftës së Trojës, ose më pas Luftës së Trojës si migratorë të lirë për në vendin fitimtar të luftës, ku me siguri kërkonin një jetë më të mirë, dhe ku padyshim shpresonin në përkrahjen e paraardhësve të tyre Ionikë. Një pjesë e atyre që i shpëtuan luftës, me siguri, shkoi drejt jug-perëndimit të bregdetit Anatolik, duke krijuar atje më pas vendbanime, që i shërbyen më vonë krijimit të Lidhjes Ionike, duke pasë në mbështetje edhe migrimin apo pushtimin Ionik nga gadishulli Ballkanik në drejtim të gadishullit Anatolik, siç kemi përmendur më sipër. Pra, kemi një rikthim në vendin e origjinës, por kësaj herë si kolonizatorë Grekë Ionikë.

Përsa i përket origjinës së Akejve dhe Eolianëve, në mungesë të një informacioni të nevojshëm për të arritur të krijoj një hamendësim llogjik në vijimësi të atyre të mësipërm, jam i detyruar të kufizohem të them se mendimi im është që këto dy fise janë fise autoktone në kohën e migrimit Ionik të hamendësuar prej meje në rreshtat e mësipërm.

Them autoktone me kuptimin "të vendosura para Luftës së Trojës dhe para lëvizjeve Ionike fillestare të sipërhamendësuara". Por kjo nuk e zhvlerëson hamendësimin e pranisë autoktone të Akejve dhe Eolianëve si pjesë e fisit të madh pellazgjik, që kishte zbritur në këto krahina në kohë paraIoniane. Fakti që lufta ndërmjet Akejve, të spikatur ndërmjet Grekëve, dhe Ionianëve të Trojës (Ilionit) konsiderohet si një luftë ndërmjet fiseve pellazge, që flisnin të njëjtën gjuhë, "atë pellazge", të lë të kuptosh se Akejtë dhe Ilionët nuk ishin të panjohur për njeri tjetrin, por ishin degë të një peme. I njëjti hamendësim mendoj se është i vlefshëm edhe kur flitet për Eolët.

Dallim nga fiset sipërpërmendura "Ionët, Akejtë dhe Eolët" bëjnë Dorët.

Tukididi thotë se 80 vjet pas pushtimit të Trojës"Dorët erdhën në Peloponezin e Herkulit" (A13); (Fq. 77)

N.q.s. e pranojmë si të saktë këtë datë, i bie që Dorët të kenë ardhur në brigjet Greke rreth vitit 1100.

Duke marrë në konsideratë faktin se periudha ndërmjet shekujve 12-9 p.e.s (vitet 1200 – 800 p.e.s.) konsiderohet si periudhë e errët në historinë e Greqisë (me mungesë informacioni historik) nga ana e historianëve; duke marrë në konsideratë faktin se gjuhësia Greke nuk ka asnjë dokumentacion të shkruar në gjuhën Greke, që i përket kësaj periudhe; duke marrë në konsideratë faktin se kjo periudhë e errët në historinë e Greqisë përkon me periudhën lulëzimit Fenikas, që kulmon në vitet 1100 - 800 p.e.s.; duke marrë në konsideratë faktin se në kohën e lulëzimit të vet Fenikia ndërtoi koloni të shumta përgjatë bregdetit të Mesdheut, ndikim të cilit nuk i shpëtoi as toka Greke; duke marrë në konsideratë hipotezat e shumë studjuesve të njohur mbi futjen e germave Fenikase nga Kadmi fenikas në Greqi, germa që shërbyen si bazë për zhvillimin artit shkrimor Grek; duke marrë në konsideratë faktin se në vitet 800 p.e.s kemi edhe shfaqjen e lulëzimit të qytetërimit Grek, të cilit i paraprin Homeri me "Iliadën" dhe "Odisenë", që mendohet se janë shkruar rreth viteve 900-800 p.e.s., atëhere nuk ka asnjë pengesë llogjike përse të mos pranohet ndikimi Fenikas në mjediset Greke të lodhura e të rraskapitura nga lufta e gjatë kundër Trojës, luftë që kushtoi burime njerëzore e financiare, luftë që la në harresë zhvillimin qytetar. Fenikia e fuqishme financiarisht, ushtarakisht dhe kulturalisht, fuqia më e madhe tregtare e asaj kohe, pa dyshim, nëpërmjet krijimit të bazave të saj tregtare në bregdetin Mesdhe furnizoi me njerëz të aftë e të mësuar edhe të ashtuquajturat koloni, të cilat e siguronin jetesën kryesisht nëpërmjet aktivitetit tregtar, dhe në veçanti kur flasim për Greqinë, që ishte një nga pikëqëndrimet e saj kyçe në Detin Mesdhe, nuk duhet të vihet në diskutim influenca e saj.

Mbi sa më sipër, po pranojmë një migrim paqësor Fenikas në bregdetin Grek. Po pranojmë edhe pohimin e Tuqididit për ardhjen e Dorëve në Peloponezin e Herkulit rreth viteve 1100 p.e.s.

Atëhere, hamendësimi i parë që duhet të bëjmë është ky: Dorët dhe Fenikasit nuk janë autoktonë në atë që quhet sot territor i shtetit Grek deri në çastin kur përfundoi Lufta e Trojës!

Kush janë Dorët dhe çfarë lidhje kanë me Fenikasit?

Pyetja që shtrohet pas kësaj është: Në ç'raport janë këta të ardhur me fiset autoktone pellazge që gjetën aty?

Së pari, duhet të pranojmë që, të dy këto migrime nuk janë bërë njëkohësisht dhe nga i njëjti vend, pasi ç'kuptim do kishte ardhja e njëkohshme e të njëjtit popull me dy emra të ndryshëm? Së dyti, askush nga studiuesit nuk përmend ndonjë shfaqje zhvillimi të qytetërimit Grek me shfaqjen e Dorëve, ndërkohë që ndodh e kundërta me shfaqjen e ndikimit Fenikas në brigjet Greke, gjë që shoqërohet me një zhvillim të vrullshëm të jetës qytetare Greke. Së treti, në kohën e migrimeve Greke, kur Fenikia ishte fuqia më e madhe detare e kohës, nuk përmendet një gjë e tillë edhe për fisin Dorik, as nuk flitet për ndërtime kolonish Dorike në bregdetin Grek, gjë që do të ishte e kuptueshme dhe e pranueshme ashtu si edhe për Fenikinë. Kjo lë të hamendësosh, që migrimi Dorik ka qenë migrim tokësor. Por, n.q.s. ka qenë tokësor, nga cili drejtim ka ardhur? Pa dyshim, nga veriu. Por, n.q.s. ka ardhur me rrugë tokësore dhe nga veriu, duke ditur që veriu banohej në atë kohë nga fise pellazgjike, detyrimisht të vjen ndërmend të hamendësosh se kemi të bëjmë me një lëvizje migrative të fisit Dorik nga veriu pellazgjik drejt jugut pellazgjik. Kjo do të ishte e llogjikshme po të kemi parasysh, që fill pas Luftës së Trojës kemi të bëjmë me qytet-shtete Greke të rrënuara në shumë drejtime; krahas të tjerave, në fuqi puntore, kryesisht mashkullore, për shkak të luftës së gjatë e rraskapitëse.

Shënim B.P.: Teksa po analizoj këtë lloj lëvizje migrative të kohëve të lashta, më del parasysh skema e lëvizes migrative që ka ndodhur këto 30 vitet e fundit në Ballkan: pothuajse gjysma e emigrantëve shqiptarë të pas viteve 1990 shkuan drejt jugut, në Greqi, ku vazhdojnë të banojnë edhe sot e me siguri në një të ardhme të afërt prej tyre do mbetet vetëm një kujtim i largët, por që sidoqoftë diku do mbetet i dokumentuar si kujtim për brezat e ardhshëm të banorëve të Greqisë. Pjesa tjetër, rreth 25% e emigrantëve sot gjenden në Itali, të tjerët shkuan akoma më larg, por gjithnjë drejt perëndimit.

Ndërkohë shohim një emigrim masiv nga vendet e Lindjes së Mesme (sidomos për shkak të luftrave, nga të cilat e fundit kjo e Sirisë), të cilët lëvizin kryesisht nëpërmjet dy mënyrave, nga të cilat e para dhe më masivja është lëvizja emigrative me rrugë tokësore; është po e njëjta skemë me rrugën e lëvizjes emigrative të popujve të lashtë pellazgjikë: Lindja e Mesme, Turqi, Ballkan drejt veriut, për të përfunduar më pas në zemër të Europës. Drejtimi i dytë i lëvizjes është ai i ngjashëm me lëvizjen kolonizuese Fenikase: nga portet ish Fenikase dhe ato të Afrikës Veriore (Egjiptit, Libisë, Tunizisë, etj) drejt qyteteve bregdetare të Europës Jugore, kryesisht Greqisë dhe Italisë.

Por tashmë nuk kemi një migrim qytetërues të natyrës Fenikase për të cilin folëm më sipër, por një migrim me natyrë humane. Sidoqoftë, pavarësisht nivelit më të ulët të zhvillimit të emigrantëve përkundrejt vendeve strehuese (në këtë rast p.sh Gjermania, Austria, Franca, etj.), pavarësisht faktit që prania e tyre përkundrejt banorëve vendas është shumë më e vogël në numër, ky fenomen (migrimi) do lerë gjurmë në jetën e këtyre vendeve.

Duke pasë parasysh nivelin e sotëm të zhvillimit të shoqërisë njerëzore, besoj se në të ardhmen historia nuk do të njohë më periudha të errta historike, siç jemi detyruar të pranojmë për Greqinë e viteve 1200 – 800, periudhë që po përpiqemi ta ndriçojmë. (sot që po shkruhen këto rradhë jemi në vitin 2020)

Ka vetëm një dyshim: mos vallë të ardhurit e parë Fenikas quheshin Dorë? Ky dyshim do ta fuste në një rrjedhë akoma më të ndërlikuar çështjen e migrimit Dor, pasi do të ringrinte një sërë pikëpyetjesh, që deri më sot akoma nuk kanë marrë përgjigje, si p.sh.: nga vinin, erdhën nga toka apo nga deti, cilit prej qyteteve Fenikase i përkisnin, ç'gjuhë flisnin, në ç'formë erdhën, si pushtues apo si emigrantë të thjeshtë? N.q.s. pranojmë që ishin ndër Fenikasit e parë që erdhën në tokat Greke, atëhere përse thuhet që shkrimin e sollën Fenikasit dhe nuk thuhet që e sollën Dorët, përse thuhet që e solli Kadmi nga Fenikia dhe jo p.sh. Dori nga Fenikia? N.q.s.

kishin ardhur nga deti dhe u bënë aq shumë shpejt të njohur dhe fis i fuqishëm, duhet të kenë qenë edhe në një numër të madh; dhe një lëvizje e përmasave të tilla me rrugë detare, që i ngjan një pushtimi të madh, zor se kalon pa u vënë re në histori. Të paktën do të ishte një histori kolonizuese e krahasueshme me atë të Fenikisë në ditët e saj më të mira.

Mendoj, se një shfaqje e Dorëve në përmasa të tilla, në mënyrë kaq të heshtur dhe misterioze për historinë, sa që papritur të paraqitën si një ndër katër fiset kryesore e më të fuqishme Greke të periudhës së pas Luftës së Trojës, mund të ketë ardhur vetëm si rezultat i lëvizjeve migrative tokësore, nga veriu më pak i zhvilluar drejt jugut më të zhvilluar, por të dobësuar si rezultat i luftës së gjatë, dhe për më tepër brenda fiseve të të njëjtit lloj, ose të paktën, që flisnin të njëjtën gjuhë e merreshin vesh me njeri tjetrin. Përse të mos thuhet në këtë rast që, mund të ketë qenë vetë jugu i dobësuar ekonomikisht nga kjo luftë e gjatë e me shumë humbje ekonomike dhe jetësh njerëzore, që i ka ftuar fiset veriore për të ndihmuar në rimëkëmbjen e tyre?

Shfaqja e Dorëve nuk duket të shoqërohet me shfaqjen e një gjuhe të re e të pakuptueshme për fiset që ndodheshin prej kohësh aty, siç ishin Ionët, Akejtë dhe Eolët, ndërkohë që, kur flitet për Fenikasit, përmendet edhe gjuha Fenikase, gjë që lë të kuptosh se nuk është e njëjta gjuhë me atë të vendasve Grekë. Gjithashtu, kur flitet për gjuhën e përdorur nga Homeri në veprat e tij, thuhet që ato janë shkruar në gjuhën e vjetër Greke, por në asnjë rast nuk thuhet që ato janë shkruar në gjuhën Fenikase.

Shënim B.P.: Sipas Wikipedias kemi: Dialekti Jon ishte një nga tre ndarjet kryesore gjuhësore të botës Helene, së bashku me dialektet Doriane dhe Eoliane.

Ndërkohë, nuk mund të rri pa vënë në dukje edhe një hamendësim, që më vjen ndër mend lidhur me prejardhjen e emrit "Dor".

Fjala Shqipe *"nip"* në gjuhën Armene shprehet me fjalën *"torr"*.

Ծոռն (torr) = nip

Kjo më shtyn të bëj pyetjen: A ka mundësi vallë, që *"Dorët"* pellazgjikë, që vinin rishtas nga veriu, të jenë pritur dhe cilësuar në jugun pellazgjik si ardhje e *"Torrëve – nipërve"* pellazgjikë?

Me mendimin se dikush mund të gjejë ndonjë element, që i shërben ndriçimit të etimologjisë së emrave "Dor" apo "Durrës" (për këtë të dytin kam mendimin se e ka prejardhjen po prej emrit "Dor") në të ardhmen, nëpërmjet fjalëve të gjuhës Armene, degë e trungut të gjuhëve Indoeuropiane, po sjell këtu disa prej tyre, që përafrojnë me këto fjalë, ashtu siç përdoren në gjuhën Shqipe:

թոռ (torr) – nip

թոռնիկ (torrnik) – nip

թուր (tur) - shpatë

դիւրին (tjurin, tyrin, djurin, dyrin) – i lehtë, jo i vështirë

դուռ (turr, durr) - derë

դուր (tur, dur) - daltë

դուրս (turs, durs) - jashtë

տորմիղ (dormigh, tormigh) – flotë

ShënimB.P.: Fjalët në kllapa i përkasin të dy dialekteve të gjuhës Armene (Perëndimore dhe Lindore)

Në gjuhën Shqipe fjalë të përafërta kemi:

dorë - (si pjesë e trupit të njeriut)

dorëz – koka e një arme, e një shkopi, etj.

dori' – kalë qimekuq

turi – fytyra e njeriut

turr – turtull (zog)

turr – të hedhurit, të vërsulurit me vrull mbi një objekt; vërsulje

turrë – grumbull, turmë

(Nxjerrë nga "Fjalor i Gjuhës Shqipe", botim i "Instituti i Shkencave", Tiranë, 1954

Mos vallë quheshin Tur apo Dur, Turs apo Durs, përpara se të ishin Dorë??

Cila ka qenë vetia kryesore që i karakterizonte Dorët?

Përse hamendësoj sa më sipër?:

Sepse shndrrimi i germës *"t"* në *"d"* dhe anasjelltas, si edhe i *"u"* në *"o"* dhe anasjelltas, nuk janë të pazakonta në dialektet e gjuhës Armene; po e njëjta gjë mund të thuhet edhe për gjuhën Shqipe. Po sjellim dy shembuj të thjeshtë:

Shqip: të shkosh – me shkue, me shku,

duke shkuar – tue shkue, Ndue – Ndoj – Noj (emër njeriu)

Armenisht: դուռ (turr, durr) – derë;

նույն (nujn) = նոյն (nojn) – i njëjti, po ai;

Tigran – Dikran (emër njeriu)

Disa hamendësime rreth emrit etimologjsë së emrit Durrës:

Torr (nip) – Torrës – Turrës – Durrës

Durr, Turr (derë) - Durrës

Durs, Turs (jashtë) – Durrës

Futja e germave Fenikase, nuk thuhet të ketë sjellë ndryshimin e gjuhës në qytet shtetet Greke, por flitet për dialekte të ndryshme, p.sh. dialekti Dorik, Jonik, etj.. Herodoti vëren se gjuha që flitet në kohën e tij ndryshon nga ajo e gjuhës së përdorur nga Homeri, por jo aq sa ai të mos e kuptojë. Ai vëren se gjuha, që flet populli i Athinës, është gjuha e vjetër e Homerit, që ai e quan pellazge, dhe njëkohësisht e cilëson "barbare". Gjuha e përdorur nga Homeri, pavarësisht se e shkruajtur me germa Fenikase, nuk është gjuha Fenikase, por një gjuhë krejt e ndryshme me të; ajo është gjuha që flisnin banorët e Greqisë të asaj kohe. Dhe pasardhësit e Homerit e shkruan dhe e rishkruan veprën e tij për popullin e tyre, në gjuhën e tyre, në atë që njihet si Greqishtja e vjetër, dhe që sot ka studiues, të cilët pohojnë se gjuha e Homerit zbërthehet më kollaj me gjuhën Shqipe se sa me

gjuhën e sotme moderne Greke. Dhe është e natyrshme të pranohet edhe evoluimi i gjuhës së Homerit, po të kemi parasysh, se u shkrua me germa Fenikase një gjuhë, e cila nuk ishte Fenikase, u shkrua me më pak simbole se sa tinguj nxirrte gjuha e banorit autokton pellazg. Është pikërisht ai ndryshim në germa që shfaqet edhe sot kur bëhet krahasimi i alfabetit Grek apo Latin me atë Shqiptar. Këtu duhet pasur parasysh edhe fakti se si ndikuan dialektet e ndryshme në shkrimin e krijuar nëpërmjet këtyre germave, për të arritur në një gjuhë të kuptueshme nga gjithë masa e banorëve që popullonin ato zona.

Lidhja Greke, në kohën e luftës me Persët, e forcoi akoma më shumë unitetin gjuhësor dhe kultural ndërmjet qytet-shteteve Greke, e çoi në nivele shumë të larta kulturën gjuhësore dhe shkrimore të tyre, u bë djepi i ndriçimit kulturor të kohës kur shfaqet ylli i Aleksandrit të Madh. U bë gjuha e edukimit të burrave të mëdhenj të shteteve të asaj kohe; udhëheqësve dhe filozofëve Grekë, udhëheqësve Maqedonas, Epirotë dhe Ilirë.

Por ndërkohë populli i Epirit dhe Ilirisë vazhdonte të fliste atë gjuhë që Grekët e Herodotit e quanin gjuhë "barbare" apo " e huaj".

Thuhet që edhe Aleksandri i Madh e njihte dhe e fliste këtë gjuhë "barbare", e cila konsiderohej si gjuha e nënës.

Si përfundim, do të thoja, që gjuha e sotme Greke nuk u shpik nga asgjëja apo nga fillimi, por është gjuha e të parëve banorë të Greqisë, të cilët Homeri i quan"pellazgë", gjuha që Herodoti e quan "pellazge" dhe njëkohësisht "barbare", gjuhë që e shkruar me shkronja Fenikase dhe nën ndikimin pozitiv të zhvillimit të marrëdhënieve ekonomike e kulturore, në rradhë të parë me Fenikinë, e më pas me vendet përreth, pësoi ndryshime të dukshme, në krahasim me krahinat më veriore të Ballkanit, që ishin më pak të ekspozuara ndaj këtyre zhvillimeve pozitive. Shembull i dukshëm i kësaj tablloje ishin shtetet Maqedone, Epirote, Ilire, me prapambetjen e tyre të theksuar në fushën e zhvillimit të kulturës shkrimore, prapambetje e cila edhe për shkak të faktorëve historikë të veçantë, ka qenë reale deri në

ditët e vona, krahasuar me kulturën shkrimore Greke e më pas atë Romake të ndikuar drejtpërsëdrejti prej saj.

Përsa i përket ardhjeve njerëzore nga Fenikia dhe ndikimit të tyre në zhvillimin e ekonomisë dhe kulturës Greke mendoj që shpjegimi i mësipërm është i mjaftueshëm, ndërkohë që prejardhja e banorëve të Fenikisë dhe ndikimi i ndërthurjes së tyre me popullsinë vendase në ndryshimin e përkatësisë pellazgjike të kombit të mëpastajmë Grek është një temë që i kalon mundësitë e mia.

Megjithatë ja vlen të shihet trajtimi që i bëhet Fenikisë dhe Fenikasve nga ana e G. Nalbandian në librin "Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit". Sipas legjendës, Fenikasit ishin me origjinë Xhafetike, të cilët në kohën kur kaluan në varësinë e Nimrodit Hamitik u populluan me fise të ardhura nga vende të tjera të mbretërisë Babilonase. Po të kemi parasysh pozicionin e Fenikisë në mbretërinë Babilonase të asaj kohe mund të merret me mend se ajo ndodhej në qendër të rrugës, e cila lidhte Afrikën veriore (Egjipt, Libi) me Babiloninë. Përmendja e qytetit të Tirit (Tyrit) tregon se në atë kohë ai ishte një qytet i rëndësishëm.

Origjina Xhafetike e Fenikasve të trajtuar në "Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit", pushtimi dhe sundimi Hamitik nga Bel Nimrodi, si edhe politika e tij e përzierjes së popujve të mbretërisë së tij Babilonase, hamendësimi mbi arritjet masive të mëpasshme të fiseve semitike në truallin e Fenikisë së atëhershme, ngrenë pikëpyetjen: Cila ishte përbërja racore e Fenikisë në kohën e mbizotërimit të ndikimit Fenikas në Mesdhe dhe veçanërisht në Greqi dhe ndikimi i cilit prej tyre ishte përcaktues në krijimin e kulturës gjuhësore të shkruar? Cila ka qenë shkalla e ngjashmërisë së gjuhës së folur Fenikase dhe Greke të asaj kohe?

Këto dhe të tjera vazhdojnë të mbeten objekt studimi.

Gjithashtu, këtu do desha të vë në dukje se trajtimi që i bëhet Fenikisë me Kadmin mbret nga ana e G. Nalbandian në librin "Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit" dhe trajtimi që i bëhet Kadmit

nga Herodoti, si bir i Agenorit, mbretit të Finikisë, që solli germat në Greqi, ka të përbashkët faktin që Kadmi ose Kadmosi ishin në krye të Fenikisë, njeri i emëruar nga Hajku si mbret pa qenë vetë Fenikas dhe tjetri duke qenë bir i mbretit të Finikisë. Kadmosi, bir i Aramenakut (Armenakut), ndërsa Kadmi, bir i Agenorit (Antenorit).

Kadmosi i trajtuar nga G. Nalbandian, sipas legjendës, i takon të ketë filluar mbretërimin në vitet 2490 p.e.s., ndërsa Kadmi, si bir mbreti, i trajtuar nga Jani Vreto, që citon Herodotin, mendohet të ketë shkuar në Greqi rreth vitit 1600 p.e.s..

Kadmosi i trajtuar nga G. Nalbandian ishte pasardhës Xhafetik, ndërsa populli Fenikas mbi të cilin ai u vendos për ta qeverisur, nuk përmendet si popull Xhafetik, por sipas pemës gjenalogjike të Noes hamendësohet të ketë qenë fis Semitik. Ndërkohë sipas legjendës treguar nga G. Nalbandian kemi:

"Hajku kurorëzoi nipin e tij, Kadmosin, si mbret të Fenikias, pasi që nga momenti që Feneçi kishte vdekur në mënyrë të mistershme, tokat i kishin kaluar në administrim Nimrodit, dhe pas vrasjes së këtij të fundit nga Hajku, Fenikasit kishin nevojë për një mbret të ri; kështu Kadmosi u bë mbreti i Fenikasve në momentin që Hajku u bë mbret i mbretërisë së Nimrodit. (Fq. 145)"

Sipas kësaj rezulton, që edhe Nimrodi, i cili ishte pasardhës Hamitik, nuk ishte mbret origjine i popullit Fenikas, por një mbret pushtues nga jashtë Fenikisë.

Në gjithë sa thamë më sipër, duket se ka mospërputhje, sidomos kur bëhet fjalë për kohën kur kanë mbretëruar Kadmosi-mbret apo Kadmi-bir mbreti, si edhe për përkatësinë racore të banorëve të Fenikisë në kulmin e lulëzimit të saj, duke ditur që dikur ka qenë pjesë e mbretërisë së madhe Babilonase, gjatë mbretërimit të së cilës ndodhën përzierje racash e gjuhësh. Mospërputhja në trajtimin e Kadmit qëndron edhe në faktin, që gjuha e shkruar Greke shfaqet pas Luftës së Trojës, në kohën e lulëzimit Fenikas, pra pas viteve 1100. Megjithatë, fakt është, që futja e germave dhe shkrimit në Greqi i njihet si meritë Fenikasve, pavarësisht me Kadmin ose pa të.

Përsa i përket asaj, që quhet sot gjuha Greke e ditëve të sotme, duhet pasë gjithnjë në vëmendje fakti, që në zhvillimin e saj, nga ajo që quhet gjuha e Homerit deri në këtë të ditëve të sotme, një rol të madh ka luajtur ndikimi Grek në zhvillimin e botës Europiane Mesdhetare, ndikim që jo vetëm ka qenë dhënës, por edhe marrës.

Gjuha Greke ka qenë objekt i ndryshimeve të vazhdueshme, që nga momenti që Aleksandri i Madh i imponoi botës që pushtoi kulturën Greke e deri në zhvillimet e mëpasshme, që u shoqëruan me:

- shpërbërjen e Perandorisë së Aleksandrit të Madh,

- ngritjen e Perandorisë së fuqishme Romake, e cila diti ta përvetësojë dijen kulturore Greke dhe ta zhvillojë më tej atë,

- ngritjen e perandorisë së madhe fetare Kristiane shumëracore në territorin e Perandorisë Romake, që gjeti në gjuhën Greke shprehësin me gojë dhe me shkrim më të madh të doktrinës së saj në të gjithë shtrirjen e atëhershme të Perandorisë Romake, dhe që u ligjërua më pas si gjuhë zyrtare dhe e besimit Kristian e Perandorisë Bizantine,

- lëvizjet e mëdha njerëzore të shoqëruara me ndikime ekonomike e kulturore brenda Perandorisë Romake, Bizantine dhe më pas asaj Otomane.

Dhe, megjithëse nuk është më gjuha e Homerit, Greqia ja dedikon asaj dhe Homerit atë, me të cilën ajo krenohet dhe bashkë me të edhe qytetërimi Europian.

Pa veprat heroike të paraardhësve të saj, pa popullin e saj të lashtë, që i nxorri nga gjiri i vet këta heronj e që u krenua me bëmat e tyre duke i fiksuar në këngët dhe tregimet popullore, që u kthyen në legjenda për t'i shërbyer Homerit si lëndë e parë për të krijuar ato vepra të pavdekshme, Greqia nuk do të ishte ajo që është sot.

Dhe Homeri, i mori ato nga goja e popullit, që krenohej me bëmat e bijve të tij, për t'i fiksuar një herë e përgjithmonë si kujtim për brezat e ardhshëm të po atij populli, që sot krenohet me bëmat e paraardhësve të vet.

Cili popull dhe cili këngëtar do të shkruante me krenari për bëmat e paraardhësve të tij në një gjuhë që nuk do të ishte e tij, e që nuk do të kuptohej nga bijtë e tij?

Prandaj, hamendja ime i bashkohet teorisë së atyre studiuesve, të cilët pohojnë se baza mbi të cilën ngrihet sot kombi dhe shteti Grek, janë "banorët e lashtë pellazgjikë dhe gjuha e tyre pellazgjike", të cilën ata ditën aq mençurisht ta fiksojnë me germat e diturisë Fenikase, për t'i dhënë më pas botës Europiane bazën e gjuhës dhe historisë së shkruar.

Tani, përsa i përket kohës së shfaqjes së emrit *Greqi* dhe *Helen,* si edhe kohës kur këta emra hynë në përdorim masiv në Greqi dhe jashtë saj, i përmbahem fakteve të paraqitura më sipër nga studiues të ndryshëm apo të marra nga Wikipedia. Po i përmbledh:

Helenët dhe *Greqia* përmenden një ose dy herë nga Homeri si një vend i vogël në rrëzë të Pindit, ku dy gjërat më karakteristike janë se ndodhet nën pushtetin e Akilit dhe se ka gra të bukura. (A. Kola, Fq. 43)

"Hellas" – përmendet nga Homeri si një vend i vogël pranë Pindit dhe që karakteristika e tij më e veçantë ishte se kish gra të bukura ("Greqia grabukura"- siç e quan Homeri) dhe prijës i tij ishte një ndër heronjtë më të lavdishëm të luftës së Trojës, Akili. (A. Kola, Fq. 110)

Aristoteli ishte i pari që përdori emrin Graeci (Γραικοί), në *"Meteorologjinë"* e tij. Ai shkroi se zona përreth Dodonës dhe lumit Achelous ishte e banuar nga Selli dhe një popull, të cilët ishin quajtur Graeci, por u quajtën Helenë nga koha e tij. (Wikipedia)

Emri anglisht "Greqi" dhe përshtatjet e ngjashme në gjuhë të tjera rrjedhin nga emri latin "Graekia" (greqisht: Γραικία), që do të thotë fjalë për fjalë "toka e Grekëve", e cila u përdor nga Romakët e Lashtë për të treguar zonën e Greqisë së sotme. (Wikipedia)

Nga paragrafët, paraqitur më sipër, pavarësisht se nuk del qartë renditja kohore e shfaqjes së emrave "Grek", Helen", apo "Hellas", mendoj se duhet të kenë këtë renditje të shfaqjes në kohë: fillimisht

kemi shfaqjen e emrit "Grek", më pas atë "Helen" dhe, në lidhje etimologjike me këtë, vjen emri i krahinës "Hellas".

Përsa i përket emrit *"Grek"*, nga pikëpamja etimologjike jam përpjekur të shpjegoj hamendësimin tim në pjesën që titullohet "Interpretimi Geg – Tosk", nën dritën e bindjes së paraardhjes "pellazgjike" të kombit të sotëm Grek. Kjo vlen edhe për hamendjen e renditjes kohore të shfaqjes së këtyre emrave. Përsa i përket zyrtarizimit të këtyre emrave në formën që i njohim neve sot, ky nuk është objekt trajtimi në këtë shkrim.

Së dyti, përsa i përket emrit "Helen", mendoj se nuk është pa lidhje me emrin Ilion.

Kur trajtuam më sipër etimologjinë e emrit Ilion, u përpoqëm të bëjmë një shpjegim, duke u mbështetur tek shpjegimi i bërë për emrin e Babilonisë, duke thënë:"..., ku *"Il* apo *Ili"* nënkupton *"Zot"* apo *"mbret fuqiplotë …"* .

Në gjuhën Armene, fjala *"Zot"* shkruhet *"Աստված"*, dhe lexohet *"astvac* ose *asdvax"*, dhe rrjedh nga fjala *"աստղ"*, që lexohet *"ast* ose *asd"*, dhe që përkthehet *"Yll"*. Pra, për Armenët, superiori *"Zot"* e ka rrënjën tek superiori hapësinor *"Yll"*.

Po a ka më Zot se Ylli apo Dielli (Ylli Diell)?

E njëjta gjë mund të thuhet për përdorimin e fjalës "yll" në gjuhën popullore Shqipe, ku fjala "Yll", krahas kuptimit të sendit hapësinor, krahas barazimit në kuptim me "Diellin" si "ylli" më i afërt me Tokën, shpreh edhe shkallën më të lartë të vlerësimit për objektin e diskutimit. P.sh. kur flitet për një femër të bukur, përdoret shprehja "ajo është yll", etj. Por këtu duhet pasë parasysh që në gjuhën Shqipe, në varësi të dialektalizmave kemi "Ill" apo "Il", "Hyll", "Hill" apo "Hyu" për "Yll". Por rrokjen "Ill" e kemi edhe në përbërje të fjalës "Diell", ylli më i afërt me Tokën. Edhe këtu në varësi të dialektalizmave kemi "Diell", Dill", "Djell".

Të prejardhura prej fjalës "Yll, Hyu", në gjuhën Shqipe, kemi "Hyjni, Hyjneshë, Hyjnor, etj".

Duke pasur një ide të vakët për emrin "Helios", m.q.s. nuk e njoh gjuhën Greke, ju drejtova për ndihmë "Wikipedias", ku gjeta:

Helios, gjithashtu Helius (/ ˈhiːlioʊs /; Greqishtja e lashtë: Ἥλιος Hēlios; e latinizuar si Helius; Ἠέλιος në Greqishten Homerike), në fenë dhe mitin e lashtë Grek, është perëndia dhe personifikimi i Diellit. (Wikipedia)

Ήλιος (Ílios) – diell Άστρο (Astro) – yll

Siç shihet, edhe në gjuhën Greke, në bazë të fjalës hyjnore "Zot, Perëndi, Diell" qëndron fjala "Hilius, Hilios, Helius, Helios", që në bazë kanë "Ilius, Ilios, Elius, Elios", që në fund të fundit si rrokje bazë fjalëformuese kanë "il, el". Po ripërmendim:".., ku *"Il* apo *Ili"* nënkupton *"Zot"* apo *"mbret fuqiplotë…" .*

Tani, le të përqëndrohemi për një çast në mënyrën se si gjuha Shqipe popullore e tij e ka idealizuar bukurinë femërore: "Hyjneshë, Hyjnore, Hyri, Perëndeshë e bukurisë, etj". Pra, e ka çuar në lartësinë e Zotit, Perëndisë, Zotit Diell, Zotit Yll. (Jo më kot çdo yll përfaqësonte një figurë Hyjnore, një Zot – si p.sh Ylli Afërdita). Këtu është vendi për të kujtuar me humor këngën Elbasanase, që thotë: "Ylli Afërdita leu n'Elbasan".

Duke pasë parasysh që në gjuhën Shqipe, në varësi të krahinave, germa "i" dhe "e" shpesh këmbejnë vendet me njera tjetrën, si p.sh.

Folja "me pasë", në kohën e tashme, numri shumës, veta e parë, bën "kemi"; por përdoret dialektalisht (dial. Geg) edhe "kina" ose "kena".

Po kështu, germa "y" me "i", p.sh. "hymn" – "himn", "lyrë" – "lirë", etj.

Germa "h", nga ana e vet, shpesh bie në gjuhën e folur ose mbetet e patheksuar, p.sh: "hiç" tek "iç", "hile" tek "ile", "helm" tek "elm", për të ardhur tek "Hylli" – "Ylli" dhe anasjelltas.

Gjithë paraqitja e mësipërme u bë në funksion të mbështetjes së hamendësimit se, fjala "Helen" mund të jetë rezultat i shndrrimeve në kohë të rrokjes – fjalë – bazë "Ili" apo "Eli". Ashtu siç kemi arritur në Helios, Helius për Diellin, nëpër të njëjtën rrugë mund

të ketë kaluar formimi i fjalës "Helen". Po pranoj skemën që është e ngjashme me atë që hamendësuam per emrin e qytetit "Ilion", pra: *Ili – Ili Ion – Ilion,* nga ku

dalim në:

Ili – Eli – Ele – Hele – Helen – Helena

Ili – Ili In – Ilin - Ilina - Elena – Helena

pra mund të pranojmë si domethënie:

Helena = Grua e Bukur, Bukuroshe, Perëndeshë e Bukurisë, Bukuri Hyjnore, Hyjni

Për krahasim:

Shqip	Grua
Greqisht	Γυνή (gyni', gini) – grua
Armenisht	*կին* (kin, gin) – grua
Anglisht	queen (kuin) – mbretëreshë, grua Zot, Perëndeshë

Duke parë praninë e rrokjes "In" në fjalët më sipër, mund të hamendësojmë prejardhjen e fjalës "Helen" nga "Ili + In = Ilin, Elen, Helen".

Përsëri hamendësim:

"Ili + In = Ilin, Elen, Helen" = Ili (Zot) + In (Femër) = Zot + Femër = Femër + Zot, Perëndeshë, Hyjni, Femër Yll, etj..

Nisur nga hamendësimet e paraqitura më sipër, nuk më mbetet tjetër, përveçse t'i shtoj edhe hamendësimin e fundit, që përsëri nuk është gjë tjetër, përveçse rrjedhojë e hamendësimeve të mëparshme:

Me këtë dua të them se mendimi im lidhur me emrin "Hellas" nuk është gjë tjetër përveçse një pohim i prejardhjes së saj prej fjalëve "Helen" dhe "Helena", një nënkuptim i vendit, që lind dhe rrit burra dhe gra të bukura, burra dhe gra hyjnore.

Tani edhe një hamendësim lidhur me Historinë e Helenës së Bukur apo Helenës së Trojës.

Lidhur me emrin Helen apo Helenë (e përdorur për seksin femër) kam bindjen se ai, si emër, nuk përfaqëson një grua të veçantë, por është një emër përgjithësues përfaqësues për femrat e bukura.

Fjala Helenë, në kohën kur shfaqet si emër, ka pasur kuptimin "e bukur si Yll", shqip "Bukuroshe". Prandaj, mendoj se është pikërisht ai vend pellazgjik rrëzë Pindit, brenda krahinës së Ionisë, i quajtur Greqi, i përmendur për gratë e bukura, ku Menelau zgjodhi të merrte gruan e tij, mbretëreshën e ardhshme të Spartës Mikenase, e cila qëlloi të ishte vërtet e bukur si Yll dhe, që për këtë arsye, nënshtetasit e Menelaut i vunë nofkën, që përdornin Ilionët për gratë e bukura, "Ilin - Helen" (Bukuroshja), që më pas mori gjithë madhështinë dhe përdorimin, që i dha historia. Gjithashtu, mendoj se e ashtuquajtura Greqi nga Homeri ishte veç një zonë e vogël, e cila përfshihej në vendbanimin Ionik.

Në mënyrë të përmbledhur:

Banorët e vendit pellazgjik rrëzë Pindit, të quajtur Greqi nga Ionët, brenda krahinës së Ionisë, përdornin për gratë e bukura nofkën "Helen" (Bukuroshja), nofkë kjo, që u përvetësua edhe nga banorët e fiseve të tjera pranë tyre për të cilësuar një grua të bukur. Vendbanimi Grek i Ionisë, i përfaqësuar në botën e atëhershme pellazgjike si vendi i Helenës (Bukuroshes), mori namin si vendi i Helenëve, apo vendi i "Bukurosheve". Zhvillimi i vrullshëm e i gjithanshëm i kulturës së këtyre trojeve nën ndikimin Fenikas, bëri që kultura e tyre të kthehej në një qendër admirimi për të gjithë popujt e lashtë, që i rrethonin ata. Lulëzimi i kulturës fizike dhe mendore, lulëzimi i arteve të bukura dhe i filozofisë, lulëzimi i gjithçkaje që nxirrte në pah bukuritë e shoqërisë njerëzore, bënë që Greqia e asaj kohe të meritonte emrin "vendi i Helenëve", por tashmë me nënkuptimin "vendi i njerëzve që vlerësojnë Bukurinë". Kurse vendi mori emrin e prejardhur prej kësaj - "Hellas".

Ndërsa të huajt ruajtën emrin "Greqi" për të treguar "vendin e Grave të bukura", ashtu siç shprehet Homeri, vetë vendasit u mbiquajtën "Helenë", besoj me kuptimin, njerëzit që morën Helenën, njerëzit që sollën Helenën, njerëzit që zotëronin Helenën, njerëzit

që zotëronin Bukurinë. Dhe kush më mirë se figura Homerike e Helenës, u bë figurë përfaqësuese e bashkimit të fiseve Greke të asaj kohe. Dhe kush më tepër se zotësia e tyre për të shtënë në dorë Helenën e nxirrte në pah burrërinë dhe mençurinë e tyre.

Dhe është e kuptueshme që banorët e atyre viseve të vendosnin për veten e tyre një emër gjithëpërfshirës, në krahasim me atë që përfaqësonte emri i një grupi të vogël njerëzish Ionikë, që banonin rrëzë Pindit, që shquhej për gratë e bukura, por që në fund të fundit, përgjithësisht quheshin "Greke", ashtu si edhe burrat e tyre "Grekë".

Duket sikur me këtë kanë dashur të shkëputen nga Grekët (apo Geghët), fisi i tyre pellazgjik verior, i cili kishte mbetur më inferior në nivelin e zhvillimit, por duke mbetur përsëri në gjirin pellazgjik me emrin "Ilin -Helen", n.q.s. prejardhja e tij është vërtet sipas hamendësimit bërë prej meje në rreshtat më sipër.

Për kuriozitet:

- "Sipas John Tzetzes (një shkrimtar bizantin i shekullit të 12të), vargmali Pindos atëherë quhej Metzovon.

- Kur Anastasios Gordios përktheu (midis viteve 1682/83 dhe 1689) në një gjuhë më bashkëkohore lavdërimin fillestar për Shën Vissarion, i cili u hartua në 1552 nga Pahomios Rousanos, ai shkroi: "Një mal, i quajtur nga grekët Pindos, është i njëjti mal, i cili quhet Metzovon në gjuhën Barbare" dhe më tej, në të njëjtin tekst, ai shton: "ky mal, Metzovon, ndan rajonin e Janinës nga rajoni i Selanikut". *(Shënim B.P.: gjuhën Barbare ??)*

Në gjuhën Armene kemi:


Մեծ + ավան = Մեծավան (Metzavan) – vendbanim i madh, lagje e madhe


մեծ (metz, mec, mex) – i madh, i math

ավան (avan) – vend, ven

Shënim B.P.: Në fjalët e mësipërme duket sikur ka vend për analizë afërsie.


Tracia
Paflagonia
Ponto
Misia
Bitinia
Tróade
Halis
Lesbos
Frigia
Galacia
Eólida
Quíos
Lidia
Jonia
Meandro
Pisidia
Capadocia
Licaonia
Caria
Panfilia
Cilicia
Licia
Rodas
Chipre
0 100 200 300 400 km


ATLANTIC OCEAN
EUROPE
Adriatic Sea
Black Sea
IBERIA
SARDINIA
ASIA
Aegean Sea
SICILY
Carthage
Tingis (Tangier)
Mediterranean Sea
CRETE
CYPRUS
Byblos
Sidon
Tyre
AFRICA
Lepcis
Cyrene
The Commercial Network of the Phoenicians
Phoenicia
Trade routes
N
Memphis
0 250 500 mi
0 250 500 km


NOE
(ndryshe Ksisuthros ose Ziusudra)
Lindur 2950 p.e.s - Vdekur 2000 p.e.s
SEM ZRVAN (Djalë)
XHAFET OSTE (Djalë)
HAM TITANI (Djalë)
ASTGHIK (Vajzë)
ARAZA (Vajzë)
Gomer
Tiras
Torgom
Rifat
?
?
?
Hajk
?
Aramaneak
Feneçi
Kadmos
Paflagoni

KAPITULLI 7

NË VEND TË MBYLLJES

PËRMBAJTJA

1. Autorë të ndryshëm për lidhje afërsie ndërmjet gjuhëve Etruske, Baske, Shqipe dhe Armene 667
2. Emra Perëndish (Pellazge ??) 677
3. Vendbanime shqiptare që kanë lidhje me emërtimin "Arbër" 681
4. Duke lexuar librin "Arbni: historik, gjeografik, kishtar dhe Politik" të autorit Aurel Plasari, Tiranë, 2020 699

AUTORË TË NDRYSHËM PËR LIDHJE AFËRSIE NDËRMJET GJUHËVE ETRUSKE, BASKE, SHQIPE DHE ARMENE

ELENA KOCAQI:
"SHQIPJA - ÇELSI I GJUHËVE INDOEVROPIANE"

Gjuhëtarët nuk kanë mundur të vërtetojnë se kush është gjuha bazë, që lindi të gjitha këto gjuhë. Gjuhëtari dhe albanologu Frank Boppi ka hedhur mendimin se sanskritishtja ka qenë baza e këtyre gjuhëve, gjë që nuk është vërtetuar. Ka pasur gjuhëtarë, që kanë menduar se duhet të ishte Armenishtja, por nga studimi i saj nuk dilnin aq shumë elementë të përbashkët që ta vërtetonin këtë teori.

…

Gjuha Shqipe është më afër nga të gjitha gjuhët me gjuhën mëmë Japetike, ose me gjuhën origjinale të popullsisë së racës së bardhë. (fq.9)

Shënime B.P.: Mbase krahasimi i Shqipes me Armenishten do shërbente për përafrimin e teorive në lidhje me gjuhën mëmë!?

ZACHARIE MAYANI:
"ETRUSKËT FILLOJNË TË FLASIN"

Faktikisht, Etruskishtja paraqet disa pika kontakti me Armenishten, ashtu si edhe Shqipja. (fq. 130)

Shënim B.P.: Tek fq. 452 – N.q.s. Shqipja vjen pas Etruskishtes, atëhere si shpjegohet Etruskishtja me Armenishten??

Nuk ka asgjë për t'u habitur që në Armenisht gjejmë shumë terma korrespondues me terma Ilirë, sepse, sipas Herodotit, Armenët janë me origjinë Thrako-Frigjiase (ose trashëgimtarë të Brigëve të lashtë Ballkanikë). Le të nënvizojmë disa pika kontakti midis Armenishtes dhe Shqipes: 1) të dy gjuhët kanë një nyje shquese të *pasvendosur;* 2) *erthal* në Armenisht është "shkoj, erdha" krahaso me Shqipen *ardh;* 3) *ges* është "gjysmë"; krahaso me Shqipen "gjysmë"; *gtanem,* "unë gjej"; krahaso me Shqipen *gjet;* 5) *tzain,* "zë"; krahaso me Shqipen za; 6) *medz,* Armenisht "i madh", në Shqip është *madh.* Prej kohësh janë nxjerrë në pah edhe ngjashmëri të tjera, ku ndër më të rëndësishmit është: shumësi *-ik* i Armenishtes formohet nga mbaresa *–er, -eri* (*doun,* "shtëpi", shumës "dounerë"). Tashmë kjo është krahasuar me *–ar* të Etruskishtes (dhe *–eri?* "krahaso *shoqëri, vëtëra* (vite) të shqipes). (fq. 475)

Së fundi me gjuhët e Kaukazit lidhet gjuha Baske. Sipas një teorie të Trombetti-t kjo gjuhë është një mbetje e Kaukazishtes së lashtë, hapësira e të folurës të së cilës dikur shtrihej nga Kaukazi deri në Pirene dhe prej së cilës sot kanë mbetur vetëm dy ekstremitete: gjuha Baske dhe idiomat e Kaukazit.

Megjithatë, *ne vërejmë se ekzistojnë disa pika kontakti midis gjuhës Baske dhe asaj Shqipe. (fq. 477 - 478)*

Andre Piganjoli i ka shtuar tezës së origjinës orientale të Etruskëve edhe disa argumente të tjera... Një gjë e tillë i jep mundësinë autorit të mbërrijë në përfundimin se "afërsia midis Etruskëve dhe popujve të lashtë të Azisë së Vogël nuk mund të vihet në dyshim" (Les Etrusques, people d'Orient, fq. 338). (fq. 513- 514)

...Gjuha Etruske përafrohet dhe lidhet me disa gjuhë të Orientit, d.m.th. të Azisë së Vogël. Por këto gjuhë nuk janë me origjinë lindore. Ato janë gjuhë me bazë Indo-Evropiane, të vendosura në Azinë e Vogël. Po kështu, gjuha Etruske nuk është orientale.

Origjina e saj të shpie drejt Danubit.

Etruskët janë, pjesërisht, trashëgimtarët e Tursha-ve. Por Turshat nuk janë një popull me origjinë orientale. Ata janë Ilirë të lashtë (ose Thrako-Ilirë) të vendosur në Azinë e Vogël. (fq. 515)

KRISTO FRASHËRI:
"ETNOGJENEZA E SHQIPTARËVE"

Më 1836 dijetari freng Antoine d'Abbadie (Antuan d'Abadi), vuri re afrinë gjuhësore midis Baskishtes dhe gjuhëve Kaukaziane. (Kristo Frashëri, fq. 37).

Shënim B.P.: Cilave gjuhë konkretisht ??

NERMIN VLORA FALASKI:
"PELLAZGËT, ILIRËT, ETRUSKËT, SHQIPTARËT"

Shënim B.P.: "Gjuhët-mbesa" (armenishtja, persishtja, anglishtja, arabishtja, etj) – cilët kanë prindër?? (fq. 33-34)

Seneka na e konfirmon ardhjen e Etruskëve në Itali, ..., me këto fjalë: "Etruskët numëronin me "Saecula" historinë e tyre dhe mendonin se "Saecolum" i parë fillonte në vitet 1200-1100, para Krishtit". (Fq. 53)

Përsa i përket fisit të Etruskëve, Seneka na thotë se ata kanë ardhur më 1200 para Krishtit. (Fq. 271)

Shënim B.P.: Mos vallë me datën e rënies së Trojës??

FALLMERAYER:
"ELEMENTI SHQIPTAR NË GREQI"

Nga ana tjetër, shumë kohë para Likut, këshilltari gjerman i oborrit, fon Arndt, në fjalorin krahasues që kishte ndërtuar Pallasi me porosi të Katerinës II, mbas një analize, ç'është e vërteta të vetëm 56 fjalëve, kishte arritur në bindjen *se gjuha Shqipe ishte gjuha e stërlashtë e vendit dhe se ajo kishte afërsi të saktësuar me gjuhën Baske.* Rrjedhimisht, ajo i përkiste gjuhëve më të vjetra historikisht të njohura, që kishin sunduar në Europë para imigrimit të grekëve, sllavëve, latinëve dhe gjermanëve. Këto mbetje gjuhësh të stërlashta janë ruajtur deri në kohët tona vetëm në skajet malore të kësaj pjese të botës, domethënë tek irlandezët, skocezët e Skocisë së Sipërme, çudët, baskët dhe shqiptarët.

ROBERT D'ANGELY:
"ENIGMA, NGA PELLAZGËT TEK SHQIPTARËT"

Armenët janë një popull Mesopotamas. Nëse gjuha e tyre çfaq ngjashmëri me gjuhë të tilla, si Shqipja, Sanskritishtja, Greqishtja e të tjera, ky fakt nuk ka asgjë të veçantë, për shkak të kontakteve dhe marrëdhënieve të të gjitha llojeve, që populli Armen ka pasur që në origjinë me Argienët, të ekspeditës së parë Ariane ose Pellazge drejt Indisë. Na mjafton si provë e këtij kontakti ose e marrëdhënieve të Armenëve me Shqiptarët ndikimi i gjuhës së këtyre të fundit, që ka ushtruar lidhur me përdorimin e nyjes që vihet pas emrit. (fq. 234).

Në fakt, studimi i thelluar i Shqipes, i Greqishtes dhe i Latinishtes bën të dalë qartë, se marrëdhënia e afërisë që i lidh, është ai i nënës për Shqipen, dhe i bijave për dy të tjerat : Greqishten dhe Latinishten. (fq. 277).

EDWIN JACQUES:
"SHQIPTARËT. HISTORIA E POPULLIT SHQIPTAR NGA LASHTËSIA DERI NË DITËT E SOTME''

Shënim B.P.: Duke folur për gjuhëtarin Franz Bop (1791 – 1867) Jacques thotë: Ai vërejti ngjashmëri midis fjalorit të Shqipes, nga njera anë, dhe atij të Armenishtes ose të gjuhëve balltike, Letonishtes dhe Lituanishtes nga ana tjetër,... Bopi e botoi veprën e tij më 1854, duke vërtetuar përfundimisht se Shqipja bën pjesë në familjen e gjuhëve Indoeuropiane dhe nuk rrjedh nga ndonjë gjuhë tjetër simotër në kontinent, si edhe Greqishtja. (fq. 36).

Çuditërisht ky diagram tregon se ndër 47 gjuhë moderne me bazë Indoeuropiane, vetëm dy prej tyre, Shqipja dhe Armenishtja, kanë një prejardhje të drejtpërdrejtë nga Indoeuropianishtja, pa ndonjë prind të ndërmjetëm gjuhësor. (fq. 48).

Shënim B.P.: Të shihet kjo hamendje: N.q.s. gjuha Armene ka ngjashmëri me atë Shqipe, por ndryshon nga ajo e Albanëve të Kaukazit, atëhere do të thotë që Shqiptarët dhe Albanët e Kaukazit kanë ndryshime thelbësore në mes tyre, pra nuk janë i njëjti popull.

LUFTULLA PEZA, LILJANA PEZA:
"GJUHËT E LASHTA TË BALLKANIT DHE ANADOLLIT DHE FAMILJA PELLAZGJIKE E GJUHËVE"

Majani (1973) dhe N. Vlora (2004) kanë vërtetuar plotësisht lidhjen e gjuhës Etruske me gjuhën Shqipe, me anë të analizës së mjaft mbishkrimeve Etruske. (fq. 117)

Shënim B.P.: N.q.s gjuha Etruske zbërthehet njëkohësisht si me gjuhën Shqipe ashtu edhe me atë Armene, atëhere si lidhen midis tyre gjuha Shqipe dhe ajo Armene.

VAHAN SETYAN:
"ARMENIAN ORIGINS OF BASQUE"

Në kontrast me grupimin që i bënë Gray dhe Atkinson gjuhës Armene dhe asaj Greke duke i vendosur në një degë të veçantë, Serva dhe Petroni e trajtuan gjuhën Armene si një degë fare më vete, shumë pranë rrënjës, ndërsa dega tjetër - si degë që përmbante të gjitha gjuhët e tjera Indo-Europiane të mbetura. Për më tepër, rezultatet e tyre e vendosën gjuhën Greke në fazën fillestare të ndarjes, duke vendosur, gjithashtu, gjuhën Shqipe si pjesë e gjuhëve Indo-Europiane në krahasim me pozicionimin Indo-Iraniane të propozuar më parë nga Gray dhe Atkinson. Kështu, ata vendosën gjuhën Armene dhe pastaj atë Greke në rradhën e atyre që u shkëputën fillimisht nga pema e gjuhëve Indo-Europiane. (Fq. 106)

JANI VRETO:
"VEPRA TË ZGJEDHURA"

Shënim B.P.: Në shkrimet e Jani Vretos të përmbledhura në këtë vepër nga A. Uçi trajtohen shumë probleme interesante të gjuhës Shqipe. Po veçoj dy-tre elemente që paraqesin ngjashmëri edhe me trajtimin që u bëhet në gjuhën Armene :

1. Xhdo = çdo (Fq. 49)

Shënim B.P.: Problemi i shndrrimit të xh në ç dhe anasjelltas shfaqet edhe në dialektet e gjuhës Armene, p.sh.:

Fjala *ջուր* (xhur, çur) shkruhet me germën *"ջ"* (ça)

Armeno - Lindorët e lexojnë - *ջուր* (xhur)

Armeno - Perëndimorët e lexojnë - *ջուր* (çur)

Fjala *ճերմակ* (çermak, xhermag) shkruhet me germën *"ճ"* (xhe)

Armeno - Lindorët e lexojnë - *ճերմակ* (çermak)

Armeno - Perëndimorët e lexojnë - *ճերմակ* (xhermag)

2. Transformime (ia - ja; p.sh.: ziar – zjar)

(ea – ja; p.sh.: nusea – nuseja – nusja) (Fq. 50)

Shënim B.P.: I njëjti fenomen shfaqet edhe në gjuhën Armene, p. sh: mbaresa *"ɬա"* (jea) lexohet – "ja". Në këtë rast bie germa "e"

SHABAN DEMIRAJ:
"EPIRI, PELLAZGËT, ETRUSKËT DHE SHQIPTARËT"

Ajo (Gjuha Pellazge – *Shënim B.P.:*), si në Armenishte, i ka çaspiruar bashkëtingëlloret mbylltore të zëshme të aspiruara dhe mbylltoret e zëshme i ka shndrruar në të pazëshme, kurse mbylltoret e pazëshme i ka kthyer në të aspiruara. "Pellazgjishtja jep vetëm një shembull të një Indoeuropianishteje të pazëshme të aspiruar: *th,* e cila ruhet si e tillë ashtu si në Armenishte" (po aty fq.13 - e ka fjalën për veprën "Le Pelasgique" të Van Vindekens – *Shënim B.P.:*). (fq. 32)

JOHAN GEORGE VON HAHN:
"STUDIME SHQIPTARE"

"m" shndrrohet në *"p"* ose *"b"* (vërejtja nr. 92 dhe 103)

Fq. 304 kemi:

1. *Bagëti-a* tosk., *bakti-a* geg. ... tingujt *m* dhe *p* pësojnë ndryshime dialektore në fillim të fjalës, sepse *m*-ja asht gegënisht (ose ilirisht) dhe *p*-ja toskënisht (ose epirotisht). N.q.s. përdorim trajtën gegënishte, atëhere na del fjala Makëtia (ë- e pazanë nuk luen rol). Kuptimi i sotëm i kësaj fjale përmbledh hem gjatë e imta, hem gjatë e trasha

2. c. Të shihet shënimi nr. 188 kur flitet për fjalën (emnin) *"serb"* dhe të krahasohet me shënimin nr. 92 ku flitet .. ndërrimi i germës *"m"* me *"p"* ose *"b"*. Serbët e kishin me vete emrin kur u dyndën

në Ballkan, apo e morrën si nofkë nga vendasit që gjetën aty?? (Fq. 323, parag. i fundit) (*argjend - serm – serp – serb* – mos vallë kanë qenë përpunues argjendi ??)

3. Fq. 323: fjala *"serm"* – argjend; nëqoftëse i referohemi shndrrimit të germës *"m"* – në *"p"* ose *"b"* mund të rezultonte që të prodhonte fjalën *"serb".*

Shënim B.P: Shndrrimi i "p" në "b" dhe anasjelltas është një dukuri normale në gjuhën e folur Armene. Kjo dukuri përbën një nga elementet që dallojnë dialektin Lindor nga ai Perëndimor.

STANISLAO MARCHIANO
"STUDIME FILOLOGJIKE ZHVILLUAR ME GJUHËN PELLAZGO-ALBANE"

Por edhe nëse pranojmë hipotezën se janë pikërisht ata (*Shënim B.P.*: Kadmi me fenikasit) që kanë shpikur gjashtëmbëdhjetë shkronjat, siç thuhet pa një bazë të thelluar, duhet theksuar se nuk janë ata, që kanë shpikur zanoret dhe sidomos një zanore të veçantë të albanëve, që i përgjigjet tingullit të zanoreve italiane "e" dhe "o" = ë, e cila nuk mund të mësohet ndryshe përveçse duke dëgjuar mësuesin. (Fq. 21)

Shënim B.P.: Të kihet parasysh që edhe në gjuhën Armene germa "ë" ka përdorim shumë të gjerë e të veçantë!

INFORMACIONE

Informacion 1:

Shënim B.P: Gjuha Shqipe sot ka 36 germa.

Interesant është fakti që një gjë e tillë është pohuar nga Jani Vreto që më 1879, në "Allfabetore e Gluhesë Shqip", (botuar në Konstandinopojë, 1879).

Ja çfarë shkruan ai:

Alfabeta duhetë të ketë kaqë shkronjëza, sa zëre të vetëmë dhe të pandamë ka gjuha.

Gjuha Shqip ka tridhjet' e gjashtë zëre të vetëmë dhe të pandarë, edhe alfabet' e Shqipesë ka tridhjet' e gjashtë shkronjëza, edhe janë këto: a, b, c, ç, d, dh, e, ë, f, g, gj, h, i, j, k, l, ll, m, n, nj, o, p, q, r, rr, s, sh, t, th, u, v, x, xh, y, z, zh.

Zanore janë shtatë: a, e, ë, i, o, u, y

Bashkëtingëllore janë njëzet e nëntë: b, c, ç, d, dh, f, g, gj, h, j, k, l, ll, m, n, nj, p, q, r, rr, s, sh, t, th, v, x, xh, z, zh.

(Jani Vreto: Vepra të Zgjedhura, Fq. 49)

Shënim B.P: E njëjta gjë vlen të thuhet për gjuhën Armene, e cila po ashtu ka një alfabet të përbërë nga 36 germa

Informacion 2:

a. Gjuha e Albanëve të Kaukazit ka pasur 52 germa.
b. Tek libri "Sudime Shqiptare" e Johan Georg von Hahnit, Pjesa V, Fq. 378, me titull "Alfabeti i Shqipes", trajton një alfabet që ka 52 germa.
c. Pra, si Alfabeti i Albanëve të Kaukazit, po ashtu edhe ai që trajton Hahni në këtë libër, kanë të njëjtin numër germash. Te jetë një rastësi!?

Informacion 3:

Informacion më i plotë mbi ngjashmërinë e gjuhës Shqipe dhe asaj Armene mund të merret në librin "Gramatika e Gjuhës Armene" (Perëndimore dhe Lindore), B.Piranjani, albPaper, Tiranë, 2017

AUTORË QË KANË TRAJTUAR PROBLEMATIKËN E MËSIPËRME

(vendosur sipas rendit Alfabetik)

Aristidh P. Kola: "Arvanitasit dhe prejardhja e grekëve", (Shtëpia Botuese "55". Tiranë, 2002)

Berzh Piranjani: "Fjalë Shqipe të ngjashme me ato Armene"

Elena Kocaqi: "Shqipja – çelsi i gjuhëve Indoeuropiane", (botim i Shtëpisë Botuese "EMAL".)

Hraç Martirosian: "Etymological Dictionary of the Armenian Inherited Lexicon", 2010

Marika Butskhrikidze: "Studjuesja Gjeorgjiane: Ngjashmëri intriguese ndërmjet Shqipes dhe Armenishtes." Botuar në gazetën "Standart", fq. 18, të datës "E Hënë, 09.12.2013")

Nermin Vlora Falaski: "Pellazgët, Ilirët, Etruskët, Shqiptarët", (Shtëpia Botuese "Faik Konica", Prishtinë, 1998; botuar për herë të parë: 1984, Itali)

Robert Ellis: "Armenian origin of Etruscans", 1861

Origjina Armene e Etruskëve

Fjalë Shqipe që kanë lidhje me gjuhën Armene

Vahan Setian: "Origjinat Armene të Baskëve", Sh.B. "albPaper", Tiranë, 2019

Zacharie Mayani: "Etruskët fillojnë të flasin", (Sh.B. "Fan Noli", Tiranë, 2018; botuar për herë të parë 1973, Francë)

EMRA PERËNDISH (PELLAZGE?)

EDUARD SHNAIDER:
"PELLAZGËT E PASARDHËSIT E TYRE"

Shënim B.P.: Duke analizuar një kushtim gjetur në Kretë, autori (Eduard Shnaider) shkruan: Mbishkrim kushtimi gjetur në Kretë në alfabetin kretez-pellasgjik, poshtë shkrimi shqip që i përgjigjet fjalisë. Çdo shqiptar është në gjëndje me ja nxjerrë vetë kuptimin. Ne do ta japim në Shqipen e tashme.

"Pas mrekullisë nga ana e virgjëreshës që e shpëtoi Arkian, Arkakoklesi (i shoqi) i ban dhuratë *Anaisit* (hyjneshës.)" (përkthyesi) (fq. 149)

JOHAN GEORGE VON HAHN:
"STUDIME SHQIPTARE"

Zakonisht Ana Perenna[171] asht hyjnesha e vitit hanor të romakëve. Gojdhana thotë se ajo ka qenë *e bija e Belit,* e motra e Didos. Fq 322 :

Shënimi[294]: Anath, Antha, Antu asht nji hyjneshë Egjyptiane, e cila sipas Roethit, *shën. 226,* asht identike me Artemisin e grekëve.

Shfaqet në shkrimin e hieroglifeve si Tanath, Tanatha, Tanu; tingulli fillestar T, sipas Roeth, asht nyje (të jetë geg. Tanë, nji Tanath i cunguem? Me këtë kuptim ai do t'i shkonte emnit grek Artemis.) – Hyjnesha Anath ose Anait adhurohej edhe në të gjithë Azinë e mëparshme tek persët, kapadokët, armenët, dhe medët. .. (Fq. 374)

Shënimi[225]: Nji kangë shqipe thotë: dolla, dolla në ballë të malit; jam në ballë. Ndoshta ka të bajë me fjalën e greqishtes së vjetër *"balen"* – mbret; kjo fjalë, siç duket, asht nga origjina Fryge. A asht fis me fjalën semite *Baal, Bel – Zot?* Grimmi, Gesch. Der Deutch. Sprache, fq. 193, përmend mbretin e Dakasve, Dekebalin dhe mendon se ky emën asht nji apelativ; atëhere fjala shqipe në lidhje me fjalën fryge do të përkthehej "mbreti i dakëve, kryetari i dakëve... (Fq. 368)

hënë-a, tosk., *hanë*-a, geg. Femnore (Anna Perenna ose Peranna; këtë emën na e mbajmë identik me emnin e hyjneshës *Anaitis* të perso-fenikasve[294])

Shënim B.P.:

a. *bija e Belit* – për cilin Bel e ka fjalën ??

b. *Bel* – a nuk është zot, mbret, i plotfuqishëm në Babiloni?!

c. *Shumë interesante asht lidhja e Anës me Enean*, … – do të thotë që kanë qenë bashkëkohas; këtu të shihet kur ka ndodhur përleshja ndërmjet Hajkut dhe Belit??

MOISI KAGHANKATVACI:
"HISTORIA E ALBANËVE TË KAUKAZIT"

(Ndërmjet këtyre robërve) ishte edhe një grua e quajtur Taguhi (Takuhi), një nga gratë fisnike vendase të provincës së Uti nga fshati Bagink, një grua jashtëzakonisht e pasur, e cila kishte vizituar shpesh misionarët nga Jeruzalemi.

Beteja e saj ishte e ngjashme me atë të Hripsimesë, dhe kështu e madhja Taguhi u kurorëzua me kurorën e lavdishme dhe hyjnore të Krishtit. Po atë natë, ndërkohë që princi i pafe dhe forcat e tij po festonin dhe ishin në kulmin e haresë, një shenjë e mrekullueshme u shfaq nga Zoti. Çdokush e pa qartë një rreze të fortë drite që ndriçoi nga skena e martirizimit të Taguhisë. Mbeturinat e leckave te veshjes se saj, të shpërndara në tre grumbuj në pyll, ndriçonin si yje, dhe për një kohë të gjatë kjo dritë yjesh ndriçoi mbi martirët e shenjtë. Kur e panë këtë, njerëzit e quajtën vendin Astegh Blur (*Shënim B.P.:* Astegh Blur = Kodra e Yllit), ashtu siç njihet akoma edhe sot. (Fq. 80 - 81)

ARTAK MOVSISJAN:
"HISTORIA E ARMENISË", TIRANË, 2019

Perënditë e tokës Armene përmenden në marrëveshjet Hittito-Armene, ku në dorëshkrimet origjinale të dëmtuara mund të lexohen 13 emra perëndish. Në krye të perëndive të Hajasës (Armenisë) qëndronte Zoti i Plotfuqishëm i luftës dhe shtërngatës, në vend të dytë vjen Nëna Perëndeshë.

...

Panteoni i Zotave i Vanit përfaqëson paraqitjen më të shkëlqyer të treshes; Haldin (babain e zotave, krijuesin e tokës dhe qiellit), Tejshebanin (zotin e luftës, trimërisë dhe shtërngatës) dhe Shivinin (zotin e Diellit, qendra kryesore e adhurimit të të cilit ishte Tushpa, kryeqyteti i Vanit). Adhuroheshin gjithashtu edhe zotat e fushave, maleve, detrave, etj. Pas panteonit të mbretërisë së Vanit u shfaqën edhe forma të tjera panteonesh dhe, në prag të pranimit të Krishterimit, panteoni Armen shfaqet me një formë të re. (fq. 78)

Në krye të panteonit përsëri është treshja superiore: Aramazdi, Anahiti dhe Vahagu. Babai i zotave Aramazdi adhurohej si krijuesi

i tokës dhe qiellit, i mirësisë, bollëkut, trimërisë. Qendra kryesore e adhurimit të tij ishte Kështjella Ani në provincën e Daranahut. Nënës Perëndeshë Anahitit, së cilës i kishin mveshur titullin "Nëna e Artë", i atribuoheshin ndriçimi i tokës dhe ushqimi, të gjithë veprat mirëbërëse si edhe vigjiluese dhe mbrojtëse e kryeqytetit. Qendra kryesore e adhurimit të saj ndodhej në vendbanimin Jeriza (Jerzinka) në provincën Akilisene (Ekeghiats) dhe në kryeqytetin Artashat. Vahagu (brenda vendit të shenjtë Nemrut: Artak) adhurohej si zoti i luftës, trimërisë dhe shtërngatës; sipas një të dhëne, ai para së gjithash nderohej si "Zoti i Diellit". Tempulli kryesor i Vahagut është gjetur brenda Ashtishatit dhe quhet Vahe-Vanian (Vaheja i Vanit). (fq. 79)

Në periudhën e helenizimit, perëndive Armene ju vendosën korrespondenca me perënditë Greke (Aramzd - Zeusi, Anahit – Artemisi, Vahag – Heraklesi, Astik – Afrodita, Arek – Heliosi, Tir – Apolloni, etj). (fq. 80)

VENDBANIME SHQIPTARE QË KANË LIDHJE ME EMËRTIMIN "ARBËR"

1. ALBANOPOLIS

në

(Albania e Ballkanit)

Shënime nxjerrë nga libri:

"ARBNI"

(Historik, Gjeografik, Kishtar dhe Politik)

Shkruar nga: AUREL PLASARI:

Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Tiranë, 2020

Në librin III të Gjeografisë, kreu XIII, §23, duke përshkruar provincën romane të Maqedonisë, Ptolemeu ka shënuar: "I Albanëve; Albanopolis" si edhe ka dhënë gjatësinë gjeografike: 46° dhe gjerësinë 41° 5', pra me përafërsi në zonën midis Matit dhe Shkumbinit.*

**Shënim A. Plasari.:* Identifikimi më i pranueshëm i Albanopolisit të Ptolemeut është ai me Zgërdheshin, në rrëzën perëndimore të malit të Krujës ose në jugperëndim të rrugës nga Fushë-Kruja për Krujë, identifikim që e propozoi albanologu Johann Georg von

Hahn mbasi e hulumtoi vetë rajonin përkatës dhe nuk gjeti tjetër mbetje rrënojash që të përkonte me qytetin e shënuar në shek. II nga Ptolemeu... Deri sot e gjithë ditën kjo është hipoteza e mbetur në fuqi dhe e zhvilluar më tej. (Fq. 16-17)

Albanopolis

në

(Albania e Kaukazit)

Shënime nxjerrë nga Wikipedia:

Në Jetët e Shenjtorëve, hagiografi i shekullit të 18-të Alban Butler thotë se traditat popullore në lidhje me Shën Bartolomeun përmblidhen në Martirologjinë Romake, e cila thotë se ai "predikoi ungjillin e Krishtit në Indi; prej andej ai shkoi në Armeninë e Madhe, dhe kur ai kishte konvertuar shumë njerëz atje në besimin e Krishterë, ai u vra i gjallë nga barbarët dhe me komandën e mbretit Astiaxhes përmbushi martirizimin e tij".

Sidoqoftë, vetë Butler shfaq dyshime për pranimin e të dhënave gjeografike tepër fjalë për fjalë. Ai tregon se "India" ishte një emër që aplikohej rëndom nga shkrimtarët grekë dhe latinë për Arabinë, Etiopinë, Libinë, Parthinë, Persinë dhe tokat e Medëve. Në mënyrë të ngjashme termi Armeni e Madhe u përdor mjaft shpesh nga shkrimtarët mesjetarë për të treguar krahinat në rajonin midis Anadollit Lindor, Detit të Zi dhe Kaspikut.

Sidoqoftë, të paktën tre lokacione janë propozuar si vende të mundshme të Albanopolis: *Derbent* në Dagestan, Albyrak/Albac afër Başkale në rajonin e atëhershëm Armen të asaj që është tani Turqia Lindore dhe Baku, Azerbajxhan.

Kjo e fundit ka një sasi të caktuar të së vërtetës, duke qenë se zona e Azerbajxhanit të sotëm historikisht njihej si Albania, por asnjë provë përfundimtare nuk është gjetur për ndonjë teori të tillë.

Butler është gjithashtu skeptik ndaj sugjerimit të Albyrak (Albajrak), duke thënë ndërkohë, që pohimi sipas të cilit Bartholomeu predikoi dhe vdiq në Armeni është i mundur dhe është një traditë unanime midis historianëve të mëvonshëm të atij vendi; …shkrimtarët e hershëm Armenë i referohen pak ose aspak atij si të lidhur me kombin e tyre. Kështu, megjithëse një Manastir shumë i shenjtë Armen u kujdes për atë, që besohej të ishte varri i Bartolomeut në vend, kjo ishte ndoshta një ide e mëvonshme.

Shënim B.P.: Mendoj:

Albanopolis (i Kaukazit) – mendoj se është emër i vendosur në periudhën Aleksandrine (periudha para Krishtit) dhe ka ardhur në Ballkan në periudhën Romake me murgjit predikues të fesë së Krishterë (periudha pas Krishtit). Fillimisht si strehë e murgjve, mendoj, ka shërbyer Mali i Krujës (guva e Sari-Salltikut të sotëm). Prej këtej kanë zbritur për të ushtruar predikimin e tyre në Zgërdhesh (Albanopolis).

Mendoj se ky emër "Albanopolis" (në Shqipëri) i takon qytetit – gërmadhë të zbuluar në Zgërdheshin e sotëm, qytet që rezulton të ketë pasur edhe një kishë të vogël brenda saj. Kjo ka më tepër kuptim, se sa të mendosh që emri Albanopolis mund t'i ketë përkitur qytetit të Krujës. Nuk do kishte kuptim që brenda një kohe shumë të shkurtër t'i jetë ndrruar emri nga Albanopolis në Krujë. Për më tepër që emri "Albanopolis" mendohet të jetë eksonim, ndërkohë që emri "Krujë" ngulmohet se është endonim. Në fakt mendoj që emri Albanopolis mund të jetë përdorur nga Romakët për qytetin e Zgërdheshit, duke menduar që ai ka qenë një qytet i formuar nga të ardhur Albanë të Kaukazit apo mund t'i jetë vënë nga murgjit e posaardhur si efekt i ngjashmërisë me Albanopolisin e Bartolomeut.

Megjithatë, fakti, që në shek. e II[të], kur Albanopolisi përmendet nga Ptolemeu, Durrësi ishte një qytet i zhvilluar dhe një pikë strategjike Romake për veprimet në Lindje të perandorisë, dhe në

lindje të saj qëndronte një qytet tjetër, që nga pikëpamja strategjike ishte po aq i rendësishëm për kontrollin e lëvizjeve tokësore, që drejtoheshin drejt lindjes, një qytet që kontrollonte edhe lëvizjet tokësore jug-veri përgjatë gjithë zonës fushore të bregdetit Adriatik, që shtrihej ndërmjet Shkumbinit dhe Matit, një qytet që ishte edhe pika ndërlidhëse e qytetërimit Romak me zonën e Malësisë së panënshtruar që shtrihej në lindje të Durrësit, të bën të mendosh se ky qytet nuk ka qenë jashtë vëmendjes së Romakëve, të cilët mund ta kenë përgjithësuar si Qyteti i Lindjes dhe për rëndësinë strategjike që ka pasur ta kenë emërtuar për analogji me Albanopolisin e Kaukazit. Kjo do t'i jepte kuptim edhe hamendësimit se në periudhën Aleksandrine (periudha para Krishtit) shtegu i kalimit që ndodhej ndërmjet Maleve të Kaukazit dhe Detit Kaspik do të kishte qenë emërtuar Portat Albane dhe vetë Derbenti i sotëm atëhere do ketë qenë pasë quajtur Albanopolis.

Në krijimin e kësaj ideje të shtyn edhe fakti që për analogji mund të mendosh se Albanopolis shfaqet në territorin e Shqipërisë së sotme ashtu si shfaqet edhe Sebastea (Mali i Laçit ku ndodhet Shna Ndoj) (si rezultat i lëvizjes së predikuesve të fesë Kristiane). Jemi po në zonën e Kurbinit, një zonë e vështirë për t'u shkelur nga pushtuesi i huaj, sidomos në atë kohë.

Si Albanopolis, si Sebastea janë eksonime. Si Albanopolis, si Sebastea janë vizituar dhe banuar që në fillimet e Krishterimit nga predikues (murgj) të krishterë në rrugën e tyre drejt perëndimit. Si Albanopolis, si Sebastea kanë pasur objekte kulti të krishterë që në fillimet e Krishterimit. Mendohet që edhe Apostulli Pal dhe Pjetri kanë kaluar nëpër këto zona. Nuk do të ishte çudi që shkatërrimi i Zgërdheshit të jetë pasojë e zemërimit Romak ndaj përqafimit të fesë së krishtere nga banorët e këtij qyteti, përpara njohjes së saj si fe zyrtare nga ana e Perandorisë.

2. QYTETI ILIR NË ZGËRDHESH

Selim Islami

"Qyteti Ilir në Zgërdhesh"

Iliria, Nr. 2, 1972 (Fq. 195-213)

Botim i veçantë me rastin e "Kuvendit të parë të studimeve Ilire", mbajtur në Tiranë, më 15-21 Shtator 1972

Kanë kaluar pak më shumë se 100 vjet qëkurse J.G.Hahn vizitoi kalanë ilire në Zgërdhesh dhe hodhi mendimin se në këtë vend duhej kërkuar Albanopoli i vjetër.

...

Në Zgërdhesh, gjatë verës së vitit 1969 zhvilloi punimet një ekspeditë e Institutit të monumenteve të kulturës. ... Ky punim i kushtohet rezultateve historiko – arkeologjike të arritura prej saj.

Rrënojat e Zgërdheshit gjenden në jugperëndim të Krujës, një orë e gjysëm në këmbë larg saj dhe gjysmë ore larg nga fshati Zgërdhesh, në vendin e quajtur Kakariq. Një rrugë automobilistike fshati, që kthehet në gjysmën e rrugës Fushë-Krujë – Krujë, të çon pas pak minutash në rrëzë të qytetit antik. (Fq. 195)

Një portë tjetër e rëndësishme duhet të ketë qenë midis kullës nr. 5 dhe asaj nr. 6 të supozuar. Ajo përshkonte murin e Akropolit, diku para rrënojave të kishës mesjetare në F', për të lidhur qytetin e sipërm me të poshtmin. (Fq. 198 - 199)

Gjetjet arkeologjike tregojnë, nga ana tjetër, se qyteti ka qenë shtrirë edhe jashtë mureve rrethuese. Në një kodër të vogël, nga ana jugore, që gjenden përtej përroit të Lanës, pak a shumë në një vijë me murin rrethues të anës perëndimore, duken gjurmët e një godine, ka shumë të ngjarë, të një tempulli, kurse gjatë punimeve të ndërtimit në zonën përfund qytetit, në vitin 1961, janë gjetur

mbeturinat e mureve të një godine, një sasi tjegullash dhe një kokë luani, pjesë e një sime (Tab. V,4). (Fq. 199)

Më parë duhet të vëmë në dukje se lidhur me këtë çështje (*Shënim B.P.:* bëhet fjalë për kohën e ndërtimeve) deri vonë ka qenë pranuar mendimi i Prashnikerit, i cili, pa të drejtë, i ka quajtur të ngjashëm dhe të njëkohshëm muret e Zgërdheshit me ato të Lisit dhe i daton në shek. e IV p.e.s. Tani së fundmi Garashanin, duke u nisur nga mbishkrimi i Lambesas, mundohet të retifikojë Prashnikerin dhe e daton Zgërdheshin, bashkë me një varg qendrash të tjera, që sipas mendimit të tij lidhen me të, si një themelim të kohës së Agronit, në atë periudhë kur ai ishte në marrëdhënie miqësore me Demetrin II të Maqedonisë. (Fq. 203) Shtresa e dytë përmban material të kohës helenistike. … Si element datues për fillimin e saj na shërben qeramika apule e fundit të shek. IV dhe fillimit të shek. III p.e.s. sonë, të cilën e ndeshim menjëherë pasi mbaron shtresa sterile e çakëllit.

Jeta e qytetit na paraqitet me tërë larminë e saj në shtresën e IIItë, që përmban material të përzier helenistiko-romak. … Me elementet e saj ajo përcakton më mirë fizionominë e shtresës së dytë, cakton si kufi të fundit të saj shek. II p.e.s. dhe zbulon para nesh, në mënyrë më të qartë faktin se në shek. III-II p.e.s. qyteti ka jetuar periudhën e tij të lulëzimit. (Fq. 205)

Nga mallrat e importit që vinin në Zgërdhesh nëpërmjet Durrahut mbizotërojnë prodhimet apule të fundit të shek. IV dhe sidomos ato të shek. III-II p.e.s., midis të cilave duhet të shënojmë enët që kanë të aplikuar figurat me reliev. Ndeshen edhe fragmente të enëve të Megarës, por duket se tregtia me bregdetin italik jugor kishte dëbuar në këtë kohë nga Iliria gjithë konkurentët e tjerë.

Monedhat, që qarkullonin në këtë kohë në Zgërdhesh, janë kryesisht të Durrahut. Midis tyre gjejmë të tilla me Herakli-armë, që Durrahu i hedh në qarkullim qysh nga gjysma e dytë e shek. IV p.e.s. dhe të tjera me Zeus-trekëmbësh dhe Helios-anije, që i përkasin shekujve III dhe II p.e.s. Duket se Zgërdheshi me këtë qytet kishte

lidhje të forta ekonomike. Nga monedhat e huaja deri tani njohim vetëm një ekzemplar të Demetrit II të Maqedonisë me mburojë-përkrenar. (Fq. 207)

Gjetjet që u bënë në Nekropolin, buzë murit rrethues të anës perëndimore te kulla nr. 2 dhe porta bri saj, (Gërmimi b) tregojnë se aty nga shek. IV i erës sonë, muret rrethues kanë humbur rëndësinë dhe funksionet e dikurshme, përderisa buzë tyre vendoset një varrezë. Që nga kjo kohë qyteti fillon të braktiset dhe banorët e tij duket se shpërngulen në një qendër tjetër. Ka shumë të ngjarë që kjo të ketë qenë Kruja e ardhshme, ... (Fq. 208)

Thamë më lart se Hahnit i takon merita të ketë hedhur i pari mendimin se tek rrënojat e Zgërdheshit duhet të kërkohet Albanopoli i vjetër. Interesi për këtë qytet u lidh kështu me emrin kombëtar të shqiptarëve. Që nga kjo kohë, argumenta të reja bindëse, në favor të këtij mendimi, nuk kanë dalë; megjithatë hipoteza e Hahnit mbetet gjithmonë një hipotezë pune me shumë vlerë, që ka nxitur dhe do të nxisë edhe në të ardhmen kërkimet shkencore në këtë drejtim. Fakti që në zonën midis Matit dhe Shkumbinit, në të cilën Ptolemeu vendos Albanopolin si qytet më të shënuar, nuk njohim një qendër tjetër më të madhe antike se sa Zgërdheshin, e bën këtë hipotezë të qëndrojë ende e fortë...

Duhet të mos harrojmë nga ana tjetër, se tek rrënojat e Zgërdheshit kemi mbeturinat e një qyteti të rëndësishëm ilir, që u ngrit e lulëzoi në afërsitë e një qyteti të madh si Dyrrahu, prandaj edhe për këtë fakt meriton të gjurmohet posaçërisht. (Fq. 208)

Shënime nxjerrë nga "KRUJA" Travel Book; blue-albania.com:

Të dhënat e para të shkruara për këtë qytet (*Shënim B.P.:* bëhet fjalë për Albanopolisin "Zgërdheshin") gjenden në veprën e Ptolemeut "Gjeografia" në shek. e II të erës sonë. ... Sipas studimeve qyteti ka lulëzuar nga mesi i shek. IV deri në shek. I p.e.s..

3. BISHTI I PALLËS OSE KEPI I PALIT (DURRËS)

Nxjerrë nga Interneti:

...shefit të regjimit komunist Enver Hoxha nuk i pëlqente në fillimin e vitit 1976 emri Bishti i Pallës (i Skënderbeut), pasi toponimi bizantin Kepi i Palit figuronte 4-5 shekuj më parë se të shfaqej Skënderbeu me pallë. Duke filluar nga viti 2005 Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë përdor toponimin "Kepi i Palit" për atë të vjetër që njihet si "Bishti i Pallës".

Në hartat anglishtfolëse toponimi është "Cape Pali", kurse në ato italiane "Capo Pali. Sipas historianëve, Krishterimi është përcjellë tek Arbrit drejtpërdrejt nga goja e vetë apostujve të Jezus Krishtit dhe filloi të përhapej në Iliri që në shek. I^{rë} të erës sonë si fe e ligjshme.

Apostulli Pal rreth vitit 57 shkruan: "Kështu, prej Jeruzalemit e përqark e deri në Iliri kam kryer shërbimin e ngjalljes se Krishtit, duke u përpjekur të ungjillëzoj atje, ku nuk ishte i njohur emri i Krishtit".

Mendohet se Pali ka qëndruar në një kep në veri të Durrësit.

Ka hamendësime, që fillimisht ky kep të jetë quajtur "Kepi i Palit".

Në toponiminë e Durrësit ai njihet si Bishti i Pallës.

4. DERVENI (DERVENDI)

(qytet në Republikën e Shqipërisë)

Shënime nxjerrë nga Wikipedia:

Sipas Wikipedias emri Derbent (Darbant) i është vënë qytetit të themeluar në ngushticën tokësore që ndodhet ndërmjet Maleve të Kaukazit dhe Detit Kaspik. Për vetë pozicionin strategjik që mbart si rrugë kalimi nga lindja në perëndim (dikur e cilësuar si një nga "Rrugët e Mëndafshit") ajo ka marrë edhe emrin "Porta Hyrëse apo Dalëse", "Porta e Hekurt apo Bllokuese", "Porta e Kalimit", etj. Kush zotëronte Derbentin, zotëronte edhe "Rrugën e Mëndafshit".

Shënim B.P.: Rastësia e do që në pjesën fushore, që ndodhet ndërmjet Zgërdheshit dhe detit Adriatik (njëlloj si pozicioni gjeografik i Derbentit në Dagestan), të krijohet edhe një qytet i quajtur sot Derven.

Interesant është fakti që Derveni (Dervend – e përdor Shtjefën Gjeçovi) shqiptar ka një pozicion pothuajse të njëjtë strategjik me të, kur bëhet fjalë për rrugën që lidh Shqipërinë e mesme me atë veriore. Edhe si kuptim shfaq po atë ngjashmëri "Der – Vend = Dera e Vendit".

Shënim B.P.: Të bën përshtypje ngjashmëria e madhe në të shprehur dhe në kuptim ndërmjet Derbentit Kaukazian dhe Dervendit Shqiptar.

Derbenti

(qytet në Republikën e Dagestanit, Rusi)

Shënime nxjerrë nga Wikipedia:

Derbent (rusisht: Дербе́нт; persisht: دربند; lezgjisht: Кьвевар, Цал; azerbajxhanisht: Dərbənd; Avar: Дербенд), i romanizuar më parë si Derbend, është një qytet në Republikën e Dagestanit, Rusi, i vendosur në Detin Kaspik.

Derbenti zë portën e ngushtë midis Detit Kaspik dhe Maleve të Kaukazit që lidh Stepën Euroaziatike në veri dhe Pllajën Iraniane në jug.

Derbent rrjedh nga persishtja "Darband" (persisht: دربند, literalisht "Portë e mbyllur", nga dar "portë" + band "fashë, bandë", literalisht, "portë mbyllëse", "portë bllokuese", "porta e Rripit"), duke iu referuar shtegut të ngushtë kalimtar.

5. KRUJA

Shënime nxjerrë nga Wikipedia:

Kruja ishte e banuar nga fisi i lashtë ilir i Albanëve. Në 1190 Kruja u bë kryeqyteti i shtetit të parë shqiptar në mesjetë, Principata e Arbërit. Më vonë ishte kryeqyteti i Mbretërisë së Albanisë, ndërsa në fillim të shekullit të 15të Kruja u pushtua nga Perandoria Osmane.

Emri i qytetit lidhet me fjalën shqipe kroi, krua, që do të thotë "burim", nga Proto-Shqiptar * krana <* krasna.

Qyteti shfaqet për herë të parë si Kroai (në Greqishten Mesjetare Κροαί) në dokumentet bizantine të fillimit të *shekullit VII.* Në latinishten mesjetare ishte e njohur si Croia, Croya dhe Croarum. Gjatë epokës Osmane ajo njihej gjithashtu si Ak Hisar ose Akçahisar nga fjalët turke ak (e bardhë) dhe hisar (kështjellë).

Në kohët e lashta krahina e Krujës ishte e banuar nga fisi ilir i Albanëve, ndërsa qyteti ndodhet pranë vendbanimit ilir të epokës së hekurit, të quajtur Zgërdhesh. Disa studiues e kanë identifikuar Zgërdheshin me vendbanimin kryesor të Albanëve, Albanopolisin, ndërsa të tjerët e identifikojnë Albanopolisin me vetë Krujën. Gjatë Luftërave Ilire zona e Krujës u pushtua nga Republika Romake.

Fillimisht një kështjellë me madhësi të mesme si qendrat e tjera urbane, Kruja u zgjerua në një qytet ndoshta nga *shekulli i gjashtë* deri në shekullin e nëntë pas Krishtit. Në 1190 Kruja u bë kryeqyteti i shtetit të parë shqiptar të mesjetës, Principata e Arbërit, e themeluar nga Progoni i Shtëpisë së Progonit.

Shënime nxjerrë nga "KRUJA" Travel Book; blue-albania.com:

Kruja është një vendbanim shumë i hershëm që daton tre shekuj para Krishtit. Dy fise ilire, Albanët dhe Parthinët banuan në qytezat Brysaka dhe Albanopolis.

6. DURRËSI

Shënime nxjerrë nga Wikipedia:

Durrësi u themelua nga kolonistët e lashtë grekë nga Korinti dhe Korfuzi me emrin Epidamnos rreth shekullit të 7të para Krishtit në bregdetin e Taulantëve Ilirë. Më vonë i njohur si Dyrrachium, ai në thelb u zhvillua për t'u bërë domethënës pasi u bë një pjesë integrale e Perandorisë Romake dhe pasardhësit të saj Perandorisë Bizantine. Via Egnatia, vazhdimi i Via Appia, filloi në qytet dhe çoi nëpër pjesën e brendshme të Gadishullit Ballkanik për në Kostandinopojë në lindje.

Në antikitet, qyteti u emërua Epidamnos (Ἐπίδαμνος) dhe Dyrrhachion (Δυρράχιον) në Greqishten klasike dhe më pas Epidamnus dhe Dyrrachium në Latinishten klasike. Epidamnos është më i vjetri nga dy toponimet. Eshtë vërtetuar nga Thyqididi (shekulli V p.e.s.), Aristoteli (shekulli IV p.e.s.) dhe Polibi (shekulli 2 p.e.s.). Dyrrachium u bë emri i qytetit pasi Republika Romake mori kontrollin e rajonit pas Luftërave Ilire në 229 p.e.s. Drejtshkrimi latin i "y" mbajti formën e Greqishtes Dorike, që shqiptohej si "Durrakhion". Ky ndryshim i emrit është vërtetuar tashmë në letërsinë klasike. Titus Livius, në fund të shekullit të parë para Krishtit, shkruan në Ab Urbe Condita Libri se në kohën e Luftërave Ilire (afërsisht 200 vjet më parë) qyteti nuk ishte i njohur si Dyrrachium, por si Epidamnus. Pomponius Mela, rreth 70 vjet më vonë se Titus Livius, ia atribuoi ndryshimin e emrit faktit që emri Epidamnos u kujtoi Romakëve fjalën Latine "damnum", që për ta nënkuptonte të keqen dhe fatin e keq. Plini Plaku, i cili jetoi në të njëjtën periudhë, e përsëriti këtë shpjegim në veprat e tij. Romakët gjithashtu përvetësuan emrin e ri sepse tashmë ishte në përdorim më të shpeshtë nga qytetarët e qytetit.

Emri Dyrrhachion shpjegohet zakonisht si një përbërje Greke nga δυσ- "keq" dhe ῥαχία "breg shkëmbor, përmbytje, valë të zhurmshme", një shpjegim i lënë të kuptohet tashmë në antikitet

nga Cassius Dio, i cili shkruan se u referohej vështirësive të vijës bregdetare shkëmbore, ndërsa raportonte gjithashtu se autorë të tjerë romakë e lidhën atë me emrin e një heroi eponim Dyrrachius. Ndërtimi mitologjik i emrit të qytetit u rregjistrua nga Appiani (shekulli 2të pas Krishtit) i cili shkroi se mbreti i barbarëve të këtij vendi, Epidamnus i dha emrin qytetit. Djali i vajzës së tij Dyrrachius, ndërtoi një port afër qytetit, që ai e quajti Dyrrachium. Stephanus i Bizantit përsëriti këtë konstruksion mitologjik në veprën e tij. Është e paqartë nëse dy toponimet referoheshin fillimisht në zona të ndryshme të territorit të qytetit apo nëse ato i referoheshin të njëjtit territor. Literatura klasike tregon se ato më shumë i referoheshin zonave të ndryshme fqinje fillimisht. Gradualisht, emri Epidamnus ra nga përdorimi dhe Dyrrachium u bë emri i vetëm për qytetin.

Emrat modernë të qytetit në shqip (Durrës) dhe italisht (Durazzo, shqiptim italisht: [duˈrattso]) rrjedhin nga Dyrrachium / Dyrrachion.

Vendi banohej nga njerëz të lashtë: prania e Brygëve duket se konfirmohet nga disa shkrimtarë antikë, Taulantët Ilirë (ardhja e tyre është vlerësuar të ketë ndodhur jo më vonë se shekulli i 10 para Krishtit), ndoshta edhe Liburnët që u zgjeruan në jug në shekullin e 9të para Krishtit. Qyteti u themelua nga kolonët grekë në vitin 627 para Krishtit në bregdetin e Taulantëve. Sipas autorëve antikë, kolonistët grekë ndihmuan Taulantët për të dëbuar Liburnët dhe u përzien me popullsinë lokale duke futur elementin Grek në port.

Krishterimi në Durrës dhe gjetkë në Shqipëri ka një prani që daton që nga lashtësia klasike. Traditat e krishtere tregojnë se arqipeshkvia e Durrësit u themelua nga apostulli Pal ndërsa ai predikonte në Iliri dhe Epir dhe se kishte ndoshta rreth shtatëdhjetë familje të krishtera në qytet që nga koha e apostujve.

7. SARI - SALLTIK

Shpella e shenjtë e malit të Krujës mban brenda shumë mistere. Historitë paranormale nisin në vitin 1325, kur në Krujë mbërrin nga Turqia Sari Salltiku, i dërguari i Haxhi Bektesh Veliut. Ai u vendos pikërisht në këtë vend, për të ushtruar ritet fetare larg njerëzve.

DY EMRA VENDBANIMESH TË HERSHME DHE TË SOTME

1. SEBASTEA (NË SHQIPËRI)

Shënime nxjerrë nga libri:

"Histori e vogël mbi Shejtnoren e Shna Ndout në Sebaste"

Shkruar nga: At Marjan Prelaj ofm

At Donat Kurti ofm

Botime Franceskane, Shkodër, 2013

Nuk mund të qitet poshtë hipoteza: se Françeskajt, menjiherë, menduen me ngrehë kuvendin e Novicjatit, e, për kah vendi, si ishte koha, kërkuen vend vetmie, kështu mali i Sebastes u pa ma i përshtatun për kuvend Novicjatit. Me dashtë me caktue me saksi: se në çë vjetëkje ngrehë këtu në Sebaste kuvendi, nuk asht e mujtun, por, afërsisht nga fillimi i shekullit XIV, e aty pari 1300. (Fq. 11)

Historiani At Donato Fabianich në librin e tij "Storia dei Frati Minori in Dalmazia e Bossina" (1863), shkruen:

N'Arkidioçezin e Durrësit, në shpat të nji malit, në nji vend të vetmuem, gjindet kuvendi i vjetër i Fretënvet të Vogjel të Sebastes. Mbi të nuk dihet vjeti se kur u themelue. Në librin e Provincës përmendet gjithmonë si kuvend i Novicjatit, e, ku shpesh mbaheshin mbledhjet provinciale. (Fq. 12)

Shejtnorja e Sebastes gjindet e ngrehun mbi nji lëndinë të vogël të shpatit të malit, qi ban emrin "Sebaste", kund nji orë kambë prej qytetit të Laçit. (Fq. 13)

Jo larg nga kisha, me u ul pak poshtë, në shkrep të gjallë gjendet nji shpellë, me xanë deri 20 vetë, qi thirret: *"Shpella e Shna Vlashit".* Gojëdhana thotë: se në këtë bigë të malit jetoj i mëshehun ky ipeshkv i shejt. Këtu shtegtarët, që vijnë në Shejtnore, ulen e ndalen në shpellë me mderue Shna Vlashin, i cili kje kapë prej ushtarvet të Agrikolaut e martirizue në Durrës*. (Fq. 14)

* *Sh. Gjeçovi: Sebaste n'Armeni a po n'Arbëni?*

SEBASTEA (në Anatoli)

dhe

Shën Vlashi i Sebasteas

Shënime nxjerrë nga Wikipedia:

Vlashi i Sebastesë (Armenisht: *Սուրբ Վլասի*, Soorp Vlasi; Greqisht: Άγιος Βλάσιος, Agios Vlasios) ishte një mjek dhe peshkop i Sebasteas në Armeninë historike (sot Sivasi modern, Turqi) i cili nderohet si një shenjt dhe martir i krishterë.

Vlashi nderohet si një shenjtor në kishat Katolike Romake, Ortodokse Lindore dhe Ortodokse Orientale dhe është shenjt mbrojtës i sëmundjeve të leshit dhe sëmundjeve të fytit. Në Kishën Latine, festa e tij bie më 3 Shkurt, në Kishat Lindore më 11 Shkurt. Sipas Acta Sanctorum, ai u martirizua duke u rrahur, sulmuar me krehra hekuri dhe prerë kokën.

Referenca e parë për Vlashin janë shkrimet mjekësore të Avetius Amidenus (rreth vitit 500 pas Krishtit) ku kërkohet ndihma e tij në trajtimin e objekteve të mbërthyer (të ngecur) në fyt.

Marco Polo raportoi për vendin ku "Messer Shën Vlashi fitoi

kurorën e lavdishme të martirizimit", Sebastea; faltorja afër malit të kështjellës u përmend nga Uilliam i Rubrukut në 1253. Sidoqoftë, duket se nuk ekziston më.

Nga të qenit një shërues i sëmundjeve trupore, Shën Vlashi u bë një mjek i shpirtrave, pastaj u tërhoq për një kohë në një shpellë ku qëndroi në lutje. Si peshkop i Sebasteas, Vlashi e frymëzoi popullin e tij sa me shembullin e tij, ashtu edhe me fjalët e tij, dhe virtytet e mëdha dhe shenjtëria e shërbëtorit të Zotit u vërtetuan nga shumë mrekulli. Nga të gjitha anët, njerëzit vinin tek ai për shërimin e sëmundjeve trupore dhe shpirtërore. Thuhet se ai ka shëruar kafshë (të cilët erdhën tek shenjtori vetë për ndihmën e tij) dhe se ishte ndihmuar nga kafshët.

Në vitin 316, Agricolausi, guvernatori i Kapadokisë dhe Armenisë së Vogël, filloi një persekutim me urdhër të Perandorit Licinius dhe Shën Vlashi u kap. Pas marrjes në pyetje dhe një fshikullimi të ashpër, ai u fut në burg, dhe më pas iu pre koka.

Aktet legjendare të Shën Vlashit janë shkruar 400 vjet pas vdekjes së tij, dhe janë apokrife dhe, ndoshta, trillime.

Legjenda është si më poshtë:

Vlashi, i cili kishte studiuar filozofi në rininë e tij, ishte një mjek në Sebaste në Armeni, qyteti i lindjes së tij, i cili ushtroi artin e tij me aftësi të mrekullueshme, vullnet të mirë dhe devotshmëri. Kur peshkopi i qytetit vdiq, ai u zgjodh për ta pasuar, me brohoritjen e të gjithë njerëzve. Shenjtëria e tij u shfaq përmes shumë mrekullive: nga e gjithë rreth, njerëzit erdhën tek ai për të gjetur shërime për shpirtin dhe trupin e tyre; edhe kafshët e egra erdhën në tufa për të marrë bekimin e tij. Në vitin 316, Agricola, guvernatori i Kapadokisë dhe i Armenisë së Vogël, pasi kishte mbërritur në Sebastia me urdhër të perandorit Licinius për të vrarë të krishterët, arrestoi peshkopin. Ndërsa po e çonin në burg, një nënë vendosi djalin e saj të vetëm, gati duke u mbytur deri në vdekje prej një kocke peshku, në këmbët e tij, dhe fëmija u shërua menjëherë. Pavarësisht, guvernatori, në

pamundësi për ta bërë Vlashin të heqë dorë nga besimi i tij, e rrahu atë me një shkop, ia shqeu mishin me krehje hekuri dhe ia preu kokën.

Bekimi i Shën Blaise

Sipas Akteve, ndërsa Vlashi po merrej në paraburgim, një nënë e dëshpëruar, fëmija i vetëm i së cilës po mbytej prej një hale peshku, u hodh te këmbët e tij dhe iu lut ndërhyrjes së tij. I prekur nga pikëllimi i saj, ai bëri lutjet e tij dhe fëmija u shërua. Si pasojë, Shën Vlashi thirret për mbrojtje kundër dëmtimeve dhe sëmundjeve të fytit.

Në shumë vende ditën e festës së tij jepet bekimi i Shën Vlashit: dy qirinj (ndonjëherë të ndezur), të bekuar në festën e Prezantimit të Zotit (Candlemas), mbahen në një pozicion të kryqëzuar nga një prift mbi kokat e besimtarëve ose të njerëzve dhe preken në fyt me ta. Në të njëjtën kohë jepet bekimi i mëposhtëm: "Përmes ndërmjetësimit të Shën Vlashit, peshkop dhe martir, Zoti ju çliroftë nga çdo sëmundje e fytit dhe nga çdo sëmundje tjetër". Pastaj prifti bën shenjën e kryqit mbi besimtarët.

Legjenda

Ndërsa gjuetarët e guvernatorit e çuan Vlashin përsëri në Sebastea, gjatë rrugës, thotë historia, ata takuan një grua të varfër, derrin e së cilës e kishte kapur një ujk. Me komandën e Vlashit, ujku ia ktheu derrin pronarit të saj, i gjallë dhe i padëmtuar. Kur ai arriti në kryeqytet dhe ishte në burg në pritje të ekzekutimit, plaka, derrin e së cilës ai kishte shpëtuar, erdhi për ta parë atë, duke sjellë dy qirinj të shkëlqyer dylli për të shpërndarë errësirën e qelisë së tij të errët. Në Perëndim nuk kishte asnjë grup që nderonte Shën Vlashin para shekullit të tetë.

Kulti i Shën Vlashit

Si një nga Katërmbëdhjetë Ndihmësit e Shenjtë, Vlashi u bë një nga shenjtorët më të njohur të Mesjetës. Ndjekësit e tij

u përhapën në Evropë në shekujt 11 dhe 12 dhe legjenda e tij rrëfehet në Legenda Aurea të shekullit të 13-të. Shën Vlashi është shenjtori i kafshës së egër.

Ai është mbrojtës i Urdhrit Armen të Shën Vlashit. Në Itali ai njihet si San Biagio. Në vendet spanjolle, ai njihet si San Blas dhe e ka huazuar emrin e tij në shumë vende (shih San Blas). Disa vende në Portugali dhe Brazil janë emëruar gjithashtu pas tij, ku ai quhet São Brás (shih São Brás).

Në Kroaci

Shën Vlashi (kroatisht: Sveti Vlaho ose Sveti Blaž) është shenjt mbrojtës i qytetit të Dubrovnikut dhe më parë mbrojtës i Republikës së pavarur të Raguzës. Në Dubrovnik festa e tij festohet çdo vit në 3 Shkurt, ditë kur reliktet e shenjtorit, koka e tij, pak kocka nga fyti, dora e tij e djathtë dhe e majta, janë parakaluar në shenjtore.

Sebastea - Historia e emrit të qytetit Sebastea

Sivas (latinisht dhe greqisht: Sebastia, Sebastea, Sebasteia, Sebaste, Σεβάστεια, Σεβαστή; armenisht: *Սեբաստիա* - Sebastia;) është një qytet në Turqinë qendrore dhe selia e Provincës Sivas.

Dihet pak nga historia e Sivas para shfaqjes së saj në periudhën romake. Në vitin 64 para Krishtit, si pjesë të riorganizimit të tij të Azisë së Vogël pas Luftës së Tretë Mithridatike, Pompei i Madh themeloi një qytet në vendin e quajtur "Megalopolis". Dëshmitë numizmatike sugjerojnë se Megalopolis ndryshoi emrin e saj në vitet e fundit të shekullit të I para Krishtit në "Sebaste", e cila është forma femërore e emrit grek që korrespondon me Augustus. Emri "Sivas" është versioni turk që rrjedh nga emri Sebasteia, pasi qyteti ishte i njohur gjatë perandorisë së vonë Romake (Bizantine). Sebasteia u bë kryeqyteti i provincës së Armenisë së Vogël nën perandorin Dioklecian, ishte një qytet me një farë rëndësie në historinë e

hershme të Kishës së Krishterë; në shekullin e 4të ishte shtëpia e Shën Vlashit dhe Shën Pjetrit nga Sebasti, peshkopë të qytetit dhe të Eustathius, një nga themeluesit e hershëm të monastizmit në Azinë e Vogël. Gjithashtu, ishte vendi i martirizimit të Dyzet Dëshmorëve të Sebastesë, po në shekullin e 4të.

...

Sebastos (Koinē Greqisht: Σεβαστός, i romanizuar: Sebastós, lit. 'Venerable One, Augustus', shqiptimi Grek Bizantin: [se.vasˈtos], shumës σεβαστοί, sebastoí [se.vasˈty]) ishte një titull honorifik i përdorur nga Grekët e lashtë në lartësinë e titullit perandorak romak të Augustit. Forma femërore e titullit ishte sebastē (σεβαστή). Nga fundi i shekullit të 11-të, gjatë periudhës Komneniane, ai dhe variantet e prejardhura prej tij, si sebastokrator, protosebastos, panhypersebastos dhe sebastohypertatos, formuan bazën e një sistemi të ri të titujve të gjykatave për Perandorinë Bizantine.

Termi shfaqet në Lindjen Helenistike si një nder për perandorët Romakë nga shekulli I e tutje, duke qenë një përkthim i titullit Latin Augustus. Për shembull, Tempulli i Sebastoit në Efes i është kushtuar dinastisë Flaviane. Ky emërtim gjithashtu u përdor në emërtimin e qyteteve për nder të perandorëve Romakë, të tilla si Sebaste, Sebasteia dhe Sebastopolis.

Epiteti u ringjall në mes të shekullit të 11të - në formën femërore sebaste - nga Perandori Konstandin IX Monomachos (mbretëroi 1042–1055) për zonjën e tij Maria Skleraina, së cilës i dha nderime gati-perandorake. Një numër individësh u kualifikuan si sebastoi më pas, të tillë si Konstantin Keroularios, ose Isaac Komnenos dhe vëllai i tij, perandori i ardhshëm Alexios I Komnenos (1081–1118).

Titulli iu dha gjithashtu sundimtarëve të huaj dhe u përhap në shtetet fqinje, të ndikuara nga Bizanti, si Bullgaria, ku një sebastos ishte kreu i një rrethi administrativ dhe Serbia, ku titulli ishte përdorur për zyrtarë të ndryshëm.

2. SISAK

Nxjerrë nga Wikipedia – kur kërkon informacion
për qytetin Sisak të Kroacisë

Sisak (kroatisht: [sǐːsak], i njohur edhe me emra të tjerë alternativë) është një qytet në Kroacinë qendrore, ….

Para se t'i përkiste Perandorisë Romake, e cila i dha asaj emrin latin Siscia, rajoni ishte Keltik dhe Ilir dhe qyteti atje u quajt Segestica ose Segesta. Shkrimtarët e lashtë Grekë i referoheshin qytetit: Σισκία; e romanizuar: Siskía, …

Nxjerrë nga Wikipedia – Sisak (eponym) – kur kërkon
informacion për qytetin Sisak të Kroacisë

Sisak (Armenian: *Սիսակ*) ishte paraardhësi legjendar i shtëpisë princërore armene të Syuni, i quajtur gjithashtu Siunids, Syunid dhe Syuni. Historiani armen Movses Khorenatsi deklaron se Sisak ishte vëllai i Harmar i cili ishte i njohur si Arma, i biri i Gegham dhe një pasardhës i patriarkut legjendar të armenëve, Hayk.

Gegham ishte vendosur pranë Liqenit Sevan dhe, pas vdekjes së tij, tokat që përfshinin zonat nga Liqeni Sevan deri në lumin Araxes u trashëguan nga Sisak.

Nxjerrë nga Wikipedia - kur kërkon informacion
për qytetin Sisak të Armenisë

Sisian (armenisht: *Սիսիան*) është një qytet dhe qendra e komunitetit urban të Sisianit, në Provincën Sjunik në Armeninë jugore.

Zona e Sisianit të sotëm ishte e njohur gjithashtu si Sisakan dhe Sisavan gjatë kohërave antike dhe më vonë në Mesjetë. Sipas Moisi Khorenacit, emri i Sisakanit - dhe më pas Sisian - rrjedh nga Sisak, një paraardhës legjendar i shtëpisë princërore Armene të Sjunit.

Gegharkunik (Armenisht: *Գեղարքունիք*) është një krahinë e Armenisë.

Krahina e Gegharkunikut ndodhet në pjesën lindore të Armenisë, në kufi me Azerbaixhanin. Gegham ishte babai i Sisak (themeluesi i dinastisë Siunia) dhe Harma (gjyshi i Ara e Bukura). Malet Gegham dhe Liqeni Gegham (sot njihet si Liqeni Sevan) janë emërtuar gjithashtu prej Geghamit.

DUKE LEXUAR LIBRIN:

AUREL PLASARI: "ARBNI"

(Historik, Gjeografik, Kishtar dhe Politik)

Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Tiranë, 2020

Në njërin nga këto fragmente, nr. 69, Hekateu ka rregjistruar: ... "Arbrët, fis pranë Adriatikut të Taulantëve dhe fqinj me Helidonët". (Fq. 9)

Shënim B.P.: Hekateu (Historian dhe gjeograf Grek, 550-476 p.e.s.)

Specialisti i Antikitetit të Europës juglindore Nicholas Hammond, që ka trajtuar emrat e fiseve të përmendura nga Hekateu, në hartën nr. 14 me titull Iliria jugore dhe Epiri në kohën e Hekateut i ka vendosur këta "Αβροί" në vendin që u takon në bazë të përshkrimit të Hekateut: buzë Adriatikut, mes lumenjve Mat dhe Shkumbin. (Fq. 10)

Duke ritheksuar rezervën e shprehur tanimë për vlerën e çekjeve nga *Vjetarët Anonimë të Raguzës* si dëshmi të derivuara prej burimesh dytësore, është për t'u vënë re që autorët e vëll. I të tekstit *Historia e Shqipërisë* (1959) kanë qenë të sigurt kur e kanë caktuar këtë shekull si kufi kohor me pohimin: "duke filluar nga shek. VIII nuk mund të flitet më për popullsi Ilire në kuptimin e mëparshëm, por për arbëreshë ose shqiptarë, pasardhësit e ilirëve antikë". (Fq. 28)

Më 1932, tërthorazi prej një studimi të enciklopedistit Benedikt Dema, u shfaq një informacion i Shtjefën Gjeçovit i rregjistruar si vijon:

"A. Shtjefën Gjeçovi, qi për disa vjetë kje famullitar në Laç të Kurbinit, i pyetun prej A. Pashk Bardhit, qe se shka shkruen përmbi krahinë t'Arbënit: "Mbas gojet të popullit të Kurbinit e të rretheve, Arbnija (nënkuptohet Arbni) përshin *Dervendin,* Larushkun e Blajin e mbaron me fushë të Brezës (Prezës) e me fushë të Krues"". (Fq. 56)

Gati dhjetë vite më vonë mbas studimit tek "Minerva" Myderrizi iu kthye edhe njëherë temës së Arbnit me një studim të ri, duke e rrokur temën në mënyrë ballore dhe duke e vështruar nga disa kënde. Ai i qëndroi përfundimit të Sirdanit, etj., që emri në fjalë rrjedh nga fjala *arbe=rrafshinë* dhe ka kuptimin e fushës që shtrihet në mes malesh dhe deti. Po ashtu pranoi, duke e përsaktësuar, tezën e Logorecit, Gjeçovit dhe Sirdanit:

"Në Kurbi emni Arben përdoret për të tregue nji krahinë fushore që gjindet në perëndim të Kurbinit, emri Arbënuer për të kallzue banorin e kësaj krahine: Jam malsuer e s'jam Arbënuer; qenke veshë si grue Arbëni; u dynd mal e Arbën. Duhet shënue se emni mal këtu asht përdorë për të tregue Kurbinin vetëm e jo të gjitha krahinat malsore të Shqipnisë". (Fq. 59-60)

Mbas kësaj Karli I lëshonte diplomën e përmendur, atë të 21 shkurtit 1272, që mbahet si datë e themelimit të "Mbretërisë së Arbërisë". (Fq. 209)

… autori nuk mund të mos shenjojë me një reper të veçantë, për t'u mbajtur parasysh nga ana e lexuesit, atë moment historik që ka për cak kohor mesin e shek. XVIII, kur emrin e *Arbërisë* e zëvendësoi plotësisht ai i Shqipërisë duke ua lënë termin *Albania* të huajve si ekzonim dhe duke adoptuar endonimin e ri *Shqipëria.* (Fq. 229)

Për të interpretuar adoptimin nga populli të "një emri tjetër pa histori", shkoi më tej me hulumtimet e veta Osman Myderrizi. ... Dhe mbas një vargu argumentesh, ka përfunduar me tezën e tij:

"Në shekullin e XVIII ngjau një kthesë e madhe në Shqipëri. Shumica e popullit tonë, për arsye të ndryshme, e la krishterimin dhe kaloi në myslimanizëm. Emri i vjetër nuk tregonte vetëm kombësinë, por edhe besimin. Më ndërrimin e besimit u ndje nevoja edhe e ndërrimit të tij […]. Emri kombëtar në Shqipëri u ndërrua vetëm pse u ndërrua besimi". (Fq. 230-231)

Mendime të miat që dalin nga leximi i librit sipërpërmendur:

Albanët e Albanisë së Kaukazit nuk kanë lidhje me barazimin Alban = Malësor, pasi Albania e Kaukazit, që ndodhet në bregun e majtë të lumit Kur e deri në detin Kaspik, është kryesisht zonë fushore. Këtu mendoj se vlen të përdoret barazvlershmëria:

Alban = Lindor

Përsa i përket Albanisë së Ballkanit, mendoj që edhe këtu vlen të thuhet e njëjta gjë, vetëm se në këtë rast, për shkak të pozicionit lindor (përkundrejt Romës Perandorake) dhe malor njëkohësisht, barazvlershmërisë së mësipërme mund t'i jetë shtuar nënkuptimi përçmues:

Alban = Lindor = Malësor (Malok)

Këtu duhet mbajtur në vëmendje fakti që ky emërtim "Alban" u shfaq në Ballkan vetëm pas pushtimit Romak (nga Ptolemeu në shek. II p.e.s.), por edhe kjo shfaqje erdhi në formën Greke të emërtimit të qyteteve (Albanopolis). Fakti që shfaqet afro 100 vjet pas ekzekutimit të Bartolomeut në Albanopolisin e Albanisë së Kaukazit, për të cilin mendoj se ka më shumë gjasa të identifikohet me Derbentin e Dagestanit të sotëm, më shtyn të mendoj se murgj dhe përkrahës Kristianë prej Albanisë së Kaukazit (apo Gjeorgjisë dhe Armenisë), në valën e përndjekjes të partizanëve Kristianë, që shoqëroi kapjen dhe ekzekutimin e Bartolomeut, të jenë larguar prej andej duke ndjekur rrugën tashmë të njohur të shpëtimit për të ardhur në Ballkan, ku shpresonin të gjenin strehë si edhe një terren të ri ku të mund të ushtronin predikimet e tyre.

Mendoj që fillimisht janë vendosur në zonën malore të Kurbinit, një zonë ku, sipas studjuesve shqiptarë e të huaj, pushtimi i huaj është ndjerë pak ose aspak. Dhe mbase është pikërisht Zgërdheshi vendstrehimi parësor i tyre dhe terreni ku ata ushtruan predikimin e tyre në favor të Kristianizmit.

Le të analizojmë disa fakte:

1. Në Zgërdhesh janë gjetur rrënojat e një qytetërimi të hershëm
2. Emri i këtij qyteti të hershëm nuk njihet
3. Në Zgërdhesh janë gjetur rrënojat e një kishe shumë të hershme
4. Pozicioni gjeografik i Zgërdheshit përputhet me përshkrimin e bërë nga Ptolemeu për qytetin Albanopolis në Ballkan
5. Ptolemeu ka folur për këtë qytet në shek. II pas Krishtit
6. Shenjti Bartolome u ekzekutua në shek. I pas Krishtit (afro një shekull më parë) në qytetin e emërtuar Albanopolis (në Albaninë e Kaukazit)
7. Trajta Albanopolis e emrit të qytetit Kaukazian (trajta Greke e emërtimit të qyteteve) duhet të jetë e kohës së Aleksandrit të Madh ose e pasardhësve të tij, që sunduan në atë zonë.
8. Trajta Albanopolis e emrit të qytetit Ballkanik, përmendur nga Ptolemeu, nuk ka asnjë bazë të jetë endonim, por, në të njëjtën kohë, nuk ka asnjë bazë të mendohet që është një sajim i çastit i Ptolemeut apo i cilitdo pushtetar Romak, i cili në rastin më të mirë do të përpiqej ta emërtonte me një emër, që të përfaqësonte diçka latine.
9. Trajta Albanopolis e emrit të qytetit Ballkanik, përmendur nga Ptolemeu, është eksonim (po nga vjen?)

Duke analizuar faktet sa më sipër, gjëja më e thjeshtë që të vjen ndër mend është:

Këtë emër dikushi e ka ditur, e ka mbartur me vete, e ka ruajtur me fanatizëm atë dhe simbolin që ai përfaqësonte, duke u përpjekur ta ringjallte atje ku do të gjente tokën e përshtatshme për të mbjellë

farën që kishte me vete.

Ekzistenca e një kishe të hershme në rrënojat e tij, si dhe fakti që qyteti nuk përmendet më në Mesjetën e hershme (tashmë është Kruja që fillon të shfaqet në historinë e Shqipërisë), më bën të mendoj se qyteti i Zgërdheshit (Albanopolisit) me kishën e tij janë rrënuar prej Romakëve përpara se Kristianizmi të njihej si fe zyrtare nga Perandoria Romake.

Gjithashtu mendoj se murgjit apo përkrahësit Kristianë të ardhur fillimisht janë strehuar në Sari – Salltik. Jo më kot mali i Krujës quhet Mal i Shenjtë. Ndërtimi i Krujës si qytet-fortesë (qytet-Kala) ka qenë kundërpërgjigja e banorëve vendas ndaj shkatërrimit të Zgërdheshit.

Arbën (Arbë) tek Aurel Plasari shfaqet si nënkuptim i "fushës" (i tokave të ulta, jo atyre malore). Kur flitet për zonën e Arbërit ajo mendohet se duhet kërkuar në zonën fushore që kufizohet në lindje nga Malësitë e Kurbinit e të Krujës dhe deti Adriatik nga perëndimi, si edhe në hapësirën ndërmjet lumenjve Mat dhe Shkumbin në drejtimin veri – jug. Pra flitet për hapësirë fushore, gjë që lë të kuptosh se fjala "Arban" apo "Alban" nuk ka lidhje me fjalën "Mal".

Shënim: Të shihet përdorimi i fjalës Armene "*արտ* (art, ard) – fushë; arë (tokë e punueshme)" tek "Fjalori përmbledhës", fq. 350 dhe tek Fq. 563, pika "e" – Përdorime të fjalës *"արտ"* (art, ard) – fushë; arë

Thuhet që më 12 Shkurt 1272 shpallet themelimi i "Mbretërisë së Arbërisë" nga Karli I d'Anzhu.

Në këtë rast si do të tingëllonte më mirë:

Themelimi i "Mbretërisë së Malësisë" ?? (Malësorëve ??)

Themelimi i "Mbretërisë së Fshatarësisë" ?? (Fshatarëve ??)

Themelimi i "Mbretërisë së Fushës" ?? (Fusharakëve ??)

Themelimi i "Mbretërisë Lindore" ?? (Lindorëve ??)

Themelimi i "Mbretërisë së Lindjes" ??

Kjo vetëm sa përforcon idenë se emri "Alban" (Arban) është përdorur për të treguar banorët e zonës lindore të Romës Perandorake.

“Studiova, ah! Filozofinë,
Jurisprudencë dhe Medicinë,
Mjerisht edhe Teologjinë
Që nga themeli me zell e me durim,
Dhe ja ku jam un’, ky lolo trutharë
Aspak më i mençur se më parë.”

“Fausti”

Johann Wolfgang von Goethe

A

DISA EMRA HISTORIANËSH, GJUHËTARËSH APO STUDJUES TË FUSHAVE TË NDRYSHME QË PËRMENDEN NË FAQET E KËTYRE SHKRIMEVE

TË KOHËS SË LASHTË

Dionisi i Halikarnasit

Dionisi i Halikarnasit (60 B.C – vdiq pas vitit 7 BC) ishte dijetar i lashtë helen nga Halikarnasi i Karisë. Jetën e tij e kaloi kryesisht në Romë në kohën eAugustit.

Eskili (greqisht : Αισχυλος)

Ishte një dramaturg i madh i Greqisë antike. Ai lindi në vitin 525 para Krishtit, në Eluzinë, afër Athinës. I takonte një familjeje aristokrate. Ai jetoi në kohë kur Grekët ishin në luftë me Persët, ku edhe vetë mori pjesë në luftën kundër tyre. Pjesën më të madhe të jetës e kaloi në Athinë, ndërsa vdiq në Gela të Sicilisë në vitin 456 para Krishtit. Ishte tragjediani i parë i madh i antikitetit grek. Së bashku me Sofoklin dhe Euripidin janë themelues të tragjedisë.

Herodoti

Herodoti është një historian i lashtë Grek. Është i njohur për shkrimin e librit "Historitë", që është një studim me përshkrime të hollësishme mbi origjinën e Luftërave Greko-Persiane.

Lindur: 484 BC, në Halikarnassus të Perandorisë Persiane (sot – qyteti Bodrum i Turqisë);

Vdekur: 425 BC në Thurii, Itali.

Kombësia: Greke

Hesiodi (shekulli 8-7 p.e.s.)

Homeri – është autori i supozuar i Iliadës dhe Odiseut, dy poezi epike që janë veprat themelore të letërsisë antike greke.

Mendohet që ka jetuar rreth shekullit të 9të p.e.s.. Shkenca ka pranuar si vendlindje më të mundshme Smirnën, qytet kolonial grek në Azinë e Vogël (Izmiri i sotëm në Turqi)

Horaci

Quintus Horatius Flaccus, i njohur në botën anglishtfolëse si Horace, ishte poeti kryesor lirik romak gjatë kohës së Augustit (i njohur edhe si Octavian)

Lindur: 08 Dhjetor, 65 BC, Venusia, Roman Republik

Vdekur: 27 Nëntor, 08 BC, Romë

Kombësia: Roman

Ksenofoni

Ksenofoni i Athinës ishte një filozof i lashtë grek, historian, ushtar, mercenar dhe student i Sokratit.

Lindur: 431 BC, Erkia

Vdekur: 354 BC, Thrakë

Moisi Khorenaci (Movses of Chorene)

Moisi Khorenatsi ishte një historian i shquar Armen nga periudha e Antikitetit të Vonë dhe autori i Historisë së Armenisë. Khorenatsi është kredituar me veprën më të hershme të njohur historiografike mbi historinë e Armenisë të shkruar në gjuhën Armene, por ishte gjithashtu edhe një poet dhe gjuhëtar.

Lindur: 410 AD, Taron

Vdekur: ?? Armeni

Pausanias

Pausanias ishte një udhëtar dhe gjeograf Grek i shekullit të dytë pas Krishtit, i cili jetoi në kohën e perandorëve Romakë - Hadrian, Antoninus Pius dhe Marcus Aurelius. Ai është i famshëm për përshkrimin e tij të Greqisë, një vepër e gjatë që përshkruan Greqinë antike nga vëzhgimet e tij të dorës së parë. Lindur: Lidia

Vdekur: 180 AD

Strabo (Straboni)

Strabo ishte një gjeograf, filozof dhe historian grek, që jetonte në Azinë e Vogël gjatë periudhës kalimtare të Republikës Romake në Perandorinë Romake.

Lindur: 63 BC, Amasia, Turqi

Vdekur: 23 AD Amasia, Turqi

Kombësia: Greke

Tuqididi (Thuqididis)

Historian dhe general Athinas (460 – 400 BC). Ishte historiani i parë i vërtetë, nëse merret se Herodoti është babai i Historisë. Në veprën e tij ai përshkruan edhe luftën civile të Epidamnit, në vtin 436 p.e.s. dhe ndërhyrjen e fisit ilir të Taulantëve në këtë luftë.

Virgjili

Publius Vergilius Maro, që zakonisht quhet Virgil, ishte një poet i lashtë romak i periudhës Augustiane.

Lindur: 15 Tetor, 70 BC, Virgilio, Itali

Vdekur: 21 Shtator, 19 BC, Brindisi, Itali

Shënim B.P.: Sa më sipër është marrë nga Wikipedia.

TË KOHËS SONË

1. Aleksandër Meksi (Shqiptar), (Lindur: 8 Mars 1939)
2. Aleksandër Mici (Shqiptar), (Lindur: 1935, Fier)
3. Aristidh P. Kola (Arvanitas, Greqi), (1944 - 2000)
4. Artak Movsisjan (Armen), (Lindur: 10 Prill 1979, Yerevan)
5. Artashes Abegian (Armen), (1877 – 1955)
6. August Schleicher (Gjerman), (1821 - 1868)
7. Aurel Plasari (Shqiptar), (Lindur: 16 Shtator 1956, Tiranë)
8. Bernardino de Bindoni (Italian), (rreth 1500 - 1570)
9. Christopher J. Walker (Anglez), (1942 – 2017)
10. Dhimitër Kamarda (Arbëresh, Itali), (1821 - 1882)
11. Eduard Schneider (Francez), (1880-1960)
12. Jacques Edwin E. (Amerikan), (1908 - 1966)
13. Elena Kocaqi (Shqiptare)
14. Eqerem Çabej (Shqiptar), (1908 - 1980)
15. Franc Bop (Gjerman), (1791 – 1867)
16. Garegin D. Nalbandian (Armen)
17. Gotfrid Vilhelm Leibnic (Gjerman), (1646 - 1717)

18. Gustav Meyer (Austriak), (1850 – 1900)
19. Gustav Weigand (Gjerman), (1860 - 1930)
20. Gjon Marku (Shqiptar), (Lindur: 1967)
21. Hans Eric Tunman (Suedez), (1746 - 1778)
22. Hans Krahe (Gjerman), (1898 - 1965)
23. Holger Pedersen (Danez), (1867 – 1953)
24. Ismail Qemal Vlora (Shqiptar), (1844 - 1919)
25. J. Ph. Fallmerayer (1790 - 1861), Gjerman
26. Jani Vreto (Shqiptar), (1822 – 1900)
27. Johan Georg von Hahn (Austriak), (1811 - 1869)
28. Johann Thunmann (Suedez), (1746 – 1778)
29. Joseph Ritter von Xylander (Gjerman), (1794 - 1854)
30. Karl Grimberg (Suedez), (1875 - 1941)
31. Kim Ghahramanyan (Armen), (1942-2014)
32. Kristian Sandfeld – Jensen (Austriak), (1873 – 1942)
33. Kristo Frashëri (Shqiptar), (1920 – 2016)
34. Liljana Peza (Shqiptar), (Lindur: 1946, Tiranë)
35. Louis Benlöw-in (Francez), (1818 – 1900
36. Luftulla Peza (Shqiptar), (Lindur: 1934, Tiranë)
37. Luigi Luca Cavalli-Sforza (Italian), (1922 - 2018)
38. Maksimilian Lambertz (Austriak), (1882 – 1963)
39. Marika Butskhrikidze (Gjeorgjiane)
40. Mark Tirta (Shqiptar), (Lindur: 1935, Mirditë)
41. Mathieu Aref (Shqiptar), (Lindur: 1935, Kairo, Egjypt)
42. Moisi Kaghankatvaci (Daskhuranci) (Armen)
43. Muharrem Abazaj (Shqiptar)

44. Muzafer Korkuti (Shqiptar), (Lindur: 1936)
45. Nermin Vlora (Falaski) (Shqiptare), (1921 - 2004)
46. Nikollë Keta (Arbëresh, Siçili), (1740 - 1803)
47. Norbert Jokli (Austriak), (1887 – 1942)
48. Robert d'Angely (Francez), (1893 – 1966)
49. Robert Ellis (Anglez), (1820- 1885)
50. Selim Islami (Shqiptar), (1927 - 2001)
51. Shaban Demiraj (Shqiptar), (1920 - 2014)
52. Spiro Konda (Shqiptar), (1862, Dardhë, Korçë – 1967, Tiranë)
53. Stanislao Marchiano (Italian)
54. Vahan Setian (Armen)
55. Vaso Pasha (Shqiptar), (1825 – 1892)
56. Wilhelm Obermüller (Austriak) (1809 - 1888)
57. Zakaria Mayani (Francez), (1899 - 1982)
58. Zef Skiroi (Arbëresh, Itali), (1865 - 1927)
59. Zef Krispi (Arbëresh, Itali), (1781 - 1859)

B

LITERATURA E PËRDORUR

(Renditja sipas Mbiemrit të Autorit)

Abazaj, Muharrem: "KODI I GJUHËS PELLAZGO - SHQIPE ", EMAL, Tiranë 2011.

Abegian, Artashes "Geschichte Armeniens", 1948

Aref, Mathieu (Arif Mati): "Mikenët = Pellazgët, (Greqia ose zgjidhja e një enigme)", Plejad, 2008

Bindoni, (Bernardino de Bindoni): Scanderbeg – Princi i Epirit, (Sh.B. Turdiu, Tiranë, 2018; botuar për herë të parë Venezia, 1544)

Butskhrikidze, Marika: "Studjuesja Gjeorgjiane: Ngjashmëri intriguese ndërmjet Shqipes dhe Armenishtes." (Botuar në gazetën "Standart", fq. 18, të datës "E Hënë, 09.12.2013")

Cavalli-Sforza, (Luigi Luca Cavalli-Sforza): Gjenet, Popujt dhe Gjuhët, (Besa, Tiranë, 2012; referuar për herë të parë Francë 1981)

Colquhoun, (Sir Patrick Colquhoun & Vaso Pasha): "Pellazgët, Pasardhësit e tyre të sotëm dhe origjina pellazge e poemave të Homerit". Botime Artini. Prishtinë 2017 (botuar për herë të parë: 1894)

Çabej, Eqrem: "Hyrje në indoeuropianistikë" (Leksionet e Prishtinës) i Eqrem Çabej, Botimet " Çabej ", 2008

D'Angely, Robert: "ENIGMA, nga pellazgët tek shqiptarët ", "Botimet TOENA" Tiranë, 1998. (botuar për herë të parë: 1962, Francë)

Demiraj, Shaban: "Epiri, pellazgët, etruskët dhe shqiptarët", Akademia e Shkencave e Shqipërisë , InfoBotues, Tiranë 2008.

Ellis, Robert: "Armenian origin of Etruscans". 1861 (botuar për herë të parë: 1861)

Falaski, (Nermin Vlora Falaski): "Pellazgët, ilirët, etruskët, shqiptarët". Shtëpia Botuese "Faik Konica", Prishtinë, 1998 (botuar për herë të parë: 1984, Itali)

Fallmerayer, J. Ph.: "Elementi shqiptar në Greqi". Tiranë, Nëntor 2003 (botuar për herë të parë: (1857-1861)

Frashëri, Kristo: "Etnogjeneza e shqiptarëve", vështrim historik, botimet M&B, Tiranë 2013.

Ghahramanyan, Kim: "1500-Years-Old Fundaments of Law and Order in Artsakh", Yerevan, 2010

Grimberg, Karl: Historia botërore dhe qytetërimi (Libri 1). Botuar 1963, Stokholm

Hahn, (Johan Georg von Hahn Dr. Jur.): "Studime shqiptare", (Tiranë, IDK 2013; botuar për herë të parë Gjermanisht: 1854)

Instituti i Shkencave: Fjalor i Gjuhës Shqipe, Tiranë, 1954

Islami, Selim: "Qyteti Ilir në Zgërdhesh", Iliria, Nr. 2, 1972 (Fq. 195-213) (Botim i veçantë me rastin e "Kuvendit të parë të studimeve Ilire", mbajtur në Tiranë, më 15-21 Shtator 1972)

Jacques, Edwin: "Shqiptarët. Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme", "Kartë e Pendë", Fondacioni Abraham Linkoln, Tiranë, 1996. (botuar për herë të parë: 1995)

Kaghankatvaci (Daskhuranci), Moisi: "Historia e Albanëve të Kaukazit", albPAPER, Tiranë, 2019

Kocaqi, Elena: "Albanët", botim i Shtëpisë Botuese "Emal", Korrik 2012

Kocaqi, Elena: "Roli Pellazgo – Ilir në formimin e kombeve dhe gjuhëve europiane" botim i tretë i Shtëpisë Botuese "EMAL".

Kocaqi, Elena: "Shqipja – çelsi i gjuhëve Indoeuropiane", botim i Shtëpisë Botuese "Emal".

Kola, (Aristidh P. Kola): "Arvanitasit dhe prejardhja e grekëve". Shtëpia Botuese "55". Tiranë, 2002

Konda, Spiro: "Shqiptarët dhe problemi pellazgjik". Botim i parë, Tiranë 1964

Korkuti, Muzafer: Parailirët, ilirët, arbërit. Botimet "Toena". Tiranë 2003

Marchiano, Stanislao: Studime filologjike zhvilluar me gjuhën Pellazgo-Albane, (Gent Grafik, Tiranë, 2019; botuar për herë të parë Napoli 1882)

Marku, Gjon: "Ndërfana", (Geer, Tiranë, 2008)

Mayani, Zacharie: "Etruskët fillojnë të flasin", Shtëpia Botuese " Fan Noli ", Tiranë, 2018 (botuar për herë të parë 1973, Francë)

Meksi, Aleksandër: "Albania e Kaukazit dhe shqiptarët". (Kopjuar nga botimi në "Univers" 11, Tiranë 2009)

Mici, Aristotel: "Prejardhja e emrit shqiptar", botim i dytë, "Botimet Dudaj", Tiranë, 2012.

Movsisjan, Artak : "Historia e Armenisë", albPAPER, Tiranë, 2019

Nalbandian, (Garegin D. Nalbandian): "Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit", albPAPER, Tiranë, 2020

Obermüller, Wilhelm: Popujt e Alpeve, (Sh.B. Turdiu, Tiranë, 2019; botuar për herë të parë Vienë, 1874)

Peza, Luftulla Peza & Liljana: "Gjuhët e Lashta të Ballkanit dhe Anadollit dhe familja Pellazgjike e gjuhëve". Geer, Tiranë 2018

Piranjani, Berzh: Fjalor Armenisht – Shqip, (rreth 13 000 fjalë), albPaper, Tiranë, 2015

Piranjani, Berzh: Fjalor Shqip - Armenisht, (rreth 11 000 fjalë), albPaper, Tiranë, 2016

Piranjani, Berzh: Gramatika e Gjuhës Armene (Perëndimore dhe Lindore), albPaper, Tiranë, 2017

Plasari, Aurel: "ARBNI" (Historik, Gjeografik, Kishtar dhe Politik), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2020

Qemali, (Ismail Qemal Vlora): "Kujtime", (Grand Prind)

Setian, Vahan: "Armenian origins of Basque", 2017

Shneider, Eduard: "Pellazgët e pasardhësit e tyre", përkthyer e paraqitur nga Lek Pervizi, botuar nga I.H.P.V.K.A, Tiranë, 2009. (botuar për herë të parë: Dhjetor 1893, Kostantinopojë)

Tirta, Mark: "Etnologjia e Shqiptarëve", (Geer, Tiranë, 2003)

Thunmann, Johann: Historia dhe gjuha e Shqiptarëve dhe Vllehëve, (Gent Grafik, Tiranë, 2018; botuar për herë të parë Leipzig, 1774)

Vaso Pasha (Sir Patrick Colquhoun & Vaso Pasha): "Pellazgët, Pasardhësit e tyre të sotëm dhe origjina pellazge e poemave të Homerit". Botime Artini. Prishtinë 2017 (botuar për herë të parë: 1894)

Vlora, (Nermin Vlora Falaski): "Pellazgët, ilirët, etruskët, shqiptarët". Shtëpia Botuese "Faik Konica", Prishtinë, 1998 (botuar për herë të parë: 1984, Itali)

Vreto, Jani (1822 - 1900). Shtypshkronja "8 Nëntori, Tiranë 1973 (botuar për herë të parë: 1878)

Walker, Christopher J. :"Armenia", A Very Brief History , Yerevan, 2014

Xylander, (Joseph Ritter von Xylander): "Gjuha e Albanëve ose Shkipëtarëve" (Sh.B. Turdiu, Tiranë, 2018; botuar për herë të parë Frankfurt am Main, 1835)

Shënim Informativ B.P.:

Krahas materialeve sipërpërmendur janë konsultuar edhe një sërë fjalorësh të tjerë të gjuhës Armene (dialekti Perëndimor dhe Lindor) me qëllim saktësimin e kuptimit të fjalëve të gjuhës Armene gjatë ballafaqimit me fjalët e gjuhës Shqipe në kapitullin ku bëhet fjalë për to.

Listimi i mëposhtëm i shërben qëndrimit korrekt ndaj sa më sipër është thënë.

Հայերեն - Իտալերեն Բառարան; Կարինե Մկրտչյան, Երևան, հեղինակային հրատարակություն, 2010. (16 500 բառ եւ բառակապակցություն)

Dizionario Armeno – Italiano; Karine Mkrtchyan, Yerevan, Edizione d'Autore, 2010. (16 500 parole e combinazioni delle paroli)

Բառարան Հայերէն – Իտալերէն; Հ. ՎԱՀԱՆ ՎՐԴ ՕՀԱՆԵԱՆ, Վենետիկ – Ս. Ղազար 1996

Dizionario Armeno – Italiano; P.Vahan Ohanian, Venezia – S. Lazzaro, 1966

Իտալերեն - Հայերեն Համառոտ Բառարան; Երևանի Համալսարանի Հրատարակչություն, Երևան 2001 (մոտ 12 000 բառ)

Dizionario Breve Italiano - Armeno; Edizione dell' Universita di Erevan, Erevan 2001 (circa 12 000 voci)

Անգլերեն - Հայերեն / Հայերեն – Անգլերեն Բառարան; կազմողներ: Սոնա Սեֆերյան, Լյուդմիլա Հովհաննիսյան, Աննա Խաչատրյան, Տաթեվիկ Քալաեջյան, Գայանե Գրիգորյան; Արեգ, Երևան 2009 (շորջ 40 000 բառ եւ արտահայտություն)

English – Armenian / Armenian – English Dictionary; compiled by: Sona Seferian, Ludmila Hovhannisian, Anna Khachatrian,

Tatevik Kalaejian, Gayane Grigorian; Areg, Yerevan 2009 (over 40 000 entries)

Հայերէն – Անգլերէն Արդի Բառարան; Աշխատասիրեցին: Վեր Տիգրան Խնդրունի եւ Մարտիրոս Գուշագճեան; Հրատարակչատուն Կ. Տոնիկեան եւ Որդիք, Պեյրութ 1970, Երեվան 1992

Armenian – English Modern Dictionary; by Rev. Dicran Khantrouni & Mardiros Koushakdjian; G. Doniguian & Sons Publishing House, Beirut 1970, Yerevan 1992

Armenian – English / English – Armenian; Diana Aroutunian and Susanna Aroutunian; Hippocrene Books, New York

Ռուսերէն Հայերէն / Հայերէն Ռուսերէն Բառարան; Լուսիկ Մաքսութեան, Մարիամ Կիրակոսյան, Սամվել Գասպարյան; Արեգ, Երեվան 2007 (շորջ 22 000 բառ)

Հայ-Ռուսերէն Բառարան; Երկրորդ լրացրած հրատարակություն; կազմեցին եւ խմբագրեցին: պրոֆ. Ա.Ս. Կարիբյան, պրոֆ. Ե. Գ. Տեր Մինասյան, Մ. Ա. Գեվորգյան; Հայաստանի Պետական Հրատարակչություն, Երեվան 1960 (շորջ 40 000 բառ)

Fjalor Rusisht – Shqip; Instituti i Shkencave i R.P. të Shqipërisë; Shtëpia botonjëse Shtetërore e Fjalorëve të Huaj dhe Nacionalë, Moskë – 1954 (rreth 25 000 fjalë)

Русско - Албанский Словарь; Институт Наук Республики Албании Государственное Издзтельство Иностанних и Национальных Словарей Москва – 1954 (25 000 слов)

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Indo-Europa : shqiptarët dhe armenët;
shqipja dhe armenishtja : [nxjerrë nga
shkrime të studjuesve shqiptarë dhe të huaj]
/ përgat. e red. Berzh Piranjani.
- Tiranë : Albpaper, 2021, 722f.; 14x21 cm,
Bibliogr.

ISBN 978-9928-05-278-0

1. Gjuha shqipe 2. Gjuha armene 3. Gramatika historike
4. Albanologë 5. Etimiologjia 6. Studime

811.18 '36-112
811.19 '36-112



9 789928 052780

Çmimi: 1200 lekë